REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjia nr 1, Blloku "T. Skendo", Kuçovë, Shqipëri Tel +35531123306 , e-mail bashkiakucove@yahoo.com,
web www.bashkiakucove.gov.al

DOKUMENTI

I PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T

Z. EDI RAMA

MINISTRJA E ZHVILLIMIT URBAN

ZNJ. EGLANTINA GJERMENI

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Z. GJERGJI MUHALI

KRYETARI I BASHKISË

Z. SELFO KAPLLANI

Miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Kuçovë Nr.76 Datë 24/11/2016

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.2 Datë 29/12/2016

Hartuar nga:	Bashkia KUÇOVË
Mbështetur nga:	Projekt i USAID për Planifkimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Përmbajtja

Përmbajtja 2

Lista e Figurave 5

Lista e Tabelave 13

Hyrje 18

1. Analiza e thelluar e Planit të Përgjithshëm Vendor 20

1.1 Analiza e përgjithshme e territorit 20

1.1.1 Analiza topografike dhe klimatike 20

1.1.2 Analiza gjeologo- inxhinierike, e burimeve natyrore dhe e pasurive minerale 22

1.1.3 Analiza hidrogjeologjike dhe hidrografike 25

1.1.4 Analiza e gjeorreziqeve 27

1.1.5 Analiza e bonitetit të tokave 29

1.1.6 Analiza e monumenteve dhe zonave të mbrojtura 29

1.1.7 Analiza e tendencave të zhvillimit 31

1.2 Dokumentet e planifikimit të hartuara më parë 33

1.2.1 Strategjitë e zhvillimit 34

1.2.2 Planifikimi rregullator e vendor 35

1.3 Pozicionimi strategjik dhe pikat e forta në territor 40

1.3.1 Pozicioni gjeografik 40

1.3.2 Elementet e forta në territor 41

1.4 Analiza e mjedisit dhe e problemeve mjedisore 43

1.4.1 Metabolizmi i territorit 43

1.4.2 Mjedisi 55

1.4.3 Peizazhi, pyjet, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti 131

1.4.4 Konkluzione 154

1.5 Analiza demografike dhe e mirëqenies social-ekonomike 159

1.5.1 Demografia 159

1.5.2 Zhvillimi dhe përfshirja sociale 166

1.5.3 Konkluzione mbi sfidat dhe problematikat sociale 177

1.6 Zhvillimi ekonomik urban dhe rural 178

1.6.1 Vlerësimi Ekonomik dhe sektorët 178

1.6.2 Pronat publike 201

1.6.3 Zonat informale 209

1.6.4 Konkluzione 213

1.7 Analiza e infrastrukturave publike 215
1.7.1 Sistemi rrugor dhe transporti publik 215
1.7.2 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura 227
1.7.3 Ndriçimi i mjediseve publike 235
1.7.4 Mbetjet e ngurta 239
1.7.5 Sistemi i kullimit dhe i ujitjes 250
1.7.6 Konkluzione 253
1.8 Strehimi dhe cilësia e strukturave dhe e hapësirave 256
1.9 Përdorimi i tokës, sistemet dhe strukturimi i territorit 258
1.9.1 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës 258
1.9.2 Tipologjitë hapësinore dhe cilësia e territorit 261
1.9.3 Konkluzione 271
1.10 Rëndësia kombëtare në territor 272
1.11 Analiza e periferialitetit 274
1.12 Konkluzione dhe rekomandime për planin 280
2. Plani i Zhvillimit të Territorit 285
2.1 Plani i propozimeve territoriale 285
2.1.1 Thellimi i vizionit territorial të zhvillimit 285
2.1.2 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës 308
2.1.3 Nyjet kryesore të infrastrukturave dhe hapësirave publike 315
2.1.4 Njësitë strukturore të territorit 318
2.1.5 Parashikimi demografik dhe strehimi 324
2.1.6 Instrumentet e drejtimit të zhvillimit 326
2.1.7 Infrastruktura të tjera Publike 349
2.2 Shërbimet dhe infrastrukturat publike 327
2.2.1 Efektet e infrastrukturave kombëtare e rajonale 327
2.2.2 Lëvizja në territor 328
2.2.3 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura 335
2.2.4 Ndriçimi i mjediseve publike 340
2.2.5 Mbetjet e ngurta 341
2.2.6 Infrastrukturat sociale 347
2.3 Plani për mbrojtjen e mjedisit 351
2.3.1 Mbrojtja e tokës 353
2.3.2 Mbrojtja e peizazhit, biodiversitetit, pyjeve, kullotave dhe zonave të mbrojtura 356

2.3.3 Mbrojtja e sistemit ujor 367
2.3.4 Cilësia e ajrit 376
2.3.5 Rekomandime mbi zonat e nxehta mjedisore 379
2.3.6 Rekomandime mbi zonat historike dhe monumentet e kulturës 380
2.4 Plani i veprimeve për zbatimin e PPV-së 380
2.4.1 Fazat e zbatimit të planit 380
2.4.2 Plani i investimeve kapitale 388
2.4.3 Monitorimi i zbatimit të planit dhe çështje institucionale-ligjore 388
3. Shtojcat 393
3.1 Tabela përmbledhëse e PPV-së 393
3.2 Tabela sistemeve dhe zonave 397
3.3 Korrespondenca institucionale 399
3.4 Procesverbalet dhe materiale nga dëgjesat publike, komente e përgjigje 400
Shënime dhe Referenca 422

Lista e Figurave

Figura 1. Harta e pjerrësisë në përqindje 20
Figura 2. Harta e relievit dhe e hidrografisë 21
Figura 3. Harta klimatike 21
Figura 4. Profil gjeologjik i puseve të naftës në vendburimin në Kuçovë 23
Figura 5. Analiza e mbivendosjes së gjeologjisë, pasurive minerale dhe burimeve të naftës 25
Figura 6. Analiza e mbivendosjes së hidrogjeologjisë dhe hidrografisë 26
Figura 7. Kodër e tarracuar në Kuçovë 27
Figura 8. Analiza e mbivendosjes së rreziqeve në bashkinë e Kuçovës 29
Figura 9. Analiza e monumenteve dhe zonave të mbrojtura 30
Figura 10. Rritja e popullsisë në vite, qyteti Kuçovë 31
Figura 11. Kisha e Shën Kollit, Perondi / Uzina e Përpunimit të Naftës 32
Figura 12. Zhvillimi hapësinor i Kuçovës në intervalet: para viteve 1990, 1990-2007, 2007-2013 32
Figura 13. Grafiku i rritjes hapësinore të njësive administrative të Kuçovës në intervalet: para viteve 1990, 1990-2007, 2007-2013 33
Figura 14. Plani rregullues, 1976 36
Figura 15. Përdorimi i propozuar i tokës 37
Figura 16. Infrastruktura rrugore e propozuar 38
Figura 17. Pozicioni gjeografik 40
Figura 18. Elementet e fortë në territor 42
Figura 19. Harta e fluksit të energjisë në rajon 44
Figura 20. Fluksi i ujit (ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore) në rajon 45
Figura 21. Fluksi i energjisë (prodhimi dhe konsumi) 49
Figura 22. Njësitë ekonomike familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale në qarkun e Beratit 50
Figura 23. Fluksi i ujit (konsumi i ujit të pijshëm, zonat e mbulimit me shërbimin e ujësjellësit) 51
Figura 24. Fluksi i ushqimit, prodhimet dhe konsumi (treg e eksport) për qarkun e Beratit 52
Figura 25. Fluksi i prodhimeve bujqësore në bashkinë e Kuçovës 53
Figura 26. Fluksi i prodhimeve blegtorale në bashkinë e Kuçovës 53
Figura 27. Fluksi i bujqësisë, qarku Berat, 2014 54

Figura 28. Fluksi i mbetjeve në bashkinë e Kuçovës 55
Figura 29. Zonimi gjeoteknik i Shqipërisë dhe Kuçovës 57
Figura 30. Rrëshqitjet në Bashkinë Kuçovë 58
Figura 31. Erozioni në Bashkinë Kuçovë 59
Figura 32. Digat e prishura përgjatë lumit të Lumbardhës në NjA-në Lumas 59
Figura 33. Punimi i tokës bujqësore me zhveshje të saj në Bashkinë Kuçovë 61
Figura 34. Vëllimi i rezervuarit/digës mbushur me erozion (%) 62
Figura 35. Rrezikshmëria e përmbytjeve në vend për periudhë rikthimi 100 vjet 64
Figura 36. Harta e rrezikut të përmbytjes së Ultësirës Perëndimore me rikthim 100 vjet 66
Figura 37. Lumenjtë dhe rezervuarët kryesorë në Bashkinë Kuçovë 67
Figura 38. Profilet e monitorimit të gjendjes së shtratit të lumenjve në basenin e Semanit 69
Figura 39. Thellimi i shtratit të Semanit e Osumit për shkak të erozionit fundor 69
Figura 40. HEC-et në Pellgun e lumit Seman 72
Figura 41. Harta e marrjes së kampioneve për vlerësim në lumin Osum dhe Devoll 76
Figura 42. pH dhe përçueshmëria elektrike në Basenin e Semanit 76
Figura 43. Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen dhe oksigjeni i tretur (DO) në Basenin e Semanit 77
Figura 44. Lënda e ngurtë e tretur dhe pezull në Basenin e Semanit 77
Figura 45. Nitratet dhe nitritet në ujë në Basenin e Semanit 78
Figura 46. Niveli i baktereve koliforme, Baseni i Semanit 79
Figura 47. Metalet e rënda në Basenin e Semanit 79
Figura 48. Shkarkimi i ujrave të ndotura urbane në kanale e lumenj 82
Figura 49. Foto nga rruga hyrëse për në NjA Lumas 83
Figura 50. Akuiferët në Bashkinë Kuçovë 85
Figura 51. Lloji dhe shtrirja e akuiferëve në Qarkun e Beratit 85
Figura 52. Harta e puseve të naftës dhe akuiferëve në Qytetin e Kuçovës dhe në Devoll/Kozarë 91
Figura 53. Zonat me shpim horizontal (majtas) dhe teknologjia e përmbytjes me polimer dhe ujë djathtas (Water and Polymer Flooding) 93
Figura 54. Vlerat ditore të treguesve të monitoruar në vitin 2014 96
Figura 55. Sasia e CO2 që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë 97
Figura 56. Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite 98

Figura 57. Numri i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave që transportohen me tren në Shqipëri 98
Figura 58. Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuara 99
Figura 59. Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %) 100
Figura 60. Numri i makinave (në %) që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër, sipas vitit të prodhimit 101
Figura 61. Pus-shpimet e naftës dhe zonat e banuara në Bashkinë Kuçovë 106
Figura 62. Tokë bujqësore, Kozarë 107
Figura 63. Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës 111
Figura 64. Foto nga venddepozitimi i mbetjeve, Bashkia Kuçovë 118
Figura 65. Ndryshimet e sipërfaqes së vend-depozitimit në harkun kohor 2003-2015 .. 118
Figura 66. Shtrirja e kanalit të Dikatrës – Kuçovë 119
Figura 67. Ish-zona e UPN-së, Kuçovë 120
Figura 68. Ish-zona e UPN-së, Projekti i Rehabilitimit, Kuçovë 120
Figura 69. Depozitë dekantimi me ndarje të lire (majtas), me dy faza (djathtas) 124
Figura 70. Depozita dekantimi larëse (majtas), Depozitë dekantimi me tre faza (djathtas) 124
Figura 71. Mbetje të lëngëta industriale nga puset e naftës 125
Figura 72. Harta e fondit pyjor Bashkia Kuçovë 133
Figura 73. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat) 137
Figura 74. Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondi pyjor 138
Figura 75. Harta peizazhistike dhe rrugët 139
Figura 76. Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia autoktone si pasojë e zhvillimit të bujqësisë 139
Figura 77. Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës 140
Figura 78. Harta e Elementeve Peizazhistike 141
Figura 79. Harta e rrezikut ndaj elementeve peizazhistike 142
Figura 80. NjA Lumas, Kuçovë 144
Figura 81. Burimi i Sinecit me shkëmbinj gëlqerorë pllakorë 145
Figura 82. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi 147
Figura 83. Densiteti i popullsisë në nivel njësie administrative, qarku Berat 160
Figura 84. Struktura moshore e popullsisë në nivel bashkie dhe njësish administrative 162
Figura 85. Parashikimi për popullsinë e bashkisë Kuçovë, 2011-20131 164
Figura 86. Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative të bashkisë Kuçovë .. 165

Figura 87. Niveli arsimor në bashkinë e Kuçovës, sipas NA-së (1_Niveli i analfabetizmit; 2_% e popullsisë me arsim 9-vjeçar; 3_% e popullsisë me arsim të mesëm; 4_% e popullsisë me arsim të lartë) 167
Figura 88. Mbulimi i territorit me shërbimin e insitucioneve të arsimit parashkollor.... 168
Figura 89. Mbulimi i territorit me shërbimin e institucioneve të arsimit 9-vjeçar 168
Figura 90. Mbulimi i territorit me shërbimin e institucioneve të arsimit të mesëm 169
Figura 91. Raporti nxënës- mësues në kopshte..... 170
Figura 92. Raporti nxënës-mësues në shkollat 9-vjeçare..... 170
Figura 93. Raporti nxënës- mësues në shkollat e mesme 171
Figura 94. Numri i banorëve në moshë pune..... 172
Figura 95. Punësimi sipas sektorëve ekonomikë, nivel njësish administrative 172
Figura 96. Shkalla e të punësuarve sipas nivelit arsimor..... 173
Figura 97. Niveli i përgjithshëm i papunësisë në bashkinë e Kuçovës..... 174
Figura 98. Burimi i të ardhurave të NJEF-ve në Kuçovë 176
Figura 99. Rritja reale e PBB-së në periudhën 2009-2012 për qarkun e Beratit dhe qarqe të ngjashme 179
Figura 100. Njësitë ekonomike sipas llojit 180
Figura 101. Numri i njësive ekonomike për 1000 banorë për qarkun e Beratit në nivel njësish administrative..... 181
Figura 102. Njësitë ekonomike sipas llojit të aktivitetit në bashkinë e Kuçovës 181
Figura 103. Punësimi sipas aktivitetit ekonomik në njësitë administrative të bashkisë Kuçovë 184
Figura 104. Përqindja e të punësuarve që punojnë në njësinë administrative ku banojnë, nivel qarku 185
Figura 105. Ekonomitë agrare dhe aglomeruese në bashkinë Kuçovë 186
Figura 106. Destinacionet dhe origjina e lëvizjeve dalëse dhe hyrëse për arsye punësimi 187
Figura 107. Zonat ekonomike në bashkinë Kuçovë..... 188
Figura 108. Uji sipas të dhënave nga AKIPP-i 202
Figura 109. Uji sipas të dhënave nga përdorimi i Tokës 203
Figura 110. Vendndodhja e pronave publike: Krahasim i të dhënave nga AKIPP-i me ato nga përdorimi i Tokës 204
Figura 111. Vendodhja e të gjithë pronave publike në bashkinë Kuçovë 205
Figura 112. Zona konflikti_Shesh në NjA Kozarë 206
Figura 113. Zona konflikti_Truall në NjA Perondi 206

Figura 114. Harta e zonave të konfliktit në të gjithë territorin 207
Figura 115. Pronat në qytetin Kuçovë 207
Figura 116. Pronat me interes në qytetin Kuçovë 208
Figura 117. Vendbanimi informal nën Spital 209
Figura 118. Vendbanimi informal mbi Zjarrfikëse 210
Figura 119. Vendbanimet informale 211
Figura 120. Vendbanimet informale të propozuara 212
Figura 121. Vendbanimet informale të propozuara numër 5 212
Figura 122. Vendbanimet informale të propozuara numër 6 213
Figura 123. Analiza e infrastruktuës rajonale dhe kombëtare, Bashkia Kuçovë 216
Figura 124. Transporti ndërqytetës, bashkia Kuçovë 217
Figura 125. Hierarkia e sistemit rrugor sipas Kodit Rrugor 218
Figura 126. Seksioni i rrugëve interurbane kryesore 219
Figura 127. Seksioni i rrugëve interurbane kryesore 219
Figura 128. Seksioni i rrugëve urbane kryesore 220
Figura 129. Seksioni i rrugëve urbane dytësore 220
Figura 130. Seksioni i rrugëve lokale 221
Figura 131. Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit 222
Figura 132. Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit 223
Figura 133. Gjendja e rrugëve, bashkia Kuçovë 224
Figura 134. Aksidentet e regjistruara në territorin e bashkisë Kuçovë për periudhën 2011-2014 224
Figura 135. Transporti ndërqytetës, bashkia Kuçovë 226
Figura 136. Skema e furnizmit me ujë nga U.K. Kuçovë 228
Figura 137. Zonat e shërbyera nga U.K.Kuçovë 232
Figura 138. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në Kuçovë, qytet 233
Figura 139. Rrjeti rrugor i ndriçuar në bashkinë e Kuçovës 236
Figura 140. Rrjeti rrugor i ndriçuar në bashkinë e Kuçovës (qyteti i Kuçovës) 237
Figura 141. Venddepozitimi i mbetjeve urbane në bashkinë e Kuçovës 240
Figura 142. Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve urbane në bashkinë e Kuçovës 241
Figura 143. Ndryshimet vizuale të hapësirës së përdorur nga venddepozitimi në harkun kohor 2003-2015 242

Figura 144. Foto nga venddepozitimi i mbetjeve në Rreth Tapi, Perondi – Bashkia Kuçovë 243
Figura 145. Grafiku i gjenerimit të mbetjeve urbane në vite në bashkinë Kuçovë krahasuar me mesataren në Republikën e Shqipërisë 244
Figura 146. Mbetje të lëngëta industriale nga pusi i naftës 246
Figura 147. Mbetje përreth pusit të naftës dhe shkarkime në kanalet kulluese - Kuçovë 248
Figura 148. Ish-zona e UPN-së & Projekti i Rehabilitimit 249
Figura 149. Rrjeti i kanaleve vaditëse dhe kulluese në bashkinë Kuçovë 252
Figura 150. Sistemet territoriale, bashkia Kuçovë 258
Figura 151. Konfliktet mes përdorimeve të papërputhshme të tokës 260
Figura 152.Skema e lidhjeve territoriale në nivel bashkie 262
Figura 153. Tipologjitë e marrëdhënieve të vendbanimeve rurale në bashkinë Kuçovë 263
Figura 154. Shembuj të tipologjisë satelitore (Perondi, Kozare) 264
Figura 155. Shembuj të tipologjisë nukleare (Frashër, Drizë) 264
Figura 156. Shembuj të tipologjisë qendrore (Lumas, Ferras-Kozare) 265
Figura 157. Tipologji lineare (Tapi, Polovinë) 265
Figura 158. Tipologjitë organike (Frashër, Kozarë fshat) 266
Figura 159. Tipologjia e degëzuar (Salcë Kozarë, Lumas) 266
Figura 160. Tipologjia e tarracuar (Koritëz) dhe rrjet (Kozare) 267
Figura 161. Tipologjia e shtrirjes rrugore të vendbanimeve rurale 267
Figura 162. Shpërndarja e tipologjive hapësinore në bashkinë e Kuçovës 269
Figura 163. Zonimi tipologjik, bashkia Kuçovë 269
Figura 164. Zonimi tipologjik, Kuçovë qendër 270
Figura 165. Shpërndarja e tipologjive hapësinore në qytetin e Kuçovës 271
Figura 166. Kisha e Ungjillëzimit, Kozare 272
Figura 167. Harta e analizës së periferialitetit 276
Figura 168. Grafiku i periferialitetit për Kozaren 277
Figura 169. Grafiku i periferialitetit për Kuçovën 277
Figura 170. Grafiku i periferialitetit për Lumas 278
Figura 171. Grafiku i periferialitetit për Perondinë 278
Figura 172. Grafiku i periferialitetit për sipërfaqen e bashkisë Kuçovës 279
Figura 173. Grafiku për popullsinë sipas kategorive përkatëse të periferialitetit bashkia Kuçovë 279

Figura 174. Vizioni i përgjithshëm i Bashkisë Kuçovë 286
Figura 175. Fashat, qendërsitë dhe zonat e bashkisë Kuçovë 292
Figura 176. Karakteri i vendbanimeve 296
Figura 177. Ndërhyrjet strategjike të Bashkisë Kuçovë 297
Figura 178. Ndërhyrjet strategjike të Bashkisë Kuçovë 298
Figura 179. Rehabilitimi i zonave ripariane 299
Figura 180. Përmirësimi i aksesit në zonën e burimit të Sinecit 300
Figura 181. Krijimi i parkut rajonal të kodrave të Kozares 301
Figura 182. Rehabilitimi i zonës së rezervuarit të Belesovës 302
Figura 183. Rehabilitimi dhe ndërtimi i zgjatimit të bulevardit ekzistues në Kuçovë ... 302
Figura 184. Krijimi i zones ekonomike në aksin rrugor Kuçovë- Ura Vjagurore 303
Figura 185. Rehabilitimi i zonës së tregut në Kuçovë 304
Figura 186. Sistemet e propozuara të territorit 308
Figura 187. Përdorimi i propozuar i tokës 311
Figura 188. Zonat e bashkisë së Kuçovës 314
Figura 189. Njësitë strukturore sipas kodeve, Bashkia Kuçovë 319
Figura 190. Impakti i projekteve rajonale dhe kombëtare, Bashkia Kuçovë 328
Figura 191. Linjat e propozuara të transportit publik ndërqytetës 331
Figura 192. Skema e propozuar e transportit publik në Kuçovë 333
Figura 193. Skema e propozuar e transportit publik në qytetin e Kuçovës 334
Figura 194. Harta e sistemit aktual të furnizimit me ujë dhe propozimeve të reja, Bashkia Kuçovë 336
Figura 195. Harta e sistemit aktual të shërbimit me kanlaizime dhe propozimeve të reja, Bashkia Kuçovë 339
Figura 196. Vendndodhja e landfill-it rajonal të propozuar për ndërtim në bashkinë Ura Vajgurore & pellgu ujëmbledhës i ujërave të larta 342
Figura 197. Vendndodhja e landfill-it rajonal të propozuar për ndërtim në bashkinë Kuçovë & pellgu ujëmbledhës i ujërave të larta 343
Figura 198. Ish- zona e UPN-së & projekti i rehabilitimit 344
Figura 199. Gjendja ekzistuese dhe propozimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Kuçovë 345
Figura 200. Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve në bashkinë e Kuçovës dhe niveli i trajtimit të tyre sipas objektivave të planit të menaxhimit për periudhën 2012 - 2015 .. 346
Figura 201. Mbulimi me shërbimin e kopshteve dhe çerdheve në bashkinë Kuçovë (Propozim) 347

Figura 202. Mbulimi me shërbimin e shkollave 9-vjeçare në bashkinë Kuçovë (Propozim) 348
Figura 203. Mbulimi me shërbimin e shkollave të mesme në bashkinë Kuçovë (Propozim) 348
Figura 204. Mbulimi me shërbimin e qendrave shëndetsore në bashkinë Kuçovë (Propozim) 349
Figura 205. Fazimi i njësive strukturore 381
Figura 206. Fazimi i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor 382

Lista e Tabelave

Tabela 1. Sasia e energjisë së prodhuar në territorin e qarkut Berat 2011 46

Tabela 2. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe banesave 2011 48

Tabela 3. Bilanci i energjisë elektrike, 2011 48

Tabela 4. Njësitë ekonomike familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale në qarkun e Beratit 49

Tabela 5. Prodhimtaria bujqësore e blegtorale në bashkinë e Kuçovës 52

Tabela 6. Prodhimet dhe konsumi (treg dhe eksport) për qarkun e Beratit 53

Tabela 7. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore në vend .. 60

Tabela 8. Zonat e përmbytura në dimrin e viteve 1962-1963 62

Tabela 9. Karakteristikat kryesore hidrologjike të pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve më të mëdhenj në vend 63

Tabela 10. Lumenjtë/përrenjtë e vegjël me prirje për përmbytje në basenet Shkumbin, Seman e Vjosë 64

Tabela 11. Zonimi i rrezikut të përmbytjeve në Shqipëri për periudhë rikthimi 100 vjet 64

Tabela 12. Pasojat e përmbytjes për periudhë rikthimi 100-vjet në Ish-Rrethin e Kuçovës 65

Tabela 13. Vendndodhja e profileve të monitorimit 68

Tabela 14. Erozioni fundor ndër vite në lumenjtë Osum dhe Seman 69

Tabela 15. HEC-et në Basenin e Lumit Seman 70

Tabela 16. HEC-et në Lumin Devoll 73

Tabela 17. Pikat e monitorimit 75

Tabela 18. Fshatrat pa sistem furnizimi me ujë të pijshëm 87

Tabela 19. Ujësjellësit e Bashkisë Kuçovë dhe pus-shpimet e tyre 88

Tabela 20. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri 99

Tabela 21. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë 104

Tabela 22. Rritja e numrit të fermave të pluguara me traktor 108

Tabela 23. Rritja e sasisë së përdorur të plehrave kimike në vend 108

Tabela 24. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperatures (Referuar Tem. Mes. 1990) 111

Tabela 25. Fenomenet ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare 112

Tabela 26. Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime 112

Tabela 27. Ndryshimi i regjimit të reshjeve (në %) në krhasim me vitin 1990 113
Tabela 28. Rezervat naftëmbajtëse në Bashkinë Kuçovë 121
Tabela 29. Humbjet në sipërfaqe pyjore 133
Tabela 30. Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave 143
Tabela 31. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri 146
Tabela 32. Tregues të përgjithshëm të florës dhe faunës në Shqipëri e në Bashkinë Kuçovë 147
Tabela 33. Speciet floristike të rrezikuara në Bashkinë Kuçovë 149
Tabela 34. Speciet e rrezikuara në Bashkinë Kuçovë 151
Tabela 35. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015 160
Tabela 36. Popullsia sipas gjinisë për vitet 2011-2015 në bashkinë e Kuçovës 161
Tabela 37. Koeficientët e varësisë për bashkinë Kuçovë 163
Tabela 38. Parashikimi për popullsinë e bashkisë Kuçovë, 2011-2031 164
Tabela 39. Numri i popullsisë në bashkinë Kuçovë për periudhën 2011-2015 165
Tabela 40. Parashikimi i popullsisë sipas zyrës së gjendjes civile për vitet 2021, 2026, 2031 166
Tabela 41. Niveli arsimor i përfunduar, vitet mesatare të shkollimit dhe niveli i analfabetizmit në bashkinë e Kuçovës, krahasuar me bashkitë fqinje 166
Tabela 42. Numri dhe shpërndarja e objekteve arsimore sipas NJA-së 168
Tabela 43. Situata e papunësisë në bashkinë e Kuçovës, papunësia tek të rinjtë dhe ndarja sipas gjinive 173
Tabela 44. Numri i personave me aftësi të kufizuara sipas njësisë administrative dhe llojit të paaftësisë 175
Tabela 45. Treguesit e varfërisë në nivel qarku, krahasuar me qarqet e rajonit dhe nivelin kombëtar 176
Tabela 46. Numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike 177
Tabela 47. Shpërndarja e shërbimeve sociale në qarkun e Beratit 177
Tabela 48. PBB-ja e qarkut Berat në raport me Shqipërinë dhe qarqe të ngjashme për vitin 2012 179
Tabela 49. Produktiviteti sipas sektorëve ekonomikë në qarkun e Beratit 180
Tabela 50. Prodhimi i naftës bruto në Shqipëri në periudhën janar-qershor 2015 182
Tabela 51. Numri i puseve aktive për vitin 2014 182
Tabela 52. Punësimi sipas aktivitetit ekonomik në bashkinë Kuçovë krahasuar me bashki të tjera të qarkut Berat dhe bashkitë fqinje 183
Tabela 53. Rajonizimi i kulturave bujqësore dhe blegtorisë në bashkinë e Kuçovës 193

Tabela 54. Prodhimtaria bujqësore e blegtorale dhe sipërfaqja totale 196
Tabela 55. Prodhimi në ton i prodhimeve blegtorale në bashkinë Kuçovë 197
Tabela 56. Kategoritë e pronave sipas AKIPP-it 202
Tabela 57. Pronat publike për shërbimin parësor shëndetësor sipas të dhënave nga Përdorimi i Tokës 204
Tabela 58. Shpërndarja e rrugëve sipas kategorisë së Kodit Rrugor dhe gjatësisë përkatëse 218
Tabela 59. Shpërndarja e rrugëve sipas funksionit dhe gjatësisë përkatëse 221
Tabela 60. Prurja mesatare e burimeve të ujit në bashkinë e Kuçovës 227
Tabela 61. Volumi i depozitimit dhe furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm –Kuçovë 228
Tabela 62. Të dhëna magjistrale mbi situatën e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm – Kuçovë 229
Tabela 63. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm për NjA-të dhe fshatrat në bashkinë Kuçovë 230
Tabela 64. Pusshpimet në bashkinë e Kuçovës 230
Tabela 65. Gjendja e tubacioneve të rrjetit të furnizimit me ujë 232
Tabela 66. Gjendja e tubacioneve të rrjetit të furnizimit me ujë 234
Tabela 67. Kostot e energjisë elektrike dhe raporti me kostot totale të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik 238
Tabela 68. Të ardhurat totale dhe raporti me kostot totale të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik 238
Tabela 69. Të ardhurat totale dhe raporti me kostot e energjisë elekrike të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik 239
Tabela 70. Sasia e mbetjeve urbane të prodhuara në bashkinë Kuçovë dhe në rang vendi 241
Tabela 71. Prodhuesit e mbetjeve spitalore 245
Tabela 72. Aktivitete qe prodhojnë mbetje industriale (sipas lejeve mjedisore) 247
Tabela 73. Vëllimi dhe gjendja teknike e rezervuarëve në bashkinë Kuçovë 251
Tabela 74. Infrastruktura bujqësore sipas llojit, kategorisë dhe gjendjes në bashkinë Kuçovë në km lineare 252
Tabela 75. Sipërfaqet e ndërtimit për qëllime banimi sipas njësive administrative të bashkisë Kuçovë 257
Tabela 76. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës, sipas sipërfaqes që zënë 259
Tabela 77. Kriteret e kombinimit të tipologjisë ndërtimore me densitetin 268
Tabela 78. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore 275

Tabela 79. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën shëndetësore 276
Tabela 80. Treguesit për sipërfaqen dhe popullsinë për periferialitetin 278
Tabela 81. Treguesit për sipërfaqen dhe popullsinë sipas kategorive të periferialitetit në secilën njësi administrative të Kuçovës 279
Tabela 82. Përfshirja e propozimeve të PPK-së në PPV-në e Kuçovës..... 307
Tabela 83. Sistemet ekzistuese territoriale..... 308
Tabela 84. Sistemet e propozuara të territorit..... 308
Tabela 85. Sistemet e territorit dhe treguesit përkatës..... 309
Tabela 86. Ndryshimi i sistemeve të territorit 310
Tabela 87. Bilanci i përdorimit të tokës..... 312
Tabela 88. Zonat e bashkisë së Kuçovës 314
Tabela 89. Standardet dhe parametrat aktualë dhe të propozuar të gjelbërimit në qytetin e Kuçovës..... 316
Tabela 90. Parashikimi për popullsinë e Bashkisë Kuçovë, 2011-2031 325
Tabela 91. Parashikimi i popullsisë sipas regjistrit të gjendjes civile 2021, 2026, 2031 325
Tabela 92. Numri i banorëvë që priten të kenë akses në transportin publik 2011-2031. 332
Tabela 93. Kapaciteti i burimeve të furnizmit me ujë krahasuar me kërkesën e parashikuar 335
Tabela 94. Kërkesa për rezervuarë shtesë sipas zonave të furnizimit me ujë..... 336
Tabela 95. Përmbledhje e investimeve të nevojshme për Bashkinë Kuçovë (2021-2040) 336
Tabela 96. Projekte të sitemit të kanalizimeve. Investime Kapitale (2021-2040)..... 340
Tabela 97. Koordinatat referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e landfill-it rajonal 342
Tabela 98. Koordinatat referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e landfill-it rajonal 343
Tabela 99. Koordinatat referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e inçerneratorit344
Tabela 100. Projektet e planifikuara në PPV për mbrojtjen e tokës..... 356
Tabela 101. Projektet e planifikuara në PPV që synojnë përmirësimin e peisazhit 357
Tabela 102. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e biodiversitetit..... 363
Tabela 103. Projektet e planifikuara në PPV për shtimin e zonave pyjore..... 364
Tabela 104. Kategoritë e zonave të mbrojtura të propozuara në Bashkië Kuçovë sipas karakteristikave..... 366
Tabela 105. Shkalla e mbrojtjes dhe domethënia (veprimtaritë e ndaluara)..... 366
Tabela 106. Projektet e propozuara në PPV për mbrojtjen e lumenjve..... 371

Tabela 107. Projektet e propozuara në PPV që synojnë përmirësimin e cilësisë së ajrit 378
Tabela 108. Projektet e planifikuara në PPV për rehabilitimin e vatrave të nxehta mjedisore 380
Tabela 109. Tabela e fazimit të projekteve 383
Tabela 110. Rekomandime për përmirësimin e monitorimit të mjedisit 388
Tabela 111. Indikatorët për monitorimin e PPV-së 391

Hyrje

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Kuçovë me mbështetjen teknike të Co-PLAN, Institutit për zhvillimin e habitatit, në kuadër të Projektit të USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, ***Z. Selfo Kapllani.*** Përmbajtja e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kuçovë mbështetet në Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij. Veçanërisht si bazë referuese është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".

Megjithatë për shkak të natyrës mjaft komplekse dhe shumë dimensionale që ka ky dokument, duke mbuluar nevoja të territorit urban dhe rural, gjatë hartimit të tij janë referuar dhe akte të tjera ligjore e nënligjore si dhe dokumente udhëzuese. Ndër më të rëndësishmet janë:

- Ligji nr. 9244 datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"
- Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
- Ligji nr.111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji nr.8518, datë 30.7.1999 " Për kullimin dhe vaditjen"
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar";
- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar"
- Vendimet e KKT-së në 3 vitet e fundit, në lidhje me përcaktimin e çështjeve, zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare;
- Manuali teknik " Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri"etj.

Metodologjia e ndjekur gjatë hartimit të këtij dokumenti është mbështetur mbi përcaktimet ligjore për sa i përket strukturës së instrumenteve (dokumenteve të planifikimit) dhe proçesit që duhet të ndiqet. Në këtë kuadër Bashkia Kuçovë ka realizuar shtatë Dëgjesa Publike. Gjatë këtyre dëgjesave kanë marrë pjesë, dhe kanë dhënë kontributin e tyre të paçmueshëm, qytetarë dhe profesionistë të Bashkisë Kuçovë, grupet e biznesit dhe interesit, përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Bordi i Kullimit, Qendrat e kujdesit social, Komisioni Këshillmor Qytetar (CAP) etj.

Së fundmi një falenderim i veçantë i detyrohet të gjitha institucioneve të cilat janë treguar bashkëpunuese gjatë këtij proçesi, veçanërisht Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), Ministrisë së Zhvillimit Urban, ministrive të linjës, Bashkive fqinje të Bashkisë Kuçovë si dhe të gjithë aktorëve të përfshirë gjatë proceseve të konsultimeve publike. Gjithashtu falenderojmë: Borana Disha, Klelia Haxhihyseni, Mikel Tepelena, Ledio Capo, Ina Brata, Besjana Qaja, Aldo Sula, Erisa Poleshi dhe Dea Rogova për mbështetjen gjatë proceseve të përpunimeve të ndryshme grafike.

Grupi i punës: Dritan Shutina, Rudina Toto, Zenel Bajrami, Imeldi Sokoli, Ani Shtylla, Anila Gjika, Kejt Dhrami, Malvina Disha, Fiona Imami, Eneida Çela, Merita Toska, Elton Stafa, Sotir Dhamo, Besnik Aliaj, Renisa Muka, Ada Lushi, Iris Hyka, Erialda Zekthi, Mariana Proko, Sherif Lushaj, Arta Alla, Silvi Jano, Rodion Gjoka, Kristi Bashmilli, Elona Karafili, Antonino di Raimo, Loris Rossi, Ledian Bregasi, Elvan Dajko, Laura Pedata,

Xhesika Hoxha, Gerti Delli, Aida Ciro, Ingrid Xhafa, Ols Lafe, Godiva Rrëmbeci, Enkelejda Gjinali, Fjordi Bisha, Ferdinant Putro, Shpëtim Nishani, Ilirjan Llangonzi, Bardhyl Sula, Petrit Ruka, Petrit Shyti, Olgert Zogaj, Bledar Djamanti, Xhenisa Kostreni, Edmond Menaj, Heroina Shkëmbi, Juljan Lezo, Milena Bullari, Eljan Hajdari.

1. Analiza e thelluar e Planit të Përgjithshëm Vendor

1.1 Analiza e përgjithshme e territorit


1.1.1 *Analiza topografike dhe klimatike*

- Analiza topografike

Nga ana e relievit, Shqipëria ndahet në disa rajone dhe bashkia e Kuçovës është pjesë e Ultësirës Perëndimore në njësinë kodrinore. Terreni është në formë vargjesh kodrinore me lartësi jo shumë të larta. Në përgjithësi, ky terren përbëhet nga shkëmbinj të dobët të paqëndrueshëm ndaj rrëshqitjeve. Lartësitë më të mëdha në bashkinë e Kuçovës janë në zonën lindore dhe qendrore. Kodrat krijojnë vargje dhe ndërmjet këtyre vargjeve ndodhen disa lugina ku kalojnë lumi Devoll dhe përrenj të tjerë. Alternimi ndërmjet kreshtave dhe luginave krijon variacion në terren dhe lartësitë shkojnë duke u rritur nga verilindja në juglindje. Zona fushore ka një sipërfaqe më të vogël se ajo kodrinore dhe shtrihet përgjatë rrjedhave të lumenjve Osum dhe Devoll. Lumi Osum është në kufirin e bashkisë së Kuçovës me bashkinë e Urës Vajgurore, ndërsa lumi Devoll rrjedh nga verilindja drejt perëndimit, ku bashkohet me Osumin, duke krijuar lumin Seman.


Pjerrësia e terrenit është më e theksuar në zonën kodrinore, e cila varion nga 25%- 100%. Gjithsesi, pjesa më e madhe e terrenit kodrinor varion nga 25- 42%. Pjesa fushore e bashkisë varion nga 0-9.8 %, ndërsa pjesa parakodrinore është me pjerrësi 9.9%- 25%.

Figura 1. Harta e pjerrësisë në përqindje



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Figura 2. Harta e relievit dhe e hidrografisë




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

- Analiza klimatike

Klima në këtë bashki, sipas klasifikimit Köppen-Geiger[1], i përket Csa[2]-së dhe njihet në përgjithësi me termin klimë mesdhetare. Tiparet karakteristike të kësaj klime janë: dimër i butë me reshje dhe verë e ngrohtë e thatë. Bashkia e Kuçovës ka rreth 2,500- 2,700 orë në vit me diell dhe, në përgjithësi, nuk ka erëra me shpejtësi të madhe. Treguesit klimatikë të qytetit pasqyrohen vazhdimisht nga stacioni meteorologjik i qytetit, i krijuar në vitin 1936 dhe është një nga më të vjetrit në vend. Temperatura mesatare vjetore është rreth 16.7°C. Temperatura maksimale vjetore gjatë ditës është rreth 29.2°C, ndërsa ajo minimale është 4.1°C. Zona e Kuçovës është një nga zonat më të nxehta të vendit, ku temperatura e ditëve të nxehta mund të arrijë edhe 42-45°C, ndërsa ajo e ditëve të ftohta të dimrit mund të shkojë rreth -7°C. Territori i bashkisë ka erëra me shpejtësi rreth 1.5 m/s dhe vetëm në pjesën perëndimore ka erëra që shkojnë nga 1.6 m/s deri në 2.0 m/s. Gjithashtu, bashkia e Kuçovës ka rreth 2,500- 2,700 orë në vit me diell. Reshjet mesatare në vit në këtë bashki variojnë nga 750 mm deri në 1,250 mm. Qyteti i Kuçovës ka arritur shifrën rekord në Shqipëri për temperaturën më të lartë të regjistruar, 44.4°C, në korrik të vitit 1986.

Figura 3. Harta klimatike



Burimi: Geo Consulting;Përgatiti: Co-PLAN, 2016

1.1.2 Analiza gjeologo- inxhinierike, e burimeve natyrore dhe e pasurive minerale

- Analiza gjeologo- inxhinierike

Bashkia e Kuçovës bën pjesë në pjesën e dy Albanideve[3] të Jashtme Perëndimore, në S (Zona Sazani) Adriatike Jugore dhe në J (Zona Jonike) -përkatësisht J3 (nënzona Berati)[4].

Bazuar në hartën gjeologo-inxhinierike për qarkun e Beratit të SHGJSH-së, shkëmbinjtë në bashkinë e Kuçovës përbëhen nga tri lloje. Përqindja më e lartë i përket llojit të shkëmbinjve mesatarë, të cilët gjenden në pjesën perëndimore të bashkisë. Këta shkëmbinj klasifikohen në:

- Flishe ritmike shtresë e hollë argjilo-alevrolito-ranore
- Evaporite
- Mollasa argjilore
- Mollasa ranoro-konglomeratike

Mollasat argjilore dhe flishetë ritmike shtresë e hollë argjilo-alevrolito-ranore përbëjnë përqindjen më të madhe të këtyre shkëmbinjve. Pjesa jugore dhe pjesërisht qendrore (zona e qytetit të Kuçovës dhe NJA Perondi) përbëhen nga zhavorret e poplat me origjinë deluviale dhe proluviale me trashësi >200 mm.

Zona e bashkisë që përshkohet nga lumi Devoll ka përbërje shkëmbore të tipit subargjilor të vendosur mbi zhavorret.

- Analiza e burimeve natyrore të naftës

Prania e shenjave të naftës në rajonin e bashkisë ka tërhequr qysh herët vëmendjen e gjeologëve të huaj, të cilët kanë filluar edhe studimet. Këto studime u zhvilluan më tej nga specialistët shqiptarë që bënë të mundur zgjerimin e këtij vendburimi ku janë evidentuar disa gjire paleogjeografike, në të cilat janë zbuluar shtratime nafte dhe gazi shoqërues, shfrytëzimi i të cilave vazhdon edhe sot nga kompania "Alpetrol" Sh.A. Kohët e fundit në shfrytëzimin e këtij vendburimi marrin pjesë shoqëria koncensionare kanadeze "Sheröood International Petroleum Ltd" dhe "Bankers Petrolium Ltd" për "Zhvillim dhe prodhim hidrokarbur me ndarje prodhimi".

Vendburimi i naftës ka shtrirje kryesisht në pjesën veri-veriperëndimore të qytetit Kuçovë. Është zbuluar dhe vënë në shfrytëzim në vitin 1928 nga shoqëria italiane AIPA, me marrjen e rezultateve pozitive nga pusi D-1. Më pas, deri në vitin 1935, në këtë vendburim u shpuan një numër i madh pusesh për zbulimin dhe konturimin e detajuar të këtij vendburimi. Intensifikimi i punimeve të kërkim-shfrytëzimit të këtij vendburimi është bërë pas 1945-ës nga specialistët shqiptarë. Këto punime e zgjeruan më tej vendburimin, ku janë zbuluar shtratime të reja naftë-gazmbajtëse. Rajoni ku shtrihet ky vendburim ka ndërtim të qartë dykatësh tektonik. Kati i poshtëm përfaqësohet nga gëlqerorët e periudhës së kretë-paleogjenit dhe flishi i oligocenit, si vazhdim verior i vargut antiklinal të Beratit, ndërsa kati i sipërm përfaqësohet nga depozitimet e neogjenit të mbivendosura transgresivisht me mospërputhje këndore dhe azimutale mbi katin e poshtëm, si ekstremi më lindor i Ultësirës Pranëadriatike.[5]


Stratigrafia[6]

Vendburimi i naftës dhe i gazit të Kuçovës ka ndërtim dykatësh, ku kati i poshtëm ndërtohet nga depozitime karbonatike të kretë - paleogjenit dhe depozitime flishore të oligocenit, ndërsa kati i sipërm tektonik ndërtohet nga depozitime neogjenike të miocenit të sipërm

dhe pliocenit, të cilat vendosen në mospërputhje stratigrafike, këndore dhe azimutale mbi depozitimet e katit të poshtëm tektonik në formën e një mulde brenda rajonit. Shtratimet e naftës në këtë vendburim lidhen me depozitimet terrigjene të katit të sipërm tektonik, ku veçohen disa formacione litologjike (ndryshe suita), të cilat nga poshtë-lart janë emërtuar: "Driza"- (N1 3D), "Gorani"-(N1 3G), "Kuçova"-(N1 3K) dhe "Polovina" - (N1 3Pol). Në përgjithësi, këto formacione janë emërtuar sipas emrave të zonave ku ato janë evidentuar në bashkinë e Kuçovës. Disa nga puset e shpuara në këtë vendburim kanë hapur edhe prerjen e gëlqerorëve që përfaqësohen nga ndërthurje gëlqerorësh turbiditikë me gëlqerorë biomikritiko-skeletorë dhe gëlqerorë shtresorë. Këta gëlqerorë janë shkëmbinjtë mëmë nga ku janë gjeneruar hidrokarburet dhe janë formuar shtratimet naftë-gazmbajtëse fillestare. Mbi këto depozitime, në mënyrë transgresive, vendosen depozitimet e mesinianit, brenda të cilave veçohen edhe formacionet litologjike të sipërpërmendura. E përgjithshme për këto formacione, pavarësisht pozicionit që zënë në prerje dhe fushëpërhapjes së tyre, është se ato përfaqësohen nga ndërthurje të argjilave, argjilave alevrolitore me shtresa dhe paketa ranorike ku trashësia e ranorëve është e ndryshueshme gjatë shtrirjes.

Mbi depozitimet e mesinianit me mospërputhje këndore dhe stratigrafike vendosen depozitimet e pliocenit me dy formacionet përfaqësuese të tij, formacionin "Helmësi", kryesisht argjilor dhe me ndërthurje të rralla ranoresh, në bazë të të cilit takohen depozitimet konglomeratike të bazës së transgresionit pliocenik dhe, në mënyrë të vijueshme, mbi këtë formacion vendosen depozitimet e formacionit "Rrogozhina" me ranorë, argjila dhe konglomerate në formë ndërthurjesh. Pjesa më e madhe e këtyre depozitimeve mbulohen nga depozitimet e kuaternarit që gjejnë përhapje në të gjithë rajonin.

Figura 4. Profil gjeologjik i puseve të naftës në vendburimin në Kuçovë



Burimi: "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku i Beratit, 2014

Tektonika[7]

Vendburimi i naftës Kuçovë bën pjesë në Ultësirën Pranëadriatike, e cila ndodhet në pjesën qendrore e veriperëndimore të Albanideve të Jashtme, në trajtën e një mulde.

Mulda e Kuçovës: Lidhet me muldën e Galushit në veri nëpërmjet monoklinalit të Pekishtit dhe sinklinalit të Ballagatit. Në veriperëndim, nëpërmjet ngritjes së Karbunarës dhe Urës së Kuçit, bëhet lidhja me pjesën tjetër të Ultësirës Pranëadriatike e cila vjen nga rajonet veriperëndimore e vazhdon në jug. Ajo mbushet nga depozitimet e miocenit të sipërm dhe pliocenit, të cilat vendosen transgresivisht mbi depozitimet e katit të poshtëm strukturor deri dhe mbi gëlqerorët e kretakut, duke krijuar gjire paleogjeografike të favorshme për grumbullimin e naftës dhe gazit. Marrëdhëniet midis dy kateve tektonike janë verifikuar nga një mori pusesh të shpuara në muldën e Kuçovës, të cilët kanë vërtetuar se depozitimet

neogjenike vendosen transgresivisht mbi një sipërfaqe të shpëlarë me konfiguracion të ndryshëm në trajtë gjiresh dhe kurrizoresh. Gjiret e sipërfaqes së shpëlarë kushtëzojnë naftë-gazmbatjen industriale në vendburimin e Kuçovës, kurse në pjesën e kurrizoreve shtresat naftë-gazmbajtëse ose mungojnë, ose janë në sasi të vogël. Sipërfaqja e shpëlarë ndërtohet nga depozitimet e periudhës së kretakut të sipërm, të paleocenit, eocenit dhe oligocenit. Mulda e Kuçovës ka formë vezake me thellësi që shkon deri në 1500-1600 m, sipas të dhënave të deritanishme. Dimensionet e saj janë: gjatësia 12 km, gjerësia rreth 9 km. Brenda vendburimit të naftës Kuçovë dallohen disa gjire neogenike, të cilat janë:

- Gjiri i Kuçovës
- Gjiri Salcë - Kozarë
- Gjiri i Fermës
- Gjiri i Arrzës

Gjiri i Kuçovës: Ndodhet në pjesën lindore të këtij vendburimi. Ka shtrirje nga jugu në veri, me orientim J.JP – V.VL, me gjatësi rreth 7 km dhe gjerësi 2.5 km. Depozitimet e katit të sipërm vendosen mbi ato të katit të poshtëm në nivele të ndryshme stratigrafike. Kështu, nga aksi i gjirit e në lindje ato vendosen mbi depozitimet flishore, ndërsa nga aksi e në perëndim vendosen mbi depozitimet karbonatike të kretak – paleogjenit. Në bazë të ndërtimeve, depozitimet kanë rënie nga perëndimi me kënd 5–20o dhe lindje me kënde më të vogla, deri horizontale.

Gjiri i Fermës: Ndodhet më në perëndim të gjirit të Kuçovës dhe ndahet prej tij nga paleongritja e strukturës së varrosur të Kuçovës dhe vazhdimi i periklinalit verior të Kullsit. Në perëndim ndahet me gjirin e Arrzës nëpërmjet paleongritjes flishore, ndërsa në veri plekset me gjirin e Salcë-Kozarës. Ka orientim J.JP – V.VL, me një gjatësi 5 km dhe gjerësi 300 – 600 m, dhe ka formën e një ulluku të thellë me disa gropëzime. Trashësia më e madhe e depozitimeve është në aksin e gjirit, ndërsa në drejtimin perëndimor dhe sidomos atë lindor ajo reduktohet kryesisht në pjesën e poshtme.

Gjiri i Salcë-Kozarës: Ndodhet në pjesën veriore të vendburimit dhe ka shtrirje lindje-perëndim me gjatësi 6-7 km dhe gjerësi 0.5-1 km. Ky gji pëson thellim nga lindja drejt perëndimit dhe trashësia e depozitimeve që marrin pjesë në ndërtimin e këtij gjiri ka të njëjtën ligjësi me gjirin e Fermës. Në veri depozitimet e katit të sipërm vendosen direkt mbi depozitimet e katit të poshtëm me rënie të shtresave në kokë deri të përmbysura për efekt të diapirit të Dumresë. Drejt jugut plekset me gjirin e Kuçovës dhe kufizohet nga paleongritja e strukturës së varrosur të Kuçovës. Konfiguracioni i gjirit është funksion i veprimit të diapirit të Dumresë.

Gjiri i Arrzës: Ndodhet më në perëndim të gjirit të Fermës, dhe në jugperëndim kufizohet nëpërmjet një paleongritjeje të butë me gjirin e Pëllumbasit. Në drejtim të veriperëndimit gjiri i Arrzës pëson një thellim dhe të jep përshtypjen e bashkimit me gjirin e Salcë-Kozarës. Gjiri ka formën e një gjysëm stadiumi me një rënie monoklinale të depozitimeve nga lindja në perëndim me kënd rënieje 15 -20°.

Naftë-gazmbajtja[8]

Naftë-gazmbajtja e vendburimit të Kuçovës, deri më sot, lidhet me depozitimet neogenike të miocenit të sipërm të katit të sipërm tektonik. Si shkëmbinj kolektorë në këtë vendburim shërbejnë shtresat ranore që takohen në formë ndërthurjesh midis argjilave që formojnë suitat litologjike të përshkruara më sipër. Këto shtresa ranore, nëpërmjet sipërfaqes së

shpëlarë, vihen në kontakt me formacionet karbonatike nga ku nafta ka migruar drejt shtresave ranore ku i gjejmë sot. Këto shtresa ranore paraqesin karakteristika të ndryshme petrofizike dhe, për pasojë, edhe aftësi të ndryshme debituese. Në vartësi të pozicionit të tyre në prerje edhe nafta e depozituar në këto shtresa paraqet veti të ndryshme fizike, sipas të cilave kemi nafta të rënda e viskoze dhe nafta më të lehta. Prerja karbonatike e katit të poshtëm tektonik në të gjitha punimet e deritanishme ngelet përsëri një objekt kërkimi për të ardhmen. Në këtë vendburim janë vërtetuar shtratime të tipave: litologjik, litologo-stratigrafik dhe stratigrafik. Trupat ranorë naftëmbajtës të zonës së Kuçovës kanë veti petrofizike, të cilat variojnë në kufij mjaft të gjerë ku vlerat mesatare të ponteruara janë: Poroziteti 21.6 %; Përshkueshmëria 70-150 md; Përmbajtja e karbonateve 18%: Ujëngopja 45-50%: Nafta është e tipit nafteno-aromatik, me densitet 0,920-0,970 gr/cm3 (14-22)°API dhe fraksione të bardha 23-46 %; Përmbajtja e squfurit në naftë 3,4-5%; Gazi përbëhet nga 63-90 % metan, hidrokarbure të rënda 13-30%.

Në këtë vendburim energjia e shtresës është ajo e gazit të tretur, ndërsa tani vepron tërësisht energjia e gravitacionit që pasqyrohet në nivelet e ulëta të lëngut në puse me debit shumë të vogël të rendit 0,1-0,2 t/ditë që shfrytëzohen me regjim periodik.

- Analiza e pasurive natyrore

Bashkia e Kuçovës njihet për lëndën e parë energjetike të naftës. Gjithashtu, në territorin e kësaj bashkie hasim edhe minerale të tjera jo metalore si argjilë dhe inerte. Këto gjenden përgjatë rrjedhës së lumit Devoll.

Figura 5. Analiza e mbivendosjes së gjeologjisë, pasurive minerale dhe burimeve të naftës



Burimi: SHGJSH; Përpunoi: Co-PLAN, 2016

1.1.3 Analiza hidrogjeologjike dhe hidrografike

- Analiza hidrogjeologjike

Sipas hartës hidrogjeologjike të qarkut të Beratit[9], pjesa më e madhe e bashkisë Kuçovë përbëhet nga jo akuifere [10]: Shkëmbinj të cilët janë pa porozitetin e mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarje. Në përgjithësi, tek këto shkëmbinj mungojnë burimet ujore për furnizim lokal me ujë të pijshëm. Zona jo akuifere e bashkisë përbëhet kryesisht nga shkëmbinj kompakt sedimentar dhe shkëmbinj magmatik dhe metamorfik. Tek

shkëmbinjtë sedimentarë hasim me shumicë llojin flish, më pak llojin alevrolit dhe argjilor dhe rrallë atë ranor, ndërsa tek shkëmbinjtë magmatikë kemi llojin e vullkaniteve.

Zona e Lumit Devoll, NJA Kuçovë dhe NJA Perondi janë në përgjithësi zona të akuifereve me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri mesatare- të ulët 10^{2}-10^{-1}. Lidhja hidraulike e ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor është e mirë. Rezervat e shfrytëzueshme në këto akuifere janë të pakta. Ato shërbejnë për furnizimin e komuniteteve të vogla me ujë të pijshëm. Shfrytëzimi realizohet me anë të shpimeve, por edhe burimeve. Në përgjithësi, vetitë fiziko-kimike të ujërave të tyre janë të mira: të ëmbël e me fortësi të ulët. Shkëmbinjtë në këtë zonë i përkasin llojit të shkëmbinjve të shkrifët, sedimenteve, llojit të rërave, zhavorreve dhe argjilave. Shpimet në këtë zonë janë me presion.


Për nga sipërfaqja, vendin e tretë e zënë akuiferet me porozitet poro-çarje dhe ujëpërcjellshmëri të ulët- shumë të ulët. Këto toka përbëhen nga shkëmbinj kompakt sedimentarë të llojit të argjilës, ranorë dhe konglomerate. Këto zona ndodhen në Fier-Mimari dhe në Drizë.

Së fundmi, kemi edhe akuifere me porozitet poro-çarje dhe ujëpërcjellshmëri mesatare- e ulët. Tipi i shkëmbinjve është alevrolit dhe argjilorë të rrallë ranorë. Rezervat e shfrytëzueshme në këto akuifere bëhen nëpërmjet burimeve dhe shpimeve. Akuiferet janë me presion dhe në disa zona kanë karakter artezian. Përdoren për furnizim me ujë të pijshëm të komuniteteve të vogla. Ujërat janë të ëmbla me fortësi mesatare deri të madhe.

- Analiza hidrografike

Bashkia Kuçovë bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Seman. Kjo bashki ka një rrjet hidrografik të pasur, pasi në territorin e saj kalon lumi Devoll. Në kufirin e bashkisë së Kuçovës me bashkinë e Urës Vajgurore ndodhet edhe vendbashkimi e lumenjve Osum dhe Devoll, të cilët krijojnë lumin Seman, i cili vazhdon përgjatë kufirit bashkiak. Gjithashtu, në territorin e bashkisë kemi edhe shumë përrenj dhe disa rezervate ujore.

Figura 6. Analiza e mbivendosjes së hidrogjeologjisë dhe hidrografisë



Burimi: SHGJSH ; Përpunoi: Co-PLAN, 2016

1.1.4 Analiza e gjeorreziqeve

- Analiza e gjeorreziqeve

Gjeorreziqet janë rreziqe me natyrë natyrore që mund t'i kanosen një zone. Origjina e këtyre rreziqeve është:

- Gjeologjike: termete, rënie shkëmbinjsh, rrëshqitje tokash
- Atmosferike: stuhi bore, stuhi ere, thatësira
- Hidrologjike: përmbytje
- Biofizike: zjarre në pyje, epidemi

Sipas hartës së gjeorreziqeve të Shqipërisë nga SHGJSH-ja, gjeorreziqet më të shpeshta që hasen në bashkinë e Kuçovës kanë të bëjnë me rrëshqitjet e tokave, sidomos në zonën perëndimore. Kjo vjen si pasojë e përbërjes së këtyre tokave që janë kryesisht mollasa oligocen- miocenike. Në disa kodra të bashkisë kemi të hasur edhe dukurinë e tarracimit, i cili u realizua përgjatë viteve 1970-1980. Përveç tarracimit, kemi edhe mbjelljen me kultura bujqësore, proces i cili ua hoqi pamjen natyrale. Në të shumtën e rasteve këto kodra janë të mbjella me pemë frutore, por ka dhe raste kur ato janë të veshura me pyje natyrale. Kjo njësi morfologjike është e prekur së tepërmi nga erozioni dhe fenomene shpati të tipit rrëshqitje të dherave ,të shkëmbinjve flishorë apo ata me dominim argjilor. Në lidhje me ndërtimet, kjo njësi morfologjike është tepër e lakmueshme, sepse ka ballkone natyrore me pamje piktoreske si në drejtim të detit, ashtu edhe në drejtim të fushave dhe qyteteve kryesore të qarkut. Por nuk janë shumë të rekomandueshme, pasi kërkohen investime shtesë për marrjen e masave mbrojtëse paraprake për të eliminuar mundësinë e rrëshqitjeve, pasi nëse ato ndodhin, shkatërrohet i gjithë investimi i bërë.[11]

Figura 7. Kodër e tarracuar në Kuçovë



Burimi: SHGJSH

Problematikë e madhe në këtë territor është edhe ndotja nga industria e naftës dhe gazit. Për një periudhë mbi 40 vjeçare kjo industri u shndërrua në një ndotës potencial, pasojat e të cilit kanë ndikuar në ekosistem dhe në shëndetin e banorëve të kësaj zone. Nga të dhënat e SHGJSH-së[12], burimet kryesore ndotëse janë Uzina e Përpunimit të Naftës, Uzina Mekanike e Naftës, Shpim Shfrytëzimi, Ndërmarrja e Nxjerrjes së Naftës, TECI, Fabrika e Pluhurave Larës, Fabrika e Tullave. Të gjitha emetimet e lëngta, të ngurta dhe të gazta nga objektet industriale kanë ndikuar dhe ndikojnë në ndotjen e ajrit, të tokës dhe të ujit si

në qytetin e Kuçovë, ashtu edhe përreth tij. Të gjitha ndotjet e lëngta janë shkarkuar dhe shkarkohen në tokë dhe derdhen në lumin Osum. [I. Prifti, A. Bitri.2010].

Degradimi i godinave të Uzinës së Përpunimit të Naftës, dikur një nga veprat e njohura e produktive në vend, për shkak të ndotjes së tokës e mjediseve, si dhe mungesës së rehabilitimit të tyre nga helmet, vazhdon të mbetet një kërcënim serioz për jetën e banorëve të bashkisë së Kuçovës.


- Analiza e rrezikut sizmik

Tërmetet janë dukuri natyrore ose artificiale të cilat mund të shaktojnë dëme të mëdha në njerëz dhe në materiale. Ato shkaktohen nga disa faktorë, si: përplasja e pllakave të Tokës, shpërthimet nëntokësore etj. Duke qenë se janë të paparashikueshëm, ato shkaktojnë akoma më shumë dëme, pasi parandalimi i tyre është i paarritshëm. Megjithatë, njohja e efekteve dhe e zonave më të prirura për aktivitet të lartë sizmik pakëson pasojat negative të tërmeteve. Shqipëria bën pjesë në zonën sizmike alpine, ku gjenerohet rreth 15% e energjisë sizmike të globit tokësor[13]. Përveç pllakave sizmike, kemi edhe mikropllaka, të cilat janë njësi më të vogla ndarëse. Për vendin tonë më shumë rëndësi paraqet mikropllaka Adria, e cila shtrihet ndërmjet pllakës Afrikane dhe asaj Euro-Aziatike. Përplasja e pllakës Adria me Albanidet është shkaku kryesor i tërmeteve në vend dhe, si pasojë, kemi një aktivitet të theksuar sizmik. Shqipëria karakterizohet nga zona me aktivitete sizmike të ndryshme:

- Mikro- aktivitet sizmik intensiv: 1.0<M<3.0
- Tërmete të vegjël, por që ndodhin më shpesh: 3.0<M<5.0
- Tërmete të rrallë me madhësi mesatare: 5.0<M<7
- Tërmete më të rrallë të fortë: M>7

Bashkia Kuçovë bën pjesë në 2 zona përsa i përket intensitetit sizmik: asaj me 8 dhe 9 ballë. Kjo do të thotë që intensiteti i pritur i tërmeteve në zonë është mjaft i lartë dhe mund të shkajtojnë shumë probleme. Në territorin e kësaj bashkie nuk kanë ndodhur shumë tërmete të mëdha që të kenë shkaktuar dëme të mëdha në njerëz apo materiale[14], megjithatë në afërsi të bashkisë ka pasur 2 tërmete më të mëdha, përafërsisht 6-6.9 ballësh. Në përgjithësi, tërmetet që ndodhin në zonën Fier- Lushnje- Ballsh kanë ndikim edhe në bashkinë e Kuçovës. Tërmetet nuk kanë shkaktuar probleme në materiale, por vetëm psikologjike tek banorët. Megjithatë, rreziku sizmik në zonë mbetet mesatarisht i lartë, duke pasur parasysh edhe përbërjen e shkëmbinjve të territorit.

Figura 8. Analiza e mbivendosjes së rreziqeve në bashkinë e Kuçovës



Burimi: SHGJSH ;Përpunoi: Co-PLAN, 2016

1.1.5 Analiza e bonitetit të tokave

Përsa i përket kësaj analize nuk kemi të dhëna të cilat na ndihmojnë për të nxjerrë një konkluzion të mirefilltë mbi bonitetin e tokave por me anë të analizave të tjera që janë ndërmarrë në kuadër të planit do të bëjmë një analizim të përafërt të bonitetit të tokave. Boniteti i tokës vlerëson produktivitetin e tokës i cili është i lartë, i ulët ose i mesëm në bazë të disa kushteve dhe indikatorëve bazë që ndikojnë në të. Boniteti vlerësohet sipas numrave nga 1 në 10 ku boniteti më i lartë është 1 dhe më i ulët është 10.

Nga analiza e sektorit bujqësor, sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Kuçovë është rreth 8448 ha ku siperfaqen më të madhe e kanë njësitë administrative Kozare dhe Perondi por edhe NjA Lumas ka disa zona me toka bujqësore siç është zona e luginës së përroit të Lapardhicës.

NjA Kozare në pjesën perendimore të saj në afërsi të bashkimit të dy lumenjve Osum dhe Devoll ka toka të cilesise së larte, duke qenë se në këtë zona dhe niveli i fragmentimit të tokës bujqësore është i vogël dhe struktura e kanaleve të kullimit është e mirëbajtur dhe e ruajtur kjo zonë do të jetë me bonitet të lartë. Në pjesët e tjera të NjA Kozare niveli i fragmenitmit është më i lartë , ekzistenca e puseve në këtë zonë ul cilësinë e tokave sidhe preblemet me vaditjen dhe kullimin e bëjnë që boniteti i këtyre tokave të jetë i mesëm.

NjA Perondi ka një cilësi të mirë të tokave por për pasojë të nivelit të lartë të fragmentimit të tokës bujqësore që ka boniteti vlersohet të jetë i mesëm.

Nja Lumas ka një sasi të limituar të tokës bujqësore si pasojë e relievit që ka. Zonat bujqësore kryesisht ndodhen në luginën e lumit të Lapardhicës. Këto toka vlerësohet të jenë me bonitet të mesëm- të ulët kjo si pasje e erozionit dhe cilësisë së tokës.

1.1.6 Analiza e monumenteve dhe zonave të mbrojtura

- Gjeomonumentet

Gjeomonumentet janë zona natyrore që paraqesin interes të veçantë përsa i përket mënyrës si janë krijuar, rrallësisë, vlerave historiko- kulturore ose funksionit të tyre si pika interesi. Për nga rëndësia, gjeomonumentet ndahen në[15]:

- Gjeomonumente me vlera ndërkombëtare
- Gjeomonumente me vlera kombëtare
- Gjeomonumente me vlera rajonale

Në territorin e bashkisë kemi një gjeomonument me vlera ndërkombëtare dhe ai është vendburimi i naftës. Vendburimi i Naftës Kuçovë (VII-4) përbën një gjeomonument historik dhe është zbuluar qysh në vitin 1930. Ai ndodhet në 84 ranorët e depozitimeve neogjenike të tortonian-miocenit të sipërm, të vendosura transgresivisht mbi antiklinalin karbonatik të eroduar të Kuçovës. Shtratimet janë të tipit litologo-stratigrafik. Vendburimi është më i vjetri i naftës në Shqipëri.[16]


- Sipërfaqet pyjore

Bashkia e Kuçovës ka 16.8 km^2 toka pyjore me pronësi publike dhe private. Fondi pyjor publik zotërohet e administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor dhe organet e qeverisjes vendore. Pjesë nga ky fond pyjor kombëtar mund të kërkohet nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore për t'u kthyer në truall për destinacione specifike të parashikuara në ligjin e mësipërm: me miratim të ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha; me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe nga 1 deri në 100 ha; dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 100 ha.

- Zonat e mbrojtura

Në bashkinë e Kuçovës ndodhen 2 monumente kulture të kategorisë së parë: Kisha e Ungjillëzimit në fshatin Kozare dhe Kisha e Shën Kollit në fshatin Perondi. Kjo e fundit mendohet se është ndërtuar rreth shek. X dhe është një shprehje tipike e arkitekturës bizantine të veprave të kultit, ku në muraturë kombinohet guri me terrakotën dhe ku volumet modeste kompensohen me pasurinë e elementeve arkitekturore.

Figura 9. Analiza e monumenteve dhe zonave të mbrojtura



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe PLGP/Co-PLAN, 2016


1.1.7 Analiza e tendencave të zhvillimit

Pavarësisht identitetit të Kuçovës, të lidhur ngushtësisht me industrinë e nxjerrjes së naftës dhe emërtimin "Qyteti Stalin", vendbanimet e para në këto zona i përkasin periudhës ilire, kur territori administrohej nga fisi i Desarejve. Gjetjet në njësinë Perondi dhe në kodrën e Omurit dëshmojnë për një kulturë të zhvilluar sa i takon mënyrës së ndërtimit të shtëpive, shëtitores, armatimeve të përdorura etj.

Që në periudhën e mesjetës e deri në vitet 1700-1800 territori shfrytëzohej për naftën që dilte me vetërrjedhje, e cila u shitej tregtarëve myzeqarë si vaj grasatues dhe për djegie. Gjithsesi, zhvillimin më të madh Kuçova e ka njohur pas Luftës së Dytë Botërore, sidomos në vitet 1975 – 1990, duke u shndërruar në qytetin e parë të industrializuar në vend. Në qytet u ngritën 15 ndërmarrje të rëndësishme, si: Uzina e Përpunimit të Naftës, U.M.N Shpim-Shfrytëzimi, Ndërmarrja e Nxjerrjes së Naftës, TEC-i, Shkolla e Mesme e Naftës, si dhe u krijua Baza Ajrore "23 Peza" si formacion luftarak për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Shqipërisë.

Në këtë periudhë, popullsia e qytetit ka pësuar rritje të jashtëzakonshme, nga 300 banorë në vitin 1923 në 15 000 në 1979 e 30 000 në 1998. Vetëm vitet e fundit, me kolapsin e industrisë përpunuese dhe mekanike, popullsia ka pësuar ritme të vogla uljeje, të cilat priten të vërehen edhe në të gjithë bashkinë për 10 vitet e ardhshme.

Figura 10. Rritja e popullsisë në vite, qyteti Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë
Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Sot identiteti industrial i Kuçovës mbetet mjaft i fuqishëm, pavarësisht përqendrimit më të madh të punësimit dhe aktivitetit ekonomik në sektorin e shërbimeve dhe tregtisë. Shumë nga ndërmarrjet e dikurshme janë jashtë funksionit dhe përbëjnë një gjurmë të theksuar në ekonominë dhe mjedisin lokal. Në aspektin kulturor, dy objektet më të rëndësishme fetare në bashki përbëjnë një pasuri kombëtare të ruajtur shumë mirë dhe të përshtatshme për zhvillim potencial turizmi kulturor: Kisha e Shën Kollit e periudhës bizantine në Perondi, si dhe Kisha e Kozarës e shek. XVII.


Figura 11. Kisha e Shën Kollit, Perondi / Uzina e Përpunimit të Naftës



Burimi: Wikipedia, Shqipëri [17]

Bashkia e Kuçovës ka pësuar një shtrirje hapësinore të konsiderueshme në periudhën pas viteve 1990, e cila është shfaqur në tri forma kryesore: zgjatim i vendbanimeve ekzistuese drejt tokave bujqësore dhe natyrore, densifikim i strukturës ekzistuese urbano-rurale, si dhe krijim i vendbanimeve nukleare, të palidhura në vazhdimësi me ato ekzistueset.

Figura 12. Zhvillimi hapësinor i Kuçovës në intervalet: para viteve 1990, 1990-2007, 2007-2013



Burimi: ASIG, harta topografike (sh 1:10 000; 1:25 000), ASIG ortofoto (2007), ESRI Basemap (2015)
Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


Në periudhën para viteve 1990[18] vetëm 4,1% e territorit të tanishëm të bashkisë së Kuçovës ishte e urbanizuar (duke përfshirë këtu vendbanimet dhe zonat industriale të ndërtuara në vitet '50-'70. Qendra e urbanizimit ishte qyteti i Kuçovës, por edhe tërësia e fshatrave ekzistuese edhe sot me karakter bujqësor e natyror dhe shtrirje lineare ose në përputhje me terrenin.

Deri në vitin 2007 urbanizimi arriti masën 8.17%[19], duke shënuar kështu një rritje të vendbanimeve me 91.98% (afërsisht 2 herë). Zgjerimin më të madh e ka pësuar njësia

Perondi me 246%, ndjekur nga Kozarja me 74%. Duke qenë planifikuar që në fillim si qytet i dendur, me kufi të përcaktuar mirë, Kuçova ka pësuar një rritje minimale prej 2% gjatë kësaj periudhe. Ndërkaq, njësia Lumas, me presion të ulët zhvillimi, është rritur me 22%. Mesatarisht, ritmi i përhapjes hapësinore të vendbanimeve në intervalin kohor 1990-2007 ka qenë 4.6% në vit. Tipologjitë më të përhapura hapësinore të shtrirjes ishin: vila me densitet të ulët në toka bujqësore periferike të vendbanimeve ekzistuese, si dhe vila me densitet shumë të ulët në strukturë pikësore.

Ndërkaq, në periudhën 2007-2013, rritja hapësinore vjetore në nivel bashkie ka ritëm shumë të ulët, rreth 0.44% në vit. Kjo vjen në linjë me tendencat migruese të popullsisë dhe tkurrjen e vendbanimeve rurale. Njësia Kozarë ka shtim më të madh urbanizimi me rreth 6%, ndërkohë që njësitë e tjera variojnë në 1-2% për të gjithë intervalin kohor. Tipologjitë e këtyre lloj vendbanimesh janë kryesisht nukleare, të veçuara, me ndërtime të tipit vilë me densitet të ulët.

Figura 13. Grafiku i rritjes hapësinore të njësive administrative të Kuçovës në intervalet: para viteve 1990, 1990-2007, 2007-2013



	totali kozare	totali kucove	totali lumas	totali perondi
sip_3	183416	4404	29797	138230
sip_2	1241627	33623	426451	4815259
sip_1	1661538	1490495	1975931	1957160

Burimi: ASIG, harta topografike (sh 1:10 000; 1:25 000); ASIG ortofoto (2007); ESRI Basemap (2015); Llogaritje të autorëve
Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe PLGP/Co-PLAN, 2015

1.2 Dokumentet e planifikimit të hartuara më parë

Gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është e rëndësishme të merren në konsideratë planet dhe propozimet e parashtruara në dokumentet e mëparshme të planifikimit, në kuadër të bashkërendimit horizontal dhe vertikal me proceset e planifikimit që ndikojnë mbi territorin e bashkisë, si dhe për të ndikuar në një planifikim më të mirë, duke rimarrë ide dhe propozime ende të vlefshme.

Dokumentet e planifikimit që kanë ndikuar mbi territorin e bashkisë së Kuçovës janë të dy llojeve:

- Strategji zhvillimi ekonomik, hapësinor etj.
- Plane rregulluese dhe planifikim vendor

1.2.1 Strategjitë e zhvillimit

Strategjia e zhvillimit të qarkut Berat (2012): Qarku Berat, në bashkëpunim me UNDP-në, në 2012 ka hartuar strategjinë e zhvillimit, si një instrument që orienton politikat vendore të bashkive të qarkut drejt një vendimmarrjeje të mirë dhe të koordinuar në lidhje me aspekte të zhvillimit hapësinor, ekonomik, social etj.

Strategjia është afatmesme, me shtrirje deri në vitin 2016, dhe ka si synim të sillë aktorë të ndryshëm rajonalë e lokalë në një tryezë diskutimi për të marrë pjesë në aktivitete specifike që do të nxisnin zhvillimin rajonal.

Disa nga objektivat strategjikë të saj renditen si më poshtë:

OS1: Të zhvillohen, mbështeten dhe ruhen kapacitetet zhvilluese të aktorëve dhe institucioneve të rajonit për të nxitur procese të mëtejshme të zhvillimit rajonal;

OS2: Të zgjerohet pjesa produktive e ekonomisë së rajonit, veçanërisht sektorët apo fushat e afta për të gjeneruar të ardhura për të gjithë rajonin;

OS3: Të sigurohet niveli i duhur për komunikim/lidhjen me rrugë brenda rajonit për të siguruar zhvillimin e duhur ekonomik dhe social;

OS4: Të vlerësohet dhe përmirësohet mjedisi natyror i rajonit, si aspekt kyç për identitetin dhe tërheqjen e tij, veçanërisht duke shmangur gjithë efektet negative në mjedis që vijnë prej aktivitetit njerëzor;

OS5: Të sigurohet shërbimi adekuat shëndetësor që garanton shëndet të mirë të qytetarëve;

OS6: Të zhvillohen kapacitetet njerëzore në rajon dhe të ofrohen kushte të përshtatshme për drejtësi, përfshirje dhe mundësi për të gjithë, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja sa më e gjerë e qytetarëve në ekonomi dhe jetën sociale.

Plani strategjik për zhvillimin ekonomik të bashkisë së Kuçovës (2008-2015): Ky plan është hartuar nga Bashkia Kuçovë për të evidentuar synimet dhe pritshmëritë afatmesme në lidhje me zhvillimin ekonomik në periudhën 2008-2015. Ai trajton disa nga problematikat kryesore të qytetit, si dhe parashtron një plan veprimi për zgjidhjen e tyre. Disa nga rezultatet e pritura nga ky plan janë renditur më poshtë:

- Ulja e numrit të familjeve të pastreha në Kuçovë me 30% deri në vitin 2010
- Hartimi i një plani gjithëpërfshirës për zhvillimin e përdorimit të tokës dhe sigurimi i zhvillimeve në të
- Ulja e ndotjes dhe rritja e cilësisë së ambientit
- Rindërtimi i rrjetit të brendshëm të shpërndarjes së ujit për të pasur 24 orë ujë
- Përmirësimi i ndriçimit publik dhe i shenjave njohëse
- Përmirësimi i sistemit arsimor, kulturor e sportiv
- Përmirësimi i sistemit shëndetësor
- Nxitja për krijimin dhe konsolidimin e biznesit të vogël dhe të mesëm me qëllim zgjerimin e prodhimit e të punësimit
- Nxitja e investimeve për rritjen e prodhimit të naftës
- Shërbime sociale për shtresat në nevojë


- Ringritja e institucioneve të kulturës

Për secilin qëllim janë evidentuar aktivitetet e nevojshme për t'u kryer, aktorët përgjegjës dhe ndarja në faza kohore i këtyre veprimtarive. Disa projekte bazë të identifikuara, me ndikim në territor, janë: Identifikimi i të gjitha pronave që kanë nevojë për rikonstruksion dhe krijimi i një baze me të dhënat; Hartimi i projektit të unazës së qytetit me kalim nga ish-UPN-ja; Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit; Matja dhe analiza e treguesve të ndotjes së ambientit; Rishikimi i projekteve ekzistuese të lidhura me shtimin e gjelbërimit në qytet; Hartimi i një plan-veprimi për heqjen e mbeturinave teknologjike nga territori i U.M.N.-së; Bashkëpunimi me Këshillin e Qarkut për zgjidhjen rajonale të vendgrumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane; Hartimi i një plani pune për përmirësimin e sipërfaqes në zonën naftëmbajtëse në zonat rreth puseve të naftës; Hartimi i projekteve për zonat me gropa septike dhe për kolektorin kryesor; Rehabilitimi i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit; Kryerja e një studimi të plotë për shenjat e qarkullimit rrugor për të gjithë qytetin; Emërtimi i rrugëve sipas standardeve ndërkombëtare; Kryerja e një studimi për identifikimin e nevojave për bazë materiale didaktike në arsim; Të rritet ndjekja e arsimit bazë nga fëmijët në masën 1% për ciklin e ulët dhe ciklin e lartë deri në vitin 2010 dhe 3% për ciklin e ulët dhe 1% për ciklin e lartë deri në vitin 2015; Kryerja e nje studimi për objekte shëndetësore dhe ngarkesën e mjekëve; Ngritja e linjave të përpunimit të qumështit për rrethin; Ngritja e funksionimi i kurseve në fushat e rrobaqepësisë, qëndistarisë, floktoreve, punimit në dru etj.; Gjetja e fondeve për përfundimin e rrugës Kuçovë-Elbasan; Rritja sasiore e prodhimit të naftës; Sigurimi i të dhënave për numrin e personave me aftësi të kufizuara, llojet e AK-së, shërbimet; Reduktimi i braktisjes së shkollës nëpërmjet kurseve parashkollore dhe shkollore; Strukturimi i personelit të Shtëpisë së Kulturës etj. Siç shihet, shumë nga këto projekte janë ende realiste edhe në kushtet e sotme të zhvillimit të bashkisë.

1.2.2 Planifikimi rregullator e vendor

Planet rregulluese 1963, 1976: Qyteti i Kuçovës ka 2 plane rregulluese të mëparshme, respektivisht të vitit 1963 dhe 1976. Këto plane kanë ndikuar në strukturimin hapësinor të qytetit, duke i dhënë formën kompakte që ka edhe sot. Objektivi kryesor i planit rregullues të vitit 1976 ishte zonifikimi në mënyrë sa më të drejtë i sipërfaqes së qytetit për të pasur një ndarje të qartë të territoreve të ndërtimit dhe shpërndarjen në mënyrë të përshtatshme të objekteve social-kulturore dhe industriale. Gjithashtu, një ndër realizimet më të rëndësishme ishte studimi i rrjetit rrugor për të plotësuar nevojat e lëvizjes për popullsinë e ardhshme, e cila pritej të ishte 24,000 deri në vitin 1996.

Figura 14. Plani rregullues, 1976



Burimi: Bashkia Kuçovë, 2015


Ky plan e trajton lagjen e vjetër "11 Janari" jashtë studimit, duke qenë se përfshihet në zonën naftëmbajtëse. Sheshi i grevës është ruajtur si monument historik që merr vlera të reja. Rrjeti rrugor ka një ndryshim me ekzistuesin për sa i takon zgjidhjes më të mirë të lëvizjes së trafikut si hapjen e një rruge 7 m të gjerë në perëndim të qytetit në rrëzë të kodrave në një trase, e cila tani ka marrë formë. Kjo rrugë largon lëvizjen e makinave të rënda që kalojnë nëpër qytet dhe të çon në uzinën e përpunimit të naftës dhe në fshatrat rreth qytetit. Në të dy zgjidhjet është parashikuar një rrugë e re me gjerësi 5 m që të çon në varrezat e reja të qytetit, të vendosura pas kodrës së uzinës së përpunimit të naftës në periferi të qytetit.[20]

Sa i përket zonimit të banimit, ky plan parashikonte 3 zona kryesore: pjesën verilindore të qytetit në faqe të kodrës ku do të vendoseshin ndërtesa 5-katëshe, sipas terrenit, duke akomoduar një popullsi prej rreth 5000 banorësh; pjesën jugore, me ndërtesa të tipit vilë, me çati, për një popullsi prej rreth 4000 banorësh; dhe pjesën juglindore në lagjen '1 Maji', e rezervuar kur popullsia të arrinte mbi 30 000 banorë në të gjithë qytetin. Ky planifikim i rritjes ishte shumë larg realitetit, duke qenë se para reformës territoriale qyteti strehonte vetëm 13 323 banorë[21]. Këto zona banimi ishin planifikuar sipas konceptit të bllokut të banimit dhe duhet të kishin objekte tregtare, çerdhe e kopshte brenda territorit të tyre.

Plani rregullues propozon zgjerimin e parkut të qytetit nga 1.5 ha në 4.5 për të realizuar standardin 1.4 m2/banor.

Plani i Përgjithshëm Vendor, 2013: Në periudhën 2012-2013 Bashkia Kuçovë hartoi Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV), në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit nr. 10 119, datë 23/04/2009, 'Për planifikimin e territorit' dhe rregulloreve përkatëse që ishin në fuqi në atë periudhë. Me ndryshimet territoriale, ky plan është shfuqizuar. Gjithsesi, gjetjet dhe propozimet e tij më të rëndësishme janë marrë në konsideratë në punën për hartimin e këtij instrumenti planifikimi.

Figura 15. Përdorimi i propozuar i tokës




Burimi: PPV Kuçovë, 2012

Plani i Përgjithshëm Vendor (2013) përcakton mënyrën e zhvillimit të territorit të njësisë Kuçovë deri në vitin 2023, duke përfshirë propozimet për përdorimin e tokës, infrastrukturën rrugore dhe nëntokësore, mënyrat e ndërhyrjeve në territor, ndarjen dhe parametrat e zhvillimit sipas njësive strukturore etj. Ai parashikon disa ndryshime në përdorimin e tokës si shndërrimin e zonës së ish-UPN-së në zonë banimi mikse të kufizuar nga një hapësirë e gjelbër rekreative, krijimin e një qendre të integruar arsimi, kërkimi e sporti në afërsi të zonave industriale në hyrje të qytetit, rritjen e numrit të zonave ekonomike të ndikimit të mesëm e të lartë në kufi të qytetit, krijimin e hapësirave të gjelbra të kultivuara në periferi etj.

Nga pikëpamja infrastrukturore, plani parashikon ndërtimin e një unaze me gjerësi të trupit të rrugës 28 metra, e cila përshkon qytetin nga rrethrrotullimi në hyrje deri në afërsi të varrezave. Gjithashtu, propozohen rrugë urbane dytësore që lidhin zonat e reja të banimit dhe ato industriale me pjesën qendrore në trajtë rrjeti. Edhe në lidhje me sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimeve bëhen propozime për mbulimin më të mirë të rrjetit dhe furnizimin me shërbim të pjesës më të madhe të familjeve. Disa nga projektet që propozohen nga plani, në vazhdim, janë:

- Rinatyralizimi i strukturës së banimit të qytetit, si dhe i sipërfaqeve për kohën e lirë, zonave argëtuese dhe çlodhëse.

Figura 16. Infrastruktura rrugore e propozuar



Burimi: PPV Kuçovë, 2012

- Promovimi dhe valorizimi i imazhit origjinal për qytetin në alternativë me atë të qytetit industrial;
- Urbanizimi i zonave informale (gjelbërim, ndriçim, trotuare, kanalizime etj.);
- Përdorimi i sistemit LED dhe ndriçimi me energji diellore si në objektet publike (ndriçim rrugë, sheshe, shkolla etj.), ashtu edhe ato private duke sjellë kursim të energjisë elektrike dhe, si rrjedhim, uljen e kostove ndaj këtij shërbimi;
- Përmirësimi i mbledhjes, transportit dhe trajtimit të mbeturinave. Ndërtimi i një landfill-i në bashkëpunim me zonat përreth, si dhe mundësia e ndarjes së mbeturinave që në burim;
- Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm deri në 24 orë;
- Promovimi i sipërmarrjeve të partneritetit midis sektorit privat dhe atij publik për krijimin e parqeve argëtuese për të rinjtë dhe të ambienteve çlodhëse për të moshuarit, si dhe zonave argëtuese, zonave sportive dhe zonave për lëvizjet me biçikletë;
- Mbështetja e projektimit të tipologjive të reja të banesave për të përmirësuar cilësinë e qytetit me dendësi të mesme;
- Krijimi i një poli të ri sportiv duke parashikuar ndërtimin e një pallati shumësportësh, impiante për lojërat me dorë, terrene stërvitje për futbollin, basketbollin etj.;
- Vendosja e laboratorëve dhe shërbimeve veterinare për inspektimin, kontrollin dhe mbrojtjen e shëndetit;
- Lokalizimi i infrastrukturave, magazinimi me pajisje teknologjike për ngarkim-shkarkim për të përmirësuar zinxhirin e furnizimit duke mundësuar dorëzimin, paketimin dhe ndarjen për llogari të ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM) dhe

aktiviteteve tregtare në zonën urbane nëpërmjet automjeteve ekologjike (elektrike) për shpërndarje;

- Vendosja e magazinave të specializuara për furnizimin zinxhir të produkteve blegtorale, bujqësore dhe të ushqimeve;
- Vendosja e një ambienti të tregut me shumicë dhe pakicë i aksesueshëm lehtësisht nga të gjitha zonat dhe me të gjitha kushtet bashkëkohore (përfshirë hapësira për panaire) për çdo produkt blegtoral, bujqësor, ushqimorë, artizanal etj.;
- Ristrukturimi i zonës së braktisur të uzinës së përpunimit të naftës në një park të integruar industrial komercial për manufakturimin dhe NVM-të tregtare ku mund të integrohen edhe zona banimi për banesat sociale;
- Mbështetja e zhvillimit të NVN-ve dhe aktiviteteve të artizanatit që lidhen me sektorin e ikonave, suvenireve etj.;
- Lehtësi për vendosjen e bankave, shërbimeve financiare dhe profesionale;
- Lokalizimi dhe promovimi i projektimit të një zone industriale ekologjikisht të përshtatshme dhe miqësore me mjedisin;
- Promovimi i mbledhjes, grumbullimit dhe përpunimit të bimëve mjekësore;
- Ringritja e shkollave profesionale në fushën e naftës, bujqësisë, blegtorisë;
- Krijimi i Shkollës së Aeronautikës;
- Ngritja e laboratorëve kërkimorë shkencorë për naftën, produktet dhe nënproduktet e saj, bimët mjekësore, produktet bujqësore dhe blegtorale;
- Krijimi i Muzeut të Naftës;
- Krijimi i Muzeut të Aeronautikës;
- Krijimi i një parku industrial duke integruar me të shërbimet tregtare dhe shkolla të larta profesionale;
- Mbështetja për krijimin e një qendre agro-industriale për përpunimin, përgatitjen në shkallë rrethi të prodhimeve si produkte bujqësore dhe blegtorale;
- Shtimi i prodhimeve artizanale dhe gamës së tyre nga subjektet tregtare në fushat e prodhimit të ikonave, qëndistarisë etj.;
- Ngritja e funksionimi i kurseve në fushat e rrobaqepësisë, qëndistarisë, floktoreve etj.;
- Përmirësimi i rrjetit rrugor nëpërmjet propozimit për ndërtimin e unazës së qytetit;
- Propozimi për shtrirjen e linjës hekurudhore për pasagjerë dhe mallra;
- Përdorimi i zonave ish-industriale si park multimodal;
- Nxitja dhe mbështetja e përdorimit më efikas të transportit publik në zonat ndërqytetëse;
- Krijimi i sinjalistikës së plotë horizontale dhe vertikale në qytet;
- Ndërtimi i një terminali për autobusët ndërqytetës;
- Shtimi i numrit të parkimeve duke parashikuar në akset e reja rrugore me korsi të posaçme edhe sheshe parkimi në qytet;
- Integrimi i transportit publik në zonat me zhvillime të reja urbane duke parashikuar një hartë të re të shtrirjes së këtij shërbimi në qytet;
- Përmirësimi i nivelit të shërbimit të transportit publik duke e kaluar nga një shërbim i ofruar nga bashkia në një shërbim të menaxhuar nga sipërmarrës privatë i cili do të garantojë cilësi dhe nivel më të lartë shërbimi (dhe do të ulë kostot që sot mbart pushteti lokal përkundrejt këtij shërbimi).

1.3 Pozicionimi strategjik dhe pikat e forta në territor


1.3.1 Pozicioni gjeografik

Bashkia Kuçovë është pjesë e qarkut të Beratit dhe shtrihet në pjesën lindore të Ultësirës Perëndimore, e kufizuar në veri dhe veriperëndim nga zona e Sulovës dhe lumi Devoll e në jug e jugperëndim nga rrjedha e poshtme e lumit Osum. Me një sipërfaqe prej 160.22 km^2, territori i Kuçovës së sotme e tejkalon atë të rrethit të Kuçovës duke përfshirë nën juridiksionin e saj edhe njësinë administrative Lumas, krahas njësive Kuçovë (qendër), Perondi e Kozarë. Nga pikëpamja administrative, Kuçova kufizohet me bashkitë e Lushnjes, Belshit, Cërrikut, Gramshit, Beratit dhe Urës Vajgurore.

Bashkia e Kuçovës, nga pikëpamja e lidhshmërisë kombëtare, ndodhet ndërmjet Lushnjës dhe Beratit, të cilat lidhen ndërmjet tyre me rrugën shtetërore SH 72. Kuçova krijon një lidhje tërthore me këtë rrugë kombëtare nëpërmjet rrugës SH 91 dhe komunikon drejtpërdrejt me Urën Vajgurore në pjesën hyrëse të saj. Ndërkaq, rrugë të tjera të karakterit lokal e lidhin me Lushnjën nëpërmjet Fier-Sheganit, si dhe me Grekanin nëpërmjet Gegës, Frashërit etj. Shtigjet dhe rrugët tretësore plotësojnë lidhshmërinë rajonale nga Lumasi në Gramsh, në Gostimë, nga Kozarja në Grekan, nga Vodëza në Berat etj. Distancat[22] nga qyteti i Kuçovës në disa qendra të rëndësishme janë si më poshtë:

- 16 km nga qyteti i Beratit,
- 95 km nga Elbasani,
- 30 km nga Lushnja,
- 42 km nga Fieri,
- 75 km nga porti i Vlorës,
- 81.3 km nga porti i Durrësit,
- 86 km nga Tirana,
- 104 km nga aeroporti i Rinasit.

Figura 17. Pozicioni gjeografik



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

1.3.2 Elementet e forta në territor

Territori përbëhet nga shumë pjesë të ndryshme të cilat ushtrojnë ndikim te njëri-tjetri. Pjesët apo elementet të cilat ndikojnë më shumë apo kanë veçori më spikatëse mund të konsiderohen si elemente të forta në territor. Këto elemente mund të ndikojnë në formimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të vendbanimeve. Ato mund të shfaqen në forma apo situata që favorizojnë, por edhe kundërshtojnë/ pengojnë zhvillimin, duke realizuar kështu ndikimin e tyre në territor. Shtrirja e tyre fizike dhe ndikimi i tyre në territor mund të jetë pikësor/ qendror, por edhe sipërfaqësor në formën e fashave të ndikimit. Elemente të tilla mund të jenë natyrore, por edhe të krijuara artificialisht nga njeriu. Bashka e Kuçovës ka një sërë pikash që janë të forta.


Elementet e forta natyrore në bashki kanë të bëjnë me topografinë dhe pasuritë e shumta ujore. Ato janë:

1. Relievi kodrinor: arrin lartësitë më të mëdha me Majën e Gorrezit me 445 m. Terreni kodrinor paraqitet me variacion me kreshta dhe lugina ku kalojnë edhe lumenj e përrenj. Pamja e kodrave dominon në siluetën e kësaj bashkie.
2. Pasuria ujore: Lumi Devoll dhe pjesa tjetër e sipërfaqes ujore në këtë bashki paraqesin interes për mënyrën si kanë ndikuar në zhvillimin e territorit dhe aktiviteteve të ndryshme, por edhe për potencialin që paraqesin në të ardhmen. Gjithashtu, për t'u përmendur në pasuritë ujore është edhe lumi Osum, i cili kalon përgjatë kufirit të bashkisë. Në afërsi të bashkimit të dy lumenjve Devoll e Osum, të cilët krijojnë lumin Seman, kemi edhe rezervuarin e Thanës, i cili, pavarësisht se nuk është brenda kufijve administrativë të bashkisë, përbën një element me rëndësi në territor.
3. Kanionet e Sinecit: Këto kanione ndodhen jashtë kufirit administrativ, në afërsi të fshatit Lumas. Ky kanion paraqet një interes të madh si destinacion i veçantë për vizitorë të ndryshëm. Po në këtë kanion ndodhet edhe një shpellë interesante për speleologët. Gërryerjet kanë krijuar forma nga më të çuditshmet me një bukuri të rrallë.
4. Monumentet natyrore: Vendburimi i naftës ëahtë një monument natyror i cili ka ndikuar në zhvillimin e bashkisë. Prania e tij ka mundësuar zhvillimin e një industrie për një kohë mjaft të gjatë. Ndërtimi i uzinës së përpunimit të naftës dekada më parë në Kuçovë, në një nga zonat më të pasura naftëmbajtëse, bëri që në të të punësohen 560 punëtorë dhe specialistë. Njëkohësisht, nënproduktet nga përpunimi i naftës si vajguri, nafta, vajrat speciale, bitumi etj. ishin burim i rëndësishëm për plotësimin e nevojave në vend dhe sigurimin e të ardhurave për ekonominë e vendit. Madje, për kontrollin e këtyre nënprodukteve u ndërtua dhe laboratori me parametra bashkëkohore, i cili shërbente për të kryer të gjitha analizat e në veçanti të vajgurit që përdorej për avionët luftarakë. Specialistët shprehen se kjo ishte një nga uzinat më moderne jo vetëm në vend, por edhe në Ballkan. Pas vitit 1990 filloi ndërprerja e prodhimit dhe shkurtimi i fuqisë punëtore. Në trazirat e vitit 1997 filluan shkatërrimet dhe grabitjet e pasurisë së saj. U arrit deri atje sa të shembeshin muret e objekteve dhe të merreshin tullat. Megjithatë, nga ana tjetër, kjo pikë e fortë ka ndikuar edhe negativisht në territor duke shkaktuar ndotje.

Elementet artificiale janë po aq të rëndësishme në mënyrën e ndikimit në territor, sa edhe elementet natyrore. Ato janë krijuar nga veprimtaria njerëzore dhe mbartin edhe pjesën e identitetit kulturor dhe historik të zonës. Ndër to përmendim:

- Aeroporti: Reparti Ushtarak [23]3362 Kuçovë mbante emrin Reparti "23 Peza". Ai u krijua si formacion i parë i madh luftarak i Forcave Ajrore për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë. Bërthama e parë e këtij regjimenti u krijua me vendim të posaçëm ku u morën masa për përgatitjen e efektivit pilot e teknik për teknikën e re reaktive me të cilën do të pajisej reparti. Krahas këtyre, u morën masa për përgatitjen e ambienteve për pritjen e efektivit dhe teknikës. Pas përfundimit të përgatitjes së efektivit pilot e inxhiniero-teknik, regjimenti mori formën e plotë, i gatshëm për kryerjen e detyrave. 15 maj 1955 është dita e krijimit të regjimentit.
- Monumente kulture: Kisha e Shën Kollit në Perondi. Ndërtimi i takon shek. X dhe është një shprehje tipike e arkitekturës bizantine të veprave të kultit, ku në muraturë kombinohet guri me terrakotën dhe ku volumet modeste kompensohen me pasurinë e elementeve arkitekturore. Pikërisht në skajin e kundërt, në veri-perëndim të qytetit, por këtë radhë diçka më larg se kisha e parë, pra rreth 6 km, në vendin e quajtur Salc-Kozarë ndodhet një kishë tjetër e denjë për të qenë objekt admirimi për vizitorët. I takon një kohe më të vonshme, por është, gjithashtu, një shembull i shkëlqyer i arkitekturës së shek. XVII, i kishës me hajat të jashtëm dhe me një navatë të bollshme, në krye të së cilës është edhe ikonostasi prej druri, vepër e shquar e mjeshtërve shqiptarë të kohës.
- Zona ekonomike
- Serat: Njësitë administrative Kozarë e Perondi dallohen për tokën bujqësore të bonitetit të lartë dhe kultivimin e drithërave e perimeve dhe njësia Lumas ka një potencial të theksuar frutikulture dhe blegtoral. Kjo larmi veprimtarish ekonomike është pika e fortë dhe njëkohësisht sfida më e madhe me të cilën përballet Bashkia Kuçovë pas reformës administrativo-territoriale.

Figura 18. Elementet e fortë në territor



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

1.4 Analiza e mjedisit dhe e problemeve mjedisore

1.4.1 Metabolizmi i territorit

Analiza e metabolizmit trajton flukset në territor/qytet urban. Flukset analizohen nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve për secilin fluks që merret në studim. Ato krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë.

Në këtë rast, flukset që do të merren në analizë janë: fluksi i energjisë, fluksi i ujit, fluksi i ushqimit dhe fluksi i mbetjeve. Fluksi i energjisë dhe fluksi i ujit do të analizohen si fillim në nivel rajoni dhe më pas në nivel bashkie. Burimet e energjisë kanë ndikim dhe menaxhohen në rang kombëtar, pavarësisht territorit ku ndodhen. Uji që gjendet në një sistem urban (uji që analizon fluksi i ujit) vjen nëpërmjet burimeve nëntokësore (që nuk i përkasin territorit të një bashkie nga ana administrative) apo burimeve sipërfaqësore, duke kaluar në disa sisteme të ndryshme territoriale. Në këtë rast, lumi sjell me vete edhe ndotjet që merr gjatë rrugës. Prandaj, burimet ujore menaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar.


- Fluksi i energjisë në vështrim rajonal

Rajoni që përbëhet nga bashkitë: Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Lushnjë, Peqin, Belsh, Cërrik, Patos, Mallakastër, Ura Vajgurore, Kuçovë, Berat, Gramsh, Elbasan, Përrenjas, Librazhd, Pogradec[24] ka burime të shumta energjie. Pjesa kryesore e energjisë që përftohet nga hidrokarburet në Shqipëri është e përqendruar në këtë zonë. Kompanitë që operojnë në këtë territor për nxjerrjen e naftës janë: *Bankers* (Patos-Marinëz), *TransAtlantic* (Ballsh, Cakran, Gorisht, Delvinë), *Sherwood* (Kuçovë), *Transoil Group* (Visokë), *Phoenix* (Amonicë). Energjia e hidrokarbureve zë pjesë të rëndësishme. Energjia hidrike, gjithashtu, vazhdon të mbetet një nga burimet kryesore të energjisë.

Lumenjtë si Shkumbini, Osumi, Devolli përdoren për prodhimin e energjisë hidrike nëpërmjet hidrocentraleve të instaluar dhe atyre që po ndërtohen. Energjia hidrike vazhdon të mbetet burimi kryesor e energjisë për konsumatorët familjarë, por edhe për bizneset, industritë apo institucionet.

Burimet alternative të energjisë si dielli, era, energjia gjeotermale shfrytëzohen shumë pak. Potencialet që ekzistojnë për t'i përdorur këto energji janë të mëdha. Energjia e erës ka potencial të përdoret për prodhimin e energjisë në Ultësirën Perëndimore, Divjakë, Rrogozhinë dhe Fier (zona veri-perëndimore).

Figura 19. Harta e fluksit të energjisë në rajon



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


Energjia diellore është potencial thuajse në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë, pasi rrezatimi arrin vlera nga 1,450 kwh/m² deri në 1,650 kwh/m² [25]. Numri i madh i ditëve me diell është i favorshëm për prodhimin e energjisë diellore.

Energjia gjeotermale mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Në Elbasan gjenden burime gjeotermale, temperatura e të cilave arrin >80 °C. Gjithashtu, në Fier mund të përdoren puset gjeotermale për prodhimin e energjisë.

- Fluksi i ujit në vështrim rajonal

Rajoni në studim është i pasur më ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky territor përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Shkumbini, Semani, Devolli, Osumi, Vjosa dhe lumenj më të vegjël. Pasuritë e mëdha ujore bëjnë që shfrytëzimi i tyre të jetë i lartë. Në këtë zonë është propozuar të ndërtohet pjesa më e madhe e HEC-eve.

Figura 20. Fluksi i ujit (ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore) në rajon



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, akuiferet ndërkokrrizore me ujëpërcjellshmëri të lartë dhe shumë të lartë, të cilat dallohen për një cilësi të lartë të ujërave nëntokësore, gjenden kryesisht në pjesën verilindore të këtij territori. Këto shtresa shfrytëzohen nëpërmjet burimeve për ujë të pijshëm apo përdorime të tjera. Shtresat nëntokësore, akuifere me porozitet karst-çarje me ujëpërcjellshmëri shumë të ndryshueshme (shumë të lartë, të lartë) gjenden në zona të zhvilluara si qyteti i Elbasanit, qyteti i Kuçovës (zona urbane) dhe pjesa jugperëndimore të Bashkisë Fier. Këto shtresa nëntokësore kanë një nivel më të ulët filtrimi, ndaj dhe mundësia për të përthithur ndotjen në zonat e zhvilluara është më e lartë. Puset e përqendruara kryesisht në akuiferet karst-çarje ndikojnë në përçimin e ndotjes në shtresat nëntokësore.

- Analiza e metabolizmit të territorit të bashkisë Kuçovë

Analiza e metabolizmit të territorit në bashkinë e Kuçovës merr në konsideratë disa faktorë kryesorë që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Kuçova ka një sipërfaqe prej 161 m² dhe popullsi 31,424 banorë. Për të analizuar flukset në territorin e kësaj bashkie duhet të kemi të qarta hyrjet dhe daljet për secilin fluks.

- Fluksi i energjisë

Fluksi i energjisë tregon sasinë e prodhuar dhe konsumin e energjisë në territorin e bashkisë Kuçovë. Ky fluks tregon edhe për energjinë potenciale që mund të përdoret, duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat janë të mbishfrytëzuara.

Në territorin e bashkisë Kuçovë janë instaluar dy hidrocentrale në rezervuarin e Belesovës.

Tabela 1. Sasia e energjisë së prodhuar në territorin e qarkut Berat 2011

Bashkia	NA	Pellgu	Lumi/Përroi	Hec-i	Shoqëria koncesionare	Fuqia	Energjia	Viti i lidhjes së kontratës
Skrapar	Çorovodë	Osum	Burimet e Guakut	Çorovodë	"Emikel"	575	3,138,336	Ekzistues
Skrapar	Bogovë	Osum	P. Boronecit	Boronec	"Eonder" sh.a.	500	1,800,000	në proces
Skrapar	Bogovë	Osum	Burimet e Bogovës	Bogovë	"Eonder" sh.a.	1500	5,600,000	ekzistues
Skrapar	Gjerbës	Devoll	Burimet e fshatit Ujanik	Ujanik	"Essegei"	400	1,500,000	ekzistues
Skrapar	Çorovodë	Osum	L. Vlushës	Vlushë	Aurora Konstr" sh.p.k	14200	65,000,000	2008
Kuçovë	Lumas	Osum	Rezervuari i Belesovës	Belesova 1	"Belesova 1" sh.p.k.	160	720,000	2009
Kuçovë	Lumas	Osum		Belesova 2	"Belesova 1" sh.p.k.	280	1,260,000	2009
Skrapar	Leleshnjë	Osum	P. Faqekuqit, P. Kapinovës	Faqekuq 1	Bashkim i përkohshëm i shoqërive "Busa" sh.p.k "IRZ" sh.p.k	2500	11,566,261	2009
Skrapar		Osum	L. Kapinovës, L. Vlushës	Faqekuq 2	Bashkim i përkohshëm i shoqërive "Busa" sh.p.k "IRZ" sh.p.k	3900	18,573,044	2009
Skrapar	Bogovë	Osum	P. Nishovës	Nishova 1	"Nishova" sh.p.k	550	3,144,390	2009
Skrapar		Osum		Nishova 2	"Nishova" sh.p.k	560	3,439,825	2009
Poliçan	Vërtop	Osum	P. Vërtop	Vertop	"Salillari" sh.p.k	1500	5,300,000	2009
Skrapar		Devoll	P. Ujanik	Ujanik 2	"HP Ujaniku Energy" sh.p.k.	2550	11,893,885	2011
Skrapar		Osum	P. Baçkës	Hidrocentrali A	"Alba Construction" sh.p.k	1400	5,118,000	2012
Skrapar		Osum	P. Staraveçkës	Hidrocentrali B	"Alba Construction" sh.p.k	1600	7,797,000	2012
Skrapar		Osum	P. Baçkës	Hidrocentrali C	"Alba Construction" sh.p.k	1420	5,859,000	2012
Skrapar		Osum	P. Baçkës	Hidrocentrali I	"Alba Construction" sh.p.k	2000	8,051,000	2012
Skrapar		Osum	P. Baçkës	Hidrocentrali 2	"Alba Construction" sh.p.k	1200	5,372,000	2012
Skrapar		Osum	L. Vokopolës	Vokopola 1	"Vokopola Energji" sh.p.k	274	905,617.00	2013
Skrapar		Osum	L. Vokopolës	Vokopola 2	"Vokopola Energji" sh.p.k	3104	11,426,748	2013
Skrapar		Osum	L. Vokopolës	Vokopola 3	"Vokopola Energji" shpk	2297	8,460,234	2013
Skrapar	Fshati Shtyllë	Osum	P. Gostivishtit	Guri i Kuq 1/1	"L&G ENERGY" sh.p.k	700	2,940,000	2013

Skrapar	Fshati Shtyllë	Osum	P. Kolloveshit	Guri i Kuq 1/2	"L&G ENERGY" sh.p.k	1400	5,640,000	2013
Berat		Osum	P. Bigas	Bigas 1	"Hp Bigas & Veleshnjë Energy" shpk	600	3,161,000	2013
Berat		Osum	P. Bigas	Bigas 2	"Hp Bigas &Veleshnjë Energy" shpk	300	1,500,000	2013
Skrapar		Osum	P. Veleshnjë	Veleshnjë	"Hp Bigas dhe Veleshnjë Energy" shpk	300	1,556,260	2013
Skrapar		Osum	P. Prishtës & Rahovicës	Prishta 1	"HP Prishta 1&2 Energy" shpk	800	3,621,066	2013
Skrapar		Osum	Përr. e Prishtës & Rahovices	Prishta 2	"HP Prishta 1&2 Energy" shpk	1200	5,458,500	2013
Skrapar		Devoll	P. Gurrës & P. Hijës	Dobrenjë	"DAAB Energy Group" shpk	2400	7,479,080	2013
Skrapar		Devoll	P. Zaloshnjës	Bregu i Madh	"HP Zaloshnja Energy" sh.p.k	1100	4,165,602	
Skrapar		Osum	P. Vedresh	Vendresh	"Vendresha" shpk	800	2,879,868	2013

Burimi: AKBN, 2015

Nga Ultësira Pranëadriatike në zonën Joniane dhe më tej duke u shtrirë në territorin nga Durrësi e deri në Vrug, nga Semani e deri në Kuçovë, ka puse që kanë nxjerrë si shatërvan ujë gjeotermal dhe mund të riaktivizohen sërish për të marrë ujë të nxehtë. Po ashtu, në zonën e Kuçovës ka shumë puse të thella të naftës dhe të gazit, të cilët mund të kenë shtresa kolektore me ujë me temperaturë të lartë. Këto puse mund të shërbejnë si burime vertikale nxehtësie. (Frashëri A. et al., 2003).[26]

Një tjetër burim alternative energjie që ka potencial për t'u përdorur në territorin e Kuçovës është energjia diellore. Kuçova ndodhet ndërmjet izolinjave 1,450-1,500 kw/m² në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin global në stacionin meteorologjik të Kuçovës luhatet nga 1,656 në muajin dhjetor deri në 6,818 në muajin korrik. [27] Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1% për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me panele fotovoltaike.[28]

- Konsumi i energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur për ngrohje

Energjia elektrike është një nga burimet parësore të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km² në të gjithë territorin e bashkisë Kuçovë[29] dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2011 është 2,587,907 MWh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit.

Për vitin 2011, sipas INSTAT-it, numri mesatar i personave në një familje është 4 anëtarë. Numri total i familjeve në Shqipëri, duke marrë parasysh që një familje përbëhet nga 4 anëtarë, rezulton të jetë: 2,821,977/4 = 705,494.25 familje. Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në një vit është: Konsumi i energjisë elektrike nga familjet (2,587,535)/nr. i familjeve (705,494.25) = Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit (3.6 MWh). Për të llogaritur energjinë e konsumuar për çdo km², shumëzojmë

numrin e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë elektrike.

Tabela 2. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe banesave 2011

Popullsia banuese gjithsej	**2 821 977**
Popullsia banuese gjithsej e numëruar	2 800 138
Meshkuj	1 403 059
Femra	1 397079
Urbane	1 498 508
Rurale	1 301 630
Njësitë ekonomike familjare	2 784 539
Njësitë kolektive familjare	15 599
Numri gjithsej i njësive ekonomike familjare	722 600
Njësitë ekonomike familjare	723 262
Njësitë kolektive familjare	338


Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

Tabela 3. Bilanci i energjisë elektrike, 2011

Emërtimi	**2011**
Energji në dispozicion (Burimet)	7,532,055
Prodhimi neto vendas	4,057,089
Termocentrale	0
Hidrocentrale	4,057,089
Importi bruto (energji në marrje)	3,474,966
Eksporti bruto (energji në dhënie)	300,544
Konsumi i energjisë elektrike	7,210,731
Humbjet në rrjet	2,179,157
Familjet	2,587,907
Të tjera	2,443,667

Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

Figura 21. Fluksi i energjisë (prodhimi dhe konsumi)



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT-it, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në qarkun e Beratit nga NjEF[30] vazhdon të jetë energjia e përftuar nga drutë e zjarrit. 51.87% të NjEF-ve në qarkun Berat përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (23.44%) dhe më pas nga energjia elektrike (12.71%)[31]

Tabela 4. Njësitë ekonomike familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale në qarkun e Beratit

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	38,493	19,023	19,470
Dru	23,655	6,824	16,831
Energji elektrike nga rrjeti	3,183	2,918	265
Gaz	9,016	7,146	1,870
Lloj tjetër energjie(panel diellor, qymyr, naftë etj.)	110	69	41
Pa ngrohje	2,529	2,066	463

Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

Figura 22. Njësitë ekonomike familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale në qarkun e Beratit



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


- Fluksi i ujit

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit nga burime sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e bashkisë Kuçovë dhe sasinë e konsumit të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, *imbotilim*[32] *(mbushje e shisheve me ujë)*, shpërndarje nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit dhe përdorim nga banorët, bizneset, industritë, institucionet etj. Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në këtë rast, territorin e bashkisë Kuçovë) mund të marrim sasinë totale të ujërave në territor (burime sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia e ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor[33].

Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 12.5 km² në të gjithë territorin e bashkisë Kuçovë. Në ujërat sipërfaqësore të Kuçovës bëjnë pjesë lumi Osum, lumi Devoll, rezervuari i Murriqanit, rezervuari i Belesovës, përrenjtë dhe degëzimet të tjera të lumenjve kryesorë si dhe të gjitha kanalet ujitëse.

Sa i përket përdorimit të ujërave nëntokësore, ato furnizojnë akuiferet me porozitet çarje-karst dhe ujëpërcjellshmëri të ndryshueshme shumë të lartë - të lartë përgjatë lumit Osum, duke kaluar në zonë me puse të shumta nafte. Sasia e ujit që shfrytëzohet nga burimet ujore është nga 2 l/sek (Harta hidrografike, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar - SHGJSH)[34]. Këto ujëra nëntokësore përdoren për pirje, për t'u shpërndarë në sistemin e ujësjellësit, për qëllime teknologjike etj.

Figura 23. Fluksi i ujit (konsumi i ujit të pijshëm, zonat e mbulimit me shërbimin e ujësjellësit)



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Për të kuptuar përdorimin e ujit nga qytetarët dhe bizneset, i referohemi studimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit të ujërave të zeza. Nga të dhënat e marra nga Bashkia Kuçovë, Ndërmarrja e Ujësjellës-kanalizimeve UK Kuçovë, territori i bashkisë ka mbulim të mirë me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve. UK Kuçovë e ofron shërbimin në bashkinë e Kuçovës dhe njësitë administrative Perondi dhe Kozare, ndërsa njësia administrative Lumas është e pambuluar me shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm UK Kuçovë furnizohet me ujë nga burimi i Bogovës dhe puset e Fushës së Devollit të cilat furnizojnë me ujë fshatrat Tapi, Drizë, Goraj, Velagoshit, Gegë dhe Polovinë. Sasia e ujërave që shfrytëzohet nga burimi i Bogovës është mesatarisht 2000 l/sek në periudhën e dimrit deri në 350 l/sek në periudhën e verës. Sasia totale (burimi i Bogovës dhe puset e Devollit) mesatare e ujit që shfrytëzohet nga Ndërmarrja e Ujësjellës-kanalizimeve në bashkinë Kuçovë është 602.5 l/sek.

Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat e UK-së Kuçovë dhe në të dhënat e INSTAT-it, Censusi 2011 (Grid), për popullsinë dhe numrin e banorëve për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Kuçovë. Konsumi mesatar ditor i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë banorë është 100 l/banorë/ditë.[35]

- Fluksi i ushqimit

Fluksi i ushqimit analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Kuçovë do të analizojmë të dhënat për produktet bujqësore dhe blegtorale që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe është më e rëndësishme të analizohen në nivel kombëtar, ndërsa në këtë rast mund të përqendrohemi më tepër tek të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale, si dhe infrastrukturat ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre

produkteve, sasia e produkteve që shkon në treg dhe sasia e produkteve që shkon për eksport.

Figura 24. Fluksi i ushqimit, prodhimet dhe konsumi (treg e eksport) për qarkun e Beratit



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Sipërfaqja e tokave bujqësore në territorin e bashkisë Kuçovë është 84 km^2, pjesa më e madhe e së cilës zihet me bimësi natyrore 36,57 km^2 dhe nga tokë arë e kultivuar me lloje të ndryshme kulturash bujqësore 26,11 km^2.[36]

Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat e INSTAT-it (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të Ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet.

Tabela 5. Prodhimtaria bujqësore e blegtorale në bashkinë e Kuçovës


Përbërës Niveli I		Nënzërat	Treguesit Prodhim	Njësia hapësinore
Prodhim bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	8010	Perondi, Kozarë, Lumas
		Perime (ton)	14135	Perondi, Kozarë, Lumas
		***Patate (ton)**	900	Perondi, Kozarë
		*Fasule (ton)	168	Perondi, Kozarë
		*Bimë industriale (ton)	2	Perondi, Kozarë
		Foragjere (ton)	97130	Perondi, Kozarë, Lumas
	Prodhime në serra	Perime (ton)	5980	Perondi, Kozarë, Lumas
	Dru frutorë	Pemë frutore (ton)	4011	Perondi, Kozarë, Lumas
		Ullinj (ton)	2670	Perondi, Kozarë, Lumas
		*Agrume (ton)	590	Perondi, Kozarë
		Rrush gjithsej (ton)	2120	Perondi, Kozarë, Lumas
Prodhimi blegtoral		Qumësht (ton)	12348	Perondi, Kozarë, Lumas
		Mish (të leshta, të dhirta, derri, shpendi) (ton)	**17321**	Perondi, Kozarë, Lumas

		Lesh (ton)	47	Perondi, Kozarë, Lumas
		Vezë (kokrra)	9861000	Perondi, Kozarë, Lumas
		Mjaltë (ton)	25	Kuçovë (vetëm Perondi & Kozarë)

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Berat[37], 2015


*-*Këta zëra i përkasin të dhënave të vitit 2014 ku nuk përfshihet NjA Lumas*

Figura 25. Fluksi i prodhimeve bujqësore në bashkinë e Kuçovës



Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Berat, 2015; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Figura 26. Fluksi i prodhimeve blegtorale në bashkinë e Kuçovës



Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Berat, 2015; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


Tabela 6. Prodhimet dhe konsumi (treg dhe eksport) për qarkun e Beratit

			HYRJE	POTENCIALET PRODHUESE	
Përbërës I		**Përbërës II**	**Prodhim**	**Treg**	**Eksport**
Prodhim bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	49,354		
		Perime (ton)	90,408	36,036	22,900
		Patate (ton)	6,363		
		Fasule (ton)	1,307		
		Bimë industriale (ton)	81		
		Foragjere (ton)	82,709		
	Prodhime në serra	Perime (ton)	18,386	146,140	98,060

	Dru frutorë	Pemë frutore (ton)	22,295	33,130	800
		Ullinj (ton)	23,082	66,146	-
		Agrume (ton)	1,884	737	-
		Rrush gjithsej (ton)	26,460	6,150	-
Prodhim blegtoral	**Prodhim blegtoral**	Qumësht (ton)	65,244	67,358	-
		Mish (gjedhi, derri, shpendësh, ruminantësh të vegjël) (ton)	10,500	20,493	-
		Lesh (ton)	289		
		Vezë (kokrra)	73,658,000	40,000,000	-
		Mjaltë (ton)	177	863	-

Burimi: INSTAT, 2011, MBZHRAU, 2014

Figura 27. Fluksi i bujqësisë, qarku Berat, 2014



Burimi: INSTAT, 2011, MBZHRAU, 2014
Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Fluksi i mbetjeve

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (bashkia e Kuçovës para ndarjes territoriale). Vend-depozitimi i mbetjeve në Kuçovës është josanitar, ndodhet në fshatin Tapi pranë shtratit të lumit Devoll, 1 km larg vendbanimeve dhe 4 km larg burimeve ujore. Toka në këtë zonë ka shumë aluvione, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në infiltrimin e lëndëve ndotëse nga mbetjet në tokë dhe në ujërat nëntokësore.[38] Diferencimi i mbetjeve në burim nuk kryhet dhe rezulton në mungesë të riciklimit apo përpunimit të mbetjeve. Tregues i mungesës së diferencimit të mbetjeve është edhe niveli i lartë i mbetjeve që importohen për t'u ricikluar nga kompanitë e riciklimit të vendosura në Shqipëri. Në vitin 2013 në Shqipëri janë importuar 207,690 ton mbetje dhe janë eksportuar vetëm 30,704 ton mbetje, nga të cilat 35,055 ton janë mbetje të riciklueshme[39].

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e bashkisë së Kuçovës jemi mbështetur sërish në rrjetin e INSTAT-it për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.6 kg[40]. Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara, siç është qyteti i Beratit.

Riciklimi i mbetjeve bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, HD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e bashkisë Kuçovë është 76%, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 51.7%, 13% letra dhe 11% plastika. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj që ky proces të realizohet. [41]

Figura 28. Fluksi i mbetjeve në bashkinë e Kuçovës



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

1.4.2 Mjedisi

- **Njësitë gjeomorfologjike të territorit**

Morfologjikisht , rajoni i Kuçovës përbëhet kryesisht nga terrene kodrinore dhe fushore[42]. Njësia morfologjike fushore zë një pjesë të kufizuar të territorit dhe shtrihet kryesisht gjatë luginës së lumenjve Devoll në veri dhe Osum në jug, si dhe luginave të përrenjve të veçantë si Lumi i Lapardhasë që rrjedhin nga kodrat drejt lumenjve nëpërmjet sistemit të veprave hidroteknike.

Nënnjësia fushore në këtë qark është e tipit paramalore me origjinë aluviale. Fushat janë nga të sheshta deri me pjerrësi 30. Kuotat e tyre jane të ndryshme, nga 70-80 m mbi nivelin e detit (zona ku bashkohen lumenjtë Osum e Devoll). Këto fusha përshkohen nga një rrjet i dendur kanalesh kulluese e vaditëse, si dhe nga përrenj fushorë të cilët derdhen në shtretërit e lumenjve. Drejtimi i rrjedhjes së lumit Devoll është lindje-perëndim, në pjesën para se të bashkohet me lumin Osum. Të dy lumenjtë Devoll dhe Osum, gjatë shirave të rrëmbyeshme (plotave) dalin nga shtretërit e tyre duke përmbytur tokat bujqësore përreth. Lugina e lumit Devoll dallohet për shpate shumë të vogla ose të ulëta duke favorizuar

përmbytjen. Depozitimet aluviale përfaqësohen kryesisht nga suargjila bezhë në kafe e gri të errët, me lagështi plastike deri pak të ngjeshura. Në rajonet pranë shtretërve të rrjedhjeve ujore shpesh përfaqësohen nga surëra, rëra deri zhavorre kokrrizë mesëm, me fraksione e breza rërash të imta dhe suargjila të ngopura me ujë e mesatarisht të ngjeshura

Njësia morfologjike kodrinore zhvillohet në pjesën më të madhe të territorit të Qarkut Berat. Në Kuçovë shtrihet kryesisht në NjA-në Lumas. Kodrat kanë kuota nga 100 mbi nivelin e detit deri në 700 m. Në vartësi të strukturave gjeologjike ku ato gjenden, shfaqen edhe forma relievi tipike, si p.sh. relievet kodrinore të strukturave monoklinale dhe relievet kodrinore të strukturave të rrudhosura të cilat janë dominuese. Rajon ku shfaqen format morfologjike të strukturave monoklinale, jo shumë të dallueshme, është brezi i kodrave nga Kuçi-Cukala-Allambras e më në jug[43].

- **Zonimi gjeoteknik i Shqipërisë**

Relievi i larmishëm i vendit tonë me njësi fushore, kodrinore dhe malore krijon një peizazh natyror tërheqës dhe njëkohësisht, edhe të prirur ndaj rreziqeve natyrore për vetë përbërjen e tij. Si rezultat, në varësi të relievit, territori në vend dallohet për nivele të ndryshme qëndrueshmërie. Përveç një sipërfaqeje që zë rreth 10% të territorit kombëtar që është e qëndrueshme, pjesa tjetër e tokës është e paqëndrueshme. Kjo e fundit shprehet nëpërmjet formave të ndryshme që SHGJSH-ja i ka klasifikuar si më poshtë[44]:

- *Rënie shkëmbinjsh* (kryesisht në zona malore (në Alpeve) dhe shpate gëlqerore të zbuluara;
- *Shembje* (kryesisht në zonat malore);
- *Rrëshqitje me rrokullisje* (në shpate me shkëmbinjëve rreshporë ose molasës deltinore dhe shpatet prej konglomerati me pjerrësi > 45°dhe shpateve me drejtim të kundërt);
- *Rrëshqitje me zhvendosje* (prek shkëmbinjtë e fortë gëlqerorë ose shtresa rreshpore);
- *Rrjedhje, sidomos ato sipërfaqësore, në trajtën e laharëve* (në zonat malore të Shqipërisë me reshje vjetore 200 mm, luginat me përrenj me pjerrësi të madhe (Elbasan, Përmet, Korcë etj.)

Duke u bazuar në karakteristikat e territorit lidhur me fenomenet e rrezikut gjeomorfologjik, SHGJSH-ja ka përcaktuar zonimin gjeoteknik të Shqipërisë, sipas të cilit territori i vendit tonë ndahet në tre zona të qëndrueshmërisë natyrore (figura e mëposhtme)[45]:

- *Terrene të qëndrueshme* që mbulojnë 56.6% të vendit. Gjenden kryesisht në zona me shkëmbinj magmatikë efuzivë dhe intruzivë, gëlqerorë të epokave të ndryshme, dolomite, brecke dhe konglomerate me cimentin karbonatik, shkëmbinj metamorfikë dhe rreshpe. Brenda zonës njihen fenomenet e shkëputjes së blloqeve, rrëshqitjes e rrokullisjes dhe/ose zhvendosjes.
- *Terrene relativisht të qëndrueshme*, që mbulojnë rreth 33.6% të territorit. Gjenden kryesisht në zona me përbërje shkëmbore konglomeratikë të suitës Luma, efuzivë sedimentarë, shkëmbinjve rreshporë, shkëmbinjëve evaporitë dhe molasave të konglomerateve ranore. Këto zona dallohen për rrëshqitje, ose rënie të tavaneve në zgavrat e nëndheshme.

Terrene të paqëndrueshme që zënë rrreth 9.8% të sipërfaqes së vendit. Këto janë terrene me përbërje të ndryshme shistesh, molasash e konglomeratësh ranore. Dallohen për rrëshqitjet rrokullisëse dhe me zhvendosje, si dhe për rrjedhjet e tokës.

Figura 29. Zonimi gjeoteknik i Shqipërisë dhe Kuçovës



Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar,[46] Punoi: Co-PLAN ; 2016

- **Rrëshqitja/rrëzimi i gurëve**[47]

Rrëshqitjet e dheut janë një fenomen tejet i përhapur në Qarkun e Beratit dhe në Bashki. Deri më sot, në rang qarku janë numëruar rreth 150 rrëshqitje. Bazuar në hartën e zonimit gjeoteknik të Shqipërisë, marrë nga Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar (SHGJSH), në pjesën malore të Qarkut të Beratit, shpatet kanë pjerrësi të madhe, mbi >30°. Për këtë arsye, në këto shpate është përhapur më së shumti fenomeni i rrëshqitjeve. Në përgjithësi, ky fenomen është më tepër i përhapur në formacionet flishore me dominim argjiloro-alevrolitik, por edhe në formacionet e molasave argjilore, kryesisht në shkëmbinjtë ku ndodh vendosja e shkëmbinjve më të fortë mbi ato më të butë. Një situatë e tillë ndodh në zonën "Kruja", "Krasta-Cukali" dhe "Mirdita"[48]. Zonat kodrinore është prekur nga fenomeni i rrëshqitjes si pasojë e procesit të tarracimit të cilit iu nënshtrua gjatë viteve '70-'80. Në pjesën fushore kemi rrjedhje në trajtën e laharëve, në kohë shirash të bollshëm. Përveç zonave me pjerrësi të lartë, fenomeni i rrëshqitjes është përhapur edhe në zonat me shpate që preken pak nga dielli si dhe në fund të shpateve, nëpër të cilat kalojnë lumenj, ose përrenj të ndryshëm duke i gërryer ato.

Për sa i përket vendndodhjes, rrëshqitjet janë përqendruar kryesisht në zonën qendrore të Bashkisë, në formacionet flishore siç është zona ndërmjet lumenjve Devoll dhe Lapardha në jug të NjA-së Lumas dhe mbi të gjitha në veri të NjA-së Perondi, kufiri administrativ ndërmjet Qytetit të Kuçovës dhe NjA-së Perondi (figura e mëposhtme).

Figura 30. Rrëshqitjet në Bashkinë Kuçovë



Burimi: SHGJSH, 2014, Punoi: Co-PLAN; 2016

Shkaqet kryesore të rrëshqitjeve [49] përfshijnë faktorë natyrorë gjeologjikë (ndërtimi gjeologjiko-klitologjik, pjerrësia e shpatit mbi 5-20°, struktura, tektonika, zona ose shpate që nuk rrihen nga dielli ku lagështira e vazhdueshme ka shkaktuar rrëshqitje etj) dhe faktorë të jashtëm (përmbajtja e lartë e ujërave nëntokësore, reshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet e njeriut me ndërtime të ndryshme etj.). Kohët e fundit, rrëshqitjet janë theksuar për shkak të shpyllëzimeve të shumta. Shpeshherë, tokat pyjore janë shndërruar në bujqësore duke prishur kështu ekuilibrin natyror.
erritori e Bashkisë, territori është kryesisht gipsor dhe molasor, relativisht i qëndrueshëm.


- **Erozioni/vatrat e erozionit**

Erozioni mbetet një ndër problematikat kryesore pothuajse në të gjithë botën dhe, sigurisht, edhe në vendin tonë. Vetëm gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XX është llogaritur se degradimi i tokës për shkak të erozionit ka përfshirë rreth 43% (ose 5 miliardë ha) të territorit në shkallë botërore[50]. Ndër shkaqet kryesore të këtij degradimi janë përdorimi i tokës nga njeriu për qëllime të ndryshme. Më konkretisht, faktorët që ndikojnë ndjeshën në rritjen e erozionit janë krysisht i) reshjet (dhe sidomos shirat e rrëmbyeshme), intensiteti dhe shpërndarja e tyre luajnë një rol të rëndësishëm, ii) përbërja e tokës/shkëmbinjve (kapaciteti i infiltrimit dhe niveli i stabilitetit të strukturës së tokës), iii) pjerrësia (gjatësia dhe niveli i pjerrësisë), si dhe iv) biměsia ose shtresat bimore që mbulojnë tokën.

Edhe në Kuçovë, erozioni ka qenë i pranishëm në territor dhe, për fat të keq, vazhdon të mbetet një ndër problematikat kryesore, kryesisht të tokës bujqësore dhe kodrinore në NjA-në Lumas. Sipas SHGJSH-së[51], ky fenomen është i përhapur në zonat me përbërje litologjike argjilore e flishore të cilat preken nga erozioni tokësor. Ky i fundit është ndihmuar në një masë shumë të madhe edhe nga shpyllëzimet e shumta që u bënë gjatë viteve '80-'90 të shekullit të kaluar si dhe gjatë këtyre viteve të fundit. Erozioni tokësor

shfaqet në formën e dy tipeve kryesore: erozion sipërfaqësor dhe erozion fundor. *Erozioni sipërfaqësor* prek kryesisht zonat kodrinore, aty ku kemi dalje të fuqishme të formacioneve litologjike flishore (*zona e Lumasit me aktivitet të theksuar në zonën juglindore të Lumasit.)*[52] *Erozioni fundor* shfaqet në *brigjet e lumenjve Devoll, Osum, Seman dhe mbi të gjitha, përgjatë gjithë brigjeve të lumit të Lapardhasë ne Lumas* ku pothuajse mungon tërësisht brezi bimor mbrojtës (zona ripariane) gjatë gjithë shtrirjes së tij në territorin e Bashkisë(figura e mëposhtme). Dega e Sinecit dhe vetë lumi Lapardha kërcënojnë vazhdimisht tokat bujqësore të fshatrave Bardhaj, Sheqës, Vodës, Pëllumbas etj. përgjatë lumit. Kjo për arsye se lumi ka karakter malor. Rrëmbyeshmëria e ujërave të këtij lumi shpeshherë është e paparishikueshme.

Figura 31. Erozioni në Bashkinë Kuçovë



Burimi: SHGJSH 2014, Punoi: Co-PLAN; 2016

Në vitet e fundit, në NjA-në Lumas, erozioni është theksuar së tepërmi për shkak të prishjes së digave/pritave në zonat kodrinore të lumit të Lapardhasë, përpara digës së Belesovës.

Figura 32. Digat e prishura përgjatë lumit të Lumbardhës në NjA-në Lumas
Prita Nr. 1 në lagjen Rrerrak në Belesovë.



Prita nr. 2 afër lagjes Rrerrak



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Shpyllëzimet e vazhdueshme dhe pa kriter gjatë viteve të fundit në territorin e Bashkisë (nga vitet 1980 e deri më sot) si dhe mungesa e praktikave të përshtatshme për manaxhimin e tokës kanë luajtur një rol parësor në shtimin e fenomenit të erozionit në territor.

Në zonat pyjore ose kullosore, erozioni ka ardhur si pasojë e keqmanaxhimit, mbishfrytëzimit të tyre, shpyllëzimeve ose dëmtimit të bimësisë së ulët (nën-pyllit). Është e rëndësishme të theksojmë se sekreti i pyjeve në mbrojtjen e tokës nga erozioni qëndron pikërisht në lënien e sipërfaqes së tokës dhe të mbulesës së saj bimore të paprekur. Kjo bën të mundur që bimësia, jo vetëm pyjet, të zhvillohet dhe të krijojë një mbulesë të të gjithë sipërfaqes. Ndryshe nga sa mendohet, nuk mjaftojnë vetëm drurët e lartë (pyjet) me rrënjët e tyre të thella që të mbrojnë pyjet nga erozioni. Është *tabani i tokës* (sipërfaqja) që mbron tokën nga erozioni. Në qoftë se sipërfaqja e tokës është e zbuluar, pikat e shiut që bien nga gjethet e pemëve të larta ushtrojnë presion të lartë mbi dherat e tokës duke e gërryer atë. Mbulesa e tokës me një shtresë bimore shërben si masë efikase për mbrojtjen e tokës nga erozioni. Për këtë arsye, bimësia e ulët nëpër pyje ka një ndikim të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Përveç shpyllëzimit e dëmtimit të bimësisë në pyje, shkak tjetër kryesor i erozionit është edhe hapja ose ndërtimi i rrugëve të reja, zhvillimi i verimtarive të ndryshme për shfrytëzimin e drurit (prerje, grumbullim, transporti me makina, shitje etj.) si dhe hapja e shtigjeve të ndryshme për aktivitetet rekreative të cilat nuk kanë munguar në vitet e fundit së bashku me rrugët për shfrytëzimin e minierave (guroreve). Hapja e rrugëve të reja në zona kodrinore pa marrë masat e duhura mund të shkaktojë humbjen e 100Mg/ha dhera të shkaktuara nga erozioni.[53]

Për sa i përket erozionit në tokat bujqësore të vendit tone, rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë ndërsa në Qarkun e Beratit (ku përfshihet edhe Kuçova), rreziku i erozionit është i lartë (tabela x).[54]

Tabela 7. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore në vend

		Indeksi i erodibilitetit (gërryeshmërisë)				Indeksi i rrezikut potencial të tokës		
Rrethet	**Sip (Ha)**	**Absol.**	**Rel.**	**Indeksi i erozionit të tokës**	**Indeksi i pjerrësisë**	**Absol.**	**Rel.**	**Vlerësimi**
Qarku Berat	34,932	7.5	3	2	2.23	13.4	3	I larte

Burimi: AKM 2013

Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor, sidomos në zonën e NjA-së Lumas. Kultivimi i tokës së këtyre zonave krijon vetvetiu erozion të tokës nëse praktikat bujqësore të kultimimit nuk janë të qëndrueshme.

Për sa i përket erozionit në zonat fushore, kryesisht në toka bujqësore që shtrihen kryesisht gjatë gjithë pjesës perëndimore të Bashkisë (zona fushore e saj), ai ka ardhur si rrjedhojë e keqmanaxhimit të tokës. Gjatë gjithë territorit të vendit dhe brenda territorit të bashkisë, në kohën e punimit të tokës, vihen re ngastra me tokë të punuar thellë dhe të zhveshur tërësisht nga bimësia. Në tokat bujqësore në vendin tonë, bujqit ose fermerët gjatë punimit ende vazhdojnë ta zhveshin tokën tërësisht nga të gjitha mbetjet bimore të të mbjellave të stinëve të mëparshme pa marrë parasysh se një gjë e tillë e varfëron tokën dhe e shndërron atë në tokë të ndjeshme ndaj erozionit në rastin më të parë të reshjeve me intensitet të lartë apo të stuhive të erës. Ndërkohë që vendet e tjera kanë futur tashmë praktika kultivimi të konsoliduara për shmangien ose zbutjen e erozionit (punimi i tokës duke e trazuar atë sa më pak, ruajtja e masës bimore të të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit, përdorimi i mbulesave bimore ndërmjet stinëve të kultivimit ose mbjella e foragjereve ndarmjet bimëve të kultivuara me rreshta si pemtaria, vreshtaria ose ullishtet etj.) në vendin tonë mbetemi ende mbrapa.

Figura 33. Punimi i tokës bujqësore me zhveshje të saj në Bashkinë Kuçovë




Burimi: Co-PLAN, 2016

Për të kuptuar përmasat dhe shtrirjen e erozionit në territorin e Bashkisë, mjafton edhe të analizojmë vëllimin e rezervuarëve dhe digave që ndodhen në Bashki edhe pse shkaqet janë të ndryshme. Nga një analizë e hollësishme e 3 rezervuarëve të pranishëm në Bashki, është vënë re se pothuajse të gjithë rezervuarët kanë pësuar zvogëlim të volumit të tyre për shkak të erozionit. Më problematik mbetet Rezervuari i Belesovës zvogëlimi i kapacitetit të të cilit arrin deri në 81% i ndjekur nga Rezervuari Goraj me 25%, Fier- Mimar me 17% dhe Gegë me 15%.

Në Rezervuarin e Belesovës, mbushja e rezervuarit me dhera të sjella nga erozioni është tejet i dukshëm. Kjo ka ndodhur edhe për shkak të prishjes së 3 digave (1 pritë në lagjen Rrerrak në Belasovë, 1 pritë disa qindra metra larg lagjes Rrerrak ndërsa prita e tretë ndodhet në degën e Katërlisit, degë në të djathtë të lumit të Lapardhasë. Kjo pritë ndodhet shumë afër bashkimit të degës së Katërlisit me Lapardhanë (pothuajse në paralel me pritën 2).

Figura 34. Vëllimi i rezervuarit/digës mbushur me erozion (%)



Burimi: MBZHRAU, Punoi: Co-PLAN; 2016

Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmanaxhimit të territorit bujqësor, pyjor e kullosor, apo braktisjes, në territorin e bashkisë vihet re degradimi i territorit në disa zona. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave bujqësore kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[55].

- **Përmbytjet**

Përmbytjet në vendin tonë ndër vite: Vendi ynë është kërcënuar nga përmbytjet e lumenjve ndër vite. Sipas studimeve të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) të vitit 2003[56] informacionet e para rreth përmbytjeve në vend janë regjistruar në vitet 1854-1871, periudhë gjatë së cilës kanë ndodhur 11 përmbytje. Përmbytjet kanë patur shkaktuar dëme të konsiderueshme në vend. Megjithatë, përmbytja e viteve 1962-1963 konsiderohet përmbytja me ndikim më të madh. Lumenjtë e Drinit dhe të Bunës përmbytën fushat e Shkodrës dhe Zadrimës, lumenjtë Mat dhe Drin përmbytën fushën e Lezhës, lumi Ishëm përmbyti fushën e Thumanës ndërsa lumenjtë Shkumbin dhe Seman kanë përmbytur fushat përreth tyre (Harta e rrezikut të përmbytjes së Ultësirës Perëndimore me rikthim 100 vjet.) Sipas llogaritjeve të asaj kohe, janë përmbytur gjithsej 70,000 ha tokë bujqësore duke shkaktuar dëme të mëdha në ekonominë e banorëve vendas (Tabela e mëposhtme).

Tabela 8. Zonat e përmbytura në dimrin e viteve 1962-1963

Zonat e përmbytura	Sipërfaqja e përmbytur (ha)	Kohëzgjatja (Ditë)
Bregu i Bunës **(Fushat e Zadrimës së Shkodrës dhe të Lezhës)**	18,575	22
Drini i Lezhës dhe Mati **(Fushat ndërmjet të dy lumenjve)**	**3,122**	**10**
Mati dhe Ishmi (Fushat ndërmjet të dy lumenjve)	**5,825**	**7**
Lumi Shkumbin (Fushat poshtë Rrogozhinës, në të dy anët e lumit)	6,896	**7**
Lumi Seman (Fushat në të dy brigjet e tij)	26,738	**35**
Lumi Vjosa (Fushat në të dy brigjet e lumit, poshtë Urës së Mifolit)	**3,538**	**20**

Burimi : Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, 2003, Punoi: Co-PLAN; 2016

Përmbytje të tjera të një shkalle të gjerë janë regjistruar në vitet 1970-71 dhe në vitin 2002. Në vitin 1970-71 ndikimet më të mëdha janë ndjerë në luginën e Vjosës. Lumi i Vjosës

llogaritet të ketë përmbytur 14,000 ha dhe shkaktuar dëmtime dhe shkatërrime të argjinaturave, kanaleve ujitëse, urave, stacioneve të pompimit etj. Në shtator të vitit 2002, përmbytjet janë përsëritur duke mbuluar me ujë rreth 30,000 ha tokë bujqësore. Lumenjtë që dolën nga shtrati ishin lumi Erzen dhe, mbi të gjitha, degët kryesore të lumenjve Vjosë (Drinosi), Seman (Gjanica) si dhe përrenj të tjerë të vegjël (Gjadri, Përroi i Manatinës në Lezhë dhe Përroi i Zezës). Edhe pse mungojnë të dhënat, përmbytjet kanë vazhduar sërish (në vitin 2014-15) duke shkaktuar dëme të mëdha në vendet ku ato ndodhin.

- **Shkaqet e përmbytjes**

Përmbytje nga lumenjtë kryesorë: Sipas një studimi të kryer nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara[57], rreziku më i madh i përmbytjeve në vendin tonë vjen nga sistemi lumor kryesor (lumenjtë e mëdhenj). Përmbytjet zakonisht janë të lidhura ngushtë me periudhën kur sasia e reshjeve është më e lartë në vend e cila përkon me muajt nëntor-mars. Këto janë edhe muajt kur bien rreth 80-85% të reshjeve në vend[58]. Në përgjithësi, dhe sidomos në kohët e fundit, reshjet intensive janë të befasishme dhe dallohen për një kohëzgjatje për rreth 8-10 orë. Si rrjedhojë, lumenjtë kryesorë të vendit arrijnë kapacitetin e tyre maksimal deri në dalje nga shtrati duke përmbytur tokat përreth. Gjatë përmbytjeve, prurja specifike e lumenjve në vendin tonë luhatet nga 0.5-2.5 $m^3/s/km^2$.[59]

Tabela 9. Karakteristikat kryesore hidrologjike të pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve më të mëdhenj në vend

Pellgu ujëmbledhës	Sipërfaqja (km^2)	Prurja specifike ($l/s/km^2$)	Prurja vjetore (milion m^3)	Raporti vjetor i prurjes së lagët/thatë (1)	Raporti 10-vjeçar i prurjes (2)	Aftësia mbrojtëse e rezervuarit (milion m^3)
Drini	19,582	35	11,110	5,7 (Dhjetor/Gusht)	13	2,700 (Fierza)
Mati	2,441	40	3,250	10 (Dhjetor/Gusht)	25	240 (Ulëza)
Erezeni-Ishmi	1,439	24-31	660	9-10 (Janar,Shkurt/Gusht)	55	Nuk ka
Shkumbini	2,445	26	1,900	10,8 (Prill-Gusht)	24	Nuk ka
Semani	5,649	16	2,700	14,8 (Shkurt/Mars, Gusht)	18	700 (Diga e Banjës) (3)
Vjosa	8,1	26	5,550	7,3 (Shkurt-Gusht, Shtator)	21	Nuk ka

Burimi : PNUD, 2003

(1) Raporti midis prurjes në muajin më të lagët me atë në muajin më të thatë; 2) Raporti midis prurjes më të lartë dhe asaj më të ulët brenda një 10 vjeçari; 3) Rezervuar i papërfunduar

Përmbytje nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë: Një karakteristikë e përmbytjeve në vendin tonë është se shpesh ato shkaktohen edhe nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë, krysisht në luginat e Shqipërisë Veriore, Qëndrore dhe Jugore. Studimet tregojnë[60] se lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë që përmbyten në vend janë përrenjtë e Përmetit, Zaranikës e Manazderës në Elbasan, Manatisë, Lanës dhe Zezës si dhe lumenjtë Kiri, Tërkuza, Gjolja e Drionosi. Përrenj të tjerë që përbëjnë rrezik të ndjeshëm janë ai i Gjadrit, Droja, i Korçës dhe i Vërdovës[61].

Tabela 10. Lumenjtë/përrenjtë e vegjël me prirje për përmbytje në basenet Shkumbin, Seman e Vjosë

Lumi ose Përroi	Rajoni / Zona e ndikimit
Përroi i Zaranikës	Qyteti i Elbasanit (pjesërisht)
Përroi i Manasderës	Rruga Elbasan-Librazhd
Lumi i Gjanicës	Qyteti i Fierit (pjesërisht)
Lumi i Drinosit	Qyteti i Gjirokastrës (pjesërisht) dhe rruga Tepelenë-Gjirokastër-Kakavijë

Burimi: PNUD, 2003

Rreziku nga përmbytjet e sistemi kryesor lumor me rikthim 100 vjet në rang vendi: Vendi ynë rrezikon dëmtime të mëdha në rast se përmbytjet janë për periudhë rikthimi 50 vjet dhe 100 vjet. Nga studimet e kryera nga PNUD, pasojat janë pothuajse të papërfillshme (me ndikim të kufizuar ose pa pasoja) në rastin e përmbytjeve me rikthim në 50 vjet. Kjo në rast se merren të gjitha masat për paradalimin e tyre (kur sistemi i pendave është i padëmtuar dhe instalimet e pompimit janë të gjitha në punë). Masa të tilla janë në gjendje të shmangin rreziqet që i kanosen Ultësirës Perëndimore.

Përmbytjet me rikthim në më shumë se 50 vjet duket se janë përmbytjet që kanë një ndikim më të fuqishëm në vend. Këto lloj përmbytjesh (të rikthimit me 100 vjet p.sh.) mund të krijojnë të njëjtat kushte si përmbytja e vitit 1962/63. Shkalla e rrezikshmërisë nga këto përmbytje ndyshon nga zona në zonë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se rajonet me rrezikun më të ulët të përmbytjeve në periudhë rikthimi 100 vjet janë Ultësira Perëndimore, rajoni i Alpeve të Shqipërisë dhe Krahina Malore Juglindore.


Rrezikshmëria më e lartë e përmbytjeve paraqitet në pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve Devoll dhe Osum, pjesën e poshtme të Shkumbinit, lumenjtë Drini i Zi, Mati, rajoni i Bregut të Detit dhe lumenjtë Kiri, Gjadri, Lesniqja, Gomisqja, Ishmi dhe lumenjtë e krahinave malore jugore dhe qëndrore të Shqipërisë, si Drinosi, Shushica etj. Në pjesët e tjera të vendit rreziku është më i ulët.

Tabela 11. Zonimi i rrezikut të përmbytjeve në Shqipëri për periudhë rikthimi 100 vjet

Shkalla e rrezikut të përmbytjes	Prurje e pikut specifik (PPS-$m^3/s/km^2$)	Sipërfaqja	
		Km^2	%
E ulët	<2	6,660	23,5
E mesme	2_3	11,433	40,3
E madhe	3_4	5,878	20,7
E lartë	4_5	2,837	10.0
E skajshme	>5	1,564	5,5
Totali		28,372	100.0

Burimi : PNUD, 2003

Figura 35. Rrezikshmëria e përmbytjeve në vend për periudhë rikthimi 100 vjet



Burimi: PNUD, 2003, Punoi: Co-PLAN

Siç shihet nga grafiku i mësipërm, në pjesën më të madhe të territorit, rreziku i përmbytjeve në vend me rikthim në 100 vjet është i mesëm në 11,433 km^2 (40.3%) i ndjekur nga ai i ulët (23.5%, e më tej i madh (20.7%), i lartë (10%) dhe i skajshëm (5.5%). Duhet theksuar se të tre kategoritë e fundit me rrezik të i lartë, të madh dhe të skajshëm që kanë ndikimin më të fuqishëm në vend përfshin 36.2% të territorit. Pra, Shipëria është vend tejet i rrezikuar nga përmbytjet ku vetëm 23.5% e territorit nuk kërcënohet nga pasojat e rënda të përmbytjeve. Në pjesën tjetër, është tejet e rëndësishme që planifikimi i territorit të bëhet duke patur parasysh pasojat e mëdha në rast përmbytjesh me kthim 100 vjet.

- **Rreziku nga përmbytjet e sistemi kryesor lumor me rikthim 100 vjet në Bashkinë Kuçovë.**

Për sa i përket Bashkisë së Kuçovës, përmbytjet parashikohen të shkaktohen nga lumi Devoll. Siç u theksua më sipër, përmbytjet me rikthim në 50 vjet janë të parashikueshme dhe, vetëm duke marrë masat e duhura, mund të shmangen pasojat e tyre. Kjo është vërtetuar pas përmbytjeve të vitit 1962-63 kur janë marrë masa për parandalimin e përmbytjeve të tilla duke dhënë rezultate të kënaqshme në parandalimin e pasojave të rënda në përmbytjen e viteve 1970-71. Sipas PNUD-it, pas vitit 1962-63, masat për parandalimin strukturor dhe kontrollin e përmbytjeve (duke përjashtuar digat) të ndërmarra në vend janë mbështetur në një periudhë rikthimi të ujërave nga përmbytjet prej 50 vjetësh. Këto masa përfshijnë rindërtimin dhe ngritjen e argjinaturave të reja në pjesën e poshtme të lumenjve kryesorë. Ndërkohë, nuk janë marrë masa për përmbytje me rikthim në 100 vjet. Për këtë arsye, vendi ynë dhe, rrjedhimisht edhe Bashkia Kuçovë, nevojitet të planifikojnë zhvillimin e territorit duke patur parasysh ndikimet e përmbytjeve me rikthim në 100 vjet. Pasojat e përmbytjeve të këtij lloji të parashikuara nga PNUD-i për ish-Rrethin Kuçovë janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme (studimet janë kryer në nivel rrethi sipas ndarjes territoriale administrative përpara Reformës së re Territoriale):


Tabela 12. Pasojat e përmbytjes për periudhë rikthimi 100-vjet në Ish-Rrethin e Kuçovës

Lumi	Qarku	Rrethi	Sasia e fshatrave	Sasia e komunave	Sasia e ndërtesave	Sip. e ndërtimit (m^2)	Popullsia
			90	**30**	**15,516**	**1147,540**	**83,829**
lumi SEMAN	Berat	Kuçovë	3	2	961	64,540	4,814

Burimi : PNUD, 2003, Punoi: Co-PLAN

Sipas parashikimeve të PNUD-it, nevojat për përmbytje me rikthim 100-vjet nga pellgu i lumit Seman (kryesisht nga Devolli) janë të mëdha. Në territorin e ish-Rrethit të Kuçovës, vetëm nga një fenomen i tillë, parashikohet përmbytja e 3 fshatrave, 2 komunave, 961 ndërtesave si dhe e 64,540m^2 sipërfaqe toke. E gjithë kjo me pasoja të rënda për 4,814 banorë. Ndërkohë, llogaritet se shifrat do të shumëfishoheshin në rast përmbytjesh të njëkohësishme nga disa pellgje.

Figura 36. Harta e rrezikut të përmbytjes së Ultësirës Perëndimore me rikthim 100 vjet



Burimi : PNUD, 2003

Si përfundim, duke parë se parashikimet rreth ndikimit të përmbytjeve në vend janë kryer në vitin 2003, dhe se gjatë këtij 13-vjeçari regjimi i reshjeve ka ndryshuar duke çuar kështu në shpeshtimin e përmbytjeve dhe rritjen e ndikimit të tyre në territoret e bashkive, mendohet se pasojat e përmbytjeve me rikthim 50 ose 100 vjet të jenë edhe më të theksuara. Për këtë arsye, përveç marrjes së masave të duhura për parandalimin e përmbytjeve me rikthim 100 vjet, nevojiten edhe studime të reja më të përditësuara rreth përmbytjeve në vendin tonë.

- **Burimet ujore sipërfaqësore**

Bashkia e Kuçovës ka një rrjet të pasur ujor. Në veriperëndim, nga fshati Frashër e deri në bashkimin e tij me Osumin në Arrëz, për rreth 12.5km, bashkia përshkohet nga rrjedha e mesme e *lumit Devoll* i cili bashkohet me lumin Osum në Arrëz të Urës Vajgurore. Devolli është 196 km i gjatë dhe buron në Malin e Gramozit. Pellgu ujëmbledhës i lumit ka një sipërfaqe prej 3,130km[62], dhe një lartësi mesatare mbi nivelin e detit të barabartë me 1,082m. Burimet e tij ndodhen në zona ranore në sipërfaqe flishore në thellësi të tokës, të cilat dallohen për kapacitet të ulët ujëmbajtës. Si rrjedhojë nuk është në gjendje të furnizojë me ujë lumin gjatë periudhës së nxehtë dhe reshjeve të pakta të verës. Prurja e Devollit është mesatarisht 49,5 m³/s, dhe ushqehet kryesisht nga ujërat sipërfaqësore[63].

Territori i Bashkisë përshkohet për rreth 3.9km edhe nga rrjedha e mesme e *lumit Osum* që ndan kufirin administrativ të Bashkisë së Kuçovës me Bashkinë e Urës Vajgurore, duke filluar nga Guri i Bardhë në Urë Vajgurore e deri në perëndim në Arrëz, pika ku Devolli dhe Osumi bashkohen për të formuar Semanin. Nga Arrëzi deri në kufi me Lushnjën në veri-perëndim, Bashkia përshkohet nga *Semani* në një gjatësi prej 4.9km. Osumi dhe Semani shërbejnë edhe si kufij administrativë ndërmjet bashkive Kuçovë dhe Urë Vajgurore. Pjesa perëndimore e Bashkisë përshkohet nga *lumi i Lapardhasë*, i cili

furnizohet me ujë nga një numër i madh përrenjsh në zonën e Lumasit. Një sërë përrenjsh të vegjël përshkojnë pothuajse të gjithë territorin e Bashkisë e shërbejnë si burime ushqyese të lumenjve të mëdhenj: Osum, Devoll e Lapardha.

Figura 37. Lumenjtë dhe rezervuarët kryesorë në Bashkinë Kuçovë



Burimi: SHGJSH, Përgatiti:Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Në Kuçovë ndodhen edhe një numër *rezervuarësh,* ndër të cilët mund të përmendim ujëmbledhësin e *Gorajt* në pjesën qendrore të Bashkisë, ujëmbledhësin e *Belesovës* në pjesën perëndimore, ujëmbledhësin ndërmjet fshatrave *Gegë dhe Drizë* dhe ujëmbledhësin në *Salcë-Kozarë.*

Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujitje, ujë industrial etj.) dhe mbi të gjitha, ato shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore jetike për furnizimin me ujë të bashkisë dhe të qyteteve përreth.

- **Gjendja e burimeve ujore sipërfaqësore (problematikat)**

Në dy dhjetëvjeçët e fundit në vendin tonë, burimet ujore dhe kryesisht lumenjtë, janë shfrytëzuar për bujqësi, industri, për materialin e tyre inert dhe për sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe njëkohësisht, janë përdorur si kanale për derdhjen e ujërave të ndotura. Për më tepër, mungesa e planeve për mbrojtjen e lumenjve e shoqëruar me ndërhyrje pa kriter të njeriut në shfrytëzimin e tyre (shfrytëzimi i inerteve në shtratin e lumenjve, punimi i brezave të gjelbër mbrojtës etj.) ka përshpejtuar shumë procese natyrore gjeologjike në shtratin e lumenjve siç janë gërryerja e shtratit, erozioni anësor dhe sipërfaqësor i brigjeve, rrështitjet e tyre etj. të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në përkeqësimin e gjendjes së tyre.[64] Si rrjedhojë, sot lumenjtë vuajnë pasojat e një keqmanaxhimi të gjatë që janë kryesisht *i) ndyshime në hidro-morfologjinë e lumenjve; ii) humbje të florës & faunës ujore, dhe iii) ndotje.*

Hidromorfologjia e lumenjve dhe ndryshimet e saj lidhen kryesisht me tipare fizike të një lumi të cilat janë kryesisht[65]: *morfologjia e kanalit* dhe *lloji i rrjedhës* (natyrale ose e

modifikuar); *përbërja litologjike e shtratit* (lloji, sasia e përbërjes shkëmbore në shtrat); *struktura dhe stabiliteti i brigjeve* – mjaft e rëndësishme sepse tregon ndikimin që do të ketë lumi në gërryerjen e brigjeve dhe, si rrjedhojë, në sasinë e sedimentit që do të përfundojë në lumë; *digat/pengesat* përgjatë rrjedhës, të cilat ndikojnë në ndryshimin e shpejtësisë së rrjedhës së lumit dhe largësinë e rrjedhjes së lirshme të ujit deri në largësinë në të cilën është në gjendje të trasportojë sedimentin; *bimësia në shtratin e lumit* (habitatet, biodiversiteti, bimët,etj); *brezi i bimësisë mbrojtëse përgjatë brigjeve, përdorimi i tokës në afërsi* (rreth 20 metra nga bregu) dhe *gjerësia e zonës me ndikim nga përmbytjet*.

Në vendin tonë, ndërhyrjet në lumenj janë të shumëllojshme, si në shtrat, ashtu edhe në ndryshimin ose zhvendosjen e mbulesës bimore; marrjen e materialeve inerte, rërë, zhavorr, gurë ose plisa; ndërtime afër lumenjve; hedhje apo depozitim i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore; gërmime të ndryshme, si dhe veprimtari të tjera që prodhojnë mbetje; shkarkimi i ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajtuara, veprimtari të cilat ndalohen me ligj. [66] Të gjitha këto kanë shkaktuar dëmtime të hidromorfologjisë së lumenjve që janë vërtetuar nga studime të ndryshme, ndër të cilat, edhe nga studimet e Shërbimit Gjologjik Shqiptar rreth thellimit të shtratit të lumenjve.

Me qëllim analizimin e gjendjes së lumenjve në vendin tonë dhe përcaktimin e shkallës së ndikimit të fenomeneve gjeologjike dhe ndërhyrjes së njeriut në shtratin e tyre, SHGJSH-ja ka monitoruar[67] basenet e lumenjve në vend, ndër të cilët edhe Basenin/Pellgun e lumit Seman.


Pellgu i lumit Seman është monitoruar në pesë pika/profile monitorimi për periudhën 2008-2016. Këto profile janë shpërndarë në lumin Osum (dy pika) dhe në Lumin Seman (tre pika). Në lumin Devoll nuk ka profile të monitoruara. Megjithatë, duke qenë se në zonën fushore përpara bashkimit, lumenjtë Osum e Devoll paraqesin ngjashmëri hidromorfologjike, rezultatet e lumit Osum në dy pikat e monitorimit Urë Vajgurore në Osum dhe Urë e Kuçit në Seman, në një farë mënyre janë tregues edhe të gjendjes së Lumit Devoll.

Tabela 13. Vendndodhja e profileve të monitorimit

Nr.	Lumi	Vendi i Profilit	Periudha e monitorimit
38	Seman	Ura e Re Berat	2008-15
39		Ura Vajgurore	2008-15
40		Ura e Kuçit	2009-15
41		Imësht	2009-16
42		Ura e Mbrostarit	2007-15

Burimi: SHGJSH, 2015

Figura 38. Profilet e monitorimit të gjendjes së shtratit të lumenjve në basenin e Semanit



Burimi: SHGJSH, 2016


Ndër problematikat kryesore të nxjerra në pah nga ky monitorim është prania e ***erozionit fundor*** në segmente të ndryshme të lumit, në forma dhe intensitete të ndryshme (tabela, më poshtë). Në të gjitha pikat ka patur erozion të theksuar fundor i cili shfaqet me *ulje të shtratit të lumit*. Më i theksuar është vënë re në *Urë Vajgurore* në vitet 2008-2015 (43.2cm ulje), i ndjekur nga segmenti i lumit në Imësht (34.8cm), Ura e Mbrostarit (19.4cm) dhe Ura e Kuçit me 13cm (figura më poshtë).

Tabela 14. Erozioni fundor ndër vite në lumenjtë Osum dhe Seman

Nr.	Vendi i profilit të monitorimit	Periudha e monitorimit	Ndryshimi total	Ecuria deri 2015			Trendi 2011-2015		
				Erozion	Neutral		E	N	A
38	Ura e Re Berat	2008-15	-16.8	+			+		
39	**Ura Vajgurore**	**2008-16**	**-43.2**	**+**			**+**		
40	Ura e Kuçit	2009-15	-13.0		+		+		
41	**Imësht**	**2009-16**	**-34.8**	**+**			**+**		
42	Ura e Mbrostarit	2007-15	-19.4	+				+	

Burimi: SHGJSH, Përpunoi: Co-PLAN; 2016

Figura 39. Thellimi i shtratit të Semanit e Osumit për shkak të erozionit fundor



Burimi: SHGJSH, Përpunoi: Co-PLAN; 2016

Erozioni i brigjeve të lumit është i theksuar, në veçanti në brigjet anësore të Urës Vajgurore i cili arrin deri në 250 metra në thellësi të terracës.

Ndërkohë, në lumë janë vënë re edhe ***ndërhyrje të gabuara për mbrojtjen e lumit*** nga erozioni në rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore Lushnjë-Berat. Një shembull është argjinimi i meandrës i cili ka shkaktuar erozion. Shkurtimisht, problematikat kryesore që janë vënë re gjatë monitorimit janë[68]:

- ulje të shtratit për shkak të erozionit fundor;
- përmbytje në zonën e poshtme të lumit Seman dhe në zona të caktuara të rrjedhës së tij;
- ndotje të ujit (nga inertet, ndotje baktereologjike të ujit etj.);
- dëmtim të florës dhe faunës së lumit;
- dëmtim të peizazhit lumor;
- erozion të tokës bujqësore në segmentet Berat-Urë-Vajgurore, Gostimë, Salcë-Kozarë, Çiflig, Arrëz, Ndërmenas, Marinzë, Jogodin, Mbrostar, etj.;
- rrezikime të objekteve inxhinjerike (ura mbrojtëse, argjinatura, etj.) në Vetrik, Vlashuk, Çipllak, Segmentet Berat-Urë Vajgurore, Gorican-Mbrostar, etj.);
- ulje e nivelit të ujërave nëntokësore në puset e ujit e stacione pompimi jashtë funksionit.

Dëmtimi i sistemit lumor nga HEC-et: Pellgu i Semanit (përfshirë Devoll e Osum) është shfrytëzuar gjerësisht për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të HEC-ve. Në fakt, në pellgun e Semanit deri më tani janë ndërtuar 6 HEC-e, ndërkohë që 5 të tjerë janë në ndërtim dhe 66 janë planifikuar për t'u ndërtuar.

Tabela 15. HEC-et në Basenin e Lumit Seman

Baseni i Semanit			
Nr	Emërtimi i HEC-eve	Kapaciteti	Lumi
		Në prodhim	
1	Gjanc	1-10MW	NN
2	Vithkuq	1-10MW	Treska
3	Bogova	1-10MW	NN
4	Ujanik	1-10MW	NN
5	Lenia	1-10MW	NN
6	Holta	1-10MW	NN
		Në ndërtim	
7	Nice	1-10MW	Nice
8	Treska 1	1-10MW	Treska
9	Treska 2	1-10MW	Treska
10	Nishovë 1	0-1MW	Nishovë
11	Banjë	>50MW	Devoll
		Planifikuar per t'u ndërtuar	
12	Gjerbes	0-1MW	Gjerbes
13	Darsi 1	0-1MW	Darsi
14	Darsi 2	0-1MW	Darsi
15	Darsi 3	0-1MW	Darsi


16	Mollas	0-1MW	Mollas
17	Arrëz	0-1MW	Arrëz
18	Vokopola	0-1MW	Vokopola
19	Bigas Veleshnje	0-1MW	Begas-Veleshnje
20	Vlasçuk	1-10MW	Devoll
21	Vertoipi	1-10MW	Osum
22	Nishovë 2	0-1MW	Nishovë
23	Corovodë	0-1MW	Corovodë
24	Prishtë 1	0-1MW	Prishtë
25	Prishtë 2	0-1MW	Prishtë
26	Staravecka 1	0-1MW	Staravecka
27	Staravecka 2	0-1MW	Staravecka
28	Staravecka 3	0-1MW	Staravecka
29	Helmes 1	1-10MW	Helmes
30	Helmes 2	1-10MW	Helmes
31	Faqekuq 1	1-10MW	Faqekuq
32	Faqekuq 2	1-10MW	Faqekuq
33	Velushe	10-50MW	Osoje
34	Treska 3	1-10MW	Treska
35	Treska 4	1-10MW	Treska
36	Qytezë	0-1MW	Qytezë
37	Kozel 1,2	1-10MW	Osum
38	Belesova 1,2	1-10MW	NN
39	Holtë 2	1-10MW	Holtë
40	Kabash-Pukë	0-1MW	Kabash
41	Sotirë 1	1-10MW	Sotirë
42	Sotirë 2	1-10MW	Sotirë
43	Skënderbegas	>50MW	Toorricë
44	Kërpicë	1-10MW	Kërpicë
45	Dobrenjë-Tomorricë	0-1MW	Dobrenjë-Tomorricë
46	Kukur 1	1-10MW	Kukur
47	Kukur 2	1-10MW	Kukur
48	Kukur 3	1-10MW	Kukur
49	Kukur 4	1-10MW	Kukur
50	Kukur 5	10-50MW	Kukur
51	Bratila 1	>50MW	Devoll
52	Bratila 2	1-10MW	Devoll
53	Zerec 1	0-1MW	Zerec
54	Zerec 2	0-1MW	Zerec
55	Moglicë	>50MW	Devoll
56	Cemerica 1	1-10MW	Cemericë
57	Cemerica 2	1-10MW	Cemericë
58	Cemerica 3	1-10MW	Cemericë

59	Strelce 1	0-1MW	Strelce
60	Strelce 2	0-1MW	Strelce
61	Lozhan 1	0-1MW	Dolanit
62	Lozhan 2	0-1MW	Dolanit
63	Verba 1	0-1MW	Verba
64	Verba 2	0-1MW	Verba
65	Babjen	0-1MW	Babjen
66	Shpella poshtë 1	0-1MW	Poshtë
67	Shpella poshtë 2	0-1MW	Poshtë
68	Hohist	1-10MW	Devoll
69	Grapsht	1-10MW	Devoll
70	Vranisht	1-10MW	Devoll
71	Stropan	1-10MW	Devoll
72	Brecen Mnekula	1-10MW	Devoll
73	Kuk Menkulas	1-10MW	Devoll
74	Dobjan Menkulas	1-10MW	Devoll
75	Miras Menkulas	1-10MW	Devoll
76	Dardhë 1	0-1MW	Devoll
77	Dardhë 2	1-10MW	Devoll

Burimi: AKBN dhe Riverwatch.eu; Përpunoi: Co-PLAN; 2016

HEC-et janë ndërtuar në dy furnizuesit kryesorë të lumit Seman (Devoll dhe Osum) si dhe në degë të nivelit të dytë (degë të degëve), të cilat shërbejnë si burim kryesor ushqyes për lumenjtë kryesorë Osum e Devoll, e si rrjedhojë, edhe Seman. Njëkohësisht, ata shërbejnë edhe si burim i materialit zhavorror për lumenjtë në fjalë.

Figura 40. HEC-et në Pellgun e lumit Seman



Burimi: Riverwatch.eu; 2016
Legjenda:
Ngjyra e zezë – HEC i ndërtuar
Ngyra e verdhë – HEC në ndërtim
Ngjyra e kuqe – HEC i planifikuar për t'u ndërtuar

Vetëm në lumin Devoll deri më tani është planifikuar ndërtimi i 15 HEC-eve, ndër të cilët HEC-i i Banjës është në ndërtim ndërsa të tjerët janë planifikuar për t'u ndërtuar. Deri në këtë moment nuk ka të dhëna rreth kohës në të cilën është planifikuar ndërtimi i tyre.

Tabela 16. HEC-et në Lumin Devoll

Nr.	Emërtimi i HEC	Gjendja	Kapaciteti	Lumi
Në ndërtim				
1	Banjë	në ndërtim	>50MW	Devoll
Planifikuar per t'u ndërtuar				
2	Vlasçuk	i planifikuar	1-10MW	
3	Bratila 1	i planifikuar	>50MW	
4	Bratila 2	i planifikuar	1-10MW	
5	Moglicë	i planifikuar	>50MW	
6	Hoçisht	i planifikuar	1-10MW	
7	Grapsht	i planifikuar	1-10MW	
8	Vranisht	i planifikuar	1-10MW	
9	Stropan	i planifikuar	1-10MW	
10	Brecen Mnekula	i planifikuar	1-10MW	
11	Kuk Menkulas	i planifikuar	1-10MW	
12	Dobjan Menkulas	i planifikuar	1-10MW	
13	Miras Menkulas	i planifikuar	1-10MW	
14	Dardhë 1	i planifikuar	0-1MW	
15	Dardhë 2	i planifikuar	1-10MW	

Burimi: Riverwatch.eu; Përpunoi: Co-PLAN; 2016

Lumenjtë janë shfrytëzuar për prodhimin e energjisë hidrike ndër vite. Në fakt, në vendin tonë energjia është pothuajse hidrike falë traditës që ka vazhduar në 50 vitet e fundit. Megjithatë, edhe pse HEC-et sjellin përfitime ekonomike dhe prodhim energjie, ata kanë ndikimet e tyre në mjedis dhe, në qoftë se nuk ndërtohen sipas parimit të përdorimit të integruar të burimeve ujore (që nënkupton përdorim i ujit duke patur parasysh edhe nevojat e sektorëve të tjerë të ekonomisë për ujë), rrezikojnë të shndërrohen në konflikte sociale.

HEC-et ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e një lumi. Ndër pasojat më të njohura renditen ndikimi i drejtpërdrejtë në karakteristikat fiziko-kimike dhe biologjike të tij. Konkretisht, mund të përmendim:

- *trasformimin e rrjedhës së lumit në* pjesën e sipërme të digës nga një sistem natyror lumor në *sistem të një rezervuari artificial* me ujëra të ndenjura,
- *bllokimin e qarkullimit të peshqve* ose specieve të tjera ujore,
- *prishjen e ekuilibrave* e *proceseve fizike* dhe *habitateve* në rrjedhën mbas digës. Zakonisht, HEC-et dhe pritat e tilla që nuk lejojnë kalimin e materialit zhavorror shkaktojnë prishjen e ekuilibrit të grykëderdhjeve duke shkaktuar erozionin detar, ishujve, zonave pjellore të lumenjve dhe zona të tjera këneto re,
- *ndryshimin e rrjedhës së lumit dhe të prurjeve të sedimentit zhavorror*, të trashë, në rrjedhën e poshtme të lumit me pasoja të rënda për deltat, florën e faunën, për faktin se

jeta në lumë dhe përreth sistemit të lumit kushtëzohet dhe zhvillohet në varësi të rrjedhës dhe sedimentit,

- *grumbullimin e sedimentit pas digës* që normalisht do të furnizonte ekosistemet në rrjedhën e poshtme. Kur një lumë nuk merr sedimente mjaftueshme, zakonisht tenton ta zëvendësojë atë duke gërryer brigjet e lumit e shaktuar thellim të shtratit,
- *thellimin e shtratit të lumit,* i cili ul edhe nivelin e ujit në akuifere.

Duke parë numrin e madh të HEC-eve që do të ndërtohen në Devoll dhe në degët e tij, mendohet se ndikimi në mjedis dhe në bujqësi në zonat përreth mund të jetë i theksuar. HEC-et mund të sjellin zvogëlimin e rrjedhës së lumit, mjaft e rëndësishme për bujqësi në stinën e verës, ose pakësimin e sasisë së ujërave të disponueshme për ujë të pijshëm dhe sektorë të tjerë, edhe pse ky mbetet objekt studimi në të ardhmen. Vetëm një njohje e mirë e strukturës së digave dhe sasisë së ujërave të rrjedhës së lumit që ato lënë me rrjedhje të lirë mund të japë një pasqyrë të qartë të sasisë së ujit, që banorët do të mund të kenë në përdorim në rrjedhën e poshtme të digës (pas digës) në të ardhmen.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se lumi Devoll është jetik për zhvillimin e bujqësisë në Bashkinë Kuçovë dhe në bashkitë e tjera nëpër të cilat kalon. Për këtë arsye, ndryshimi i rrjedhës së ujit apo pakësimi i sasisë së ujit që mund t'u shkojë fshatarëve për përdorim në periudhat e kultivimit nuk përbën më një problem vetëm mjedisor, por mbi të gjitha, një problem social që do të kërkonte zgjidhje të menjëhershme. Njëkohësisht, pakësimi i rrjedhës së lumit Devoll mund të çojë edhe në zvogëlimin e sasisë së ujërave të Akuiferit të Beratit i cili ushqehet nga lumi Devoll e Osum. Ky akuifer shërben si burim për furnizimin me ujë të popullsisë së bashkive të ndryshme (kryesisht të Bashkisë Berat, disa fshatrave të Bashkisë Kuçovë dhe fshatrave të ndryshme). Me pak fjalë, digat e HEC-eve, në rast se nuk janë planifikuar dhe nuk manaxhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të integruar që garantojnë mosndryshimin e rrjedhës së lumit dhe sasisë së ujit si dhe përdorimin e ujit edhe për bujqësi për popullsinë e zonave përreth, mund të shkaktojnë probleme të mëdha mjedisore dhe sociale në Bashki në të ardhmen e afërt.

Dëmtime të zonës ripariane: Si rrjedhojë e mangësive në manaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, zona ripariane e Semanit, Osumit e Devollit ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë brezat e bimësisë së nevojshme - bimët e ulëta deri tek ato të larta - ose nuk ekziston tërësisht). Duke qenë se rrjedha e mesme dhe e poshtme e tyre përshkon toka bujqësore të kultivuara, në të shumtën e rasteve zona ripariane është *kultivuar si tokë bujqësore*. Kështu, mbulesa natyrore e e luginës së poshtme të Devollit përfaqësohet nga plepi dhe rrapi që rriten në shtratin e luginës dhe nga shkurret mesdhetare përherë të blerta që gjenden në shpatet e ulëta të luginës. Mirëpo, shumë prej këtyre hapësirave janë shndërruar në parcela frutorësh (vreshta, kumbulla, qershi, fiq etj.) dhe tarracat lumore në të dy anët e luginës shfrytëzohen për drithëra të bukës, foragjere e perime[69]. Në rastin e Semanit, duke qenë se ai kalon në formacione tokash të gërryeshme dhe me veshje bimorë te pakët, ujërat janë mjaft të turbullta dhe me sasi të larta aluvionesh pezull. Faktorë të tillë kanë ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmbytjet), dhe mosndalimin e shkëmbimit të ndotjes mes tokave bujqësore e zonave të banimit kundrejt lumit nga njëra anë dhe ujërave sipërfaqësore dhe akuiferit nga ana tjetër. Gjithashtu, gjatë brigjeve të lumenjve vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës.

Ndotja: Gjatë 25 viteve të fundit, në vendin tonë dhe në Bashkinë Kuçovë, lumenjtë janë përdorur edhe si vend-depozitime ose kanale të mbetjeve të ngurta ose të ujërave të zeza. Në fakt, gjatë gjithë këtyre viteve, qytetet që përshkohen nga lumi Devoll e kanë shfrytëzuar këtë lumë për derdhjen e drejtpërdrejtë të ujërave të zeza urbane dhe rurale të patrajtuara në lumë duke e ndotur atë. Përveç ujërave të zeza, Lumi Devoll ka qenë vazhdimisht nën ndikimin e industrisë së naftës dhe industrive të tjera përgjatë brigjeve të tij. Në fakt, shumë puse të naftës janë hapur në largësi minimale nga lumi. Si rrjedhojë, cilësia e ujërave të lumenjve është varfëruar ndër vite. Lumi është ndotur me produkte nafte, ujëra të zeza, produkte bujqësore etj.

Ndotja e monitoruar nga Co-PLAN/PLGP USAID-i: Duke patur si qëllim përcaktimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore në disa lumenj të vendit, dhe përcaktimin e ndikimit të përdorimit të territorit të bashkive nëpër të cilat kalojnë lumenjtë e Basenit në cilësinë e këtyre ujërave, Co-PLAN-i[70] kreu monitorimin e cilësisë së ujërave të Basenit të Semanit në muajt prill-qershor të vitit 2015 me fokus të veçantë në lumin Seman dhe tre degët e tij kryesore: Osum, Devoll e Gjanicë.

Parametrat e monitoruar janë si më poshtë vijon:

- Parametra fiziko-kimikë: pH, tejdukshmeria, përçueshmeria elektrike, lënda e ngurtë pezull (TSS), lënda e ngurtë e tretur, oksigjeni i tretur, temperatura dhe nevoja biologjike për oksigjen;
- Ushqyesit: $N\text{-}NH_4$, $N\text{-}NO_3$, $N\text{-}NO_2$, Sulfidet;
- Bakteria: bakteria koliform;
- Metale të rënda: Plumb (Pb), Kadmium (Cd), Mangnez (Mn), Nikel (Ni), Zink (Zn), Bakër (Cu), Co, Krom (Cr), Mërkur (Hg), Arsenik (As), Barium (Ba), Brominë (Br).

Tabela 17. Pikat e monitorimit

N.	Lumenjtë	Vendndodhja e pikës së marrjes së mostrave të ujit
1	L. Seman	**Lushnjë (Para hyrjes në Patos Marinez)**
2		Ura e Mbrostarit në Fier (para bashkimit me L. Gjanica)
1	L. Gjanicë	**Ballsh –Panahori (para kalimit në Ballsh)**
2		Mbrostar (pas landfillit Fier, para bashkimit me L. Seman, Ura e Rr. Teodor Muzaka)
1	L. Osum	**Kanionet e Osumit: afër burimit, para Çorovodës**
2		Uznove (para bashkimit me L. Zagoria)
3		
4		Ura e Gorices, Berat
5		**Urë Vajgurore (në hyrje të Bashkisë Kuçovë tek Ura e rrugës SH-72)**
6		Arrëz (para bashkimit me L. Devoll)
1	L. Devoll	**Moglicë, Korçë**
2		Arrëz (para bashkimit me L. Seman)

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Pika e monitorimit ***Devoll 2***, para bashkimit të Devollit me Osumin dhe ***Osum 6*** në fshatin Arrëz, përpara bashkimit të Osumit me Semanin, prekin kufijtë e Bashkisë së Kuçovës.


Figura 41. Harta e marrjes së kampioneve për vlerësim në lumin Osum dhe Devoll



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Nga monitorimi i kryer në Seman, u vu re se ujërat e lumenjve Gjanicë dhe Seman, nga Ura e Mbrostarit deri në grykëderdhje, janë acidike (ph<7) ndërsa ujërat e lumenjve Osum e Devoll janë alkalinë (pH >7) në të gjitha pikat e monitorimit (Figura 21).

Figura 42. pH dhe përçueshmëria elektrike në Basenin e Semanit




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Në lumin Seman, ***thellësia e depërtimit të dritës*** është në nivele të pranueshme në pjesët e sipërme të rrjedhës, por depërtimi i dritës paraqet probleme më të theksuara në zonat me erozion të lartë, në Seman para hyrjes në Patos-Marinëz dhe në Urën e Mbrostrit ndërsa në Osum në segmentin Urë Vajgurore-Arrëz, përpara bashkimit me Devollin.

Përçueshmëria elektrike ndryshon ndërmjet lumenjve, me vlera më të larta se standardet mjedisore në lumenjtë me ujëra acidikë, Gjanicë e Seman në segmentin Ura e Mbrostarit-Grykëderdhje. Vlerat luhaten nga 601-661 µS/cm. Në lumenjtë e tjerë të pellgut të Semanit, vlerat janë brenda normës me vlera që ndryshojnë nga 309-454 µS/cm dhe 315-439 µS/cm përkatësisht. Vlerat tregojnë qartë një lidhje të drejtpërdrejtë të përçueshmërisë elektrike me pH-in, ku ujërat bazikë kanë vlera brenda normave të lejuara mjedisore.

Figura 43. Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen dhe oksigjeni i tretur (DO) në Basenin e Semanit



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


Vlerat e ***Nevojës Biologjike për Oksigjen*** (NBO_5)[71] janë brenda normës[72] në të gjitha pikat e monitorimit. Kjo mund të shpjegohet me sasinë e konsiderueshme të ujërave. Megjithatë, duke pasur parasysh derdhjen e ujërave të zeza në lumë (siç ndodh përgjatë rrjedhës jashtë dhe brenda bashkisë), vlera e NBO_5-së tregon qartë nevojën për të analizuar NBO_5-në në lidhje me parametrat e tjerë dhe me vend-ndodhjen e burimeve kryesore të ndotjes në lumë (industria përkundrejt ujërave të zeza të zonave të banuara; metalet e rënda përkundrejt ushqyesve etj.). Prania e klorinës dhe metaleve të rënda në ujë ngadalëson ose zvogëlon ndjeshëm BOD-në, sepse pengon aktivitetin e mikro-organizmave.

Lënda e ngurtë pezull (TSS[73]) është < 2 mg/l në të gjitha pikat e monitorimit të Semanit dhe shumë më e ulët se vlerat mjedisore, me përjashtim të Lumit Gjanica në afërsi të Urës së Mbrostarit. Në këtë pikë, vlerat e lëndës pezull janë 49.8mg/l dhe shënojnë një rritje të theksuar në krahasim me pikat e tjera (Figura 23).

Ndërkohë, ***lënda e ngurtë e tretur*** (TDS[74]) ka vlera më të larta krahasuar me TSS-në. Kjo lidhet me burimet e TDS që janë erozioni i tokës, mbetjet, ujërat e bardha, dhe gërryerja e brigjeve të lumit. Vlerat më të larta të TDS-së vihen re në Seman e Gjanicë.


Semani ka përmbajtje të lartë të përbërësve të ***azotit***. NO_3^- kalon vlerat mjedisore në të gjitha pikat e monitorimit në të dy lumenjtë. Një trend të ngjashëm ndjek edhe NO_2^-,me përjashtim të Gjanicës përpara Ballshit. Përmbajtja më e lartë shënohet në Seman, para Patos-Marinëzës në Lushnjë.

Figura 44. Lënda e ngurtë e tretur dhe pezull në Basenin e Semanit



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Figura 45. Nitratet dhe nitritet në ujë në Basenin e Semanit




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

NH_4^+ paraqitet më e lartë në të gjitha pikat e monitorimit në Seman, me përjashtim të Gjanicës 1 përpara Ballshit dhe Osumit në Urë Vajgurore. Vlerat më të lartë shënohen në Gjanicë afër Urës së Mbrostarit dhe në Osum përpara bashkimit me Devollin. Azoti, është një ndër lëndët kryesore ushqyese për bimët dhe kafshët, por në rastet kur është i mbipërdorur në bujqësi dhe për shkak të derdhjeve industriale, të ujërave të zeza e të gropave septike shkakton ndotje të lumenjve. Ndërkohë sulfatet në Seman janë në nivele të ulëta krahasuar me standardin dhe më të larta hasen në Devoll 2 (para bashkimit me Osumin).

Nivele të larta të ndotjes në Seman hasen sa i përket bakterieve koliforme dhe metaleve të rënda. Bakteria Koliform në Basenin e Semanit. ***Koliformet*** janë mbi vlerën 300 Cfu/100ml në të gjitha pikat e monitorimit, dhe kjo është vlera më e lartë e zbulueshme nga laboratori (ndërkohë që standardi është 330 Cfu/100ml[75]). Rezultatet e monitorimit janë tregues të nevojës së monitorimit të mëtejshëm të ujërave të Osumit për të përcaktuar nëse ujërat e Osumit janë të përshtatshme për ujitje dhe argëtim.


Figura 46. Niveli i baktereve koliforme, Baseni i Semanit





Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


Metalet e rënda janë matur në dy pika për çdo lumë[76] të basenit të Semanit. Sipas rezultateve të analizave, ujërat janë të ndotura me plumb (Pb), kadmium (Cd), nikel (Ni) dhe hekur (Fe), Bakër (Cu) dhe Krom (Cr). Kadmiumi është në vlera më të larta se sa plumbi. Ndërkohë, vlerat e magnezit (Mn) dhe zinkut (Zn) janë brenda parametrave mjedisorë.

Figura 47. Metalet e rënda në Basenin e Semanit









Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Si përfundim, rezultatet e monitorimit të ujit tregojnë se ujërat e Basenit të Semanit duhen monitoruar më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për bujqësi dhe argëtim. Kjo mund të ndikojë negativisht në përdorimin e këtij aseti të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kuçovës. *Si rrjedhojë, projektet për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të zeza dhe mbetjeve industriale) dhe për rehabilitimin e tij duhet të kenë përparësi për bashkinë së bashku me nismat me bashkitë e tjera që preken nga Baseni i Semanit për manaxhimin e integruar të këtij baseni.*

- **Burimet e ndotjes së lumenjve**

Urbanizimi i rajoneve të pozicionuara thuajse të gjitha ndërmjet brigjeve të lumenjve me ujë të bollshëm e të rrjedhshëm, zgjerimi i metropoleve, zhvillimi i hovshëm i industrisë, sektori i bujqësisë dhe shumë aktivitete të tjera prodhuese industriale kanë shfrytëzuar ujërat e rrjedhshme sipërfaqësore si pritësin kryesor të shkarkimeve.

Ndotja e lumenjve në Republikën e Shqipërisë mund të përkufizohet si ndër më primitivet dhe të pakontrolluarat, duke qenë se edhe vetë entitetet shtetërore që parashikojnë me ligj mbrojtjen e lumenjve, shkarkojnë ujërat e tyre të ndotura pa kriter në këto sipërfaqe me ujra të rrjedhshme. Në vendin tonë, mbrojtja e burimeve ujore nga ndotja parashikohet në Ligjin 111/2012[77] por zbatimi i tij në terren mbetet jo-efektiv. Si rrjedhojë, sot ende ndeshemi me derdhjen e ujërave industriale apo urbane të patrajtuara në lumë.

Kontribuesit kryesore të ndotjes së lumenjve në Bashkinë Kuçovë sot janë:

- **Ujërat e zeza**: Shkarkimi i drejtpërdrejtë i tyre nga sistemi i grumbullimit të ujrave të ndotura në sipërfaqe ujore *(pa iu nënshtruar proceseve të pastrimit në impiantet e trajtimit të ujrave të ndotura),*
- **Venddepozitimi i mbetjeve të ngurta në afërsi të brigjeve të lumit Devoll** *(infiltrimi i shllameve dhe derdhje aksidentale të mbetjeve të ngruta në ujërat e rrjedhshme të lumit),*
- **Shkarkime të ujrave të industrisë dhe mbi të gjitha të industrisë së naftës,**
- **Ujërat e ndotura të bujqësisë,**
- **Shkarkimet e ujërave të larta** *(niveli i aciditetit në ujrat e shiut është gjithnjë e në rritje si edhe mikroorganizmat dhe mbetjet që mbartin si pasojë e shplarjes së pellgut ujëmbledhës).*
- **Shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve për materiale inerte.**

Secili prej burimeve të ndotjes ka një potencial specifik të ndotjes gjatë shpërhapjes së tij në trupin ujor dhe në mjediset pritëse të cilat bartin përfundimisht këtë ndotje (zakonisht grykëderdhjet). Këtu vlen të theksohet se pritësi kryesor i ndotjes së lumit Seman (bashkë

me Osumin e Devollin) është deti Adriatik. Për këtë arsye, në deltën e lumit Seman vërehen nivele të larta të ndotjes si nga cilësia e ujërave edhe nga mbetjet e ngurta.

Ndikimi fillestar që kanë këto ndotje të përmendura më lart është dëmtimi i ekosistemit të ujrave të rrjedhshme, si dhe modifikimi i cilësisë së tyre në aspektin përmbajtësor të elementeve ushqyese.

Ndotja nga venddepozitimet e mbetjeve urbane: Shërbimi i manaxhimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Kuçovë ofrohet nga firma private "Higjena", e cila bën grumbullimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit dhe depozitimin e tyre në vend-depozitimin e mbetjeve. Pika ndodhet përgjatë brigjeve të lumit Devoll, në Rreth Tapi, në një largësi 5.5 km nga qyteti i Kuçovës, i cili funksionon që prej vitit 1987. Në këtë vend-depozitim mbetjet shpesh herë ngjeshen dhe mbulohen me dhè, por ai është plotësisht i papërshtatshëm, pasi toka në këtë zonë është shumë aluvionale dhe mbetjet e lëngshme toksike (*shllamet*) depërtojnë lehtësisht në shtresat e nëntokës, duke shkaktuar ndotje jo vetëm në shtresat nëntokësore, por edhe ujërat nëntokësore e sipërfaqësore të lumit. Përpos fakteve të sipërpërmëndura, derdhje të drejtpërdrejta shkaktohen edhe në rrjedhën natyrale të Lumit Devoll. Pika ku takohet lumi Osum me Devoll duke i dhënë jetë Semanit me vend-depozitimin e mbetjeve, në vijë ajrore është rreth 2,7 km. Ndikimi në mjedis i këtij vend-depozitimi qartësisht ka një shtrirje shumë më madhe pasi perhapja e elementeve ndotëse, toksike dhe të dëmshme përcillet nga rrjedha e lumit Devoll dhe Seman.

Vend-depozitimi paraqet probleme të mëdha për sa i përket ndotjes së mjedisit dhe rrezikimit të shëndetit të banorëve për arsye të ndryshme. Së pari, ai ndodhet buzë lumit Devoll, në një largësi jo më tepër se *120m nga shtrati i lumit*, duke ndotur vazhdimisht ujërat sipërfaqësore të lumit Devoll. Për më tepër, pozicioni në të cilin ndodhet vend-depozitimi i Kuçovës është i papërshtatshëm nga ana gjeologjike për shkak se ndodhet në një territor me dhera të shkrifëta.

Duke patur referencë hartat dhe raportet e SHGJSH-së[78], i gjithë akuiferi i rrjedhës së lumit Devoll në Bashkinë Kuçovë është me përbërje aluvionale (zhavorrore dhe poroze). Një terren i tillë bën të mundur depërtimin e shllamit të mbetjeve në ujërat nëntokësore dhe më tej në ujërat e Akuiferit Quaternar të Beratit, i cili mund përdoret për furnizimin me ujë të popullsisë së fshatrave Kuçovë dhe për vaditjen e tokave bujqësore.

Krahas shllameve, ky vend-depozitim është burim ndotës për Lumin Devoll me materiale të ngurta nga mbetjet urbane, të cilat aksidentalisht shkarkohen mbi trupin ujor të lumit.

Ndotja nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane: Shërbimi i furnizimit me ujë dhe i sistemit të ujërave të ndotura në Bashkinë Kuçovë, prej mëse 25 vitesh e ofron vetëm pjesërisht shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura urbane në Kuçovë, Perondi dhe Tapi. Këto ujëra të ndotura shkarkohen në kanalin e hapur të quajtur "Dikatër" i cili përshkron tokën bujqësore për 4 km deri në pikën përfundimtare të shkarkimit në lumin Devoll. Pra, ujërat e zeza në Bashkinë Kuçovë shkarkohen pa asnjë trajtim paraprak të tyre, përveç trajtimit biologjik që mund të realizohet në disa seksione të kanalit të hapur nga vegjetacioni i rritur si pasojë e ujërave të eutrofikuar.

Në NjA-të e tjera shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura nuk ofrohet dhe si zgjidhje provizore kanë qënë dhe vazhdojnë të mbeten gropat septike pa kushte teknike të mbrojtjes

mjedisore dhe sanitare. Këto të gjithë shkarkohen më pas në rrjedhën më të afërt ujore ose në disa raste edhe në kanale të hapura.

Figura 48. Shkarkimi i ujrave të ndotura urbane në kanale e lumenj



Burimi: Inspektoriati Mjedisor Shqiptar

Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urban ka si qëllim primar të tij "rehabilitimin" e cilësisë së ujërave të ndotura në ato nivele ku ndikimi i tyre do të ishte sa më minimal për trupat ujore natyrore pritëse. Në Bashkinë Kuçovë aktualisht një impiant i tillë mungon ndaj të gjithë elementet ndotëse që mbartin këto ujëra shkarkohen në lumenj për t'u sedimentuar e infiltruar më pas në akuiferë. Një pjesë flokulojnë me rrjedhën ujore drejt ujrave detare të kripura.

Ndotje nga industria e naftës: Në Bashkinë e Kuçovës, industria e naftës është mjaft aktive. Aktivitetet përfshijnë nga shpimet për kërkim nafte deri në nxjerrje dhe përpunim të saj. Vetëm në qytetin e Kuçovës janë 313[79] puse ndër të cilët 103 janë jashtë funksionit dhe 210 janë ende në funksion. Ndërkohë që në total Kuçova regjistron rreth 1,800[80] puse nafte, prej të cilave 1,099 janë aktualisht në gjendje pune.

Në Kuçovë, ndotja e ujit nga industria e naftës nuk është e pazakontë. Një tregues i qartë dhe i pothuajse i pamohueshëm i ndotjes së burimeve ujore nga industria e naftës janë kanalet me ujë të ndotur nga nafta përpara aerodromit të Kuçovës. Uji i këtyre kanaleve është vazhdimisht i mbuluar me një shtresë të trashë nafte duke bllokuar kështu shkëmbimin e oksigjenit ndërmjet ujit të kanaleve dhe atmosferës. Nafta në ujin e kanaleve dhe lumenjve është shndërruar tashmë në një përbërës të përhershëm të ujit.

Industria e naftës ka operuar për më se 50 vjet. Megjithatë, monitorimi i lumenjve të Kuçovës është bërë për parametra të përgjithshëm dhe mikroelemente[81], ndërkohë që mungon monitorimi i parametrave të lidhur me përbërësit e naftës dhe kimikatet/aditivët që i shtohen ujit gjatë shpimit për shkrirjen e shtresës shkëmbore. Për këtë arsye, nuk njihet shkalla e ndotjes e shkaktuar nga industria e naftës, edhe pse nga të dhënat e mbledhura kohët e fundit, rezulton se kjo industri i shkarkon të gjitha ujërat e dekantimit në lumin Devoll. Shkarkimet nga industritë e përpunimit të naftës në trupa ujorë të rrjedhshëm janë ndoshta edhe më të shpeshta.

Ndotja nëpërmjet gropave ekologjike: Gropat ekologjike/vaskat e naftës në vendin tonë janë *landfill*e specifike ku depozitohen materialet e përdorura gjatë aktivitetit të nxjerrjes

së naftës. Zona e Kuçovës, edhe pse ka një aktivitet të theksuar të industrisë së naftës, sipas lejeve të mjedisit të lëshuara nga Ministria e Mjedisit në vitin 2014, nuk ka një gropë ekologjike në të cilën të grumbullohen ujërat e prodhuara gjatë aktivitetit të naftës së bashku me mbetjet e ngurta. Si rrjedhojë, supozohet se produktet e naftës janë hedhur së bashku me mbetjet urbane duke ndotur tokën dhe ujërat sipërfaqësore e nëntokësore.

Ndotja nga aktiviteti i shfrytëzimit të materialit inert nga shtrati lumenjve: Ndonëse ky aktivitet është trajtuar nga akte të ndryshme ligjore në funksion të mbrojtjes së territorit dhe mjedisit, si në Vendimin nr.1 të datës 21.06.2006 Për "Reduktimin e shfrytëzimit të inerteve në shtretërit e lumenjve," vihet re se firmat ndërtuese vazhdojnë edhe sot shfrytëzimin e inerteve nga shtretërit e lumenjve. Vlerësohet se 2,000km^2 inerte të shtretërve natyrorë të lumenjve në Shqipëri janë zhvendosur nga ekskavatorë për në lavatriçe të cilat gjenden jo larg nga shtretërit e lumenjve.

Në Kuçovë, një shembull i shfrytëzimit intensiv të inerteve vihet re në shtratin e lumit të Lapardhasë që përshkon të gjithë NjA-në Lumas. Ky shtrat i është nënshtruar aktivitetit intensiv të shfrytëzimit të inerteve dhe, si pasojë, modifikimit të vazhdueshëm të shtratit të tij. Humbjet e biotës ujore në këto raste janë maksimale, të cilat shoqërohen më pas me ndryshim rrënjësor të cilësisë së këtyre ujërave dhe në disa raste impakti më i ndjeshëm është ai i erozionit për formimin e shtratit të ri.

Figura 49. Foto nga rruga hyrëse për në NjA Lumas



Burimi: Akriva Co-PLAN, 2016

Ky fenomen është i pranishëm si fillim në Lumin Osum dhe Devoll dhe më pas në Seman. Ndikimi i parë që ka aktiviteti i shfrytëzimit të inerteve lumore në lumë është turbullimi i ujërave nga përzjerja dhe marrja i materialit inert. Shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e erozionit në bregdetin tonë, për shkak se sasia e inerteve që shkarkohen në det është ulur me ritme të shpejta duke i dhënë kështu lehtësi ujërave detarë të përparojnë drejt vijës bregdetare për të tërhequr në thellësi materialin inert të ngurtë bregdetar.

Ndotja nga ujërat e larta dhe sektori i bujqësisë: Këta janë faktorë me ndikim relativisht më të ulët krahasuar me burimet e lartpërmendura. Por, nëse marrim në konsideratë gjurmët e ndotjes së gjetur në ujrat e lumenjve tanë, prania e aciditetit të ujrave të shiut ka ndikuar në nivelin e pH në ujërat e rrjedhshëm. Ndotja e lumenjve nga ujërat e bardha vjen për arsye se këto ujëra grumbullojnë të gjitha llojet e ndotjes së mundshme që gjendet në territorin e pellgut ujëmbledhës të lumit dhe e trasportojnë atë nëpër degët e lumit e më pas e shkarkojnë në rrjedhën lumore.

Krahas ujërave të larta, përdorimi i ujërave të ëmbla në bujqësi, ku ndodh edhe përzjerja e tyre me kimikatet e përdorura në këtë sektor, gjeneron një nivel të konsiderueshëm ndotjeje, e cila kur bie në kontakt me biotën ujore shkakton shqetësime në florë dhe faunë, si pasojë e elementeve kimike të shpërbëra në këto ujëra.


- **Përfundime dhe rekomandime**

Kuçova ka burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit. Megjithatë, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Devollit të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e Bashkisë, nxorri në pah problematikat e këtij lumi të cilat vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumit nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Devollit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e lumit përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e Devolit të monitorohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje. Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Osumit, nga burim uji për bujqësinë, ky lumë mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. *Si rrjedhojë, është e nevojshme që Bashkia të ndërmarrë projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të ndotura të industrisë së naftës, ujërave të zeza, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë në ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe ndotjen e ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efiçent të tyre. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që Bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera që përshkohen nga Devolli dhe Këshillin/Agjencinë e Basenit Ujor të Semanit për hartimin e planeve ndërvendore për përdorimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore jashtë territorit të saj administrativ.*

- **Burimet ujore nëntokësore**[82]

Qarku i Beratit (i përbërë nga bashkitë Kuçovë, Urë Vajgurore, Poliçan, Berat e Skrapar) është i pasur me burime ujore nëntokësore (akuiferë). Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike. Si rrjedhojë, ata kanë kapacitete të ndryshme ujëmbajtës.[83] Akuiferët përbëjnë burimet kryesore të furnizimit me ujë për popullsinë, industrinë, bujqësinë dhe aktivitetet të tjera ekonomike në territorin e bashkive të reja të Beratit, Kuçovës dhe të bashkive përreth. Akuiferët kanë një shtrirje të gjerë në nënterritorin e bashkisë edhe pse është e vështirë të përcaktohet me saktësi sipërfaqja e tyre për shkak të studimeve të kryera në nivel rajoni[84].


Figura 50. Akuiferët në Bashkinë Kuçovë



Burimi: SHGJSH, 2014, Punoi: Co-PLAN, 2015

Akuferët janë të llojeve të ndryshme. Megjithatë, akuiferët ***ndërkokrrizorë*** dhe me ***çarje-karst*** përbëjnë burimet ujore kryesore për Bashkinë. Më poshtë sillet një përshkrim i shkurtër i akuiferëve kryesorë në Bashkinë Kuçovë.

Figura 51. Lloji dhe shtrirja e akuiferëve në Qarkun e Beratit



Burimi: SHGJSH, 2014; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor të shkrifët (Akuiferi Kuaternar i Beratit): Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor janë akuiferë që shtrihen kryesisht përgjatë shtratit të një lumi. Në Qarkun e Beratit ky akuifer lidhet me depozitimet kuaternare aluviale të formuara nga lumi Osum e Devoll. Shtrihet nga Kozara në Syzez në gjerësi, nga Uznova në Berat e Fier-Shegan. Në sipërfaqe zhavorret aluviale të kësaj lugine dalin vetëm *në zallishtoren e lumit Osum prej Uznovës deri në Moravë* dhe në hyrje të lumit Devoll *në zonën e Kozarës.* Në të gjithë pjesën tjetër të akuiferit, zhavorroret mbulohen me një shtresë subargjile. Më konkretisht, pjesa perëndimore e Bashkisë së Kuçovës (qyteti i Kuçovës, Kozarja dhe Perondia) ndodhet mbi Akuiferin e Beratit.

Burimi kryesor i ushqimit të ujërave nëntokësore të këtyre zhavorreve është vetë *lumi Osum dhe shumë pak shkëmbinjtë rrënjësorë* mbi të cilat vendosen depozitimet kuaternare. Depozitimet kanë *lidhje të mira hidraulike me ujërat sipërfaqësore*. Këto akuiferë kanë

kapacitetit të lartë ujëmbajtës. Për këtë arsye shërbejnë si burim kryesor për furnizimin me ujë të Bashkive Berat, Kuçovë, Urë Vajgurore dhe fshatrave përreth.

Akuiferët me porozitet çarje-karst (Akuiferi i Luzajt): Shtrihen në sipërfaqe gëlqerore, karstike në masive malore të ndryshme. Në Berat ky akuifer përfaqësohet nga Akuiferi karstik i Tomorrit (në Malin e Tomorrit), Akuiferi karstik i Shpiragut (Shpiragu), Akuiferi Karstik i Luzajt, dhe Akuiferi i Micionit. Në të gjithë akuiferët fenomeni i karstit është shumë i zhvilluar dhe kapaciteti ujëmbajtës është i lartë. Zakonisht, ujërat e akuiferëve karstikë janë të një cilësie të mirë ose shumë të mirë.

Në territorin e Bashkisë së re të Kuçovës, akuiferi me çarje-karst gjendet në zonën veri-lindore të Bashkisë dhe përfaqësohet me Akuiferin e Luzajt. Në thellësi, ky akuifer vazhdon si në drejtim të veriut ashtu dhe të lindjes e perëndimit. Nga pikpamja hidrogjeologjike ky akuifer klasifikohet me ujëmbajtje të lartë megjithëse vetëm *Burimi i Sinecit* del me prurje të mëdha.

- **Problematikat e Pellgjeve Ujore Nëntokësore**

Në njëzet vitet e fundit, vendi ynë ka njohur një rritje të lartë të numrit të popullsisë, shtrirje të urbanizimit në zona dikur të pamundura, zhvillim të sektorit të bujqësisë dhe zhvillim e diversifikim të industrisë pothuajse në të gjithë territorin. Si rrjedhojë, kërkesa për ujë të pijshëm nga popullsia dhe për përdorim nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë (kryesisht bujqësia dhe industria) është shtuar duke ushtruar një presion të jashtëzakonshëm mbi lumenjtë dhe akuiferët[85].

Për më tepër, Bashkia e Kuçovës është zonë me veprimtari industriale të ndryshme, zhvillim të bujqësisë dhe urbanizim të vazhdueshëm që kanë çuar në ndotjen e lumenjve kryesorë (lumenjtë e Basenit të Semanit ku përfshihen dhe Osumi e Devolli). Ndotja e lumenjve ka sjellë si pasojë edhe ndotjen e burimeve ujore nëntokësore nëpërmjet depërtimit të ujërave të lumenjve nëpër akuiferë. Ndotja e akuiferëve që shërbëjnë për furnizimin me ujë të popullsisë përbën rrezik për shëndetin e njeriut dhe banorëve. Më poshtë paraqiten problemet kryesore të ujërave nëntokësore të Qarkut të Beratit (ndotja dhe mbishfrytëzimi) dhe në veçanti të Akuiferit të Beratit me shtrirje përgjatë lumenjve dhe të akuiferëve karstikë (të Tomorrit e Shebenikut).

Mbishfrytëzimi i ujërave/mungesa e njohjes së kapacitet ujor të shfrytëzuar: Akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst dallohen për një kapacit të lartë ujëmbajtës. Për këtë arsye, akuiferët shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi, në mënyrë të ligjshme dhe të jashtëligjshme[86]. Në vitet e fundit, shfrytëzimi i ujit të këtyre akuiferëve është bërë pa u bazuar në një plan menaxhimi, gjë që do të bënte të mundur shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Si rrjedhojë, ujërat e akuiferëve janë shfrytëzuar përtej kapacitetit furnizues. SHGJSH-ja[87]raporton se mbishfrytëzimi i akuiferëve në Qarkun e Kuçovës ka ardhur si rezultat i: i) shtimit të kërkesës për ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi sidomos në në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur burimet e ujërave nëntokësore janë në nivelet më minimale; ii) rritjes së numrit të shpimeve private ose të jashtëligjshme për shfrytëzimin e ujit për bujqësi dhe industri; iii) shfrytëzimit pa kriter të shumë shpimeve të vjetra dhe të reja të kryera në akuiferë me presion; dhe iv) ritmeve të larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.

Vetëm në Bashkinë e re të Kuçovës, sipas llogaritjeve të bëra kohët e fundit,[88] për plotësimin e nevojave të popullsisë së bashkisë me ujë nëpërmjet pus-shpimeve, shfrytëzohet një sasi prej 2308.7m^3 ujë/orë ndërkohë që kërkesa aktuale është 302m^3/orë. Pra, nga pus-shpimet ka një mbishfrytëzim total prej 2,010.4m3/orë[89]. Megjithatë, shifrat e sakta të shfrytëzimit të ujit të akuiferëve mungojnë për arsye se një pjesë e mirë e popullsisë nuk mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë. Mbishfrytëzimi ndodh në një kohë kur nga një total prej 31,262[90] banorë, rreth 13% e popullsisë (3,981) nuk kanë rrjet furnizimi me ujë të pijshëm. Zonat pa lidhje me rrjetin janë kryesisht zonat rurale dhe përfshijnë fshatrat e komunës Lumas[91].

Tabela 18. Fshatrat pa sistem furnizimi me ujë të pijshëm

Nr	Komuna	Fshati	Popullsia
1	Komuna Kozare	Demollare	153
2	Komuna Lumas	Luzaj, Zelevishde, Belesove, Mendrak, Sheqes, Krekes, Korites, Katundas	2,918
Total pa Rrjet			3,071

Burimi: VALUADD PLGP/USAID 2014[92]

Mungesa e shtrirjes së rrjetit të ujit të pijshëm në zonat rurale i detyron banorët që të gjejnë zgjidhje vetjake të cilat janë kryesisht hapja e puseve ose përdorimi i burimeve më të afërta të mundshme[93]. Këto burime apo pus-shpime, përveç se hapen pa u bazuar në studime të mirëfillta hidrogjeologjike, bëjnë të pamundur llogaritjen dhe kontrollin e sasisë së shfrytëzuar të ujit të akuiferëve[94].

Siç u theksua më sipër, përveç furnizimit me ujë të pijshëm, ujërat e akuiferëve ndërkokrrizorë dhe karstikë shfrytëzohen edhe për industri dhe bujqësi. Për fat të keq këto akuiferë shfrytëzohen gjerësisht edhe në mënyrë të jashtëligjshme[95]. Sasia e ujit që shfrytëzohet për çdo akuifer nga industria, bujqësia dhe sektorët të tjerë të ekonomisë nuk njihet. Ndaj mbetet urgjente krijimi i një pasqyre ujore për akuiferet (hyrje dhe dalje të ujit) me qëllim shfrytëzimin e ujit të akuiferit në mënyrë të qëndrueshme.

Ndotja e akuiferëve (Akuiferi i Beratit): Në Bashkinë e Kuçovës gjendet Akuiferi Kuaternar i Beratit i cili shtrihet nga Uznova deri në Urë Vajgurore dhe në Kozarë. Akuiferi i Beratit është një pellg i madh ujor nëntokësor që ushqehet kryesisht nga lumenjtë Osum dhe Devoll.

Lidhur me cilësinë e ujërave të këtij Akuiferi, fatkeqësisht nuk ka shumë të dhëna të viteve të fundit. Në vitin 2015 ky akuifer është përjashtuar nga rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore në shkallë vendi[96]. Ndërkohë, në vitin 2014, SHGJSH-ja raportonte se akuiferët ndërkokrrizorë të gjendur drejtpërdrejtë nën lumenjtë Devoll dhe Osum janë ndotur, kryesisht në zonën *Kozarë-Kuçovë*. SHGJSH-ja ka cilësuar ujërat e Akuiferit të Beratit në këtë zonë[97] si shumë të forta për shkak të fortësisë së përgjithshme që kalon nivelet e lejuara. Një zonë tjetër ku ujërat janë cilësuar të forta janë shpimet *Banaj dhe stacioni i pompimit Çiflig*. Duhet theksuar se fortësia e ujërave përbën rrezik për kripëzimin e tokave nëse uji përdoret për ujitje dhe rrezik për shëndetin e njeriut në qoftë se përdoret për t'u pirë (për banorët që furnizohen me ujë nga Akuiferi i Beratit).

Mundësinë e kanosjes së shëndetit të banorëve nëpërmjet funizimit me ujë nga ky akuifer në të shkuarë e tregon edhe fakti se ujërat e tij janë përdorur si ujëra me përdorim industrial.

Vetëm duke filluar nga viti 1998[98], ujërat e këtij akuiferi janë përdorur dhe *vazhdojnë të përdoren për furnizim me ujë të popullsisë së disa zonave të caktuara të qytetit të Kuçovës, si dhe NjA-ve Kozarë e Perondi* të cilat furnizohen nga puset e Devollit. Një gjë e tillë ndodh në një kohë që mungon tërësisht njohja e cilësisë së ujërave të këtij akuiferi dhe mbi të gjitha, të ndotjes nga industria e naftës ndër vite.

Në përgjithësi, ekziston mundësia që Akuiferi i Beratit të jetë ndotur nga industria e naftës gjatë gjithë viteve të aktivitetit të saj. Nga dixhitalizimi i territorit të Bashkisë Kuçovë rezulton se grupi i puseve të Kozarës dhe lumit Devoll kalojnë nëpërmjet këtij akuiferi gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Vetëm vendndodhja e puseve krijon mundësinë ndotjes së akuiferit në momentin më të parë që veshja e faqeve anësore të pusit nuk është bërë siç duhet.

Një faktor mjaft i rëndësishëm që duhet theksuar në lidhje me Akuiferin është *mungesa e monitorimit të ujërave të këtij akuiferi për ndotje në përgjithësi dhe për ndotje nga industria e naftës ndër vite*. Siç theksohet në seksionet e mëposhtme, industria e naftës ka vepruar në këtë territor për më shumë se 50 vjet. Duke parë se burimet e këtij akuiferi përdoren për furnizim me ujë të pijshëm dhe ujitje nga banorët vendas, është i domosdoshëm monitorimi i akuiferit për ndotje nga industria e naftës së trashëguar ndër vite.

Tabela 19. Ujësjellësit e Bashkisë Kuçovë dhe pus-shpimet e tyre

Nr.	Qyteti / Komuna	Ujësjellësi	Fshatrat e furnizuara	Nr. Pop.	Pus-shpimet: Vendndodhja
1	Qyteti i Kuçovës	U. i Bogovës (Kuçovës)	Qyteti i Kuçovës		Burimi i ***Bogovës*** rreth 37 km në JL të qytetit të Beratit, në Malin e Tomorit, 343m mnd
		U. i Devollit	Lagja 11 Janari, Kuçovë		Puset e ***Devollit****
	Kuçovë		Tapi, Drizë, Goraj, Velaglosht, Gegë, Polovinë		Fusha e ***Devollit*** me 3 puse 2 km në veri të qytetit të Kuçovës)
2	NjA-ja Kozarë	UK Berat-Kuçovë	Vlashuk, Gegë, Drizë, Frashër		
		U. Rajonal Kozarë	Havaleas, Kozarë, Feras Kozarë, Salcë Kozarë, Fier Mimar, Zdravë	5,050	Pus-shpim poshtë digës së ***Vlashukut***
		U. Vlashuk	Vlashuk	815	Pus-shpim pranë lumit ***Devoll*** në afërsi të fshatit Vlashuk
		U. Gegë	Gegë	2,040	Pus-shpim pranë lumit ***Devoll*** në lindje të fshatit Gegë
		U. Drizë	Drizë	804	Ujësjellësi i ***Devollit***
		Ujësjellësi Frashër	Frashër	334	Pus-shpim pranë lumit ***Devoll*** afër fshati Frashër
		U. Bogovës (Kuçovës)	Perondi, Tapi, Magjat	5,189	Burimet e Bogovës
		U. Magjat Fushë	Magjat Fushë	1,449	Pus-shpim afër Magjat Fushë

3	NjA-ja Perondi	U. i Devollit	Polovinë, Goraj, Rreth Tapi,Velagosht	3,087	3 pus-shpime pranë ***Devollit*** afër fshatit Polovinë
		Drizë, Devoll, Magjatë Kodër	**Drizë, Devoll dhe Magjatë Kodër**		**Pus-shpime të pavarura, me administrim nga vetë komuna**
4	NjA-ja Lumas	U. Bardhas	Bardhas	726	Pus-shpim pranë përroit në afërsi të fshatit Bardhas
		U. Lumas	**Lumas**	**1,580**	**2 pus-shpime pranë përroit rreth 1 km në veri të fsh. Lumas**
		U. Vodëz	**Vodëz**	875	Pus-shpim pranë përroit afër fsh. Vodëza e Poshtme Bardhas
		U. Pëllumbas	**Pëllumbas**	**785**	**Pus-shpim pranë përroit në afërsi të fshatit Pëllumbas**
		U. Pashtraj	Pashtraj	206	Pus-shpim afër fshatit Bardhas
		Të pavarur	**Sheqëz, Belesovë, Katundas, Zelevizhdë, Koritëz, Krekëz, Luzaj dhe Mendrak**	2,919	**Burimi më i afërt natyror**

Burimi: VALUADD PLGP/USAID 2014[99]: Punoi: Co-PLAN

Për shkak të rreziqeve që mund të paraqiten për jetën e banorëve nga përdorimi i ujit të këtij akuiferi në rast ndotjeje, SHGJSH-ja ka rekomanduar përfshirjen e Akuiferit të Beratit në rrjetin kombëtar të monitorimeve[100]. Njëkohësisht, rekomandohet në veçanti monitorimi i Akuiferit të Beratit me qëllim përcaktimin e ndotjes nga nafta gjatë 50-vjeçarit të fundit.

- **Burimet e ndotjes së Akuiferit të Beratit në zonën e Kuçovës**

Burimet e ndotjes së Akuiferit të Beratit me shtrirje në Bashkinë Kuçovë e Berat janë të shumta. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes.

Mungesa e zonave higjeno-sanitare: SHGJSH-ja përcakton mungesën e zonave higjieno-sanitare përreth pus-shpimeve si një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së akuiferëve. Këto zona mungojnë si përreth pus-shpimeve të ligjshme ashtu edhe përreth pus-shpimeve të paligjshme. Pus-shpimet e ligjshme janë të shumta dhe përdoren nga ujësjellësit e Bashkisë për furnizim me ujë të popullsisë dhe nga industria. Një numër i madh i tyre gjenden përgjatë luginës së Osumit dhe Devollit dhe pellgjeve ujëmbledhëse përkatëse.

Pus-shpimet e paligjshme gjenden gjatë gjithë territorit, sidomos në zonat rurale që nuk janë të lidhura me rrjetin e furnizimit të ujit (rreth 13% e popullsisë së Kuçovës nuk furnizohet me ujë të pijshëm)[101]. Uji sigurohet kryesisht nga vetë banorët duke përdorur burimin më të afërt të mundshëm[102] ose nëpërmjet pusshpimeve. Në Bashki ka edhe një numër pusshpimesh industriale, për të cilët nuk ka të dhëna rreth zonave të tyre industriale.

Lidhur me ndikimin e industrisë në cilësinë e ujërave të Akuiferit, duhet theksuar se mungojnë të dhënat, në veçanti numri i pusshpimeve, sasia e ujit që pompohet dhe gjendja e zonave higjieno-sanitare përreth pusshpimeve industriale etj. Përveç kësaj, në Bashkinë e Kuçovës mungojnë edhe të dhëna rreth përdorimit të ujit nëntokësor nga industria e naftës.

Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore në mënyrë jo profesionale si dhe të pakontrolluar si nga popullsia ashtu edhe nga industria rrezikon i) uljen e prurjeve në stacionet e pompimit si dhe ii) prishjen e cilësisë së ujërave të akuiferëve të Qarkut Berat duke rrezikuar seriozisht furnizimin me ujë të rrethit në tërësi.[103] Mbetet fakt se për asnjërin nga këto pus-shpime (individuale, të ujësjellësve apo industrial) pavarësisht nëse janë të ligjshme apo të paligjshme, nuk dihet nëse është zbatuar zona e mbrojtjes higjieno-sanitare. Mungesa e zonave higjieno-sanitare krijon mundësinë e ndotjes së akuiferit në një kohë shumë të shkurtër duke qenë se puset janë të lidhura drejtpërsëdrejti me akuiferin.

Ndotja e akuiferëve nëpërmjet lumenjve Osum e Devoll: Siç është theksuar më sipër, lumenjtë Osum e Devoll shërbejnë si burim ushqyes për akuiferët e shtrirë përgjatë rrjedhës së tyre. Kjo ndodh në segmente të caktuara të lumenjve, kryesisht në zonat ku zhavorroret e akuiferëve dalin në sipërfaqe. Në zallishtoren e lumit *Osum kjo ndodh prej Uznovës deri në Moravë* ndërsa në *zallishtoren e lumit Seman, në hyrje të lumit Devoll në zonën e Kozarës*[104]. Për këtë arsye, ndotja e të dy lumenjve mund të ketë pasoja të rënda për prishjen e cilësisë së ujërave të akuiferit. Mosmarrja e masave për mbrojtjen e lumit Osum dhe Devoll nga ndotja në njëzet vitet e fundit (bën të mendojmë se) mund të ketë shkaktuar ndotjen e këtij akuiferi.


Në fakt, duke qenë se ujërat e lumit Osum shërbejnë si burim për Akuiferin e Beratit dhe se rreziku i ndotjes së Akuiferit të Beratit me shtrirje përgjatë luginës së lumenjve Osum e Devoll në disa zona është i lartë (*nga Uznova deri në Moravë dhe në hyrje të lumit Devoll në zonën e Kozarës*)[105], ndotja e ujërave të Osumit e Devollit përbën element ndotjeje të Akuiferit. SHGJSH-ja[106] ka konfirmuar se Akuiferi i Beratit rrezikon ndotjen nëpërmjet vetë lumit Osum si pasojë e mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse në zonat e përmendura më sipër[107]. Për këtë arsye, keqmanaxhimi i mbetjeve të ngurta e të lëngëta si dhe mungesa e marrjes së masave për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore të Osumit e Devollit nga ndotja urbane dhe industriale mund të ketë shkaktuar ndotjen e akuiferëve përkatës të lumenjve.

Ndotja e shkaktuar nga mbishfrytëzimi i ujërave të akuiferit: Përveç mungesës së zonave higjieno-sanitare dhe ndotjes së lumit Osum e Devoll, SHGJSH-ja thekson se ndotja e ujërave të akuiferëve ndodh edhe për shkak të mbishfrytëzimit të ujërave të tyre. Ky mbishfrytëzim rrezikon të përkeqësojë cilësinë e këtij akuiferi për shkak se një veprim i tillë shton kripëzimin e ujit mbi normat e lejuara për pirje.

Ndotja nga industria e naftës: Zakonisht, një ndër rreziqet më të mëdha që i kanoset mjedisit nga industria e naftës është rreziku i ndotjes së akuiferëve. Fatkeqësisht, pastrimi i ujërave të akuiferëve është proces tejet i kushtueshëm, ose edhe i pamundur. Duke qenë se ujërat e akuiferëve lëvizin shumë ngadalë, atëherë duhen dhjetëvjeçarë përpara se një ndotës të pastrohet ose të migrojë në zona të tjera. Ky është rasti i nitrateve ose pesticideve e 1-2-3-Trichloropropane të cilat edhe pse të ndaluara për t'u përdorur që në vitin 1970, vazhdojnë të gjenden nëpër akuiferë[108].

Në Bashkinë e Kuçovës, industria e naftës është mjaft aktive. Vetëm në qytetin e Kuçovës janë 313 puse, ndër të cilët 103 janë jashtë funksionit dhe 210 janë ende në funksion.[109] Një pjesë e mirë e puseve kalojnë drejtpërdrejt në Akuiferin Quaternar të Beratit.

Figura 52. Harta e puseve të naftës dhe akuiferëve në Qytetin e Kuçovës dhe në Devoll/Kozarë



Burimi: SHGJSH, Përpunoi: Co-PLAN; 2016

Ndërsa ndotja e ujrave sipërfaqësore nga nafta është e dukshme, ndotja e ujërave nëntokësore është vështirë që të përcaktohet, për shkak të mungesës së të dhënave ose të dhënave të pakta e jo të plota. Teorikisht, industria e naftës, për vetë natyrën e aktivitetit të saj, gjatë zhvillimit të aktiviteteteve të industrisë mund të ndotë akuiferët në disa mënyra në rast se nuk merren masat e duhura teknike për mbrojtjen e tyre. Më konkretisht, industria e naftës mund të ndotë nëpërmjet i) pus-shpimeve, ii) teknologjisë së përdorur, dhe iii) puseve të ri-injektimit të ujërave shtresorë. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i mënyrave kryesore të ndotjes së ujërave nga industria e naftës.

a) Ndotja nëpërmjet pusshpimeve.

Me qëllim shmangien e ndotjes së tokës dhe ujërave, puset e naftës vishen me me shtresa të ndryshme (*well cases*), ndër të cilat edhe një shtresë që shërben për parandalimin e rrjedhjeve të pusit dhe depërtimin e tyre në rrethinat e tij (në tokë ose ujë) gjatë aktivitetit naftënxjerrës[110]. Për të njëjtin qëllim, kur puset dalin jashtë funksionit, si në rastet kur kompania vendos se nuk janë me leverdi ekonomike, puset mbyllen dhe izolohen.

Në rastet kur puset shpohen në thellësi në prani të një akuiferi, siç ka ndodhur në Kuçovë ku puset janë në Akuiferin Quaternar të Beratit, puset e naftës kalojnë nëpër akuifer duke e ndotur atë me ujë të kripëzuar (me kripëra /substance kimike të ndryshme), hidrokarbure dhe materiale të tjera toksike. Cili është ndikimi i puseve të indutrisë së naftës në këtë akuifer në Berat e Kuçovë, dhe në zona të tjera në vendin tonë, mbetet ende e panjohur për shkak të mungesës së të dhënave. Megjithatë, ***ekziston mundësia që Akuiferi i Beratit në Kozarë të jetë ndotur nga industria e naftës nëpërmjet puseve që kalojnë në të.*** Siç u tha më sipër, nga dixhitalizimi i territorit të Bashkisë Kuçovë rezulton se grupi i puseve në Kozarë kalon nëpërmjet këtij akuiferi gjatë ushtrimit të aktivitetit naftënxjerrës. Vetëm vendndodhja e puseve krijon mundësinë e ndotjes së akuiferit në momentin më të parë që veshja e faqeve anësore të pusit nuk është bërë sipas standardeve teknike dhe nuk është marrë parasysh parimi i parandalimit dhe mbrojtjes së burimeve ujore gjatë shpimeve. Mundësia e ndotjes vërtetohet edhe nga fakti se një sërë pusesh që kalojnë në këtë akuifer kanë teknologji të vjetër e cila nuk garanton një izolim të mirë të puseve.

Për më tepër, ***në vendin tonë mungon edhe legjislacioni i posaçëm që rregullon hapjen e puseve pranë ose në akuifer*** gjë që mund të ketë stimuluar kompanitë të anashkalojnë rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore. Në vendin tonë, mbrojtja e ujërave nëntokësore nga ndotja parashikohet në Ligjin nr. 111/2012.[111] që përcakton Shërbimin Gjeologjik Shqiptar si autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e burimeve ujore deri në një nivel të caktuar. SHGJSH-ja përcakton masat për ruajtjen e rezervave ujore nëntokësore si dhe miraton dhënien e lejeve për pus-shpime në ujërat nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës. Megjithatë, asnjë ligj nuk shprehet në lidhje me mbrojtjen e Akuiferëve nga pus-shpime e tipit industrial (instalime të përhershme siç janë puset e naftës), duke lënë kështu hapësirë për abuzime. E gjithë kjo ndodh në kundërshtim me ligjet dhe praktikat e vendeve më të zhvilluara. Në SHBA, për shembull, përpara se një kompani të fillojë aktivitetin e saj për nxjerrjen e prodhimin e naftës, prodhimin e energjisë gjeotermale dhe nxjerrjen e mineraleve, kërkon leje për përjashtimin e akuiferit më të afërt nga lista e trupave ujorë të përdorur për furnizimin e popullsisë për ujë të pijshëm në të tashmen dhe të ardhmen[112]. Në këtë mënyrë, shmangen rreziqet që i kanosen shëndetit të banorëve që furnizohen me ujë nga ky akuifer, nuk ndiqet penalisht për dëmtimin e akuiferëve, dhe sigurisht nuk vepron në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve Ujore të Përdorura për Furnizim të Popullsisë me Ujë.[113] Mbetet fakti se akuiferi i përjashtuar nuk shërben më si burim ujor për pije.

b) Ndotja e akuiferit nëpërmjet *teknologjisë* së përdorur (shpimi *horizontal / puse me trungje horizontale, ose puse me drejtim të caktuar)*

Në Bashkinë e re të Kuçovës akuiferët gjenden në zonën naftë-nxjerrëse (p.sh. përgjatë Devollit në Kozarë). Duke qenë akuiferë kuaternarë të shkrifët, këta kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ujërat sipërfaqësore. Si rrjedhojë, janë shumë të ndjeshëm ndaj ndotjes mjedisore nga pus-shpimet për ujë, naftës, ri-injektimit të ujërave shtresore si dhe mbetjeve të industrisë së naftës etj. Industria e naftës shpesh është akuzuar për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore sidomos gjatë përdorimi të teknologjisë së quajtur *plasje e shkëmbinjve me ujë*[114] e shoqëruar me teknika të reja të kohëve të fundit që janë kryesisht shpimi *horizontal / puse me trungje horizontale, ose puse me drejtim të caktuar*[115]. Sipas EPA-s në SHBA:

> *Procesi i plasjes me ujë krijon çarje në shtresën shkëmbore të cilat bëjnë të mundur daljen e naftës dhe gazit, duke rritur kështu volumin e naftës që mund të nxirret. Puset shpohen me trung vertikal nga 100 deri në mijëra metra nëntokë, dhe mund të përfshijnë puse me trungje horizontale ose me drejtim të caktuar që shtrihen me mijëra metra. Çarjet krijohen duke hedhur sasi shumë të mëdha lënde të lëngshme me presion të lartë në vrimën e një pusi të shpuar enkas dhe në shkëmbinjtë ku ndodhet nafta. Lënda e lëngshme (ose uji siç quhet shpesh) përbëhet kryesisht nga ujë, propant dhe kimikate që përdoren për të hapur dhe zgjeruar plasjet e krijuara në shkëmb. Këto plasje mund të jenë me qindra metra të gjata. Propantët përfshijnë rërë, peletë qeramike, ose pjesëza të tjera të pashtypshme. Propantët shërbejnë për të mbajtur hapur (për të mos lejuar mbylljen) çarjet e krijuara. Pasi mbaron procesi i hedhjes së lëndës së lëngshme (ujit me kimikatet në pus), trysnia e brendshme e shtresës shkëmbore shtyn lëndën e lëngshme që të dalë në sipërfaqe nëpërmjet pusit të shpuar. Ky ujë që del njihet si ujë i prodhur (kthyer) dhe në përbërjen e tij mund të gjenden edhe i) kimikatet e shtuara përpara injektimit dhe*


ii) materialet që ndodhen natyrshëm në shtresën shkëmbore si kripëra të ndryshme, metale, hidrokarbone, rodionuklide etj.

Uji shtresor ose uji i kthyer magazinohet në vend në kontenierë të mëdhenj ose në gropa ekologjike në pritje për t'u trajtuar ose ricikluar. Në shumë raste, ky ujë shpesh ri-injektohet[116]*. Në zonat ku ri-injektimi nuk është i mundur, uji i kthyer mund të trajtohet nga një impiant i trajtimit të ujërave dhe më tej të shkarkohet në ujëra sipërfaqësorë.*

Kjo teknikë është përdorur që në vitet 1940, dhe për më se 50 vjet është përdorur në puse me trungje vertikale në shtresa shkëmbore konvencionale. Sot, kjo teknikë përdoret përsëri në të njëjtat shtresa shkëmbore. Megjithatë, kohët e fundit teknika ka avancuar. Zhvillime të teknikave si shpimi horizontal ose shpimi me drejtim të caktuar kanë çuar në shpimin e shtresave shkëmbore të pazakonta për nxjerrjen e naftës të cilat nuk janë shfrytëzuar deri më sot. Pa këto teknika, kërkimi dhe shpimi për naftë në këto zona nuk do të ishte me fitim.

Burimet e naftës që përkojnë me akuiferin ndërkokrrizor në Kuçovë shfrytëzohen kryesisht nga Kompanitë Albpetrol dhe Bankers Petroleum Ltd. Bankers ka deklaruar se deri në vitin 2014 ka arritur të shpojë 536 puse.[117] Duke patur si qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë operacionale të shpimit, uljen e shpenzimeve dhe rritjen e kompanisë në të ardhmen, kompania ka futur edhe teknologji të reja të patestuara më parë në vendin tonë siç është teknologjia e shpimit horizontal për nxjerrjen e naftës (*primary horizontal drilling*) dhe ajo e plasjes me ujë dhe polimer (*water and polymer flooding*). Në vitin 2015, Bankers planifikonte edhe hapjen e rreth 60 puseve horizontale të reja (*horizontal wells with a two-rig program*) si vazhdim i shfrytëzimit të fushës Patos-Marinëz.

Figura 53. Zonat me shpim horizontal (majtas) dhe teknologjia e përmbytjes me polimer dhe ujë djathtas (Water and Polymer Flooding)



Burimi: Bankers Petroleum Ltd., (Printscreen 30 Mars 2016)[118]

Sipas kompanisë, *Shpimi me plasje me ujë dhe polimer* konsiston në hedhjen e ujit ose të një kimikati në rezervuarin e naftës e cila ka si qëllim të shtyjë naftën drejt pusit. Kjo teknologji njihet si teknologji që bën të mundur rekuperimin efiçent të naftës në rezervarët nëntokësorë. Zakonisht kjo është një teknologji që përdoret pasi pjesa më e madhe e naftës është nxjerrë nga rezervuari.

Ndërsa teknika e plasjes së shtresës shkëmbore me ujë është vërtetuar të jetë tejet efikase për nxjerrjen e naftës dhe gazit edhe në zona dikur të pamundura[119], kjo teknologji është

akuzuar edhe për *ndotjen e ujërave nëntokësore.* Në fakt, pas kërkimesh shumëvjeçare, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit (EPA) në SHBA ka arritur në përfundimin se një teknikë e tillë përdor disa mekanizma "mbi tokë dhe nëntokë, nëpërmjet të cilëve nxjerrja e naftës me plasje me ujë mund të ndikojë në ndotjen e burimeve ujore të pirjes". Këto mekaniza përfshijnë:

- Rrjedhjen e lëndës së lëngshme dhe të *ujit shtresor* gjatë aktivitetit;
- Plasjen e drejtpërdrejtë në burime ujore nëntokësore;
- Migrimin nëntokësor të ujit shtresor dhe gazrave;
- Përdorimin e ujit në kohëra (ose në zona) kur uji nuk është i bollshëm;
- Trajtimin e papërshtatshëm të ujërave industriale dhe shkarkimeve të tyre në burime ujore.

Ndërkohë që EPA dhe agjenci të tjera nëpër botë vazhdojnë ta studjojnë këtë teknikë me qëllim shmangien e ndotjes së ujërave nëntokësore, në vendin tonë një shqetësim i tillë ende nuk është ngritur. Si rrjedhojë, ende nuk ekzistojnë të dhëna rreth aktivitetit të naftës lidhur me këtë teknologji dhe ndikimit e saj në Bashkinë Kuçovë dhe bashkitë e tjera ku është e pranishme industria e naftës. Pra, deri më tani mungon *një inventar i kompanive të naftës që përdorin një teknikë të tillë; një inventar i puseve që përdorin një teknikë të tillë, regjistër i sasisë së ujërave të përdorura gjatë shpimit (ujit shtresor); një regjistër i puseve ku ri-injektohet uji shtresor dhe një studim nëse ri-injektimi është i mundshëm, në përputhje me ligjet për mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore, i incidenteve që kanë bërë të mundur rrjedhjen e ujit shtresor në mjedis gjatë aktivitetit, i puseve ku është plasur drejtpërdrejt në akuifer, i rasteve të migrimit të ujit shtresor dhe gazrave në mjedis etj.*

Në të njëjtën kohë, problemit të ndotjes së ujërave nga industria e naftës nuk i kushtohet vëmendja e duhur. Kjo vërtetohet edhe nga mungesa e një legjislacioni dhe një institucioni specifik që ka si objektiv kryesor mbrojtjen e nëntokës, ose të ujërave nëntokësore nga industria e naftës[120]. Për këtë arsye, në mungesë të të dhënave të mësipërme, është e pamundur të përcaktohet qartë dhe në mënyrë sasiore rreziku që mund t'iu kanoset banorëve që furnizohen me ujë nga ky akuifer.

c) <u>Ndotja e ujërave nëntokësore nëpërmjet puseve të ri-injektimit të ujërave shtresorë.</u>

Gjatë prodhimit të naftës dhe gazit, prodhohet një sasi e konsiderueshme ujërash të ndotura të cilat mund të përmbajnë edhe metale helmuese dhe lëndë radioaktive[121]. Shpesh, këto ujëra janë edhe më të kripura se ujërat e detit. Për këtë arsye, në qoftë se nuk manaxhohen siç duhet, përbëjnë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut[122].

Duke filluar që në vitet 1930,[123] këto ujëra të ndotura zakonisht janë ri-injektuar në puse me qëllim shmangien e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë. Ri-injektimi i tyre nënkupton rikthimin ose hedhjen e ujit të dalë nga puset e naftës (ujit të prodhur dhe atij shtresor) pas shpimit ose gjatë prodhimit të naftës, përsëri në nëntokë. Ri-injektimi i ujërave të prodhuar nga industria e naftës është praktikë e ndjekur edhe sot.[124] Në Bashkinë Kuçovë, ri-injektimi është konfirmuar të ndodhë si praktikë nga Kompania Bankers. Edhe pse mungojnë të dhënat, nga biseda me naftëtarë rezulton se ri-injektimi është praktikë e zakonshme në vendin tonë. Krahas shpimeve, në vitin 2015, Bankers kishte planifikuar edhe kalimin e 20% të puseve në puse për ri-injektim.

Për shkak të rrezikut që paraqet për ndotjen e ujërave nëntokësore, [125] ri-injektimi rregullohet me ligj.[126] Fatkeqësisht, në vendin tonë ri-injektimi nuk rregullohet me ligj. Si rrjedhojë, kompanitë nuk janë të detyruara të ndjekin rregulla specifike gjatë ri-injektimit përveç praktikave të mira të kompanisë. Për këtë arsye, mund të thuhet se në Bashkinë e Kuçovës mbetet i panjohur, së paku për publikun dhe bashkinë: i*) numri dhe vendndodhja e puseve të ri-injektimit të ujërave të përdorura, ii) gjendja dhe kushtet e puseve të ri-injektimit, iii) ndikimi i tyre në Akuiferin e Beratit dhe në trupa e tjerë ujorë sipërfaqësorë e nëntokësorë etj*

- **Përfundime dhe rekomandime**

Në përgjithësi, ekziston mundësia që Akuiferi Quaternar i Beratit të jetë ndotur nga industria e naftës gjatë viteve të aktivitetit të saj. Nga dixhitalizimi i territorit të Bashkisë Kuçovë rezulton se grupi i puseve të Kozarës dhe lumit Devoll kalojnë nëpërmjet këtij akuiferi gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Vetëm vendndodhja e puseve krijon mundësinë e ndotjes së akuiferit në momentin më të parë që veshja e faqeve anësore të pusit nuk është bërë siç duhet.

Një faktor mjaft i rëndësishëm që duhet theksuar në lidhje me Akuiferin është mungesa e monitorimit të ujërave të këtij akuiferi për ndotje nga industria e naftës ndër vite. Industria e naftës ka vepruar në këtë territor për më shumë se 50 vjet. Duke parë se burimet e këtij akuiferi përdoren për furnizim me ujë të pijshëm dhe ujitje nga banorët vendas, është i domosdoshëm monitorimi i akuiferit për ndotje nga industria e naftës së trashëguar ndër vite dhe njëkohësisht ndalimi i përdorimit të ujërave të këtij akuiferi për furnizimin e popullsisë me ujë deri në momentin që nuk është vërtetuar se ujërat e këtij akuiferi janë të një cilësie të mirë. Ndotja e Akuiferit Quaternar të Beratit nëpërmjet pus-shpimeve në vendburimin e naftës në Kuçovë mund të përbëjë problem të jashtëzakonshëm për furnizimin me ujë të popullsisë në Bashkinë Kuçovë e Berat që furnizohen me ujë nga ky akuifer.

Si përfundim, përveç lumenjve, Bashkia përballet me problemet që kanë të bëjnë me Akuiferin e Beratit dhe, mbi të gjitha, me përcaktimin e llojit të përdorimit të ujërave të këtij akuiferi. Duke parë teknologjinë e vjetër dhe të papërshtatshme për mbrojtjen e burimeve ujore që Industria e naftës ka përdorur në të shkuarën dhe teknologjinë e re që është futur për shpimin e puseve në vendin tonë këto vite, është e rëndësishme që të ndërpritet menjëherë furnizimi me ujë i popullsisë nga Akuiferi i Beratit (puset e Devollit) dhe të merren masa të menjëhershme për monitorimin specifik të ujërave të akuiferit, me qëllim që të përcaktohet nëse ujërat e tij janë ende të përshtatshme për furnizimin me ujë të popullsisë së Beratit e Kuçovës.

- **Ajri**

Cilësia e ajrit në teritorin e Bashkisë Kuçovë është e ndryshme në sajë të përdorimit të tokës dhe përqëndrimit të aktiviteteve të nxjerrjes së naftës, në qytet vlerat e elementëve ndotës paraqiten relativisht të larta, ndërsa në disa zona rurale cilësia e ajrit është e mirë.

Sipas ARM-së Berat 2014, monitorimi i cilësisë së ajrit në qytetin e Kuçovës është realizuar për një periudhë prej 9 ditësh (22 -30 dhjetor 2014), për pesë treguesit kryesor si: PM_{10}, SO_2, CO, O_3 dhe Benzen.[127] Monitorimi është realizuar me pajisje automatike, ku për indikatorët NO_2 dhe O_3 të dhënat rregjistrohen për 30 minuta, kurse për SO_2 të dhënat

regjistrohen për çdo 5 minuta, ndërsa për PM_{10} llogariten ditore dhe monitorimi realizohet me metoden gravimetrike, me peshim ë filtrit para dhe pas mostrimit.


Nga rezultatet e monitoruara nga ARM-ja Berat 2014, vihet re se ka një tejkalim të vlerave të PM_{10}krahasuar me normën ditore të BE (5 nga 9 ditë të monitoruara).

Vlerat orare të NO_2 paraqiten më të larta se norma e BE-së mbi përqendrimin e tij në ajër, vlera maksimale e arritur është 85.8 $\mu g/m^3$ (23.12.20014), ndërsa ajo minimale minimale arrin në 1.07$\mu g/m^3$ (28.12.2014).

Gjithashtu edhe Benzeni paraqitet me vlera mbi normën e lejuar nga BE-së në vlerat orare. Vlera maksimale arrin në 12.16 $\mu g/m^3$ e rregjistruar më datë 26.12.2014, nërsa vlera më e ulët është regjistruar më 28 dhjetor 2014 me vlerën 0.11 $\mu g/m^3$.

Rezultatet tregojnë se për SO_2, O_3, dhe CO nuk kemi asnjë rast të tejkalimit të normave.

Figura 54. Vlerat ditore të treguesve të monitoruar në vitin 2014



Burimi: ARM Berat 2014, Punoi: Co-PLAN

Marrë si reference të dhënat e mësipërme të cilat tregojnë se ka tejkalim të normave të elementëve ndotës në ajër, mund të themi se faktor në këtë situatë, krahas shkarkimeve në atmosferë nga industritë, mjetet e transportit publik dhe privat si dhe nga ndërhyrjet infrastrukturore, është edhe niveli i ulët në gjelbërimin dhe hapsirave për rekreacion të cilat kryejnë, ndër të tjera, edhe funksionin e filtrimit të ajrit të ndotur dhe prodhimin e sasive të vogla të O_2 me rëndësi në cilësinë e ajrit në qëndrat urbane.

Hapësirat e gjelbra ose bimësia urbane, siç quhet shpesh në literaturë [128], ndikojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Konkretisht, bimësia urbane ndikon në uljen e ndotjes nëpërmjet thithjes së ndotësve në gjendje të gaztë nga gjethet e tyre. Krahas filtrimit të ajrit të ndotur, hapsirat e gjelbra shërbejnë dhe janë faktor në mbrojtejen e tokës dhe shëndetit publik.

Sipas të dhënave mbi gjelbërimin, sipërfaqa e gjelbër për banor në zonat urbane është më e vogël se standardi edhe pse Bashkia ka hapsira të mjaftueshme për të arritur standartet e nevojshme të gjelbërimit të përgjithshëm publik dhe gjelbërimit të veçantë. Gjelbërimi në nivel njësie strukturore është $0m^2$/banorë kundrejt $2m^2$ që është standardi.

Një situatë e ngjashme paraqitet lidhur me gjelbërimin masiv ($2.8m^2$/banorë kundrejt 4 që është standardi) dhe me gjelbërimin rrugor, sheshet, brigjet ujore dhe zonat urbane. Vetëm në zonat periferike vihet re që sipërfaqa e gjelbër është ose tejkalon standardet.

- **Burimet e ndotjes së ajrit**

Siç u theksua më sipër, burimet e ndotjes së ajrit janë të ndryshme (urbanizimi, mjetet e transportit, industria e naftës etj.). Megjithatë, në Bashkinë Kuçovë, ndotja nga makinat dhe industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës mbeten burimet kryesore. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes së ajrit në Kuçovë.

Ndotja nga mjetet e trasportit: Sipas të dhënave nga Bashkia Kuçovë, ndikim të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në mjedis në territorin e Bashkisë kanë mjetet e transportit të cilat shkarkojnë në ajër një numër të konsiderueshëm gazrash të dëmshme. Ndër gazrat kryesore renditen:

- monoksidi dhe dioksidi i karbonit (CO dhe CO_2 përkatësisht);
- substancat sulfurike (SOx);
- lënda e ngurtë pezull e përmasave të ndryshme (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ kryesisht);
- THC (sasia totale e shkarkimeve në ajër të hidrokarbureve);
- përbërësit organikë të avullueshëm (VOC).

Sasia e ndotësve që makinat shkarkojnë në ajër është e konsiderueshme. Nga llogaritjet e Agjencisë Amerikane të Mjedisit, një makinë e tonazhit të vogël (makinat për transport njerëzish deri në 12-vendëshe) shkarkon rreth ***5 ton CO_2 në vit*** (4.7metric tons)[129]. Kjo shifër vlen për makinat e prodhuara mbas vitit 2008 dhe me teknologji të përparuar. Nisur nga këto shifra, llogaritja e sasisë së ndotjes për 1 litër lëndë djegëse paraqitet si më poshtë.

Figura 55. Sasia e CO2 që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë



Lënda djegëse	Gallon	g/Gallon	g/Liter
Benzinë	1	8,887	2,347.70
Naftë	1	10,180	2.689.27


Burimi: US EPA, 2016

Sasia e ndotësve që shkarkohet në ajër nga një makinë e vogël individuale/pasagjerësh varet nga një sërë faktorësh që janë lloji dhe përmasat e makinës (makinë e vogël, autobus urban, kamion etj.), mosha dhe kilometrazhi, lloji i lëndës djegëse që përdor, kushtet atmosferike (shi apo diell etj.), gjendja e makinës, mënyra e drejtimit të makinës etj.[130] Në rast ndryshimesh të këtyre kushteve, shkarkimet në ajër shtohen. Por, duhet patur parasysh se llogaritjet e mësipërme janë bërë për makina me teknologji më të zhvilluar se një pjesë e mirë e automjeteve që përdoren në Shqipëri, dhe për cilësi më të mirë të lëndës djegëse (shih seksionin e mëposhtëm). Për rrjedhojë, sasia e gazrave të shkarkuara nga një makinë në Shqipëri mund të jetë më e lartë se shifrat e sjella më sipër.

Rritja e numrit të makinave: Numri i makinave ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit në mënyrë të theksuar në rang vendi. Nëse në vitin 2000 numëroheshin rreth 55 makina /1,000 banorë, në vitin 2010 numri i makinave në Shqipëri arriti 120.8 makina për 1,000 banorë[131]. Ndërkohë, në Bashkinë Kuçovë, numri i makinave të regjistruara është më i vogël se mesatarja kombëtare 54 makina/1000 banorë (INSTAT 2011) ose një total prej

1,701 makina në nivel Bashkie dhe 658 makina në Qytetin e Kuçovës. Numri i makinave në Bashkinë e Kuçovës për vitet 2015-2016 mungon.


Figura 56. Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite



Burimi: Ministria e mjedisit dhe UNDP, 2016[132]

Ndërsa numri i makinave për banorë ka ardhur duke u rritur në mënyrë të theksuar në vend, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me tren është ulur në mënyrë drastike. Nga statistikat e viteve 2005-2013,[133] ky numër ka pësuar rënie të ndjeshme.

Figura 57. Numri i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave që transportohen me tren në Shqipëri



Burimi: Ministria e Mjedisit dhe UNDP, 2016[134]

Me rritjen e numrit të makinave, rritet edhe sasia e shkarkimeve në ajër të ndotësve. Në rastin e CO_2, në qoftë se do të marrim për bazë shifrën 5 ton CO_2 në vit/makinë, sasia e CO_2 e shkarkuar në ajër vetëm nga mjetet individuale të transportit (makinat familjare) ***në nivel bashkie është rreth 8,505 ton CO_2/vit*** (1,701 automjete x 5 ton CO_2/automjet në vit = 8,505ton/CO_2/vit) ndërsa në nivel ***qyteti 3,290 ton CO_2/vit***. Pra, 38.6% e sasisë së gazrave të dioksidit të karbonit shkarkohet vetëm në Qytetin e Kuçovës.

Në vitet në vijim, ekziston mundësia që ndotja nga mjetet e transportit të shtohet për arsye se numri i makinave dhe investimet e Qeverisë Shqiptare në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (dhe jo në investime në zhvillimin e llojeve alternative si treni etj.) po shtohen. Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, rreth 55% e investimeve publike të Shtetit Shqiptar kanë shkuar për infrastrukturë rrugore[135]. Ndërkohë, transporti hekurudhor është lënë pas dore edhe pse Shqipëria është angazhuar për përmirësimin e tij në vitet në vijim. Në vitin 2006, Shqipëria nënshkroi Aktin e Stabilizim-Asociimit, i cili nënkupton rindërtimin e hekurudhës sipas kodeve dhe standardeve të BE-së[136]. Megjithatë, fondet për zhvillimin e trasportit hekurudhor mendohet të përftohen nga donatorët.

Ndotja nga cilësia jo e mirë e lëndës djegëse: Në vendin tonë, lënda djegëse për mjetet e transportit nuk është e mirë dhe kjo është e dukshme edhe vizualisht. Për më tepër, është vërtetuar edhe nga Inspektorati Qendror Teknik. Në periudhën janar-shtator 2014, Inspektorati Qendror Teknik (sipas të dhënave të publikuar nga AKM) ka monitoruar cilësinë e lëndës djegëse në vend, konkretisht të *naftës*[137], *benzinës dhe solar-mazutit*. Mostrat e analizuara për vlerësimin e cilësisë së ajrit janë marrë para zhdoganimit të lëndës djegëse dhe pas hyrjes në tregun e brendshëm shqiptar. Në total, janë analizuar 164 mostra, të ndara në tre grupe, 122 për naftën, 31 mostra për benzinën dhe 11 për solar-mazutin.

Figura 58. Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuara



Burimi: AKM (Inspektorati Qendror Teknik), Përpunoi: Co-PLAN[138]

Rezultatet e monitorimit të lëndës djegëse për naftën dhe benzinën janë paraqitur më poshtë: [139]

Tabela 20. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri

Vlerat e Sulfurit	Lënda djegëse			
	Gazoil		Benzinë	
	Mostrat (numër)	Mostrat (%)	Mostrat (%)	Mostrat (numër)
11-15ppm	6	4.9	16.1	5
16-20ppm	2	1.6	19.4	6
20-50ppm	14	11.5	29.0	9
>50ppm	100	82.0	35.5	11
Totali	**122**			**31**

Burimi: AKM (Inspektorati Qendror Teknik)[140]


Për naftën, nga 122 mostrat e analizuara, 82% e mostrave (100 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 11.5% e tyre (ose 14 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 6.5% e mostrave (8 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm. Në rastin e benzinës, nga 31 mostrat e analizuara, 35.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 129% e tyre (ose 9 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 3.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm.

Në bazë të standardit EN 590 për naftën dhe EN 228 për benzinën, vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në naftë është *10 ppm*. Nga analiza e mostrave të benzinës dhe naftës rezulton se përmbajtja e sulfurit është mbi vlerën e lejuar në të gjitha mostrat. Ndryshimi ndërmjet naftës dhe benzinës qëndron vetëm në vlerat më të larta të shkaktuara në ajër. Nafta ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë të sulfurit (82% kundrejt 35.5%). Përmbajtja e sulfurit ndryshon tendencë në rastin e grupimit 20-50ppm. Në këtë

rast është benzina që ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë squfuri (29% të mostrave të benzinës kundrejt 11.5 të gazoilit).

Si përfundim, në bazë të rezultateve të mësipërme rrjedh se të dyja llojet e lëndës djegëse që përdoren në vendin tonë (nafta dhe benzina) kanë përmbajtje të lartë të squfurit. Ndryshimi i vetëm qëndron në faktin se përmbajtja e squfurit në rastin e naftës arrin kufij më të lartë se sa në rastin e benzinës.

Figura 59. Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %)



Burimi: AKM (Inspektorati Qendror Teknik), Përpunoi: Co-PLAN[141]


Testime janë bërë edhe për Solar-Mazutin[142]. Të 11 mostrat e monitoruara rezultojnë me përmbajtje më të lartë squfuri (mbi 3%). Në bazë të standardit S SH UNI 6579, për analizimin e lëndës diegëse (gazoil), vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në gazoil është < 3%. Mostrat e analizuara rezultojnë se përmbajtja e squfurit është mbi 3%. Si përfundim, mund të thuhet se lënda djegëse (nënproduktet e naftës) që shitet në tregun shqiptar është e një cilësie jo të mirë.[143]

Veç kësaj, në përgjithësi, në Shqipëri preferohet përdorimi i naftës përkundrejt benzinës, për shkak të kostove relativisht më të ulëta. Sipas të dhënave të publikuara në Manualin e Kontrollit, Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Së Automjeteve, pergatitur nga ECAT[144], në seksionin e shkarkimeve në ajër nga automjetet raportohet se *87% e automjeteve në vend përdorin si lëndë djegëse naftën* dhe *13% benzinën.*

Ndotja nga mosha e vjetër e mjeteve të transportit: Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, Shqipëria ka rreth 350,000 makina, pjesa më e madhe e të cilave janë makina të përdorura[145]. Me rritjen dramatike të numrit të makinave dhe mbi të gjitha të numrit të makinave të vjetra, trafiku në zonat urbane është tashmë një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit.[146] Siç e theksuam edhe më parë, shkarkimet në ajër nga makinat shtohen edhe me rritjen e vjetërsisë së automjeteve për shkak se këto të fundit nuk arrijnë të bëjnë djegien e plotë të lëndës diegëse.

Sipas një studimi të kryer për automjetet në Tiranë, del se 36% e automjeteve me benzinë të prodhuara *para* vitit 1986 dhe 27% e atyre *pas* vitit 1986 shkarkojnë CO mbi normat e lejuara. Në rastin e automjeteve me naftë, pavarësisht nga viti i prodhimit, 39.7% e tyre i tejkalojnë normat e lejuara për koefiçentin K të tejdukshmërisë së lejuar, i cili është K 2.5.[147].

Figura 60. Numri i makinave (në %) që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër, sipas vitit të prodhimit



Burimi: ECAT 2008[148], Përpunoi: Co-PLAN

Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, mjetet me benzinë çlirojnë sasi më të mëdha CO dhe HC në ajër në krahasim me mjetet me naftë. Nga ana tjetër, mjetet me naftë çlirojnë më shumë grimca prej karboni elementar, përbërës organikë të karburantit dhe vajra lubrifikante të motorit, sulfate të formuara nga squfuri i karbonit dhe gjurmë përbërjesh metalike. Përbërësit organikë, zakonisht përbëjnë 10-30% të grimcave totale. Por, në motorat e vjetër, përbëjnë deri në 90%. Ky është rasti tipik i Shqipërisë ku shumica e motorave diezel janë prodhime të vjetra dhe pa pajisje të sistemeve mbrojtëse.[149]

Ndotja nga industria e naftës: Sektori i naftës përfshin aktivitetet të ndryshme industriale që fillojnë nga nxjerrja deri tek përpunimi dhe shitja si produkt përfundimtar tek konsumatori. Operacionet e prodhimit përfshijnë puset e shpimit, proceset e injektimit dhe ri-injektimit.Vendet e prodhimit, nuk përfshijnë vetëm vendet ku janë vendosur puset por dhe vendin ku nafta kondensohet, vendi ku nafta dhe uji që dalin nga pusi mund të ndahet, të depozitohet dhe të trajtohet. Sektori i prodhimit përfshin gjithashtu tubacionet me presion të ulët dhe me diametër të vogël që mbledhin dhe transportojnë

Gjatë nxjerrjes dhe përpunimit të naftës shkarkohen në ajër një shumëllojshmëri përbërësish organikë si metani (CH_4, një gaz i efektit serë i cili është 20 herë më i fuqishëm se dioksidi i karbonit CO_2), etani (C_2H_6), përbërësit organikë të avullueshëm (VOCs), një grup kimikatesh që kontribuojnë në formimin e ozonit të nivelit të tokës,smogut dhe ndotës organikë të rrezikshëm të ajrit (HAP)[150]. HAP-at më të zakonshme organike janë n-hekzan dhe përbërësit BTEË (benzene, toluene, etil-benzeni dhe ksileni). Sulfuri i hidrogjenit dhe SO_2 shkarkohet nga proceset e prodhimit dhe përpunimit, që merren dhe trajtojnë gazin e lëngshëm.

Në Bashkinë e Kuçovës, aktiviteti i industrisë së naftës përqëndrohet kryesisht në nxjerrjen dhe dekantimin e saj e cila shoqërohet edhe me shkarkimet në ajër të shumë nga gazrat e rrezikshme të përmendura më sipër. Ekspozimi ndaj këtyre shkarkimeve lidhet me një numër të lartë sëmundjesh përfshirë azmën në gjëndje të rënduar dhe vdekje të parakohshme.

Ndotja nga sektori i ndërtimit: Sipas të dhënave nga Bashkia Kuçovë, burim tjetër për ndotjen e ajrit janë edhe ndërtimet e reja në zona të ndryshme të qytetit, të cilat ndonëse janë të pajisura me VNM[151], ku përcaktohen qartë rregullat që duhet të ndjekin kantierët e ndërtimit, ndodh shpesh që punimet kryhen pa marrë masat e nevojshme dhe koha e ndërtimit është më e gjatë se sa është planifikuar. Në shumë raste, zonat e banuara janë pre

e pluhurit (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$) në ajër të shkaktuar nga kantieret e ndërtimit të ndërtesave dhe të ndërhyrjeve në infrastrukturë.

Vend-depozitimet e mbetjeve: Janë një burim i konsiderueshëm ndotës i ajrit, pasi nuk është në standardet e kërkuara teknike dhe higjieno-sanitare për depozitimin e mbetjeve. Depozitimi i mbetjeve kryesisht shkarkon në ajër gazin metan, i cili ka ka aromë të keqe dhe, në përqëndrim të lartë, është irritues dhe shkakton probleme në sistemin e frymëmarrjes dhe në sistemin nervor.

Sektori i bujqësisë: gjithashtu ka një kontribut të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në territorin e Bashkisë, kryesisht në çlirimin e gazrave gjatë shpërbërjes së mbetjeve organike dhe plehut organik.

- **Ndikimi i ndotjes së ajrit në shëndetin e njeriut**

Siç e pamë më sipër, makinat, industria etj., shkarkojnë në ajër një numër jo të vogël ndotësish me ndikim në shëndetin e njeriut. Ndër më kryesorët janë O_3, CO, CO_2, SO_x (SO_2), PM (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$), Pb, VOC dhe O_3. Më poshtë sillet një përmbledhje e rreziqeve që i kanosen shëndetit të njeriut nga çdo ndotës në veçanti. Vlen të theksohet se nuk është studiuar ndikimi në shëndetin e njeriut i efekteve që vijnë nga ndërveprimi i ndotësve së bashku (pasojat akumulative/grumbulluese).

Monoksidi i karbonit (CO)[152]: Ekspozimi ndaj përqendrimeve të larta të monoksidit të Karbonit mund të shkaktojë probleme akute me frymëmarrjen, helmim, humbjen e vetëdijes, vdekje, humbje ekulibri, dhimbje koke, dobësim të muskujve të përzjera dhe të vjella. Problem kritik ndaj ekspozimit të monoksidit të karbonit kanë gratë shtatëzëna tek të cilat mund të shkaktojë abort, të rrisë rrezikun e dëmtimit të fetusit, lindjen e foshnjës me peshë të ulët dhe dëmtim të sistemit nervor. Grupet më të ndjeshme ndaj helmimit nga monoksidi i karbonit janë fëmijët e vegjël, gratë shatëzëna, të moshuarit, njerëzit me anemi, njerëzit që vuajnë nga sëmundjet e zemrës dhe mushkërisë dhe përdoruesit e duhanit. Në afate të gjata, ekspozimi ndaj monoksidit të karbonit me vlera të ulëta, mund të shkaktojë lodhje, dhimbje gjoksi, humbje të kujtesës, sëmundje të zemrës, dëmtim të sistemit nervor, simptoma gripi dhe probleme me lëkurën në rastet kur mund të ketë kontakt me monoksidin e karbonit në formë të lëngët.

Dioksidi i karbonit (CO_2)[153]: Dioksidi i Karbonit ne formë e tij të gaztë është asfiksues për arsye se vështirëson furnizimin normal të trupit oksigjen gjatë frymëmarrjes, sidomos në hapësira të mbyllura. Ekspozimi në një mjedis me përqëndrim të $CO_2 \geq 10\%$ mund të shkaktojë vdekje, humbje ndjenjash, apo marrje mendsh. Gjithashtu ekspozimi ndaj një përqëndrimi të lartë të CO_2 mund të dëmtojë zhvillimin e fetusit. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj CO_2, në përqindje më të ulët se 10% mund të shkaktojë probleme me shikimin, bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, dëmtimin e sistemit nervor qëndror, kontraktimin e muskujve, ngritjen e tensionit të gjakut. Gjithashtu ekspozimi mund të shkaktojë marrje mendsh, dhimbje të vazhdueshme koke, djersitje të vazhdueshme, lodhje, mpirje, humbje të kujtesës, të përziera, të vjella, depresion, problem me lekurën, djegie të syve dhe zhurma në vesh.

SO_2[154]: Ekspozimi afatshkurtër ndaj niveleve të larta të SO_2 në ajër mund të jetë i rrezikshëm për jetën duke shkaktuar vështirësi në frymëmarrje dhe bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, sidomos për njerëzit me sëmundje të mushkërive. Ekspozimi afatgjatë ndaj

niveleve më të ulta të SO_2 mund të shkaktojë bronkit kronik, emfizemë, sëmundje të frymëmarrjes dhe mund të përkeqësojë sëmundjet ekzistuese të zemrës.

Kur dioksidi i squfurit reagon me kimikate të tjera në ajër, formon grimca të vogla sulfate. Këto grimca mund të mblidhen në mushkëri gjatë frymëmarrjes dhe të shkaktojnë rritjen e problemeve të frymëmarrjes dhe vështirësi në frymëmarrje. Ekspozimi afatgjatë ndaj grimcave sulfate mund të shkaktojë sëmundje të frymëmarrjes, madje edhe vdekje të parakohshme.

Të sëmurët me astmë janë shumë të ndjeshëm ndaj ekspozimit të dioksidit të squfurit, por edhe të njerëzit të cilët vuajnë nga sëmundjet e zemrës mund të përkeqësohen gjatë ekspozimit ndaj SO_2

PM (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$):[155] Është vërtetuar shkencërisht se përqendrimet e larta të grimcave në ajër (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$) paraqesin një kërcënim serioz për shëndetin e njeriut. Grimcat me diametër më të vogël në ajër shfaqin probleme të rënda në shëndet, pasi ato depozitohen në pjesët fundore të mushkërive dhe qëndrojnë aty për një kohë të gjatë ose depërtojnë në gjak. Ekspozimi në periudha të gjata ndaj lëndës së ngurtë në ajër shkakton rritjen e sëmundjeve të frymëmarrjes, ul funksionin e mushkërive, shkakton bronkit kronik, madje dhe vdekje të parakohshme për shkak të problemeve me frymëmarrjen. Grimcat e shkarkuara nga automjetet që përdorin lëndë diegëse diezel, janë vërtetuar të kenë ndikim në shtimin e mundësisë për t'u prekur nga kanceri.

Grupet e njerëzve më të prekur nga problemet shëndetësore që shkaktojnë grimcat janë fëmijët, të moshuarit dhe njerzit që vuajnë nga sëmundje të mushkërisë dhe zemrës.

Pb[156]**:** Sipas Agjencisë Amerikane të Mjedisit, plumbi mund të jetë lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut. Plumbi përbën rrezik për shëndetin e fëmijëve sepse mund të shkaktojë sistemin nervor në mënyrë të përhershme, dhe të shkaktojë sëmundje në veshka, zemër, dhe në sistemin riprodhues. Niveli i plumbit në gjak konsiderohet si shumë i rrezikshëm pavarësisht nga sasia e tij. Plumbi gjendet në formë inorganike si në lëndë djegëse, bojëra, kompjutera, bizhuteri, dhera dhe produkte të tjera, në miniera, që është edhe forma më e përhapur sot. Plumbi në trup merret nëpërmjet të ushqyerit apo frymëmarrjes.

VOC[157]**:** Ekspozimi afatgjatë ndaj komponimeve organike të paqëndrueshme mund të shkaktojë dëmtimin e mëlçisë, veshkave dhe sistemit nervor qëndror. Ndësa ekspozimi afatshkurtër mund të shkaktojë probleme në sy, acarim të rrugëve të frymëmarrjes, dhimbje koke, marrje mendsh, çrregullime vizuale, lodhje, reaksione alergjike të lëkurës, vjellje, dhe dëmtim të kujtesës.

O_3: Ekspozimi ndaj përqendrimit të lartë të Ozonit (O_3) mund të shkaktojë dëmtim të përhershëm të mushkërive, sidomos tek fëmijët, mushkëritë e të cilëve janë në zhvillim. O_3 mund të shkaktojë probleme me lindshmërinë dhe probleme gjenetike si dhe mund të rritë mundësinë e dëmtimit të fetusit. Ekspozimi ndaj këtij gazi mund të përkeqësojë sëmundjet kronike të mushkërive, të zvogëlojë sistemin imunitar, të përkeqësojë sëmundjet e astmës dhe ato të zemrës dhe të shkaktojë depozitime të lëngëta në mushkëri, duke vështirësuar ndjeshëm frymëmarrjen. Simptomat fillestare të ndikimit të O_3 në shëndet fillojnë me irritimin e rrugëve të frymëmarrjes, shkaktimin e kollës si dhe ndjesi shqetësuese në fyt dhe në gjoks. Futja e O_3 në organizëm nëpërmjet frymëmarrjes shkakton gjithashtu dhimbje koke, dhimbje stomaku si dhe lodhje dhe të vjella.

- **Përfundime dhe rekomandime**

Ndotja e cilësisë së ajrit në Bashkinë Kuçovë shkaktohet kryesisht nga mjetet e transportit, cilësia jo e mirë e naftës, industria e naftës dhe aktivitete të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë si industria dhe ndërtimet. Megithatë, transporti në zonat urbane dhe ndotja nga industria e naftës në zonat naftënxjerrëse mbeten burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Bashkinë Kuçovë.

Me qëllim shmangien e rrezikut që i kanoset banorëve nga ndotja e ajrit veçanarisht në zonat urbane dhe naftënxjerrëse rekomandohet planifikimi i zhvillimit të territorit duke zonuar territorin sipas përdorimit. Në zonat naftënxjerrëse me intensitet të lartë, rekomandohet shpërngulja e popullsisë në zona të tjera. Njëkohësisht, rekomandohet planifikimi i zhvillimit të territorit dhe sektorit të transportit, duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik alternativ dhe këmbësor, hartimi i politikave që synojnë uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimi i hapësirave të gjelbëra, bashkëpunimi i nguhtë me Inspektoriatin e Mjedisit për monitorimin e rregullt dhe rigoroz të shkarkimeve në ajër të aktiviteteve industriale të pajisura me leje mjedisore (aktivitetet naftënxjerrëse kryesisht), si dhe kufizimi i ndërtimeve në qytet jashtë standardeve për mbrojtjen e cilësisë së ajrit. Njëkohësisht, rekomandohet bashkëpunim me ARM/AKM-në dhe Institutin e Shëndetit Publik për krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit të cilësisë së ajrit në qytetin e Kuçovës gjatë gjithë vitit me qëllim krijimin e një pasqyre të qartë të cilësisë së ajrit dhe përcaktimin e zonave që nevojitin për hartimin e Planeve të Cilësisë së Ajrit

- **Problematikat e tokave bujqësore në Bashkinë Kuçovë**

Erozioni i tokave bujqësore, shkarjet, shembje: Bashkia e Kuçovës shtrihet në një zonë me reliev të larmishëm fushor, kodrinor dhe malor ku zonat fushore janë të kufizuara përgjatë luginave të lumit Devoll dhe Lapardha dhe degëve të tij kryesore. Si rrjedhojë, duke qenë se një pjesë e mirë e tokave bujqësore shtrihen në reliev jofushor, janë të prirura ndaj erozionit, shkarjeve dhe shembjeve.

Për sa i përket ***erozionit*** në tokat bujqësore, ndërsa në vendi tonë rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë, në Qarkun e Beratit konsiderohet i lartë.[158]

Tabela 21. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë

		Indeksi i erodibilitetit				Indeksi i rrezikut potencial të tokës		
Rrethet	**Sip (Ha)**	**Absol.**	**Rel.**	**Indeksi i erozionit të tokës**	**Indeksi i pjerrësisë**	**Absol.**	**Rel.**	**Vlerësimi**
Berat	34,932	7.5	3	2	2.23	13.4	3	I larte

Burimi: AKM 2013

Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e NjA-ve Lumas dhe pjesërisht në NjA-të Perondi e Kozarë. Veçanërisht në NjA-në Lumas, në shumë sipërfaqe ku erozioni është i zhvilluar janë krijuar gërryerje të mëdha të cilat krijojnë vështirësi në rihabilitimin e tyre. Kjo vihet re kryesisht në sipërfaqe jo pyjore si tokat bujqësore, kullotat, ose sipërfaqet e zhveshura.

Sipas SHGJSH-së, tokat e rajoneve te Qarkut Berat ku bën pjesë edhe Kuçova (dhe rajoneve të tjera si Pogradecit, Skraparit, Gramshit, Mirditës, Elbasanit, Korçës) janë vazhdimisht të rrezikuara edhe ndaj shkarjeve dhe shembjeve (të cilat janë trajtuar më sipër).[159] Në rang vendi, llogaritet që shkarjet dhe shëmbjet të prekin rreth 140-150 mijë ha. Shkarjet dhe shembjet e tokës vijnë si rrjedhojë e faktorëve gjeologjikë (lëvizjet e tokës si rezultat i reshqitjeve apo gravitetit[160] , relievi i thyer, reshjet etj.) si dhe nga ndërhyrja e njeriut (kryesisht nga moskujdesja si dëmtimi i bimësisë natyrore, shpyëzimet, braktisja e tokave bujqësore, mosdisiplinimi i rrjedhave të ujërave sipërfaqesore, ose mungesa e manaxhimit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore etj,). Këto të fundit krijojnë kushte të përshtatshme për përshpejtimin e këtij fenomeni. Si përfundim, për shkak të veçorive teritoriale dhe mungesës së përkujdesjes dhe një manaxhimi të duhur të tokës të treguar në 25 vitet e fundit, toka bujqësore rrezikon shkarje dhe rrëshqitje të vazhdueshme. Në rang vendi, duket se tendenca e shkarjeve dhe rrëshqitjeve mbetet e pandryshuar si në vitin 2012 ashtu edhe në vitin 2013 gjë që dëshmon mungesën e marrjes së masave për parandalimin ose të paktën zvogëlimin e këtij fenomeni.


Fatkeqësisht, ndërkohë që vendet e tjera kanë futur tashmë praktika kultivimi të konsoliduara për shmangien ose zbutjen e erozionit (punimi i tokës duke e trazuar atë sa më pak, ruajtja e masës bimore të të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit, përdorimi i mbulesave bimore ndërmjet stinëve të kultivimit ose mbjella e foragjereve ndërmjet bimëve të kultivuara me rreshta si pemtaria, vreshtaria ose ullishtet etj.) në vendin tonë mbetemi ende mbrapa. Si rrjedhojë, për shkak të erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmenaxhimit, apo braktisjes, në territorin e bashkisë vihet re degradimi i tokës. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[161].

Përdorimi konfliktual i tokës: Përdorimi i tokës në Bashkinë Kuçovë, edhe pse i llojeve të ndryshme (industrial, bujqësor, pyjor etj.), nuk është i zonuar. Kjo nënkupton se Bashkia nuk ka një zonë për përdorim vetëm industrial ose vetëm bujqësor gjë që do të lehtësonte manaxhimin e territorit në mënyrë të qëndrueshme dhe ndikimin e industrisë në sektorin bujqësor. Si rrjedhojë, tokat e kultivuara bujqësore bashkëjetojnë me aktivitetet të tjera ose gjenden në kufi me aktivitete tejet ndotëse, pa marrë asnjë masë për mbrojtjen e saj.

Ndër përdorimet më të theksuara konfliktuale në Bashki dallohet përdorimi i tokës për *aktivitetet e industrisë së naftës, për bujqësi dhe banim* njëkohësisht duke krijuar probleme të mëdha për ndotjen e mjedisit dhe, mbi të gjitha, duke rrezikuar shëndetin e banorëve.

Prania e puseve të naftës në tokë bujqësore, dhe shumë shpesh në afërsi të sipërfaqeve ujore, sjell një konflikt shumë shqetësues për prodhimtarinë bujqësore. Puset e naftës ndodhen mbi një ndër zonat akuifere më të mëdha të rajonit, dhe si e tillë, ndotja mund të ketë ndikim shumë afatgjatë në ujin e pijshëm, në ujin e përdorur për ujitje, e si rrjedhojë në prodhimet bujqësore etj.

Figura 61. Pus-shpimet e naftës dhe zonat e banuara në Bashkinë Kuçovë



Burimi: SHGJSH dhe Albpetrol, Punoi: Co-PLAN;2016

Për më tepër, ekziston, ndonëse jo shumë e përhapur, dukuria e shpërhapjes urbane në tokë bujqësore. Efektivisht, kjo sjell një konflikt tjetër përdorimi, pasi nuk përdoret toka për prodhim, nga njëra anë, dhe nxitet shpërhapja më tej, nga ana tjetër. Gjithsesi nuk ka ndonjë tregues që të dëshmojë se shpërhapja urbane e ul bonitetin apo përshtatshmërinë e tokës bujqësore. Efektet e kësaj dukurie janë ekonomike, në sigurimin e shërbimit për ndërtesat e veçuara, estetike, në dëmtimin e peizazhit bujqësor, që i shërben zhvillimit të turizmit dhe mbi të gjitha, *zvogëlon sipërfaqen e tokës bujqësore në Bashki.*

Një konflikt tjetër është *konflikti i përdorimit infrastrukturor – ujor-bujqësor* siç është prania e vendit të depozitimit të mbetjeve urbane ndërmjet bregut të lumit Devoll dhe tokave bujqësore në afërsi të fshatit Rreth Tapi. Ky vend-depozitim është jo-sanitar dhe përbën rrezik për ndotjen e ujërave të lumit dhe atë të tokave përreth njëkohësisht, përveç shkarkimeve të gazrave të dëmshme në ajër. Për këtë arsye, është e rëndësishme të gjendet një zgjidhje më e qëndrueshme, dhe e integruar për të gjithë bashkinë, në lidhje me manaxhimin e mbetjeve.

Përmbytja e tokave nga Lumi Devoll: Një sfidë tjetër për Bashkinë e Kuçovës mbetet përmbytja dhe ndotja e tokës përgjatë brigjeve të lumit nga mbetjet urbane dhe të rrezikshme (shih seksionin e Problematikave të Burimeve Ujore). Në vitet e fundit, rreziku i përmbytjes së tokave nga Devolli është shtuar. Ngushtimi i shtratit të lumit Devoll nga hedhja në shtratin e lumit të mbetjeve të ngurta rrezikon përmbytjen e tokave përreth lumit në rast prurjesh të mëdha[162]. Në Bashkinë e Kuçovës grumbullohen gjithsej rreth 10 tone mbetje te ngurta me burim sektorin e ndërtimit të cilat hidhen në bregun e lumit Devoll[163].

Urbanizimi: (tkurrja e sipërfaqes së tokës bujqësore nga ndërtimet e pakontrolluara në tokë bujqësore).[164] Territori i bashkisë së Kuçovës ka një sipërfaqe modeste prej rreth 84 km^2 (52%) tokë bujqësore[165]. Legjislacioni në fuqi dhe Ligji nr. 9244, datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, përcaktojnë mbrojtjen nga ndërtimet, mbrojtjen e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimin e një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane, mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar, përveç ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë

të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuara në Vendimin e KM nr. 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin eobjekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dheblegtorale, në tokë bujqësore". Në të gjitha kategoritë e bonitetit miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtim bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor.

Po ashtu, Ligji nr. 8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, cilëson që në tokat bujqësore mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastrukturë (rrugore, hekurudhore, ajrore, detare), hidrocentrale, varreza si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall) bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndërkohë pika 4/5 e nenit 11/1 shpreh që kalimi i tokave bujqësore në kategori të resurseve të tjera, si pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe anasjelltas bëhet me miratimin e përbashkët të ministrave përkatës, që i administrojnë këto resurse për sipërfaqe deri në 5 ha dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 5 ha.

Figura 62. Tokë bujqësore, Kozarë



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016

Ndotja e tokës: Në Bashkinë e Kuçovës ndotja e tokës ka ndodhur në seksione të caktuara të territorit, kryesisht në zonën naftënxjerrëse, në zonat e depozitimit të mbetjeve si dhe në zona të tjera, edhe pse këto të fundit më të kufizuara. Si zonë e ndotur në Bashkinë Kuçovë dallohet mbi të gjitha zona naftënxjerrëse e përbërë nga dy zona kryesore (këto zona do të trajtohen më thellësisht në seksionin e Zonave të Nxehta Mjedisore):

- Zona naftënxjerrëse përgjatë lumit Devoll;
- Zona naftënxjerrëse në Qytetin Kuçovë e cila përbëhet nga ish-UPN dhe zona me puse nafte të shpërndara nëpër territore të ndryshme.

Në Bashkinë e Kuçovës janë disa vend-depozitime në të cilat depozitohen mbetjet e të gjitha llojeve pa asnjë kusht higjeno-sanitar dhe teknik. Ndër vend-depozitimet me ndikim

më të theksuar në mjedis dhe në tokat bujqësore është ai pranë lumit Devoll i cili rrethohet nga toka bujqësore. Sipas ARM-së Berat[166], të gjitha sheshet e depozitimeve si në Komuna ashtu edhe në Bashki janë jashtë standarteve dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin shqiptar. Vend-depozitimet kontribojnë në ndotjen e tokës, ajrit dhe të burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, në varësi të vendndodhjes së tyre specifike. Për fat të keq, shtirja hapësinore e ndotjes së tokave përreth vend-depozitimeve nuk është përcaktuar ose studiuar, gjë që përbën shqetësim të madh për popullsinë.

Ndotja me metale të rënda në tokat përreth zonave industriale ka rezultuar shkatërruese si për tokën bujqësore ashtu dhe për pyjet dhe kullotat.

Ashtu si edhe për vend-depozitimin pranë Lumit Devoll dhe për zonat naftënxjerrëse, shtrirja e sipërfaqes së ndotur mbetet ende e papërcaktuar ndërkohë që toka vazhdon të kultivohet duke rrezikuar shëndetin e banorëve nëpërmjet konsumit të drithërave apo perime të kultivuara në toka të ndotura.

Ulja e rendimentit të tokave për shkak të përdorimit intensiv të saj: Sot, bujqësia në vendin tonë përballet me ndryshime të mëdha të sistemit bujqësor. Në zonat fushore, bujqësia po shndërrohet nga bujqësi familjare në bujqësi intensive që nënkupton: i) kultivimin e tokës bujqësore përgjatë gjithë vitit me përdorimin e makinerive moderne e inputve bujqësore të panjohura më parë si dhe ii) shtimin e kulturave bujqësore të reja. Disa tregues të zhvillimit të bujqësisë së shkallës në tokat bujqësore fushore në vend janë rritja e numrit të fermave të pluguara me traktor dhe rritja e numrit të serave.

Tabela 22. Rritja e numrit të fermave të pluguara me traktor

Rritja e nr. fermave të pluguara me traktor					
Me traktor				Totali	
2011	2011 (%)	2012 (%)	2012	2011	2012
17,987	39	41	19,330	46,374	46,660

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

Nga viti 2011 në vitin 2012, pra në harkun kohor të një viti, në vendi tonë ka një rritje prej 3% të fermave të pluguara me traktor. Ndërkohë në vend është shtuar sasia e plehrave kimike të përdorura, kryesisht të uresë (nga 6.9 në 11.5%) dhe diamond superfosfatit (nga 1.9 në 8.2%) në në dhjetë vitet e fundit. Megjithatë, një fenomen që është vënë re në këto vite, është edhe ndryshimi i llojit të plehrave kimike të përdorura (kalimi nga superfosfati në diamond superfosfat), për të cilin nuk njihet arsyeja.

Tabela 23. Rritja e sasisë së përdorur të plehrave kimike në vend

Rritja e përdorimit të plehrave kimike				
Emërtimi	1998			2013
Fermat që plehërojnë	372,507	%	%	342,083
Ure	25,875	6.9	11.5	39,228
Nitrat amoni	48,674	13.1	10.6	36,220
Diamon superfosfati	7,075	1.9	8.2	27,904
Superfosfat	42,428	11.4	5.8	19,729

Të tjera	-	0.0	1.0	3,406

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

Zhvillimi i bujqësisë së shkallës ka ardhur për shkak se kjo lloj bujqësie garanton rritjen e prodhimtarisë e, si rrjedhojë, edhe të përfitimeve ekonomike. Megjithatë, duhet theksuar se bujqësia intensive kërkon njohje të thella të vetive fiziko-kimike të tokës të cilat ndihmojnë në përdorimin efiçent të saj (përdorimin e inputeve bujqësore, llogaritjen e përmbajtjes së metaleve të rënda, depërtimit të ndotjes nga toka në shtresat ujore nëntokësore, llogaritjes së sasisë së ujit të përdorur për ujitje, kohën e përdorimit etj.). Mungesa e njohjeve të tilla mund të çojë në degradimin e tokës dhe në ndotjen e mjedisit me kalimin e viteve.

- **Përfundime dhe rekomandime**

Kuçova bën pjesë në Ultësirën Perëndimore të vendit me toka pjellore që kultivohen pothuajse gjatë gjithë vitit. Vend të rëndësishëm zë nga kultivimi i drithërave deri te perimtaria, bostanoret, foragjeret, ullinjtë, pemët frutore dhe vreshtat. Zhvillimin e bujqësisë në Bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti i gjerë hidrik dhe i kanaleve ujitëse-kulluese i cili ka bërë të mundur kultivimin e bujqësisë intensive përgjatë gjithë vitit. Këtij rrjeti i shtohet edhe Lumi i Devollit së bashku me lumenjtë Osum e Seman, të cilët përshkojnë territorin e bashkisë në pjesën jugore e juglindore përkatësisht.

Në shumë ish-komuna të Bashkisë së Kuçovës, territori ka përdorim bujqësor dhe industrial. Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike që ka sjellë për vendin, ka ndikuar negativisht në ndotjen e tokës, për shkak të mbetjeve të dherave industriale të depozituara në vende të papërshtatshme dhe për shkak të puseve të industrisë së naftës të përdorur gjatë aktivitetit naftënxjerrës ndër vite. Si rrjedhojë, është e nevojshme që bashkia të përcaktojë qartë kufirin e ndarjes ndërmjet tokave bujqësore dhe atyre industriale në mënyrë që të shmanget degradimi i tokave dhe rrezikimi i shëndetit të njeriut nëpërmjet konsumit të produkteve të rritura në toka të ndotura nga nafta.

Përveç mbrojtjes së burimeve ujore, Bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së degradimit të tokës nga praktikat bujqësore të paqëndrueshme. Në dhjetëvjeçarin e fundit, bujqësia është shndërruar nga familjare në intensive. Kjo lloj bujqësie, ka sjellë përfitime ekonomike për banorët vendas por ka krijuar edhe degradim të tokës bujqësore i cili i shtohet atij nga ndotja e naftës dhe industrisë. Për këtë arsye, është e nevojshme që Bashkia të krijojë kushte që shmangin problemet që vijnë me bujqësia intensive duke futur shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave të mira bujqësore pa cenuar qëndrueshmërinë e saj. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jobujqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së[167].

- **Ndyshimet klimatike dhe rreziqet**

Ndryshimet klimatike janë tashmë të prekshme në nivel botëror dhe vendor. Shkaku kryesor mbetet shtimi i sasisë së gazeve serë në atmosferë. Vendet e industrializuara njihen

si kontribuesit kryesorë të këtyre gazrave, ndërsa vendet e vogla dhe me ekonomi jo shumë të industrializuar si Shqipëria janë kryesisht pësuese.
Megjithatë, edhe pse në sasi të vogla, Shqipëria kontribuon në shtimin e gazeve serë në atmosferë. Sipas raportimeve që Ministria e Mjedisit në Shqipëri ka bërë në UNFCCC[168], sektorë të ndryshëm të ekonomisë në vend kontribojnë në çlirimin e CO_2, CH_4, dhe N_2O. Sektori energjitik është kontribuesi kryesor i çlirimit të CO_2 (97.07%) i ndjekur nga transporti me 45.06%, sektori i banimit dhe sektorë të tjerë në norma më të ulta. Kontribues të tjerë mbeten proceset industriale dhe përdorimi i produkteve të tilla si solventet. Procesi i planifikimit të territorit mund të mos ndikojë (domosdoshmërisht) në sjelljen e industrive dhe çlirimin e gazrave. Megjithatë, mund të ofrojë shumë mundësi për mënyrat e trajtimit përmes planifikimit dhe për zbutjen/shmangien e efekteve mbi territorin shqiptar si pësues i ndryshimeve klimatike.

- **Ndryshimet klimatike në Rajon**

Në vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, pasojat e ndryshimeve klimatike do të shprehen në forma të ndryshme si:

- rritje e temperaturës me 1.7 – 3.5°C deri në vitin 2100,
- ulje e sasisë së reshjeve dhe ndryshimi i regjimit të tyre (-3.84 deri në -18.13% deri në vitin 2100)[169].

Këto fenomene parashikohet të kenë pasoja të theksuara në zhvillimin e rajonit sepse kanë mundësi të shkaktojnë ngritjen e nivelit të detit duke krijuar erozion detar, përmbytje, pakësimin e ujërave nëpër lumenj e liqene gjatë vitit dhe përmbytje në periudha të caktuara për shkak të shtimit të reshjeve me intensitet të lartë, ndryshime në stinën e kultivimit në bujqësi, ndryshime të habitateve, paksimin e numrit dhe llojeve të specieve, shtimin e llojeve të huaja invazive së bashku me rritjen e sëmundjeve infektive.[170]

Gjithashtu, probleme të shumta do të hasen në komunitetet lokale dhe ato rajonale që varen nga shërbimet që ofron ekosistemi, uji i pijshëm, karburanti, materialet për ndërtim dhe të korra, të gjitha së bashku do të kenë një ndikim të madh në mbajtjen e kushteve optimale të jetesës. Është fakt i rëndësishëm që disa rajone të Europës Juglindore shtrihen në fushën e Europës që është zonë më e ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndër pasojat më të theksuara të ndryshimeve klimatike që parashikohet të ndodhin në rajon renditen më poshtë:[171]

- Mungesa e ujit të pastër për shkak të uljes të sasisë së reshjeve dhe rritjes së temperaturave.
- Në zonat malore ku rritja e temperatures do të shkaktojë shkrirjen e shpejtë të akujve dhe dëbores parashikohet fryrja e rrjedhave të lumit dhe ndikimet zinxhirë që rrjedhin.
- Zonat bregdetare do të përballen me pasojat që vijnë nga rritja e nivelit të detit kombinuar me rritjen e rrezikut nga fenomene klimatike si stuhitë apo reshjet intensive.

- **Ndryshimet klimatike në Shqipëri (ndikimet në Bashki)**

Siç u tha me lart, Shqipëria, duke qënë se shtrihet në Europën Juglindore, do të këtë pasoja të ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndryshime kryesore që parashikohen janë[172]:

- rritja e temperaturave;
- ulja e sasisë së reshjeve;

- shtimi i fenomeneve ekstreme të motit;
- rritja e nivelit të detit[173].

Sipas të dhënave të nxjerra nga kërkimet e shumta në lidhje me **ngrohjen globale** dhe efektet e saj në territor, edhe për Bashkinë Kuçovë sektorët që do të preken më shumë janë bujqësia, energjia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore[174].

Rritja e temperaturave: Bazuar në të dhënat e paraqitura në komunikimin e tretë që Shqipëria ka bërë për ndryshimet klimatike në tre skenare të përgatitur, tregohet një rritje e mundshme e temperaturës mesatare vjetore përgjatë viteve 2030, 2050, 2080 dhe 2100. Si temperaturë referencë është marrë temperatura mesatare e vitit 1990.

Tabela 24. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperatures (Referuar Tem. Mes. 1990)


Stinët		Vitet		
	2030	2050	2080	2100
Vjetor	1.0 (0.7 to 1.2)	1.7 (1.3 to 2.2)	2.8 (2.0 to 3.5)	3.2 (2.4 to 4.1)
Dimër	0.8 (0.7 to 0.9)	1.2 (1.1 to 1.4)	2.0 (1.7 to 2.3)	2.4 (1.9 to 2.7)
Pranverë	1.0 (0.8 to 1.12)	1.5 (1.3 to 1.8)	2.6 (2.2 to 3.0)	3.1 (2.6 to 3.6)
Verë	1.6 (0.5 to 1.8)	2.5 (2.1 to 2.8)	4.3 (3.8 to 4.9)	5.3 (4.6 to 6.0)
Vjeshtë	1.0 (1.0 to 1.1)	1.6 (1.5 to 1.8)	2.8 (2.7 to 3.0)	3.5 (3.2 to 3.7)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[175], Punoi: Co-PLAN; 2016

Në skenaret e rritjes së temperaturës, në vitin 2050 parashikohet një rritje mesatare e temperaturës me 1.7°C dhe vlera maksimale 2.2°C. Ndërsa në vitin 2080, temperatura mund të rritet me 2.8°C, ndërsa vlera maksimale e vlerësuar arrin shifrën 3.5°C. Në vitin 2100, temperatura mesatare vjetore parashikohet të rritet me 2.4-4.1°C.

Duke vëzhguar vlerën e rritjes së temperaturës sipas stinëve të vitit, shqetësues është fakti që rritja më e madhe e temperaturës parashikohet të ndodhë në stinën e verës, duke e kthyer atë në një stinë akoma më të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare vjetore për skenaret e përgatitur mund të rriten me 2.1-2.8°C në vitin 2050, dhe një rritje me 4.6-6.0°C në vitin 2100, referuar temperaturavetë vitit 1990. Temperaturat mesatare vjetore, sipas skenareve të hartuara, pritet të arrijnë në 25°C në vitet 2050, dhe në 30°C në vitin 2100.

Figura 63. Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës



Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[176], Përpunoi: Co-Plan; 2016

Përveç rritjes së temperaturave në përgjithësi, parashikohet edhe shtimi i fenomeneve ekstreme të motit siç janë numri i ditëve me temperaturë >35°C pa ndërprerje, numri i ditëve me valë të nxehta, dhe numri i ditëve me temperaturë të ftohtë pa ndërprerje.

Tabela 25. Fenomenet ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare

Fenomene ekstreme të motit	Rajon	Vitet 1961-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Nr. ditëve me Tmaks >35° C	Veri	1.7-5.8	5-10	7-14	8-20	10.0-24.0
	Qendër	6 - 4.9	2-9	2-12	3-18	4.0-21.0
	Jug	1.3	4	5	7	8
Nr. ditëve me valë të nxehta	Veri	19-27	56-60	72-80	95-98	115-120
	Qendër	16	29	36	52	60
	Jug	7	13	16	20	25
Numri i ditëve me temperaturë të ftohtë	Veri	360	550	670	840	930
	Qendër	686	780	870	980	1100
	Jug	757	860	950	1050	1160

Burimi:Ministria e Mjedisit ; Punoi: Co-PLAN;2 016[177]

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme, përgjatë gjithë viteve të ardhshme deri në vitin 2100 do të kemi një rritje të ditëve më temperatura maksimale mbi 35°C, ku ng 1.7-5.8 ditë në periudhën 61-1990, në vitin 2100 do të arijnë 10-24 ditë me temperatura mbi 35°C në veri, nërsa në pjesën qëndrore dhe jugore kjo vlerë është më e ulët. Gjithashtu, ditët me valë të nxehta do të rriten përgjatë viteve të ardhshme, nga 19-27 ditë në periudhën 61-1990, në 115-120 në vitin 2100 në pjesën veriore, ndërsa në atë qëndrore dhe jugore vlerat paraqiten më të ulëta. Përsa i përket ditëve me temperaturë me të ulët se 0°C të paraqitura në tabelën e mësipërme, parashikohet një rënie drastike deri në vitin 2100, krahasuar me vitin 1990, nga 10-27 ditë në periudhën 1961-1990, në vitin 2100 këto ditë nuk do të jenë aspak të pranishme në të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, edhe ditët me valë të të ftohtit nuk do të jenë të pranishme në vitet 2100.

Tabela 26. Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime

Fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 61-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Ditë me Tmin < 0°C	Veri	10-27	4-15	0-10	0-3	0
	Qendër	7-32	3-18	0-11	0-5	0
	Jug	3	0	0	0	0
Ditë me valë të ftohta	Veri	30-48	10-15	6-7	0-6	0
	Qendër	32-46	20-32	12-23	6-8	0
	Jug	7	0	0	0	0
Ditë me valë të ngrohta	Veri	1450	1410	1390	1350	1335
	Qendër	1530	1495	1460	1420	1390
	Jug	1168	1130	1110	1090	10702

Burimi: Ministria e Mjedisit, Punoi: Co-PLAN; 2016[178]

Si pasojë e rritjes së temperaturës, dhe rritjes së numrit të ditëve me valë të nxehta, vendi do të përballet me thatësirë të konsiderueshme dhe mot të nxehtë. Ndikim të menjëhershëm do të ketë në rritjen e mesatares vjetore të vdekshmërisë, kryesisht për moshat e treta; në kërkesën në rritje për ujë të pastër; dhe probleme me përshtatjen e kulturave bujqësore me klimën.

Ulja e sasisë së reshjeve: Një problem i rëndësishëm që pritet të vijë bashkë me ndryshimet klimatike, tashmë të vërtetuara shkencërisht, është ulja e sasisë së reshjeve vjetore dhe shpërndarja e tyre përgjatë vitit.

Tabela 27. Ndryshimi i regjimit të reshjeve (në %) në krhasim me vitin 1990

Viti	2030	2050	2080	2100
Vjetor	-3.84 (-35.4 to 27.7)	-8.46 (-56.0 to 47.4)	-14.37 (-78.6 to 81.1)	-18.13 (-89.7 to 94.9)
Dimër	-5.96 (-15.9 to 4.0)	-10 (-27.9 to 7.7)	-14.3 (-44.6 to 16.1)	-18.1 (-55.8 to 19.6)
Pranverë	-2.45 (-11.9 to 7.0)	-7.26 (-25.3to 10.75)	-14.26 (-45.1to 16.6)	-17.7 (-55.3 to 19.8)
Verë	-10.4 (-12.8 to -7.9)	-19.7(-24.1 to -15.3)	-41.9 (-49.2 to -34.5)	-50.4 (-59.4 to -41.3)
Vjeshtë	0.5 (-10.1 to 11.1)	-2.5 (-21.3 to 16.3)	-6.9 (-38.1 to 25.2)	-9.5 (-48.1 to 29.1)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[179], Përpunoi: Co-PLAN

Në vitet e ardhshme pritet që sasia e reshjeve të ulet rreth 14.37% në vitin 2080 dhe deri në mbi 18% në vitin 2010. Në vitet e ardhshme parashikohet që periudhat e thatësirës të shtohen së tepërmi, si pasojë e uljes së sasisë mesatare të reshjeve vjetore dhe shpërndarjes së tyre përgjatë vitit. Nga të dhënat e skenareve të parashikuara të shpërndarjes së reshjeve vjetore, vihet re që stina e verës do të jetë mbi 50% më e thatë. Mungesa e reshjeve do të çojë në një verë shumë më të nxehtë dhe të thatë, duke u kthyer në problem serioz për zhvillimin e bujqësisë, dhe shumë probleme të tjera në sektorë të ndryshëm ekonomik.

Rritja e temperaturave në territorin e Bashkisë Kuçovë do të ketë një sërë problemesh kryesisht në zhvillimin e bujqësisë dhe në biodiversitet. Zhvillimi bujqësor në teritorin e bashkisë do të përballet më kushte klimatike më të thata, si pasojë do të ketë një rritje të kërkesës për ujë për vaditje dhe nga ana tjetër një ulje të sasisë së reshjeve dhe rezervave ujore të përdorshme për bujqësinë. Shtimi i dëmtuesve (parazit, mikrobe, insekte) do të jetë një problem ekzistent më rritjen e temperaturës mesatare vjetore. Biodiversiteti do të preket ndjeshëm nga kohëzgjatja e periudhave të nxehta gjatë vitit dhe mungesës së reshjeve, si pasojë dhe intensifikimi i zjarreve të cilët demtojnë specie dhe habitate në tërësi. Për zhvillimin sa më të qëndrueshëm të biodiversitetit duhen marrë masa në kohë sa më të hershmë, për adoptimin e bujqësisë dhe gjetjen e mënyrave për plotësimin e nevojës me ujë për vaditje.

Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit: Përgjatë viteve fenomenet ekstreme te motit si përmbytjet, valët e të nxehtit etj. kanë qënë të pranishme në vendin tonë. Përmbytjet kanë një ndikim të madh në aspektin e jetës së njerëzve, ekonomisë, bujqësisë dhe mjedisit. Pika kulminante e përmbytjes në vitin e fundit është regjistruar në vitin 2010, në të cilën humbjet arritën në rreth 0.15% të PBB-së së vendit. Në vitet që vijnë, fenomeni i përmbytjeve i ndihmuar nga shirat intensive që pritet të shtohen, parashikohet të shpeshtohet. Stina e verës do të pësojë ndryshime të theksuara duke krijuar kushte ekstreme si temperatura të larta dhe periudha të zgjatura të thata. Ndërsa në zonat bregdetare, me rritjen e

temperaturave dhe intensifikimin e reshjeve, parashikohet të formohen stuhi, të cilat do të kenë një ndikim jo të vogël në ato zona.

Në të shkuarën, pjesë të territorit të Bashkisë Kuçovë janë bërë pre e përmbytjeve të vazhdueshme nga lumenjtë, kryesisht tokat bujqësore pranë brigjeve. Në vitet e fundit ky fenomen po kthehet i përvitshëm edhe pse në shkallë të ndryshme. Në skenarët e parashikimit të ndryshimit të klimës, theksohet shtimi i fenomeneve ekstreme të motit, kryesisht shtimi i shirave itensivë, të cilët janë tepër problematik në fryrjen e menjëhershme të lumenjve dhe si pasojë përmbytjet do të jenë më të mëdha. Zonat breglumore, apo dhe zona përreth, do të jenë tepër të prekura nga përmbytjet që parashikohen në të ardhmen, ndaj duhen marrë masa të menjëhershme për përballimin e këtij fenomeni, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe të zonave urbane.

Rritja e nivelit të detit[180]: Niveli i detit Adriatik ka pësuar një rritje prej 15cm gjatë shekullit të shkuar, Në dekadat e ardhshme deri në vitin 2100, niveli i detit pritet të rritet me 40cm. Rritja e konsiderueshme e nivelit të detit do të sjellë një sërë pasojash negative përgjatë vijës bregdetare, kryesisht në tokat bujqësore, habitatet bregdetare dhe mbi zonat turistike. Si rezultat i rritjes së nivelit të detit, deri në vitin 2050, rreth 1,082.45km^2 (32% e zonës bregdetare, ose 3.76% e sipërfaqes së vendit) do të vuajë pasoja të drejtpërdrejta nga përmbytjet. Pjesë të konsiderueshme të tokës bujqësore do të konsiderohen të humbura, apo të papërdorshme, për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe kripëzimit. Shumica e habitateve bregdetare të tilla si dunat ranore, ligatinat me ujë të njelmët, lagunat, do të pësojnë ndryshime të konsiderueshme, disa prej tyre do të kenë humbur totalisht funksionin dhe të tjera do të jenë të dëmtuara në shkallë relativisht të lartë.

- **Sektorët ekonomikë më të prekur nga Ndryshime Klimatike**

Bujqësia[181]**:** Sektori i bujqësisë është një nga drejtuesit kryesorë të ekonomisë shqiptare. Në vitin 2011 sektori i bujqësisë numëronte 54.6% të punësuarve, dhe kontribuonte në 20% të PBB-së. Bujqësia është shumë e ndjeshme ndaj ndryshimeve afatshkurtra të motit, luhatjeve sezonale dhe vjetore. Ndryshimi i klimës dhe rritja e temperaturës kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në uljen e prodhimit, shtimin e dëmtuesve në bujqësi (insekteve, parazitëve) etj. Gjithashtu, ndryshimi i klimës do të sjellë ulje të sasisë së reshjeve, sidomos në periudhën e verës duke çuar në rritjen e kërkesës për ujë dhe uljen e mundësisë për të pasur ujë të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat gjithnjë e në rritje që ka bujqësia për ujë. Me rritjen e temperaturës, kulturat bujqësore do të hasin probleme me përshtatshmërinë e tyre rajonale. Kjo nënkupton që përgjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm nevojitet të përshtatim llojin e të mbjellave me lloje më rezistente ndaj thatësirës dhe varietete që kërkojnë më pak ujë. Frutat dhe perimet do të jenë më të prekura nga ndryshimet klimatike, pasi rritja e temperatures shton stresin tek këto bimë, duke ulur prodhimtarine e tyre ose duke vështirësuar rritjen e tyre.

Në territorin e Bashkisë Kuçovë do të hasen jo pak ndryshime. Ndryshimet kryesore në lidhje me zhvillimin bujqësor janë, rritja e temperatures, shtimi i kohës së kultivimit, valët e të nxehtit, zgjatja i periudhës së thatë, shtimi i dëmtuesve të bujqësisë dhe mundësia e mungesës së ujit vaditës në disa zona. Rritja e temperaturës mesatare vjetore ka ndikim direkt në zhvillimin e bujqësisë, pasi kulturat aktuale të cilat përdoren në tokat bujqësore nuk do të përshtaten maksimalisht me temperaturat në rritje, apo disa prej tyre do ta kenë të pamundur të përshtaten, e si pasojë do të kemi të korra më të ulëta nga bujqësia.

Intensifikimi i valëve të nxehtit dhe ulja e reshjeve në periudhen e kultivimit të bujqësisë pritët të këtë një ndikim të madh në zhvillimin e bujqësisë, pasi do të kërkojë sasi të mëdha uji për vaditje, ndërsa zona të cilat nuk kanë akses në kanalet vaditës do të reduktojnë maksimalisht sasinë e të korrave. Rritja e temperaturës dhe zvogëlimi i valëve të ftohta në dimër do të këtë një ndikim direkt në shtimin e dëmtuesve të mbjellave bujqësore, pasi shume prej këtyre dëmtuesve (duke mos pasur temperatura të ulëta në dimër) do të mund të shtohen duke rritur periudhën e riprodhimit të tyre. Kjo situatë do të çojë në rritjen e kostos së prodhimit, në sajë të përdorimit të pesticideve, në ulje të cilësisë së prodhimit dhe rënie të rendimentit.

Burimet ujore (Energjitika, HEC-et dhe burimet ujore)[182]: Përbërësit kryesorë të ciklit hidrologjik janë avullimi, transpirimi dhe reshjet. Ndryshimi i parametrave klimatikë, rrezatimi diellor, shpejtesia e erës, temperatura dhe lagështia ndikojnë drejtpërsëdrejti në fenomenin e avullimit. Ndryshimi i avullimit dhe reshjeve do të ndikojë në bilancin ujor në vend. Reshjet mesatare vjetore në dekadat e ardhshme priten të ulen rreth 18%, ndërsa rastet e shirave intensive parashikohen të jenë më të shpeshta duke rritur shpeshtësinë e përmbytjeve. Duke patur parasysh që energjia elektrike në vend plotësohet nga HEC-et, rritja e temperturës do të shtojë mungesën e ujit për të plotësuar nevojat përgjatë gjithë vitit për energji dhe bujqësinë. Zgjatimi i periudhës së thatë në stinën e verës, shkrirja e dëborës në male, dhe mungesa e reshjeve në periudha të caktuara të vitit do të jetë një problem madhor në plotësimin e nevojave me ujë për sektorë të ndryshëm si energji, bujqësi etj. Prodhimi i energjisë pritet të ketë vështirësi në manaxhimin e situatave, duke qenë së ndarja e sasisë së reshjeve përgjatë vitit do të ketë diferenca të konsiderueshme. Rezervuarët e HEC-eve parashikohet të tejmbushen në periudha të caktuara dhe të vuajnë mungesën e sasisë së ujit në periudhën e verës. Megjithatë, edhe në rastin më të keq diferenca midis prodhimit dhe nevojës së ujit mund të zbuten me çështje teknike dhe të politikave.

Përmbytjet nga rrjedhat e lumenjve do të jenë një problem serioz dhe me i shpeshtë në dekadat e ardhshme. Shirat e rrëmbyeshme që sjellin vërshimin maksimal të lumenjve në kohë të shkurtër parashikohet të jenë problemi kryesor i përmbytjeve në pjesën fushore të vendit. Periudha nëntor-mars kur sasia e reshjeve është më e madhe (80-85% e sasisë vjetore) parashikohet periudha më problematike për përmbytjet.

Vlen të theksohet se rritja e temperaturës sjell edhe zgjatjen e harkut kohor brenda të cilit mund të kultivohet përgjatë vitit gjë që mund të ketë ndikime pozitive në bujqësi. Mundësia e kultivimin në një periudhë më të gjatë kohore dhe mundësia e futjes së kulturave të reja në bujqësi mund të çojë në rritjen e prodhimtarisë.

Turizmi[183]**:** Kontributi i sektorit të turizmit për PBB-në është 7.6%, referuar vitit 2009. Ndryshimi i klimës është parashikuar të ketë një ndikim jo të vogël në sektorin e turizmit në vend, pozitiv dhe negativ. Deri në vitin 2030 parashikohet që periudha tetor-maj të jetë e papërshtatshme për turizëm ndërsa periudha tjetër do të ofrojë një rehati për zhvillimin e turizmit të diellit dhe detit. Të dhënat për vitin 2050 përcaktojnë prillin si muaj të pranueshëm për zhvillimin e turizmit bregdetar, ndërsa muajt maj - tetor cilësohen muaj të shkëlqyer për zhvillimin e turizmit bregdetar. Parashikimet për vitin 2080 përcaktojnë vetëm dhjetorin, janarin dhe shkurtin si muaj të papërshtatshëm për turizem diellor e detar, ndërsa muajt e tjerë janë mëse të përshtatshëm. Aktualisht, 80% e turistëve që hyjnë në Shqipëri janë të përqëndruar në zonën bregdetare. Me rritjen e temperaturave, ky numër pritet të rritet duke çuar kështu në rritjen e presionit ndaj mjedisit, ndotjes të zonave nga

mbetjet, ndotjen e ajrit dhe ujit. Manaxhimi i mbetjeve, ujërave të ndotur urbane si dhe siguria për ujë të pastër është një nga sfidat kryesorë me të cilat do të përballet sektori i turizmit në vend.

Popullsia: Ndryshimi i klimës parashikohet të ndikojë në shëndetin e banorëve në zonën bregdetare dhe veprimtarinë e tyre ekonomike kryesore si turizmi dhe bujqësia. Krahas kësaj, do të ketë rreziqe kërcënuese të cilat do të ndikojnë në sigurinë e jetës (përmbytjet, zjarri, rritja e mikrobeve dhe insekteve që transmetojnë sëmundje ngjitëse, ulja e rezervave të ujit të pijshëm, ushqimi, energjia, cilësia e mjedisit dhe peizazhit). Rritja e nivelit të detit dhe përmbytjet e lumenjëve do të jenë një problem tepër shqetësues në zonat fushore, kënetat apo ish-kënetat të cilat janë në disnivel nga deti (deri në 2m). Në këto zona ka ardhur në rritje numri i popullsisë që nga viti 1950, kur toka bujqësore është përfituar nga bonifikimi i kënetave dhe shkripëzimi i tokave në afërsi të vijës bregdetare.
Përveç ndikimit mbi popullsinë, një numër i konsiderueshëm i banesave të ndërtuara gjatë 24 viteve të fundit pritet të dëmtohen nga përmbytjet. Rreth 41,625 banesa vendosur deri në 0.5 m mbi nivelin e detit të cilat rrezikohen të përmbyten deri në vitin 2030, dhe 48,730 ndërtesa të cilat janë ndërtuar mbi nivelin e detit priten të preken nga përmbytjet pas vitit 2050. Lagështia e tepërt dhe përmbytjet do të kenë një ndikim të madh në popullsi pasi shumica e kateve të para të banesave nuk kanë hidro-izolim. Në vitet e ardhshme priten përmbytje (si ato të 2010) dhe stuhi të cilat, krahas dëmeve materiale, mund të shkaktojnë dhe humbje në njerëz, ashtu si në shumë vende europiane dhe fqinje. Në zonat bregdetare, nga rritja e frekuences së përmbytjeve, pritet që ndikim të madh të ketë në infrastrukturën sipërfaqësore dhe nëntokësore si kanalizime, rrjet energjie, telefoni, interte etj. [184]

Siç shikohet, ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të madh në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësore dhe energjitike. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori në PPB arrin në 24%. [185] Në këtë kontekst shihet më se e rëndësishme të merren masa të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke patur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masa për parandalimin dhe kontrodhin e zjarreve, mbrojtja ndaj erozionit të tokës etj.

Duke vëzhguar me kujdes skenarët që trajtuam më sipër, popullsia në territorin e Bashkisë Kuçovë do të përballet me jo pak probleme në të ardhmen ndër të cilat përmendim përmbytje nga lumenjtë (Devoll dhe Osum), shtim të rasteve të zjarrit, thatësira të zgjatura dhe rritje të kërkesës për ujë në bujqësi si dhe ulje të sasisë së ujit të gjendur territor për përdorime të ndryshme. Popullsia në territorin e Bashkisë, në zonat të cilat janë pranë brigjeve të lumenjëve do të pësojnë dëmtime nga fryrja dhe dalja nga shtrati, nëqoftëse shirat e intensive shtohen në të ardhmen, duke krijuar dëme bujqësi dhe banesa. Zhvillimi bujqësor do të sigurojë të ardhura më të pakta për banorët, pasi rritja e periudhës së thatësirave çon në rritjen e kërkesës për ujë dhe aktualisht kanalet ujitës nuk janë totalisht në funksion. Gjithashtu problematikë shfaqen edhe parazitët e shtimi i numrit të insekteve që trasmentojnë sëmundje gjë që mund të përbëjë një problem serioz në përhapjen e epidemive të ndryshme.

- **Përfundime dhe rekomandime**

Ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të madh në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësor dhe energjitik. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori në PPB arrin në 24%.[186] Në këtë kontekst, shihet më se e rëndësishme marrja e masave të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke pasur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen e kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masa për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve, mbrojtja ndaj erozionit të tokës etj.

Edhe për Bashkinë Kuçovë, sektorët që do të preken më shumë nga ndryshimet klimatike janë bujqësia, energjia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore[187]. Për këtë arsye, duhen marrë masa për fortifikimin e barrierave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekur edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës. Nga ana tjetër, në kushtet e një skenari negativ të përmbytjeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, territori i Bashkisë Kuçovë mund të kthehet në një nga territoret kryesore pritëse të popullsisë së zhvendosur.

- **Vatrat e nxehta mjedisore dhe aktiviteti industrial**

Bashkia Kuçovë nuk ka zona të nxehta mjedisore të shpallura ligjërisht. Megjithatë, mendohet se në territorin e Kuçovës ndodhen disa zona të nxehta mjedisore që kanë nevojë për rihabilitim sa më të shpejtë me qëllim shmangien e ndotjes së mjedisit dhe rreziqeve që i kanosen shëndetit të banorëve që jetojnë ngjitur ose përreth këtyre zonave. Zonat kryesore të nxehta mendohet se janë vend-depozimi i mbetjeve urbane, Kanali i "Dikatrës, ish-Uzina e Përpunimit të Naftës (UPN-ja) dhe zona naftënxjerrëse.

Vend-depozitimi i mbetjeve urbane: në Bashkinë Kuçovë, mbetjet urbane depozitohen në vend-depozitimin e mbetjeve në *NjA-në Perondi*, i cili ndodhet rreth 2 km larg nga rruga kombëtare dhe *2.5 km larg nga qendra e qytetit*. Ky vend-depozitim është vënë në funksion që nga viti 1990 dhe është jashtë çdo kushti teknik dhe higjieno-sanitar. Në këtë vend-depozitim, mbetjet, pasi depozitohen, mbulohen me dhé e më pas ngjeshen nga makineritë e transportit të mbetjeve.

Vend-depozitimi paraqet probleme të mëdha për sa i përket ndotjes së mjedisit dhe rrezikimit të shëndetit të banorëve për arsye të ndryshme. Së pari, ai ndodhet buzë lumit Devoll, në një largësi jo më tepër se *120 m nga shtrati i lumit*, duke ndotur vazhdimisht ujërat sipërfaqësore të lumit Devoll. Pë më tepër, ndryshimet e theksuara në regjimin e rrjedhjes së Osumit ndër vite kanë ndryshuar edhe mikrotipologjinë e truallit ku ndodhet ky vend-depozitim brenda një harku kohor 5-15-vjeçar. Sot, mund të themi se një pjesë e vend-depozitimit të hershëm gjendet e përmbytur ose e gërryer nga shtrati aktual i lumit Devoll. Për më tepër, pozicioni në të cilin ndodhet ky venddepozitim është i papërshtatshëm nga ana gjeologjike për shkak se ndodhet në një territor me dhera të shkrifëta të cilat favorizojnë depërtimin e ujërave (shllamit) të ndotura të vend-depozitimit

në ujëra nëntokësore.[188] Ndotja është edhe më e theksuar në kohë reshjesh të cilat përshpejtojnë depërtimin e ujërave sipërfaqësore në Akuiferin Kuaternar të Beratit.

Figura 64. Foto nga venddepozitimi i mbetjeve, Bashkia Kuçovë



Burimi: Raporti i fizibilitetit mbi menaxhimin e mbetjeve, Bashkia Kuçovë, 2014

Një aspekt tjetër tejet i rëndësishëm është fakti se vend-depozitimi ndodhet afër segmentit të lumit Devoll. Prania e vend-depozitimit në këtë zonë përbën një kërcënim serioz për ndotjen e Akuiferit të Beratit.

Figura 65. Ndryshimet e sipërfaqes së vend-depozitimit në harkun kohor 2003-2015





Burimi: Google map, 2016

Përveç ndotjes së ujit, vend-depozitimi paraqet probleme edhe në lidhje me ndotjen e ajrit për shkak të djegies së mbetjeve plastike që kryhet në këtë zonë dhe gazrave të dëmshme që çlirohen gjatë shpërbërjes së mbetjeve organike siç është metani (CH_4). Gazi metan çlirohet i gjithi në atmosferë duke kontribuar si gaz i efektit serë dhe duke ndotur me aromën e tij të fortë, në vend që të kapej me anë të skemave të rikuperimit e të përpunohej e të ofrohej si një Lëndë Djegëse Gaz (LDG) për të prodhuar enegji elektrike ose mekanike.

Ky vend-depozitim, duke mos përmbushur kriteret teknike të projektimit dhe funksionimit, rrezikon ndotjen e mjedisit, ndaj edhe ndërhyrja urgjente për rehabilitimin e kësaj sipërfaqeje dhe ndalimin e aktivitetit të depozitimit të mbetjeve paraqitet tepër urgjente.

Kanali i "Dikatrës": me një gjatësi të vlerësuar prej 8.37 km, ky kanal shërben për kullimin dhe vaditjen e zonës së poshtme dhe fushore të qytetit të Kuçovës. Pikënisja e këtij kanali është rezervuari në fshatin Drizë dhe zgjatet përgjatë pjesës perëndimore të qytetit duke kaluar përmes tij për të dalë në fushat pranë ish-N.B Partizani e për t'u shkarkuar në Lumin Osum, në veri të fshatit Tapi.

Figura 66. Shtrirja e kanalit të Dikatrës – Kuçovë



Burimi: Google Imagery, 2016

Shtrirja e tij përgjatë puseve dhe depozitave të naftës si dhe shkarkimet në të nga kolektorët e grumbullimit të ujërave të ndotura urbane të Qytetit Kuçovë e kanë transformuar rrënjësisht funksionin e këtij kanali duke e kthyer në një bartës të ndotësve kryesorë të prodhuar në territorin e qytetit (në kolektor të ujërave të ndotura urbane dhe industriale) dhe duke e shtrirë më pas ndikimin e tyre në mjedis drejt ujërave të lumit Osum e Seman, si edhe në tokat bujqësore që shfrytëzojnë ujërat e këtij kanali për vaditje.

Duke patur parasysh se ujërat e kanalit gjejnë përdorim të gjerë në bujqësi, nevojitet që kanali t'i nënshtrohet një procesi rehabilitues përgjatë gjithë gjatësisë së tij duke larguar fillimisht llumin dhe bimësinë në shtratin e tij e, më pas, duke pastruar e gërryer edhe sedimentin e grumbulluar në kohë përgjatë tij.

Ish-Uzina e Përpunimit të Naftës (UPN-ja): Në Qytetin e Kuçovës ka vepruar për një kohë të gjatë ish-Uzina e Përpunimit të Naftës ose ish-UPN-ja. Sipas një prezantimi të z. Shpëtim Nishani, kjo uzinë ka prodhuar solventë[189], benzinë brut, vajguri brut, gazoil brut, solar brut, vajra brut, mazut, bitum, graso, sulfonat, bitum i oksiduar, valvolinë, dinaftenat alumini, merzolat, sapun naftenik, vaj emulsol, koks dhe gudron (mbetje nga përpunimi i vajit). Lëndet ndihmëse që janë përdorur në uzinë janë acidi sulfurik 98%, soda kaustike, solventet, oleumi, lëngu i xhamit dhe dodecilbenzoli. Gjithmonë sipas të njëjtit autor, mbetjet teknologjike të prodhuara janë gudron acid nga pastrimi (gërryes dhe ndotës) i vajrave, sulfonatit, vajgurit dhe gazoilit. Mbetje teknologjike të uzinës janë edhe karburante dhe ujra sodike nga dekantimi (ndotës ambjenti) i benzinës, vajgurit, gazoilit, naftës bruto, sabie nga pastrimet e depove. Kjo Uzinë ka shkarkuar nivele të larta ndotjeje në tokë e cila trashëgohet edhe sot[190]. Duke pasur parasysh ndotjen e lartë të shkaktuar nga kjo uzinë dhe faktin se sipërfaqja e ndotur në të cilën ndodhet kjo uzinë është pjesërisht e banuar dhe ndodhet pothuajse afër qendrës së qytetit, nevojitet rehabilitimi urgjent i sipërfaqes së zonës. Në këtë mënyrë, shmanget rreziku që i kanoset shëndetit të banorëve me banim në brendësi të ish-UPN-së ose në rrethinat e saj. Zona e ish-UPN-së paraqet rrezik të theksuar për fëmijët e moshës parashkollore të cilët duke lozur në brendësi të territorit të ndotur, mund të prekin dhe gëlltitin dherat e ndotura në sipërfaqen e ish-UPN-së.

Figura 67. Ish-zona e UPN-së, Kuçovë



Burimi: Bashkëpunimi për Zhvillim nga R.Çeke, Raporti Fizibilitetit, 2012

Ish-zona e UPN-së i është nënshtruar një studimi në kuadër të hartimit të një projekti rehabilitimi në të cilin janë kryer paraprakisht analiza të tokës nga të cilat ka rezultuar me nivele të larta ndotjeje në tokë. Studimi ka sugjeruar edhe metodat e ndryshme të mundshme për rehabilitimin e kësaj zone. Në këtë zonë, studimi i financuar nga Republika Çeke planifikon edhe rivitalizimin e zonës së ndotur duke përfshirë trajtimin e të gjithë ndotësve të identifikuar në këtë zonë. Gjithashtu, është sugjeruar që në një seksion të kësaj hapësire, pas rehabilitimit, të ndërtohet një impiant djegës (incenerator) për mbetjet e ngurta të Bashkisë Kuçovë dhe jo vetëm. Propozimet për shfrytëzimin e hapsirave të ish-UPN-së, Mekanikes dhe TEC-it konsistojnë kryesisht në krijimin e hapësirave publike dhe argëtuese si dhe krijimin e hapësirave muzeale.

Figura 68. Ish-zona e UPN-së, Projekti i Rehabilitimit, Kuçovë



Burimi: Bashkëpunimi për Zhvillim nga R.Çeke, Raporti Fizibilitetit, 2012

Pavvarësisht nëse projekti i mësipërm do të realizohet apo jo, mbetet fakti se zona e ish-UPN-së është një zonë tejet e ndotur me hidrokarbure. Me qëllim shmangien e rrezikut që mund t'i kanoset shëndetit të banorëve të qytetit, rekomandohet rehabilitimi i menjëhershëm i saj, dhe, në pritje të rehabilitimit, rekomandohet rrethimi i kësaj zone dhe shenjimi i saj si zonë e nxehtë mjedisore.

Zona naftënxjerrëse në Kuçovë: Zona naftënxjerrëse në Kuçovë, edhe pse nuk është përcaktuar si vatër mjedisore, është ndotur rëndë me hidrokarbure[191]. Në Kuçovë, ndotja e ajrit, ujit e tokës nga industria e naftës është e theksuar për shkak të llojit të veprimtarisë

dhe teknologjisë së vjetër të përdorur nga industritë e sektorit[192]. Për më tepër, industritë në vendin tonë janë dalluar për mosrespektimin e mjedisit gjatë veprimtarisë së tyre. Si rrjedhojë, Kuçova dhe Kozara vuajnë pasojat e ndotjes së tokës nga puset e naftës në sipërfaqen naftënxjerrëse[193].

- **Vendburimi i naftës Kuçovë**

Vendburimi i naftës Kuçovë është një nga vendburimet më të vjetra të zbuluara në Shqipëri, ku janë zbuluar rezerva të konsiderueshme nafte. Sot, në territorin e Bashkisë përfshihen vendburimet e mëposhtme të naftës me rezerva të llogaritura si më poshtë:[194]

Tabela 28. Rezervat naftëmbajtëse në Bashkinë Kuçovë

Emertimi	Rezevat e llogaritura (ton)
Vendburimi Kuçovë	**rreth 67,824,448**
Shtratimi Fermë – Çiflik (pjesa qe i takon Bashkisë Kuçovë)	rreth 2,937,624
Shtratimi Arrëz (pjesa qe i takon Bashkisë Kuçovë)	**rreth 3,474,075**
TOTALI	74,236,147

Burimi: AlbPetrol sh.a,Përpunoi: Co-PLAN; 2016

Zbulimet e para të vendburimeve të naftës si dhe të rezervave nëntokësore janë identifikuar në këtë zonë nga Prof. Stanisllav Zuber i cili, në harkun kohor 1927-1947, udhëhoqi proceset kërkimore të vendburimeve të naftës. Njëkohësisht, Prof. Zuberi mban edhe autorësinë e hartave të para inxhinieriko-gjeologjike të Shqipërisë.

Kuçova njihet edhe më herët për burimet e saj të vajit të kandilit i përdorur gjerësisht gjatë periudhës kohore ndërmjet shek XVII-XIX. Më tej, pas zbulimeve të rezervave cilësore të rërës bituminoze, naftës dhe gazit natyror në këtë rajon, të parët që e shtrinë aktivitetin industrial në përmasat që ka edhe sot ishin kompanitë Italiane (AIPA 1934). Këto sollën në vend teknologji të cilat janë pjesërisht aktive edhe sot. Më pas, me përfundimin e luftërave, qeveritë e Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë bashkëpunuan ngushtë për të ndërtuar të parën rafineri moderne të naftës në Shqipëri. Industria njohu një hov të fuqishëm gjatë diktaturës dhe një shkatërrim të ngadaltë pas vitit 2003 ku, nëpërmjet Ligjit nr. 9117,[195] ky sektor u privatizua.

Zona naftëmbajtëse e Kuçovës sot shfrytëzohet nga Kompania shtetërore Albpetrol sh.a. dhe kompania private Sherwood Petroleum Ltd. (Degë e Bankers Petroleum Ltd.).[196] ***Albpetrol sh.a*** është shoqëri shtetërore e cila ka si qëllim prodhimin dhe tregtimin e produkteve të naftës si dhe monitorimin e Marrëveshjeve Hidrokarbure me palë të treta.[197] Në Bashkinë e Kuçovës, Albpetrol zotëron të gjithë aktivitetin e naftës, me përjashtim të zonave të shfrytëzuara nga Bankers e cila do të shtjellohet më poshtë. Pjesa më e madhe e puseve të naftës në pronësi të Albpetrolit është përqendruar në Kozarë, Kozarë Fshat dhe Arrëz, përgjatë lumit Devoll dhe në pjesën lindore të qytetit të Kuçovës. ***Bankers Petroleum Ltd.*** (Sherwood International Petroleum Ltd.) ka lidhur një marrëveshje[198] me Kompaninë Albpetrol në vitin 2007 për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në vendburimin e Kuçovës për 30 vjet[199]. Zona e kontrates [200] e shfrytëzuar nga Bankers Petroleum Ltd. ndodhet në dy akse kryesore të cilat janë Aksi Fermë/Kozarë-Arrëz dhe Aksi Fermë-Çiflig[201].

Në territorin e Bashkisë Kuçovë ka pasur dhe vazhdon të ketë në shfrytëzim një numër të lartë pusesh të naftës me ndikim të lartë në mjedis. Në territorin e Bashkisë Kuçovë ka 1,800 puse nafte 1,099[202] prej të cilëve janë puse aktive ndërsa 701 prej tyre nuk janë në gjendje pune. Këto të fundit janë izoluar pjesërisht ose jashtë kushteve teknike. Në Qytetin e Kuçovës ndodhen 311[203] puse nafte ndër të cilët 210 janë në funksion ndërsa 101 puse janë jashtë funksionit. Pjesa dërrmuese e puseve të naftës ndodhen përgjatë rrjedhës së lumit Devoll me përqendrim të lartë nga Kozara deri në bashkimin e Devollit me Osumin dhe në Kuçovë qytet. Për më tepër, puset janë shpërndarë edhe në zonën bujqësore në lindje dhe perëndim të qytetit Kuçovë si dhe në të gjithë pjesën jug-perëndimore të Kozarës.

- **Ndikimet e mundshme të industrisë së naftës në mjedis**

Industria e naftës, për vetë natyrën e aktivitetit të saj, mund të krijojë ndotje në mjedis gjatë fazave të ndryshme të procesit të nxjerrjes së naftës (fazës së shpimit, dekantimit, transportit dhe përpunimit etj.) gjatë të cilave krijohen mbetje[204] që mund të ndotin mjedisin.

Faza e shpimit të puseve: Ka ndikim jo të vogël në mjedis, në varësi të teknikave të përdorura. Teknikat e shpimeve për naftë janë të ndryshme. Për një kohë të gjatë, kompanitë kanë përdorur teknikën e shpimit me *puse me trungje vertikale* (puset e zakonshme). Krahas shpimit vertikal, është përdorur gjerësisht edhe *shpimi me puse horizontale*. Pusi shtrihet horizontalisht në shtresën shkëmbore në të cilën shpohet për një largësi të theksuar (ndryshimi është 3,000 m kundrejt 15m). Këto puse bëjnë të mundur shpimin në zona ndryshe të paarritshme me teknologjinë e vjetër (nën akuifer, zona të mbrojtura etj.). Distancat horizontale nga zona e pusit në sipërfaqe deri në fundin e pusit në tokë mund të arrijnë deri në 8 km[205].

Një teknologji tjetër që ka gjetur përdorim të gjerë nga industria e naftës në dhjetëvjeçarin e fundit është shpimi me *puse me trungje horizontale me çarje/plasje* të shkëmbinjve me ujë[206] (*hydraulic fracturing*). Sipas Agjencisë Amerikane për Mjedisin (EPA) puset shpohen me trung vertikal nga 100 deri në mijëra metra nëntokë dhe mund të përfshijnë puse me trungje horizontale ose me drejtim të caktuar që shtrihen me mijëra metra. Çarjet krijohen duke hedhur sasi shumë të mëdha lënde të lëngshme me presion të lartë në pusin e shpuar enkas dhe në shkëmbinjtë ku ndodhet nafta. Balta përbëhet kryesisht nga ujë, propant dhe kimikate që përdoren për të hapur dhe zgjeruar plasjet e krijuara në shkëmb. Këto plasje mund të jenë me qindra metra të gjata. Propantët përfshijnë rërë, peletë qeramike, ose pjesëza të tjera të pashtypshme.

Mbasi mbaron procesi i hedhjes së lëndës së lëngshme (ujit me kimikatet në pus), trysnia e brendshme e shtresës shkëmbore shtyn lëndën e lëngshme që të dalë në sipërfaqe nëpërmjet pusit të shpuar. Ky ujë rikthehet në sipërfaqe. Shpesh njihet me emrin *ujë i prodhuar*. Në përbërjen e tij mund të gjenden edhe kimikatet e shtuara përpara injektimit dhe materialet që ndodhen natyrshëm në shtresën shkëmbore si *kripëra të ndryshme, metale, hidrokarbone, rodionuklide* etj. Uji i kthyer magazinohet në vend në kontenierë të mëdhenj ose në gropa ekologjike në pritje për trajtim ose riciklim. Në shumë raste, ky ujë shpesh ri-injektohet[207]. Në zonat ku ri-injektimi nuk është i mundur, uji i prodhuar mund të trajtohet në impiante të trajtimit të ujërave të zeza dhe, më tej, të shkarkohet në ujëra sipërfaqësore. Teknologjia e shpimit me puse me trungje horizontale *me çarje/plasje* është ekonomikisht e leverdishme. Ajo ka bërë të mundur shfrytëzimin e shtresave shkëmbore që dikur nuk

paraqisnin interes ekonomik. Megjithatë, kjo teknologji mund të ketë ndikim të lartë në burime ujore për disa arsye:

- *Është teknologji që kërkon sasi tepër të mëdha uji* (Procesi i shpimit të një pusi shpenzon nga *7 deri në 15 milion litra ujë)*[208]. *Sasi të mëdha uji përdoren edhe gjatë pastrimit të puseve dhe mirëmbajtjes së tyre.*
- *Një pjesë e ujit të përdorur gjatë shpimit kthehet mbrapsht (ujë i kthyer/prodhuar*). Sasia e kthyer varet nga shtresa shkëmbore naftëmbajtëse.
- *Nga puset mund edhe të dalë ujë shtresor* (uji që del nga shtresat shkëmbore dhe, për këtë arsye, ka përmbajtje të lartë kripërash dhe lëndësh toksike).

Pra, me pak fjalë, shpimet krijojnë mbetje të lëngëta, materiale të ndryshme, minerale dhe lëndë të tjera që duhet të hiqen nga pusi. Përgjithësisht, ***nga procesi i shpimit del balta e papërdorshme, uji i podhuar, uji shtresor dhe mbetjet nga pusi.*** Uji shtresor dhe i prodhuar shndërrohen në mbetje të lëngëta të cilat kompanitë zakonisht i grumbullojnë në *gropa ekologjike* deri në një zgjidhje përfundimtare (ri-injektim, trajtim të ujërave nga vetë kompania dhe shkarkimin e tyre në një burim sipërfaqësor, derdhje të ujërave në një sipërfaqe të caktuar në tokë, dërgim për trajtimin e ujërave në një impiant të përshtatshëm për trajtimin e tyre etj.).


Uji i prodhuar nga veprimtaria e nxjerrjes së naftës përmban ***kripëra, boron, metale të rënda, si dhe lëndë radioaktive*** të cilët nuk treten vetvetiu në mjedis[209]. Për më tepër, ujërat e përdorura, balta ose uji i prodhuar, mund të përmbajnë edhe kimikate të ndryshme të përdorura nga kompania gjatë fazës së shpimit e shfrytëzimit që zakonisht nuk njihen. Kimikatet përdoren gjerësisht gjatë procesit të prodhimit të naftës.

Faza e dekantimit[210]: Pas nxjerrjes së naftës, kompanitë bëjnë *dekantimin* ose ndarjen e naftës nga fraksionet e tjera (uji dhë gazi). Kontenierët e dekantimit mund të jenë depozita ndarjeje horizontale ose vertikale të llojeve të ndryshme. Në të gjitha pajisjet e dekantimit që përdoren në industrinë e prodhimit të naftës ndodh ndarja e ujit, gazit dhe naftës. Pra, në përgjithësi, rezultati i procesit të dekantimit është:

- Uji, nga fundi i depozitës shkarkohet në një depozitë uji
- Nafta shkarkohet në një depozitë nafte,
- Gazi shkarkohet vazhdimisht në ajër nëpërmjet valvulës së daljes në pjesën e sipërme të depozitës.


Pas dekantimit, nafta transportohet në rafineritë përkatëse të përpunimit, nga ku fillon një cikël krejt i ri ndotjeje dhe shkarkimesh në atmosferë në rast se nuk merren masat e duhura për mbrojtjen e mjedisit.

Figura 69. Depozitë dekantimi me ndarje të lire (majtas), me dy faza (djathtas)



Burimi: Agjencia e Mjedisit SHBA, Përpunoi: Co-PLAN; 2016

Figura 70. Depozita dekantimi larëse (majtas), Depozitë dekantimi me tre faza (djathtas)



Burimi: Agjencia e Mjedisit SHBA, Përpunoi: Co-PLAN; 2016

- **Ndotja e mjedisit e trashëguar nga industria e naftës në Bashkinë Kuçovë**

Në Kuçovë, ndotja e ajrit, ujit e tokës nga industria e naftës është e theksuar për shkak të llojit të veprimtarisë dhe teknologjisë së vjetër të përdorur nga industritë e sektorit[211]. Teknologjia e përdorur nga kompania Albpetrol për nxjerrjen e naftës është e vjetër duke shkaktuar ndotje të tokës, ajrit dhe të ujërave sipërfaqësore (ujërat e Devollit dhe ujërat e kanaleve të vogla) e nëntokësore (Akuifein e Beratit)[212]. Ndotja e tokës nga puset e naftës veçanërisht në Kuçovë dhe sidomos në Kozarë, është e dukshme përreth puseve të naftës. Në disa zona, për shkak të erës së fortë është e vështirë të qëndrosh në afërsi të gropave ekologjike për më shumë se disa sekonda. Një gjendje e tillë vihet re pothuajse në zonat ku puset kanë ende teknologji të vjetër. Duke vlerësuar paraprakisht sipërfaqen që zë çdo pus nafte (përafërsisht 20m²) , mund të thuhet se dheu i ndotur me naftë zë një vëllim rreth 500,000m³. Në nivel sipërfaqeje, ***rreth 1/3 e sipërfaqes së vendburimeve të naftës rezulton të jetë e ndotur nga nafta bruto***[213].

Industria ka ndotur ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore vazhdimisht për arsye se, përveç teknologjisë së vjetër, ujërat e dekantimit të cilat përmbajnë ende hidrokarbure dhe ndotës

të tjerë, janë shkarkuar historikisht të patrajtuara në lumin Devoll. Pra, ujërat e dekantimit janë lënë me rrjedhje të lirë duke përfunduar në lumë. Në shkarkimet ujore të raportuara të industrisë së naftës është gjetur prani e lartë e klorureve, fenolëve dhe naftës bruto që derdhen nëpër kolektorin kryesor të ujërave të zeza apo kanaleve të tjera dhe përfundojnë në lumin Devoll dhe Osum. Niveli i fenolëve në shkarkim të Lumit Devoll arrin në 2mg/l, i klorureve 20.000-50.000 mg/l, ndërsa niveli i naftës bruto në 40-90 mg/l.

Figura 71. Mbetje të lëngëta industriale nga puset e naftës



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015

Lidhur me ***ndotjen e ajrit,*** në Bashki është e vështirë të përcaktohet cilësia e ajrit dhe ndikimi i vetë industrisë së naftës në ndotjen e ajrit. Në qytet dhe në zonat e naftës nuk ka sisteme monitorimi të përhershme të ajrit për të përcaktuar më përafërsi se cili është ndikimi i industrisë së naftës. Të dhënat që ekzistojnë janë të dhëna të monitorimit të ajrit nga vetë kompanitë që opërojnë në zonë.

Pra, duke u bazuar nga vëzhgimet në terren mund të thuhet se në Bashkinë Kuçovë, ndeshemi përpara një realiteti të dhimbshëm: në zonat naftënxjerrëse ku puset kanë teknologji të vjetër mund të thuhet pa hezitim se ***sipërfaqet e tokës përreth puseve të naftës mund të quhen vatra të ndotja mjedisore*** për arsye se nafta bruto vazhdon të rrjedhë përreth puseve duke ndotur njëkohësisht tokën dhe ujërat sipërfaqësore e mundësisht, edhe ujërat nëntokësore.

- **Industria e naftës dhe sfidat kryesore mjedisore për bashkinë Kuçovë në të ardhmen**

Sektori i naftës është sektor ekonomik mjaft i rëndësishëm në Bashkinë Kuçovë. Megjithatë, sektori i naftës, për vetë llojin e aktivitetit, paraqet sfida të mëdha mjedisore,

veçanërisht në vende në zhvillim si Shqipëria të cilët ende nuk kanë një kuadër ligjor dhe procedurial të plotë për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të banorëve nga industria e rëndë.

Në vendin tonë mungon një kuadër legjislativ i plotë ose programe të posaçme që garantojnë mbrojtjen e plotë të mjedisit (dhe kryesisht ujit, ajrit, tokës) nga industria e rëndë ku përfshihet edhe industria e naftës. Konkretisht, legjislacioni shqiptar rregullon mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjeve të shumta (Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit për Lejet e Mjedisit, e shumë ligje të tjera). Megjithatë, Shqipëria nuk ka ligje të posaçme ose programe që rregullojnë disa procese (shpimin, operimin, ri-injektimin, etj.) të industrisë gjatë aktivitetit të saj. Në përgjithësi, në Shqipëri mungojnë ligje dhe programe që përcaktojnë:

- llojin e teknologjisë së shpimit të puseve të naftës që i përshtatet çdo zonë që shfrytëzohet nga industria e naftës;
- llojin e teknologjisë që industria e naftës duhet të përdorë për veshjen e puseve të naftës;
- procedurat/teknikat/teknologjitë për izolimin e puseve të naftës kur dalin jashtë funksionit dhe monitorimin e tyre;
- mbulimin e shpenzimeve për izolimin e puseve jashtë funksionit dhe rihabilitimin e zonave naftënxjerrëse në rast falimentimi të kompanisë;
- zonimin e territorit për efekt të ri-injektimit (zona ku lejohet dhe zonat ku ky proces mund të shkaktojë ndotje të mjedisit) si dhe
- programe që rregullojnë ri-injektimin e ujërave të ndotura. Ri-injektimi është thjesht një mënyrë për të ricikluar ose futur në vend-depozitim përfundimtar ujërat e ndotura nga industria e naftës. Për këtë arsye, shteti duhet të hartojë një program në të cilin të përcaktohen të paktën disa kërkesa minimale që parandalojnë ndotjen e burimeve ujore nëntokësore dhe mbrojnë shëndetin e njeriut.
- ligje e programe që rregullojnë shpimet për naftë në afërsi (dhe në akuifer) të një akuiferi uji i të cilit përdoret për furnizim me ujë të popullsisë në të sotmen dhe në të ardhmen;
- ligje e programe që rregullojnë shfrytëzimin e burimeve ujore e nëntokësore nga industria e rëndë (dhe ajo e naftës në veçanti në Bashkinë Kuçovë) duke patur parasysh se kjo industri përdor sasi tepër të mëdha uji gjatë aktivitetit të saj;
- ligje e programe që rregullojnë shfrytëzimin e ujërave nëntokësore të thella (mbi 200 m thellësi) me qëllim shmangien e uljes së relievit të tokës, si dhe përcaktimin e zonave të ndjeshme ndaj uljes së relievit (tabanit) të tokës nga mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore ose i mineraleve

Për këtë arsye, mund të thuhet se në mungesë të një kuadri legjislativ të plotë dhe të programeve të posaçme që rregullojnë mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore dhe të nëntokës nga industria e naftës, për disa aspekte që u përmendën më sipër dhe që do të shtjellohen shkurtimisht më poshtë, mbrojtja e burimeve ujore është në varësi të kompanive të naftës dhe jo e garantuar me ligj. Kjo nuk përjashton faktin se disa kompani në vend operojnë sipas praktikave më të mira ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit (Kompania Bankers, p.sh.).

Më poshtë janë shtjelluar shkurtimisht aspektet kryesore që nevojitet të mbulohen me ligj ose nëpërmjet programeve të posaçme, që janë:

Teknologjitë e përdorura për shpim (kryesisht teknologjitë që rritin efiçencën e shfrytëzimit të naftës që në anglisht njihen me emërtimin[214] *Enhancement Oil Recovery Tecniques*). Shumë kompani të reja që operojnë në vendin tonë mbas viteve 1990 kanë futur teknologji të reja për shfrytëzimin e naftës të cilat nuk janë përdorur më parë. Këto teknika rritin ndjeshëm efiçencën e shfrytëzimit të naftës ose sasinë e nxjerrjes së naftës nga nëntoka. Teknika të tilla mund të jenë termike, me gaz ose kimike. Kompania Bankers, për shembull, përdor teknika kimike (shpimin me përmbytje me ujë dhe polimer -*polimer flooding*). Këto teknika bëjnë të mundur rekuperimin efiçent të naftës në përqindje të lartë dhe zakonisht përdoren mbasi pjesa më e madhe e naftës është nxjerrë nga rezervuari. Për shkak të dëmtimeve në mjedis, në shumë vende si Francë[215], Skoci dhe Bullgari, ndalohet përdorimi i disa teknikave të shpimit (*i plasjes hidraulike*).

Në vendin tonë, me përjashtim të kompanisë Bankers e cila e ka publikuar teknologjinë e saj të shpimit në internet, është e vështirë të kuptohet lloji i teknologjive të shpimit që përdoren nga shumë kompani nafte. Për rrjedhojë, pasojat e mundshme të tyre në vend mbeten të panjohura. Për këtë arsye, është tejet e rëndësishme që, përpara futjes së teknologjive të reja të shpimit që mund të propozojnë për përdorim kompanitë e naftës, të kryhen studime për të përcaktuar nëse teknika të tilla mund të kenë ndikime në mjedis në zonat e shfrytëzimit.

Programe që rregullojnë veshjen e puseve: veshja e puseve ose izolimi i tyre efikas parandalon rrjedhjet e ndryshme që mund të shkaktohen gjatë aktivitetetit naftënxjerrës dhe depërtimin e përbërësve të naftës në shtresa të ndryshme të tokës dhe në ujë gjatë aktivitetit. Për këtë arsye, shumë shtete të zhvilluara rregullojnë aktivitetin e shpimit dhe veshjen e puseve me ligj ose përcaktojnë një sërë praktikash të mira që duhen ndjekur (si SHBA-të për shembull ku një rol të rëndësishëm e luan Instituti Amerikan i Naftës[216]).

Fatkeqësisht, në vendin tonë kuadri legjislativ në këtë rast është i paplotë. Ligji Nr. 7746, Datë 28.07.1993, "Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", i ndryshuar i kërkon kontraktorit (kompanive) të kujdeset për ruajtjen e mjedisit. Megjithatë, ky ligj nuk përcakton mënyrat e mbrojtjes së mjedisit nga kontraktori (kompanitë e naftës). Pra, mungon një kuadër legjislativ i posaçëm që të përcaktojë rregullat dhe teknologjitë që kompanitë e naftës duhet të zbatojnë për veshjet e puseve. Në përgjithësi, standardet për cilësinë e veshjeve të puseve përcaktohen nga vetë kompanitë e naftës.

Si rrjedhojë, sot *mungojnë të dhënat rreth* llojit të veshjeve të puseve dhe cilësisë së tyre e cila do të ndihmonte për të kuptuar se cilat zona, akuiferë apo burime ujore sipërfaqësore rrezikojnë ndotjen nga këto puse. Në Bashkinë Kuçovë, dihet vetëm se një numër i madh i puseve (të Albpetrolit) është braktisur dhe mendohet se kanë nevojë urgjente për mirëmbajtje dhe riparim për shkak të teknologjisë së tyre tepër të vjetër. Njëkohësisht *mungojnë edhe të dhënat specifike rreth llojit të teknologjisë së përdorur për veshjen e puseve nga kompanitë që kanë vepruar pas vitit 1990.*

Kjo mungesë të dhënash vështirëson identifikimin e problematikave mjedisore (nëse nafta ka arritur të depërtojë në shtresat e tokës dhe në ujëra sipërfaqësore e nëntokësore) dhe rehabilitimin e mjedisit.

Regjistrimi/identifikimi i puseve pa funksion dhe izolimi i tyre (dhe monitorimi): Në Bashki, industria e naftës ka funksionuar për dekada të tëra. Si rrjedhojë, një numër pusesh të vjetra janë mbyllur dhe puse të reja janë hapur. Edhe në këtë rast, praktika e izolimit të

puseve nuk rregullohet me ligj. Ligji Nr. 7746 përcakton Ministrinë si organ përgjegjës për hartimin e rregullores për ose në lidhje me masat lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe shmangien e rrjedhjeve, mbetjeve, ndotjes dhe aksidenteve. Megjithatë, deri më sot nuk ka të dhëna që një rregullore e tillë është hartuar. Si rrjedhojë, procedurat e mbylljes dhe izolimit të puseve në rast mosshfrytëzimi nuk përcaktohen me ligj

Për më tepër, legjislacioni nuk përcakton organin kompetent që mbulon shpenzimet për izolimin e puseve të braktisura, në rast se kompania falimenton. Procesi i izolimit të puseve është i kushtueshëm (rreth 4,500$ për pus në Teksas[217]). Në qoftë se kompanive nuk u përcaktohen rregulla të qarta ose kushte për mbulimin e shpenzimeve për izolimin e puseve (pagesa e një takse, garacie bankare për raste të tilla etj.) që në fillim të aktivitetit, rrezikohet ndotja e mjedisit në çdo rast që falimentojnë kompanitë e naftës.

Një problem tjetër shqetësues është edhe mungesa e monitorimit të puseve të braktisura. Cili është ndikimi i tyre në mjedis dhe në shendetin e banorëve mbetet ende e panjohur. Kjo vjen si pasojë e mangësive ligjore që detyron kompaninë të raportojë puset jashtë funksionit dhe gjendjen e tyre në Agjencinë Kombëtare ose Rajonale të Mjedisit me qëllim që të parandalohet ndotja e ujit dhe e tokës nëpërmjet puseve të tilla. Si rrjedhojë, sot nuk njihet numri i puseve pa funksion të izoluara dhe i puseve pa funksion të braktisura në territorin e Bashkisë.

Me qëllim shmangien e ndotjes nëpërmjet migrimit të fluideve në mjedis nga puset e paizoluara në të ardhmen, lind nevoja e përcaktimit të rregullave dhe procedurave për izolimin e puseve pas daljes nga funksioni, përcaktimit të përgjegjësive për mbylljen e tyre, dhe përcaktimit të palëve që mbulojnë shpenzimet në rast falimentimi të kompanive të naftës.

Pra, për shkak të boshllëkut legjislativ, Bashkia ndodhet përballë zgjidhjes së problematikave të puseve të paizoluar dhe parandalimit të problemeve që mund të shkaktohen nga mosizolimi i puseve në të ardhmen. Për këtë arsye, nevojitet identifikimi i puseve pa funksion të paizoluara dhe rehabilitimi i tyre (izolimi) si dhe plotësimi i kuadrit ligjor për hidrokarburet.

Masat parandaluese dhe të kontrollit të rrjedhjeve e depërtimit të naftës në shtresa të ndryshme të tokës dhe në ujëra sipërfaqësore e nëntokësore në rast problemesh teknike ose incidentesh në punë: edhe në këtë rast, kompanitë veprojnë sipas standardeve të tyre në mungesë të legjislacionit shqiptar.

Përdorimi i sasive të mëdha të ujit nga industria e naftës: Siç është theksuar më sipër, industria e naftës përdor sasi të mëdha uji gjatë aktivitetit të saj. Sasitë më të mëdha përdoren kryesisht gjatë shpimit (shpime të reja) dhe gjatë pastrimit të puseve të naftës. Vetëm për hapjen e një pusi është llogaritur se sasia e ujit të përdorur arrin nga 7 deri në 15 milion litra ujë[218]. Zakonisht, kompanitë shfrytëzojnë burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Në Bashkinë Kuçovë, kompanitë e naftës shfrytëzojnë burimet ujore sipërfaqësore (kryesisht lumin Osum e Seman)[219] ndërkohë që nuk ka të dhëna rreth shfrytëzimit të burimeve ujore nëntokësore. Shfrytëzimi i ujërave të Basenit të Semanit bëhet me leje shfrytëzimi të lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të Semanit (KBU Seman), ndërsa

shfrytëzimi i ujërave nëntokësore nën 15 metra bëhet me miratim nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.[220]

Shfrytëzimi i ujërave sipërfaqësore në sasi të mëdha mund të krijojë konflikt me sektorin e bujqësisë (veçanërisht në stinën e thatë të verës kur bujqësia ka më shumë nevojë për ujitje) dhe me sektorë të tjerë të ekonomisë, si dhe mund të krijojë probleme për manaxhimin e qëndrueshëm të lumit në të ardhmen për aq kohë sa nuk është hartuar Plani i Menaxhimit të Basenit të Lumit Seman[221].

Për asye keqmanaxhimi të Basenit, në Bashkinë e Kuçovës dhe në Bashki të tjera që preken nga lumi Seman dhe degët e tij (Devoll e Osum), nuk ka një regjistër të sasisë së ujit që përdor industria e naftës gjatë aktivitetit të saj së bashki me sektorët e tjerë të ekonomisë ç'ka vështirëson vlerësimin e ndikimit të industrisë së naftës dhe dhe sektorëve të tjerë të ekonomisë në Basenin e Semanit dhe në burimet ujore nëntokësore.

Shpimi i puseve drejtpërdrejt në Akuiferin e Beratit dhe ndikimi i tyre në cilësinë e ujrave të tij: Akuiferi i Beratit përdoret për furnizimin me ujë të popullsisë së disa fshatrave përreth në Bashki. Nga dixhitalizimi i puseve të naftës rezulton se një numër i konsiderueshëm pusesh janë shpuar drejtpërsëdrejti në Akuiferin e Beratit, veçanërisht puset në zonën e Kozarës, përgjatë lumit Devoll (figura x). Këto puse janë përdorur në të shkuarën dhe vazhdojnë të përdoren edhe në të tashmen për nxjerrjen e naftës ndërkohë që nuk dihet lloji i veshjeve anësore të puseve dhe gjendja e tyre si dhe nuk dihet rasti i incidenteve të prishjeve të shtresave të izolimit të puseve dhe rrjedhjet e naftës e produkteve të saj në ujërat e Akuiferit. Njëkohësisht, ujërat e akuiferit nuk monitorohen në vazhdimësi.

Legjislacioni shqiptar nuk përcakton nëse akuiferët si Akuiferi Kuaternar i Beratit ku kalojnë puset e naftës mund të vazhdojnë të shfrytëzohen për furnizim me ujë të popullsisë. Si rrjedhojë, mungesa e legjislacionit rreth mbrojtjes së akuiferëve nga shpimet industriale kërcënon rrezikun e banorëve që furnizohen me ujë nga ky akuifer (shihni seksionin e Burimeve Ujore Nëntokësore).

Ulja e relievit (tabanit) të tokës nga mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore: Ulja e relievit (tabanit) të tokës është proces që mund të ndodhë gradualisht ose në një kohë shumë të shkurtër për shkak të lëvizjes/spostimit nëntokësor të materialit tokësor[222]. Një ndër shkaqet kryesore të uljes së relievit është zvogëlimi i volumit të ujit nëntokësorë nën atë sipërfaqe, ose ngjeshja e sistemit të ujërave nëntokësore [223]. Pompimi i sasive të mëdha të ujërave nëntokësore të një akuiferi në SHBA, për shembull, është një ndër shkaqet kryesore të uljes së nivelit të tokës[224]. Ulja mund të jetë edhe e menjëhershme e cila mund të ketë ndikim katastrofik në sipërfaqe (shembje të mëdha të sipërfaqeve të tokës).

Nga biseda me përfaqësues të industrisë së naftës rezulton se burimet ujore që shfrytëzohen nga industria e naftës janë edhe akuiferët në thellësi mbi 200m[225]. Megjithatë, mungojnë të dhënat e burimeve ujore që shfrytëzojnë, vendndodhjen (studimet e SHGJSH-së rreth burimeve ujore iu referohen burimeve ujore të cekëta në përgjithësi), ndikimin e tyre në mjedis. Duke patur parasysh se industria e naftës ka nevojë të përdorë sasi të mëdha të ujit, rrjedh se industria e naftës (ashtu siç shpesh ndodh edhe me sektorë të tjerë si bujqësia), mund të shkaktojë ulje të relievit të tokës në zonat e shfrytëzimit të burimeve ujore nëntokësore.

Ri-injektimi i baltës dhe ujit shtresor: ndotja dhe tërmetet: Ri-injektimi i ujërave të përdorura nga industria e naftës është praktikë e hershme në vendin tonë dhe është përdorur si mënyrë për depozitimin përfundimtar të ujërave të përdorura/të ndotura nga industria e naftës. Kriteret që ndiqen për përcaktimin e mundësisë së ri-injektimit në puset e naftës janë të panjohura për publikun ashtu siç edhe si rrjedhojë është i panjohur edhe ndikimi në mjedis i ri-injektimit të këtyre ujërave.

Në shumë vende (si në SHBA), me qëllim shmangien e rreziqeve që mund t'i kanosen shëndetit të njeriut nga ndotja e ujit të pijshëm, ndalohet me ligj ri-injektimi në burime ujore nëntokësore që përdoren për furnizimin e popullsisë me ujë.[226]. Në rastet kur ri-injektimi lejohet, akuiferët që furnizojnë me ujë popullsinë nuk përdoren më si të tillë. Kjo ndodh vetëm në rastet kur vendoset se këto akuiferë nuk do të përdoren më për furnizimin me ujë të popullsisë në të sotmen ose në të ardhmen. Pra, konktrolli dhe rregullimi i procesit të ri-injektimit me ligj bëhet me qëllim mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja duke parandaluar migrimin dhe lëvizjen e ndotësve në burimet ujore nëntokësore gjatë procesit të ri-injektimit.

Në vendin tonë nuk ka ligje që rregullojnë procesin e ri-injektimit. Si rrjedhojë, nuk ka të dhëna rreth vendndodhjes së puseve ku ri-injektohen ujërat e përdorura/të ndotura, nuk njihet numri i tyre, nuk njihet sasia e ujërave të ri-injektuar, kriteret që ndiqen, afërsia me me burimet ujore të ëmbla ku kryhet ri-injektimi, monitorimit të puseve të ri-injektimit nga kompanitë dhe, mbi të gjitha, nuk njihet ndikimi i tyre në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Disa teknika si ***Teknika e shpimit me plasje me ujë*** (*hydraulic fiacturing*), për shembull, përveç se shumë e debatuar për dëmtimet që sjell në mjedis, është tejet e përfolur për tërmetet që mund të shkaktojë gjatë ri-injektimit të mbetjeve të lëngëta (baltës e ujit shtresor).[227] Tërmetet e shkaktuara mund të ndihen edhe në largësi deri në 10 milje nga pusi i ri-injektimit dhe në thellësi edhe më të mëdha se ajo e ri-injektimit. Edhe puset në të cilat nuk ushtrohet presion gjatë ri-injektimit mund të shkaktojnë tërmete[228].

Manaxhimi i mbetjeve të rrezikshme: gjatë aktivitetit industria e naftës nxjerr një sërë mbetjesh të rrezikshme të cilat duhen depozituar në venddepozitime të përshtatshme. Në vendin tonë, kompanitë grumbullojnë mbetjet e rrezikshme në zonën e tyre të kontratës. Megjithatë, ende nuk ka një zgjidhje përfundimtare të mbetjeve të rrezikshme në vend.

Vend-depozitimet e mbetjeve të lëngëta dhe të ngurta (gropat ekologjike/vaskat): Gropat ekologjike/vaskat e naftës në vendin tonë janë *landfill*e specifike ku depozitohen materialet e përdorura gjatë aktivitetit të nxjerrjes së naftës. Zona e Kuçovës, në zonat ku puset kanë teknologji të vjetër, edhe pse ka një aktivitet të theksuar të industrisë së naftës, sipas lejeve të mjedisit të lëshuara nga Ministria e Mjedisit në vitin 2014, nuk ka një gropë ekologjike, në të cilën të grumbullohen ujërat e prodhuara gjatë aktivitetit të naftës së bashku me mbetjet e ngurta. Si rrjedhojë, mbetjet e naftës janë depozituar pranë vend-depozitimit të mbetjeve urbane duke ndotur tokën dhe ujërat sipërfaqësore e nëntokësore. Kjo nënkupton se mbetjet, balta dhe ujërat e përdorura për pastrimin e puseve të naftës përfundojnë përreth puseve, në vend-depozitimet e mbetjeve urbane, të ri-injektuara ose me derdhje të lirë. Në fakt, për vite me rradhë, ujërat e dekantimit në territorin e Bashkisë derdhen të lira në lumin Devoll pa asnjë trajtim paraprak duke ndotur kështu lumin dhe Akuiferin e Beratit nga i cili ky i fundit ushehet pjesërisht.

- **Përfundime dhe rekomandime**

Zona naftëmbajtëse e Kuçovës vazhdon të shfrytëzohet nga kompani nafte të cilat veprojnë me teknologji të ndryshme. Veprimtaria e tyre ndryshon lidhur me ndikimin e industrisë në tokë. Megjithatë, në të dyja rastet mbeten ende shume të panjohura si ndikimi i industrisë në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore sipërfaqësore e nëntokësore, në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (në cilësinë e ujërave të Akuiferit Kuaternar të Beratit), vend-depozitimi i mbetjeve të rrezikshme të ngurta e të lëngëta të prodhuara gjatë aktivitetit, masat e marra për parandalimin dhe kontrollin e rrjedhjeve të naftës gjatë aktivitetit, sasia e ujit (baltës/ujit të prodhuar dhe ujit shtresor) që prodhojnë gjatë aktivitetit, vendi i depozitimit të këtij uji të përdorur, puset e ri-injektimit të ujërave të përdorura dhe ndikimi i tyre, numri dhe vendndodhja e tyre, nëse ka të tillë, gjendja dhe kushtet e puseve të ri-injektimit dhe tërmetet e mundshme nga ri-injektimi etj.

Në shumë vende të botës, shumë procese të industrisë së naftës si hapja e puseve, mundësia e hapjes së puseve në rast se afër puseve gjendet një akuifer, lloji i veshjeve të puseve me qëllim mbrojtjen e mjedisit, ri-injektimi, vend-depozitmi i mbetjeve, etj. Janë rregualluar me ligj. Në vendin tonë, kuadri ligjor për mbrojtjen e burimeve ujore nga industria e naftës në veçanti ka boshllëqe duke lejuar që kompanitë të përcaktojnë vetë rregullat e mbrojtjes së mjedisit. Për këtë arsye, rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për rregullimin e aktivitetit naftënxjerrës në mënyrë që të shmanget ndotja e mjedisit deri në një pikë të pakthyeshme .

Duke patur parasysh rreziqet që i kanosen shëndetit të njeriut dhe mjedisit, rekomandohet që Bashkia të marrë masa për pastrimin dhe rehabilitimin e zonave të nxehta mjedisore dhe kontrollin e ndotjes nga industria e naftës, vend-depozitimi i mbetjeve etj.

Rekomandohet që fillimisht të mbyllen dhe rehabilitohen të gjitha puset jo aktive në Kuçovë, të krijohen zona buferike rreth këtyre puseve ku aktiviteti bujqësor të jetë i ndaluar si edhe industria e nxjerrjes së naftës të investohet në rehabilitimin e puseve të vjetër dhe trajtimit intensiv të ndotjes së gjeneruar nga këto puse.

Monitorimi i shkarkimeve dhe trajtimit të ujrave të ndotura industriale dhe urbane duhet të përfshihet në axhendën e Inspektoriatit Mjedisor Rajonal, duke referuar kështu në mënyrë dinamike cilësinë e ujërave sipërfaqësor të Bashkisë Kuçove si edhe të adresohet secili shkelës nëpërmjet parimit ndotësi-paguan.

1.4.3 Peizazhi, pyjet, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

- **Pyjet dhe Kullotat nën Administrim**

Ruajtja e natyrës dhe e biodiversitetit përbëjnë aktualisht një ndër problemet më të mëdha në vendin tonë. Ekosistemet pyjore luajnë një rol të rëndësishëm në qarkullimin global të karbonit. Dioksidi i karbonit (CO_2) thithet nga pemët nëpërmjet fotosintezës ku gjatë rritjes depozitohet në dru, lëvore, gjethe e rrënjë. Sipërfaqet pyjore shërbejnë si rezervuar karboni, ndaj shtimi apo përmirësimi i këtyre sipërfaqeve do të ndihmonte në reduktimin e dioksidit të karbonit në atmosferë. Në kuadër të protokollit të Kjotos ku bën pjesë edhe Shqipëria, shtetet janë dakordësuar të luftojnë efektin serë nëpërmjet uljes së sasisë së karbonit, nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Nëse ky objektiv arrihet, krijohen kapacitete të lira karboni (kredite karboni), të cilat mund të shiten tek vendet me teprica karboni.

Mirëadministrimi i pyjeve dhe kullotave nga Bashkia Kuçovë, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e situatës aktuale. Njësitë Administrative (NjA) nëpërmjet planeve të manaxhimit të pyjeve dhe kullotave mund t'i ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha ku ka aktivitete të punimeve pyjore. NjA-të, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drunjve të lartë mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit. Sipas ndarjes administrative dhe ligjit të vetëqeverisjes vendore,

Sipas ndarjes administrative të vitit 2015, Bashkisë Kuçovë dhe 3 NjA-ve përkatëse u janë transferuar me VKM këto sipërfaqe pyjore sipas ekonomive të ndara[229]:

- **Kozare**[230]; – 763.13 ha, prej të cilave 736.33 ha janë të rakorduara, ku 234.27 ha i përkasin kategorisë djerrë, 1.28 ha jo-produktive, 53.4 ha kullotë, 61.85 ha pyll mbrojtës me trungishte, 143.86 ha pyll prodhues me shkurre, 123.22 ha pyll prodhues me cungishte, 3.3 ha pyll prodhues me trungishte (Pishë Mesdhetare), 124.05 ha sipërfaqe bimësi kyjore.
- **Perondi**; – 754.188 ha, prej të cilave 116.09 ha janë sipërfaqe me bimësi pyjore, 144.7 ha kullota, 186.35 ha pyll prodhues, 160.7 pyll prodhues me shkurre, 30.1 ha djerrë, 1.8 ha jo produktive, 30 ha pyll lisi, 1.7 ha sipërfaqe bosh dhe 77.75 ha pyll me pisha;
- **Lumas** – 3273.81 ha,prej të cilave2.39 ha janë djerrë, 61.1 ha jo-produktiv, 25.4 ha jo-prodhues, 225.15 ha kullotë, 80.61 ha pyll mbrojtës, 2,869.46 ha pyll prodhues, 5 ha sipërfaqe bosh dhe 4.70 ha sipërfaqe shkëmbore.
- Në total, sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor në pronësi/përdorim të Bashkisë Kuçovë është 4791.13ha.

Bashkia Kuçovë disponon të gjitha materialet përfundimtare të pronave pyje dhe kullota që ka marrë në pronësi sipas ndarjes së re administrative-territoriale, Regjistrin e ngastrave, disa nga hartat përkatëse të fondit pyjor në shkallën 1:25,000 të viteve 1984-1985, ku pjesa më e madhe e tyre janë në cilësi të dobët e lexueshmëria e legjendave përkatëse bëhet e pamundur. Aktualisht ka filluar procesi i dixhitalizimit të këtyre hartave me ndihmën e VKM-ve, dokumentave e relacioneve, si dhe tekste të tjetra përkatëse, ekspertëve lokalë të pyjeve dhe kullotave, si dhe nëpërmjet vizitave verifikuese në terren.

Fondi Pyjor është paraqitur në GIS duke u bazuar tek hartat e viteve 1984-1985 dhe ndryshimet e fondit pyjor të identifikuara në ortofoton e 2006-7 dhe *Google imagery 2016.*

Nëpërmjet kësaj analize rezulton se, sipas ndarjes së re administrative në inventarin tabelar, Bashkia Kuçovë ka 4,791.13ha pyje, të cilat nuk përputhen me sipërfaqet pyjore të hartave të Pyjeve dhe Kullotave të inventarizuara në vitet 1984-5 dhe as me sipërfaqet pyjore të ortofotos 2006-07.

Sipas hartave të vjetra të viteve 1984-1985 janë 4,423ha sipërfaqe pyjore, pra 368.13ha më pak, ndërkohë sipas hartografimit të ortofotos së vitit 2006-7, rezulton se vetëm 2153ha janë pyje, pra 2,638.13ha më pak shfaqet sipërfaqe e tjetërsuar në tokë bujqësore.


Tabela 29. Humbjet në sipërfaqe pyjore

Burimi i Sip. Pyjore	Sip. Pyjore (ha)	Sip. e humbur (ha)
Sip. Pyjore sipas inventarit tabelar të Bashkisë Kuçovë	4791.13ha	
Sip. Pyjore sipas Hartave të Pyjeve dhe Kullotave (Inventarizuar 1984-1985)	4 423ha	368.13ha
Sip. Pyjore sipas ortofotos 2006-7	2153 ha	2638.13ha

Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Berat/Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016.

Ndonëse analiza është kryer në GIS, vlen të merret parasysh ekzistenca e një marzhi të vogël gabimi pasi hartat e vjetra janë të një teknologjie të vjetër, lexueshmëria e legjendës dhe simbolikës është e vështirë, si dhe ka mbivendosje apo problem përshtatjeje me ortofoton e vitit 2006-7. Po ashtu, ka një marzh gabimi si pasojë e ndryshimeve në territor. Vizitat e vazhdueshme në terren dhe konsultat mes specialistëve të pyjores dhe banorëve/pronarëve kanë ndihmuar deri diku në saktësim, por vazhdimësia e tyre nga Bashkia mund të zgjidhë këtë ngërç, duke saktësuar përfundimisht informacionin/analizën e më tejshme.

Figura 72. Harta e fondit pyjor Bashkia Kuçovë



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Berat/Kuçovë, Përpunoi Co-PLAN, 2016.

- **Përfundime dhe Rekomandime**

Kushtet klimatike, hidrologjike dhe gjeomorfologjike në territorin e Bashkisë Kuçovë mundëson një larmishmëri drurësh ndër të cilët vlen të veçohen dhe shtohen sipërfaqet e mbjella me; Ekualipt, Pisha e butë, Plepi, Dafina dhe Bliri pasi këta janë disa nga llojet të cilët janë përshtatur më së miri në territorin e Bashkisë si dhe ndikojnë në përmirësimin e klimës industriale që karakterizon këtë zonë. Ekualipti (Ekualiptus globulus) ndikon në përmirësimin e ajrit, Pisha e butë (Pinus pinea), përmirëson ajrin dhe shton vlerat estetike të sipërfaqeve pyjore me kurorën e saj ovale si dhe është mjaft rezistente ndaj erërave, Plepi (Populus canadensis) për pyllezimin e brigjeve të lumenjve (zonave ripariane) pasi ndikon në mbrojtjene tyre nga erozioni, Dafina (Laurus nobilis), përmirëson cilësinë e ajrit dhe

merr vlera ekonomike si bimë mjeksore si dhe Bliri (Tilia cordata) për vlerat ekologjike që ka.

Për më tepër në sipërfaqet e fondit pyjor është e nevojshme të ndërmerren disa hapa për përmirësimin e gjendjes së pyjeve dhe kullotave. Të tilla mund të jenë:

- Kryerja e një studimi të hollësishëm me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë shkaktuar tharjen e llojeve të bimësisë pyjore rrap, dushk dhe plep në seksione të ndryshme të trupave ujor në territor.
- Studimi i hollësishëm për përcaktimin e mundësisë së rehabilitimit të sipërfaqeve të djegura që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale si pisha e butë.
- Mbajtja nënkontroll e sëmundjeve (koncesionares) dhe dëmtuesve, ku shkalla e prekjes është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm.

Marrja e masave për parandalimin e zjareve si krijimi i një rrjeti për njoftimin e rënies së zjarreve (barinjtë mund të luajnë një rol tejet të rëndësishëm në këtë rast), ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien përpara përgjegjësisë të gjithë kundravajtësve që shkaktojnë zjaret, etj.

- **Peizazhi dhe tipologjitë përkatëse**

Analiza peizazhistike e ndjekur për leximin e tipologjive të peisazhit në territorin e Bashkisë Kuçovë kryhet nëpërmjet qasjes ekologjike/mjedisore të leximit të territorit. Peizazhi dhe imazhi që ai ofron prioritatizohet në këtë analizë. Duhet të kuptohet se peizazhi është ajo çka duket në territor mbi sipërfaqen e tokës dhe mund të studiohet në dy drejtime: i) estetik; ii) funksional dhe në lidhje me shërbimet e ekosistemit. Të dyja këto drejtime janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjerën dhe në fakt, aspekti funksional ndikon mbi atë estetik. Pra mes shumë zgjidhjeve estetike që mund te realizohen në peizazh, zgjidhen ato që garantojnë pacënueshmërinë dhe mbrojtjen e mbarështimin e funksoneve dhe shërbimeve ekologjike.

Peizazhi është ndarë në pesë fasha (tipologji) kryesore; ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor***. Ndarja e fashave, ndonëse mbetet konceptuale për shkak të shkallës (studim në nivel territori të të gjithë bashkisë), elementët e forta si rrugë, sipërfaqe ujore, fusha apo kodra janë identifikuar fillimisht nga ortofoto dhe vizitat në terren dhe më pas janë përdorur si pika referimi për ndarjen e kufijve mes fashave.

Komponentët mjedisorë të kësaj analize kanë si qëllim identifikimin e tipologjive të peizazhit duke u fokusuar më pas tek elementet përbërëse të **Peizazhit Natyror**. Qëllimi i analizimit të elementeve të peizazhit natyror mbetet mbrojtja e tyre dhe e funksioneve të tyre nga aktiviteti njerëzor dhe më specifikisht ai bujqësor pasi zhvillimi i vrullshëm urban ka copëzuar pjesën më të madhe të këtyre elementeve, të cilat janë vendimtare në ruajtjen e biodiversitetit të Bashkisë Kuçovë. Këto elemente janë identifikuar e më pas interpretuar në hartën përkatëse për të vënë në pah anët e mira, problematike dhe dobësitë e elementëve mbizotëruese të peizazhit natyror. Objektivat e pritshme të kësaj analize janë:

- Identifikimi i shumëllojshmërisë peisazhistike (fashave), duke përdorur elementet natyrore lokale me nevojë të ulët për mirëmbajtje, të cilat ndjellin dhe forcojnë peisazhin vendas;
- Ruajtja e karakteristikave vizuale të fashave;
- Identifikimi dhe ruajtja e funksioneve e për rrjedhojë e shërbimeve të ekosistemit përmes masave që do të propozohen;

- Identifikimi dhe sigurimi i zonave të pushimit, monumenteve identifikuese (*landmarks*) në të gjitha tipologjitë e peizazheve të gjetura brenda territorit të Bashkisë;
- Propozimi dhe sigurimi i zonave "*tampon*" për të reduktuar ndotjen akustike në peizazh, të shkaktuar nga zonaturbane e industriale, për të bllokuar erën dëmtuese në zonat rurale si dhe për të ofruar barrierë në fashën natyrore me qëllim krijimin e "zemrës" së habitatit të pa ndikuar nga aktiviteti njerëzor.

Një analizë e tillë konsiderohet risi për kontekstin shqiptar, e aq më tepër për Bashkinë Kuçovë, në kushtet kur problemet madhore të ndotjes së dukshme të ekosistemit, ndryshimet klimatike, humbjet në biodiversitet dhe rritmet e shpejta të aktivitetit njerëzor e urban, shpesh herë e anashkalojnë aspektin peizazhistik, ndoshta duke e konsideruar thjesht estetik. Edhe një herë theksojmë se aspekti estetik i pezazhit është tejet i rëndësishëm pasi trajtimi i duhur rrit vlerën e territorit për qëllime ekonomike. Megjithatë, çdo ndërhyrje në peizazh që shpesh lexohet si estetike, në thelb është një masë (mundësisht jo teknologjike, por natyrore) që ruan ekosistemin, shërbimet e tij dhe sigurinë e jetës së qytetarëve. Shumë nga propozimet në këtë seksion por edhe në vijim në rastin e zonave të mbrojtura, të bregdetit, lumenjve etj. janë masa peizazhistike për konservimin e shërbimeve të ekosistemit.

Termat e përdorura në analizën peizazhistike janë pjesërisht të njohura përmes legjislacionit për zonat e mbrojtura, dhe një pjesë tjetër të importuara dhe përshtatura nga literatura për peizazhin. Kuptimi i tyre është si më poshtë:

- ***Ekosistem***[231] është një kompleks dinamik komunitetesh: bimë, kafshë, mikrobe dhe mjedisi jo i gjallë, që ndërveprojnë si njësi funksionale.
- ***Matrica*** është mbulesa e tokës, dominuese dhe e nderlidhur mbi pjesën kryesore të sipërfaqes së tokës (p.sh. pylli, bujqësia, urbanizimi)
- ***Copëzat e tokës*** janë zona shumë këndore (jo lineare), më pak të bollshme dhe të ndryshme nga matrica.
- ***Rrip i gjelbër*** është vijë lineare bimësie autoktone (barëra, shkurre, etj) e cila shpreh lagështinë sezonale të dherave në territor.
- ***Ngastra*** janë tipe të izoluara bimësie ose habitate të cilat tregojnë modele të përsëritura (p.sh. një grupim me pisha). Ngastrat duhet të jenë aq të mëdha sa të mund të sigurojnë ***zemrën e habitatit*** ose pjesën e brendshme të tij. Për shumë specie, brendësia e habitatit fillon reth 50m në thellësi të habitatit (matur në lidhje me kufirin).
- ***Korridori*** është një copëz toke lineare ose ezgjatur, që lidh copëzat e tjera të tokës në matricë si ngastrat etj. Ato luajnë një rol të rëndësishëm si shtigje kryesore për lëvizjen e energisë, materialeve dhe organizmave. Korridori mund të jetë i vazhdueshëm, i fragmentarizuar, si dhe i gjerë apo i ngushtë.
- ***Mozaiku*** është një përmbledhje e copëzave të tokës, ku asnjëra prej të cilave nuk është aq dominuese sa të ndërlidhet nëpër peizazh. (bashkësia e ngastrave dhe korridoreve në një peizazh përbën një mozaik).
- ***Zonë Ripariane*** është një zonë me pemë dhe shkurre, e vendosur afer përrenjve, liqeneve, pellgjeve dhe tokave të lagura. Zona merr ndotjen nga derdhjet sipërfaqësore dhe vërshimet e ujërave të cekëta nën sipërfaqe. Gjithashtu, rrit

mbrojtjen e habitait të jetës së egër, ndikon në temperaturën e ujit dhe ndihmon në stabilitetin e brigjeve të përroit.

- ***Erëpritës (quhet zone amortizuese tek harta e elementeve peizazhistik por do nderruar ne ereprites pasi tingellon me shqip)*** është një ose shumë radhë pemësh ose shkurresh të cilat mbrojnë dheun nga erozioni i erës, bimët e ndjeshme, manaxhojnë dëborën, përmirësojnë efikasitetin e kullimit, mbrojnë bagëtitë dhe strukturat, krijojnë ose rrisin habitatin e jetë së egër.
- ***Zonë Amortizuese*** (i referohet **zonës buferike** në ligjin nr. 8906[232]) është zonë e cila mbron zemrën e habitatit dhe llojet.
- ***Pyll mbrojtës,*** sipas ligjit nr. 9385[233], *"Pyje mbrojtëse janë pyjet e përcaktuara kryesisht për qëllime mbrojtëse të vetë pyllit, të tokës pyjore dhe të tokave, që shtrihen përreth zonave urbane, pellgjeve ujëmbledhëse, për të luftuar a parandaluar dukuritë e gërryerjes, të ndikimit të erërave, çrregullimeve në rrjedhjet ose burimet ujore dhe sigurimin e funksioneve ekologjike".* Por është tërësia e bimësisë (pjesa më e madhe janë bimë autoktone të zonës) në një habitat e cila siguron ***zemrën e habitatit*** ose pjesën e brendshme të tij. Pylli mbrojtës zakonisht karakterizohet nga bimësi kompakte ku vërehen të treja katet (barërat, shkurret dhe pemët) por nuk mund të shihet në brendësi të pyllit.
- ***Pyll produktiv*** karakterizohet nga bimë frutor si ulliri dhe cungishte si lisi të cilat mbillen dhe menaxhohen nga njëriu por njëkohësisht kanë rol të rëndësishëm në mjedisin e egër pasi specie të ndryshme ushqehen dhe strehohen në këto pyje.
- ***Fragmentizim*** është ndarja në seksione të peizashit (urban, industrial, rural dhe natyror) nëpërmjetë rrugëve, shtrirjes së tokës bujqësore apo infrastrukturës njerëzore, e cila krijon pengesa për rrjedhën normale të aktiviteteve të jetës së egër në territor.

Funksionet/Shërbimet e ekosistemit që janë marrë në konsideratë janë:

1. **mbështetëse** *(supporting)*: Këto nevojiten për të bërë të mundur prodhimin shërbimet e 3 kategorive të tjera në vijim (habitat i përshtatshëm për riprodhim, ciklet e ujit dhe të *nutrientëve*, materiali gjenetik dhe evolucioni për specie e egra, formimi i tokës dhe mbajtja *(retention)* e saj).
2. **siguruese/prodhuese** *(provisioning)*: Ekosistemi ofron një sërë të mirash materiale dhe shërbimesh për konsum njerëzor (*ushqim, ujë, energji, lëndë të parë, burime mjekësore, dekorime*).
3. **rregulluese** *(regulating)*: Procese ekologjike dhe sisteme të mbështetjes së jetës përmes cikleve e proceseve biogjeokimike dhe biosferike (cilësia e ajrit, rregullimi i klimës, zbutja e shqetësimeve – mbrojtja nga përmbytjet dhe stuhitë e kontrolli i erozionit, pastrimi i ujit/cilësia e trajtimi i mbetjeve/ndotjes, polinimi, kontrolli biologjik etj.)
4. **kulturore/informative:** zhvillim mendor dhe i njohies (estetik, shëtitje në natyrë, veprimtari rekreative dhe turistike, frymëzim kulturor dhe artistik, vlera historike e shpirtërore, arsim dhe shkencë etj.)

Figura 73. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat)



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016.

Analiza Peizazhistike e Bashkisë Kuçovë trajton një sërë komponentësh peizazh-formues, të cilët kategorizohen në: ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor***. Krijimi i fashave peizazhistike lidhet ngushtë me formacionet territoriale, hidrogjeologjinë dhe hidrografinë, si dhe pjerrësitë e terrenit. Pjesa verilindore-lindore dhe lindore-juglindore e territorit karakterizohet nga shkëmbinj pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor, ku pjerrësia varion nga 42% në 100%. Pjerrësia 0%-42% i përket zones veriperëndimore-jugperëndimore ku shtrihen edhe akuiferet me porozitet ndërkokrrizor dhe poro – çarje, të cilët në një fare mënyre kanë orientuar edhe zhvillimin urban dhe bujqësor, për shkak të afërsisë me burimin ujor.

Megjithëse këta komponentë kanë tipologji të ndryshme nga njeri-tjetri dhe gjenden në zona të ndryshme të territorit, parë në shkallë peizazhi ata unifikohen në një të vetëm, duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda kufirit bashkiak.

Ky diversitet peizazhistik dominohet nga ***fasha rurale***, e cila karakterizohet nga toka bujqësore, toka të hapura të pozicionuara në mënyrë "informale", grupime pemësh/shkurresh, pemë të mbjella në rresht (vijë tampon) të cilat herë duken të mbjella nga njeriu e herë në mënyrë spontane nga natyra, trupa ujorë (lumenj, kanale, rezervuare, etj.) dhe ***fasha natyrore,*** e cila është edhe fasha më komplekse në matricën peizazhistike. Kjo fashë karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, korridore të gjelbëra apo ujore, zona tampon, zona ripariane, zemra e habitatit, ngastra, si dhe mozaikë. Po në këtë fashë përfshihet edhe sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura natyrore brenda territorit të Bashkisë Kuçovë.

Figura 74. Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondi pyjor



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Berat/Kuçovë, Përpunoi Co-PLAN, 2016

Ndonëse një fashë komplekse dhe me diversitet të larmishëm biologjik, për shkak të zhvillimit njerëzor në tërësi dhe bujqësor në veçanti, fasha natyrore shfaqet e fragmentuar në tërësinë e vet.

Dy tipologjitë e tjera peizazh-krijuese të Bashkisë Kuçovë janë ***fasha/njolla urbane***; ku peizazhi shpaloset në zona banimi dhe shërbimesh me një karakter "***formal***". Këtu, peizazhi karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh dekoruese, parqe si dhe zona tampon.

Peizazhi industrial shfaqet i pa ndashëm nga fasha urbane, me përjashtim të pjesës jugperëndimore të territorit, specifikisht në Njësinë Administrative Perondi. Ky peizazh ka po ashtu karakter "***formal***", ndonëse bimësia është më e rallë. Po ashtu, në krasitjen e paraqitjen e tyre i përkushtohet rëndësi dekorimit, më tepër se sa funksionit dhe shërbimit mjedisor. Si në rastin e pemëve në peisazhin urban, edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi, apo publike.

Fasha e fundit është ajo e ***sipërfaqeve ujore***, e cila karakterizohet nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale. Peizazhi ujor dominohet nga lumenjtë Devoll në perëndim-qendër dhe Lapardha në lindje të territorit.

Ndonëse pjesë dominuese dhe e pandashme e peizazhit urban, ***rrugët*** ashtu si edhe sipërfaqet ujore shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë, duke krijuar "çarje" të tipologjive peizazhistike. Nga ana tjetër, ato krijojne edhe lidhje fizike e pamore mes tipologjive peizazhistike. Këto rrugë u përkasin kategorive të ndryshme nga madhësia, po ashtu edhe funksioni, por elementi i përbashkët dhe i pa ndryshuar mbetet peizazhi. Në hartën më poshtë (***Harta Peizazhistike dhe Rrugët***), rrugët shfaqen si "kanale" lidhëse pa trashësi të përcaktuar, apo kategorizim funksional. Pra në vend të funksionit e lidhjes që ato krijojnë mes zonave, në analizën peizazhistike, ato karakterizohen vetëm nëpermjet imazhit që secila përcjell në fashën peizazhistike ku kalon.

Figura 75. Harta peizazhistike dhe rrugët



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016.

- **Elementet përbërëse të peizazhit natyror të territorit**

Identifikimi i elementeve peizazhistike në fashën natyrore të territorit të Bashkisë Kuçovë, ku pjesë e pandashme janë edhe sipërfaqet e Fondit Pyjor dhe të Zonave të Mbrojtura Natyrore, merr rëndësi të veçantë, pasi identifikimi dhe leximi i këtyre elementeve ndikon drejtpërsëdrejti në të kuptuarin e biodiversitetit lokal, potencialin e ekoturizmit si dhe gjendjen e fondit pyjor, përfshirë mbrojtjen e tij e të fashës natyrore në tërësi nga rreziqet natyrore dhe njerëzore. Elemente të peizazhit natyror që gjenden në territorin e Bashkisë Kuçovë, si ***zonat ripariane***, ***korridoret***, ***kopshtet ujëmbajtëse*** etj., luajnë një rol të rëndësishëm edhe në krijimin e mikroklimës në zonat ku ato shtrihen. Zonat *ripariane*, të cilat natyrshëm shtrihen përgjatë trupave ujor si lumenj, përrenj, kanale dhe rezervuare ndalin erozionin ujor, krijojnë strehë dhe ofrojnë ushqim për gjallesat e ndryshme ujore e tokësore që frekuentojnë ketë mjedis, krijojnë mikroklimë të vetën, ofrojnë habitatin e nevojshëm për mbarështimin e këtyre specieve dhe mbrojnë burimet ujore nga derdhja e nutrientëve (ushqyesve me tepricë), që rezultojnë nga përdorimi i kimikateve në tokë bujqësore.

Figura 76. Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia autoktone si pasojë e zhvillimit të bujqësisë



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016

Zhvillimi dhe zgjerimi i tokave bujqësore në tëresi të territorit dhe sidomos përgjatë trupave ujorë ka ngushtuar, copëzuar dhe zhveshur në mënyrë të theksuar zonat ripariane nga bimësia si në burime *Lentike* (afër ujrave të ndenjura, si liqenet dhe pellgjet) dhe *Lotike* (afër ujrave rrjedhës, si lumenjtë dhe përrenjtë). Lumi Devoll shfaq dukshëm këtë fenomen. Nga 12.5km gjatësi që ka lumi përgjatë shtrirjes së tij në territorin e Bashkisë Kuçovë (Fshat Frashër - Arrëz), vetëm 2.34km janë zonë ripariane e cila ka mbetur e pa tjetërsuar në tokë/aktivitet bujqësor apo tjetërsuar si pasojë e urbanizimit. Bimësia lokale në to karakterizohet me bimësi; kallami, robinja (Robinia Pseudoacacia), rrapi (Latanus), shelgë (Salix), plepi i bardhë (Populus Alba) dhe shkurre autoktone. Në sipërfaqet ku zona ripariane ende ekziston, shtresat përbërëse të saj si ajo e sipërme, mesme dhe e mbulimit të tendës rrallë gjenden të pa ndikuara nga aktiviteti njerëzor. Herë ka humbur shtresa e mbulimit të terrenit në zonën e sipërme të tokës, e cila kryen filtrimin e ndotësve dhe të sedimenteve të derdhjeve sipërfaqsore dhe herë shtresa e mesme e tendës në zonën bregore ku gjenden shkurret e larta dhe pemët të cilat nëpërmjet rrënjëve stabilizojnë anët e përroit. Si pasojë: nga një anë aktiviteti bujqësor ka dëmtuar zonën ripariane e nga ana tjetër erozioni lumor ka përparuar në dëm të tokave bujqësore duke gërryer brigjet, marrë tokë, shkaktuar përmbytje dhe shkarkuar sedimentet ujore mbi toka.

Rripat e gjelbër, korridoret dhe korridoret lidhës marrin një rol po aq të rëndësishëm sa edhe zonat ripariane, pasi ato luajnë rolin e venave në peizazh duke ***lidhur*** parcelat, ngastrat, sipërfaqet ujore, apo matricat peizazhistike me njëra-tjetrën. Ato ofrojnë edhe ***vendkalime*** për specie të ndryshme, mbrojnë biodiversitetin lokal si dhe krijojnë ***barrierë*** natyrore për erën. Në territorin e Bashkisë Kuçovë rripat e gjelbër, parcelat e lidhura dhe ato të ndara dominojnë peizazhin natyror. Ato ndahen në dy kategori; ***natyrore*** dhe ato ***të mbjella*** nga fermerët me bimë si; robinja (Robinia Pseudoacacia), rrapi (Latanus), shelgë (Salix) dhe plepi i bardhë (Populus Alba), të cilët në pjesën më të madhe shtrihen përgjatë tokave bujqësore si elemente ndarës pronësie por edhe si pasojë e kushteve të krijuara për rritjen dhe zhvillimin natyror të këtyre bimëve në këto rripa të gjelbër dhe koridore.

Figura 77. Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës



Burimi: Google Imagery, 2016

Korridoret (të cilët karakterizohen nga shërbimet e shumëta ekologjike në përgjithësi të përherëshme si strehimi, ushqimi e vendet e riprodhimit për jetën e egër, por edhe ato të

përkohëshme si vendkalimet dhe ushqimi sezonal) dhe korridoret lidhës të cilët janë në shkallë më të vogël dhe si pasojë ofrojnë shërbime ekologjike të përkohëshme ku shërbimi kryesor mbetet kalimi i jetës së egër nga një pikë në tjetrën) shfaqen të copëzuar herë-herë në formë parcele apo ngastre, por kanë rol kyç në ruajtjen e biodiversitetit dhe mikroklimës, ndaj rimëkëmbja e këtyre sistemeve do të shtonte/risillte specie të ndryshme të faunës lokale. Në tërësi nga elementet përbërëse të peizazhit natyror në Bashkinë Kuçovë mbizotërojnë: tokat e zhveshura, korridoret lidhëse, rripat e gjelbër, trupat ujorë dhe parcelat e ndara. Elemente të tjera si korridoret, ngastrat, rezervat, apo matricat janë tepër të copëzuara për shkak të aktivitetit njerëzore dhe fenomeneve gjeologjike.

Figura 78. Harta e Elementeve Peizazhistike



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016.

- **Përfundime**

Komponentët peizazh-formues si ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor*** të analizuar më sipër shfaqen në zona të ndryshme të territorit por problematika mbetet e njëjtë si pasojë e ndërveprimit mes tyre.

Peizazhi Urban dhe ***Industrial***, karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore ku llojet e tyre shfaqen të ndryshueshme sipas rrugës. Zgavrat ku këto pemë qendrojnë gjithashtu të ndryshueshme nga një rrugë në tjetrën, disa janë me bordura të ngritura e disa pa bordura. Ndërkohë pjesa më e madhe e përmasave të zgavrave të pemëve janë relativisht të vogla në raport me pemën. Grupime pemësh dekoruese apo në formë "ishulli" gjenden vetëm brenda hapësirave park apo lulishte dhe qëllimi është estetik e jo sipas funksionit dhe shërbimit mjedisor pasi "katet" e ndryshme të bimësisë mungojnë. Elementet urbane dhe industriale të forta/dominuese apo edhe të padëshiruara shfaqen herë-herë në zona të ndryshme të qytetit. Zona tampon apo brezat e gjelbër pengues të erës dhe imazheve urbane apo industrial të padëshiruar ndodh në mënyrë spontane e të paplanifikuar. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve parkim shfaqet e ekspozuar ndaj diellit pasi bimë gjethore për hijëzimin e këtyre hapësirave mungojnë. Gardhet e muret ndarës të pronave në disa zona janë mbi 2 metra të lartë dhe estetikisht "ngushtojnë" hapësirën e përbashkët si dhe ndjesia që ngjallin është ajo e mungesës së sigurisë.


Të tri tipologjitë e peizazhit ***rural, natyror*** dhe ***ujor*** karakterizohen nga elemente të ndryshëm por shkalla e lartë e ndërveprimit mes tyre bën që edhe problematikat e njërit të

shfaqen edhe tek tjetri. Sipërfaqet ujore të cilat karakterizohen nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale nuk mund të shihen veçmas nga fasha rurale e natyrore pasi here-herë ato shfaqen si "*hinkë*" ku marrin dhe mbajnë materialet organike në matricën përreth si dherat, farat etj, dhe herë thjesht si "*kanale*" ku rrjedh energjia, ushqimi etj.

Peizazhi ujor në tërësi dhe në veçanti ai lumor shfaqet i "fshehur" nga peizazhi urban. Bimësia "ripariane" mungon në pjesën më të madhe ndërkohë në pjesën tjetër përbëhet nga bimë të llojit bar dhe shkurre të ulëta. Ndërkohë kur trupi ujor përshkon fashën rurale dhe natyrore sërish humb një pjesë të konsiderueshme të zonës së tij ripariane si pasojë e tjetërsimit në tokë bujqësore dhe fenomenit gjeologjik të përshpejtuar si pasojë e prerjes së bimësisë në këto zona. Pra peizazhi ujor shfaqet si lidhës mes peizazhit rural dhe atij natyror.

Ndonëse pjesë dominuese dhe e pandashme e peizazhit urban, një tjetër element lidhës në territor janë ***rrugët.*** Ato krijojnë "çarje" mes fashave por edhe "lidhje" fizike e pamore mes tipologjive peizazhistike pasi si fasha ujore edhe ato shpërhapen në territor ku ndryshimi peizazhistik bëhet edhe më i dukshëm.

Figura 79. Harta e rrezikut ndaj elementeve peizazhistike



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Peizazhi ***Natyror*** mbetet më kompleksi ndër fashat peizazhistike. Ai karakterizohet nga një sërë elementesh peizazhistike të cilat shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë. Hartat më sipër shfaqin këto elemente dhe rreziqet me të cilët përballen disa prej tyre. Trupat ujorë rrezikojnë daljen nga shtrati si pasojë e tjetërsimit të zonës ripariane dhe shfrytëzimit të materialeve inerte si dhe fragmentimi i ngastrave natyrore dhe mungesa e theksuar e koridoreve të kalimit rrezikon largimin e jetës së egër nga ato kjo fashë.

- **Zonat e Mbrojtura**

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore[234].

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj[235] dhe zënë rreth 16%[236] të territorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kritere:[237] i) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, ii) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, iii) të ketë përfaqësueshmëri, iv) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, v) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, vi) të ketë vlera shkencore, vii) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, viii) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, ix) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe x) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Në vendin tonë, zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori, të cilat janë përshkruar më poshtë.

Tabela 30. Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave

Kategoria	Emërtimi	Karakteristikat
Kategoria I	Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.
Kategoria II	Park kombëtar	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.
Kategoria III	Monument natyror	Monumenti Natyror përfaqëson një formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralesh ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror[238].
Kategoria IV	Rezervat natyror i manaxhuar/Park Natyror	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i manaxhuar (zonë e manaxhimit të habitateve dhe llojeve).
Kategoria V	Rezervat natyror i manaxhuar/ Peizazh i mbrojtur	Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me reliev të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.
Kategoria VI	Zonë e mbrojtur e burimeve të manaxhuara /zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht, të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të manaxhuara.


Burimi: Ligji Nr 8906/.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868/2008

- **Zonat e mbrojtura në Bashkinë Kuçovë**

Bashkia e Kuçovës nuk ka zona të mbrojtura të shpallura. Megjithatë, me Reformën e re Territoriale, Bashkisë i është shtuar territori i NjA-së Lumas në pjesën juglindore të

Bashkisë së Kuçovës dhe ka një sipërfaqe prej 76.41km.[2239] Sipërfaqja pyjore zë rreth 3,273.81ha ndërsa ajo kullosore rreth 225,15ha.[240] Territori i NjA-së Lumas dallohet për një sipërfaqe të konsiderueshme natyrore të pasur me bimësi dhe botë shtazore të larmishme si dhe për zona me ineteres të veçantë turisik të panjohura për publikun deri më tani siç është Kanioni i Sinecit (Saraselit).

Figura 80. NjA Lumas, Kuçovë



Burimi : Bashkia Kuçovë, Co-PLAN 2016

- **Kanioni i Sinecit (Saraselit)**

Në NjA-në Lumas dhe në Bashkinë Gramsh gjendet Kanioni i Sinecit (Saraselit) i cili është shpallur ***monument natyre me Vendim nr. 676, date 20.12.2002.***[241] Sipas AKZM-së[242]ky kanion ndodhet pranë fshatit të Saraselit të komunës së Sultit, rrethi i Gramshit dhe është i gjatë rreth 1,5 km, rreth 300m i thellë dhe rreth 20-30m i gjerë.

Burimi i Sinecit gjendet në pjesën me karakter natyror të Bashkisë, në kufi me Bashkinë Gramsh dhe shquhet për një bukuri të rrallë natyrore. Burimi del me prurje të mëdha dhe rrjedh duke krijuar kanione të shumta. Burimi i Sinecit buron nga Akuiferi i Luzajt, akuifer karstik me përbërje gëlqerore me prurje rreth 50 l/sek[243]. I shtrirë në një gjeologji të tillë, pranë këtij burimi gjejmë forma interesante natyrore si ujëvara të vogla apo dhe shpella të ndryshme siç është ***Shpella e Xhixhilesë***, shumë pak e njohur për banorët dhe turistët. Peizazhi që ofrohet është i mahnitshëm. Gjarpërimet nëpër të cilin kalon ky burim ofrojnë një pamje piktoreske me gjelbërim me gjithfarë bimësh dhe drurësh, që nga ullinjtë, pemët frutore dhe deri tek bimët e ulëta të llojeve të ndryshme. Uji i pastër dhe i kthjellët rrjedh nëpër shkëmbinj karstikë duke krijuar forma të ndryshme bukurie natyrore si ujëvara të vogla, pellgje ku mund të notohet dhe kanione ku gjithësecili mund të ushtrojë sportin e kanoes/kajakut. Këto forma natyrore ofrojnë mundësinë e të shijuarit një pamje piktoreske në freskinë e një pylli drurësh, që përshkon brigjet e të dyja anëve të rrjedhës ujore. Sineci ofron mundësinë e shijimit të bukurive natyrore të rralla dhe me vlerë peizazhistike natyrore. Kanioni i Sinecit "ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike"[244].

Figura 81. Burimi i Sinecit me shkëmbinj gëlqerorë pllakorë



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016

- **Përfundime dhe rekomandime**

Duke qënë se në Bashkinë e Kuçovës nuk ka zona ose objekte të tjera të mbrojtura përveç Kanionit të Sinecit, rekomandohet që vendburimi dhe kanionet e Sinecit të zgjerohen si sipërfaqe në zonën e Kuçovës dhe të krijohet një park natyror i përbashkët ndërmjet Bashkivë Koçovë dhe Gramsh ku të përfshihen vendburimi i Sinecit së bashku me shpellën e Xhixhilesë dhe zona të tjera piktoreske. Një gjë e tillë mundëson ruajtjen e këtij burimi dhe kanioneve të tij si dhe shfrytëzimin e tij si një pasuri kombëtare dhe vendore për zhvillimin e turizmit.

- **Biodiversiteti në Shqipëri**

Sipas Ligjit nr. 9587/2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitet", me biodiversitet ose larmi biologjike nënkuptojmë shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë[245]. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

Shqipëria është një vend i vogël. Megjithatë, ajo dallohet për larmi të peizazheve dhe larmi biologjike[246], duke u radhitur në vendet e Europës që shquhen për biodiversitet të lartë.

Pjesa e Ultësirës Perëndimore është më e rëndësishme nga pikëpamja e biodiversitetit dhe larmishmërisë së tij, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga qyteti i Vlorës në jug e deri tek liqeni i Shkodrës në veri. Përveç faktit që kjo është një zonë bregdetare, Ultësira përshkohet nga lumejtë kryesorë të vendit të cilët rrjedhin nga lindja në perëndim. Vija bregdetare arrin gjatësinë 476km.[247] Zona veriore e vendit ka një reliev malor, ku karakterizohet nga diveritet i formacioneve shkëmborë që nga koha e Paleozoikut. Klima në Shqipëri përbëhet nga katër zona klimatike dhe 13 nënzona, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në biodiversitetin e pasur që ka vendi.[248]

Shqipëria ka një shumëllojshmëri të ekosistemeve dhe habitateve. Në terirtorin e vendit gjenden ekosistemet detare, zonat bregdetare, lumenjtë, liqenet, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje halore dhe fletore, kullota alpine dhe subalpine, si dhe ekosistemet e larta malore. Larmia e ekosistemeve dhe habitateve në Shqipëri mundëson një larmi të lartë të llojeve të kafshëve dhe të bimëve që rriten në to. Në Shqipëri gjenden rreth ***7,233 taksone bimore***[249] (bashkë me fiernat, likenet, kërpudhat, myshqet dhe algat) dhe ***5,438 lloje kafshësh***[250] (përfshirë shpendë gjitarët, zvarranikët, insektet, peshqit, etj.). Bimët me lule dhe algat mikroskopike janë grupi përfaqësues më i larmishëm dhe i pasur i llojeve të rradha, relike dhe endemike. Kjo për shkak të elementeve floristike të rajoneve.

Pyjet zënë rreth 33% të territorit, ose 1,041,000 ha, ndërsa *kullotat* zënë rreth 15% të sipërfaqes së territorit (400,000 ha). Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve dhe komuniteteve shtazore dhe atyre bimore.[251] Pyjet e larta strehojnë kryesisht gjitarët e mëdhenj si ujku, rrëqebulli, ariu, dhia e egër, si dhe shpendë të ndryshëm të cilët janë të lidhur me jetesën në pyjet e virgjëra. *Liqenet* e mëdha të vendit dhe lagunat bregdetare janë vendbanimet më të rëndësishme për shpendët, veçanërisht për dimërimin e atyre migratorë. Në këto hapësira, prej vitesh numërohen rreth 70 lloje shpendësh uji, të cilët përbëjnë një popullsi që arrin deri në 180,000 individë gjatë dimrit.[252] Shqipëria është edhe një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për shpendët migratorë dhe insektet.[253]

- **Speciet e rrezikuara në Shqipëri**


Në territorin e vendit gjenden rreth *91 lloje të kërcënuara speciesh në nivel global*. Në këtë listë përfshihen pelikani kaçurrel (Crispus crispus), breshka shqiptare e ujit (Pelophylax shqipericus) dhe blini (Acipenser sturio), për të cilat Shqipëria është një vend i rëndësishëm.[254] Sipas IUCN,[255] 109 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme taksonomike janë konsideruar si të kërcënuara. Lista e llojeve të bimëve të kërcënuara në vendin tonë e kalon atë të kafshëve, duke arritur shifrën 319 nga të cilat 76 janë të kërcënuara në formë kritike, 123 lloje konsiderohen në rrezik, dhe 120 lloje të përkeqësuara.

Tabela 31. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri

Kategoritë IUCN	Numri i llojeve të florës	Numri i llojeve të shpendëve
EX – Të zhdukura	0	5
CR – Të rrezikuara në mënyrë kritike	76	43
EN –Të rrezikuara	123	56
VU – Të pambrojtura	120	154
LR – Rrezik i ulët	59	238
DD – Mungojnë të dhëna	30	72
NE – Të pavlerësuara	3	7

Burimi: Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016[256].

Figura 82. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi



Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016[257]. Punoi: Co-PLAN

- **Biodiversteti në Bashkinë Kuçovë**

Bashkia e Kuçovës ka një sipërfaqe prej 160km^2, prej të cilës 58.84km^2 është sipërfaqe natyrore (rreth 36.5% e territorit). Bashkia e Kuçovës ka një reliev përgjithësisht fushor në pjesën perëndimore dhe kodrinore në NjA-në Lumas. Shumëllojshmëria në florë dhe në faunë në këtë Bashki është e përqendruar më tepër rreth zonave pyjore të NjA-së Lumas, Kozarë dhe Perondi. Fatmirësisht, NjA-të Lumas dhe Kozarë kanë plane manaxhimi për fondin pyjor ndërsa NjA-ja Perondi nuk e ka një plan të tillë.

- **Flora në Bashkinë Kuçovë**

Shumëllojshmëria e bimëve në Bashkinë e Kuçovës është lokalizuar në zonat pyjore të NjA-ve të Lumasit, Kozarës dhe Perondis. Për Bashkinë e Kuçovës nuk njihet numri total i llojeve të specieve të florës sepse mungojnë studimet specifike për njohjen e saj. Megjithatë, në bashki ka bimë të larta të cilat përfaqësohen nga pisha medhetare, dushqet, pemët frutore, ullishtet, vreshtat dhe foragjerët. Brezi i mesëm i bimëve karaketrizohet nga shkurret e ndryshme të cilat qëndrojnë të gjelbërta gjatë gjithë vitit siç janë shkurrja dhe shkoza e përzier dhe mareja. Në këto sipërfaqe natyrore gjejnë përhapje edhe bimët mjekësore dhe bimë të ndryshme të cilat listohen si të rrezikuara në Librin e Kuq të Florës Shqiptare. Edhe numri i specieve të rrezikuara në territorin e bashkisë dhe habitatet e tyre nuk njihet me saktësi për arsyet e përmendura më sipër. Megjithatë, njihet në një farë mënyre, numri i specieve të faunës që janë në rrezik zhdukjeje (Libri i Kuq i Florës Shqipëtare, 2007) i cili shkon në 13. Të tilla mund të përmendim: gjunjëzën *(Ephedra Distachia)*, dëllenjën e kuqe *(Ephedra Distachia)*, zambakun e detit *(Panctratium Maritimum)*,etj.

Tabela 32. Tregues të përgjithshëm të florës dhe faunës në Shqipëri e në Bashkinë Kuçovë

Flora dhe Fauna e Rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Kuçovë				
Kategoritë Taksonomike	Nr. total i specieve në vend	Nr. i specieve të rrezikuara në vend	Nr. i specieve të Rrezikuara B. Kuçovë	% e specieve të Rrezikuara B. Kuçovë
Kërpudha	800	16	0	0
Bimësi	3,228	363	6	1.6

Insekte	680	108	5	4.6
Peshq	**311**	**61**	**0**	**0**
Amfib	15	15	1	6.6
Zvarranikë	**37**	**37**	**4**	**10.8**
Shpend	330	120	10	8.33
Gjitarë	**91**	**46**	**2**	**4.3**
Totali	5,492	766	28	3.65

Burimi: Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqiptare; Punoi: Co-PLAN;2016

Shkaqet kryesore që kanë rrezikuar rritjen e numrit të specieve të bimësisë në zhdukje janë grumbullimi pa kriter i bimëve të ndryshme për tregëti si bimë mjekësore, veprimtaria e njerëzve në zonat ku përhapen speciet e bimësisë, shfrytëzimi pa kriter i specieve të ndryshme floristike, përhapja e rrallë dhe e kufizuar e specieve të ndryshme, përdorimi i metodave të gabuara për grumbullim (me shkulje, duke dëmtuar rrënjët), kullotja intensive, ndjeshmëria e lartë ndaj ndryshimit të klimës dhe dëmtimi i habitatit ku është vendosur kjo bimësi.

- **Fauna në Bashkinë Kuçovë**

Sa i përket faunës në zonën e Bashkisë Kuçovë, sikurse dhe rasti i florës, nuk njihet numri total i specieve që jetojnë në territorin e kësaj Bashkie. Pavarsisht kësaj, aty gjenden një shumëllojshmëri kafshësh, shpendësh dhe zvarranikësh. Zonat pyjore të NjA-ve bëhen strehë për kafshët si: dhia e egër (*Rupicapra Rupicapra*), baldosa (*Meles Meles*), urithi, çakalli, nusja e lalës, dhelpra, si dhe disa lloje zvarranikësh si gjarpri etj. Në Bashkinë Kuçovë gjejmë edhe lloje të ndryshme zvarranikësh por dhe shumëllojshmëri shpendësh shtegtarë ose jo shtegtarë si thëllëza dhe sorra. Edhe pse nuk njihet me saktësi numri i specieve në zhdukje, nga Libri i Kuq i Faunës Shqiptare (Tiranë, Nëntor 2006) është vënë re se numri i tyre arrin në 22 specie. Llojet e specieve në zhdukje janë të ndryshme, por ndër ta dallohen lloje të rralla speciesh të faunës shqiptare si kërmilli i shkurreve (*Helix Lucorum*), flatërbluja njollëzezë (*Pseudophilotes Vicrama*), bullari (*Ophisaurus Apodus*), bolla me 4 vija (*Elaphe Quatrolineata*) etj.

Shkaqet kryesore që kanë rrezikuar rritjen e numrit të specieve të faunës në zhdukje janë grumbullimi pa kriter për tregtim, koleksionimi dhe balsamosja, prishja dhe ndotja e habitatit të specieve të caktuara, gjuetia e jashtëligjshme, shqetësimet në vendet e folenizimit gjatë periudhës së riprodhimit dhe pakësimi i ushqimit.

- **Ndërhyrjet e njeriut me ndikim në biodiversitet**

Disa nga ndërhyrjet kryesore të njeriut që ndikojnë drejtpërdrejtë në biodiversitet janë renditur më poshtë:

- *Mospatja e një plani menaxhimi/veprimi* për mbrojtjen e zonave natyrore në Bashkinë Kuçovë.
- *Industria e naftës:* Industra e naftës është një ndër ndotësit kryesorë të ujit e ajrit në Bashki.
- *Zhvillimi i bujqësisë së shkallës*: Zhvillimi i bujqësisë, ka qenë kërcënimi kryesor ndaj biodiversitetit gjatë sistemit të shkuar (periudha e regjimit komunist), hapja e tokave të

reja bujqësore, shpyllëzimi për këtë qëllim dhe përdorimi i kimikateve bujqësore. Aktualisht, ky mbetet një problem i trashëguar edhe pse disa nga tokat bujqësore të përftuara nga tarracimet masive të viteve 1980-90 të cilat nuk u përdorën më për funksione bujqësore po i rikthehen në gjendjen e mëparshme natyrore. Sot, bujqësia ndikon ndjeshëm në biodiversitet, kryesisht nëpërmjet përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike në mënyrë të pakontrolluar, duke u kthyer në sektor ndotës, kryesisht për rrjedhat ujore.

- *Urbanizimi*: Kërkesa gjithnjë e në rritje për zona banimi, ku në dy dekadat e fundit kjo kërkesë është reflektuar në shtimin e zonave urbane informale dhe në shpërhapje duke zënë sipërfaqe të zonave natyrore e bujqësore. Shndërrimi i sipërfaqeve natyrore në urbane ka çuar në uljen e numrit të specieve taksonomike.
- *Fragmentimi i habitateve* nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore apo i veprave të ndryshme ka çuar në fragmentimin e habitateve ose ndërprerjen e vazhdueshmërisë së zonave natyrore i cili vjen si rrjelloje e ndërtimit të infrastrukturës në toka bujqësore e natyrore pa marrë parasysh parimet e mbrojtjes së mjedisit. Fragmentimi në vetvete sjell zvogëlimin e sipërfaqes së habitatit të florës e faunës dhe izolimin e tyre në njësi të vogla habitati duke penguar lëvizjen e lirë të kafshëve të ndryshme.
- *Gjuetia e jashtëligjshme* ka pasur një ndikim të ndjeshëm në biodiversitet, gjë që ndihet edhe sot, pas dy viteve të ndalimit të saj (moratoriumi i gjuetisë). Për fat të mirë, moratoriumi është zgjatur edhe për 5 vite të tjera.
- *Shpyllëzimi* ka qënë dhe mbetet një problem kryesor i prishjes së habitateve. Në dy dekadat e shkuara, krahas prerjeve për lëndë drusore dhe djegëse, shpyllëzimeve masive kanë ndodhur edhe me qëllim shndërrimin e tokae pyjore në toka bujqësore. Kjo ka bërë të mundur uljen e numrit të specieve në këto zona. Aktualisht, qeveria shqiptare ka vendosur një moratorium 10-vjeçar me qëllim ripërtëritjen e fondit pyjor në vend.
- *Kullotja* e bagëtisë, në përgjithësi ka një ndikim negativ në zhvillimin e biməsisë, kryesisht në bimët dhe shkurret e ulta të cilat shërbejnë si ushqim për bagëtinë. Në territorin e Kuçovës nuk ka një studim të mirëfilltë mbi kapacitetin mbajtës të kullotave. Si rrjedhojë, nuk dihet ndikimi i kullotjes në këtë zonë.
- *Mbledhja e bimëve mjekësore* është një tjetër aspekt i rëndësishëm që ka çuar në zvogëlimin e numrit të specieve të veçanta në zonë. Kjo sepse mbledhja bëhet pa kriter dhe kryesisht me shkulje (duke i shkulur me rrënjë) të këtyre bimëve.
- *Gjuetia pa kriter e kafshëve* duke mos lejuar zbatimin e moratoriumit për gjuetinë.

Tabela 33. Speciet floristike të rrezikuara në Bashkinë Kuçovë

Nr.	Emërtimi në Latinisht	Emërtimi në Shqip	Rreziku	Foto
1	Ephedra Distachia	Gjunjëz	Aktiviteti njerëzor	

2	Hypericum Perforatum	Lulebasani	Mbikullotja, bujqësia	
3	Juniperus Oxycedrus	Dëllinja e kuqe	Shfrytëzimi pa kriter	
4	Panctratium Maritimum	Zambaku i detit	Veprimtaria njerëzore	
5	Sambucus Nigra	Shtogu i zi	Grumbullimi si bimë mjekësore.	
6	Satureja Montana	Trumzë, Shtërmen	Dëmtimi i rrënjëve gjatë shkuljes.	
7	Baldellia Ranunculoides	Baldelë zhabinëngjashme	Ndjeshmëri e lartë ndaj klimës.	
8	Nuphar Lutea	Lëkue i verdhë	Ndjeshmëri e lartë ndaj klimës.	
9	Centaurea Pindicola	Kokoçeli i Pindit	Individë shumë të rrallë	

10	Conium Maculatum	Kakudë	Individë shumë të rrallë	
11	Orchis Albanica	Salepi shqiptar	Individë të rrallë	
12	Sinapis Pubescens	Sinapi pushlor	Individë të rrallë	
13	Gladiolus Palustris	Gladiola e moçaleve	Prishja e habitatit	

Burimi : Libri i Kuq i Florës Shqiptare, Punoi: Co-PLAN; 2016

Tabela 34. Speciet e rrezikuara në Bashkinë Kuçovë

Nr.	Emërtimi në Latinisht	Emërtimi në Shqip	Rreziku	Foto
1	Helix Lucorum	Kërmilli i shkurreve	Tregtimi	
2	Thymelicus Aceton	Okërverdha aketon	Prishja e habitatit dhe koleksionimet	
3	Pseudophilotes Vicrama	Flatërbluja njollëzezë	Dëmtimi habitateve dhe koleksionimet	
4	Brintesia Circe	Circia	Dëmtimi i habitateve dhe koleksionimet	

5	Gnorimus Nobilis	Gnorimusi fisnik	Tepër të rrallë	
6	Purpuricenus Kaehleri	Kuqalashi njollë-zezë	Koleksionimet	
7	Emys Orbicularis	Breshkuçja	Ndotje habitatesh	
8	Ophisaurus Apodus	Bullari	Dëmtime fizike	
9	Coluber Najadum	Shigjeta e hollë	Shqetësime dhe dëmtime fizike.	
10	Elaphe Quatrolineata	Bolla me 4 vija	Dëmtime nga frika	
11	Nycticorax Nycticorax	Çafka e natës	Gjuetia e jashtëligjshme dhe shqetësimi i kolonive nga njeriu	
12	Ardeola Ralloides	Çafka e verdhë	Gjuetia, pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendeve të flozimit, gjuetia	
13	Egretta Garzetta	Çafka e vogël e bardhë	Gjuetia, pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendeve të flozimit, gjuetia	

14	Accipiter Gentilis	Gjeraqina	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendeve të flozimit, gjuetia	
15	Buteu buteo	Huta	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendeve të flozimit, gjuetia	
16	Falco Peregrinus	Krahëthati	Gjuetia nga njeriu	
17	Tyto Alba	Kukuvajka mjekroshe	Balsamosja	
18	Apus Apus	Dejka	Dëmtimi i folesë, shqetësimi human	
19	Apus Pallidus	Dajaka e zbehtë	Dëmtimi i folesë, shqetësimi human	
20	Hippolais Olivetorum	Përqeshësi i madh i ullinjve	Dëmtimi i habitateve	
21	Meles Meles	Baldosa	Dëmtimi i habitateve dhe gjuetia e paligjshme	
22	Rupicapra Rupicapra	Dhia e egër	Gjuetia e paligjshme	

Burimi: Libri i Kuq i Faunës Shqiptare, Punoi: Co-PLAN; 2016

- **Përfundime dhe rekomandime**

Bashkia e Kuçovës ka një botë bimore dhe shtazore të pasur e të larmishme e cila përqendrohet kryesisht rreth zonave natyrore të NjA-së Lumas, Kozarë dhe Perondi. Fatmirësisht, NjA-të Lumas dhe Kozarë kanë plane manaxhimi për fondin pyjor ndërsa NjA-ja Perondi nuk ka një plan të tillë. Megjithatë, në Bashki nuk njihet numri total i llojeve të specieve të florës dhe faunës sepse mungojnë studimet specifike për njohjen e saj. Për më tepër, gjatë dy dekadave të fundit, bimësia dhe bota shtazore janë dëmtuar si rezultat i ndërhyrjeve të njeriut (mosmanaxhimit të zonave natyrore, dëmtimit dhe fragmentimit të habitateve, gjuetisë dhe mbledhjes së bimëve mjeksore pa kriter etj.) dhe faktorëve natyrorë (mungesës së masave specifike për mbrojtjen e biodiversitetit dhe mungesa e manaxhimit të zonave natyrore etj.). Si rrjedhojë, shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes.

Me qëllim ruajtjen e biodiversitetit në këtë zonë, është e rëndësishme që të merren masa urgjente për mbrojtjen e biodiversitetit në përgjithësi dhe të kafshëve që rrezikojnë të zhduken në veçanti. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia i) të bashkëpunojë me Ministrinë e Mjedisit dhe të Bujqësisë për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij, në nivel vendor, duke zbatuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin, ii) për hartimin e planeve të veprimit për ruajtjen e llojeve veçanërisht të mbrojtura, të regjistruara me status ruajtjeje të pafavorshëm, iii) për hartimin e planeve dhe procedurave të veprimit për manaxhimin e rasteve të papritura nga veprimtaritë njerëzore. Gjithashtu, është e rëndësishme që Bashkia të hartojë një plan manaxhimi për mbrojtjen e zonave natyrore brenda territorit të saj.

1.4.4 Konkluzione

Metabolizmi: Analiza e metabolizmit tregon se si funksionon territori i bashkisë në lidhje me disa nga flukset kryesore të burimeve të tij, nga prodhimi deri në konsumim dhe prodhim të mbetjeve. Për sa i përket fluksit të energjisë, Kuçova ka potencial për përdorimin e energjive alternative si energjia gjeotermale dhe energjia e diellit. Energjia gjeotermale në territorin e Kuçovës mund të përftohet nga uji i shtresave kolektore që gjendet në puset e naftës. Uji i këtyre puseve mund të shërbejë për ngrohjen e serave. Numri i ditëve me diell dhe sasia e rrezatimit diellor në territorin e Kuçovës janë mjaft të favorshme për t'u përdorur si burim energjie. Një nga mënyrat e përdorimit të kësaj energjie do ishte nëpërmjet paneleve fotovoltaike, për ngrohjen e banesave etj. Energjia e eksportuar përbën vetëm 8,6% të energjisë së importuar, kjo tregon që përveç humbjeve në rrjet, burimet alternative të energjisë nuk shfrytëzohen. Përdorimi i energjive alternative do të efiçentojë përdorimin e energjisë hidrike dhe do të sigurojë furnizim me më të mirë me energji.

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm duhet të shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë. Ky sistem furnizimi duhet të jetë kryesisht konvencional (rrjet tubacionesh) në zonat ku është e nevojshme, ndërsa në zonat ku uji mund të nxirret nëpërmjet puseve mund të përdoret kjo metodë. Thuajse i gjithë territori shtrihet në formacion ujëmbajtës (akuifer me porozitet çarje-karst dhe ujëpërcjellshmëri shumë të lartë të lartë), ndaj është më i ndjeshëm ndaj ndotjes që mund t'iu shkaktohet ujërave nëntokësore dhe tokës. Sasia totale e ujit të prodhuar në Bashkinë Kuçovë është 2,308.7 m^3/ orë ndërkohë që kërkesa aktuale është

vetëm 302 m³/ orë, që tregon se me një menaxhim më të mirë të sistemit të furnizimit me ujë mund të kemi mbulim të të gjithë territorit me shërbimin e furnizimit me ujë.

Fluksi i ushqimit tregon që kulturat bujqësore që kanë prodhim më të lartë në Bashkinë Kuçovë janë perimet, drithërat, drufrutorët si: pemët frutore, ullinjtë dhe vreshtat. Pra, Kuçova nuk është e specializuar në një kulturë specifike, por ka një sasi prodhimi të përafërt të kulturave të sipërpërmendura. Sipas edhe Ministrisë së Bujqësisë, kulturat më të përshtatshme për Kuçovën janë prodhimet e serave, duhani, drufrutorët si pjeshkë dhe ullinj, gjithashtu prodhimi i mjaltit, i cili ka një rendiment mesatarisht të lartë.

Duhet që mbetjet të diferencohen patjetër që në burim, në mënyrë që të ketë një nivel më të lartë riciklimi. Vend depozitimi që ndodhet në Tapi, pranë shtratit të Lumit Devoll duhet të mbyllet dhe sipas standardeve përkatëse dhe të transferohet si *landfill* sanitar-inxhinierik në një territor gjeologjikisht dhe teknikisht të përshtatshëm, larg akuifereve dhe me përshkueshmëri të ulët. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë dhe ky është një tregues pozitiv. Prioritet i kësaj bashkie duhet të jetë diferencimi i mbetjeve urban, për të pasur një ndotje sa më të ulët në territor.

Uji

Kuçova ka burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit. Megjithatë, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Devollit të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e Bashkisë, nxorri në pah problematikat e këtij lumi të cilat vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumit nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Devollit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e lumit përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e Devolit të monitorohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje. Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Osumit, nga burim uji për bujqësinë, ky lumë mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. *Si rrjedhojë, është e nevojshme që Bashkia të ndërmarrë projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të ndotura të industrisë së naftës, ujërave të zeza, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë në ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe ndotjen e ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efiçent të tyre. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që Bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera që përshkohen nga Devolli dhe Këshillin/Agjencinë e Basenit Ujor të Semanit për hartimin e planeve ndërvendore për përdorimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore jashtë territorit të saj administrativ.*

Në përgjithësi, ekziston mundësia që Akuiferi Kuaternar i Beratit të jetë ndotur nga industria e naftës gjatë viteve të aktivitetit të saj. Nga dixhitalizimi i territorit të Bashkisë Kuçovë rezulton se grupi i puseve të Kozarës dhe lumit Devoll kalojnë nëpërmjet këtij akuiferi gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Vetëm vendndodhja e puseve krijon mundësinë e ndotjes së akuiferit në momentin më të parë që veshja e faqeve anësore të pusit nuk është bërë siç duhet.

Një faktor mjaft i rëndësishëm që duhet theksuar në lidhje me Akuiferin është mungesa e monitorimit të ujërave të këtij akuiferi për ndotje nga industria e naftës ndër vite. Industria e naftës ka vepruar në këtë territor për më shumë se 50 vjet. Duke parë se burimet e këtij akuiferi përdoren për furnizim me ujë të pijshëm dhe ujitje nga banorët vendas, është i domosdoshëm monitorimi i akuiferit për ndotje nga industria e naftës së trashëguar ndër vite dhe njëkohësisht ndalimi i përdorimit të ujërave të këtij akuiferi për furnizimin e popullsisë me ujë deri në momentin që nuk është vërtetuar se ujërat e këtij akuiferi janë të një cilësie të mirë. Ndotja e Akuiferit Kuaternar të Beratit nëpërmjet pus-shpimeve në vendburimin e naftës në Kuçovë mund të përbëjë problem të jashtëzakonshëm për furnizimin me ujë të popullsisë në Bashkinë Kuçovë e Berat që furnizohen me ujë nga ky akuifer.

Si përfundim, përveç lumenjve, Bashkia përballet me problemet që kanë të bëjnë me Akuiferin e Beratit dhe, mbi të gjitha, me përcaktimin e llojit të përdorimit të ujërave të këtij akuiferi. Duke parë teknologjinë e vjetër dhe të papërshtatshme për mbrojtjen e burimeve ujore që Industria e naftës ka përdorur në të shkuarën dhe teknologjinë e re që është futur për shpimin e puseve në vendin tonë këto vite, është e rëndësishme që të ndërpritet menjëherë furnizimi me ujë i popullsisë nga Akuiferi i Beratit (puset e Devollit) dhe të merren masa të menjëhershme për monitorimin specifik të ujërave të akuiferit, me qëllim që të përcaktohet nëse ujërat e tij janë ende të përshtatshme për furnizimin me ujë të popullsisë së Beratit e Kuçovës

Ajri

Ndotja e cilësisë së ajrit në Bashkinë Kuçovë shkaktohet kryesisht nga mjetet e transportit, cilësia jo e mirë e naftës, industria e naftës dhe aktivitete të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë si industria dhe ndërtimet. Megjithatë, transporti në zonat urbane dhe ndotja nga industria e naftës në zonat naftënxjerrëse mbeten burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Bashkinë Kuçovë.

Me qëllim shmangien e rrezikut që i kanoset banorëve nga ndotja e ajrit veçanarisht në zonat urbane dhe naftënxjerrëse rekomandohet planifikimi i zhvillimit të territorit duke zonuar territorin sipas përdorimit. Në zonat naftënxjerrëse me intensitet të lartë, rekomandohet shpërngulja e popullsisë në zona të tjera. Njëkohësisht, rekomandohet planifikimi i zhvillimit të territorit dhe sektorit të transportit, duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik alternativ dhe këmbësor, hartimi i politikave që synojnë uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimi i hapësirave të gjelbëra, bashkëpunimi i nguhtë me Inspektoriatin e Mjedisit për monitorimin e rregullt dhe rigoroz të shkarkimeve në ajër të aktiviteteve industriale të pajisura me leje mjedisore (aktivitetet naftënxjerrëse kryesisht), si dhe kufizimi i ndërtimeve në qytet jashtë standardeve për mbrojtjen e cilësisë së ajrit. Njëkohësisht, rekomandohet bashkëpunim me ARM/AKM-në dhe Institutin e Shëndetit Publik për krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit të cilësisë së ajrit në qytetin e Kuçovës gjatë gjithë vitit me qëllim krijimin e një pasqyre të qartë të cilësisë së ajrit dhe përcaktimin e zonave që nevojitin për hartimin e Planeve të Cilësisë së Ajrit

Toka

Kuçova bën pjesë në Ultësirën Perëndimore të vendit me toka pjellore që kultivohen pothuajse gjatë gjithë vitit. Vend të rëndësishëm zë nga kultivimi i drithërave deri te

perimtaria, bostanoret, foragjeret, ullinjtë, pemët frutore dhe vreshtat. Zhvillimin e bujqësisë në Bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti i gjerë hidrik dhe i kanaleve ujitëse-kulluese i cili ka bërë të mundur kultivimin e bujqësisë intensive përgjatë gjithë vitit. Këtij rrjeti i shtohet edhe Lumi i Devollit së bashku me lumenjtë Osum e Seman, të cilët përshkojnë territorin e bashkisë në pjesën jugore e juglindore përkatësisht.

Në shumë ish-komuna të Bashkisë së Kuçovës, territori ka përdorim bujqësor dhe industrial. Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike që ka sjellë për vendin, ka ndikuar negativisht në ndotjen e tokës, për shkak të mbetjeve të dherave industriale të depozituara në vende të papërshtatshme dhe për shkak të puseve të industrisë së naftës të përdorur gjatë aktivitetit naftënxjerrës ndër vite. Si rrjedhojë, është e nevojshme që bashkia të përcaktojë qartë kufirin e ndarjes ndërmjet tokave bujqësore dhe atyre industriale në mënyrë që të shmanget degradimi i tokave dhe rrezikimi i shëndetit të njeriut nëpërmjet konsumit të produkteve të rritura në toka të ndotura nga nafta.

Përveç mbrojtjes së burimeve ujore, Bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së degradimit të tokës nga praktikat bujqësore të paqëndrueshme. Në dhjetëvjeçarin e fundit, bujqësia është shndërruar nga familjare në intensive. Kjo lloj bujqësie, ka sjellë përfitime ekonomike për banorët vendas por ka krijuar edhe degradim të tokës bujqësore i cili i shtohet atij nga ndotja e naftës dhe industrisë. Për këtë arsye, është e nevojshme që Bashkia të krijojë kushte që shmangin problemet që vijnë me bujqësia intensive duke futur shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave të mira bujqësore pa cenuar qëndrueshmërinë e saj. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jobujqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së[258].

Pyjet dhe Kullotat

Kushtet klimatike, hidrologjike dhe gjeomorfologjike në territorin e Bashkisë Kuçovë mundëson një larmishmëri drurësh ndër të cilët vlen të veçohen dhe shtohen sipërfaqet e mbjella me; Ekualipt, Pisha e butë, Plepi, Dafina dhe Bliri pasi këta janë disa nga llojet të cilët janë përshtatur më së miri në territorin e Bashkisë si dhe ndikojnë në përmirësimin e klimës industriale që karakterizon këtë zonë. Ekualipti (Ekualiptus globulus) ndikon në përmirësimin e ajrit, Pisha e butë (Pinus pinea), përmirëson ajrin dhe shton vlerat estetike të sipërfaqeve pyjore me kurorën e saj ovale si dhe është mjaft rezistente ndaj erërave, Plepi (Populus canadensis) për pyllezimin e brigjeve të lumenjve (zonave ripariane) pasi ndikon në mbrojtjene tyre nga erozioni, Dafina (Laurus nobilis), përmirëson cilësinë e ajrit dhe merr vlera ekonomike si bimë mjeksore si dhe Bliri (Tilia cordata) për vlerat ekologjike që ka.

Për më tepër në sipërfaqet e fondit pyjor është e nevojshme të ndërmerren disa hapa për përmirësimin e gjendjes së pyjeve dhe kullotave. Të tilla mund të jenë:

- Kryerja e një studimi të hollësishëm me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë shkaktuar tharjen e llojeve të bimësisë pyjore rrap, dushk dhe plep në seksione të ndryshme të trupave ujor në territor.

- Studimi i hollësishëm për përcaktimin e mundësisë së rehabilitimit të sipërfaqeve të djegura që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale si pisha e butë.
- Mbajtja nënkontroll e sëmundjeve (koncesionares) dhe dëmtuesve, ku shkalla e prekjes është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm.

Marrja e masave për parandalimin e zjareve si krijimi i një rrjeti për njoftimin e rënies së zjarreve (barinjtë mund të luajnë një rol tejet të rëndësishëm në këtë rast), ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien përpara përgjegjësisë të gjithë kundravajtësve që shkaktojnë zjaret, etj

Peizazhi

Komponentët peizazh-formues si ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor*** të analizuar më sipër shfaqen në zona të ndryshme të territorit por problematika mbetet e njëjtë si pasojë e ndërveprimit mes tyre.

Peizazhi Urban dhe ***Industrial***, karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore ku llojet e tyre shfaqen të ndryshueshme sipas rrugës. Zgavrat ku këto pemë qendrojnë gjithashtu të ndryshueshme nga një rrugë në tjetrën, disa janë me bordura të ngritura e disa pa bordura. Ndërkohë pjesa më e madhe e përmasave të zgavrave të pemëve janë relativisht të vogla në raport me pemën. Grupime pemësh dekoruese apo në formë "ishulli" gjenden vetëm brenda hapësirave park apo lulishte dhe qëllimi është estetik e jo sipas funksionit dhe shërbimit mjedisor pasi "katet" e ndryshme të bimësisë mungojnë. Elementet urbane dhe industriale të forta/dominuese apo edhe të padëshiruara shfaqen herë-herë në zona të ndryshme të qytetit. Zona tampon apo brezat e gjelbër pengues të erës dhe imazheve urbane apo industrial të padëshiruar ndodh në mënyrë spontane e të paplanifikuar. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve parkim shfaqet e ekspozuar ndaj diellit pasi bimë gjethore për hijëzimin e këtyre hapësirave mungojnë. Gardhet e muret ndarës të pronave në disa zona janë mbi 2 metra të lartë dhe estetikisht "ngushtojnë" hapësirën e përbashkët si dhe ndjesia që ngjallin është ajo e mungesës së sigurisë.

Të tri tipologjitë e peizazhit ***rural***, ***natyror*** dhe ***ujor*** karakterizohen nga elemente të ndryshëm por shkalla e lartë e ndërveprimit mes tyre bën që edhe problematikat e njërit të shfaqen edhe tek tjetri. Sipërfaqet ujore të cilat karakterizohen nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale nuk mund të shihen veçmas nga fasha rurale e natyrore pasi here-herë ato shfaqen si "*hinkë*" ku marrin dhe mbajnë materialet organike në matricën përreth si dherat, farat etj, dhe herë thjesht si "*kanale*" ku rrjedh energjia, ushqimi etj.

Peizazhi ujor në tërësi dhe në veçanti ai lumor shfaqet i "fshehur" nga peizazhi urban. Bimësia "ripariane" mungon në pjesën më të madhe ndërkohë në pjesën tjetër përbëhet nga bimë të llojit bar dhe shkurre të ulëta. Ndërkohë kur trupi ujor përshkon fashën rurale dhe natyrore sërish humb një pjesë të konsiderueshme të zonës së tij ripariane si pasojë e tjetërsimit në tokë bujqësore dhe fenomenit gjeologjik të përshpejtuar si pasojë e prerjes së bimësisë në këto zona. Pra peizazhi ujor shfaqet si lidhës mes peizazhit rural dhe atij natyror.

Ndonëse pjesë dominuese dhe e pandashme e peizazhit urban, një tjetër element lidhës në territor janë ***rrugët.*** Ato krijojnë "çarje" mes fashave por edhe "lidhje" fizike e pamore

mes tipologjive peizazhistike pasi si fasha ujore edhe ato shpërhapen në territor ku ndryshimi peizazhistik bëhet edhe më i dukshëm.

Peizazhi *Natyror* mbetet më kompleksi ndër fashat peizazhistike. Ai karakterizohet nga një sërë elementesh peizazhistike të cilat shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë. Hartat më sipër shfaqin këto elemente dhe rreziqet me të cilët përballen disa prej tyre. Trupat ujorë rrezikojnë daljen nga shtrati si pasojë e tjetërsimit të zonës ripariane dhe shfrytëzimit të materialeve inerte si dhe fragmentimi i ngastrave natyrore dhe mungesa e theksuar e koridoreve të kalimit rrezikon largimin e jetës së egër nga ato kjo fashë.

Biodiversiteti

Bashkia e Kuçovës ka një botë bimore dhe shtazore të pasur e të larmishme e cila përqendrohet kryesisht rreth zonave natyrore të NjA-së Lumas, Kozarë dhe Perondi. Fatmirësisht, NjA-të Lumas dhe Kozarë kanë plane manaxhimi për fondin pyjor ndërsa NjA-ja Perondi nuk ka një plan të tillë. Megjithatë, në Bashki nuk njihet numri total i llojeve të specieve të florës dhe faunës sepse mungojnë studimet specifike për njohjen e saj. Për më tepër, gjatë dy dekadave të fundit, bimësia dhe bota shtazore janë dëmtuar si rezultat i ndërhyrjeve të njeriut (mosmanaxhimit të zonave natyrore, dëmtimit dhe fragmentimit të habitateve, gjuetisë dhe mbledhjes së bimëve mjeksore pa kriter etj.) dhe faktorëve natyrorë (mungesës së masave specifike për mbrojtjen e biodiversitetit dhe mungesa e manaxhimit të zonave natyrore etj.). Si rrjedhojë, shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes.

Me qëllim ruajtjen e biodiversitetit në këtë zonë, është e rëndësishme që të merren masa urgjente për mbrojtjen e biodiversitetit në përgjithësi dhe të kafshëve që rrezikojnë të zhduken në veçanti. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia i) të bashkëpunojë me Ministrinë e Mjedisit dhe të Bujqësisë për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij, në nivel vendor, duke zbatuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin, ii) për hartimin e planeve të veprimit për ruajtjen e llojeve veçanërisht të mbrojtura, të regjistruara me status ruajtjeje të pafavorshëm, iii) për hartimin e planeve dhe procedurave të veprimit për manaxhimin e rasteve të papritura nga veprimtaritë njerëzore. Gjithashtu, është e rëndësishme që Bashkia të hartojë një plan manaxhimi për mbrojtjen e zonave natyrore brenda territorit të saj.

1.5 Analiza demografike dhe e mirëqenies social-ekonomike


1.5.1 Demografia

Për zhvillimin e analizës së demografisë janë përdorur dy burime të dhënash. Të dhënat nga INSTAT-I, që si burim kanë studimet e Censusit 2011, si dhe të dhënat nga Gjendja Civile, të cilat janë marrë nga Bashkia. Analizimi i të dhënave nga INSTAT-i është më i detajuar sepse të dhënat janë më të plota përsa i përket indikatorëve që kërkohen, ndërsa të dhënat nga Gjendja Civile nuk janë të plota. Gjithsesi, analiza i përfshin të dyja llojet e burimeve me gjithë ndryshimet që kanë këto burime.

Bashkia Kuçovë është një nga qendrat e rëndësishme demografike dhe ekonomike të qarkut të Beratit. Me ndarjen e re administrative kjo bashki përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ qytetin e Kuçovës dhe 3 ish-komunat Kozarë, Lumas dhe Perondi.

Nga këndvështrimi strukturor demografik, në bashkinë Kuçovë banojnë rreth 22% e popullatës rezidente të qarkut Berat, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës është e shpërndarë në bashkitë e tjera: Berat, Ura Vajgurore, Skrapar e Poliçan, respektivisht me rreth 42%, 19%,9% dhe 8% të popullatës gjithsej.

Figura 83. Densiteti i popullsisë në nivel njësie administrative, qarku Berat



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


Si rrjedhojë e ndarjes së re administrative, popullata rezidente e bashkisë së Kuçovës është më shumë së dyfishuar, duke shënuar një numër popullsie stok në rreth 31 mijë banorë rezidentë në fillim të vitit 2015[259].

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqendruar kryesisht në qytetin e Kuçovës me rreth 40% të saj, ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë së bashkisë është e shpërndarë në NjA Kozarë, Lumas dhe Perondi, respektivisht me 18%, 13%, dhe 29%. Krahasuar me regjistrimin e fundit të popullsisë në vitin 2011, popullsia e kësaj zone ka pësuar rënie me rreth 1500 banorë ose me 5% më pak, rënie e cila si dukuri tashmë është e pranishme pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përjashtuar këtu qarkun e Tiranës dhe Durrësit) pas viteve '90. Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Kuçovë *lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë, si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm,(nga zonat rurale drejt atyre urbane dhe bregdetare) duke ndjekur të njëjtin model - profil të zhvillimit demografik të popullsisë sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit.*

Tabela 35. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015

Popullsia, qarku, bashkia, njësitë administrative	Viti 2011	Viti 2015
Bashkia Kuçovë	32,964	31,424
Kuçovë	13,343	12,720
Kozarë	5,928	5,651
Lumas	4,198	4,002

Perondi	9,495	9,052
QARKU BERAT	149,672	142,679



Burimi: INSTAT (2011) dhe llogaritje të autorëve; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Tabela 36. Populsia sipas gjinisë për vitet 2011-2015 në bashkinë e Kuçovës

Popullsia, qarku, bashkia, njësitë administrative	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Bashkia Kuçovë	32,964	16,398	16,566	31,424	15,793	15,631
Kuçovë	13,343	6,452	6,891	12,720	6,214	6,505
Kozarë	5,928	2,976	2,952	5,651	2,866	2,785
Lumas	4,198	2,108	2,090	4,002	2,030	1,971
Perondi	9,495	4,862	4,634	9,052	4,682	4,369
QARKU BERAT	149,672	75,280	74,392	142,679	72,503	70,176

Burimi: INSTAT (2011) dhe llogaritje të autorëve

Popullsia e bashkisë Kuçovë, nga këndvështrimi i raportit gjinor, ruan një diferencë të lehtë për sa i përket ndarjes gjinore të popullsisë në meshkuj e femra. Mbështetur edhe në të dhënat e popullsisë sipas gjinisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra*100) tregon se për vitin 2015 raporti gjinor i krahasuar me vitin 2011 ka pësuar ndryshime në përmbajtje dhe në përmasa: nga një raport gjinor në favor të popullatës së femrave (99 meshkuj për çdo 100 femra) në vitin 2011 në një raport në favor të popullatës së meshkujve (101 meshkuj për çdo 100 femra) për vitin 2015.

Gjithashtu, nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë Kuçovë me atë të qarkut Berat, identifikohen vlera afërsisht të njëjta të raportit gjinor, ndërkohë që ky tregues në nivel ish-komunash "flet" për mbizotërimin e popullatës së meshkujve ndaj popullatës së femrave për të dy vitet 2011-2015.


Për sa i përket strukturës gjinore të qarkut bën dallim qyteti i Kuçovës, i cili vazhdon të ruajë një raport gjinor në favor të popullatës femërore. Struktura gjinore e popullsisë në favor të popullatës së meshkujve është rrjedhojë edhe e strukturës rurale/urbane të popullsisë së kësaj njësie vendore ku pesha e popullsisë rurale është rritur akoma më shumë si pasojë e ndarjes së re administrative.

Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Analiza e strukturës moshore të popullatës, si dhe mosha mesatare e re e saj (39 vjeç për vitin 2015, ndërkohë që mosha mesatare në nivel kombëtar është 37 vjeç) tregojnë se, aktualisht, popullata e bashkisë Kuçovë vazhdon të jetë akoma një popullsi e re, sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi.

Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë Kuçovë tregon së 68% e saj i takon grupmoshës 15-64 vjeç dhe 19% grupmoshës 0-14 vjeç, të dhëna këto shumë

optimiste dhe që evidentojnë së bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë, ekonomikisht aktive por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës duhet analizuar së bashku me të dhënat për punësimin.

Figura 84. Struktura moshore e popullsisë në nivel bashkie dhe njësish administrative



Burimi: INSTAT (2011) dhe llogaritje të autorëve; Përgatiti Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel komunash që përfshihen brenda bashkisë Kuçovë tregon se popullata e kësaj grupmoshe është e pranishme me të njëjtat nivele (67-69%) edhe në komunat. Në këtë paraqitje grafike vlen për t'u vënë në dukje struktura moshore e qytetit të Kuçovës ku niveli i grupmoshës së të rinjve dhe i moshës së 3-të (pra, dy grupmoshat e përjashtuara nga popullsia ekonomikisht aktive) paraqiten në të njëjtat vlera, rreth 16%, nivele këto që kanë ndikuar edhe në përcaktimin e profilit të strukturës moshore të popullatës në nivel bashkie. Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, të cilët janë të rëndësishëm dhe plotësues në analizën socio-ekonomike.

Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe, rrjedhimisht, të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.

Treguesit e varësisë klasifikohen në: treguesi i varësisë totale (raporti i grupmoshave [(0-14)+ (+65)] /(15-65)) ndaj popullsisë në moshë pune; treguesi i varësisë së të rinjve (raporti i grupmoshës (0-14)/(15-65)); dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës (+65)/(15-65)).

Koefiçenti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo-pune) ndaj popullsisë në moshë pune, duke treguar se sa individë në moshë jo-pune "mbulohen"/përballohen nga 100 individë në moshë pune.

Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq më shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike, ndërkohë që koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve tregojnë, respektivisht, raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe + 65 vjeç kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç.

Gjithashtu, interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale. Pra, një tregues me vlerë të lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes në të ardhmen afatmesme të numrit të popullsisë aktive-të aftë për punë, ndërkohë që rritja e treguesit

të varësisë së të moshuarve është "sinjal" për rritje shpenzimesh, angazhim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqenien e kësaj kategorie të popullsisë.

Konkretisht, për bashkinë Kuçovë, treguesit e varësisë moshore totale, të varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në tabelën në vijim:

Tabela 37. Koeficientët e varësisë për bashkinë Kuçovë

Koeficientet e varësisë, qarku, bashkia, komunat 2011	Koeficientët e varësisë 2011/2015		
	Varësia totale	Varësia e të rinjve	Varësia e të moshuarve
BASHKIA KUÇOVË	47	27	19
Kuçovë	46	24	23
Kozarë	49	33	16
Lumas	48	29	18
Perondi	46	28	17
QARKU BERAT	46	29	18

Burimi: INSTAT (2011) dhe llogaritje të autorëve

Mbështetur në këta tregues, konstatojmë se treguesi i varësisë totale për bashkinë e Kuçovës shënon vlerën 47, pra 47 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +65vjeç) "përballohen" nga 100 banorë të moshës aktive për punë (15-64 vjeç), vlerë kjo e barabartë me vlerën e këtij treguesi në nivel kombëtar.

Analiza krahasimore e këtyre treguesve për nivele të ndryshme të njësive vendore (qark/komuna) identifikon vlera afërsisht të njëjta, duke dëshmuar në këtë mënyrë jo vetëm për një shpërndarje pothuaj homogjene të grupmoshave të popullsisë, por edhe për potenciale relativisht të larta të popullsisë ekonomikisht aktive në të gjitha njësitë vendore të qarkut.

Ndërkohë, analiza historike (1979-2011) e treguesve të varësisë tregon qartë ndryshimet drastike demografike që ka pësuar popullsia shqiptare në tërësi dhe në njësitë vendore në veçanti.

Më konkretisht, viti 2011 është viti në të cilin ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturin episod të "dividendit demografik" dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65). Ecuria e këtij treguesi edhe për vitet në vazhdim vlerësohet të jetë në të njëjtat nivele.

Nëse bashkia/qarku do të përfitojë nga ky "dividend demografik", kjo varet nga efektiviteti i politikave social-ekonomike të politikëbërësve, përfshirë këtu, në mënyrë të veçantë, edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive, të cilat me tej do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike, por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës.

Ndërkohë që koeficienti i varësisë totale flet për ekzistencën e "dividendit demografik", analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregon një rritje të konsiderueshme të numrit të personave të moshuar 65 vjeç e lart (nga 9% në 23%) dhe një rënie të grup-moshave të reja (nga 60% në 24%), duke demonstruar qartazi për "shenjat" e hyrjes në një fazë të re demografike të popullsisë, atë të "plakjes". Rritja e grupmoshës (+65) shoqërohet edhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë.

Prandaj, analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik, sepse ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e parashikimeve të popullsisë për të paktën 2 dekada. Këto parashikime ofrojnë informacion për numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.


Në vijim po paraqesim tabelat me numrat e popullsisë për periudhën 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme të popullsisë.[260]

Tabela 38. Parashikimi për popullsinë e bashkisë Kuçovë, 2011-2031

Popullsia, qarku, bashkia, komunat, 2011-2031	Bashkia Kuçovë	Kuçovë	Perondi	Kozarë	Lumas
2011	32,964	13,343	9,495	5,928	4,198
2015	31,424	12,720	9,052	5,651	4,002
2016	30,531	12,358	8,794	5,491	3,888
2021	28,489	11,532	8,206	5,123	3,628
2026	26,653	10,788	7,677	4,793	3,394
2031	24,969	10,107	7,192	4,490	3,180

Burimi: INSTAT; Llogaritje të autorëve; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Figura 85. Parashikimi për popullsinë e bashkisë Kuçovë, 2011-20131



Burimi: INSTAT; Llogaritje të autorëve; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia rezidente e bashkisë Kuçovë, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë rënie të konsiderueshme, e cila si mesatare vjetore llogaritet të jetë rreth 1%, ndërkohë që rënia e popullsisë në vitin 2031, krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe, rreth 20%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente gjatë

periudhës 2016-2031 është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënieje sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme është faktori migrim, vazhdueshmëria e të cilit për periudhën 2016-2031 argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, me migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe me rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, çka do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.


Analizimi sipas të dhënave të zyrës së gjendjes civile

Tabela 39. Numri i popullsisë në bashkinë Kuçovë për periudhën 2011-2015

Emërtimi	Numri i popullsisë në 2011	Numri i popullsisë në vitin 2015	Rritja\ Ulja e numrit të popullsisë	Rritja\ Ulja e numrit të popullsisë në %
NjA Kuçovë	30017	29558	-459	-1.53%
NjA Perondi	10717	10494	-223	-2.08%
NjA Kozarë	8369	7949	-420	-5.02%
NjA Lumas	6980	7014	34	0.49%
Total	56083	55015	-1068	-1.90%

Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

Figura 86. Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative të bashkisë Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

Sipas zyrës së gjendjes civile, popullsia rezidente në bashkinë Kuçovë është 55015 banorë. Rreth 53.7 % e popullsisë është e përqendruar në qytetin e Kuçovës, ndërsa pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndarë në NjA Kozarë, Lumas dhe Perondi, respektivisht me 14.6%, 12.7% dhe 20%.

Duke krahasuar numrin e popullsisë ndërmjet viteve 2011 dhe 2015, vihet re një rënie e lehtë e numrit të popullsisë. Në total, në bashkinë e Kuçovës kemi një ulje prej 1068 banorësh me 1.9 % , në NjA Kuçovë kemi një ulje prej 459 banorësh me 1.5 % , në NjA Perondi kemi një ulje prej 223 banorësh me 2.08%, në NjA Kozarë kemi uljen më të madhe

të popullsisë prej 420 banorësh me 5%, ndërsa në NjA Lumas kemi një rritje të lehtë të popullsisë me 34 banorë ose 0.5 %. Kjo ulje e numrit të popullsisë vjen si pasojë e disa faktorëve si migrimi i brendshëm.

Tabela 40. Parashikimi i popullsisë sipas zyrës së gjendjes civile për vitet 2021, 2026, 2031

Emertimi	2015	2016	2021	2026	2031	Dif. 2031-2015
NjA Kuçovë	29,558	29,473	29,053	28,638	28,230	-1328
NjA Perondi	10,494	10,470	10,349	10,229	10,020	-474
NjA Kozarë	7,949	7,938	7,864	7,794	7,727	-222
NjA Lumas	7,014	7,011	6,997	6,983	6,969	-45
Total	55,015	54,892	54,263	53,644	52,946	-2069

Burimi: Regjistri i Gjendjes Civile dhe llogaritjet e autorëve; 2015

Sipas parashikimeve të bëra në bazë të metodologjisë së llogaritjes, nga viti 2015 deri në vitin 2031 pritet që në bashkinë e Kuçovës të ketë rënie të numrit të popullsisë. Në total, në bashkinë Kuçovë pritet që numri i banorëve të ulet me 2,069 banorë. Në NjA Kuçovë pritet që të ketë një ulje prej 1328 banorësh, në NjA Perondi pritet të ketë një ulje prej 474 banorësh, në NjA Kozarë pritet të ketë një ulje prej 222 banorësh, si dhe në NJA Lumas pritet të ketë një ulje prej 45 banorësh.

1.5.2 Zhvillimi dhe përfshirja sociale

- **Arsimi**

Niveli i përgjithshëm arsimor: Popullsia e bashkisë Kuçovë ka një nivel të përgjithshëm arsimor relativisht të ulët, por të krahasueshëm me qarkun dhe bashkitë e tjera fqinje. Pjesa më e madhe e popullsisë është me arsim fillor 8 ose 9 vjeçar[261], përkatësisht 57.1% e popullsisë (INSTAT, Censusi 2011). Ky raport është më i lartë se në bashkinë e Beratit, shumë i përafërt me atë në bashkitë e Gramshit dhe Lushnjes, por krahasimisht i ulët, krahasuar me bashkitë Cërrik, Belsh, Ura Vajgurore, Çorovodë dhe Poliçan.

Sa i përket arsimit të mesëm, Kuçova, me 31.8% të popullsisë që ka kryer këtë nivel arsimor, ka një raport pothuajse të njëjtë me Beratin dhe Lushnjen dhe krahasimisht më të lartë se bashkitë e tjera fqinje. Kjo do të thotë që popullsia që përbën forcën e punës në këtë bashki është më e kualifikuar nga ajo që ofrohet nga bashkitë fqinje dhe, për rrjedhojë, lehtëson konkurencën në tregun e punësimit rajonal.

Tabela 41. Niveli arsimor i përfunduar, vitet mesatare të shkollimit dhe niveli i analfabetizmit në bashkinë e Kuçovës, krahasuar me bashkitë fqinje

Bashkia	Niveli arsimor i përfunduar 8 ose 9 vjeçar	Niveli arsimor i përfunduar i mesëm	Niveli arsimor i përfunduar i lartë	Vitet mesatare të shkollimit	Niveli i analfabetizmit
Kuçovë	**57.1%**	**31.8%**	**6.2%**	**9.6**	**3.5%**
Berat	53.2%	33.0%	8.9%	9.9	3.0%
Ura Vajgurore	69.1%	22.1%	4.1%	9.1	3.3%
Lushnje	56.7%	31.3%	7.8%	9.8	2.9%
Belsh	71.4%	19.4%	2.9%	8.8	4.4%
Cërrik	66.2%	23.6%	4.3%	9.2	4.2%


Gramsh	59.5%	27.8%	7.7%	9.7	3.5%
Poliçan	62.8%	27.7%	4.4%	9.2	3.7%
Çorovodë	61.9%	28.2%	5.7%	9.5	2.9%
Qarku Berat	**58.6%**	**29.8%**	**6.8%**	**9.6**	**3.21%**
Shqipëri	***52.10%***	***31.40%***	***11.80%***	***10.2***	***2.80%***

Burimi: INSTAT, 2011

Nga ana tjetër, përqindja e popullsisë me arsim të lartë universitar dhe pasuniversitar është 6.2%. Ky raport e pozicionon Kuçovën para bashkive të Belshit, Cërrikut, Urës Vajgurore, Çorovodës dhe Poliçanit, por pas atyre të Beratit, Lushnjes dhe Gramshit.

Në nivel njësish administrative, Kozara është ajo që ka përqindjen më të lartë të popullsisë me arsim fillor dhe 8 ose 9 vjeçar, me një vlerë prej 75.17%, ndërsa qyteti i Kuçovës ka 38.47% të popullsisë (raporti më i ulët prej njësive) me nivel arsimor fillor dhe 8 ose 9-vjeçar.

Figura 87. Niveli arsimor në bashkinë e Kuçovës, sipas NA-së (1_Niveli i analfabetizmit; 2_% e popullsisë me arsim 9-vjeçar; 3_% e popullsisë me arsim të mesëm; 4_% e popullsisë me arsim të lartë)



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Siç vërehet në figurën e mësipërme, popullsia e qytetit të Kuçovës ka përqindjen më të lartë edhe për popullsinë që ka përfunduar arsimin e mesëm, edhe atë që ka përfunduar të lartin, krahasimisht me njësitë e tjera.

Infrastruktura arsimore: Për të analizuar infrastrukturën arsimore në bashkinë e Kuçovës janë marrë në shqyrtim 3 faktorë: 1) rrezja e shërbimit dhe mbulimi që ka territori i bashkisë, 2) raporti nxënës-mësues në shkolla; c) gjendja fizike e objekteve arsimore.

- Aksesi dhe rrezja e shërbimeve


Aktualisht, bashkia Kuçovë ka 26 kopshte, 29 shkolla 9-vjeçare dhe 6 shkolla të mesme, të shpërndara si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 42. Numri dhe shpërndarja e objekteve arsimore sipas NJA-së

	Kopshte	Shkolla 9-vjeçare	Shkolla të mesme të përgjithshme	Shkolla të mesme profesionale
Kuçovë	6	6	2	1
Kozarë	7	9	1	0
Perondi	6	5	1	0
Lumas	5	7	1	0


Burimi: Bashkia Kuçovë, 2015

Figura 88. Mbulimi i territorit me shërbimin e insitucioneve të arsimit parashkollor




Burimi: Bashkia Kuçovë; Perpunoi: Co-PLAN, 2015

Figura 89. Mbulimi i territorit me shërbimin e institucioneve të arsimit 9-vjeçar



Burimi:Bashkia Kuçova; Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Figura 90. Mbulimi i territorit me shërbimin e institucioneve të arsimit të mesëm



Burimi:Bashkia Kuçova; Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Qyteti i Kuçovës ka një mbulim të mirë me të trija nivelet e shërbimit arsimor. Problematike mbetet gjendja në pjesën rurale të bashkisë. Mbulimi i territorit nga rrezja e shërbimit të kopshteve është shumë i vogël. Fshatra të tillë si Frashër, Luzaj dhe Katundas në veri të bashkisë apo Belesovë dhe Mëndrakë në lindje nuk kanë kopshte.


Njësia e Lumasit është më problematikja edhe sa i përket mbulimit me shkolla 9-vjeçare. Fshatra si Zelevizhdë, Lumas dhe Katundas nuk kanë shkollë 9-vjeçare dhe rrezja e shërbimit të fshatrave fqinje nuk i mbulon.

Pothuajse po të njëjtat zona rurale të banuara të cilat kanë problematika me mbulimin me kopshte dhe shkolla 9-vjeçare kanë edhe probleme me mbulimin nga rrezja e shërbimit të shkollave të mesme. Zonave problematike i shtohen edhe fshatrat e Drizës, Koritëzës dhe Sheqëzit.

Kapaciteti akademik: Për sa i përket kapacitetit akademik, raporti nxënës/mësues qëndron veçanërisht i lartë krahasuar me standardet e BE-së.

Raporti fëmijë/edukator në 26 kopshtet e bashkisë Kuçovë mund të konsiderohet shumë i lartë. Rekomandimi i UNICEF-it sugjeron se raporti optimal duhet të jetë 10 për fëmijët 3-4 vjeç dhe akoma më i ulët për ata më të vegjël. Ky raport për Kuçovën është 18 fëmijë/edukator (Ministria e Arsimit, 2012).


Figura 91. Raporti nxënës- mësues në kopshte



Burimi: Bashkia Kuçovë; Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Sipas Bankës Botërore, në vitin 2013 raporti nxënës/mësues për shkollat fillore në BE ishte 13.3, ndërsa në Shqipëri ky raport ishte 19.1. Në Kuçovë, nga 29 shkolla 9-vjeçare 12 e kanë këtë raport më të ulët se ai i BE-së, ndërsa pjesa tjetër e tejkalon atë. Ndërkohë, mesatarja është e barabartë me atë të BE-së. Pra, sa i përket kapacitetit akademik për shkollat 9-vjeçare, bashkia Kuçovë është shumë e avantazhuar.


Figura 92. Raporti nxënës-mësues në shkollat 9-vjeçare



Burimi:Bashkia Kuçova;Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Sërish sipas Bankës Botërore, raporti nxënës/mësues për shkollat e mesme në BE është 11.8, ndërsa në Shqipëri është 14.8. Në këtë pikë, me vlerën 15.2, bashkia Kuçovë është më pak e avantazhuar, krahasuar edhe me Shqipërinë. Gjithsesi, prania e një shkolle të mesme në secilën njësi administrative është pozitive në kuadër të aksesit në arsimin e mesëm.

Figura 93. Raporti nxënës- mësues në shkollat e mesme



Burimi: Bashkia Kuçovë; Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Gjendja fizike e shkollave: Nga një analizë e gjendjes fizike të shkollave, kryer nga Ministria e Arsimit (2012) për shtatë kritere[262], në bashkinë e Kuçovës paraqesin gjendje rrezikshmërie këto objekte arsimore: shkolla 9-vjeçare në Bardhaj, Lumas dhe kopështi "Shefqet Shuaipi", Lumas. Ndërtesat në fjalë kanë 6-7 kritere në gjendje kritike.

Një vëzhgim i përgjithshëm[263] i objekteve arsimore sugjeron se, përgjithësisht, gjendja e tyre është mesatare, me nevojë për rikonstruksione të pjesshme. Të gjitha kopshtet kanë nevojë për pajisje mësimore dhe laboratorike dhe në 50% të rasteve rruga për tek to është e paasfaltuar. Vetëm 60% e kopshteve janë të pajisura me terrene sportive.


Sa i takon shkollave të mesme, pjesa më e madhe e tyre kanë akses të mirë, me rrugë të asfaltuara. Janë identifikuar 5 shkolla në gjendje të përgjithshme të degraduar, në nevojë për rikonstruksion tërësor: "Dëshmorët e Kombit" dhe "18 Dhjetori" në Kuçovë, si dhe shkolla e Kozarës, Zdravës dhe Salcë Kozarës. Asnjë nga objektet arsimore nuk ka laboratorë dhe të gjitha kanë nevojë për pajisje dhe mjete mësimore.

Ndër shkollat e mesme, "Myrteza Kepi" në qytetin e Kuçovës paraqitet në nevojë për rikonstruksion. Gjithsesi, gjendja e shkollave të mesme është përgjithësisht e mirë dhe aksesi në to bëhet me rrugë të asfaltuar. Edhe në këto objekte mungojnë tërësisht laboratorët dhe ka nevojë për mjete mësimore, por të gjitha sigurojnë terren sportiv dhe kanë kapacitete optimale klasash, çka bën të mos lindë nevoja për alternativën e kryerjes së mësimit me dy turne.

- **Punësimi**

Bashkia Kuçovë paraqet një situatë të mirë të punësimit potencial, duke qenë se përqindja e popullsisë së aftë për punë në grupmoshën 15-64 vjeç është e konsiderueshme. Respektivisht, ky tregues është 68.2% për Kuçovën, 67.1% për Kozarën, 67.6% për Lumasin dhe 68.6% për Perondinë.


Figura 94. Numri i banorëve në moshë pune



Burimi: INSTAT (2011) dhe llogaritje të autorëve për vitin 2015

Punësimi sipas degëve të ekonomisë: Në këtë seksion do rimerret sërish vlerësimi i sektorëve kryesorë të punësimit, tashmë në aspektin e mirëqenies ekonomike. Në zonat me karakter rural mbizotëron vetëpunësimi në sektorin bujqësor e pyjor në mbi 70% të fuqisë punëtore lokale. Në analogji me analizën e nivelit të edukimit sipas njësive administrative vërehet gjithashtu që në njësitë Lumas, Kozarë e Perondi arsimi mbizotërues është ai fillor e 8-vjeçar (në masën 65-80%). Ky është tregues i rëndësishëm i ndërlidhjes mes sektorit të punësimit dhe nivelit arsimor të popullsisë.

Figura 95. Punësimi sipas sektorëve ekonomikë, nivel njësish administrative




Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Në Kuçovë punësimi ka tendenca diversifikimi drejt sektorit të shërbimeve, industrisë dhe tregtisë, përkatësisht në masën 40.4%, 33.5% dhe 17.3%. Si rrjedhojë e kësaj, qyteti i Kuçovës shënon një numër të lartë të punësuarish me pagesë, rreth 69%, të krahasueshëm

me njësitë administrative urbane fqinje (INSTAT, 2011). Gjithsesi, vetëm 0.2% e popullsisë në njësinë administrative Kuçovë janë të punësuar në administratë, ndërsa pjesa tjetër i dedikohet sektorit privat, gjë që dëshmon për efiçencë në shpërndarjen e fuqisë punëtore. Pavarësisht tendencave pozitive të arsimit në njësinë Kuçovë, vërehet se, në tërësi, punësimi është më i ulët se në njësitë rurale dhe se popullata me arsim të lartë përbën vetëm 25% të të punësuarve në rang qyteti.

Figura 96. Shkalla e të punësuarve sipas nivelit arsimor



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatititi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


Një tjetër tregues i rëndësishëm që ndikon në mirëqenien dhe konkurrueshmërinë e kësaj bashkie është edhe papunësia. Shkalla e papunësisë për bashkinë është relativisht e ulët në raport me rajonin: Kuçova ka një normë 20.5% të papunësisë, përkundrejt normës mesatare kombëtare (29.3), normës në nivel qarku (20.3%) dhe normave të papunësisë së bashkive të të njëjtit karakter: Gramshi (31.5%), Roskoveci (33%), Patosi (49%) etj. Shkalla e papunësisë për femra arrin 22%, me një hendek 3% më tepër në raport me papunësinë në popullatën mashkullore. Kjo pasqyron tendenca të pranishme në gjithë territorin, ku diferenca për Shqipërinë është 4.8% dhe për qarkun Berat 4.5%. Norma më e lartë e papunësisë i takon qytetit të Kuçovës me 38,5% të popullatës së regjistruar si punëkërkues. Duke pasur parasysh përqindjen e konsiderueshme të popullsisë së aftë për punë (Figura 43), kjo shifër bëhet domethënëse. Shkalla e papunësisë te të rinjtë në nivel bashkie është 40.4%, relativisht e mirë në kontekstin rajonal, por shumë e lartë në njësinë Kuçovë (75.9%), mjaft më e lartë se njësitë urbane të zhvilluara të rajonit si Berati (60.2%), Lushnja (62.3%), Fieri (59%) dhe Elbasani (65%). Ky është një drejtim në të cilin bashkia duhet të investojë, së bashku me diversifikimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe rritjes së shkallës së përgjithshme të edukimit, për t'u bërë konkurruese në rajon dhe për të ulur largimin e fuqisë punëtore drejt destinacioneve të tjera të punës.

Tabela 43. Situata e papunësisë në bashkinë e Kuçovës, papunësia tek të rinjtë dhe ndarja sipas gjinive

	Papunësia Total	Papunësia tek të rinjtë	Papunësia femra	Papunësia meshkuj
Kuçovë	38.5	75.9	38.3	38.7
Kozarë	4.8	19.1	4	5.3
Perondi	12.9	34.1	13.4	12.7
Lumas	5.4	13.6	6.9	4.8
Bashkia Kuçovë	20.5	40.4%	22%	19%

Burimi: INSTAT, 2011

Figura 97. Niveli i përgjithshëm i papunësisë në bashkinë e Kuçovës



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

- **Shëndetësia**

Infrastruktura shëndetësore: Shërbimi parësor shëndetësor në bashkinë Kuçovë mbulohet nga 13 qendra shëndetësore[264]. Kozara ka 4 qendra shëndetësore të shpërndara në fshatrat Havaleas, Gegë, Kozarë dhe Vlashuk. Dy prej këtyre qendrave shëndetësore, ato në fshatin Gegë dhe Kozarë, nuk plotësojnë standardin e madhësisë së parcelës[265] prej 300-400 m^2. Duke pasur parasysh që njësia administrative Kozarë ka 5651 banorë[266], mund të dilet në përfundimin se numri i qendrave shëndetësore është i mjaftueshëm. Sa i përket njësisë administrative të Perondisë, nga 4 qendrat shëndetësore vetëm ajo në fshatin Perondi plotëson standardin për madhësinë e parcelës. Në të njëjtën kohë, popullsia prej 9052 banorësh nuk mbulohet mjaftueshëm nga këto katër qendra shëndetësore dhe kërkohet minimalisht edhe një tjetër. Nga ana tjetër, njësia administrative e Lumasit ka në përbërje të saj 5 qendra shëndetësore, nga të cilat vetëm ajo në fshatin Bardhaj nuk plotëson standardin për madhësinë e parcelës. Situata e mbulimit të popullsisë, në këtë rast, paraqitet më e favorshme për 4,002 banorët e kësaj njësie administrative.

Situata në qytetin e Kuçovës paraqitet mjaft e mirë në aspektin e infrastrukturës shëndetësore. Në këtë qytet ndodhet një spital, 3 ambulanca, 1 qendër shëndetësore, 1 konsultore e gruas, 4 konsultore të fëmijës, 1 qendër planifikimi familjar dhe 1 poliklinikë. Duke iu referuar standardit të mësipërm, në njësinë Kuçovë duhet të ketë 8 qendra shëndetësore dhe 6 ambulanca konsultore. Gjithsesi, nëse marrim parasysh objektet e tjera shëndetësore, ky numër është i mjaftueshëm. Spitali i Kuçovës, nën administrimin e Drejtorisë së Shëndetit Publik (DSHP)[267] Kuçovë, ka 5 reparte, me një numër total prej 55 shtretërish. Numri i të shtruarve në vit është rreth 1740, me një numër mesatar prej 3.6 ditësh qëndrimi.[268] Të dyja këto vlera janë mjaft të ulëta në raport me rajonin.

Mesatarisht, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore dhe mjeku më i afërt, në nivel qarku, është 14 minuta për zonat rurale dhe 15 minuta për ato urbane. Kjo do të thotë që aksesi është relativisht i mirë, sidomos për zonat rurale (INSTAT, 2011).

Niveli i shëndetit publik: Sa i takon nivelit të përgjithshëm shëndetësor të popullsisë, numri i personave me aftësi të kufizuara në bashkinë Kuçovë arrin 7.5% ndaj totalit të popullsisë. Kjo vlerë është pak më e lartë se vlera mesatare e qarkut (7.3%) dhe mesatarja kombëtare (6.2%). Rezulton se bashkia Kuçovë ka numrin më të lartë të personave me aftësi të kufizuara në qark (22%), veçanërisht me probleme në ecje dhe në shikim.

Treguesit e vdekshmërisë foshnjore e rendisin rrethin e Kuçovës ndër të paktat rrethe me shifër shumë të ulët, 0-1 raste në 1000 fëmijë të moshës 0-1 vjeç[269]. Gjithsesi, një problem për shëndetin publik, sidomos në qytetin e Kuçovës, por edhe në disa fshatra të Kozarës dhe Perondisë, mbetet prania e industrisë nxjerrëse të naftës. Pavarësisht mungesës së shifrave statistikore të sëmundshmërisë së lidhur me ndotjen e naftës si në ajër, ashtu edhe në ujërat nëntokësore e sipërfaqësore dhe, rrjedhimisht, në tokën bujqësore e produktet që kultivohen në të, ka pasur raste të protestave të banorëve për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore prej disa muajsh nga ndotja në ajër e ndërmarrjeve të përpunimit të naftës.[270]

Tabela 44. Numri i personave me aftësi të kufizuara sipas njësisë administrative dhe llojit të paaftësisë


	Në shikim	Në dëgjim	Në ecje	Në kujtesë	Në kujdesin ndaj vetes	Në komunikim	Gjithsej	% ndaj qarkut
Qarku Berat	**3,111**	**2,174**	**4,818**	**2,559**	**2,479**	**2,090**	**17,231**	
Kozarë	114	77	183	82	77	71	604	3.51%
Kuçovë	393	215	477	202	204	154	1,645	9.55%
Lumas	125	97	184	129	116	102	753	4.37%
Perondi	131	107	186	138	115	111	788	4.57%
Bashkia Kuçovë	**763**	**496**	**1,030**	**551**	**512**	**438**	**3,790**	**22.00%**

Burimi: INSTAT, 2011

- **Mirëqenia ekonomike e sociale**

Burimi i të ardhurave të njësisë ekonomike familjare: Grafiku i mëposhtëm paraqet situatën mbi të ardhurat e njësive ekonomike familjare për bashkinë Kuçovë. Vihet re që të ardhurat nga puna e paguar ose vetëpunësimi zënë pjesën më të madhe. Në vend të dytë janë të ardhurat nga pensionet, për të cilat qyteti i Kuçovës ka përqindjen më të lartë, gati 45%. Shqetësuese është situata për NJA Lumas ku mbi 15% e të ardhurave rezultojnë të jenë nga ndihma sociale. Këto raporte tregojnë se gjendja e punësimit dhe e vetëpunësimit është më problematike në qendrën urbane të Kuçovës, e cila potencialisht duhet të jetë qendra kryesore e gjenerimit të punësimit për bashkinë.

Figura 98. Burimi i të ardhurave të NJEF-ve në Kuçovë



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Varfëria: Qarku Berat renditet ndër qarqet me përqindjen më të lartë të varfërisë në rajon (12.7%), krahasimisht me qarqet fqinje të Elbasanit, Korçës, Gjirokastrës etj. Thellësia e varfërisë është 2.4% dhe ashpërsia 0.7%, shifra këto relativisht më pozitive në raport me nivelin kombëtar të varfërisë.

Tabela 45. Treguesit e varfërisë në nivel qarku, krahasuar me qarqet e rajonit dhe nivelin kombëtar

Qarku	Përqindja	Thellësia	Ashpërsia
Berat	**12.7**	**2.4**	**0.7**
Vlorë	11.7	2.4	0.8
Korçë	12.2	2.5	0.7
Gjirokastër	10.7	2.2	0.9
Fier	17.5	3.5	1.1
Elbasan	10.7	2.3	0.8
Shqipëri	14.3	2.9	1.0

Burimi: LSMS[271], INSTAT, 2012

Si rezultat i kushteve të jetesës në varfëri ekstreme ose pjesërisht-ekstreme, pak më shumë se 5,000 familje në qarkun e Beratit përfitojnë ndihmë ekonomike.[272]

Në bazë të informacionit të marrë nga Zyra e Ndihmës Ekonomike në Bashkinë e Kuçovës, 435 familje trajtohen me ndihmë ekonomike. Kjo do të thotë rreth 10% e familjeve në nivel qarku, shifër mjaft e ulët në raport me numrin e popullsisë. Pjesa më e madhe e familjeve që përfitojnë nga ndihma jetojnë në Kuçovë, por të ardhurat nga asistenca janë krahasimisht të larta për Lumasin ku 34 familje jetojnë me asistencë. Ky fakt thekson statusin e cënueshëm të njësisë Lumas në ekonominë vendore, si dhe disbalancën e mirëqenies ekonomike në qendrën Kuçovë.

Tabela 46. Numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike

	Nr.i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike
Kuçovë	361 familje
Perondi	25 familje
Kozarë	15 familje
Lumas	34 familje

Burimi: Zyra e Ndihmës Ekonomike, Bashkia Kuçovë, 2015

Shërbimet sociale: Qarku Berat ka një numër të kufizuar shërbimesh sociale, pjesa më e madhe e të cilave janë të vendosura në qytetin e Beratit, me distancë të arritshme për 20-30 minuta nga pjesa më e madhe e vendbanimeve të bashkisë së Kuçovës. Ndërkaq, nën administrimin e bashkisë nuk ka qendra sociale për të moshuar, për komunitete të ndjeshme apo për probleme sociale specifike.

Tabela 47. Shpërndarja e shërbimeve sociale në qarkun e Beratit

Qarku Berat	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	0	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	1	3
Shërbime sociale për fëmijët	0	1[273]
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	1	2
Shërbime sociale për PAK	0	1
Gjithsej	2	7

Burimi: Harta e shërbimeve sociale në Shqipëri 2013,-MMSR dhe UNICEF

Këto shërbime mbulohen pjesërisht nga një qendër rinore me bibliotekë të përfshirë, një qendër kulturore, një qendër kulturore fëmijësh, si dhe ambientet sportive të siguruara në fushën e tenisit, në stadium dhe në aneksin e fushës së sportit "1 Maji" në qytetin e Kuçovës.

1.5.3 Konkluzione mbi sfidat dhe problematikat sociale

Analiza demografike: Bashkia Kuçovë, në 1 janar 2015, regjistroi një numër të popullsisë rezidente prej 31 mijë banorësh, me një koeficient të raportit gjinor të vlerësuar me 101 (101 meshkuj për çdo 100 femra). Rreth 40% e kësaj popullsie klasifikohet si popullsi urbane dhe 60% e saj si popullsi rurale. Sipas strukturës moshore, rreth 68% e kësaj popullsie i përket grup-moshës 15-64 vjeç dhe 19% grupmoshës 0-14 vjeç, tregues këta që demonstrojnë potencial të lartë të popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e së cilës në tregun e punës do të rrisë performancën ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente, si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregon se kemi akoma një popullsi të re.

Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, si dhe rënia e ritmeve të lindshmërisë dhe vdekshmërisë kanë ndikuar jo vetëm në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike, por edhe në pakësimin/rënien e numrit të popullsisë. Sipas projeksioneve të popullsisë (skenari i rritjes së mesme), popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie me një ritëm mesatar vjetor rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.

Treguesi i varësisë totale do të ruajë vlerat e tij të ulëta (45-55) deri në vitin 2021, duke demonstruar kështu ekzistencën e të ashtuquajturit "divident demografik". Për të përfituar nga "dividenti demografik" kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e vendor, për të mundësuar arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullatës me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

Analiza socio-ekonomike: Në bashkinë e Kuçovës mesatarja e viteve të shkollimit është 9.6 vite, relativisht më e ulët se mesatarja kombëtare. Përqindja e popullsisë me arsim të lartë universitar dhe pasuniversitar është 6.2%. Ky raport e pozicionon Kuçovën në mënyrë të favorshme në raport me bashkitë fqinje të Belshit, Cërrikut dhe Urës Vajgurore, por në disfavor në lidhje me vlerën në nivel qarku (11.7%). Qyteti i Kuçovës rezulton me nivelin më të lartë arsimor, ku 10% e popullsisë kanë përfunduar arsimin universitar.

Sa i takon infrastrukturës arsimore, bashkia Kuçovë ka mbulim të mirë me të trija nivelet e arsimit (parashkollor, 9-vjeçar dhe të mesëm). Disa fshatra me distancë të largët nga institucionet arsimore më të afërta janë: Frashëri, Luzaj dhe Katundas në lidhje me kopshtet; Zelevizhda, Lumasi e Katundasi në lidhje me shkollat 9-vjeçare; Driza, Koritëza e Sheqëzi në lidhje me shkollat e mesme.

Raporti mësues-nxënës, si tregues i kapacitetit të mësimdhënies, rezulton të jetë relativisht favorizues në krahasim me standardet e BE-së, si dhe mesataren kombëtare, sidomos për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.

Në bashkinë Kuçovë gjenden 20 institucione shëndetësore, nga të cilat 1 spital (në qytetin e Kuçovës), 6 qendra shëndetësore, 7 ambulanca konsultore, 3 shërbime dentare dhe 3 farmaci. Është e nevojshme të shtohet një qendër shëndetësore në njësinë Perondi dhe 2-3 qendra shëndetësore apo ambulanca në Kuçovë për të mbuluar më mirë shërbimin e shëndetit parësor.

Niveli i përgjithshëm shëndetësor i popullsisë paraqitet i mirë sa i takon numrit të personave me aftësi të kufizuara dhe treguesve të vdekshmërisë foshnjore. Gjithsesi, prania e industrisë përpunuese të naftës sjell shqetësim të vazhdueshëm në shëndetin e banorëve të zonave afër saj.

Punësimi në bashkinë Kuçovë është i orientuar kryesisht drejt sektorit bujqësor, sidomos në njësitë rurale. Në qytetin e Kuçovës ka diversifikim të mirë të punësimit mes shërbimeve, tregtisë dhe industrisë, por shkalla e papunësisë është shumë e lartë (38%).

Gjendja e përgjithshme e varfërisë dhe e mirëqenies ekonomike paraqitet pozitive në raport me nivelin kombëtar dhe rajonin.

Shërbimet sociale të dedikuara për grup-moshat në nevojë, si dhe për ato me probleme specifike mungojnë totalisht në qark ose janë të paaksesueshme nga banorët e bashkisë.

1.6 Zhvillimi ekonomik urban dhe rural

1.6.1 Vlerësimi Ekonomik dhe sektorët

Në këtë seksion jepet një pasqyrë e tendencave kryesore të zhvillimit ekonomik në bashkinë e Kuçovës, fokusuar veçanërisht në ndryshimet që ka sjellë reforma administrative- territoriale. Në përgjithësi, vlen të theksohet që bashkia ka kaluar nga një territor vetëm urban në një territor më kompleks urbano-rural. Aspektet që janë marrë në

konsideratë për këtë analizë janë: treguesit makroekonomikë si PPB-ja, VSHB-ja dhe produktiviteti, të analizuar në rang qarku; tendencat kryesore të bizneseve; potencialet bujqësore; sektorët ekonomikë me peshën kryesore në bashkinë Kuçovë, të ndarë sipas klasifikimit 'ekonomi agrare' dhe 'ekonomi aglomeruese'.

- **Prodhimi i brendshëm bruto, vlera e shtuar bruto dhe produktiviteti**

Për vlerësimin e treguesve ekonomikë si prodhimi i brendshëm bruto (PBB), vlera e shtuar bruto (VSHB) dhe produktiviteti i sektorëve i referohemi të dhënave për qarkun Berat, si niveli më i detajuar ku maten këta tregues.

Tabela 48. PBB-ja e qarkut Berat në raport me Shqipërinë dhe qarqe të ngjashme për vitin 2012


Vendi	Struktura e PBB-së (%)	PBB-ja për frymë në lekë
Shqipëria	100	460,436
Qarku Berat	4.1	371,324
Qarku Vlorë	5.8	422,054
Qarku Dibër	3.2	309,670
Qarku Lezhë	3.4	327,027

Burimi: INSTAT, Vjetari Statistikor Rajonal, 2015

Në qarkun e Beratit PBB[274]-ja për frymë është rreth 371 000 lekë, pra 20% më e ulët në raport me PBB-në për frymë në nivel kombëtar (460 400). Krahasuar me qarqe të ngjashme, qarku i Beratit pozicionohet më mirë se Dibra dhe Lezha dhe më në disfavor në lidhje me Vlorën, ndërkohë që, në këndvështrimin rajonal, ndan vlera PBB-je të përafërta me qarqet fqinje (Berat, Elbasan), më të mëdha se qarku Korçë dhe më të ulëta se qarku Fier[275]. Kontributi i qarkut Berat në PBB-në e përgjithshme është 4.1%, duke e renditur atë ndër 5 qarqet me kontributin më të ulët në vend.

Tendencat e PBB-së të qarkut Berat paraqiten jo të qëndrueshme në periudhën pas vitit 2008, me luhatje mes ritmeve të rritjes dhe uljes. Në vitin 2012 PBB-ja për qarkun Berat ka pësuar ulje me 2.1%, ndërkohë që edhe në qarqet fqinje vërehen tendenca uljeje si në Vlorë, Elbasan etj. Në raport me normat e rritjes së PBB-së në rang Shqipërie, tendencat tregojnë, gjithashtu, rritje më të ngadaltë, nga 3.4% në 2009 në 1.39% në 2013.

Figura 99. Rritja reale e PBB-së në periudhën 2009-2012 për qarkun e Beratit dhe qarqe të ngjashme



Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal 2015; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Nga analiza e vlerës së shtuar bruto[276] sipas sektorëve, për qarkun Berat, rezulton se sektori bujqësor ka VSHB-në më të madhe, me 42.7%, ndjekur nga shërbimet, që vlerësohen me 35.9% të VSHB totale. Kontribuesi kryesor te shërbimet është tregtia, hotelet dhe restorantet me 9.3%, post telekomunikacioni me 2.5% dhe sektori i transportit me 2.3%. Sektori industrial vlerësohet si sektori terciar me 11% të VSHB-së, ku ka si nënndarje sektorin e industrisë nxjerrëse me 3% dhe sektorin e industrisë përpunuese me 8%. Sektori i fundit, i cili ka VSHB-në më të vogël, është sektori i ndërtimit me 10.5%.

Këta tregues dëshmojnë që të ardhurat kryesore të qarkut gjenerohen nga sektori bujqësor dhe nga shërbimet. Sektori industrial, i cili përfaqësohet nga një numër i madh industrish në periferi të qytetit të Beratit dhe nga e gjithë zona e puseve dhe e përpunimit të naftës në Kuçovë, zë një peshë mjaft të vogël në VSHB-në e qarkut.

Sa i takon produktivitetit të sektorëve ekonomikë[277] në qarkun e Beratit, vlera më e lartë dallohet në sektorin e shërbimeve me 0.9, ndjekur nga sektori bujqësor me 0.64 dhe sektori industrial me 0.53. Kjo tregon se, pavarësisht kontributit të lartë të sektorit bujqësor, numri i madh i të punësuarve në të bën që sektori i bujqësisë të mos jetë më produktivi në ekonominë e qarkut.

Tabela 49. Produktiviteti sipas sektorëve ekonomikë në qarkun e Beratit


Sektori	VSHB-ja e sektorit	Numri i punonjësve në sektor	Produktiviteti
Industria	5152	9743	0.53
Shërbimet	17841	19669	0.9
Bujqësia	20063	31543	0.64

Burimi: INSTAT, Llogaritë Rajonale 2012

- **Vlerësimi i situatës së njësive ekonomike në bashkinë Kuçovë**


Kuçova ka një numër total prej 823 njësish ekonomike (viti 2015). Nga këto, 92% (757) i takojnë biznesit të vogël dhe vetëm 8% (66) biznesit të madh. Numri më i madh i bizneseve ndodhet në Kuçovë (396 biznese të vogla dhe 41 të mëdha), ndjekur nga Perondia (195 biznese të vogla dhe 15 të mëdha), Kozarja (195 biznese të vogla dhe 15 të mëdha) dhe më pas Lumasi me 62 biznese gjithsej. Pavarësisht numrit relativisht të vogël të njësive ekonomike që operojnë në bashkinë Kuçovë, krahasimisht me qarkun, vërehet se, në raport me numrin e banorëve, shpërndarja e njësive ekonomike është mjaft e lartë, veçanërisht në njësitë administrative Kuçovë dhe Perondi (mesatarisht 50-60 biznese për 1000 banorë).

Figura 100. Njësitë ekonomike sipas llojit




Burimi: Bashkia Kuçovë;Përgatiti Co-PLAN, 2015

Figura 101. Numri i njësive ekonomike për 1000 banorë për qarkun e Beratit në nivel njësish administrative



Burimi: INSTAT, Ndërmarrjet aktive sipas llojit dhe njësisë administrative (2012)
Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Figura 102. Njësitë ekonomike sipas llojit të aktivitetit në bashkinë e Kuçovës



Burimi: Bashkia Kuçovë; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Për sa i përket sektorëve ku këto njësi ekonomike operojnë, sektori me numrin më të madh të bizneseve është ai i shërbimeve me 42.65% të tyre. Në shërbime janë përfshirë gjithë subjektet e restoranteve, hotelerisë e bareve, operatorët e transportit e komunikacionit, si

dhe shërbime të tjera. Në nivel bashkie, vërehet se numri më i madh i bizneseve të shërbimit i takon hoteleve, bareve e restoranteve (154 subjekte), duke theksuar funksionin mikpritës, akomodues dhe rekreativ të bashkisë.

Sektori i tregtisë zë 33.54% të njësive ekonomike, fokusuar kryesisht në biznese të vogla. Sektorët me peshë më të ulët janë industria (11.06%), përqendruar kryesisht në njësitë Kuçovë dhe Perondi; bujqësia (5.1%) dhe ndërtimi (1.58). Pavarësisht peshës relativisht të vogël në numër biznesesh respektive, bujqësia dhe industria janë dy sektorë shumë të rëndësishëm zhvillimi (ekzistues dhe potencial), të cilët janë trajtuar si seksione të veçanta:

- **Vlerësimi i sektorit industrial**

Industria është një sektor mjaft i rëndësishëm për bashkinë e Kuçovës, e cila, nga pikëpamja e punësimit, vlerësohet me rreth 17% të numrit të të punësuarve në rang bashkie. Zona e Kuçovës është një ndër zonat naftëmbajtëse më të hershme të Shqipërisë, zbuluar në vitin 1928, ku është zhvilluar industria e nxjerrjes së naftës, si dhe industria përpunuese e saj. Zona e nxjerrjes së naftës ndodhet në njësinë administrative të Kozarës, në brigjet e Lumit Devoll dhe në veri të qytetit të Kuçovës. Rezervat e naftës llogariten rreth 490 milion fuçi ose 6.7×10^7 t. Prodhimtaria mesatare e naftës bruto në Kuçovë është rreth 2500 ton në vit.

Nga të dhënat e prodhimtarisë së naftës bruto në Shqipëri rezulton se për 6 mujorin janar-qershor 2015 Kompania Sherwood, që ushtron aktivitetin e saj në Kuçovë, ka nxjerrë 1133 ton naftë bruto. Në raport me situatën në Shqipëri për të njëjtën periudhë kohore, kjo vlerë është mjaft e vogël (0.2% e totalit të prodhimit të naftës). Ndërkaq, numri i puseve është më i larti në të gjithë zonat naftëmbajtëse të Shqipërisë: 1090 puse, ndjekur nga Ballshi me 80 dhe Patosi me 28. Megjithëse industria e nxjerrjes së naftës ka një kontribut të vogël në krahasim me prodhimin kombëtar, ky sektor është mjaft i rëndësishëm për ekonominë lokale.

Tabela 50. Prodhimi i naftës bruto në Shqipëri në periudhën janar-qershor 2015

Kompania	Prodhimi në ton
Sherwood (Kuçovë)	1133
Marrëveshjet hidrokarbure	626,635
Albpetrol	23,166
Totali	650,934

Burimi: AKBN, 2015

Tabela 51. Numri i puseve aktive për vitin 2014

Vendburimi	Numri i Puseve
Patos	28
Amonicë	1
Kuçovë	1090
Ballsh	80

Burimi: AKBN, 2015

- **Klasifikimi i njësive administrative sipas llojit të ekonomive**

Ky seksion e trajton bashkinë dhe njësitë administrative të saj në këndvështrimin e llojit të ekonomive në to, pra sektorit kryesor të punësimit dhe dinamikave të lëvizjeve vajtje-

ardhje për në vendet e punës. Zonat ku mbizotëron karakteri bujqësor konsiderohen ekonomi agrare, ndërsa zonat me potencial për të thithur punësim dhe me fokus shërbimet apo industrinë do konsiderohen ekonomi aglomeruese.

Në bashkinë Kuçovë, aktualisht, 54.9% e popullsisë janë të punësuar në sektorin e bujqësisë, 17% në industri dhe 28% në shërbime (INSTAT, 2011). Në raport me bashkitë e tjera fqinje dhe pjesë të qarkut sektori bujqësor është më pak mbizotëruesi në strukturën lokale të punësimit, me përjashtim të bashkisë Berat, që e ka punësimin në këtë sektor shumë të ulët (39.4%). Edhe bashki të tilla si Ura Vajgurore, Cërriku, Poliçani, me sektorin industrial mjaft dominues në raport me qarkun, kanë një dominim të dukshëm të sektorit bujqësor në ekonominë lokale. Në aspektin industrial, për bashkinë Kuçovë, punësimi në këtë sektor shënon vetëm 17% të të punësuarve, vlerë kjo më e lartë se vlera në nivel qarku (16%), por më e ulët se pesha që zë në ekonominë e Beratit, Poliçanit, Belshit, Cërrikut etj. Duke marrë parasysh potencialin e naftës në rajon dhe ndikimin e madh që kanë puset e shpimit dhe orientimi industrial në dëmtimin e mjedisit dhe në uljen e cilësisë së jetesës për banorët e Kuçovës, përfitimi në strukturën e punësimit në këtë sektor duhet të ishte shumë më i madh.

Sektori i shërbimeve e pozicionon Kuçovën relativisht mirë, me rreth 1/3 e popullsisë të punësuar në të. Kjo vlerë është e krahasueshme me bashki si Skrapari, Gramshi, Lushnja etj. dhe shumë më e ulët se në bashkinë Berat, e cila është e vetmja në rajonin në studim që e ka sektorin e shërbimeve dominues në strukturën e punësimit.

Në tërësi, bashkia Kuçovë ka sektor kryesor punësimi bujqësinë, por prirjet drejt tij nuk janë shumë të theksuara. Sektorët e tjerë të industrisë dhe shërbimeve e paraqesin bashkinë neutrale në kontekstin rajonal, por të balancuar relativisht mirë në raport me vetveten.

Tabela 52. Punësimi sipas aktivitetit ekonomik në bashkinë Kuçovë krahasuar me bashki të tjera të qarkut Berat dhe bashkitë fqinje

	Bujqësi	Industri	Shërbime
Bashkia Kuçovë	**54.9**	**17.0**	**28.1**
Bashkia Berat	39.4	18.9	41.6
Bashkia Poliçan	60.2	17.6	22.2
Bashkia Skrapar	60.2	9.5	30.3
Bashkia Ura Vajgurore	67.3	10.6	22.1
Bashkia Gramsh	57.4	8.2	34.4
Bashkia Lushnje	59.3	9.6	31.2
Bashkia Cërrik	61.6	14.7	23.7
Bashkia Belsh	66.8	12.5	20.7
Qarku Berat	**51.8**	**16.0**	**32.3**
Shqipëria	**26.1**	**20.4**	**53.5**


Burimi: INSTAT, 2011

Situata e punësimit në nivel njësie administrative është e diversifikuar për Kuçovën dhe mjaft e orientuar drejt sektorit bujqësor për Kozaren, Perondinë dhe Lumasin. Në Kuçovë, sektori kryesor, me 40% të të punësuarve, janë shërbimet, ndjekur ngushtësisht nga industria (33.5%) dhe më pas tregtia. Sektori i ndërtimit dhe i bujqësisë zë një peshë shumë të ulët (rreth 2% të të punësuarve). Nga njësitë e tjera administrative, Perondia ka një

diversifikim disi më të madh, me sektorin e shërbimeve që zë 10% të punësimit. Edhe në Lumas ky sektor zë një peshë të madhe, 9.6%, në raport me sektorët e tregtisë, industrisë etj. Gjithsesi, në këto njësi sektori bujqësor është dominues në vlera 71-82%.

Tendencat e punësimit dëshmojnë për ekonomi thellësisht agrare në njësitë Kozarë, Lumas dhe Perondi dhe ekonomi më të diversifikuar, urbane në qytetin e Kuçovës. Për të vlerësuar nëse kjo ekonomi arrin të jetë aglomeruese, pra të mbledhë të punësuar nga vende të tjera dhe të mos humbasë fuqi punëtore, në vazhdim jepet një pasqyrë e lëvizjeve për në vendin e punës nga njësitë e bashkisë Kuçovë.

Figura 103. Punësimi sipas aktivitetit ekonomik në njësitë administrative të bashkisë Kuçovë



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Në nivel qarku, njësitë administrative të bashkisë Kuçovë duket se humbin më tepër fuqi punëtore se pjesa më e madhe e njësive të tjera. Përjashtim bën vetëm njësia Roshnik në Bashkinë Berat ku mbi 60% e të punësuarve punojnë jashtë territorit të saj. Bashkitë Berat dhe Ura Vajgurore, në tërësi, kanë tendencat më të mira të punësimit, ku mbi 80% e të punësuarve punojnë brenda territorit të njësisë përkatëse. Të trija njësitë administrative Perondi, Kozarë e Lumas kanë tendenca të larta të humbjes së fuqisë punëtore, veçanërisht Lumasi, ku mbi 50% e të punësuarve udhëtojnë për në vendin e punës. Ndërkaq, në Kozaresi kjo shifër është 23%, në Perondi 18% dhe në Kuçovë 15%.


Nëse studiojmë tendencat e lëvizjeve të të punësuarve, vërehet që njësia Lumas humbet mjaft fuqi punëtore, kryesisht drejt destinacioneve jashtë bashkisë. Respektivisht, 22% e tyre punojnë në Moglicë, 15% në Poshnje, 7% në Otllak dhe 4% në Urën Vajgurore. Vetëm 0.1% e popullsisë së punësuar punojnë në Kuçovë dhe Perondi e asnjë në Kozare. Kjo është mjaft kuptimplotë në interpretimin e lidhjeve historike, ekonomike dhe kulturore të njësisë Lumas me rrethin Kuçovë.

Njësia Kozarë ka lidhje të theksuar punësimi me njësitë fqinje, ku 8.8% janë të punësuar në Kuçovë, 2.7% në Krutje dhe 1.8% në Perondi. Perondia paraqet të njëjtat tendenca, ku 9.3% të të punësuarve punojnë në Kuçovë, 2% në Urën Vajgurore dhe 1.7% në Berat. Duke

pasur parasysh marrëdhëniet territoriale me Kuçovën, shkëmbimet për arsye punësimi nuk paraqiten të larta.

Qyteti i Kuçovës ka si objektiv punësimi Beratin (5.4%). Gjithsesi, nuk mungojnë marrëdhëniet me Kozarën (2.4%), Perondinë (2.1%), Urën Vajgurore (1.6%) dhe Fierin (0.8%). Destinacionet e tjera janë të larmishme, por jo domethënëse sa i takon numrit të të punësuarve në to. Ato variojnë që nga Kopliku, Kukësi, Fushë-Kruja, Durrësi, njësitë e Fierit e deri në Sarandë e Dropull.

Figura 104. Përqindja e të punësuarve që punojnë në njësinë administrative ku banojnë, nivel qarku



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015


Për sa i përket flukseve ardhëse të të punësuarve, tendencat janë mjaft të zbehta. Në Lumas prurjet kryesore vijnë nga Otllaku, Mollasi, Frakulli, Kuçova etj., por në masë 0.2-0.4% të të punësuarve të njësisë respektive. Në Perondi prurjet kryesore vijnë nga Kuçova (2.1%), Kozarja (1.8%) dhe Lumasi (1.5%), ndjekur nga Maqellara e Gjorica. Në Kozarë ka prurje të konsiderueshme nga Frashëri, ku 8.6% e të punësuarve punojnë në Kozarë, si dhe nga Kuçova (2.4%) e Perondia (0.7%). Së fundi, në Kuçovë flukset kryesore hyrëse të punësimit i takojnë Perondisë (9.3%), Kozarës (8.8%), ndjekur nga Konispoli (4.3%), Ura Vajgurore e Dropulli i Poshtëm. Vërehet se marrëdhëniet e punësimit me Lumasin janë shumë të dobëta dhe ka tendenca ardhjeje nga zona shumë të largëta për arsye punësimi në sektorin industrial.

Si përfundim, mund të thuhet se, pavarësisht situatës neutrale në rajon, sa i takon përthithjes së fuqisë punëtore në raport me njësitë e veta përbërëse, bashkia Kuçovë ka prirje

aglomerimi të mira dhe njësia Kuçovë mund të konsiderohet ekonomi aglomeruese me fokus shërbimet dhe tregtinë. Në njësitë e tjera ekonomia agrare është mbizotëruese, me theksim më të madh në Lumas dhe më të zbehtë në Kozarë dhe Perondi.


Sfida e bashkisë së Kuçovës është të integrojë më mirë Lumasin në "basenin e punësimit" dhe të synojë diversifikimin e ekonomive të njësive Kozarë dhe Perondi në aspektin e ofrimit të shërbimeve si dhe në potencialin industrial të tyre.

Figura 105. Ekonomitë agrare dhe aglomeruese në bashkinë Kuçovë



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Figura 106. Destinacionet dhe origjina e lëvizjeve dalëse dhe hyrëse për arsye punësimi



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

- **Zonat ekonomike në bashkinë e Kuçovës**

Ky seksion bën një evidentim të poleve kryesore ekonomike të bashkisë Kuçovë, të kategorizuar në dy grupe kryesore:


- Fashat e bizneseve ku janë përqendruar shërbimet tregtare dhe të llojeve të tjera
- Zonat industriale ku janë përfshirë zonat e puseve të naftës, si dhe industritë operuese në territor.

Kështu, në bashkinë Kuçovë identifikohen 6 zona ekonomike kryesore:

Zona 1 është zona hyrëse në qytetin e Kuçovës që përbëhet kryesisht nga njësi tregtare dhe njësi të shërbimeve. Në këtë zonë ka përqendrim biznesesh të vogla dhe disa të mëdha.

Zona 2 është zona që përfshin qendrën dhe rrugën kryesore të qytetit dhe karakterizohet kryesisht nga biznese të vogla.

Figura 107. Zonat ekonomike në bashkinë Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Zona 3 është zona industriale e qytetit të Kuçovës e cila ndodhet në hyrje të qytetit dhe vazhdon deri në njësinë administrative të Perondisë. Kjo zonë industriale kryesisht i dedikohet përpunimit të naftës, po ka dhe njësi industriale të prodhimit të materialeve inerte si dhe njësi ekonomike të ndryshme.

Zonat 4, 5 dhe **6** janë vendndodhjet e grupuara të puseve të nxjerrjes së naftës, të cilat ndodhen në zonat afër bregut të lumit, në terrenin bujqësor të njësisë Kozarë e Perondi, si dhe shumë afër zonave të banuara. Këto zona paraqesin një aktivitet ekonomik të rëndësishëm në rajon, por gjithashtu janë burim ndotjesh të parikuperueshme të tokës e ujërave dhe shqetësim për banorët në afërsi tyre. Pus-shpimet janë të përhapura edhe në qytetin e Kuçovës, në zonën qendrore të tij.

Nëse kryejmë një evidentim të përhapjes së tokës bujqësore në territor, vërejmë se njësitë Kozarë dhe Perondi kanë sasinë më të madhe të saj, ndërkohë që njësia Lumas ka kryesisht karakter natyror. Duke qenë se ekonomitë e njësive janë kryesisht agrare, ndotja e tokës bujqësore dhe ujërave ujitëse nga prania e puseve dhe zonave industriale pa hapësirë buferike rreth tyre përbën një rrezik në produktivitetin e tokës dhe në cilësinë e produkteve të saj.

- **Vlerësimi i sektorit bujqësor**

Kuadri ligjor për bujqësinë, tokën bujqësore dhe zhvillimin rural përcaktohet kryesisht nga dokumentet e mëposhtme:

Sipas ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, **"Për bujqësinë dhe zhvillimin rural"**, objektivat e përgjithshëm të qeverisë në lidhje me zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimin rural lidhen me rritjen e të ardhurave për popullsinë rurale, rritjen e prodhimit të përgjithshëm kombëtar, duke garantuar cilësi dhe siguri ushqimore dhe, në të njëjtën kohë, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin. Përsa i përket rolit dhe funksioneve të qeverive lokale në këtë drejtim, ligji nr. 139/2015, datë 31.07.2000, **"Për vetëqeverisjen vendore"**, , përmbledh funksionet e zgjeruara të bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave pas reformës administrative territoriale, duke përfshirë: administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit, menaxhimin e pyjeve dhe kullotave vendore, si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtyre fuksioneve. Për më tepër, bashkitë kanë funksion krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimit rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët dhe janë përgjegjëse për shërbimin veterinar vendor, informacionin statistikor bujqësor dhe administrimin e kadastrës së tokave bujqësore.

Përsa i përket aspektit të planifikimit, objektivat e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural janë të lidhura me rritjen e sipërfaqes së tokave bujqësore të shfrytëzuara për të rritur madhësinë mesatare të fermave e, në këtë mënyrë, për të rritur prodhimtarinë e sektorit (**Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor, 2014-2020**). Sipas legjislacionit në fuqi dhe ligjit 9244, datë 17.06.2004, **"Për mbrojtjen e tokës bujqësore"**, i ndryshuar, specifikohet mbrojtja e tokës nga ndërtimet, mbrojtja e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit, si dhe zbatimi i një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar me përjashtim të ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 283, datë 01.04.2015, **"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"**. Për të gjitha objektet për qëllime bujqësore duhet të respektohen distancat nga rrugët, çdo infrastrukturë tjetër publike, nga kanalet ujitëse e kulluese, si dhe brigjet e lumenjve, me sipërfaqe dhe kritere të veçanta të përcaktuara në pikat 1-12. Leja e ndërtimit lëshohet nga njësia e qeverisjes vendore në përputhje me dokumentin e planifikimit vendor.

Ndryshimi i tokës bujqësore në kategori të tjera burimesh si në tokë urbane, pyjore, kullotë, livadh dhe tokë e pafrytshme bëhet sipas përcaktimit në ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001, **"Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës"**, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Më specifikisht, ligji cilëson që në tokat bujqësore të kategorisë së parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të bonitetit mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave vetëm për rastet e domosdoshme si infrastukturë (rrugore, hekurudhore, arjore, detare), hidrocentrale, varreza, si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm 1 (një) herë. Kalimi i

tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall), si dhe për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore e kariera, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndryshimi i kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategoritë e resurseve pyll, kullotë dhe livadh bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo organit të qeverisjes vendore i cili i ka në përdorim këto toka.

Ndryshimi për sipërfaqet deri në 5 ha bëhet me urdhër të ministrit përkatës, kurse për sipërfaqet mbi 5 ha me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë, miratimi i ndryshimit të kategorisë së resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh dhe kalimi i tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore bëhet nga komisioni që krijohet pranë bashkisë (me përfaqësues të drejtorive specifike në qark, kryetarin e bashkisë dhe juristin e bashkisë). Megjithatë, këto ndryshime si në rastet e pronësisë private, ashtu edhe në rastet e pronës publike të bashkisë, ndërmerret vetëm kur paraqiten projekte zhvillimi afatgjata të kulturave bujqësore që përputhen me programet mbështetëse të qeverisë. Ndryshimi i tokës së pafrytshme në kategorinë e resursit tokë bujqësore miratohet nga ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për sipërfaqet deri në 5 ha dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqet mbi 5 ha.

Në tokat bujqësore, në të gjitha kategoritë e bonitetit, miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor. Sipas ligjit nr.10 263, datë 08.04.2010, **"Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara"**, toka bujqësore konsiderohet si e pakultivuar në rastet kur autoritetet vendore kanë vërtetuar se toka nuk është kultivuar për të paktën 2 vjet rradhazi. Në këto raste, kur pronari i tokës nuk ushtron të drejtën për kultivimin e saj, bashkia ka të drejtë ta nxjerrë në ankand për ta ofruar me qera sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Akte të tjera nënligjore që i shërbejnë zhvillimit të përgjithshëm bujqësor dhe rural përfshijnë VKM-në nr. 52, datë 21.01.2015, **"Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2015"**, si dhe udhëzimin e Ministrisë të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 4, datë 25.02.2015, **"Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural"**, të cilat përcaktojnë mbështetjen financiare për vitin 2015 nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, i cili bazohet në rajonizimin e aktiviteteve sipas hartës bujqësore të miratuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Ligje të tjera që organizojnë veprimtarinë bujqësore përfshijnë ligjin nr. 9199, datë 26.02.2004, **"Për prodhimin, përpunimin, çertifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio""**, në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit, të kryera në përputhje me rregullat e përshkruara në këtë ligj për prodhimin e produkteve organike dhe ligji nr. 38, datë 05.04.2012, **"Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor"**, ku shprehet përcaktimi i rregullave, kritereve dhe kushteve për themelimin e administrimin e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, si dhe aspekte të tjera të veprimtarisë së tyre.

Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor: Strategjia (2014-2020) shkon në të njëjtin drejtim me perspektivën e vendit në anëtarësimin në BE dhe, si rrjedhojë,

mbështetet në parimet dhe objektivat e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP) dhe politikat e paraaderimit (IPARD), duke patur në fokus edhe kushtet dhe problemet specifike të bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri. Objektivi i përgjithshëm i strategjisë është trajtimi i sfidave me të cilat përballet sektori i bujqësisë dhe agro-përpunimit në vend, si edhe zhvillimi i zonave rurale në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale. Në lidhje me zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, objektivi lidhet me rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit duke mbështetur sektorët prioritarë, rritjen e sipërfaqeve bujqësore të shfrytëzuara për të rritur madhësinë mesatare të fermës e, si rrjedhim, edhe produktivitetin.

Bujqësia mbetet sektor shumë i rëndësishëm në ekonominë e gjithë qarkut të Beratit, ashtu si në gjithë ekonominë kombëtare, e matur me kontributin e saj në produktin e brendshëm bruto, punësimin dhe stabilitetin makroekonomik. Në qarkun e Beratit sektori i bujqësisë jep kontributin më të lartë në vlerën e shtuar bruto (VSHB) me 42,72 % të totalit[278]. Në përgjithësi, sektori i bujqësisë në Shqipëri ka treguar një kapacitet të lartë të përshtatjes dhe të rezistencës ndaj krizave të ndryshme si tranzicionit të tejzgjatur nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut apo krizës më të fundit ekonomike globale. Megjithatë, performanca ekonomike e sektorit bujqësor në vend është ende e pamjaftueshme për shkak të fermave të vogla dhe të fragmentuara, nivelit të ulët të teknologjisë dhe produktivitetit në total të faktorëve të prodhimit krahasuar me mesataret e BE-së. Edhe në bashkinë e Kuçovës ashtu si në të gjithë vendin sektori bujqësor është përqendruar fuqishëm rreth bujqësisë familjare.

Në rang kombëtar, më shumë se 90 përqind e 380,000 fermave janë nën 2 hektarë (ha) dhe llogariten rreth 95 për qind të tokës së përdorur, duke e bërë Shqipërinë të vetmin vend në Evropë që mbështetet kryesisht në një shkallë të vogël, jo-intensive të prodhimit të brendshëm[279] . Në bashkinë e Kuçovës veprojnë 5,318 ferma bujqësore, blegtorale e mikse nga totali prej 24,176 fermash në qarkun e Beratit. Ky numër, i cili përbën rreth 22% të totalit të fermave të qarkut Berat, është relativisht përfaqësues, duke marrë parasysh që në bashkinë Kuçovë ndodhen rreth 38% të tokës bujqësore dhe vetëm 5% e tokës kullosore dhe barishtore me bimësi jo të dendur në raport me qarkun[280]. Fermat familjare janë kontribuesi më i rëndësishëm për sigurinë e ushqimit, duke prodhuar ushqimin për vetë-konsum si dhe pjesërisht për treg. Kontributi i tyre në punësim është i rëndësishëm duke qenë se shumica e fermave individuale shërbejnë si burimi kryesor i të ardhurave për të vetëpunësuarit në këtë sektor.

Sipas regjistrimit më të fundit të popullsisë (Census 2011), numri i banorëve në zonat urbane në rang vendi tani e tejkalon numrin e banorëve në zonat rurale, një ndryshim i konsiderueshëm ky krahasuar me fillimin e viteve '90, kur rreth 2/3 e popullsisë jetonte në zonat rurale. Në ndryshim nga prirjet e përgjithshme kombëtare, numri i banorëve në zonat rurale të bashkisë Kuçovë e tejkalon numrin e banorëve në zonat urbane, përkatësisht me 60% popullsi rurale dhe 40% popullsi urbane[281]. Kjo dëshmon se bashkia e Kuçovës ka një karakter edhe më të rëndësishëm bujqësor se bashkitë e tjera ku bujqësia mbetet edhe sektori ekonomik që punëson pjesën më të madhe të popullsisë me rreth 54.9% të të punësuarve, krahasuar me 17 % në sektorët e industrisë dhe 28.1 % në sektorin e shërbimeve[282]. Të punësuarit në sektorin e bujqësisë në qytetin e Kuçovës nuk përbëjnë më shumë se 2.5% të numrit total të të punësuarve për gjithë bashkinë, kurse pjesa e popullsisë që ndodhet në njësitë e tjera administrative të bashkisë është punësuar kryesisht në bujqësi,

duke e bërë kështu bujqësinë sektorin primar të ekonomisë për Perondinë(71.5%), Lumasin (82.9%), Kozaren (82.9%).

Nëse këto të dhëna analizohen në raport me bashkitë e tjera fqinje dhe pjesë të qarkut, sektori bujqësor është më mbizotëruesi në strukturën lokale të punësimit. Në tërësi, bashkia Kuçovë ka sektor kryesor punësimi bujqësinë, por pirjet drejt tij nuk janë shumë të theksuara. Tendencat e punësimit dëshmojnë për ekonomi thellësisht agrare në njësitë Kozarë, Lumas dhe Perondi, si dhe ekonomi më të diversifikuar, urbane në qytetin e Kuçovës. Megjithatë, nëse merren parasysh trendet negative për rritjen e popullsisë në vitet e ardhshme, migrimin e brendshëm dhe braktisjen e zonave bujqësore (sidomos ato kodrinoro-malore), shoqëruar kjo me modernizmin e sektorit dhe rritjes së produktivitetit, mendohet se numri i personave të punësuar në sektorin e bujqësisë do të ulet edhe për bashkinë Kuçovë. Përmirësimi i përdorimit të tokës do të mundësojë punësim shtesë në të ardhmen dhe, sipas parashikimeve të qeverisë shqiptare, bujqësia do të mbetet një sektor kryesor punësimi edhe në vitin 2020[283].

Në përgjithësi, tokat bujqësore në të gjithë territorin shqiptar karakterizohen nga niveli i lartë i fragmentimit, gjë që ndodh edhe në Bashkinë e Kuçovës. Madhësia mesatare e fermës brenda bashkisë varion nga 1 ha në njësinë administrative të Perondisë në 1.2 ha në Lumas dhe 1.4 ha në Kozarë, krahasuar me madhësinë 1.2 ha në qarkun e Beratit dhe madhësinë 1.2 ha në rang kombëtar, ndërkohë që madhësia e parcelës është 0.27 ha në rang kombëtar, 0.26 ha në rang qarku[284]. Këto të dhëna dëshmojnë së fermat në bashki kanë pothuajse të njëjtën madhësi si mesatarja kombëtare ose më të vogla, duke treguar që sektori i bujqësisë dhe toka bujqësore vazhdojnë të ngelen mjaft të fragmentarizuara. Rritja e madhësisë së fermës konsiderohet si një faktor i rëndësishëm për të përmirësuar efiçencën ekonomike në sektorin bujqësor dhe për t'u bërë më konkurrues në treg. Aktualisht, nevojat për produkte blegtorale dhe bujqësore mbulohen nga importi, i cili mbetet shumë i lartë krahasuar me eksportet. Megjithatë, bashkia ka potenciale të mira për rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral për shkak të burimeve të papërdorura tokësore dhe dendësisë së vogël të bagëtive.

Plani kombëtar: Në lidhje me sektorin e bujqësisë, plani kombëtar përqendrohet në qëllime specifike strategjike, të cilat synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, vlerësimin e potencialeve, mbrojtjen e interesave publike dhe private si dhe nxitjen e planifikimit të harmonizuar të territorit. Një ndër objektivat më prioritarë të planit kombëtar është ruajtja maksimale e fondit të tokës bujqësore duke ndaluar çdo ndërtim që nuk i shërben sistemit bujqësor. Për më tepër, plani synon vendosjen e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim-grumbullim-përpunim-eksportim, si dhe investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanaleve ujitëse e vaditëse, hidrovore etj.

Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar të territorit, rajoni në të cilin bën pjesë Kuçova ka një karakter zhvillimi që bazohet në kombinimin mes ekonomive bujqësore (prodhuese dhe përpunuese), ekonomisë së turizmit, industrisë dhe funksioneve urbane. Sigurimi i balancës mes këtyre ekonomive përbën sfidë për vizionin e ardhshëm të zhvillimit urban e rural të territorit. Parashikimi i Planit të Përgjithshëm Kombëtar për zgjatimin e aksit Papër-Memaliaj si pjesë e boshtit kombëtar qendror ndikon pozitivisht në zhvillimin e sektorit bujqësor në Kuçovë, pasi përmirëson në mënyrë të menjëhershme lidhjen e bashkisë në rajon, duke lehtësuar dhe përshpejtuar në këtë mënyrë dërgimin e produkteve bujqësore më pranë tregjeve. Për më tepër, sipas objektivave strategjikë të planit, çdo

zhvillim i ri në njësitë administrative duhet të ruajë karakterin ekzistues rural. Një rëndësi e madhe këtu duhet t'u kushtohet strukturave dhe ngritjes së infrastrukturës strategjike të përshtatshme në funksion të zhvillimit bujqësor e blegtoral. Plani i trajton me prioritet rajonet me karakter bujqësor. Për zhvillimin e metejshëm të ekonomisë rurale ai thekson diversifikimin e aktiviteteteve të fermerëve dhe rritjen e efiçencës në sektorin e ushqimit dhe bujqësisë së bashku me peshkimin dhe pylltarinë.

Rajonizimi i kulturave dhe skemat mbështetëse për bujqësinë: Rajonet bujqësore zakonisht përcaktohen si zona me një homogjenitet të lartë në reliev dhe karakterizohen nga disa faktorë siç janë, lloji i tokës, kushtet klimatike, praktikat bujqësore, kulturat e prodhuara bujqësore, dhe shoqatat bujqësore. Duke qenë se territori i Shqipërisë është relativisht i vogël dhe kushtet gjeografike përgjatë territorit nuk janë tejskajshmërisht të ndryshme, vendi ynë nuk ka një ndarje specifike në rajone bujqësore. Megjithatë, për të sjellë variacione rajonale në bujqësi, është realizuar rajonizimi i kulturave bujqësore, ku rrethe të caktuara, në bazë të kushteve specifike, si: relievi, klima e përshtatshme, lloji i tokës, tradita kultivuese etj., janë specializuar sipas përparësisë drejt disa kulturave të veçanta.

Kështu, gruri për shembull, edhe pse mbillet në të gjitha zonat e Shqipërisë siguron rendiment të lartë vetëm në disa zona të vendit ku bashkia e Kuçovës nuk përfshihet, duke patur vetëm përparësi mesatare në kultivimin e kulturës. Zakonisht, përfitueshmëria nga kultivimi i grurit është e ulët, duke përfaqësuar kështu një aktivitet jo shumë të leverdisshëm, nëse krahasohet me kultura të tjera. Kjo situatë kushtëzohet nga një sërë faktorësh agronomikë, por nuk mund të neglizhohet as madhësia e vogël e fermës. Bimë të tjera që mendohen të rajonizohen në bashki janë perimet dhe duhani, një kulturë e kultivuar në të shkuarën kjo e fundit, me produktivitet të lartë dhe mundësi të mira për eksport. Rritja dhe kultivimi i perimeve mendohet të sjellë të ardhura të larta ekonomike në nivel lokal, por edhe shtimin e të ardhurave të fermerëve, duke qenë dhe një drejtim prioritar i prodhimit bimor, i shprehur në Strategjinë Ndërsektoriale të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural[285]. Në përgjithësi, të gjitha rajonet të cilat kanë kushte eko-klimatike të favorshme për kultivimin e perimeve e shohin si të nevojshme skemën mbështetëse të qeverisë mbi serrat me ngrohje dhe serrat me plastmasë, dhe i gjithë qarku i Beratit renditet ndër të parët në lidhje me rëndësinë e mbështetjes së të dyjave.

Tabela 53. Rajonizimi i kulturave bujqësore dhe blegtorisë në bashkinë e Kuçovës

Ish- bashkia e vjetër Kuçovë dhe komunat sipas ndarjes së vjetër administrative			
	Bimët e arave	**Pemët frutore**	**Blegtoria**
Përparësi kryesore	Perime në sera, duhan	Ullishtaria, pjeshkë, vreshtari	Bletët
Përparësi mesatare	Grurë, misër, perime e bostan, bimë medicinale, foragjere	Arrorë, kumbulla, qershi, agrume, Vreshtari	Lopë, të leshta, të dhirta, derra
Jo përparësi	Patate, fasule	Mollë	

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Nëntor 2014; Analiza e skemave mbështetëse; Politikat dhe strategjitë e ndërhyrjeve në bujqësi

Pemëtaria zë një vend të rëndësishëm në prodhimin bujqësor dhe bashkia e Kuçovës ka një traditë të pasur të kultivimit të drufrutorëve. Për shkak të kushteve të përshtatshme klimatike dhe tokësore bashkia merr përparësi kryesore në rajonizimin e pemëve frutore. Peshën specifike më të lartë në këtë drejtim duhet ta zerë kultivimi i pjeshkës, kajsisë etj. Analiza dhe vlerësimi i matricës së ullishtarisë tregon se Kuçova është ndër bashkitë ku ullinjtë duhet të jenë prioritarë dhe të zënë një vend të konsiderueshëm në zhvillimin bujqësor. Zhvillimi i ullishtarisë në zonë lidhet me nivelet e treguesve ekonomikë të prodhimit, por, mbi të gjitha, me përshtatshmërinë e kushteve tokësore dhe klimatike, ndaj dhe rajonizimi i tyre duhet të jetë i përhapur kudo në zonën kodrinoro-malore të bashkisë Kuçovë, duke qenë edhe pjesë e skemës së qeverisë për mbështetjen në kultivimin e ullirit. Duke pasur parasysh kushtet e përshtatshme tokësore e klimatike të bashkisë Kuçovë për këtë kulturë, nevojat për ullinj kokërr dhe vaj ulliri, efektivitetin ekonomik që paraqet ulliri, si dhe ndikimin pozitiv në biodiversitet, por edhe zhvillimin e industrisë agropërpunuese, rezulton se bashkia është e favorizuar në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj kulture.

Agrumet kanë përhapje më të kufizuar se ajo e ullirit dhe për shkak të kërkesave të veçanta klimatike mbillen më pak në Kuçovë, edhe pse skema mbështetëse e qeverisë e vitit 2014 për këtë kulturë është konsideruar e suksesshme[286]. Analiza dhe vlerësimi i produktivitetit të vreshtarisë tregon se, duke pasur parasysh përshtatshmërinë e kësaj bime me kushtet klimatike dhe tokësore, rajonizimi i saj duhet të jetë në gjithë bashkinë e Kuçovës, me prioritet zonat kodrinore-malore. Duke marrë në konsideratë kapacitetet për mbarështrimin blegtoral, bashkia e Kuçovës futet në grupin me prioritete mesatare në mbarështimin e gjedhit, të leshtave apo të imtave. Bashkia ka prioritet kryesor rritjen e bletëve.

Bujqësia organike: Në përgjithësi, kushtet e favorshme klimatike, gjeoformologjia e përshtatshme e tokës, si dhe njohuritë tradicionale të fermerëve vendas e vendosin bujqësinë organike në vendin tonë në avantazhe shumë të favorshme për t'u zgjeruar dhe rritur më tej si nëndegë e veçantë e sektorit të bujqësisë. Për shkak të zhvillimeve të vrullshme të turizmit kulinar dhe elitar kërkesa për produktet bio-organike është e lartë në tregjet mesdhetare apo europiane, ndaj Shqipëria duhet të përqendrohet në zhvillimin e këtij sektori si një avantazh konkurrues. Me "prodhime organike" do të kuptohen të gjitha veprimet e përfshira për prodhimin e produkteve "Bio", në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit dhe të kryera në përputhje me rregullat e përshkruara në ligjin nr. 9199, datë 26.2.2004, **"Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve bio"**.

Një nga parimet kryesore për prodhimet organike, ndër shumë specifikave të tjera, lidhet me sasinë totale të plehrave kimike, e cila nuk mund t'i kalojë 170 kg azot në vit/hektarë të përdorur në një tokë bujqësore. Sipas studimit të ndërmarrë nga Ministria e Bujqësisë[287], **produktet** relativisht më të lehta për t'u prodhuar **bio** janë: ulliri dhe vaji i ullirit; bimët mjekësore; **perimet** si qepa, domatja, speci, patllixhani, lakra, lulelakra, sallatrat, brokoli, spinaqi, erëzat e guzhinës, **patatja**; **frutat** si hurma, shega dhe fiku; **produktet blegtorale** të tilla si mishi i viçit në alpe, mishi i qingjave dhe kecave, djathi i dhisë dhe mjalti. Mbështetja e prodhimeve organike duhet të orientohet në zonat kodrinore dhe malore ku ndotjet janë më të pakta dhe mjedisi ruhet më mirë. Bashkia e Kuçovës vlerësohet të ketë një potencial të lartë për prodhimin e produkteve bio, kryesisht të perimeve, për shkak të terrenit të përshtatshëm dhe klimës relativisht të favorshme, por edhe për pemëtarinë, kultivimin e ullirit, sidomos në zonën kodrinore të saj. Gjithashtu, bujqësia biologjike duhet

të shtrihet gjerësisht tek bagëtitë e imta në zonën kodrinore dhe malore me kullotje në natyrë, të cilat sigurojnë qumësht dhe mish bio. Megjithatë, mbështetja financiare për fermat bio duhet të rritet dhe të kalohet nga mbështetja e fermave individuale në grup fermerësh dhe në *eco-village* (fshatra ekologjikë).

Zhvillimi i bujqësisë në vite: Të gjitha bashkitë e reja të riorganizuara në vitin 2015 (bashkia e Beratit, e Urës Vajgurore dhe e Kuçovës) deri në vitin 1990 ishin të përfshira në rrethin e Beratit me një sipërfaqe të përgjithshme prej 1381 km². Në këtë periudhë sektori i bujqësisë menaxhonte rreth 41 mijë ha tokë bujqësore, e organizuar në 26 kooperativa dhe ferma shtetërore bujqësore. Madhësia e kooperativave në zonën kodrinore malore ishte rreth 300-1000 ha dhe në zonën fushore shkonte deri në 3000 ha. Rreth 40 % e popullsisë banonte në qytetet e rrethit, përkatësisht në qytetin e Beratit, të Kuçovës, Urës Vajgurore dhe 60 % banonte në fshat, ku punësimi kryesor ishte në sektorin bujqësor. Në këtë kohë, përdorimi i tokës përfshinte 72 % bimët e arave, 10 % pemëtari, 3.7 % vreshta dhe 14.3 % ullishte. Kuçova zhvillohej si një qytet industrial shumëdimensional. Pas vitit 1990, me formimin e qarkut të Beratit, Kuçova u nda si rreth më vete dhe iu shtuan disa komuna të cilat kishin karakter bujqësor, në ndryshim nga qendra e qytetit. Pas reformës territoriale 2015, **Bashkia Kuçovë përfshin njësitë administrative Lumas, Perondi dhe Kozarë, të cilat** mbartin kapacitete bujqësore, vlera turistike dhe mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të lidhur më tokën dhe produktet bujqësore.

Bashkia Kuçovë ka pësuar një shtrirje hapësinore të konsiderueshme në periudhën pas viteve 1990, e cila është shfaqur në dy forma kryesore: zgjatim i vendbanimeve ekzistuese drejt tokave bujqësore dhe natyrore dhe humbje e tokave potenciale bujqësore në zonën peri-urbane.

Toka bujqësore: Sipas analizës së thelluar dhe klasifikimit të Censusit 2011, në bashkinë e Kuçovës, qyteti i Kuçovës klasifikohet si qendër rajonale, Perondia si qendër suburbane dhe Kozarja e Lumasi si njësi administrative bujqësore fushore, të cilat mbajnë peshën kryesore të zhvillimit të bujqësisë në zonën e bashkisë. Bashkia Kuçovë ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 161.25 km², me karakter dominues bujqësor, të ndërthurur me atë natyror. Tokat bujqësore, të shpërndara kryesisht në njësitë Kozare dhe Perondi dhe përgjatë luginave të njësisë Lumas, përbëjnë 52% të territorit, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 84 km². Sipërfaqja totale e tokave bujqësore në territorin e bashkisë Kuçovë është 8,448 ha, pjesa më e madhe e së cilës zihet nga bimësia natyrore me 3657 ha dhe nga toka arë e kultivuar me lloje të ndryshme kulturash bujqësore me rreth 2,611ha[288]. Njësitë administrative Kozare e Perondi dallohen për toka bujqësore të thella dhe kultivimin e drithërave dhe perimeve, ndërsa njësia Lumas ka një potencial të theksuar frutikulture dhe blegtoral.

Sipërfaqja totale e bashkisë Kuçovë është 160 km², nga e cila 84 km² ose 52 % e sipërfaqes së përgjithshme është tokë bujqësore (këtu përfshihen tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe 58 km² është tokë natyrore (pyje, kullota). Tokat bujqësore dallohen për larminë e tipologjive, karakteristikave, ndryshimeve në vlerat agroprodhuese, relievit dhe përshtatshmërisë ndaj bimëve të ndryshme. Treguesit ekzistues tregojnë se ka vend për përmirësime të rëndësishme në menaxhimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore dhe rajonizimin e prodhimit. Toka bujqësore në bashkinë e Kuçovës klasifikohet sipas tipologjive kryesore të mëposhtme në:

(i) Toka të hinjta kafe, të cilat përfaqësojnë grupin kryesor të tokave dhe zënë më shumë se 40-45 % të sipërfaqes së tokës bujqësore, të shpërndara në zonën kodrinore (të njësive administrative Kozarë, Perondi, Lumas), në lartësitë nga 70 m deri në 600 m mbi nivelin e detit. Këto toka gjenden në zona me pjerrësi 12-17 gradë dhe janë të përshtatshme për kultivimin e pemëtarisë, vreshtarisë, ullirit, por edhe për kultivimin e foragjereve dhe bimëve të arave. Përgjithësisht, këto toka kanë horizont të thellë të tokës, por kanë shkallë të lartë të erozionit. Për këtë arsye është e nevojshme zbatimi i praktikave bujqësore që e mbrojnë tokën nga erozioni;

(ii) Nëntipi i tokave të hinjta kafe livadhore, të cilat gjenden rrëzë kodrave dhe janë të përshtatshme për kultivimin e pemëtarisë;

(iii) Toka të nëntipit livadhor të hinjta kafe, të cilat shtrihen në mënyrë të kufizuar në zonën fushore të njësive administrative Perondi e Kozarë dhe janë të përshtatshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore.

(iv) Toka aluvionale, të cilat shtrihen në Perondi dhe Kozarë (sipërfaqe e kufizuar me fshatin Gegë), me kapacitet të lartë prodhues dhe të përshtatshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore.

(v) Toka kafe malore, të cilat shtrihen menjëherë mbas brezit të tokave të hinjta kafe mbi lartësinë 650m. Zënë rreth 35% të territorit të njësisë administrative të Lumasit. Zakonisht, kulturat më të përshtatshme për t'u kultivuar në këto lartësi janë ullishtet dhe drufrutorët.

Zona me reliev kodrinor-malor, me pjerrësi 6-25%, përbën rreth 25% të sipërfaqes së bashkisë Kuçovë dhe shfrytëzohet, përgjithësisht, për kultivimin e pemëtarisë, kurse pjesa tjetër është tokë fushore, e shtrirë në pjerrësinë 0-5 %, ku kultivohen bimët e arave dhe foragjereve. Ky lloj konfiguracioni i relievit mundëson që për bashkinë e Kuçovës të zhvillohen sistemet e diferencuara bujqësore, ku zona kodrinore zhvillon kulturat e ullirit, pemëtarisë, disa lloje perimesh (kryesisht me funksion eksportin) dhe blegtorinë. Zona fushore duhet të vazhdojë konsolidimin e kultivimit të perimeve për konsum të gjerë vendas dhe rritjen e gjedhit, gjelit etj.

Në të gjithë territorin e bashkisë mbizotërojnë tokat me horizont humusor mbi 25 cm dhe thellësi të tokës mbi 60-70 cm. Në njësitë administrative të bashkisë, vlerat agroprodhuese gjejnë një shpërndarje në klasat e bonitetit me dominim të kategorive II deri në V, por me sipërfaqe të konsiderueshme që arrijnë deri në klasën VIII të bonitetit. Ndërkohë, tokat karakterizohen nga horizonte të thella e të përshtatshme për bujqësinë, veçanërisht për ullirin, pemtarinë, vreshtarinë, zhvillimin e blegtorisë dhe produktet bio e për eksport. Të gjithë treguesit e mësipërm dëshmojnë se tokat bujqësore në bashkinë Kuçovë nuk shfrytëzohen plotësisht në përputhje me kapacitetin potencial që zotërojnë. Kushtet e një toke të përshtatshme bujqësore me tregues mesatar e të lartë produktiviteti lejojnë planifikimin e një zhvillimi më të shpejtë dhe të qëndrueshëm bujqësor të zonës në vitet e ardhshme.

Produktet bujqësore dhe blegtorale:

Tabela 54. Prodhimtaria bujqësore e blegtorale dhe sipërfaqja totale

	Sipërfaqja	Bashkia Kuçovë	Prodhimi në	Qarku Berat
	(ha)	Prodhimi	raport me qarkun	Prodhimi

		(ton)		(ton)
Drithëra	1,592	8,010	16.23%	49,354
Perime	275	14,235	15.75%	90,408
Perime Serre	85	5,980	32.52%	18,386
Bostanore	45	2,500	20.28%	12,327
Foragjere	2,587	97,130	25.38%	382,709
Vreshta	145	2,120	13.11%	16,174
	Rrënjë			
Ullinj	391,750	2,670	11.57%	23,082
Pemë Frutore	165,665	4,011	17.99%	22,295

Burimi: Bashkia Kuçovë; Përgatiti: Co-PLAN 2015

Tabela e mësipërme paraqet sipërfaqen e kultivuar sipas kulturave bujqësore dhe prodhimtarinë bujqësore të bashkisë Kuçovë në raport me atë të qarkut Berat. Sipas të dhënave, sipërfaqen dhe peshën më të madhe bujqësore e zë prodhimi i foragjereve (72% e prodhimtarisë totale bujqësore), ndjekur nga perimet dhe drithërat. Në raport me qarkun, kontributi më i lartë jepet në perimet e serrës, si dhe në foragjere e bostanore. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë sipërfaqen e vogël të territorit të bashkisë (10% të atij të qarkut), kontributi prej 10-20% është mjaft i lartë edhe për kultura si pemët frutore, ullinjtë e vreshtat.

Tabela 55. Prodhimi në ton i prodhimeve blegtorale në bashkinë Kuçovë

	Prodhim në ton	Raporti i prodhimeve me qarkun
Qumësht gjithsej	12,348	19%
Mish gjithsej	1,867	17%
Vezë në 000/kokrra	9,861	13.3%
Prodhim leshi te imëta	49.2	16.4%
Prodhim mjalti	25	12.5%

Burimi: Bashkia Kuçovë; Përgatiti:Co-PLAN, 2015

Kontributi i kulturave blegtorale në prodhimtari (në ton) për qarkun luhatet nga 12% në 20% (Tabela e mësipërme). Prodhimtari më të madhe ka qumështi, me 12,348 ton në vit ose 19% në nivel qarku. Rendimentin më të lartë (kg/krerë) e ka qumështi i lopës, me 2,908 kg/kr[289]. Prodhimi i mishit është gjithashtu konsiderueshëm i lartë (1,867 ton në vit ose 17% e prodhimit të qarkut), me shpërndarje pothuajse të njëjtë mes mishit të gjedhit, të shpendëve dhe të imëtave. Prodhimtaria e leshit nga të imëtat është gjithashtu e kënaqshme në rang qarku. Ndërkohë, prodhimet e vezëve janë të ulëta në krahasim me totalin e qarkut, përkatësisht 13.3% dhe 12.5%. Kjo vjen si pasojë e rendimentit të tyre prej 120 kokrrash për krerë, në krahasim me atë në nivel qarku që është 175 kokrra/kr. Pavarësisht kësaj, në tërësi, situata bujqësore e blegtorale e Kuçovës është mjaft e kënaqshme dhe konkurruese në nivel qarku për sa i përket foragjereve, perimeve të serrave e bostanoreve, si dhe rendimentit prodhues blegtoral të qumështit të lopës, të dhisë, mishit të gjedhit dhe mishit të të imëtave.

Në vitet e fundit vihet re që sipërfaqja e mbjellë me drithëra është zvogëluar në mënyrë graduale. Kështu, në vitin 2002 u mbollën rreth 1,600 ha, në krahasim me rreth 1,750 ha

në vitin 2000[290]. Ky zvogëlim ka ndodhur për shkak të rritjes së sipërfaqes së mbjellë me dru frutorë, ullishta e vreshta, kurse sipërfaqja e mbjellë me perime nuk ka patur ndryshime thelbësore. Megjithatë, vihet re një rritje e dukshme e prodhimeve në serra, të cilat kanë filluar edhe të eksportohen, një risi mjaft pozitive për zhvillimin e bujqësisë në bashkinë e Kuçovës. Baza e zhvillimit të blegtorisë vazhdon të mbetet gjedhi, edhe pse në vitet e fundit nuk është shënuar rritje e rëndësishme e numrit të krerëve të lopëve. Megjithatë, një zhvillim pozitiv në këtë drejtim është përmirësimi racor dhe tufëzimi me 10-30 krerë për prodhimin e mishit dhe qumështit. Tradicionale për rrethin e Kuçovës është edhe rritja e gjelit të detit, që ka arritur deri në rreth 30,000 krerë në vit[291].

Ndërkaq, në bashki gjenden edhe 37 subjekte agropërpunuese, të shpërndara kryesisht në Kuçovë (14) dhe në Perondi (11)[292]. Mbizotërojnë furrat e bukës (14 njësi, me një prodhimtari 194 ton në vit) dhe baxhot (9 njësi, me prodhimtari 65,5 ton në vit), si dhe 4 fabrika vaji, 3 subjekte konservimi perimesh, 2 sallameri, 2 fabrika prodhimi mielli, 1 fabrikë prodhimi qumështi, 1 fabrikë prodhimi pijesh alkoolike etj. Bashkia Kuçovë nuk ka një pikë grumbullimi bujqësor dhe produktet kryesisht dërgohen në qendrën e Kutallisë në Urën Vajgurore.

Risi në bujqësi: Në përgjithësi, niveli i investimeve në bujqësi dhe në sektorin agro-ushqimor në rang kombëtar apo lokal është ende i ulët. E njëjta gjë vihet re dhe për bashkinë Kuçovë, në të cilën, pavarësisht skemave mbështetëse direkte/indirekte të qeverisë dhe donatorëve të huaj, risitë në sektorin bujqësor mbeten në nivele të pamjaftueshme.

Risi në këtë fushë për të ardhmen mund të konsiderohet edhe mbështetja për të filluar aktivitete të reja (*start-up*) të prodhimeve plotësuese ose alternative të diversifikimit të ekonomisë rurale që nuk janë domosdoshmërisht pjesë e traditave disa vjeçare kultivuese, si p.sh.: prodhimi i bimëve mjekësore, i erëzave, i bimëve dekorative, i kërpudhave, i kërminjve, i produkteve bujqësore specifike për biokarburant në të ardhmen etj. ose aktivitete që nuk lidhen detyrimisht me produktin bujqësor apo blegtoral, por tregtimi i tyre mund të zhvillohet në portën e fermës, agro-turizëm dhe aktivitete shoqëruese (kalërimi, turizmi, peshkimi, gjuetia).

- **Sfida dhe konkluzione**

Me gjithë dinamikat dhe performancën ekonomike të sektorit bujqësor dhe nivelin e përgjithshëm të zhvillimit rural, Bashkia e Kuçovës është ende larg shfrytëzimit të plotë të kapaciteteve potenciale bujqësore dhe rurale që zotëron për shkak të një grupi të caktuar problemesh që lidhen veçanërisht me numrin e madh të fermave të vogla dhe të fragmentuara, me ekzistencën e sistemeve të parehabilituara të kullimit dhe ujitjes, me nivelin e ulët të përdorimit të teknologjive në zonën kodrinore malore, me funksionimin e pjesshëm të zinxhirit prodhim-grumbullim-përpunim, si dhe me nivelin e ulët të produktivitetit të prodhimit krahasuar me mesataret e rendimenteve të vendeve të BE-së.

Një nga sfidat e rëndësishme që has Bashkia e Kuçovës për zhvillimin rural dhe bujqësor lidhet me numrin e popullsisë, që sa vjen e po ulet në zonat rurale. Edhe pse momentalisht rreth 60 % e popullsisë totale është përqendruar në zonat rurale të bashkisë (me karakter të theksuar bujqësor), projeksionet e ardhshme të popullsisë parashikojnë se tendencat e largimit të popullsisë nga këto zona do të shpeshtohen. Nga analiza demografike vlerësohet se popullsia e bashkisë së Kuçovës, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie të konsiderueshme, e cila, si mesatare vjetore për periudhën 2015-2031, llogaritet të jetë rreth

-1%, ndërkohë që rënia e popullsisë, e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet se do të jetë rreth 20%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031 është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënieje. Shkaku kryesor i kësaj zhvendosjeje mendohet të vijë si pasojë e migrimit të brendshëm dhe, ndër të tjera, nga largimi i vazhdueshëm i të rinjve nga sektori bujqësor[293]. Kjo prirje demografike me migrim të të rinjve ndikon negativisht në disponueshmërinë e forcës së punës në zonat rurale dhe përbën një sfidë të rëndësishme për të ardhmen e zhvillimit bujqësor dhe rural në bashkinë e Kuçovës. Megjithatë, përmirësimi i përdorimit të tokës do të mundësonte punësim shtesë në këtë sektor në vitet e ardhshme. Në përgjithësi, për sa i përket zhvillimit të bujqësisë në bashkinë Kuçovë, vihet re se prodhimi bujqësor e blegtoral përgjithësisht është rritur, me një tendencë të qartë rritjeje veçanërisht për vreshtarinë, ullishtet, frutikulturën, perimet dhe blegtorinë. Megjithatë, bashkia e Kuçovës vlerësohet të ketë madhësinë më të vogël të fermës në qark, gjë që ndikon në mënyrë të ndjeshme në potencialin e saj prodhues. Kështu, për shembull, njësia administrative e Perondisë ka më pak tokë bujqësore për familje se të gjitha njësitë administrative të qarkut[294]. Gjithashtu, krahas sipërfaqes së vogël të tokës bujqësore për familje, një ndikim të madh në nivelin e të ardhurave që gjenerohen nga sektori bujqësor ka edhe cilësia e ulët e tokës bujqësore. Sipërfaqja e ujitshme është shumë e vogël dhe investimet për ndërtimin apo rehabilitimin e veprave ujitëse janë të pakta.

Aktiviteti bujqësor është shumë i rëndësishëm për ekonominë e Kuçovës, por, nga pikëpamja mjedisore, ai has dy sfida të mëdha: së pari, ndotjen e tokës bujqësore nga industria e naftës dhe, së dyti rrezikun potencial të erozionit të tokave kodrinore. Në bashkinë e Kuçovës është identifikuar prania e puseve të naftës në tokë bujqësore shumë në afërsi të sipërfaqeve ujore, duke shkaktuar kështu një konflikt shumë shqetësues për prodhimtarinë bujqësore. Ndotja e tokës nga industria e naftës (si p.sh. në Kuçovë dhe Kozarë) është një shqetësim i vazhdueshëm në bashki. Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike që ka sjellë për vendin, ka ndikuar në ndotjen e tokës, ajrit e ujit[295]. Në Kuçovë, dhe sidomos në Kozarë, ndotja e tokës nga puset e naftës është e dukshme në të gjithë sipërfaqen naftë-nxjerrëse. Rreth 1/3 e sipërfaqes së vendburimeve të naftës rezulton të jetë e ndotur nga nafta bruto[296]. Pas degradimit të industrisë së përpunimit të naftës në të gjithë zonën naftëmbajtëse ka ndotje të tokës, ujit dhe ajrit, për pasojë ndotja ka ndikimin e vet në shëndetin e banorëve, në bujqësi, blegtori (kafshë dhe shpendë) deri tek drurët apo bimët natyrale. Në shumë zona duhen marrë masa konkrete për përmirësimin e tokave të kontaminuara nga nafta dhe duhet kryer monitorimi i vazhdueshëm i ujërave që përdoren për ujitje/vaditje. Problematika të tjera që po hasen në zhvillimin e bujqësisë në të gjithë vendin tonë dhe në Kuçovë lidhen kryesisht me degradimin e tokave për shkak të erozionit. Ky i fundit ka prekur pothuajse një pjesë të mirë të lumenjve të basenit të Semanit përfshi edhe Devollin. Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurive të thelluara për tokën dhe praktikave të keqmenaxhimit, një nga dukuritë që po vihet re është ai i degradimit të tokës. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[297]. Në këtë aspekt, është e nevojshme të përmirësohen praktikat bujqësore në zonën kodrinore gjatë punimeve të tokave të pjerrëta për kufizimin e erozionit.

Një sfidë tjetër për Bashkinë e Kuçovës mbetet përmbytja dhe ndotja e tokës përgjatë lumit nga mbetjet. Në vitet e fundit, rreziku i përmbytjes së tokave nga Devolli është shtuar. Ngushtimi i shtratit të lumit Devoll nga hedhja në shtratin e lumit të mbetjeve të ngurta

rrezikon përmbytjen e tokave përreth lumit në rast prurjesh të mëdha[298]. Në bashkinë e Kuçovës grumbullohen gjithsej rreth 10 ton mbetje të ngurta me burim sektorin e ndërtimit të cilat hidhen në bregun e lumit Devoll[299].

Përveç mbrojtjes së burimeve ujore, bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së degradimit të tokës nga praktikat bujqësore të paqëndrueshme. Në dhjetëvjeçarin e fundit, bujqësia ka filluar të shndërrohet nga familjare në intensive në mënyrë të kufizuar. Kjo lloj bujqësie, e cila praktikohet kryesisht në zonat fushore, ka sjellë përfitime ekonomike për banorët vendas, por krijon edhe degradim të tokës bujqësore, e cila i shtohet degradimit të tokave nga industria dhe sektorë të tjerë të ekonomisë. Për këtë arsye, lipset që bashkia të krijojë kushte që shmangin problemet që vijnë me bujqësinë intensive dhe me kultivimin e zonave kodrinore-malore, duke futur shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur fermerëve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore, pa cënuar qëndrueshmërinë e saj. Me qëllim që të shmanget degradimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe jo buqësore, nevojitet që bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktohet në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së .

- **Rekomandime**

Në kushtet e ndarjes së re territoriale dhe formimit të një bashkie me karakter malor e kodrinor nevojitet që objektivat e zhvillimit ekonomik e social të kushtëzohen nga përputhja me karakteristikat e territorit dhe lidhjeve organike të njësive brenda saj. Zhvillimi i sektorit ekonomik të bujqësisë duhet të shoqërohet me ngritjen e kapaciteteve menaxhuese teknike dhe krijimin e një baze të dhënash (*database*) të burimeve natyrore. Duke qenë se territori i bashkisë Kuçovë është një territor i përzier mes atij fushor, kodrinor dhe malor është shumë e rëndësishme që zhvillimi i bujqësisë të ecë në **dy binarë paralelë**: **bujqësi shkalle**/intensive, kryesisht në zonën fushore, dhe **bujqësi familjare**. Kjo e fundit është bujqësia e praktikuar në vendin tonë, e diktuar nga një traditë disa vjeçare e fermave të vogla, në mungesë të aktivizimit të tregut të tokës për rritjen e madhësisë së fermave dhe në kushtet e një infrastrukture të dobët bujqësore. Në ditët e sotme është përqendruar në shkallë të gjerë në zonat malore-kodrinore. Përveç sigurimit të mbijetesës së popullatave të zonave me reliev të thyer, kjo bujqësi ka treguar se i reziston faktorëve klimatikë dhe ekonomikë dhe luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit (në veçanti të tokave, pyjeve e burimeve ujore) në zonat ku praktikohet.

Në zonën fushore duhet të propozohet intensifikimi i bujqësisë; duhen bërë përpjekje për zmadhimin e fermave së paku deri në 2 herë të madhësisë ekzistuese; duhet konsoliduar toka bujqësore dhe përmirësuar sistemi i prodhimit, në mënyrë që të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm i sektorit dhe, në të njëjtën kohë, të rriten të ardhurat dhe mirëqenia për fermerët e zonës, ndërkohë që sigurohet edhe mbrojtja e tokës. Në bazë të kushteve konkrete në territorin e bashkisë, duhet të bëhet efektiv zbatimi i sistemeve bujqësore, të diferencuara për zonën fushore dhe për zonën kodrinore, dhe specifike për tokat me pjellori të kufizuar.

Në zonën kodrinore prioritet duhet të mbetet zhvillimi i pemëtarisë (i qershisë dhe kumbullës, ullirit dhe vreshtarisë, arroreve) dhe zhvillimi i blegtorisë së imët, kurse në

zonën fushore bimët e arave, shtimi i gjedhit dhe i deleve në blegtori, serrat e perimeve etj. Në zonat kodrinore është e leverdisshme të ngrihen edhe fermat e vogla familjare të specializuara me pemëtore dhe vreshta, edhe pse nuk i kalojnë më shumë se 2-4 dynym. Çdo lloj ndërhyrjeje duhet të ketë parasysh ndërtimin e strukturave të prodhimit sipas kushteve të njësive. Për më tepër, duhen marrë masa për bashkimin e pronave të copëtuara, për përshtatjen e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike, për mirë-menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e praktikave të kultivimit, pasi tokat kodrinore janë të rrezikuara nga erozioni masiv, si dhe për konsolidimin e zinxhirit prodhim-grumbullim-përpunim.

Për të gjithë qarkun e Beratit, por edhe për bashkinë e Kuçovës në veçanti, duhet të nxitet krijimi i shoqatave të prodhimit dhe shërbimit në zonën rurale për të forcuar bashkëpunimin e prodhuesve dhe për të rritur interesin e fermerëve nëpërmjet përmirësimeve të teknologjisë së prodhimit dhe rritjes së shkallës së mekanizmit bujqësor, të përshtatur me terrenin dhe madhësinë e fermës. Në bashkinë e Kuçovës është e rëndësishme të përmirësohet infrastruktura bujqësore, si për shembull konsolidimi i tregjeve të shumicës në afërsi të njësive administrative apo qytetit për grumbullimin e prodhimeve të fermerëve privatë. Për të nxitur tregtimin dhe për të rritur vlerën e këtyre produkteve të specializuara në treg, sugjerohet që të ofrohet mbështetje për marketingun e prodhimeve të njohura lokale tradicionale, si: ulliri, gjeli i detit etj.

Të gjitha sugjerimet e mësipërme kanë nevojë të mbështeten me instrumentet e duhura ligjore dhe financiare, në bashkërendim mes nivelit vendor dhe atij qendror të qeverisjes. Zakonisht, interesi për ngritjen e punishteve të agropërpunimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale është i madh e i dukshëm, por mundësitë financiare për ngritjen e linjave me teknologji bashkëkohore janë mjaft të kufizuara. Kjo nuk është vetëm një pengesë në rritjen e të ardhurave apo mundësive për eksport, por edhe si një frenim për rritjen e mëtejshme të prodhimit bujqësor e blegtoral, veçanërisht në zonat me dalje të kufizuar në treg. Si rrjedhim, kreditimi për ngritjen e linjave të përpunimit të prodhimeve dhe nxitja e bizneseve në këtë fushë konsiderohen si prioritete për shtimin e kapaciteteve përpunuese.

Kuçova do të vazhdojë të jetë një bashki me prioritete dhe identitet industrial dhe bujqësor në funksion të punësimit, rritjes së të ardhurave, shërbimeve dhe konsolidimit të zhvillimit të qëndrueshëm rural e bujqësor. Bashkia e re duhet ta mbështesë zhvillimin ekonomik mbi kushtet fizike a natyrore të tokës, burimeve, klimës, zhvillimit rural dhe bujqësor. Sektorët kryesorë bujqësorë që duhen trajtuar me prioritet janë turizmi rural e bujqësor dhe zhvillimi intensiv i pemëtarisë dhe agroturizmit.

1.6.2 Pronat publike

"E mirë publike" është pronë e paluajtshme publike e shtetit, sipas legjislacionit përkatës, si dhe të mira të tjera të natyrës publike, si: ajri, ujërat, burimet natyrore, mjedisi në përgjithësi, trashëgimia kulturore, frekuenca dhe të tjera të kësaj natyre, sipas legjislacionit në fuqi.[300]

Evidentimi i pronave publike në bashkinë Kuçovë është bërë nga analizimi i disa të dhënave nga Agjencia Kombëtare e Inventarit të Pronave Publike (AKIPP) dhe nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, Kuçovë. Nga këto dy burime u bë i mundur evidentimi i pronave publike sipas këtyre kategorive kryesore:

- Emri i pronës,

- Sipërfaqja totale e pronës,
- Funksioni i pronës,
- Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative,
- Institucioni / Enti përdorues (Statusi juridik i përdorimit) etj.

Për të kuptuar se sa i plotë është inventari dhe se si është gjendja aktuale, të dhënat janë krahasuar me të dhënat nga Përdorimi i Tokës. Megjithatë, informacioni i marrë nga inventari mbetet baza për analizimin e pronave publike. Për bashkinë Kuçovë, nga Inventari i Pronave Publike[301], kemi të evidentuara këto kategori kryesore pronash:


Tabela 56. Kategoritë e pronave sipas AKIPP-it

Funksioni i pronës	Sipërfaqja (m^2)	Raporti në përqindje
Energji elektrike	792.56	0.022%
Ujitje, Burime ujore	1,097,243.85	30.4%
Mbrojtje civile	4,320	0.12%
Prodhim nafte	134.32	0.003%
Pa funksion	5,997.6	0.16%
Shërbim funeral	84,709.77	2.35%
Administratë	4,642.1	0.13%
Arsim	3,203.2	0.088%
Banim	5,667.65	0.16%
Hapësira publike	3,200	0.088%
Infrastruktura rrugore	2,360,985.6	65.45%
Kulturë	508.57	0.014%
Shërbim parësor	372	0.01%
Shërbim publik	767.69	0.021%
Zhvillim ekonomik	21,149.4	0.59%
Truall	4,534	0.13%
Pa informacion	9341.1	0.26%
Totali i pronave publike	3,607,569.41	100%

Burimi: Agjencia Kombëtare e Inventarit të Pronave Publike; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016


Ky evidentim na tregon se pas infrastrukturës rrugore, e cila përbën pjesën më të madhe të pronave publike, kemi infrastrukturën ujore (kanale, burime, rezervuare), të cilat përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të pronave publike në Bashkinë Kuçovë. Kjo është si pasojë e pasurive të shumta që kemi në territor. Në bashki kemi kalimin e lumit Devoll dhe lumin Osum, të cilët bashkohen për të krijuar lumin Seman. Duke parë se këto prona shtrihen në përgjithësi rreth zonës fushore të territorit, mund të themi se ato përbëjnë një aset të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë në zonë.

Figura 108. Uji sipas të dhënave nga AKIPP-i



Burimi: AKIPP; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Figura 109. Uji sipas të dhënave nga përdorimi i Tokës



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Për shërbimet publike, sipas AKIPP-it, kemi 5 prona publike që kanë funksion arsimi parashkollor si kopshte dhe çerdhe, ndërsa për pronat me funksion shëndetësor parësor kemi një qendër shëndetësore.

Ndërkohë, sipas të dhënave nga Përdorimi i Tokës, kemi 47 prona me funksion "arsim", ndër të cilat 1 pronë e arsimit të lartë (qendër kërkimore), 6 prona të arsimit të mesëm (nga të cilat 1 është shkollë e mesme profesionale), 23 prona të arsimit të ulët dhe 16 prona të arsimit parashkollor. Gjithashtu, kemi edhe një bibliotekë që përfshihet në pronat publike me funksion "arsim". Për më tepër, kemi 21 prona me funksion "shërbim parësor shëndetësor", që janë:

Tabela 57. Pronat publike për shërbimin parësor shëndetësor sipas të dhënave nga Përdorimi i Tokës


Aktiviteti i pronës	Nr. i njësive	Sipërfaqe në m^2
Spital	2	6,365 m^2
Farmaci	3	794.09 m^2
Qendra shëndetësore	6	2,827.8 m^2
Ambulanca- konsultore	7	2,233.8 m^2
Shërbim dentar	3	1,071.31 m^2
Total	21	13,292 m^2

Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Bashkia Kuçovë mban përgjegjësi[302] për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave që kanë funksion "arsimi parauniversitar", duke përjashtuar këtu shkollat profesionale, nëse ka. Për sa i përket arsimit parashkollor, bashkia mban përgjegjësi për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor në kopshte e çerdhe. Ndërkohë, për pronësitë ku kemi aktivitet shëndetësor, përgjegjësitë e bashkisë të përcaktuara në ligj janë: ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave.

Siç mund të shohim nga evidentimi i të dhënave të mësipërme, nxjerrim përfundimin se AKIPP-i ka disa mangësi kur krahasohet me vlerat e gjetura nga përdorimi i tokës.

Figura 110. Vendndodhja e pronave publike: Krahasim i të dhënave nga AKIPP-i me ato nga përdorimi i Tokës




Burimi: Inventari i Pronave Publike Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Nga analiza e pronave kuptojmë se në bashkinë e Kuçovës kemi shpërndarje të pronave publike të kategorive të ndryshme përgjatë gjithë territorit. Megjithatë, njësia

administrative e Lumasit mbetet njësia me më pak prona publike, gjë që mund të rezultojë jo e lehtë për bashkinë që të përdorë prona për të integruar aktivitete të nevojshme në zonë.

Për më tepër, duke qenë se rreth 95% e pronave publike, sipas AKIPP-it, përbëhen nga infrastruktura rrugore dhe ajo ujore, vërejmë që përqindja e pronave të tjera është e ulët. Kjo nuk është shumë e favorshme për bashkinë, pasi asetet në formë ndërtese, të cilat mund të përdoren për të aktivizuar funksione të veçanta në një zonë, janë shumë të vogla në numër. Gjithashtu, këto asete janë në përgjithësi të përqendruara në qytetin e Kuçovës, si dhe në njësinë administrative Perondi. Për t'u përmendur vlejnë edhe pronat me vlera historike kulturore që janë në pronësi të bashkisë, të cilat veprojnë si asete pozitive për të rritur interesin e turizmit kulturor.

Figura 111. Vendodhja e të gjithë pronave publike në bashkinë Kuçovë



Burimi: AKIPP, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullorave- Lushnje; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Problem në bashki paraqesin edhe situatat kur kemi ndërtime mbi pronën publike, duke paraqitur zona konfliktuale. Kjo është me rëndësi për t'u analizuar pasi pas viteve 1990 kemi pasur një ndërtim të lartë të godinave informale, të cilat janë realizuar edhe mbi prona publike. Për të evidentuar zona të tilla është bërë krahasimi i të dhënave të AKIPP-it me ortofoton. Nga ky krahasim del se në përgjithësi kemi troje të ish- magazinave apo dyqaneve, por kemi edhe raste kur kemi ndërtime në oborret e shkollave dhe qendrave shëndetësore. Këto situata paraqesin probleme për përdorimin dhe menaxhimin e të gjithë pronës publike sipas kompetencave të parashikuara në ligj. Më poshtë do të paraqesim konfliktet në 2 nga këto zona.

Figura 112. Zona konflikti_Shesh në NjA Kozarë




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Figura 113. Zona konflikti_Truall në NjA Perondi




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Figura 114. Harta e zonave të konfliktit në të gjithë territorin



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Figura 115. Pronat në qytetin Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Siç mund të vëheret nga harta e mësipërme, shpërndarja e pronave publike në qytetin e Kuçovës shtrihet përgjatë gjithë territorit të qytetit. Pronat në pronësi të bashkisë janë të shpërndara në pjesën Veri-Perendimore të qytetit, ndërsa pronat publike në pronësi të institucioneve të tjera janë të shpërndara në zonën Jugore dhe Perëndimore të qytetit. Bashkia Kuçovë ndërkohë ka në përdorim edhe prona të tjera, të cilat janë në përgjithësi të karakterit të hapësirave publike më të vogla, të shpërndara përgjatë gjithë territorit.

Pronat që janë me rëndësi mund të përmendim:

1. Ish Uzina e Përpunimit të Naftës (UPN)- në pronësi të bashkisë. Paraqet interes për zhvillim duke e shndërruar zonën në një nga hapësirat e gjelbra më të mëdha në bashki. Zona do t'i nënshtrohet rehabilitimit mjedisor dhe rikonceptohet si hapësirë rekreative për qytetin dhe banorët.
2. Tregu i qytetit- në përdorim të bashkisë. Zona do të ristrukturohet për të ofruar kushte më të mira për përdoruesit e hapësirës dhe blerësit.
3. Ish zona industriale në pronësi të bashkisë në fund të bulevardit të qytetit. Kjo hapësirë do të shërbejë si vazhdimi i bulevardit të qytetit, duke shtuar hapësirat kualitative publike në qytet.
4. Stadium i qytetit- në pronësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Hapësira e stadiumit paraqet interes për zhvillim, që do realizohet ndërmjet bashkëpunimit të Bashkisë me Ministrinë përkatëse për të rizhvilluar zonën me anën e një projekti për stadiumin e rid he rigjenerimin e hapësirave përreth.
5. Ish TEC- në pronësi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Ky është një nga polet e zhvillimit të Kuçovës. Në bashkëpunim me bsahkinë, kjo zonë do të rigjenerohet dhe rikonceptohet si hapësirë rekreative për banorët e qytetit.
6. Aneksi- në pronësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Kjo hapësirë ekzistuese sportive do të rigjenerohet për të përmirësuar kushtet e zonës dhe të shërbejë si hapësirë rekreative-sportive.

Figura 116. Pronat me interes në qytetin Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

1.6.3 Zonat informale

Në përcaktimin e Qeverisë, zonë informale do të konsiderohet territori me sipërfaqe mbi 2 hektarë, i zënë nga ndërtime informale, procesi i legalizimit të të cilave nuk u nënshtrohet kushteve të instrumenteve të planifkimit të territorit. Sipas ALUIt kriteret që merren parasysh për propozimin e këtyre zonave janë:

- Evidentimi i ndërtimeve informale në territorin përkatës,
- Vija kufizuese administrative e njësive administrative,
- Morfologjia dhe kushtet e terrenit,
- Gjendja e pronësisë,
- Cilësitë juridike të territorit.


Sipas ligjit të ri të legalizimit ndaj ndërtimeve që gjenden brenda zonave informale aplikohen procedura më të lehta[303].

Sipas të dhënave zyrtare të ALUIZNI-t, 29.5% e ndërtimeve në territorin shqiptar janë pa leje. Numri total i ndërtimeve në Shqipëri është 1,008,243 dhe 297,440 prej tyre rezultojnë objekte informale[304], në bazën e të dhënave të Agjencisë së Legalizimeve.

Për Bashkinë Kuçovë kemi katër zona informale, nga të cilat dy janë të miratuara. Zonat e miratura janë[305]:


- Vendbanimi informal Nr. 1, nën Spital, i miratuar si zonë informale nga Këshilli i Qarkut Berat me vendimin Nr. 8 i datës 12.06.2007. Kjo zonë ka sipërfaqe prej 13.7 ha, dhe ka 54 ndërtime informale. Për këto vendbanime është bërë edhe vetëdeklarimi.
- Vendbanimi informal Nr. 2, mbi Zjarrfikëset, i miratuar nga Këshilli i Qarkut Berat me vendimin Nr. 8 i datës 12.06.2007. Zona ka sipërfaqe 6.8 ha dhe ka 65 ndërtime informale. Gjithashtu edhe për këto vendbanime është bëre edhe vetëdeklarimi.

Figura 117. Vendbanimi informal nën Spital




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Figura 118. Vendbanimi informal mbi Zjarrfikëse



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016


Figura 119. Vendbanimet informale



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016


Përveçse këtyre dy zonave informale të miratuara, Bashkia Kuçovë ka edhe dy zona të tjera për të propozuar për zona informale. Zona e propozuar numër 5 është në jug të qytetit të Kuçovës, pranë stadiumit, ndërkohë që zona e propozuar numër 6 ndodhet në veri, pranë varrezave të qytetit.

Figura 120. Vendbanimet informale të propozuara



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016


Figura 121. Vendbanimet informale të propozuara numër 5



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Sipërfaqja e kësaj zonë është 58.2 ha, por sipërfaqja e zënë me ndërtime informale është rreth 1.87 ha. Në këtë zonë janë deklaruar 170 ndërtime, ndërsa numri total i lejeve të emetuara dhe në proçes është rreth 25. Zona dominohet nga objekte banimi që përbëjnë rreth 73,5%, ndërkohë që objektet me funksion social-ekonomik janë 26,5 % e objekteve të zonës. Raporti i sipërfaqeve të ndërtuara me raportin e sipërfaqen e zonës është 3,2 %. Pavarësisht se ka mjaft ndërtime, këto nuk janë shumë të larta me lartësinë maksimale që shkon në 13m.

Figura 122. Vendbanimet informale të propozuara numër 6



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Sipërfaqja e zonës numër 6 është 75 ha, por sipërfaqja e zënë me ndërtime informale është rreth 1.7 ha. Në këtë zonë janë deklaruar 155 ndërtime, ndërsa numri total i lejeve të emetuara dhe në proçes është rreth 15. Zona dominohet nga objekte banimi që përbëjnë rreth 77,4%, ndërkohë që objektet me funksion social-ekonomik janë 22,6 % e objekteve të zonës. Raporti i sipërfaqeve të ndërtuara me raportin e sipërfaqen e zonës është 2,3 %. Lartësia maksimale e objekteve në zonë shkon deri në 10 m.

1.6.4 Konkluzione

- **Zhvillimi ekonomik**

Treguesit makroekonomikë në nivel qarku vlerësojnë se Qarku Berat është ndër 5 qarqet që kontribuojnë më pak në PBB-në e vendit dhe ka tendenca uljeje të vlerave të PBB-së ndër vite.

VSHB-ja më e madhe në nivel qarku i takon bujqësisë, e ndjekur nga industria. Gjithsesi, produktiviteti më i lartë është i sektorit të shërbimeve, gjë që tregon se ky është sektor në të cilin vlen për të investuar.

Kuçova ka ecuri pozitive të njësive ekonomike me mbizotërim biznesesh të vogla dhe numër të madh biznesesh për 1000 banorë në krahasim me qarkun (veçanërisht Kuçova e Perondia). Aktivitetet ekonomike përgjithësisht janë të diversifikuara, sidomos në Kuçovë ku shërbimet dhe tregtia janë mbizotëruese, ndjekur nga aktivitetet industriale.

Sektori bujqësor përfaqësohet nga një numër prej 5,318 fermash bujqësore, blegtorale e mikse, si dhe 37 subjekte agro-përpunuese. Numri i fermave është mjaft përfaqësues në Qarkun Berat, dhe veçanërisht prodhimi i perimeve të serës, foragjereve, bostanoreve, dhe rendimenti i lartë prodhues i qumështit të lopës, të dhisë, mishit të gjedhit dhe të të imëtave. Gjithsesi në Kuçovë nuk ka pikë grumbullimi bujqësore, por më e afërta ndodhet në Kutalli të Lushnjes.

Sektori industrial përfaqësohet nga disa subjekte agro-përpunuese të industrisë së lehtë, si dhe nga industria e nxjerrjes së naftës dhe e përpunimit të saj. Numri i puseve në bashkinë e Kuçovës është më i larti në të gjithë zonat naftëmbajtëse në Shqipëri, ndërkohë që rendimenti prodhues i tij është më i ulëti, rreth 0.2% e burimeve të naftës bruto. Gjithashtu, punësimi në këtë sektor zë vetëm 17% të të punësuarve në nivel bashkie.

Ekonomia e bashkisë Kuçovë është e orientuar drejt ekonomisë agrare, por sektori bujqësor nuk është aq mbizotërues sa në bashkitë e tjera fqinje. Potencialisht, sektori i shërbimeve vlen për t'u zhvilluar, duke qenë se aktualisht zë 30% të të punësuarve.

Në nivel qarku, bashkia Kuçovë humb një pjesë të madhe të fuqisë punëtore, sidomos në njësinë Lumas, ku më shumë se 50% e të punësuarve punojnë jashtë saj. Zhvendosjet për arsye punësimi bëhen kryesisht drejt njësive administrative të bashkisë Berat, drejt bashkive fqinje, por edhe drejt qyteteve të mëdha të afërta si Fieri e Lushnja. Kuçova përthith pjesën më të madhe të të punësuarve që lëvizin për arsye pune nga Perondia e Kozara, ndërsa njësia Lumas nuk ka një marrëdhënie të theksuar me të, por kryesisht me njësi mjaft periferike si Moglica, Poshnja etj. Flukset ardhëse të punësimit janë shumë të pakta, gjë që dëshmon se Kuçova nuk është ende një ekonomi aglomeruese e mirëfilltë, por mund të ketë tendenca të bëhet e tillë, nëse fuqizohet në vazhdim me Perondinë.

Zonat kryesore ekonomike të Kuçovës janë 6:

- 2 zonat e bizneseve që ndodhen në hyrje të qytetit dhe në bulevardin kryesor të tij, fokusuar në biznese të mëdha e të vogla dhe në shërbime tregtare
- 1 zonë industriale në periferi të qytetit, e cila funksionon pjesërisht si industri nxjerrjeje e përpunimi nafte dhe pjesërisht me industri të tjera të vogla
- 3 zonat e puseve të naftës, të shpërndara në tokë bujqësore, në afërsi të burimeve ujore dhe lumenjve, si dhe në mes të qendrave urbane

Këto zona industriale, veçanërisht industritë nxjerrëse dhe puset e naftës, janë në konflikt të vazhdueshëm mjedisor, në raport me tokën bujqësore e urbane, dhe duhen marrë masa pyllëzimi e masa buferike për shmangien e këtyre problemeve.

- **Pronat publike**

Nga inventari i pronave në bashkinë Kuçovë i cili është marrë nga Agjencia Kombëtare e Inventarit të Pronave Publike (AKIPP) rezulton se në bashkinë Kuçovë ka një sipërfaqe prej 3.6 km² prona publike ku rreth 65% të tyre e zënë rruget, rreth 30.4 % e zënë burimet ujore. Rezulton se rreth 4.6% janë objkete me pronësi publike dhe me funksione të tjera siç janë, shkollat, qendrat shëndetsore, hapësirat publike etj. Nga ky inventar me rëndësi të

përmëndet është se rreth 4534 m² është pronë truall dhe se rreth 8.4 ha janë prona publike pa funksion.

Sipas inventarit të pronave në qytetin e Kuçovës ka disa prona publike të cilat në bazë të interesit publik do të zhvillohen. Këto prona publike me interes zhvillimi janë 6: Magazinat në fund te bulevardit të Kuçovës dhe ish-UPN janë në pronësi të Bashkisë, zona e tregut aktual të qytetit të Kuçovës e cila është në përdorim të bashkisë dhe zona e stadiumit, zona e ankesit si dhe zona e ish-TEC të cilat janë prona publike në pronësi të institucioneve të tjera publike.

- **Zonat informale**

Sipas ALUIZNI-t në bashkinë e Kuçovës kemi dy zona të miratuara infromale me një siperfaqe prej 20.5 ha dhe 119 ndërtime. Përvec dy zonave të miratuara në kuçovë ndodhen dhe dy zona të tjera informale të cilat nuk janë të miratuara si të tilla. Në total kanë një siperfaqe prej 133.2 ha dhe 225 ndërtime.

1.7 Analiza e infrastrukturave publike


1.7.1 Sistemi rrugor dhe transporti publik

Bashkia e Kuçovës, nga pikëpamja e lidhshmërisë kombëtare, ndodhet ndërmjet Lushnjës dhe Beratit, të cilat lidhen ndërmjet tyre me rrugën shtetërore SH 72. Kuçova krijon një lidhje tërthore me këtë rrugë kombëtare nëpërmjet rrugës SH 91 dhe komunikon drejtpërdrejt me Urën Vajgurore në pjesën hyrëse të saj[306]. Ndërkaq, rrugë të tjera të karakterit lokal e lidhin me Lushnjën nëpërmjet Fier-Sheganit, si dhe me Grekanin nëpërmjet Gegës, Frashërit etj. Shtigjet dhe rrugët tretësore plotësojnë lidhshmërinë rajonale nga Lumasi në Gramsh, në Gostimë, nga Kozarja në Grekan, nga Vodëza në Berat etj.

Përsa i përket projekteve rajonale të infrastrukturës rrugore mund të përmendim rehabilitimin dhe ndërtimin e disa segmenteve të reja në aksin Kuçovë-Belsh-Cërrik. Ky është një projekt i bërë nga ARRSH-ja (Autoriteti Rrugor Shqipëtar), i cili ka një gjatësi rreth 30 km dhe kalon kryesisht në rrugën ekzistuese, e cila do të rehabilitohet, kurse në bashkinë e Kuçovës ky itinerar kalon në një distancë 4.1 km lineare, kurse rruga e ekzistuese kalon në distancën 3.8 km, sepse në pjesën perëndimore të fshatit Vlashuk pritet të ndërtohet një by-pass. Ndërtimi i këtij segmenti pritet të lehtësojë lëvizjen ndërmjet bashkisë së Kuçovës dhe bashkive të Belshit dhe Cërrikut.

Një investim tjetër i rëndësishëm rajonal është dhe rikonstruksioni i rrugës Grekan (Belsh) – Kozarë (Kuçovë), e gjatë 13.5 km. Ky investim ka sjellë një lidhje më të mirë ndërmjet këtyre dy bashkive.

Figura 123. Analiza e infrastruktuës rajonale dhe kombëtare, Bashkia Kuçovë



Burimi: ARRSH; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Transporti ndërqytetës (interurban): Transporti publik ndërqytetës luan një rol të rëndësishëm në mënyrën e lidhjes (bashkëveprimit) së bashkive me njëra-tjetrën. Transporti publik ndërqytetës është kompetencë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Transporti ndërqytetar përkufizohet si "Transport i udhëtarëve me autobus i cili kryhet në linjat kryesore dhe linjat ushqyese, të parashikuara në rrjetin e linjave të miratuara nga ministri". Linjat kryesore shërbejnë për të plotësuar nevojat e lëvizjes së popullsisë që lidhin bashkitë, si më poshtë:

a) Bashkitë qendër të qarqeve të ndryshme;

b) Një bashki qendër qarku me bashkitë jo qendër qarku të një qarku tjetër ose dy bashki jo qendër qarku të qarqeve të ndryshme.[307]


Transporti në linjat kryesore kryhet pa ndalime ose me ndalime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës. Linjat ushqyese lidhin dy bashki brenda një qarku, me qëndrime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës, të përcaktuara në rrjetin e linjave. Transporti ndërqytetës kryhet nga persona juridikë, të organizuar në shoqëri transporti e të pajisur me licencë. Rrjeti i linjave ndërqytetëse (kryesore dhe ushqyese), stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve për secilën linjë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin çdo tre vjet.[308]

Nga analiza e transportit ndërqytetës, sipas informacioneve të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, lëvizshmërinë më të shpeshtë bashkia e Kuçovës e ka me Tiranën dhe Beratin. Nga skema e paraqitur më poshtë shohim që Bashkia Kuçovë ka 26 orare shërbimi për udhëtim drejt Beratit në ditë, gjë që dëshmon për një marrëdhënie të

fortë në kontekstin rajonal. Në Berat ndodhet edhe terminali më i afërt ndërqytetës. Në Kuçovë ekziston një terminal i vogël vetëm për lëvizjet. Me Tiranën ofrohen 8 orare, me Korçën dhe Vlorën 2, dhe me Durrësin, Fierin e Elbasanin 1 orar. Kjo tregon se lidhjet rajonale të Kuçovës nuk janë të fuqishme në aspektin e marrëdhënieve të punësimit.

Tarifat e transportit për udhëtarët zbatohen mbi bazën e dispozitave të ligjit "Për çmimet dhe tarifat". Tarifat e transportit të udhëtarëve me subvencion nga shteti miratohen nga Këshilli i Ministrave. [309]

Figura 124. Transporti ndërqytetës, bashkia Kuçovë



Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

- Infrastruktura rrugore

Analiza sipas kodit rrugor

Analiza e infrastrukturës rrugore është hartuar sipas Kodit Rrugorë të Republikës së Shqipërisë që është ligji Nr.8378, datë 22.7.1998. Sipas këtij kodi rrugët klasifikohen në:

A. Autostradë
B. Rrugë interurbane kryesore
C. Rrugë interurbane dytësore
D. Rrugë urbane kryesore
E. Rrugë urbane dytësore
F. Rrugë lokale[310]

Në bashkinë e Kuçovës rezulton të ketë 793.8 km rrugë lineare gjithsej, duke përfshirë rrugët arteriale dhe ato peizazhistike e bujqësore. Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor për bashkinë Kuçovë (2012), në qytetin e Kuçovës ka pasur 3.4 km rrugë lineare që ndodhen brenda administrimit të ish- njësisë administative Kuçovë. Pra, Bashkia e sotme qëndron

para sfidës për të rikonstruktuar, mirëmbajtur dhe mbështetur me shërbime një rrjet rrugor i cili është shumëfishuar dhjetra herë.


Tabela 58. Shpërndarja e rrugëve sipas kategorisë së Kodit Rrugor dhe gjatësisë përkatëse

Kategoria e rrugës	Gjatësi (km)
Rrugë interurbane kryesore	0.1
Rrugë interurbane dytësore	12.8
Rrugë urbane kryesore	2.6
Rrugë urbane dytësore	163.1
Rrugë lokale	615.2
Total	793.8

Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Karakteri jo-tranzitor i infrastrukturës së Kuçovës vërehet në faktin se mbi 77 % e segmenteve rrugore i përket kategorisë lokale, pra që nuk përfshihen në asnjë nga kategoritë ndërlidhëse, me gjerësi e karakteristika të standardizuara. Rrugët urbane dytësore përbëjnë mbi 20% të rrjetit rrugor. Ky është tregues më tepër i distancave të largëta mes zonave rurale, sesa i numrit të madh të lidhjeve të tyre. Kjo shfaqet më së miri edhe në strukturën e qytetit të Kuçovës, ku dallohen dy bulevardet, të lidhur me njëri tjetrin në formë unazore, e pjesa tjetër janë rrugë dytësore. Për t'u thesuar është që në këtë analizë nuk janë vendosur rrugët e parcelave, të cilat shtrihen në një distancë 75.5 km lineare.

Figura 125. Hierarkia e sistemit rrugor sipas Kodit Rrugor




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Profilet e infrastrukturës rrugore bazuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë:

Rruga interurbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe bankina të shtruara, pa kryqëzime në nivel, me hyrje të koordinuara për objekte anësore, e dallueshme nga sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjetesh me motor. [311]


Figura 126. Seksioni i rrugëve interurbane kryesore



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Rrugë interurbane dytësore: Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsi lëvizjeje për sens dhe bankina.

Figura 127. Seksioni i rrugëve interurbane kryesore




Burimi: PLGP dhe CO-PLAN, 2016

Rrugë urbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe një korsi e mundshme e rezervuar për mjete

publike, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqëzime në nivel të pajisura me semafor. Për qëndrimin janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës, të dyja me hyrje dhe dalje të përqendruara.


Figura 128. Seksioni i rrugëve urbane kryesore



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Rrugë urbane dytësore: Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës.


Figura 129. Seksioni i rrugëve urbane dytësore



Burimi: PLGP dhe Co- PLAN, 2016

Rrugë lokale: Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme sipas përkufizimeve të pikës 1 të këtij neni, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme.

Figura 130. Seksioni i rrugëve lokale



Burimi: PLGP dhe Co PLAN, 2016


Analiza sipas funksionalitetit: Në aspektin e funksionit të akseve rrugore, mbizotërojnë rrugët bujqësore (33% të totalit), ndjekur nga rrugët peizazhistike (25%). Kjo dëshmon për një potencial të madh bujqësor dhe peizazhistik, për integrimin me itineraret potenciale rajonale të turizmit malor. Gjithsesi, në tërësi, sistemi rrugor i bashkisë ka nevojë për përmirësime të shumta në lidhjen me rrjetin kombëtar, por akoma më shumë në lidhjet e brendshme. Kjo është e dukshme në numrin e vogël të rrugëve të llojit arterie e kolektor (vetëm 11 % të gjatësisë së sistemit rrugor). Njësia Lumas lidhet me qendrën Kuçovë nëpërmjet Beratit dhe ka akses të drejtpërdrejtë vetëm me shtigje natyrore kodrinore. Gjithashtu, edhe ndërlidhja mes fshatrave, sidomos me njësinë Lumas, lë për të dëshiruar për shkak të terrenit të vështirë.

Tabela 59. Shpërndarja e rrugëve sipas funksionit dhe gjatësisë përkatëse

Funksioni	Gjatësia (km)
Arterie	22.3
Bujqësore	261
E brendshme kryesore	21.4
E brendshme dytësore	155.8
Kolektor	70.7
Korridor shumë-funksional	1
Peizazhistike	199.6
Rekreative	14.2
Shërbimi	47.8
Total	793.8

Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Figura 131. Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Rrugët urbane dhe rurale: Me ndarjen administrative të vitit 2016 vërejmë që infrastruktura rrugore ka pësuar shumë ndryshime ku mund të përmendim që sipërfaqja e rrugëve në planin rregullues të Bashkisë Kuçovë 2012 ishte 32.1 ha. Infrastruktura rrugore e bashkisë është 495.8 ha. Kjo tregon shtrirjen e madhe që ka marrë kjo bashki me ndarjen e re administrative.

Nga ky ndyshim që ka ndodhur shohim që rrugët urbane zënë 57.1ha, kurse rrugët rurale 438.7 ha. Kjo tregon që në bashki mbizotërojnë rrugët rurale dhe që kësaj infrastrukture duhet t'i jepet rëndësi në hartimin e planit të përgjithshëm vendor. Kjo infrastrukturë shtrihet në pjesën jashtë qytetit në ish- njësitë e vjetra administrative, të cilat i janë bashkuar bashkisë Kuçovë.

Pikat potenciale të rrezikut: Për të bërë një vlerësim të pikave të tjera potenciale të rrezikut, janë evidentuar të gjithë pikat ku rrugët interurbane kryesore ose dytësore kryqëzohen me rrugët lokale, si dhe me rrugët e parcelave, të cilat janë rrugë në pronësi private që lidhin kryesisht zonat ekonomike (bizneset) në mënyrë të drejtpërdrejtë me infrastrukturën kombëtare (rrugë interubane kryesore dhe dytësore). Numri i tyre është shumë i lartë: 157 pika konfliktuale, nga të cilat 87 pika janë më problematike (rrugët e parcelave). Pra, duhet marrë parasysh që lëvizja në akset kryesore të Kuçovës duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme ndaj kthesave drejt rrugëve lokale. Rrugët të cilat do të shikohen me kujdes janë: rruga që lidh Kuçovën me Fier-Shegan, si dhe rruga kryesore që lidh Kuçovën me Urën Vajgurore.

Figura 132. Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Gjendja e infrastrukturës rrugore: Krahas llojit dhe funksionit të akseve rrugore, kjo analizë merr në konsideratë edhe gjendjen fizike të infrastrukturës, në aspektin e cilësisë së shtrimit, pranisë së trotuareve, sinjalistikës etj. Nga ky evidentim[312] rezulton se në bashkinë e Kuçovës vetëm 58.2 kilometra rrugorë janë të shtruara dhe 735.6 janë të pashtruara. Rrugët me cilësi të mirë shtrihen kryesisht në qytetin e Kuçovës, në një pjesë të qendrave të njësive rurale, si dhe në segmentet interurbane kryesore e dytësore.

Investimet e bëra në vitet e fundit në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore nuk mungojnë: Në periudhën 2005-2013 FSHZH-ja ka financuar rindërtimin e rrugës që lidh ish-komunën Kozarë me Kuçovën në një gjatësi prej 3.82 km. Kjo infrastrukturë ka sjellë një lidhje më të mirë me qytetin e Kuçovës dhe lehtësi në shkëmbimet tregtare mes dy zonave.


Figura 133. Gjendja e rrugëve, bashkia Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Aksidentet rrugore: Sipas informacioneve të marra nga Instituti i Transportit mbi pikat e rrezikut, në bashkinë Kuçovë janë regjistruar 2 aksidente me rrezikshmëri të gradës së parë në rrugën ndërqytetëse kryesore të Salcë-Kozarës gjatë periudhës 2011-2014. Kjo shifër nuk është e lartë si statistikisht, ashtu edhe krahasimisht në lidhje me bashki të tjera fqinje. Në Berat, për shembull, kjo shifër arrin 12 aksidente në 5 pika të ndryshme rreziku. Gjithsesi, duke marrë parasysh llojin e rrugës dhe shpejtësinë e lejuar në të, numri i aksidenteve duhet të ishte më i ulët.

Figura 134. Aksidentet e regjistruara në territorin e bashkisë Kuçovë për periudhën 2011-2014



Burimi: Instituti i Transportit, Bashkia Kuçovë, 2014; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Lëvizshmëria (mobiliteti) dhe transporti publik rrethqytetës: Të dhënat statistikore për përdorimin e automjetit apo transportit publik (INSTAT, 2011) tregojnë se 76.5 % e banorëve të bashkisë Kuçovë shkojnë në punë në këmbë ose me biçikletë, 6.4 % me autobus, minibus ose taksi dhe vetëm 13.9 % me automjete personale (makina ose motoçikleta). Kjo dëshmon për një kulturë ende të largët nga ajo automobilistike, e cila mund të jetë për disa arsye: afërsia e vendit të punës, struktura kompakte e qendrave të banuara, pamundësia për të përballuar një automjet etj. Gjithsesi, numri i vogël i personave që përdorin transportin publik vjen si pasojë e mungesës së një sistemi të tillë brenda qytetit.

Transporti rrethqytetës është shumë i rëndësishëm në mobilitetin (lëvizshmërinë) brenda bashkisë. Kjo vjen pas reformës administrative që u bë në vitin 2015, ku bashkive të vjetra iu bashkuan dhe ish-njësitë administrative (komunat). Transporti i udhëtarëve në linjat rrethqytetëse është shërbim i rregullt transporti, i cili plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet:
a) njësive administrative përbërëse dhe qendrës së bashkisë së cilës i përkasin;
b) njësive administrative përbërëse të së njëjtës bashki;
c) fshatrave me njëri-tjetrin ose fshatrave në drejtim të qendrës së njësisë administrative së cilës i përkasin dhe/ose një njësie administrative tjetër të së njëjtës bashki;
ç) fshatrave dhe njësive administrative përbërëse të bashkive të ndryshme, por që ndodhen në kufi me njëra-tjetrën.[313]

Hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse dhe ndërqytetëse bazohet mbi të dhënat demografike e gjeografike, gjendjen social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjetin rrugor dhe gjendjen e infrastrukturës rrugore. Linjat e transportit rrethqytetës mbështeten në nevojat e lëvizjes së udhëtarëve për në ose nga bashkitë qendër qarku, bashkitë e tjera dhe destinacionet dimërore apo verore dhe qendrat historike. Në procesin e hartimit të rrjetit të linjave rrethqytetëse merren parasysh lidhjet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe qendrave të njësive administrative përbërëse, si dhe lidhjet ndërmjet qendrave të njësive administrative përbërëse dhe fshatrave dhe fshatrave ndërmjet tyre. Ky rrjet linjash transporti miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet të cënojë rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse.[314]

Një fakt i rëndësishëm që duhet përmendur është që Këshilli Bashkiak ka kompetencë të përcaktojë nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet (transporti rrethqytetës), në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave[315].

Me ndarjen e re administrative, duke parë zgjerimin e territorit dhe sistemit rrugor, bashkia e Kuçovës ka propozuar disa linja të reja dhe shtimin e autobusëve dhe mikrobusëve që ish-njësitë administrative (komunat)të kenë një akses më të mirë të qytetit të Kuçovës, në mënyrë që të marrin shërbimet që ndodhen në qytetin e Kuçovës. Sipas infomacioneve nga bashkia Kuçovë, deri në vitin 2015 numri i autobusëve ka qenë 40, nga të cilët 38 në linjat ndërqytetëse midis bashkisë dhe qyteteve të tjera të vendit dhe 2 në linjat urbane (qytetëse). Numri i mikrobusëve taksi me 1+8 vende në vitin 2010 ka qenë 20, në vitet 2011 e 2012 ka qenë 22, në vitin 2013 ka qenë 20 dhe në vitet 2014 e 2015 numri i tyre është ulur në 15. Tendenca e mikrobusëve taksi me 1+8 vende është në rënie për shkak të heqjes së tyre nga ky shërbim, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.


Sipas ndryshimeve që kjo bashki ka bërë me shtimin e transportit publik ndërqytetës mund të thuhet që ky lloj transporti mbulon 40.8 km lineare, ku në vitin 2016 janë shtuar linjat Kuçovë- Drizë, Perondi- Kuçovë dhe Kuçovë-Lumas, si dhe propozohen disa lidhje të tjera që do të jepen në propozimet e planit për transportin publik. Për t'u theksuar është që bashkia Kuçovë gjatë vitit 2016 ka rritur numrin e linjave të transportit publik me 60 % duke kaluar në 5 linja gjithsej nga 2 që ka pasur në vitin 2015.

Përsa i përket kostos, nga informacionet e marra nga Bashkia, thuhet se për transportin publik me furgona me 1+8 vende varion nga 50 deri në 100 lekë/udhëtar, por kjo varet nga distanca. Për distancën Kuçovë - Havaleas (qendër Kozarë), për shembull, është 50 lekë/udhëtar, ndërsa për Kuçovë -Salcë Kozarë është 100 lekë/udhëtar. Po kështu, për linjën Kuçovë-Gegë është 50 lekë/udhëtar, ndërsa për linjën Kuçovë-Gegë-Frashër (që nuk është shumë i aksesueshëm) është 100 lekë/udhëtar.

Stacionet e furgonave janë të përcaktuara nga vetë drejtuesit e furgonave dhe udhëtarët, pasi kur jepen licencat e tyre nuk vendosen orare dhe stacione, sepse furgonat janë "autovetura taksi" dhe nuk i parashikon formati i licencave të tyre. Linja Kuçovë-Salcë Kozarë, për shembull, ka 4 stacione që janë: Kuçovë-Sheshi i lagjes "11 Janari"- Dikater (kryqëzimi te karburanti "Benja") - Havaleas (qendër Kozarë) - Salcë Kozarë.

Për numrin e udhëtarëve që lëvizin me transportin publik nuk ka statistika zyrtare nga shoqëritë që bëjnë këto linja, por nga personat që punojnë në bashkinë e Kuçovës thuhet se në një ditë mund të udhëtojnë rreth 140-150 udhëtarë, pa marrë parasysh ata që udhëtojnë me automjete të palicensuara si mjete "taksi". Në muaj janë rreth 4,500 udhëtarë, kurse në vit rreth 54,000 udhëtarë.

Figura 135. Transporti ndërqytetës, bashkia Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

1.7.2 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura

- **Ujësjellësi Kuçovë**

Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane operon nëpërmjet shoqërisë aksionere rajonale Berat-Kuçovë (e vetmja sh.a. rajonale në Shqipëri), e cila ofron shërbimin për bashkinë e Beratit dhe Kuçovës, por që aktualisht është duke ndjekur procesin e tranzicionit të sektorit sipas reformës territoriale.

Bashkia Kuçovë siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik në pjesën më të madhe nga burimi i Bogovës në malin e Tomorrit, rreth 37 km në juglindje të qytetit Berat në një lartësi prej 343 mmnd. Prurja maksimale e këtij burimi është 2 deri në 2.4 m^3/s gjatë periudhës së dimrit dhe në verë është rreth 350l/s. UK Kuçovë, krahas ujit nga burimi i Bogovës, përdor edhe pusshpimet në fushën e Devollit, 2 km në veri të qytetit, ku nëpërmjet pompave furnizon kryesisht fshatrat Tapi, Drizë, Goraj, Velaglosht, Gegë dhe Polovinë[316]. Klorinimi ndodh në këtë St.P, i cili injektohet direkt në rrjetin e transmetimit. Kërkesa e përgjithshme e Bashkisë Kuçovë, përkatësisht e NjA-ve të saj, mbulohet pjesërisht nga pusshpimet e Frashërit, Vlashukut, Magjatës dhe Gegës.

Akuiferi i Kuçovës është mjaft i rëndësishëm duke qenë se shtrirjen e tij më të madhe e ka pikërisht nën pikën ku formohet lumi Seman nga bashkimi i lumit Osum dhe Devoll. Ky akuifer shfrytëzohet nëpërmjet puseve të thella rreth 210m. Nëpërmjet St.Pompimit në Çiflik, Drizë dhe Devoll furnizohet me ujë për konsum publik popullsia në fshatrat pranë qytetit Kuçovë. Këto pompa janë ndërtuar në vitin 1975, çka tregon se konsumi i energjisë prej tyre është në vlera maksimale, duke pasur në të njëjtën kohë rendiment minimal.

Tabela 60. Prurja mesatare e burimeve të ujit në bashkinë e Kuçovës

Burimi/Pusi i ujit	Prodhimi	
	m^3/ditë	l/s
Bogovë	51,840	600
Çiflik, Drizë, Devoll	216	2.5
St.P Frashër	43	0.5
St.P Vlashuk	43	0.5
St.P Magjatë	43	0.5
St.P Gegë	43	0.5
Total	52,228	604.5


Burimi: PLGP/VALUADD, KFW – Projekti Teknik i Ujësjellësit Kuçovë
Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Cilësia e ujit nga burimi i Bogovës, që përdoret për furnizimin e popullatës, paraqitet mjaft e mirë, por në rastin e shfrytëzimit të ujërave nga akuiferi i Kuçovës janë konstatuar ndotje të cilat shkaktohen kryesisht nga mungesa e zonave buferike dhe të mbrojtjes higjieno-sanitare pranë pusshpimeve. Këto ujëra janë shfaqur të ndotura si pasojë e faktorëve të renditur më poshtë:

- Shkarkimet e ujërave të ndotura të qytetit Kuçovë në ujërat sipërfaqësore të lumit Osum e Seman, pranë zonës së St.P-së dhe, rëndom, mbi këtë akuifer
- Përdorimi i këtyre puseve nga industria e naftës gjatë sistemit të kaluar
- Infiltrimi nga ujërat sipërfaqësore të zonës përdorur në sektorin e bujqësisë

- Mungesa e zonave higjieno-sanitare rreth puseve

Figura 136. Skema e furnizmit me ujë nga U.K. Kuçovë



Burimi: VALUADD, KFW – Projekti Teknik i Ujësjellësit Kuçovë
Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Kapaciteti stokues i ujit të pijshëm për popullatën e bashkisë Kuçovë përfaqësohet nga 18 rezervuarë kryesorë dhe disa të vegjël, të cilët u shërbejnë komuniteteve në fshatra. Volumi i përgjithshëm prej 8,700m^3 paraqitet nga tabela e mëposhtme:

Tabela 61. Volumi i depozitimit dhe furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm –Kuçovë

Rezervuar/Depo	Volumi (m³)	Vjetërsia (vite)	Lartësia (m.m.n.d)	Konstruksioni
Kuçova Rez.1	**3 * 2000 = 6,000**	**23**	**142**	**Beton-arme**
Kuçova Rez.2	1000	23	142,3	Beton-arme
Kuçova Rez.3	**500**	**23**	**116,2**	**Beton-arme**
Kuçova Rez.4	250	23	180,3	Beton-arme
Magjatë Fushë	**2 * 50 = 100**	**14**		**Beton-arme**
Magjatë Kodër	50	14		Beton-arme
Drizë St.P	**2*250 + 50 = 550**	**41**		**Beton-arme**
Drizë Fshat	50	18		Beton-arme
Gegë St.P	**2 * 50 = 100**	**15**		**Beton-arme**
Vlashuk St.P	50 + 36 = 86	33		Beton-arme
Frashër St.P	**25**	**26**		**Beton-arme**

Burimi: PLGP/VALUADD, KFW – Projekti Teknik i Ujësjellësit Kuçovë
Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Nga konstatimet e kryera rezulton se sistemi aktual, i cili po i nënshtrohet rehabilitimit dhe zgjerimit[317], ka një kapacitet stokues të ujit të pijshëm ekuivalent me 200% të kërkesës ditore projektuar për vitin 2020.

Tabela 62. Të dhëna magjistrale mbi situatën e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm – Kuçovë

Nr	NjA	Popullsia aktuale	Kërkesa aktuale përujë *(l/sek)*	Kërkesa aktuale përujë *(m^3/orë)*	Sasia e ujit të prodhuar aktualisht	Bilanci	Kërkesa për rez.	Vol. i rez.	Bilanci i vol.të rez. me kërkesën
					(m^3/orë)	*(m^3/orë)*	*(m^3)*	*(m^3)*	
1	Kuçovë	12,720	24	85	2169	+2,084	1,020	7,750	+6,730
2	Kozarë	5,651							
		Uj. Rajonal Kozarë	23.3	84	22.7	-61.6	1,000	330	-670
		Uj.Vlashuk Uj. Gegë Uj. Drizë Uj. Frashër							
3	Lumas	4,002					4,30	300	-130
		Uj. Bardhas Uj. Lumas Uj. Vodëz Uj. Pëllumbas Uj. Pashtraj	10	36	20	-16			
4	Perondi	9,052 Uj. Berat – Kuçovë Uj. Magjat Fushë Uj. Devollit	27	97	97	+4	1,160	700	+100
Total		**31,424**	**84.3**	**3002**	**2,308.7**	**2.010.4**	**3,610**	**9,080**	**+5,470**

Burimi: PLGP/VALUADD, KFW – Projekti Teknik i Ujësjellësit Kuçovë; Përpunoi: Co-PLAN 2016

Duke qenë gjithnjë në gjendje pune, rezervuarët, stacionet e pompimit, klorifikatori dhe vetë sistemi i tubacioneve nuk i janë nënshtruar rregullisht proçeseve mirëmbajtëse si pastrim-shpëlarje dhe dezinfektim.

Gjithashtu, agjentët atmosferikë dhe, në disa raste, vegjetacioni kanë ndikuar negativisht në higjienën e këtyre elementeve. Siguria e tyre është një aspekt tjetër i cili nuk shfaq besueshmëri, duke marrë parasysh faktin se në këto elemente mund të kenë akses edhe persona të paautorizuar.

VKM-ja nr. 102, datë 16.3.1992, "Për normat e përdorimit dhe çmimin e ujit të pijshëm në qytet dhe në fshat" përcakton që normat e përdorimit të ujit të pijshëm për efekt pagese për përdoruesit familjarë të cilët nuk kanë matës të jetë 120 litra ujë në ditë për frymë. Është kryer llogaritja e kërkesës për ujë në qytetin e Kuçovës.

Gjatë kësaj llogaritjeje janë marrë parasysh humbjet në rrjet, të cilat synohet të reduktohen deri në 35%. Norma e konsumit për popullatën ndryshon nga 90-120 litra ujë në ditë për frymë sipas kategorive (banesa, institucione, biznese).

NjA-të në bashkinë e Kuçovës e kanë infrastrukturën e furnizimit me ujë të pijshëm në territorin e tyre në masën 85%, por specifikisht vetëm Nj.A Lumas paraqitet problematike

sa i përket ofrimit të këtij shërbimi. Fshatrat Luzaj, Belesovë, Mëndrak, Sheqëz, Koritëz, Krekëz e Katundas nuk kanë infrastrukturën minimale, ndaj zgjidhja e tyre është me puse në oborret e shtëpive.

E vetmja NjA në këtë bashki e cila e ofron shërbimin e furnizimit me ujë në masën 100% të popullatës së saj rezidente është NjA Perondi.

Në këtë NjA uji sigurohet nëpërmjet magjistralit, i cili furnizon Kuçovën me ujë nga burimi i Bogovës nga mali i Tomorrit.

Tabela 63. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm për NjA-të dhe fshatrat në bashkinë Kuçovë

Nr.	Njësitë administrative	Fshatrat e NJA-ve	Pop. %
1	Kuçovë	Me rrjet: qyteti Kuçovë, 5 fshatrat pranë qytetit	93
2	NjA Kozarë	Me rrjet: Havalehas, Kozarë, Feras Kozarë, Salcë Kozarë, Vlashuk, Fier Mimar, Zdravë, Gegë, Drizë, Frashër	98
		Pa rrjet: Demollarë	
3	NjA Perondi	Me rrjet: Perondi, Magjatë, Tapi, Goraj, Velagosht, Rreth Tapi, Polovinë	99
		Pa rrjet:	
4	NjA Lumas	Me rrjet: Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Pashtraj, Vodëz	58
		Pa rrjet: Luzaj, Belesovë, Mëndrak, Sheqëz, Koritëz, Krekëz e Katundas	
Totali i popullsisë së shërbyer me infrastrukturën e furnizimit me ujë për konsum publik:			85.5

Burimi: PLGP/VALUADD 2015; Punoi: Co-PLAN, 2016

- **Pusshpimet**

Për të përmbushur nevojat e përditshme për ujë të pijshëm dhe konsum sekondar, popullsia banuese në zonat e pashërbyera ka ndërmarrë në mënyrë të organizuar ose individuale iniciativën për të realizuar pusshpime.

Bashkia Kuçovë dhe Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve mbështeten kryesisht tek prurjet që vijnë nga burimi i Bogovës, por gjithashtu edhe nga puset e fushës së Devollit (Driza, Çiflik, Devoll) për furnizimin me ujë për konsum publik të banorëve në qytet dhe fshatrat fqinje. Në të njëjtën linjë operojnë edhe NjA-të e tjera, të cilat e kanë mbështetur shërbimin e furnizimit duke shfrytëzuar pusshpime apo burime sipërfaqësore brenda territorit të tyre dhe afër qendrave të banuara.[318]

Tabela 64. Pusshpimet në bashkinë e Kuçovës

Nr.	Qyteti / NjA	Ujësjellësi	Qyteti / NjA - Fshati i furnizuar	Pusshpimet: Vendndodhja
1	Qyteti Kuçovë	U.K. Kuçovë	Qyteti i Kuçovës	Burimi i Bogovës (37km në juglindje të Beratit)
				Puset në fushën e Devollit, 4km në veri të Kuçovës (3 puse të thella), kapaciteti = 216m³/orë.
2	NjA Kozarë	Ujësjellësi Rajonal Kozarë	Havaleas, Fier Mimar, Salcë Kozarë, Feras Kozarë	Pusshpim dhe STP nën digën e Vlashukut, kapaciteti = 63l/s.
		Ujësjellësi Vlashuk	Vlashuk	Pusshpim në akuiferin e lumit Devoll pranë fshatit Vlashuk, kapaciteti = 3 l/s
		Ujësjellësi Gegë	Gegë	Pusshpim në akuiferin e lumit Devoll pranë fshatit Gegë, kapaciteti = 3 l/s

		Ujësjellësi Drizë	Drizë, Polovinë, Goraj, Rreth Tapi, Velagosht	Ekstraktim i sasisë 15l/s nga Ujësjellës Devoll.
		Ujësjellësi Frashër	Frashër	Pusshpim në akuiferin e lumit Devoll pranë fshatit Frashër, kapaciteti = 3 l/s
3	NjA Perondi	Ujësjellësi Bogovë	Perondi, Tapi, Magjat Kodër	Furnizim me gravitet nga linja magjistrale që furnizon Kuçovën me ujë nga burimi i Bogovës
		Ujësjellësi Magjat Fushë	Magjat Fushë	Pusshpim në fshatin Magjat Fushë, kapaciteti = 3 l/s
		Ujësjellësi Devoll	Polovinë, Goraj, Rreth Tapi, Velaglosht	3 Pusshpime pranë lumit Devoll, në afërsi të fshatit Polovinë, kapaciteti = 15 l/s.
4	NjA Lumas	Ujësjellësi Bardhaj	Bardhaj	Pusshpim dhe STP pranë përroit Lapardhicë, me prurje Q = 1 l/s
		Ujësjellësi Lumas	Lumas	Pusshpim dhe STP 1km në veri të fshatit në përroin e Lapardhicës, prurje Q = 1 l/s
		Ujësjellësi Vodëz	Vodëz	Pusshpim dhe STP në fshatin Bardhaj në përroin e Lapardhicës, prurje Q = 1 l/s
		Ujësjellësi Pëllumbas	Pëllumbas	Pusshpim dhe STP në fshatin Pëllumbas në përroin e Lapardhicës, prurje Q = 1 l/s
		Ujësjellësi Pashtraj	Pashtraj	Pusshpim dhe STP në fshatin Bardhaj në përroin e Lapardhicës, prurje Q = 1 l/s

Burimi: PLGP/VALUADD 2015; Punoi: Co-PLAN 2016

Aktualisht po realizohen ndërhyrje në rrjetin e furnizimit me ujë të bashkisë Kuçovë, ku po zbatohet projekti i realizuar me mbështetjen e KfË-së, në të cilin është parashikuar të bëhet rehabilitimi i sistemit dytësor dhe kryesor të furnizimit me ujë dhe i lidhjeve me shtëpitë.

- Rehabilitimi i linjës magjistrale të transmetimit nga pusshpimet Devoll në qytet Kuçovë, si edhe rehabilitimi i linjës që furnizon qytetin nga burimi i Bogovës
- Masa parandaluese për kontaminimin dhe ndotjen e Drizës, Çiflikut, Devollit
- Rehabilitimi i rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë
- Projektimi i zonës së parashikaur për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura
- Rehabilitimi i zyrave qendrore të UK Kuçovë dhe trajnime
- Instalimi i sahatëve matës në shkallë të gjerë (rreth 800 copë), si edhe pajisje të tjera

Masat që duhen ndërmarrë për rritjen e efiçencës së këtij sistemi kanë të bëjnë kryesisht me kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sasisë së ujit të pijshëm të prodhuar dhe të faturuar.

Në vlerësimin tonë nevojitet që, për të qenë sa më miqësorë me mjedisin, të kontrollohet në mënyrë dinamike sasia e ujit të prodhuar nga pusshpimet e Devollit (përfshirë edhe puset e shpërndara në NjA-të e bashkisë Kuçovë) në varësi të kërkesës për konsum. Kjo realizohet me anë të sistemit SCADA[319], i cili në mënyrë automatike do të monitorojë nivelin e ujit të stokuar në depozitat e lartpërmendura të ujit të pijshëm e, më pas, po në mënyrë automatike, do të komandojë pompat në Devoll dhe gjatë magjistralit nga UK Berat (Bogova) lidhur me sasinë e nevojshme të ujit për t'u pompuar nga thellësia.

Ky sistem mbështetës kërkon një investim fillestar, por kontributi që ai jep në ruajtjen e ujërave natyrale është mjaft i rëndësishëm, duke ulur në të njëjtën kohë edhe humbjen e

ujit që shkarkohet në tepërplotësat e depozitave pasi ato janë mbushur, por nuk janë komanduar për t'u mbyllur.

Gjithashtu, një masë tjetër, e cila shkon përkrah atyre që po ndërmerr aktualisht projekti në zbatim pranë Bashkisë Kuçovë për rritjen e efiçiencës së sistemit, ka të bëjë me monitorimin e të gjithë linjës magjistrale, si edhe nivelet kryesore e dytësore të rrjetit të shpërndarjes për konstatim dhe shkëputje të lidhjeve të paligjshme.

Kjo masë do të ndikojë duke reduktuar ndjeshëm humbjet prej dëmtimeve në rrjet, si edhe do të ndihmojë që sasia e faturuar e ujit të jetë sa më pranë sasisë së prodhuar, duke rritur kështu edhe rentabilitetin e ndërmarrjes e duke i ulur humbjet sa më pranë nivelit të humbjeve hidraulike në projektim.

Figura 137. Zonat e shërbyera nga U.K.Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë & Co-PLAN, 2016

Krahas masave të lartpërmendura, duhet të theksojmë se situata në njësinë administrative të Lumasit mbetet mjaft problematike lidhur me mbulimin e plotë me këtë shërbim. Objektiv duhet të mbetet zgjerimi i sistemit edhe në këtë NjA gjatë 5-vjeçarit të ardhshëm.

- **Problematikat në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm**

Për sa i përket problematikave që hasen në sektorin e furnizimit me ujë, ato janë të llojeve të ndryshme dhe përfshijnë kryesisht:

- Shtrirjen jo të plotë të sistemit të furnizimit me ujë për konsum publik në bashkinë Kuçovë.
- Në zonat ku ofrohet furnizimi me ujë: vështirësi për mbulimin e nevojave me ujë gjatë periudhës së verës, kur kërkesa për konsum rritet si pasojë edhe e përdorimit të këtyre ujërave për vaditje, por edhe uljet e prurjeve nga burimi i Bogovës.
- Gjendjen jo të mirë të sistemit aktual për shkak të tubacioneve të vjetëruara ose të bllokuara.


Tabela 65. Gjendja e tubacioneve të rrjetit të furnizimit me ujë

Fusha e përdorimit	Gjatësia e tubacioneve(m)
Rrjet kryesor (DN 300-400)	3,110
Rrjet dytësor (DN 50-250)	101,146
Totali	104,256

Burimi: USAID/ValuAdd 2015; Punoi: Co-PLAN

- Humbjet në sistem. Aktualisht humbjet vlerësohen të jenë midis 40-65% (faktor i cili rrit kërkesën për ujë gjatë verës deri në 210-255 litra/ditë/banorë). Këto humbje, në bazë të strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë të popullatës, duhet të reduktohen deri në masën 30%.
- Gjendja jo e mirë e depozitave. Mosha mesatare e këtyre depozitave vlerësohet të jetë mesatarisht 50-vjeçare.

Figura 138. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në Kuçovë, qytet



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

- **Sistemi i ujërave të ndotura urbane, Kuçovë**

Shërbimi i grumbullimit dhe i kanalizimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet në qytetin e Kuçovës dhe në fshatrat fqinje Perondi e Tapi. Shërbimi i orfuar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij, si edhe mjaft problematike paraqiten seksionet të cilat, në mungesë të kuotave për të shkarkuar me gravitet, detyrojnë ujërat e ndotura që të flenë për një kohë të gjatë në seksionet e tubacioneve të kanalizimeve. Ky sistem është i kombinuar dhe mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura, ashtu edhe ujërat e larta e ato industriale. Nuk ofrohet asnjë nivel trajtimi i këtyre ujërave dhe shkarkimet ndodhin mbi trupat ujore sipërfaqësore më të afërta.

Aktualisht janë të identifikuara dy pika kryesore shkarkimi në lumin Devoll; njëra është grykëderdhja e kanalit të "DiKatrës", kurse tjetra është pranë fshatit Tapi.

Kompozimi i këtij sistemi për grumbullimin e ujërave të ndotura urbane është i tillë që, njëkohësisht, ai grumbullon ujërat e larta, si edhe shkarkime të ndryshme e të pakontrolluara që ndodhin në kolektorë apo kanalet e hapura dedikuar këtij sistemi.

Gjatësia totale e tubave të kanalizimit është 13.9 km me diametra që variojnë nga 150 deri në 1000. Kanalet janë kryesisht tuba betoni pa bazament dhe me bashkime me llaç. Pothuaj 80% e rrjetit është shtrirë para vitit 1980. Përveç kësaj ka edhe 2.23 km kanal në formë drejtkëndëshi për ujërat e bardha, në të cilin prej vitesh përzihen edhe ujërat e ndotura urbane.

Tabela 66. Gjendja e tubacioneve të rrjetit të furnizimit me ujë

Diametri Ø[mm]	Gjatësia [m]
200	5,615
300	2,706
400	1,170
500	1,752
600	354
1,0 x 1,0 m	1,855
1400	478
Total	**13,930**

Burimi: USAID/ValuAdd; Punoi: Co-PLAN; 2015

Zonat urbane: Sot, Bashkia Kuçovë mbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura rreth 70% të popullsisë së qytetit të Kuçovës. Shkarkimi në kanalin e hapur dhe shkarkimi i këtyre ujërave drejtpërdrejt në lumin Devoll përbën një problem mjaft të madh mjedisor, kjo pasi mund të konfirmohet se lumi Seman ndotet që në momentin kur Osumi dhe Devolli bartin në prurjet e tyre ujërat e ndotura të Kuçovës e Beratit.

Zonat rurale: Në zonën rurale të bashkisë Kuçovë nuk ekziston ndonjë sistem i organizuar inxhinierik i mbledhjes dhe largimit të ujërave të ndotura.

Ujërat e ndotura të çdo shtëpie largohen në gropa individuale në oborret e shtëpive, të cilat nuk i respektojnë standardet tekniko-sanitare të gropave septike me ose pa filtrim. Në mjaft raste largimi i tyre bëhet edhe në kanale të hapura kulluese që kalojnë pranë shtëpive të tyre e që, gjithashtu, janë në kundërshtim me respektimin e kushteve sanitare të largimit të tyre.

Shkarkimi dhe trajtimi i këtyre ujërave, si edhe i ujërave industriale është problemi më i madh sanitar që mund të paraqitet sot në bashkinë Kuçovë, për arsye se të gjithë kolektorët i shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajtuara në sipërfaqe ujore sipërfaqësore.[320] Përzierja e lëndëve ndotëse organike dhe inorganike (ujërat e ndotura urbane e ato industriale), si edhe rrugëtimi i tyre deri në grykëderdhje pranë lumit Devoll duke përshkruar një gjatësi afro 4km përmes fushave bujqësore, përbën një shqetësim të thellë mjedisor e shoqëror për të gjithë banorët e Kuçovës.

Ky sistem është ndërtuar rreth viteve 1968 dhe 1980, vite këto që përkojnë me ndërtimin e banesave të reja. Pas viteve 1990 nuk është ndërhyrë më në këtë sistem. Si rrjedhojë, ndërtimet pas viteve 1990 janë të pakontrolluara dhe të paplanifikuara[321] në aspektin e ofrimit të infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe kanalizime.

- **Problematikat**

Sikurse u pa më sipër, rrjeti i kanalizimeve në bashki është relativisht i amortizuar dhe nuk përmbush me efiçencë funksionin bazë. Përveç qytetit të Kuçovës, pjesa tjetër e bashkisë nuk mbulohet me rrjet kanalizimesh. Për më tepër, edhe në zonat ku ky rrjet shtrihet hasen shumë probleme. Kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar ose i dëmtuar, pa llogaritur ndotjen e ujërave të lumit Seman dhe kanaleve kulluese e vaditëse, që shkaktohet nga derdhja e ujërave të ndotura të patrajtuara.

1.7.3 Ndriçimi i mjediseve publike

Në këtë seksion do të analizohet ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik në bashkinë Kuçovë. Në fillim do të bëhet një analizë e kompetencave ligjore të pushtetit vendor mbi ofrimin e këtij shërbimi. Do të kryhet një analizë statistikore e ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik, do të vihen në dukje zonat që kanë sistem të amortizuar të ndriçimit publik, si dhe zonat në të cilat nuk ofrohet ky shërbim. Në pjesën e fundit do të nxirren konkluzionet përkatëse mbi analizën.

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020 në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike (shërbimi i ndriçimit publik)

Me reformën administrativo – territoriale u krijuan 61 bashki nga 374 komuna dhe bashki, si rezultat i bashkimit të disa NJQV-ve. Jo të gjitha NjQV-të e vjetra i ofronin shërbimet publike të përcaktuara në ligj për banorët e tyre, dhe kjo si shkak i pamundësive të ndryshme. Me reformën administrative-territoriale bashkive të reja u lind nevoja të ofrojnë shërbimet publike në të gjithë territorin e tyre. Kjo gjë do të ndodhë dhe me Bashkinë Kuçovë, e cila duhet të ofrojë shërbimin e ndriçimit publik në të gjitha NjA-të e bashkisë. Për momentin Bashkia Kuçovë ofron shërbimin e ndriçimit publik në NjA-të Kuçovë, Perondi dhe Kozarë, kurse në NjA Lumas nuk e ofron. Kjo sepse ish- Komuna Lumas nuk ka patur mundësi financiare për të ofruar këtë shërbim më parë.

Përsa i përket strategjisë së decentralizimit, ofrimi i shërbimeve publike, ku bën pjesë dhe ndriçimi publik, i përket funksioneve të veta të pushtetit vendor, të cilat bashkia duhet t'i ofrojë në mënyrë ekskluzive në territorin që administron.

Kuadri ligjor mbi shërbimin e ndriçimit publik nga pushteti vendor:

- **Ligji nr. 139\ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore"**

Në këtë ligj, në nenin 23, pika 5, thuhet se pjesë e funksioneve të veta të bashkive është dhe ndriçimi i mjediseve publike, pra ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik. Gjithashtu, në nenin 35, pika 5a, thuhet se Bashkia krijon të ardhura nga tarifat vendore për shërbimet publike që ofrohen. Një ndër këto shërbime publike është edhe ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik.

- **Ligji nr, 9632 "Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar"**

Në këtë ligj, në kreun VII për tarifat vendore dhe administrimin e tyre, në pikën 2, thuhet që tarifat vendore vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr. 139\ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat

bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe vendos nëse këto tarifa mblidhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga agjentët.

- **Ligji nr. 125/ 2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".**

Në këtë ligj, në nenin 4, thuhet se zbatimi i koncesioneve ose i partneriteteve publike private lejohet në shërbime publike të tilla si ndriçimi publik në territorin e njësive vendore (kjo pikë është shtuar me ligjin nr. 88/ 2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat").


Pronësia dhe administrimi i shërbimit të ndriçimit publik në bashkinë e Kuçovës: Sipas strukturës organizative të Bashkisë Kuçovë të vitit 2015 (informacion i marrë në Bashki), shërbimi i ndriçimit publik administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Komunale, e cila ndahet në dy sektorë: sektori i shërbimeve komunale dhe sektori i gjelbërimit. Pjesë e sektorit të shërbimeve komunale është edhe zyra e shërbimit të ndriçimit publik. Kjo zyrë ka në përbërjen e saj 3 punonjës (1 inxhinier elektrik dhe 2 specialistë të fushës). Gjithashtu, ka një mjet teknologjik me kosh hidraulik për shërbimin e ndriçimit. Drejtoria e shërbimeve komunale që merret me administrimin e shërbimit të ndriçimit publik minimalisht 1 herë në vit duhet të bëjë inventarizimin e infrastrukturës së ndriçimit publik në tërësi. Stafi i shërbimit të ndriçimit publik menaxhon mirëmbajtjen e rrjetit, ~~si mund të jenë~~ ndërrimin e llambave të djegura, riparimin e shtyllave dhe kabllove të dëmtuara, si dhe riparimin e pajisjeve të tjera elektrike në funksion të ndriçimit publik.

Vendimet mbi buxhetin, strukturën e personelit apo ndryshimet e nevojshme për administrimin e shërbimit të ndriçimit publik miratohen nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak i Kuçovës.

Ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik në bashkinë e Kuçovës: Objekt i ndriçimit publik mund të jenë akset rrugore për makinë, rrugët e këmbësorëve, sheshet urbane, lulishtet, si dhe ndërtesat e institucioneve të ndryshme publike (ndriçimi i jashtëm i tyre).

Në total kemi rreth 17.6 km rrugë të pajisura me ndriçim publik të shpërndarë në rreth 40 akse rrugore. Ekzistojnë 8 sheshe urbane, si dhe parku në qendër të qytetit, të cilët janë të pajisur me ndriçim publik. Në total janë 625 shtylla të ndriçimit, nga të cilat rreth 138 janë shtylla me ndriçim LED dhe 24 janë shtylla të ndriçimit dekorativ. Gjithashtu, rrjeti i ndriçimit publik ka rreth 1135 llamba, nga të cilat 156 janë llamba LED.

Figura 139. Rrjeti rrugor i ndriçuar në bashkinë e Kuçovës



Burimi: Bashkia Kuçovë; Përpunoi: Co-PLAN, 2016

Performanca e shërbimit të ndriçimit publik në bashkinë e Kuçovës: Shërbimi i ndriçimit publik në bashkinë e Kuçovës ofrohet në qytetin e Kuçovës dhe në NjA-të Kozarë dhe Perondi, ndërsa në NjA-në Lumas, për momentin, nuk ofrohet ky shërbim.

Në NjA Kozarë ka rreth 120 ndriçuesa, të cilët janë vendosur në akset kryesore: Kuçovë-Havaleas, Havaleas, Polovinë dhe Gegë. Nga 120 ndriçuesa rreth 54 nuk janë në funksionim. Arsyet e mosfunksionimit janë dëmtimi i kabllit lidhës, si dhe dëmtimi i ndriçuesave.

Në NjA Perondi ka rreth 59 ndriçuesa, të cilët janë vendosur në akset Tapi dhe Perondi. Nga 59 ndriçuesa rreth 10 janë jashtë funksionimit. Arsyeja e mosfunksionimit kryesisht është dëmtimi i kabllit lidhës.

Në qytetin e Kuçovës kemi rreth 94% të rrjetit rrugor të ndriçuar, çka tregon për një shtrirje të kënaqshme të rrjetit të ndriçimit rrugor. Sistemet e rrugëve kryesore dhe dytësore janë të ndriçuara tërësisht, ndërsa sistemi i rrugëve tretësore është i ndriçuar pjesërisht.

Figura 140. Rrjeti rrugor i ndriçuar në bashkinë e Kuçovës (qyteti i Kuçovës)



Burimi: Bashkia Kuçovë; Përpunoi: Co-PLAN, 2016

Rreth 85% e investimeve në rrjetin e ndriçimit rrugor janë bërë pas viteve 90. Në investimet e fundit në rrjetin e ndriçimit publik është përdorur teknologjia LED, e cila ka një performancë më të mirë dhe konsum më të vogël të energjisë sesa teknologjia e përdorur më parë. Gjithsesi, në disa segmente të rrjetit të ndriçimit rrugor ka amortizime të konsiderueshme. Rreth 6.7 % e rrjetit ose rreth 80 koka ndriçimi nuk funsionojnë gjatë orarit të punës. Zonat në të cilat rrjeti i ndriçimit publik nuk funksinon janë 4:

- Zona e ish-furrës së bukës, rruga që të çon në drejtim të fshatit Perondi (7 koka ndriçimi jashtë funksionimit)
- Rruga nga ura e lumit Devoll deri në qendër të fshatit Kozarë (41 koka ndriçimi jashtë funksionimit)
- Aksi rrugor tek këndi i lojërave për fëmijë (6 koka ndriçimi jashtë funksionimit)
- Aksi rrugor për në fshatin Gegë (26 koka ndriçimi jashtë funksionimit)

Përsa i përket amortizimit të ndriçimit rrugor, ekzistojnë rreth 11 akse rrugore të tilla, të cilat i përkasin rrjetit rrugor sekondar dhe terciar. Këto akse janë në lagjet 1 Maji, 11 Janari dhe Llukan Prifti. Në këto akse ndriçuesit janë të vendosur në shtyllat e betonit që mbajnë rrjetin elektrik ajror dhe janë në pronësi të OSHEE Kuçovë. Arsyeja kryesore e mosfunksionimit të disa segmenteve të rrjetit të ndriçimit është dëmtimi i kabllit kryesor lidhës i rrjetit rrugor, por edhe mungesa e investimeve të vazhdueshme në këtë fushë.

Statisitikat mbi kostot, të ardhurat, buxhetin, si dhe sasinë e energjisë për ofrimin e shërbimit të ndriçimit publik:

Tabela 67. Kostot e energjisë elektrike dhe raporti me kostot totale të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Kostot e energjisë elektrike në 000 lekë	8,800	10,200	9,600	10,322	12,529	11,553
% e kostove të energjisë elektrike ndaj totalit	82.33%	72.35%	79.74%	80.82%	79.59%	77.62%
Kostot totale në lekë	10,689	14,099	12,039	12,771	15,741	14,885

Burimi: Bashkia Kuçovë, 2016

Kostot kryesore të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik janë kostot e energjisë elektrike. Në raport me kostot totale ato variojnë nga 72.4% në 82.3%. Në vitin 2010 kostot e energjisë përbëjnë rreth 82.3% të kostove totale, që do të thotë se kostot operative ose kostot për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit janë më të ulëta se në vitet e tjera. Në vitin 2011 kostot e energjisë përbëjnë 72.35% në raport me kostot totale. Në vitet 2012, 2013 dhe 2014 kostot e energjisë elektrike tentojnë të jenë rreth 80% në raport me kostot totale, kurse në vitin 2015 përbëjnë 77% të kostove totale.

Sa më e vogël të jetë përqindja e kostove të energjisë në raport me kostot totale, aq më të mëdha do të jenë mundësitë për të patur investime dhe më shumë fonde do t'i dedikohen mirëmbajtjes së rrjetit dhe, për rrjedhojë, do të kemi një shërbim më të mirë dhe më cilësor të ndriçimit publik.

Tabela 68. Të ardhurat totale dhe raporti me kostot totale të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015

Të ardhurat totale në 000 lekë	1979	1342	1895	3482	5209	4570
% e të ardhurave totale ndaj kostove totale	18.51%	9.52%	15.74%	27.26%	33.09%	30.70%
Kostot totale në 000 lekë	10689	14099	12039	12771	15741	14885

Burimi: Bashkia Kuçovë, 2016

Në tabelën e mësipërme vërehen të ardhurat kryesore në raport me kostot kryesore të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik. Të ardhurat totale variojnë nga 9.5 % deri në 33.1% të kostove totale. Në vitin 2010 të ardhurat janë sa 18.5% e kostove totale, në vitin 2011 kemi një rënie prej 9%, në vitin 2012 kemi një rritje prej 7%, në vitin 2013 kemi një rritje prej 12%, në vitin 2014 kemi një rritje me 6%, ndërsa në vitin 2015 kemi një rënie prej 3%. Këto të dhëna tregojnë qartë që tarifat për ndriçimin publik mblidhen në një nivel mjaft të ulët si nga familjarët, ashtu edhe nga institucionet dhe bizneset, por vitet e fundit vërehet një përmirësim i kësaj situate. Kostot e tjera të ofrimit të shërbimit bashkitë ose komunat i mbulonin nga buxheti i akorduar nga pushteti qendror.

Tabela 69. Të ardhurat totale dhe raporti me kostot e energjisë elekrike të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të ardhurat totale në 000 lekë	1,979	1,342	1,895	3,482	5,209	4,570
% e të ardhurave totale ndaj kostove të energjisë	22.49%	13.16%	19.74%	33.73%	41.58%	39.56%
Kostot e energjisë elektrike në 000 lekë	8,800	10,200	9,600	10,322	12,529	11,553

Burimi: Bashkia Kuçovë, 2016

Tabela e mësipërme tregon raportin ndërmjet kostove të energjisë elektrike dhe të ardhurave të përgjithshme të mbledhura nga tarifat vendore për ndriçimin publik. Si në tabelën 2, paraqitet gati e njëjta situatë. Nga këto të dhëna vërehet se niveli i pagesës së tarifës së ndriçimit është mjaft i ulët, por në vitet e fundit kemi rritje të kosiderueshme. Gjithashtu, niveli i arkëtimit të tarifës së ndriçimit duhet të rritet më tej, në mënyrë që diferenca ndërmjet kostove dhe të ardhurave të minimizohet sa më shumë.

1.7.4 Mbetjet e ngurta

- **Menaxhimi i mbetjeve në bashkinë e Kuçovës**

"Menaxhimi i integruar i mbetjeve" është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve, si edhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.[322]

Në zbatim të ligjit, Bashkisë Kuçovë i lind nevoja për të përditësuar "Planin vendor të Menaxhimit të mbetjeve", ku do të përfshijë mbulimin e të gjithë territorit të saj sipas RT[323]-së.

Aktualisht Bashkia Kuçovë ofron shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta për 87.5%[324] të popullsisë së bashkisë së Kuçovës (NjA Kozarë, Lumas & Perondi). Me menaxhim të mbetjeve nënkuptohet grumbullimi i mbetjeve të ngurta nga pikat e grumbullimit të mbetjeve, shpërndarë në funksion të dendësisë së popullatës dhe aktiviteteve private e shtetërore, transportimi i tyre drejt vend-depozitimit, si edhe stokimi i tyre përfundimtar.

Më poshtë paraqitet një përshkrim i menaxhimit të mbetjeve urbane të ngurta, ku përfshihen edhe inertet, edhe mbetjet e rrezikshme (mbetjet industriale, spitalore) në bashkinë e Kuçovës.

- **Mbetjet e ngurta urbane**

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë Kuçovë ofrohet nga firma private "Higjiena", e cila bën grumbullimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit dhe depozitimin e tyre në venddepozitimin e mbetjeve që ndodhet përgjatë brigjeve të lumit Devoll, në Rreth Tapi, në një largësi 5.5 km nga qyteti i Kuçovës, i cili funksionon që prej vitit 1987. Në këtë venddepozitim mbetjet shpeshherë ngjeshen dhe mbulohen me dhè, por ai është plotësisht i papërshtatshëm, pasi toka në këtë zonë është shumë aluvionale dhe mbetjet e lëngshme toksike (*shllamet*) depërtojnë lehtësisht në shtresat e nëntokës, duke shkaktuar ndotje jo vetëm në shtresat nëntokësore, por edhe në ujërat nëntokësore, si edhe në ujërat sipërfaqësore të lumit. Përpos fakteve të sipërpërmendura, derdhje direkte shkaktohen edhe në rrjedhën natyrale të lumit Devoll. Pika ku takohet lumi Osum me lumin Devoll duke u bashkuar në Seman me venddepozitimin e mbetjeve në vijë ajrore është rreth 2,7 km. Impakti në mjedis i këtij venddepozitimi qartësisht ka një shtrirje shumë më të madhe, pasi përhapja e elementeve ndotëse, toksike dhe të dëmshme përcillet nga rrjedha e lumit Devoll dhe Seman.

Aktualisht, në territorin e NjA Kuçovë janë të vendosur në pika grumbullimi 240 kontenierë 1.1 m^3 dhe ofrimi i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve kryhet çdo ditë. Në bashkëpunim me USAID-in dhe organizatën Assist Impact është hartuar një studim fizibiliteti për ndarjen e mbetjeve në burim. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet edhe në njësitë administrative Perondi e Kozarë[325].

Bashkia Kuçovë ka planifikuar tarifë pastrimi për konsumatorët familjarë, e cila është 1,400 lekë/vit, ndërsa për familjet në nevojë, invalidët, pensionistët, veteranët e luftës, kjo tarifë është 400 lekë/ vit. Sipas të dhënave të marra nga bashkia, niveli i arkëtimeve gjatë vitit të fundit ka qenë rreth 86%.

Figura 141. Venddepozitimi i mbetjeve urbane në bashkinë e Kuçovës



Burimi: Bashkia Kuçovë & Co-Plan; 2016

Gjatë vitit 2015, bashkia Kuçovë ka prodhuar rreth 8,230 ton mbetje/vit[326], me një sasi prodhimi prej **0.4 deri në 0.717 kg/banor/ditë** *(ndryshimi midis zonës urbane dhe asaj*


rurale). Sasia e mbetjeve të prodhuara ka ardhur duke u rritur nga viti në vit (tabela e mëposhtme). Nga një krahasim i bërë për periudhën kohore 2003-2015 rezulton se sasia e mbetjeve të prodhuara nga viti 2003 në vitin 2012 ka një tendencë rritjeje të ekuilibruar, ku maksimumi i gjenerimit ka qenë viti 2012, ndërsa në vitin 2015 regjistrohet rënie konstante e sasisë totale të gjeneruar për banor. Për më tepër, që prej vitit 2009 Kuçova ruan një tendencë gjenerimi mbetjesh mbi mesataren e sasisë së podhuar në rang vendi.

Tabela 70. Sasia e mbetjeve urbane të prodhuara në bashkinë Kuçovë dhe në rang vendi

Mbetjet urbane Kuçovë – Projeksion (ton/banor.vit)						
Viti	**2003**	**2006**	**2009**	**2012**	**2014**	**2015**
Kuçovë	0.15	0.307	0.303	0.513	0.367	0.262
Sasia mesatare e mbetjeve të prodhuara në rang vendi.	0.118	0.241	0.292	0.392	0.253	0.235

Burimi: Instat & ARM Berat

Figura 142. Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve urbane në bashkinë e Kuçovës



Burimi: Instat & ARM Berat

Për sa i përket venddepozitimit të mbetjeve në Bashkinë Kuçovë, pasi grumbullohen, mbetjet urbane depozitohen në venddepozitimin përballë fshatit Kozarë në brigjet e lumit Devoll, fare pranë vendit ku bashkohet me lumin Osum. Gjithashtu, depozitimet e mbetjeve bëhen në pika të paligjshme, ku shërbimi nuk ofrohet (si në rastin e NjA Lumas ku mbetjet inerte nuk kanë një destinacion të përcaktuar). Më konkretisht, mbetjet e bashkisë Kuçovë depozitohen në venddepozitimin e mbetjeve në NjA **Perondi**, i cili ndodhet rreth **2km larg nga rruga kombëtare** dhe **2.5km** larg nga qendra e qytetit. Ky venddepozitim është vënë në funksionim që në vitin 1990 dhe është jashtë çdo kushti teknik dhe higjieno-sanitar. Në këtë venddepozitim, pasi depozitohen, mbetjet mbulohen me dhe e më pas ngjeshen nga makineritë e transportit të mbetjeve.

Venddepozitimi paraqet probleme të mëdha për sa i përket ndotjes së mjedisit dhe rrezikimit të shëndetit të banorëve për arsye të ndryshme. Së pari, ai ndodhet buzë lumit Devoll, në një largësi jo më tepër se **120m nga shtrati i lumit,** duke ndotur vazhdimisht ujërat sipërfaqësore të lumit Devoll. Për më tepër, pozicioni në të cilin ndodhet

venddepozitimi i Perondisë është i papërshtatshëm nga ana gjeologjike për shkak se ndodhet në një territor me dhera të shkrifëta.

Duke patur referencë hartat dhe raportet e SHGJSH-së[327], i gjithë akuiferi i rrjedhës së lumit Devoll në bashkinë Kuçovë është me përbërje aluvionale (zhavorrore dhe poroze). Një terren i tillë bën të mundur depërtimin e shllamit të mbetjeve në ujërat nëntokësore dhe më tej në ujërat e akuiferit të Semanit, i cili mund të përdoret për furnizimin me ujë të popullsisë Fier, Lushnje dhe të zonave përreth, si edhe për vaditjen e tokave bujqësore. Me pak fjalë, lëndët toksike që çlirohen gjatë procesit të shpërbërjes së mbetjeve në venddepozitim depërtojnë drejtpërsëdrejti në ujërat nëntokësore të akuiferit të Beratit duke rrezikuar shëndetin e popullsisë së zonës, si dhe duke ndotur Devoll - Seman dhe tokën përreth. Ndotja është edhe më e theksuar në kohë reshjesh, të cilat përshpejtojnë depërtimin e ujërave sipërfaqësore në akuiferin e Be

ratit.

Ndotje shkaktohet edhe nga çlirimi i gazrave toksike (metani CH_4) si produkt i proçesit të kompostimit të shtresave më të vjetra të mbetjeve organike dhe jo vetëm. Ky produkt kimik, në formën e tij të gaztë mund të kapej me anë të skemave të rikuperimit dhe të përpunohej e të ofrohej si një LDG (lëndë djegëse gaz) për të prodhuar energji elektrike ose mekanike.

Në rastin e venddepozitimit Kuçovë, gazi metan çlirohet i gjithi në atmosferë, duke kontribuar si gaz i efektit serë dhe duke ndotur me aromën e tij të fortë.

Figura 143. Ndryshimet vizuale të hapësirës së përdorur nga venddepozitimi në harkun kohor 2003-2015



Burimi: Bashkia Kuçovë & Co-Plan; 2016

Ky venddepozitim, duke mos përmbushur kriteret teknike të projektimit dhe funksionimit, nuk ka status ligjor si landfill, ndaj edhe ndërhyrja urgjente për rehabilitimin e kësaj sipërfaqeje dhe ndalimin e aktivitetit të depozitimit të mbetjeve paraqitet tepër urgjente. Një aspekt tjetër tejet i rëndësishëm është fakti se venddepozitimi i Rreth Tapi - Perondi ndodhet afër segmentit të lumit Devoll (ku bashkohet me lumin Osum) që shërben si burim ushqimi për akuiferin e Beratit. Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi[328], të gjitha zonat e lumit që shërbejnë si burim ushqyes për akuiferet (dritaret hidrogjeologjike) duhen mbrojtur me ligj.

Gjithashtu, në bazë të ligjit pët landfillet[329], është e nevojshme që ky venddepozitim t'i nënshtrohet një plani rehabilitimi dhe vetëmonitorimi periodik për të raportuar në ARM Berat, e cila, më pas, do të kryejë verifikimet e nevojshme.

Gjithashtu, nëpërmjet fotove ajrore, janë vënë re ndryshime në shtratin dhe regjimin e rrjedhës së lumit Devoll në vite. Këto ndryshime të forta në regjimin e rrjedhës së Osumit kanë ndryshuar edhe mikrotipologjinë e truallit ku ndodhet ky venddepozitim brenda një harku kohor 5-15-vjeçar. Sot, mund të themi se një pjesë e venddepozitimit të hershëm gjendet e përmbytur ose e eroduar nga shtrati aktual i lumit Devoll. Përveç ndotjes së ujit, venddepozitimi paraqet probleme edhe në lidhje me ndotjen e ajrit për shkak të djegies së mbetjeve plastike që kryhet në këtë zonë.

Ndërkohë, në bashkëpunim me USAID dhe ASSISTIMPACT, është hartuar një studim fizibiliteti për ndarjen e mbetjeve në burim.

Figura 144. Foto nga venddepozitimi i mbetjeve në Rreth Tapi, Perondi – Bashkia Kuçovë



Burimi: Raporti i fizibilitetit mbi menaxhimin e mbetjeve – Bashkia Kuçovë 2014

Si përfundim, mund të thuhet se venddepozitimi i Rreth Tapi-së është një vatër e nxehtë mjedisore që rrezikon shëndetin e banorëve (Kuçovë, Fier, Lushnje etj.) dhe ndotjen aktive të lumit Seman.

Për këtë arsye, lipset mbyllja ose ndërhyrja emergjente në të sipas kërkesave të përgjithshme të ligjit në fuqi[330], i cili u kërkon operatorëve të venddepozitimeve, të pajisur apo jo me leje, që t'i mbyllin këto venddepozitime brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi janë jashtë kushteve higjieno- sanitare, ose të marrin masa për të realizuar ndërhyrjet e listuara në aneksin 1 brenda 8 viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- **Mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe shkatërrimi)**

Gjatë vitit 2015, Bashkia Kuçovë ka prodhuar një sasi mbetjesh prej 3,650 m^3/vit[331] , të krijuara nga ndërtimet, rikonstruksionet, si dhe prishjet e objekteve pa leje. Deri më sot, Bashkia nuk ka përcaktuar një vend-depozitim të posaçëm për depozitimin e mbetjeve inerte.

Shpesh, pjesa më e madhe e mbetjeve inerte është përdorur për të mbushje të ndryshme ndërsa më së shumti ato janë shkarkuar jashtë çdo kriteri përgjatë brigjeve të Lumit Devoll duke ndikuar në argjinaturë si edhe në ngushtimin apo ngritjen e nivelit të shtratit të lumit, i cili ka forcuar efektet e tij eroduese në seksione të tjera përgjatë rrjedhës.

Megjithatë, në disa raste, mbetjet inerte depozitohen në vend-depozitimin e mbetjeve urbane, qoftë si shtresë mbuluese apo të vendosura pirg në pjesën kufijtare të tij. Rasti i


ilustruar në foton e mësipërme paraqet situatën në hyrje të fshatit Lumas, ku mbetje inerte janë depozituar qoftë nga shkarkimet e banorëve, por edhe nga prurjet inerte të lumit duke krijuar një zonë të gjerë grumbulli inertesh.

Zonë problematike në lidhje me mbetjet urbane dhe inerte në qytetin e Kuçovës është qendra e qytetit ku në formën e gërmadhave të braktisura paraqitet situata e ish-Uzinës së Naftës.

Zona ripariane e anëve të lumit dikur e mbjellë me pemë dhe vegjetacion mbrojtës, sot është thuajse tërësisht e zhveshur nga vegjetacioni mbrojtës dhe e zëvendësuar nga masive inertesh ose mure mbajtëse b/a.

Këto ndërhyrje nuk e kanë ndaluar erozionin anësor të lumit, veçse e kanë zhvendosur atë në seksione të tjera më të ndjeshme ku janë identifikuar humbje të tokës bujqësore.

Figura 145. Grafiku i gjenerimit të mbetjeve urbane në vite në bashkinë Kuçovë krahasuar me mesataren në Republikën e Shqipërisë



Burimi: INSTAT; Punoi: Co-PLAN,2016

Zonë problematike në lidhje me mbetjet urbane dhe inerte në qytetin e Kuçovës është qendra e qytetit ku në formën e gërmadhave të braktisura paraqitet situata e ish-Uzinës së Naftës.

Zona ripariane e anëve të lumit, dikur e mbjellë me pemë dhe vegjetacion mbrojtës, sot është thuajse tërësisht e zhveshur nga vegjetacioni mbrojtës dhe e zëvendësuar nga masive inertesh ose mure mbajtëse b/a.

Këto ndërhyrje nuk e kanë ndaluar erozionin anësor të lumit, veçse e kanë zhvendosur atë në seksione të tjera më të ndjeshme ku janë identifikuar humbje të tokës bujqësore.

- **Mbetjet spitalore**

Në rang qarku, sipas të dhënave të grumbulluara nga ARM Berat, sasia totale e mbetjeve spitalore të prodhuara në qarkun Berat është 35,848 kg/vit[332]. Kjo sasi përfshin mbetjet e prodhuara nga spitalet, qendrat shëndetësore, si dhe laboratorët stomatologjikë dhe mjekësorë.

Mbetjet spitalore menaxhohen nga dy kompani private (Euro-Team dhe Medi-Tel, dy subjektet që kanë lidhur kontrata me subjektet të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit mjekësor), të cilat i tërheqin mbetjet periodikisht sipas kontratës së lidhur me subjektet përkatëse. Kompania Euro-Team ofron shërbimin e sterilizimit dhe grirjes së mbetjeve spitalore dy herë në javë. Kjo mënyrë e trajtimit të këtyre mbetjeve zvogëlon vëllimin e tyre me anë të shpërbërjes mekanike për t'i administruar më pas mbetjet si urbane, jo të rrezikshme për komunitetin dhe mjedisin.

Nga të gjitha njësitë e mësipërme, Euro-Team trajton mbetjet e spitalit rajonal të Beratit e Kuçovës, ndërsa Medi-Tel grumbullon mbetjet e njësive të tjera shëndetësore (poliklinika, qendra shëndetësore të NjA-ve, laboratore, klinika etj.). Situata e menaxhimit të mbetjeve spitalore në bashkinë Kuçovë monitorohet vazhdimisht nga Agjensia Rajonale e Mjedisit Berat, si edhe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Tabela 71. Prodhuesit e mbetjeve spitalore

Subjektet	Numri i subjekteve	Sasia (kg/vit)	Kompania që menaxhon mbetjet	Leje mjedisi
Spitali Kuçovë	1	1,200	Euro Team	Me leje mjedisi
D.SH.P Kuçovë	1	24	Medi-Tel	Pa leje mjedisi
Qendra shëndetësore	4	2,004	Medi-Tel	Pa leje mjedisi
Laboratorë mjekësorë	2	1,120	Medi-Tel	Me leje mjedisi
Klinikë mjekësore	1	156	Medi-Tel	Me leje mjedisi
Laboratorë mjeksorë	5	1,120	Medi-Tel	Me leje mjedisi
Kabinete stomatologjike	27	1,116	Medi-Tel	Proces

Burimi: ARM Berat

Një pjesë e subjekteve konfirmojnë se nuk prodhojnë sasi të konsiderueshme mbetjesh, duke qenë se furnizimet e tyre janë në sasi të vogla e, si rrjedhojë, nuk u mbeten mbetje për trajtim.[333] Sipas ARM-së Berat, të gjitha subjektet me aktivitet depo farmaceutike në qarkun Berat, të pajisura me leje mjedisi, janë me pakicë. Për subjektet që kanë pohuar se nuk kanë leje mjedisore, menaxhimi i mbetjeve që ato prodhojnë mbetet i pamonitoruar nga organizmat shtetërorë, pasi ato nuk i nënshtrohen proçesit të vetëmonitorimit.

- **Mbetjet industriale**

Në bashkinë Kuçovë ushtrojnë aktivitetin e tyre biznese të ndryshme në fushën e ndërtimit, agro-ushqimore etj, por në këtë zonë mbizotëron kryesisht industria e naftës. Sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve industriale, bizneset duhet të mbajnë regjistrin e mbetjeve të prodhuara. Megjithatë, deri më sot nuk ka të dhëna rreth sasisë së prodhuar të mbetjeve industriale në bashkinë Kuçovë.

Në të gjithë zonën naftëmbajtëse ka ndotje të tokës, ujit dhe ajrit, për pasojë ndotja ka ndikimin e vet në shëndetin e banorëve, në bujqësi, blegtori (kafshë dhe shpendë) e deri

tek drurët apo bimët natyrale. Për shkak të tejzgjatjes së përdorimit të një teknologjie të vjetëruar dhe mungesës së investimeve, 1/3 e sipërfaqes së vendburimeve të naftës rezulton të jetë e ndotur nga nafta bruto.

Në shkarkimet ujore vëmë re një prani të lartë të klorureve, fenolëve dhe naftës bruto që derdhen nëpër kolektorin kryesor të ujërave të zeza apo kanaleve të tjera dhe përfundojnë në lumin Devoll dhe Osum. Niveli i fenolëve në shkarkim të lumit Devoll arrin në 2mg/l, i klorureve 20.000-50.000 mg/l, ndërsa niveli i naftës bruto në 40-90 mg/l.

Një burim tjetër i ndotjes industriale është edhe ndërrimi apo grumbullimi i vajrave të makinave, të cilat mund të përdoren si lëndë djegëse. Ato lehtësisht mund të derdhen në tokë dhe në sipërfaqe dhe më pas të përfundojnë në lumë duke dëmtuar biodiversitetin dhe ekosistemin.

Figura 146. Mbetje të lëngëta industriale nga pusi i naftës



Burimi: Arkiva Co-PLAN

Duhet theksuar se aktiviteti i nxjerrjes së naftës gjeneron mbetje të rrezikshme dhe, si i tillë, ky sektor duhet të jetë subjekt i trajtimit të këtyre mbetjeve në bazë të ligjit 10463, datë 22.09.2011, ku cilësohet se këto mbetje duhet të monitorohen, të regjistrohen dhe të transportohen rigorozisht, siç përshkruhet në ligj.

Më poshtë paraqitet lista ekzistuese e aktiviteteve gjeneruese të këtyre mbetjeve në bashkinë Kuçovë, të cilat janë të pajisura me leje mjedisore.

Tabela 72. Aktivitete qe prodhojnë mbetje industriale (sipas lejeve mjedisore)

AKTIVITETE GJENERUESE TË MBETJEVE NË BASHKINË KUÇOVË - SIPAS LEJEVE QË ZOTËROJNË						
	Aktiviteti	Vendndodhja	Subjekti	Kategori Katalogu	Tipi i mbetjeve të gjeneruara	Tipi i lejes
1	HEC Belesova I	Belesove- Lumas	Korkis-2009	20 & 17	Mbetje urbane & mbetje nga ndërtimet dhe prishjet	A
2	HEC Belesova II	Belesove- Lumas	Korkis-2009	20 & 17	Mbetje urbane & mbetje nga ndërtimet dhe prishjet	A
3	HEC	Berat	Salillari	20 & 17	Mbetje urbane & mbetje nga ndërtimet dhe prishjet	A
4	Ritje intensive e shpendëve në instalim, ambalazhim, magazinim, tregtim dhe import-eksport edhe të nënprodukteve të tyre	Perondi	Luma sh.p.k	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme & mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkimet që lidhen me to	B
5	Fabrikë për prodhimin e membranave bituminoze (letër katrama)	Kuçovë	ENARVI	6, 5, 4	Mbetje të dala nga rafinimi i naftës, pastrimi i gazit natyror dhe trajtimet pirolotike të karbonit. Mbetje të kimisë minerale dhe nga procese të kimisë organike	B
6	Prodhim- përpunim çimentoje	Kozarë	Construction	1 , 16 , 17	Mbetje nga shfrytëzimi i karrierave, mbetje inerte & mbetje të paspecifikuara	B

Burimi: ARM Berat

Legjendë orientuese	
Mbetje organike	
Mbetje inerte	
Mbetje industriale	

Burimi:ARM Berat

- **Vajrat e përdorura**

Vajrat e përdorura përbëjnë elemente ndotjeje për mjedisin në rast se nuk menaxhohen siç duhet. Në bashkinë Kuçovë dhe në rang qarku sasia e vajrave të përdorura nuk njihet për shkak se subjektet prodhuese nuk mbajnë regjistra per shitjen e vajrave, gjë që tregon se sasia vjetore e vajrave të përdorura nuk është e saktë.[334]

Mgjithatë, sipas ARM-së Berat, sasia e vajrave të gjeneruara është rreth 6,400 l/vit. Nga verifikimet në terren që janë bërë kohët e fundit rezulton se subjektet e pajisura me leje mjedisi (7 të tilla) që prodhojnë vajra të tilla kanë lidhur kontratë me firma të licencuara që bëjnë tërheqjen e vajrave në mënyrë periodike. Mbetet ende e pasaktë sasia e vajrave të përdorura që nuk riciklohet dhe që përfundon në mjedis.

- **Industria e nxjerrjes dhe e përpunimit të naftës**

Në përgjithësi, e gjithë zona naftëmbajtëse e Kuçovës, për shkak edhe të historikut të veprimtarisë industriale në atë zonë, bart ndotje të lartë sa i përket shkarkimeve të naftës bruto dhe metaleve të rënda të përhapura në sipërfaqe të mëdha toke.

Aktualisht, problemi që ngrihet nga banorët dhe organizatat[335] me profil mjedisor të cilat veprojnë në qarkun e Beratit ka të bëjë me aktivitetin e industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të naftës.

Teknologjitë e përdorura në këtë industri, si edhe investimet që janë realizuar në këtë sektor nuk duket të kenë patur impakt pozitiv në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në këtë zonë. Uzina e Përpunimit të Naftës - UPN tashmë ka reduktuar aktivitetin e saj dhe niveli i ndotjes në ajrin e Kuçovës ka një përmirësim cilësor. Impianti është mbyllur pasi ai ishte ndotësi më i madh në këtë qytet duke shkarkuar nivele të larta të H_2F-së, SO_2-shit. Gjithashtu, gazrat e H_2S-së kanë qenë tepër acide. Bazuar në faktin që faktori gazor është ende shumë i lartë, 29.3 nm3 /m3, instalimi i stacioneve të separatorëve me disa shkallë ndarjeje do të mundësojë kapjen e gjithë kësaj sasie dhe, më pas, tregtimin e tij, duke e bërë kështu procesin fitimprurës.

Për shkak të numrit të madh të puseve në bashkinë e Kuçovës, ku mendohet se në total ekzistojnë rreth 1800 puse ku rreth 1099 janë puse aktive dhe rreth 701 nuk e kryejnë funksionin e tyre. Duke vlerësuar paraprakisht sipërfaqen që zë çdo pus nafte, mund të themi se dheu i ndotur me naftë zë një vëllim prej 500.000 m^3.

Zona e 3 puseve të ujit, veçanërisht në stacionin e Devollit, ka qenë përdorur intensivisht nga aktiviteti industrial, i cili ka akumuluar ndotje të lartë në ujërat nëntokësore, duke e kthyer atë të papërdorshëm për furnizimin e popullatës me ujë. E njëjta gjë ka ndodhur më pas edhe me ujërat nëntokësore të Çiflikut dhe Drizës.

Figura 147. Mbetje përreth pusit të naftës dhe shkarkime në kanalet kulluese - Kuçovë



Burimi: Arkiva Co-PLAN

Shkarkimet e llumrave të naftës vlerësohen të jenë rreth 74 tonë/vit. Vlerat e disa prej parametrave më të rëndësishme janë pH=8.3, NKO=4.8 mg/l, NBO=40 mg/l, përmbajtja e fosfateve 0.5 mg/l dhe përmbajtja e NH_4 0.3 mg/l. Efektet e kësaj ndotjeje janë shtrirë edhe në lumin Seman e, përmes tij, deri në bregdetin e Adriatikut (Seman, Darëzezë e Re).[336]

Ish-zona e UPN-së në hyrje të qytetit i është nënshtruar një studimi në kuadër të hartimit të një projekti rehabilitimi në të cilin janë parashtruar analizat specifike që paraqesin nivelet e ndotjes në tokë, ajër dhe në ujërat nëntokësore, si edhe sugjerimet mbi metodat e ndryshme të rehabilitimit të kësaj zone.

Figura 148. Ish-zona e UPN-së & Projekti i Rehabilitimit



Burimi: Kooperimi për Zhvillim nga R.Çeke, "Raporti i fizibilitetit"

Kooperimi për Zhvillim nga Republika Çeke ka hartuar një projekt të detajuar mbi mundësinë e rivitalizimit të ish-UPN që është një zonë e cila ka problemetikë serioze ndotjen mjedisore, duke inkorporuar trajtimin e të gjithë ndotësve të identifikuar në këtë zonë. Gjithashtu, është menduar që në një pjesë të kësaj hapësire që do i nënshtrohet rehabilitimit të ndërtohet një inçernerator për mbetjet e ngurta të bashkisë së Kuçovës dhe jo vetëm. Kjo iniciativë bie disi ndesh pasi zonat e banuara, në këtë rast, janë shumë pranë këtij inçerneratori, ndaj edhe çdo hap i mëtejshëm për planifikimin dhe projektimin e tij duhet të parashikojë alternativa të tjera lidhur me pozicionin, si edhe procesin teknologjik të djegies së mbetjeve dhe emetimit të gazrave kanceroze (dioksin & furane).

- **Riciklimi**

Për sa i përket riciklimit të mbetjeve, në bashkinë e Kuçovës është realizuar një studim i dedikuar ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve, ndaj edhe një shifër e përafërt mbi sasinë e mbetjeve të ricikluara i përafrohet masës 23% ndaj totalit të mbetjeve të riciklueshme të gjeneruara.

Riciklimi ndodh nëpërmjet subjekteve vendase si kompania që ofron shërbimin e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve dhe një kompani e cila operon në vendepozitimin e mbetjeve në Orizaj.[337]

Plani për ndarjen e mbetjeve urbane që në burim për bashkinë e Kuçovës parashikon edhe ndërtimin e qendrës për trajtimin e mbetjeve për riciklim të përftuara nga procesi i ndarjes në burim, që përbën një hallkë të rëndësishme në procesin e riciklimit. Mbetjet e ndara që në burim do të transportohen në këtë ambient për të bërë trajtimin e mëtejshëm, i cili përfshin[338]:

- Një seleksionim të mëtejshëm të mbetjeve sipas natyrës dhe pastërtisë së tyre;
- Zvogëlimin e volumit nëpërmjet prerjes, shtypjes apo presimit;
- Paketimin/paletimin e tyre (sipas natyrës, letër, plastike, metal) dhe përgatitjen për tregtim në impiantet e riciklimit.

Mbetjet e riciklueshme të ndara që në burim pritet të jenë më të pastra duke siguruar uljen e kostove të cilat shkaktohen nga trajtimi i tyre i mëtejshëm. Sot impiantet e riciklimit janë shumë të interesuara që mbetjet e riciklueshme të jenë të pastra, sepse kjo rrit cilësinë dhe ul firot. Kjo iniciativë është paraqitur bashkë me një plan biznesi i cili tregon se kjo iniciativë është rentabël.

Referuar Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, krahas planit për riciklimin e mbetjeve të cilat klasifikohen si lehtësisht të riciklueshme, Bashkia Kuçovë

duhet të hartojë një plan të dedikuar për menaxhimin dhe riciklimin e mbetjeve elektronike, inerte dhe industriale. Krahas këtij detyrimi, si objektiv mbetet riciklimi i mbetjeve organike, qelq, letër & plastike në masën 75-80% përkundrejt totalit të gjeneruar, kjo për një periudhë kohore deri në 2018.

1.7.5 Sistemi i kullimit dhe i ujitjes

Ky seksion analizon vlerësimin e gjendjes ekzistuese të infrastrukturave të bujqësisë në bashkinë Kuçovë. Me infrastrukturë bujësore kuptojmë tërësinë e rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese sipas kategorisë, si dhe të gjitha veprat inxhinierike me funksion të bujqësisë, dhe këtu mund të përmendim argjinaturat, rezervuaret ujitëse, digat, stacionet e pompimit dhe hidrovoret.

Mënyra e funksionimit të infrastrukturave bujqësore: Infrastruktura bujqësore kryesisht përbëhet nga rrjeti i kanaleve që ndahen në kanale vaditëse dhe kulluese. Kanalet vaditëse shërbejnë për të bërë shpërndarjen e ujit të domosdoshëm në parcelat bujqësore. Kanalet vaditëse i kemi të tri kategorive: kanale të para, të dyta dhe të treta. Kanalet e para janë kanalet kryesore të cilat e çojnë ujin nga rezervuarët drejt tokave të cilat do të vaditen më pas. Shpërndarja e ujit kalon nga kanalet e para në të dyta dhe, në fund, në kanalet e treta.

Kanalet kulluese janë kanalet që bëjnë mbledhjen e ujit të tepërt të parcelave bujqësore dhe e çojnë atë drejt lumenjve, liqeneve ose detit. Këto kanale janë po aq të rëndësishme, sepse mbrojnë tokën bujqësore nga përmbytjet. Kanalet e treta kulluese mbledhin ujin nga parcelat e vogla dhe e çojnë në kanalet sekondare ose të dyta e, më pas, në kanalet kryesore që e çojnë ujin në lumenj ose në dete.

Argjinaturat janë një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës bujqësore, sepse bëjnë mbrojtjen e tokave bujqësore nga vërshimet e lumenjve. Gjithashtu, rezervuarët janë vendepozitimet e ujit të cilat janë të lidhura kryesisht me kanalet kryesore vaditëse dhe shërbejnë si ushqyes kryesorë të ujit me të cilin vaditen tokat bujqësore.

Korniza ligjore mbi kullimin dhe vaditjen: Korniza ligjore mbi administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturës bujqësore shërben për të kuptuar kompetencat e institucioneve të ndryshme mbi administrimin e kësaj infrastrukture. Ligji kryesor që tregon mbi administrimin dhe menaxhimin institucional dhe përcakton të gjitha direktivat ligjore mbi infrastrukturën bujqësore është ligji nr. 8518, datë 30.7.1999, " Për kullimin dhe vaditjen".

Më zhvillimin e reformës territoriale-administrative edhe menaxhimi institucional i një pjese të infrastrukturës bujqësore ka ndryshuar. Këto ndryshime ligjore mbi kompetencat institucionale i paraqesin dy VKM: VKM-ja nr. 691, datë 29.07.2015, "Për miratimin e strategjisë për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020" dhe VKM-ja nr. 1108, datë 30.12.2015, "Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave tek bashkitë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit". Ligjet që sapo përmendëm tregojnë administrimin institucional dhe menaxhimin e infrastrukturës bujqësore si më poshtë:

- **Ligji nr. 8518, datë 30.7.1999, "Për ujitjen dhe kullimin", i ndryshuar me ligjin nr. 9860, datë 21.01. 2008.** Ky ligj përcakton Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit

Rural dhe Administrimit të Ujërave si organin kryesor përgjegjës për administrimin e ujitjes dhe kullimit.

Menaxhimi i skemave të kullimit dhe të vaditjes bëhet nga njësi më të vogla që janë Bordet e Kullimit, të cilat ndodhen në çdo qark me përjashtim të Lushnjes, që ka bord kullimi të veçuar.

Në nenin 56, në pikën ç) përcaktohen distancat e ndërtimit të objekteve në raport me infrastrukturën bujqësore (kanalet vaditëse dhe kulluese). Distanca minimale që lejon ligji në raport me kanalet kryesore është 8 metra dhe distanca minimale që lejon ligji në raport me kanalet dytësore dhe tretësore është 4 metra.

Bordet e kullimit janë struktura teknike të specializuara në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

- **Vendim i Këshillit të Ministrave nr.691, datë 29.07. 2015, "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020".** Thuhet se kjo strategji hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për zbatimin e këtij vendimi legjislativ ngarkohen ministri i Çështjeve Vendore, ministritë, institucionet qendrore dhe njësitë e pushtetit vendor të përmendura në tekstin e kësaj strategjie.

  Në këtë strategji thuhet se në fushën e infrastrukturës së bujqësisë bashkive do t'u shtohet si funksion i ri administrimi dhe menaxhimi i rrjetit dytësor dhe tretësor.

- **Vendim i Këshillit të Ministrave nr.1108, datë 30.12.2015, "Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave tek bashkitë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit".** Në këtë vendim thuhet se bashkive u transferohet e drejta e menaxhimit dhe e administrimit të infrastrukturës bujqësore dytësore dhe tretësore, aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe makinerive të rënda nga Bordet e Kullimit tek bashkitë në territorin e të cilave ndodhen këto infrastruktura.

Analiza e argjinaturave dhe e rezervuarëve ujitës të bashkisë Kuçovë: Përsa i përket gjendjes së argjinaturave në bashkinë e Kuçovës, në territorin e kësaj bashkie, në NjA Perondi, ndodhet rreth 2.1 km argjinaturë, e cila mbron tokat bujqësore përgjatë lumit të Devollit. Gjendja e kësaj argjinature raportohet të jetë e mirë. Një argjinaturë tjetër që ndikon në mënyrë direkte në bashkinë e Kuçovës është argjinatura e lumenjve Seman dhe Osum, e cila ndodhet në bashkinë e Urës Vajgurore. Kjo argjinaturë ka një gjatësi prej 12.7 km dhe raportohet se ka nevojë për rehabilitime të pjesshme.

Tabela 73. Vëllimi dhe gjendja teknike e rezervuarëve në bashkinë Kuçovë

Emri i ujëmbledhësit	Vëllimi i ujit në 1000m³	Gjendja e trupit të digës	Gjendja e shkarkuesit	Gjendja e ujëlëshuesit
Belesovë	600	E mirë	I dëmtuar	Funksional
Fier-Mimar	1000	E mirë	Me probleme	Funksional
Gegë	510	E mirë	Funksional	Funksional
Goraj	900	E mirë	Funksional	Funksional


Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, 2016

Në tabelën e mësipërme tregohen rezervuarët vaditës që ndodhen në bashkinë e Kuçovës. Rezervuari më i madh është rezervuari i Fier-Mimarit, më pas rezervuari i Belesovës, Gorajt dhe i Gegës. Rezervuari i Fier-Mimarit ndodhet në pjesën veriperëndimore të bashkisë, pranë fshatrave Salc Kozarë dhe Fier-Mimar. Rezervuarët e Gegës dhe Gorajt ndodhen në pjesën qendrore të bashkisë, në verilindje të qytetit të Kuçovës, ndërsa rezervuari i Belesovës ndodhet në pjesën lindore të bashkisë, në NjA Lumas, në afërsi të fshatit Belesovë. Të gjithë këta rezervuarë, përfshirë këtu dhe rezervuarin e Thanës, që është në kufirin administrativ ndërmjet bashkisë Kuçovë dhe bashkisë Lushnje, kanë një rëndësi të madhe në zhvillimin e ekonomisë lokale dhe zhvillimin e sektorit bujqësor.

Përsa i përket gjendjes teknike të rezervuarëve, më problematike paraqitet gjendja e rezervuarëve të Fier-Mimarit dhe Belesovës. Gjithashtu, problematike paraqitet gjendja edhe në rezervuarin e Thanës. Si rezultat i këtyre problematikave duhet të bëhet rahabilitimi i këtyre rezervuarëve.

Analiza e rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese bujqësore në bashkinë Kuçovë

Figura 149. Rrjeti i kanaleve vaditëse dhe kulluese në bashkinë Kuçovë



Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave; Përpunuar nga Co-PLAN, 2016

Tabela 74. Infrastruktura bujqësore sipas llojit, kategorisë dhe gjendjes në bashkinë Kuçovë në km lineare

Lloji i kanaleve	Gjatësia e kanaleve në km lineare	% ndaj totalit
Kulluese	73.2	62.62%
Vaditëse	43.7	37.38%
Total	116.9	100.00%
Kanalet sipas kategorisë		
Kanale të para	55	47.05%
Kanale të dyta	49.3	42.17%
Kanale të treta	12.6	10.78%

Total	116.9	
Gjendja e kanaleve		
Të lirë	25.5	21.81%
Për mirëmbajtje	66.2	56.63%
Të bllokuar	25.2	21.56%
Total	116.9	100.00%

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave; Përpunimi: Co-PLAN, 2016

Siç dallohet edhe në hartën e mësipërme, zona kryesore bujqësore, në të cilën ndodhet edhe infrastruktura bujqësore, ndodhet në pjesën perëndimore të bashkisë. Tokat bujqësore në NjA Kozarë ujiten nga rezervuarët e Thanës dhe të Fier-Mimarit, si dhe nga lumi Devoll. Tokat bujqësore në NjA Perondi dhe Kuçovë ujiten nga rezervuarët e Gegës dhe Gorajt, ndërsa tokat bujqësore të NjA Lumas ujiten kryesisht nga rezervuari i Belesovës.

Në tabelën e mësipërme jepen disa statistika të cilat tregojnë mbi gjendjen, llojin dhe kategorinë e infrastrukturës kulluese dhe vaditëse në bashkinë Kuçovë. Nga ky informacion i bazuar në të dhëna nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në këtë bashki në total kemi rreth 117 km lineare rrjet të kanaleve bujqësore ku rreth 62.6 % përbëhet nga kanalet kulluese dhe 37.4% përbëhet nga kanalet vaditëse. Rreth 47 % e këtij rrjeti janë kanale të para, 42.1% janë kanale të dyta dhe 10.9 % janë kanale të treta.

Përsa i përket gjendjes së këtij rrjeti, rreth 21.8% e kësaj infrastrukture vlerësohet si kanale të cilat nuk janë të bllokuara, rreth 56.6% janë të bllokuara në mënyrë të pjesshme dhe 21 .7% janë kanale të cilat janë krejtësisht të bllokuara.[339]

1.7.6 Konkluzione

Sistemi rrugor dhe transporti publik:

- Lëvizshmërinë më të lartë përsa i përket transportit ndërqytetës bashkia e Kuçovës e ka me qytetin e Tiranës dhe Beratit.
- Sipas draftit të Planit Kombëtar 2015-2030 në Kuçovë do të kalojë boshti qendror jugor i cili vjen nga Papëri dhe përfundon në Memaliaj ku bashkohet me korridorin e kaltër. Ky është një nga investimet më të rëndësishme të infrastrukturës rrugore që pritet të ndërtohet në vendin tonë.
- Si pasojë e reformës territoriale, bashkia e Kuçovës tashmë ka një shumëfishim të sipërfaqeve rrugore të cilat gjenden në territorin e saj në krahasim me ish-njësitë e vjetra administrative. Si pasojë e këtij ndryshimi, edhe numri i sipërfaqeve të rrugëve ka ndryshuar. Në këtë bashki mbizotërojnë rrugët lokale dhe kemi kalimin nga rrugët urbane ku shtrihej kjo bashki në rrugë rurale ku shtrihet sot.
- Nga analiza e infrastrukturës rrugore, një nga problemet kryesore që është evidentuar nga grupi i punës janë hyrje daljet (intersect-et) e rrugëve lokale me rrugët interurbane kryesore. Kjo analizë është bërë në GIS dhe janë evidentuar 157 pika konfliktuale të cilat janë burim aksidenti për këtë bashki.

Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura:

- Kanalizimi i ujërave të ndotura është i pjesshëm edhe në vetë zonën urbane në Kuçovë (ofrohet vetëm në qytetin e Kuçovës 70%).

- Shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme, pasi sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura në pjesën më të madhe është i bllokuar, i dëmtuar, ose është shtrirë në mënyrë të pakontrolluar dhe jashtë standardeve higjieno-sanitare.
- Ujërat e ndotura urbane vazhdojnë të ndotin pjesën më të madhe të ujërave sipërfaqësore të kanaleve dhe emisarëve, si edhe kemi shkarkime direkt në ujërat e lumit Seman e Shkumbin.
- Zonat rurale nuk kanë rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura (largimi i ujërave bëhet nëpërmjet gropave septike, jashtë standardeve higjieno-sanitare ose nëpërmjet kanaleve të hapura kulluese që kalojnë fare pranë zonave të banuara).
- Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane duhet parashikuar të ndërtohet paralelisht me rehabilitimin apo ndërtimin e sistemit të ri të grumbullimit të ujërave të ndotura. Një studim përcjellës nevojitet për të përcaktuar karakteristikat dhe elementet kryesore ndotëse të ujërave në Kuçovë në mënyrë që të përzgjidhet metodologjia dhe teknika më e përshtatshme trajtuese në impiant.
- Nevojitet që sistemi i grumbullimit të ujërave të ndotura të projektohet i ndarë nga sistemi i cili pret ujërat e larta, kjo për arsye të shmangies së mbingarkesës, e cila shpesh rezulton në përmbytje dhe daljen në sipërfaqe të ujërave të ndotura.
- Sistemet primitive të grumbullimit dhe trajtimit të këtyre ujërave në zonat ruarale duhet të studiohen për të gjetur një alternativë më të qëndrueshme e miqësore me mjedisin. Disa praktika, kombinime të inxhinierisë së thjeshtë dhe natyrës, janë mjaft efektive sa i përket eleminimit të elementeve ndotëse dhe krijimit të plehut kimik si rezultat final i procesit të trajtimit të ujërave të ndotura në zonat rurale.
- Duke qenë se Kuçova gjeneron ujëra të ndotura industriale, sidomos ato të cilat futen në proceset e përpunimit të naftës, ato bartin elemente si metale të rënda, squfur etj., të cilat jo vetëm janë shpesh në nivele toksike, por kanë pasoja të drejtpërdrejta në botën ujore me të cilën vihen në kontakt. Si rrjedhojë, do të propozohet që këto ujëra të kenë një sistem të dedikuar grumbullimi – trajtimi – monitorimi e shkarkimi.

Ndriçimi i mjediseve publike:

- Ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik hyn ndër funksionet e veta të pushtetit vendor dhe bashkitë kanë të drejta ekskluzive mbi ofrimin e këtij shërbimi në territoret e tyre. Gjithashtu, Këshillat Bashkiakë vendosin mbi kriteret e ofrimit të këtij shërbimi.
- Në bashkinë Kuçovë shërbimi i ndriçimit publik ofrohet në qytetin e Kuçovës , në NjA Kozarë dhe në NjA Perondi, ndërsa në NjA Lumas ky shërbim nuk ofrohet.
- Ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik në qytetin e Kuçovës është mjaft i kënaqshëm. Rreth 94 % e rrjetit rrugor të qytetit është e ndriçuar, ndërsa të pandriçuara janë disa akse terciare të qytetit. Investimet kryesore në këtë fushë janë bërë pas viteve '90, megjithatë në qytet kemi disa zona në të cilat rrjeti i ndriçimit publik nuk funksionon. Kemi rreth 80 koka ndriçimi në një gjatësi prej 1600 m. Arsyeja e mosfunksionimit është mungesa e kabllit lidhës.
- Shërbimi i ndriçimit publik në NjA Kozarë është i shtrirë në rreth 4 akse rrugore, në një gjatësi prej 3746 m, me 120 ndriçuesa. Nga 120 rreth 54 janë jashtë funksioni. Arsyeja kryesore e mosfunksionimit është dëmtimi i kokave të ndriçuesve.

- Në NjA Perondi kemi rreth 2326 m rrjet rrugor të ndriçuar me 59 ndriçuesa, nga të cilët 10 nuk punojnë.
- Kostot kryesore të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik janë kostot e energjisë elektrike, të cilat variojnë nga 72% deri në 80% të kostove totale. Duhet thënë se sa më të larta të jenë këto kosto, aq më pak buxhet për investime dhe mirëmbajtjen akordohet. Ky problem rrjedh edhe nga nivelet e ulëta të arkëtimit të tarifave të ndriçimit, të cilat vitet e fundit arrijnë deri në 33.1 % të kostove totale. Pavarësisht se këto vite këto nivele arkëtimesh kanë njohur rrithe, ato janë mjaft të ulëta në raport me kostot. Duhet të rritet në mënyrë të ndjeshme niveli i arkëtimit në mënyrë që të ardhurat të mbulojnë të paktën kostot e energjisë elektrike dhe buxheti që akordohet nga bashkia për ndriçimin të shkojnë për mirëmbajtje dhe për investime të reja në këtë fushë, në mënyrë që cilësia e shërbimit të rritet.

Mbetjet e ngurta:

Fillimisht, Bashkia Kuçovë ka nevojë të përditësojë Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane e, në të njëjtën kohë, të monitorojë nga afër objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm të cituar në atë dokument. Paraqitet si domosdoshmëri nevoja për një studim të plotë mbi shtrirjen e infrastrukturës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë[340].

Venddepozitimi në Rreth Tapi, duke u pozicionuar shumë pranë bregut të lumit Devoll, e ka kthyer në një vatër të nxehtë mjedisore të gjithë zonën pranë ish-NB Partizani. Ndryshimet e shtratit të lumit kanë përmbytur një pjesë të tokës, e cila më parë ka shërbyer si venddepozitim. Aktualisht, venddepozitimi ka marrë shtrirje gjatësore përgjatë bregut. Problematike dhe emergjente paraqitet situata mbi:

- Emetimet e gazrave CH_4 në atmosferë, NO, NH_4, si dhe dioksinat nga djegiet e ndryshme,
- Shkarkimet e mbetjeve të ngurta mbi rrjedhën e lumit Devoll,
- Infiltrimin e shllameve nga dekompozimi i mbetjeve në akuifer.

Depozitimi i mbetjeve inerte anës brigjeve të lumit Devoll, si edhe në disa pjesë të argjinaturave nuk ofron një zgjidhje teknikisht të qëndrueshme dhe afatgjatë. Nevojitet një plan për menaxhimin e këtyre mbetjeve dhe, mbi të gjitha, një pikë grumbullimi e miratuar nga Bashkia.

Mbetjet e klasifikuara si të rrezikshme (kryesisht spitalore & industriale) administrohen nga subjekte private në varësi të kushteve kontraktuale. Monitorimi i këtyre kontratave në terren paraqet mangësi, pasi janë identifikuar shkarkime industriale përgjatë të gjithë zonës naftëmbajtëse në bashkinë Kuçovë. Gjithashtu, në raste më të izoluara, janë konstatuar mbetje spitalore edhe në venddepozitimin në Rreth Tapi[341].

Skema të ndryshme të 3R-ve (reduktim – riciklim – ripërdorim) shihen pjesërisht të zbatuara në bashkinë Kuçovë. Faktor në procesin e ndarjes së mbetjeve mbetet komuniteti rom & egjiptian në Kuçovë dhe NjA. Fushatat dhe projektet pilot në fushën e reduktimit dhe ripërdorimit janë të pakta, ndaj edhe familjarizimi i popullatës me këto teknika është i ulët. Këtu veçojmë mbetjet organike të prodhuara nga bujqësia, të cilat me anë të skemave të kompostimit mund të prodhojnë pleh aktiv, i cili të ripërdoret sërish në bujqësi.

Plan projekti për ndërtimin e landfillit rajonal në bashkinë Ura Vajgurore paraqet një iniciativë pozitive bashkëpunimi ndërmjet 3 Bashkive që duhet intensifikuar, por, sigurisht, nevojitet një studim mbi fizibilitetin që paraqet kjo sipërmarrje.

Gjithashtu, edhe plan projekti për ndërtimin e një inçerneratori në zonën e ish-UPN-së, i cili do t'i nënshtrohet proceseve rehabilituese, paraqitet problematik sa i përket afërsisë së tij me zonat e banuara.

Zonat me nivel të lartë ndotjeje (ish-uzina e përpunimit të naftës, depozitat e amortizuara të stokimit të naftës bruto, puset e naftës etj) pranë qytetit të Kuçovës dhe zonave të banuara të NjA-ve përbëjnë një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këto zona duhet të jenë pjesë e skemës së re që duhet të miratojë Bashkia e Kuçovës për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Sistemi i kullimit dhe i ujitjes:
Si rezultat i analizës së mësipërme vihen re këto gjetje kryesore:

- Argjinaturat e lumit Devoll në territorin e bashkisë Kuçovë janë në një gjendje të mirë, ndërsa argjinaturat e lumit Seman dhe Osum në afërsi të kësaj bashkie kanë nevojë për rehabilitime të pjesshme.
- Rezervuarët me gjendjen më problematike janë rezervuarët e Belesovës dhe Fier Mimarit, të cilët ujisin një pjesë të madhe të tokave në bashkinë e Kuçovës.
- Rrjeti i infrastrukturës bujqësore është i bllokuar tërësisht ose në mënyrë të pjesshme në një masë prej 78.3%.

1.8 Strehimi dhe cilësia e strukturave dhe e hapësirave
Analiza e nevojave për strehim realizohet sipas pikave të mëposhtme:

a) Qëllimi i analizës – të kuptuarit e gjendjes aktuale të strehimit në bashkinë e Kuçovës, si dhe përcaktimi i disa kritereve bazë nëpërmjet të cilave do të bazohen dhe rekomandimet për zgjidhjen e nevojave përmes PPV-së. Bazuar mbi analizën e gjendjes ekzistuese, si dhe standardet orientuese të vendosura nga legjislacioni sektorial përkatës (VKM nr 671), është bërë dhe përcaktimi i kritereve të cilat do të merren parasysh gjatë hartimit të rekomandimeve të çështjeve të strehimit.

b) Përzgjedhja e kritereve për t'u vlerësuar – Për të bërë këtë analizë, duhet bërë përzgjedhja e kritereve treguese të gjendjes ekzistuese, të cilat i vijnë në ndihmë analizës së strehimit, si dhe përcaktimi i kritereve që ndikojnë në zhvillimin territorial për qëllime banimi në të ardhmen. Kriteret janë përcaktuar si më poshtë:

- Popullsia për njësi administrative (ekzistuese dhe e pritshme)
- Sipërfaqja e ndërtimit për qëllime banimi/ banor (ekzistuese dhe e propozuar)
- Numri mesatar i kateve (ekzistues dhe i propozuar)
- Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për ndërtim (ekzistues dhe i propozuar)
- Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për infrastrukturë (ekzistues dhe i propozuar)
- Standardet e shërbimeve të ofruara brenda njësive të banimit, si: gjelbërim (m^2/ banor), zona sportive (m^2/ banor), sipërfaqe parkimi (m^2/ banor).

Konkretisht, përcaktimi i intervaleve apo vlerave mesatare që do të ketë secili nga kriteret e cituara më sipër do të ndihmojë në parashikimin e nevojave për strehim për zonat e reja të banimit, si dhe në parashikimin e shërbimeve për zonat ekzistuese të banimit.

b) Situata aktuale dhe përcaktimi i vlerave mesatare për secilin kriter – Bazuar në të dhënat e regjistrimit te përgjithshëm të popullsisë, si dhe në trendin që kanë pësuar treguesit demografik (si lindshmëria, vdekshmëria, emigracioni dhe popullsia), numri i popullsisë ka pësuar ulje krahasuar me të dhënat e vitit 2011. Bashkia Kuçovë, më 1 janar 2015, regjistroi një numër të popullsisë rezidente prej 31 mijë banorësh, me një sipërfaqe prej 161 km².

Tabela 75. Sipërfaqet e ndërtimit për qëllime banimi sipas njësive administrative të bashkisë Kuçovë

	Bashkia Kuçovë			
Nr.	**Emri i njësisë administrative**	**Sip. ndërtimi**	**Nr. i popullsisë**	**m^2/banor**
1	Kozarë	307,912	5,622	54.77
2	Kuçovë	483,947	12,654	38.24
3	Lumas	196,377	3,981	49.33
4	Perondi	643,031	9,005	71.41

Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Rreth 40% e kësaj popullsie klasifikohet si popullsi urbane dhe 60% e saj si popullsi rurale. Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, si dhe rënia e ritmeve të lindshmërisë e vdekshmërisë kanë ndikuar jo vetëm në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike, por edhe në pakësimin/rënien e numrit të popullsisë. Sipas projeksioneve të popullsisë (skenari i rritjes së mesme), popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie me një ritëm mesatar vjetor rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.

Gjendja e përgjithshme e strehimit në bashki është problematike. Aktualisht, vetëm në qytetin e Kuçovës ka *865 familje të pastreha*, nga të cilat *526 jetojnë në banesa me bashkëpronësi* dhe *212 në banesa individuale*. Situata e aplikantëve për strehim social është si më poshtë:

- familje në banesa në rrezik shembjeje
- 38 familje të komunitetit rom dhe egjiptian
- 51 familje aplikante për banesa sociale me qira
- 56 familje të strehuara në banesa me pronësi të bashkisë, pjesë e skemës së qirasë së lehtësuar
- 43 familje që jetojnë në territorin e ish- Uzinës së Përpunimit të Naftës (UPN)

440 familje janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak (VKB) si aplikantë për Programin e Banesës me Kosto të Ulët, nga të cilët 28 kanë marrë miratimin nga banka.[1]

Përsa i përket infrastrukturës rekreative dhe sociale, sikurse u cilësua më lart, duke iu referuar standardeve të rekomanduara nga VKM-ja nr.671, si dhe gjendjes ekzistuese të tipologjive hapësinore rekomandohet:

Gjelbërim: Standardi i rekomanduar në qendra mbi 10,000 banorë për gjelbërim në rrugë, shëtitore, sheshe dhe brigje ujore është 2.5m^2/banor, sipas dispozitave ligjore. Aktualisht, ky standard është 2.17 m^2/banor.

Zona sportive: Standardi i propozuar nga VKM-ja nr.671 për struktura dhe territore në nivel territori urban më të madh se qyteti është 2.6 m^2/banor për rastet kur populsia është e barabartë me ose mbi 100,000 banorë, si dhe 3.5 m^2/banor për rastet me populsi nën 100,000 banorë.

Sipërfaqe parkimi: Për parkimin publik, pavarësisht formës së zgjidhjes së tij, standardi është 6 m^2/banor ose 1 vendparkim prej 12 m^2 për çdo 2 banorë. Parkimi mund të jetë privat ose publik dhe format e zgjidhjes janë në rrugë, në sheshe publike, në sipërfaqe mbi ose nën tokë, në struktura me një ose disa nivele dhe në pjesë të objekteve me përdorime të ndryshme.


1.9 Përdorimi i tokës, sistemet dhe strukturimi i territorit

1.9.1 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës

Ky seksion trajton disa nga gjetjet kryesore në lidhje me përdorimin e tokës në bashkinë Kuçovë dhe konfliktet e hasura mes përdorimeve të papërputhshme kufitare. Përdorimi i tokës është zonuar në përputhje me kategoritë e specifikuara në "Rregulloren e planifikimit të territorit[342]", duke marrë në konsideratë edhe të gjitha rastet e përdorimit "i përzier" në raportet përkatëse mes secilit përdorim. Nga ana interpretative, fillimisht është bërë analiza e territorit sipas sistemeve përbërëse të tij:

Leximi i territorit fillimisht është bërë sipas sistemeve territoriale ekzistuese[343], si më poshtë: Sistemi urban (UB); Sistemi natyror (N); Sistemi bujqësor (B); Sistemi ujor (U); Sistemi infrastrukturor (IN)

Figura 150. Sistemet territoriale, bashkia Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Bashkia Kuçovë ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 161.25 km^2, me karakter dominues bujqësor, të ndërthurur me natyror. Tokat bujqësore, të shpërndara kryesisht në njësitë Kozarë dhe Perondi dhe përgjatë luginave të njësisë Lumas, përbëjnë 52% të territorit, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 84 km^2. Ndërkaq, sistemi natyror, i përfaqësuar nga tërësia e pyjeve dhe e sipërfaqeve shkurre të shpërndara në bashki, më së shumti në njësinë Lumas, zë 37% të territorit. Sistemi ujor përbëhet nga fragmente të lumit Osum dhe Devoll që bashkohen në afërsi të fshatit Arrëz, të Urës Vajgurore, si dhe nga përrenjtë dhe 4 rezervuarët bujqësorë kryesorë të bashkisë, duke zënë kështu 3% të sipërfaqes së territorit. Sistemi urban që përfshin gjithçka që është e ndërtuar, si përdorimet "banim", "shërbime", "industri" etj., zë 5.4% të territorit. Qendërsi të dukshme në këtë aspekt përbën Kuçova, me strukturë hapësinore kompakte dhe tendenca zhvillimi në zgjatimet e akseve kryesore, ndërkohë që fshatrat janë të vendosura në mënyrë lineare ose të shpërndara në trajtë pikësore, në varësi të terrenit. Siç tregohet në seksionin 1.1.1, tendencat e rritjes kanë qenë të shumta, sidomos për Perondinë, e cila, duke u zhvilluar rrotull qytetit të Kuçovës, ka pësuar një rritje trefish në një periudhë vetëm 17-vjeçare. Sistemi infrastrukturor zë një përqindje të lartë, jo për arsye të rrjetit rrugor të dendur e me gjerësi të madhe, por për shkak të pranisë së fushës së aviacionit në qendrën e dikurshme ushtarake aeronautike të Kuçovës.


Sa i takon përdorimit të tokës, analiza është bërë duke zonuar sipas 14 kategorive bazë, me nënkategoritë dhe funksionet përkatëse. Gjetjet kryesore në lidhje me përhapjen e tyre janë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 76. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës, sipas sipërfaqes që zënë

Kategoria bazë	Sip. (km^2)
01. Banim	7.084
02. Industri dhe ekonomi	0.991
03. Bujqësi	84.069
04. Shërbime	0.284
05. Përdorime të veçanta	0.142
06. Ujëra	4.683
07. Natyrore	58.844
08. Trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike	0.001
10. Institucione	0.026
11. Aktivitete sociale dhe argëtuese	0.122
12. Arsim	0.101
13. Shëndetësi	0.013
14. Infrastrukturë	4.957

Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Figura 151. Konfliktet mes përdorimeve të papërputhshme të tokës



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Nga shpërndarja në territor e përdorimeve të ndryshme vërehen disa mospërputhje të dukshme, të shkaktuara sidomos nga përdorimet industriale, pra puset e naftës dhe industria përpunuese e saj. Së pari, zonat industriale, që kur ishin projektuar, por edhe një pjesë e puseve ndodhen në afërsi të qendrës së qytetit. Ky konflikt duhet zgjidhur duke marrë masa për reduktimin e efekteve negative në ajër, si dhe në tokë e në ujërat nëntokësore. Pavarësisht filtrave të përdorur nga industria përpunuese, rastet e shqetësimeve shëndetësore nga banorët e zonës nuk kanë munguar. Kështu, zonat buferike dhe masat shtrënguese për emetimet në ajër duhet të jenë prioritet në politikat për një mjedis të shëndetshëm.

Së dyti, prania e puseve të naftës në tokë bujqësore dhe shumë shpesh në afërsi të sipërfaqeve ujore sjell një konflikt shumë shqetësues për prodhimtarinë bujqësore. Puset e naftës ndodhen mbi një ndër zonat akuifere më të mëdha të rajonit dhe, kështu, ndotja mund të ketë ndikim shumë afatgjatë në ujin e pijshëm, në ujin e përdorur për ujitje e, si rrjedhojë, në prodhimet bujqësore etj.

Së treti, ekziston, ndonëse jo shumë e përhapur, dukuria e shpërhapjes urbane në tokë bujqësore. Efektivisht, kjo sjell një konflikt tjetër përdorimi, pasi, nga njëra anë, nuk përdoret toka për prodhim dhe, nga ana tjetër, nxitet shpërhapja më tej. Gjithsesi, nuk ka ndonjë tregues që të dëshmojë se shpërhapja urbane e ul bonitetin apo përshtatshmërinë e tokës bujqësore. Efektet e kësaj dukurie janë më tepër ekonomike, sepse sigurojnë shërbim për ndërtesat e veçuara dhe estetike, sepse dëmtojnë peizazhin bujqësor, që i shërben zhvillimit të turizmit.

Së fundi, konflikti i përdorimit infrastrukturor dhe ujor krijohet për shkak të pranisë së vendit të depozitimit të mbetjeve urbane në një ndër meandret e lumit Devoll, në afërsi të fshatit Rreth Tapi. Ky venddepozitimi është jo sanitar dhe përbën rrezik të ndotjes së ujërave të lumit dhe ujërave nëntokësore, përveç emetimeve në ajër. Është e rëndësishme të gjendet një zgjidhje më e qëndrueshme dhe e integruar për të gjithë bashkinë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

1.9.2 Tipologjitë hapësinore dhe cilësia e territorit

Analiza e tipologjive hapësinore evidenton mënyrat e ndërlidhjes së hapësirave në territor, kryesisht nga pikëpamja morfologjike. Për situatat komplekse të mbulesës së tokës dhe shtrirjes së vendbanimeve në bashkinë Kuçovë një evidentim i tillë lehtëson të kuptuarit e territorit dhe procesin e përcaktimit të treguesve realistë të zhvillimit.

Duke marrë në konsideratë shtrirjen e madhe hapësinore të bashkisë në raport me territorin e dikurshëm, kjo analizë trajton 3 nivele tipologjish:

- Nivelin territorial: mënyra si lidhen vendbanimet me njëra-tjetrën në rang bashkie;
- Nivelin e vendbanimeve rurale: shtrirjet hapësinore të fshatrave në raport me rrugët, relievin etj.;

Nivel zone: ndarja e tipologjive hapësinore në përputhje me njëtrajtshmërinë e llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes së tyre në njësi strukturore, skemave të rrjetit rrugor dhe hapësirave publike, si dhe lartësisë së strukturave, sipas përcaktimeve të "Rregullores së planifikimit të territorit"[344].

- **Bashkia Kuçovë në nivel territorial**


Bashkia Kuçovë bën pjesë në ZFU-në e Berat-Kuçovës[345] në 90.6% të territorit të saj, duke kontribuar me 28% të popullsisë së kësaj ZFU-je. Vendbanimet shtrihen në terren fushor dhe pjesërisht në terren malor, të palidhura mirë me infrastrukturë, sidomos në fshatrat e njësisë Lumas. Rritja hapësinore e vendbanimeve është dyfishuar në periudhën pas viteve '90, veçanërisht në njësinë Perondi, ku shtrirja urbane është rritur 5 herë.

Struktura e lidhjes mes vendbanimeve në bashkinë Kuçovë është relativisht komplekse për shkak të territorit të vështirë në një pjesë të bashkisë, si dhe mungesës së infrastrukturës rrugore në pjesën tjetër. Vetë qyteti i Kuçovës nuk është pjesë e një aksi kryesor ndërurban, por lidhet me aksin Lushnje-Berat nëpërmjet daljes në Urën Vajgurore, duke formuar një bosht të përbërë nga dy lidhje paralele. Njëra prej këtyre lidhjeve kalon nga qyteti i Kuçovës dhe tjetra përshkon rrëzën e kodrave e bashkohet me të parën nëpërmjet qendrës Perondi. Në këtë bosht paralel shtrihen, ose lidhen në mënyrë të degëzuar një seri vendbanimesh, si: Tapi, Perondi, Kuçovë, Majëgjatë, Goraj, Velagosht, Polovinë, Gegë, Drizë dhe Frashër. Ky sistem linear paralel në pjesën jugore të tij deri në qytetin e Kuçovës përfaqëson qendrat urbane me më shumë potencial për zhvillim dhe rritje. Krahas tij, sistemi i vendbanimeve përtej Kozarës shtrihet në formë unaze përreth kodrës së Kozarës dhe e kufizuar nga lumi Devoll dhe Seman. Këtu gjenden disa fshatra, si: Kozarë, Havaleas, Kozarë fshat, Salcë Kozarë, Ferras Kozarë në rrugën kryesore që lidhet me Lushnjen, si dhe Fier-Mimar në itinerarin tjetër në veri të kodrës. Ky sistem shtrihet paralelisht me një seri vendbanimesh të Urës Vajgurore, por nuk krijojnë lidhje për shkak të pranisë së lumit të Semanit. Ky grup sistemesh i shtrirë në zonë bujqësore, si dhe i kufizuar nga zona kodrinore me karakter bujqësor-natyror ka mundësi për krijim të një lidhshmërie të mirë me pjesën tjetër të territorit. Me fillim në Kozarë shtrihen edhe një numër fshatrash, siç janë Zdravë, Demollarë, Vlashuk etj., që lidhen linearisht me njëri-tjetrin dhe degëzohen. Këto fshatra shtrihen në terren më të vështirë, përgjatë luginës së lumit Devoll, dhe komunikojnë me një rrjet të gjerë itineraresh me Belshin, Cërrikun, Elbasanin etj.

Së fundi, sistemi tjetër i vendbanimeve i Bashkisë Kuçovë është ai linear i degëzuar i njësisë Lumas, ku lidhja ndodh përmes Otllakut, përtej territorit administrativ të bashkisë.

Ky sistem ka lidhshmëri të vështirë, të përcaktuar nga shtretërit e përrenjve dhe lugina e lumit Bardhaj, dhe përfshin trinomin Vodëz-Krekëz-Koritëz, degëzimin Bardhaj-Pashtraj, qendrën Lumas, sistemin Pëllumbas, Zelevizhdë, Belesovë, të cilët lidhen me Lumasin dhe përfundojnë në një rrjet itineraresh të lidhur me Gramshin, si dhe fshatin Luzaj në skaj të aksit. Sfida për këto vendbanime është mundësimi i lidhjes së brendshme me Kuçovën, si dhe përmirësimi i cilësisë së rrugëve lidhëse mes fshatrave periferike me njëri- tjetrin dhe me vendbanime përtej bashkisë së Kuçovës.

Figura 152.Skema e lidhjeve territoriale në nivel bashkie



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

- **Tipologjitë rurale**

Bashkia Kuçovë përbëhet nga 3 njësi administrative me karakter rural dhe Kuçova me karakter urban. Në territorin e bashkisë shtrihen 31 fshatra, të cilat kanë marrëdhënie të ndryshme të vendbanimeve brenda tyre, si dhe tipologji të ndryshme shtrirjeje përkundrejt rrjetit rrugor e terrenit.

Sa i takon mënyrës si lidhen vendbanimet brenda të njëjtit fshat, në Kuçovë evidentohen 4 tipologji kryesore:


(1) Tipologjia satelitore: Ky rast nënkupton që fshati përbëhet nga disa vendbanime të shpërndara, por të lidhura hierarkisht me një qendër mbizotëruese. Këto lidhje janë treguese të tendencës për rritje të fshatrave, si dhe terrenit të vështirë, i cili kufizon vazhdimësinë urbane. Sfida kryesore e zhvillimit e fshatrave me shtrirje satelitore është përforcimi i infrastrukturës lidhëse, si dhe shmangia e inefiçencës në furnizimin me shërbime bazë, si: infrastrukturë ujësjellëse e kanalizimesh, shërbim menaxhimi mbetjesh, ndriçim publik etj.

(2) Tipologjia nukleare: Kjo tipologji haset në fshatrat me shumë vendbanime të vogla, të shpërndara në territor në mënyrë sporadike, të palidhura. Pavarësisht prezencës së një qendre ku është zhvilluar fillimisht fshati, presioni i rritjes në kohë ka çuar në shpërndarjen e vendbanimeve të reja në mënyrë të pastrukturuar dhe abuzuese ndaj territorit. Kjo tipologji kërkon përshtatjen e ndërhyrjeve ristrukturuese dhe mbushëse urbane për të mos copëzuar më tej terrenin bujqësor apo natyror.

(3) Tipologjia qendrore: Kjo tipologji i përgjigjet fshatrave që përbëhen nga një vendbanim i vetëm, kompakt. Ky rast është mjaft i përhapur dhe përkon me fshatra që nuk kanë presion zhvillimi dhe që shtrihen në territor kodrinoro-malor.

(4) Tipologjia aglomeruese: Kjo tipologji haset në vendbanime të mëdha ku, përveç qendrës, ekzistojnë edhe zona të tjera urbane, të trajtës satelitore, të cilat, me rritjen e presionit të zhvillimit, i afrohen zonës qendrore, duke formuar një sistem të pandërprerë urban. Kjo lloj marrëdhënieje hapësinore është e përshtatshme për fshatrat në rritje, duke qenë se realizon përdorimin më efiçent të tokës dhe shpërndarjen më efikase të shërbimeve.

Figura 153. Tipologjitë e marrëdhënieve të vendbanimeve rurale në bashkinë Kuçovë



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Në bashkinë Kuçovë dallohet një mbizotërim i dukshëm i tipologjisë satelitore, veçanërisht në fshatrat e njësisë Kozarë dhe Lumas, ku terreni nuk ka lejuar vendbanime kompakte, por të shpërndara dhe të lidhura rreth një qendre. Gjithashtu, qendrat e njësive Perondi dhe Kozarë kanë tipologji satelitore me sipërfaqe më të madhe. Disa fshatra të tjera ku vendbanimet janë të lidhura në trajtë satelitore janë: Drizë, Gegë, Havaleas, Majë-Gjatë, Tapi, Vlashuk, Pëllumbas, Sheqëz etj.


Tipologjia nukleare është e përhapur gjerësisht në fshatrat e njësisë Lumas, kryesisht në zonat malore, si: Luzaj, Velagosht, Mendrakë, Belesovë etj. Këto fshatra janë mjaft të shpërndara në territor, si dhe me akses të dobët ndaj akseve interurbane që i lidhin me Kuçovën.

Figura 154. Shembuj të tipologjisë satelitore (Perondi, Kozare)



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Figura 155. Shembuj të tipologjisë nukleare (Frashër, Drizë)




Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Tipologjia qendrore është e përhapur në zona me presion më të pakët zhvillimi, ose ku shpërndarja kufizohet apo përcaktohet nga barriera dhe dukuri fizike. Kështu, në Ferras-Kozarë vendbanimi shtrihet në trajtë rrethore brenda meandrimit të lumit Devoll, kështu nuk shpërndahet më tej, por qëndron kompakt. Edhe fshatrat Lumas, Katundas, Ferras, Koritëz, Krekëz etj., pavarësisht madhësive e densiteteve të ndryshme, kanë vetëm një vendbanim të vazhduar e nuk përmbajnë fragmente të banuara më tej.

Tipologjia aglomeruese haset shumë rrallë në fshatra si Rreth Tapi, ku struktura e bashkuar lineare ka formuar një vendbanim të vetëm, të pahierarkizuar, me zhvillim hapësinor të kontrolluar, pa zënë tokë bujqësore.

Figura 156. Shembuj të tipologjisë qendrore (Lumas, Ferras-Kozare)



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Ndërkaq, studimi i rrjetit rrugor në brendësi të vendbanimeve rurale tregon se më shumë se 1/3 e vendbanimeve kanë shtrirje lineare përgjatë rrugës kryesore. Pavarësisht marrëdhënies qendrore, nukleare apo satelitore, vendbanime si Ferras Kozarë, Fier-Mimar, Drizë, Polovinë, Velagosht etj. kanë strukturë urbane të varur nga aksi kryesor linear e të orientuar drejt tij. Kjo strukturë kërkon të merren masa për shmangien e shpërhapjes urbane lineare sidomos në njësinë Kozarë dhe Perondi, me karakter më fushor.

Rreth 20% e vendbanimeve në bashkinë Kuçovë kanë shtrirje organike, duke ndjekur relievin pa ndërhyrë me tarracime. Kjo formë është shpesh e degëzuar, por pa formë të paracaktuar vendosjeje të ndërtesave. Disa raste gjenden në njësinë Lumas, si: Zdravë, Luzaj, Belesovë, Zelevizhdë, Demollar etj. Këto vendbanime kanë nevojë për një rrjet rrugor të rehabilituar, me lidhshmëri më të mirë, duke formuar rrjet të mbyllur.

Figura 157. Tipologji lineare (Tapi, Polovinë)



Burimi: ASIG, 2016

Figura 158. Tipologjitë organike (Frashër, Kozarë fshat)



Burimi: ASIG, 2015

Tipologjia e degëzuar është e treta më e përhapur në territor dhe dallohet në rastet kur, krahas një rrjeti rrugor mbizotërues linear, vendbanimet shtrihen edhe përgjatë degëzimeve të këtij rrjeti. Kjo sjell një shpërndarje më uniforme në territor, si dhe krijon më shumë mundësinë e formimit të sistemeve të rrjetëzuara potenciale, që përmirësojnë aksesin dhe kufizojnë rritjen urbane. Disa fshatra ku mbizotëron tipologjia e degëzuar janë: Lumasi, Salcë Kozarja, Pëllumbasi, Frashëri etj.

Figura 159. Tipologjia e degëzuar (Salcë Kozarë, Lumas)



Burimi: ASIG, 2015

Në bashkinë Kuçovë ka edhe një numër tipologjish të veçanta të cilat nuk janë shumë të përhapura, por kanë mjaft vlerë në aspekt të zhvillimit hapësinor. Tipologjia e tarracuar zhvillohet në fshatrat e fshira në faqe të kodrave, mbi tarraca të njëpasnjëshme ku zhvillohet edhe aktivitet bujqësor. Këto janë rastet e Koritëzës, Mendrakës, Pashtrajt etj. Tipologjia e tarracuar është e veçantë nga ana peizazhistike dhe vlen të nxitet në zona me potencial turistik. Gjithsesi, tarracimi i theksuar krijon probleme erozive nëpër shpate të pjerrëta malore ose kodrinore e, si rrjedhojë, duhet propozuar në raste të përshtatshme.


Figura 160. Tipologjia e tarracuar (Koritëz) dhe rrjet (Kozare)



Burimi: ASIG, 2015

Tipologjia rrjet, qoftë e çrregullt apo drejtkëndore, nënkupton që në brendësi të vendbanimit nuk mbizotëron një aks i vetëm linear, por ka disa rrugë, të lidhura me njëra-tjetrën, që sigurojnë akses në secilën parcelë. Ky është rasti optimal i planifikimit të zonave të banuara dhe haset shumë rrallë për shkak të nevojës së lartë për investim në infrastrukturë. Disa raste me tipologji rrjet janë: Majë-Gjata, Perondia, Kozarja etj.

Figura 161. Tipologjia e shtrirjes rrugore të vendbanimeve rurale



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

- **Tipologjitë në nivel zone**

Për bashkinë Kuçovë është realizuar ndarja e zonave tipologjike sipas kritereve të njëtrajtshmërisë të përcaktuara në "Rregulloren e planifikimit", të kombinuara me kriteret e densitetit, funksionit mbizotërues, si dhe shkallës së miksimit të tipologjive ndërtimore. Këto kritere paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Tabela 77. Kriteret e kombinimit të tipologjisë ndërtimore me densitetin

		Densiteti				
		i lartë	i mesëm	i ulët	shumë i ulët	shumë i ulët në tokë bujqësore
Tipologjia ndërtimore	gjatësore					
	vila					
	kulla					

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Tabela xx. Kriteret e kombinimeve të mundshme të tipologjive ndërtimore mes tyre

		Tipologji dytësore			
		gjatësore	vila	kulla	vila dhe kulla
Tipologjia ndërtimore mbizotëruese	gjatësore				
	vila				
	kulla				

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016


Nisur nga këto kritere, klasifikimi i zonave tipologjike për Bashkinë e Kuçovës është bërë si më poshtë:

- Ndërtesa gjatësore me densitet të lartë
- Ndërtesa gjatësore me densitet të mesëm
- Ndërtesa gjatësore me densitet të ulët
- Ndërtesa gjatësore miks me zonë vilash/kullash
- Ndërtesa gjatësore miks me vila
- Ndërtesa gjatësore miks me kulla
- Ndërtesa me kulla, densitet i mesëm
- Ndërtesa me kulla, miks me vila
- Vila miks me kulla, densitet i mesëm
- Vila me densitet të lartë
- Vila me densitet të mesëm
- Vila me densitet të ulët
- Vila me densitet shumë të ulët
- Vila me densitet shumë të ulët në tokë bujqësore
- Zona jo banim (administrative, ekonomike, industriale, fetare, serra, shkolla, stadium, ushtarake, arkeologjike etj)

Nga pikëpamja ndërtimore, tipologjitë më të përhapura në bashkinë e Kuçovës janë vilat me densitet shumë të ulët, të cilat zënë rreth 40 % të territorit të ndërtuar. Kjo dëshmon për karakterin rural dhe periferial të bashkisë, ku pjesa më e madhe e vendbanimeve janë të shpërhapura në territor e realizojnë dendësi shumë të ulëta. Mjaft të përhapura janë edhe zonat me vila me densitet të ulët, ku banesat individuale janë 2-3 katëshe, me oborre të gjera. Këto zona dallohen kryesisht në fshatrat e njësive Perondi e Kozarë, të shtrira në terren më të përshtatshëm. Ndërkaq, zonat e vilave me densitet të mesëm dhe të lartë zënë rreth 7 % të territorit të ndërtuar, kryesisht në qendrat e njësive administrative.

Duke patur parasysh karakterin thellësisht bujqësor të bashkisë, sipërfaqet e serrave janë shumë të përhapura në tokën bujqësore, duke përbërë rreth 13% të sipërfaqes së ndërtuar. Zonat industriale zënë sipërfaqe gjithashtu domethënëse, rreth 9% të territorit artificial, përqendruar shumë pranë qytetit, si dhe në akset kryesore në afërsi të Kozarës.


Figura 162. Shpërndarja e tipologjive hapësinore në bashkinë e Kuçovës



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Ndërkaq, dukuria e zënies së tokës bujqësore nga zona e banuar nuk është shumë e përhapur, por dallohet në disa raste të veçanta, sidomos përgjatë shtretërve të përrenjve në rrjedhën e sipërme të tyre, por edhe në tokën bujqësore të Kozarës dhe Perondisë. Zonat me vila të shtrira në tokë bujqësore zënë rreth 10% të sipërfaqes së ndërtuar. Këto zona kërkojnë marrjen e masave për konsolidim, si dhe përdorim të instrumenteve planifikuese në mbrojtje të tokës bujqësore.

Figura 163. Zonimi tipologjik, bashkia Kuçovë




Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Në nivel qyteti miksimi i tipologjive është shumë i theksuar, duke kaluar nga zona qendrore me mbizotërim ndërtesash gjatësore të tipologjisë së pamiksuar dhe densitetit të lartë në zona me tipologji të miksuar kullash, ndërtesash gjatësore e vilash, e deri në periferi me vila me densitet të lartë e të mesëm. Kjo strukturë e ruajtur mirë në brendësi të qytetit vjen si rezultat i pamundësisë për rritje densiteti për shkak të planifikimit qendror të Kuçovës, si dhe densifikimit dhe shtrirjes së mëtejshme në kufi të njësisë Kuçovë me njësinë Perondi, rrethuese të saj. Kjo ka ndihmuar në ruajtjen e një identiteti të mirë urban të qytetit. Gjithsesi, zona industriale zë një sipërfaqe dominuese në qytet, shumë pranë qendrës administrative.

Sfida kryesore, në nivel qyteti, është mbrojtja e tipologjive të pastra me një lloj ndërtese mbizotëruese, duke shtuar akses dhe shërbime në lagjet me ndërtesa gjatësore që lejojnë krijimin e hapësirave cilësore publike në brendësi të tyre. Gjithashtu, sfidues është trajtimi i kufirit zonë industriale – zonë banimi në pjesën qendrore të qytetit, si dhe në zonat periferike të tij.


Në qytet ka një kalim gradual nga zonat me vila me densitet të lartë në ato me densitet të mesëm dhe me densitet të ulët, veçanërisht në lidhjen me zonën e Ullishtes. Ky kalim duhet ruajtur në tipologjitë e propozuara për të mundësuar zhvillim të balancuar për qytetin, pavarësisht dukjes monocentrike. Zonat me ndërthurje tipologjish ose ish-zonat industriale që do të ndryshojnë përdorim e, si rrjedhojë, edhe tipologji janë mundësi e mirë për t'u shndërruar në polet e reja të qytetit për të siguruar një sistem urban më të aksesueshëm nga të gjithë.

Figura 164. Zonimi tipologjik, Kuçovë qendër



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Figura 165. Shpërndarja e tipologjive hapësinore në qytetin e Kuçovës



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

1.9.3 Konkluzione

Sistemet territoriale dhe përdorimi i tokës

Përdorimi bujqësor është mbizotërues dhe burimi kryesor në nivel bashkie. Pjesa më e madhe e tokës bujqësore është tokë arë e kultivuar.

Konfliktet kryesore në përdorimet e papërputhshme lidhen me vendndodhjen e puseve të naftës në afërsi të zonave të banuara dhe në mes të tokës bujqësore të kultivuar, si dhe shumë pranë brigjeve lumore. Duhen marrë masa për reduktimin e ndikimit negativ të tyre në mjedis apo rrezikun e kontaminimit të tokës dhe ujërave.

Zonat e përpunimit të naftës ndodhen shumë pranë qendrës së banuar dhe nuk janë të izoluara në mënyrë të mirë, pavarësisht përdorimit të filtrave për emetimet në ajër.

Tipologjitë ndërtimore në bashkinë e Kuçovës

Nga pikmapja e zhvillimit ndërtimor, tipologjitë më të përhapura janë vilat me densitet shumë të ulët që përbëjnë rreth 40% të territorit të ndërtuar. Kjo është një karakteristikë që dëshmon për karkaterin mjaft rural dhe periferial që ka bashkia si dhe pjesa më e madhe e vendbanimeve janë të shpërhapura në territor. Tipologji mjaft të përhapura rezultojnë dhe tipologjitë e vilave me densitet të ulët të cilat janë banesat individuale 1-3 katëshe. Në në këto tipologji klasifikohen dhe sipërfaqet e serave si tipologji në bujqësi të cilat përbëjnë rreth 13 % të sipërfaqes së ndërtuar. Tipologjitë ndërtimore industriale zënë rreth 9% të hapësirave të ndërtuara. Më pas vijnë tipologjitë ndërtimore siç janë: vilat me dendësi të lartë , vilat me dendësi të mesme , ndërtesat gjatsore me dendësi të lartë, ndërtesat gjatosre mikse me kulla sidhe ndërtesat gjatsore miks me vila. Këto tipologji kryesisht ndodhen në qytetin e Kuçovës të cilat kanë përqindje te ulëta ne krahasim me tipologjitë e tjera ndërtimore.

1.10 Rëndësia kombëtare në territor

Bashkia e Kuçovës gëzon një pozicion të rëndësishëm në territorin e Shqipërisë, i mundësuar nga disa avantazhe ndërsektoriale. Ajo ndodhet në afërsi të zonave ekonomike të Vlorës, Lushnjes dhe Fierit, si dhe pranë aksit kryesor lidhës me qytetin e Beratit. Kuçova ndodhet në një nga fushat naftëmbajtëse të Shqipërisë dhe trashëgon një aerodrom ushtarak me potencial komercial.

- **Monumentet kulturore**

Në bashkinë e Kuçovës ndodhen 2 monumente kulture të kategorisë së parë: Kisha e Ungjillëzimit në fshatin Kozarë dhe Kisha e Shën Kollit në fshatin Perondi. Në nenin 32 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore" specifikohet që për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse përreth, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që ka shpallur monumentin sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Figura 166. Kisha e Ungjillëzimit, Kozare



Burimi: Wikipedia, Shqipëri

- **Menaxhimi i integruar i burimeve ujore**

Territori i bashkisë së Kuçovës është i pasur në burime ujore, pasi ndodhet në bashkimin e lumenjve Osum dhe Devoll në lumin Seman. Të gjitha burimet ujore, së bashku me të gjitha brigjet dhe shtretërit e trupave të ujit pa përjashtim, sipas specifikimit të ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", janë në pronësi të shtetit dhe nën administrimin e organeve shtetërore. Për trupat ujorë ky ligj specifikon distancat e sigurisë në dy breza në varësi të këndit të bregut më pak ose më shumë se 10%. Zona A shtrihet nga 5 m deri në 20 m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta. Zona B shtrihet nga 100 m deri në 200 m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore.

Sistemet e kanalizimeve dhe kullimit për mbarëvajtjen e tokave bujqësore rregullohen nëpërmjet ligjit nr. 8518, datë 30.07.1999, "Për ujitjen dhe kullimin", i ndryshuar. Sistemet e kullimit që janë pronë shtetërore mund të kalojnë në përdorim apo në pronësi të një federate, organizate ose bordi, pa ndryshuar destinacionin, vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 9). Sipas strategjisë së decentralizimit[346] dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor (draft), sistemet dytësore dhe tretësore të ujitjes dhe kullimit i kalojnë në administrim bashkive si funksion i tyre.

Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", i ndryshuar, përcakton rregullat e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura, duke përfshirë ujërat e ndotura urbane, ujërat e ndotura industriale, ujërat nga kullimi i tokave bujqësore dhe ujërat e ndotura të çdo lloji. Sipas VKM-së nr. 671, datë 29.07.2015, distanca minimale e mbrojtjes nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza është 200 m për kapacitet më pak se 5,000 banorë dhe 1,000 m për kapacitet 1,000-50,000 banorë.

- **Tokat bujqësore**

Territori i bashkisë së Kuçovës ka një sipërfaqe modeste prej rreth 84 km^2 (52%) tokë bujqësore[347]. Legjislacioni në fuqi dhe ligji nr. 9244, datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, përcaktojnë mbrojtjen nga ndërtimet, mbrojtjen e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit, si dhe zbatimin e një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar, përveç ndërtimeve të përkohshme të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuara në vendimin e KM-së nr. 283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore". Në të gjitha kategoritë e bonitetit miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtim bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor.

- **Industrira e Naftës**

Kuçova ka një nga dy zonat naftë mbajtëse kryesore të Shqipërisë. Kjo zonë është marrë nga Sherwood Petroileum Ltd. (degë e Bankers Petroleum Ltd.) e cila ka një marrëveshje të aprovuar me VKM, nr. 686, datë 19.10.2007, për veprimtari tridhjetë vjeçare[348]. Kuçova ka 12 milion fuçi nafte reservë, ose 7.1% të rezervave kombëtare[349,350]. Të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, janë pronë ekskluzive të shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga ministria përkatëse. Në bazë të kushteve të specifikuara në rregulloret e hartuara në përputhje me ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)" i ndryshuar, një kontraktori mund t'i jepet e drejta për të hyrë dhe përdorur tokë publike, ose private për të kryer operacione hidrokarburesh nën marrëveshjen e hidrokarbureve, ku kontraktori është palë.

Kuçova trashëgon pasuri dhe një kulture industriale, si uzina mekanike e naftës, uzina e riparimit të avionëve, prodhim i detergjentëve larës, prodhim karton-katërma dhe bitum i oksiduar etj. Disa nga këto fabrika janë privatizuar[351], ose janë mbyllur. Ekziston gjithashtu mundësia për vënien në punë e një TEC-i që ndodhet pranë qendrës së qytetit. Sipas VKM nr. 671 datë 29.07.2015 objektet industriale, ato të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes

së energjisë elektrike, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, kanë një gjerësi minimale të zonës mbrojtëse sanitare prej 50 m përgjatë gjithë vijës kufizuese të saj dhe një distancë minimale të mbrojtjes prej 200 m. Këto vlera rriten sipas llojit të objektit e tekonologjisë së përdorur, si dhe shkallës së ndotjes së zonës industriale gjatë projektimit të saj.

Çështje të tjera që lidhen me rëndësinë kombëtare në territor janë rrugët dhe distancat e tyre mbrojtëse, rregullat për sistemin e kullimit dhe të vaditjes, zonat e mbrojtura natyrore dhe rregullat për industrinë e naftës. Sa i përket rrugëve dhe kullimit e vaditjes, ato janë trajtuar në kapitujt përkatës të analizës, ndaj nuk po i ripërsërisim këtu. Kuçova nuk ka zona të mbrojtura natyrore, sipas legjislacionit përkatës.

1.11 Analiza e periferialitetit

Analiza e periferialitetit është mjeti që ndihmon në identifikimin e shpërndarjes së pabarazive social-ekonomike brenda territorit administrativ që po studiohet. Kjo analizë bazohet në mbivendosjen e gjetjeve (shtresave) të analizave social-ekonomike dhe synon të klasifikojë zonat e ndryshme në qytet nga ato më të preferueshmet deri tek ato më të pafavorizuarat. Ky klasifikim e ndihmon bashkinë në përzgjedhjen e strategjive investuese dhe projekteve prioritare në PPV, që janë:

- largësia nga qendra e zonës së banuar;
- largësia nga qendrat e punësimit;
- lidhja me sistemin rrugor;
- furnizimi me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale;
- niveli më i përafërt i të ardhurave të shtresave shoqërore;
- plotësimi me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës;
- niveli i kriminalitetit dhe sigurisë së jetës;
- probleme të ndryshme sociale, përfshirë përjashtimin social.

Mbivendosja e hartave që tregojnë rrezet e shërbimit të infrastrukturave arsimore, sociale, shëndetësore, rrugore e nëntokësore, si dhe qendrave të punësimit dhe shërbimeve ekonomike krijon mundësinë që të identifikohen në territor zonat e favorizuara (të cilat mbulohen nga rrezet e shërbimit të infrastrukturave publike dhe gjenden në afërsi të zonave ekonomike) nga ato të pafavorizuarat, duke identifikuar kështu zonat ku ka më tepër nevojë për ndërhyrje dhe investime publike.

Kjo analizë, e mbivendosur me analizën demografike, krijon lehtësi në përllogaritjen e numrit të banorëve që banojnë në zona të pafavorizuara dhe të mangësive infrastrukturore që ato kanë, proces mbi të cilin bazohet vendimmarrja përsa i përket ndërhyrjeve prioritare në terren.

Analiza e periferialitetit ka fokus kryesor identifikimin e zonave të banimit periferike të bashkisë së Fierit dhe evidentimin e problematikave kryesore të këtij qyteti.

- **Metodologjia**

Si fillim është paraqitur rrjeti i infrastrukturës ekzistuese rrugore, rrjeti ekzistues i ujësjellësit dhe kanalizimeve, si dhe janë identifikuar institucionet arsimore dhe shëndetësore në territorin administrativ të bashkisë.

Për objektet arsimore dhe shëndetësore rrezja e mbulimit të këtij shërbimi është përcaktuar sipas standardeve. Gjithashtu, evidentohen edhe të gjitha akset kryesore të lëvizjes me zonat e influencës për shërbimet e ofruara sipas standardeve.[352] Skema e mëposhtme tregon mbivendosjen e këtyre elementeve qendrore, siç janë institucionet arsimore, shëndetësore, si dhe infrastrukturën kryesore rrugore dhe nëntokësore.

Nga mbivendosjet e të gjitha hartave që tregojnë rrezet e shërbimit të infrastrukturave arsimore, sociale, shëndetësore, rrugore e nëntokësore rezultojnë të ndërthurura zona të caktuara.

Në varësi të mbulimit të tyre nga shërbimet e infrastrukturave publike mund të klasifikohen disa kategori në lidhje me periferialitetin: ato më periferiket, të cilat nuk mbulohen nga asnjë nga shërbimet publike, ato të cilat mbulohen nga të gjitha shërbimet publike, ato të cilat mbulohen nga vetëm tri shërbime, ato që mbulohen nga dy shërbime ose një shërbim.
A. Arsim
S. Shëndetësi
U. Ujësjellës-Kanalizime
I. Infrastrukturë rrugore

Më poshtë janë kategoritë bazë të identifikimit të periferialitetit në hartë:

- **Kategoria 1:** Zonat që mbulohen nga të gjitha shërbimet **(A+S+U+I), të shërbyera shumë mirë**
- **Kategoria 2:** Zonat që mbulohen nga tri shërbime **(ASU, AUI, ASI, SUI), të shërbyera mirë**
- **Kategoria 3:** Zonat që mbulohen nga dy shërbime **(AS, AU, AI, SU, SI, UI), problematike me shërbimet publike**
- **Kategoria 4:** Zonat që mbulohen nga një shërbim **(A, S, U, I), periferike**
- **Kategoria 5:** Zonat që nuk mbulohen nga asnjë shërbim, **shumë periferike**

Kategoritë bazë të klasifikimit të periferialitetit janë rezultat i ndërthurjeve të shërbimeve të ndryshme publike, sipas treguesve të planifikimit për infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore.[353]

Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore:

Tabela 78. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore

Infrastruktura arsimore	Numri i banorëve që shërbehet nga një njësi shërbimi		Rrezja e shërbimit		Standardet e projektimit	
	Zona urbane	Zona rurale	Zona urbane	Zona rurale	Për ndërtesën	Për parcelën
Çerdhe	1000	1000	200-300m	200-300m	25m^2-30m^2/ fëmijë	900m^2-1500m^2
Kopësht	1500	1500	250-350m	500-600m	18m^2-25m^2/ fëmijë	1000m^2-1500m^2
Shkollë 9-vjeçare	6000	6000	500-600m	1000-1500m	20m^2-25m^2/ fëmijë	1500m^2-7000m^2
Shkollë e mesme	9000	9000	1000-1500m	2000-4500m	20m^2-30m^2/ nxënës	2000m^2-7000m^2


Burimi: Rregullorja e Planifikimit- VKM nr. 671

Tabela 79. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën shëndetësore

Infrastruktura shëndetësore	Sipërfaqja (m^2)	Treguesi i njësisë banuese
Qendra shëndetësore	300 – 400	Një për 250-1,500
Ambulancë–konsultore- maternitet	400 – 6,000	
Ambulancë–konsultore	700 – 1,000	Një për 1,500 – 2,000
Poliklinikë	2,000 – 5,000	
Dispanseri	3,000	
Drejtori e higjienës epidemiologjike	2,000 – 3,000	
Qendër dezinfektimi, deratizimi	2,000	

Burimi: Rregullorja e Planifikimit- VKM nr. 671

Figura 167. Harta e analizës së periferialitetit



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Sipas kategorizimit të periferialitetit në Bashkinë e Kuçovës, njësitë administrative të saj që cilësohen si zona të shërbyera shumë mirë, sepse në to ofrohen të gjitha shërbimet - **Kategoria I (A+S+U+I)**- janë: njësia e Kozarës - disa zona banimi në pjesën veriore dhe lindore të saj; njësia e Perondisë - disa zona banimi në perëndim dhe në juglindje të saj; njësia e Kuçovës - pothuajse e gjithë sipërfaqja e saj.

Si zona të shërbyera mirë që mbulohen të paktën nga tri shërbime, **Kategoria II-të (ASU, AUI, ASI, SUI- arsim- shëndetësi- ujësjellës, arsim- ujësjellës- infrastrukturë, arsim- shëndetësi- infrastrukturë, shëndetësi- ujësjellës- infrastrukturë),** janë përgjithësisht të gjitha njësitë administrative të bashkisë së Kuçovës. Njësitë administrative në Kuçovë të cilat mbulohen nga shërbimet e arsimit (kopësht, arsim i ulët, arsim i mesëm), shëndetësisë dhe infrastrukturës (ASI) janë njësia e Kuçovës, e Kozarës dhe e Lumasit. Me arsim,

shëndetësi dhe ujësjellës (ASU) mbulohen zona të caktuara banimi në Kuçovë, në Kozarë, në Perondi. Me shëndetësi, ujësjellës dhe infrastrukturë (SUI) mbulohen disa zona banimi në Kozarë dhe Perondi.


Zonat që mbulohen nga dy shërbime **(AS, AU, AI, SU, SI, UI), problematike me shërbimet publike,** janë ato të kategorisë së III-të të periferialitetit. Përgjithësisht, me to mbulohen të gjitha njësitë administrative të Kuçovës (NjA Kuçovë, Lumas, Kozarë). Me arsim dhe shëndetësi (AS) mbulohen disa zona banimi në qendrën e Kuçovës, në Lumas, Perondi dhe Kozarë. Me shëndetësi dhe infrastrukturë (SI) mbulohen disa zona banimi në Kozarë, Kuçovë, Lumas dhe Perondi, kurse me shëndetësi dhe ujësjellës (SU) mbulohen disa zona banimi në Kozarë, Kuçovë, Lumas dhe Perondi.

Në kategorinë e IV-t të periferialitetit, ku përfshihen zonat që mbulohen nga një shërbim **(A, S, U, I)** dhe që klasifikohen si **periferike,** bëjnë pjesë të gjitha njësitë administrative në Kuçovë, sepse të gjitha mbulohen nga të paktën një shërbim.

Në kategorinë e V-të të kësaj analize përfshihen ato zona të cilat nuk mbulohen nga asnjë shërbim publik, zona këto të karakterizuara si shumë periferike. Këtu nuk bën pjesë asnjë nga zonat e banimit të Kuçovës.

Më poshtë përfshihen të dhënat e numrit të banorëve për secilën njësi administrative të bashkisë së Kuçovës sipas kategorive të periferialitetit.


Figura 168. Grafiku i periferialitetit për Kozaren



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Kozarës,** sipas klasifikimit të kategorisë 1 të periferialitetit, mbulon 1,454 banorë. Sipas kategorisë së 2-të mbulohen 3,349 banorë. Sipas kategorisë së 3-të mbulohen 1,102 banorë. Sipas kategorisë së 4-t mbulohen vetëm 100 banorë.


Figura 169. Grafiku i periferialitetit për Kuçovën



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Kuçovës,** sipas klasifikimit të kategorisë 1 të periferialitetit, mbulon 9,280 banorë. Sipas kategorisë së 2-të mbulohen 2,173 banorë. Sipas kategorisë së 3-të mbulohen 12 banorë. Sipas kategorisë së 4-t nuk mbulohet asnjë banor.


Figura 170. Grafiku i periferialitetit për Lumas



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Lumasit,** sipas klasifikimit të kategorisë 1 të periferialitetit, nuk mbulon asnjë banor. Sipas kategorisë së 2-të mbulohen 3,000 banorë. Sipas kategorisë së 3-të mbulohen 731 banorë. Sipas kategorisë së 4-t mbulohen vetëm 92 banorë.

Figura 171. Grafiku i periferialitetit për Perondinë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Perondisë,** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit, mbulon 5,712 banorë. Sipas kategorisë së 2-të mbulohen 8,045 banorë. Sipas kategorisë së 3-të mbulohen 1,331 banorë. Sipas kategorisë së 4-t mbulohen vetëm 51 banorë.


Më poshtë janë paraqitur tabela dhe grafikë sipas sipërfaqes dhe numrit të banorëve, sipas kategorive përkatëse të periferialitetit.

Tabela 80. Treguesit për sipërfaqen dhe popullsinë për periferialitetin

Kategoria	Sipërfaqja (%)	Popullsia (%)	Popullsia (banorë)
Të shërbyera shumë mirë Kat 1	2%	45%	16,447
Të shërbyera mirë Kat 2	5%	45%	16,567
Problematike me shërbimet publike Kat 3	50%	9%	3,177
Periferike Kat 4	45%	1%	242


Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Figura 172. Grafiku i periferialitetit për sipërfaqen e bashkisë Kuçovës



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Figura 173. Grafiku për popullsinë sipas kategorive përkatëse të periferialitetit bashkia Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Më poshtë është paraqitur një tabelë që përfshin të gjitha të dhënat për çdo njësi administrative përsa i përket sipërfaqes sipas çdo kategorie të klasifikimit të periferialitetit dhe numrit të banorëve në çdo kategori në secilën njësi.

Tabela 81. Treguesit për sipërfaqen dhe popullsinë sipas kategorive të periferialitetit në secilën njësi administrative të Kuçovës

Njësia Administrative	Kategoria e periferialitetit														
	Kategoria 1 (të shërbyera shumë mirë)			Kategoria 2 (të shërbyera mirë)			Kategoria 3 (problematike me shërbimet publike)			Kategoria 4 (periferike)			Kategoria 5 (shumë periferike)		
	Popullsia		Sip. (%)	Popullsia		Sip. (%)	Popullsia		Sip. (%)	Popullsia		Sip. (%)			Sip. (%)
	Nr.	%		Nr.	%		Nr.	%		Nr.	%		Nr.	%	
Kuçovë	9,280	25.5	1.00	2,173	5.96	0.86	12	0.03	0.1	0	0	0.00	0	0	0
Kozarë	1,454	3.99	0.37	3,349	9.19	0.76	1,102	3.02	15.4	100	0.27	10.3	0	0	0
Lumas	0	0	0	3,000	8.23	0.59	731	2.01	17.3	92	0.25	29.8	0	0	0
Perondi	5,713	15.68	0.93	8,045	22.08	1.16	1,331	3.65	17.0	51	0.14	4.6	0	0	0

Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Rezulton se asnjë banor në njësitë e Kuçovës nuk përfshihet në kategorinë e 5-të, atë më periferiken. Kjo do të thotë që asnjë familje nuk klasifikohet si ato më periferiket e që nuk kanë mbulim nga asnjë infrastrukturë publike.

1.12 Konkluzione dhe rekomandime për planin

Tendecat kryesore të zhvillimit dhe pozicioni gjeografik

Bashkia Kuçovë është pjesë e qarkut të Beratit dhe shtrihet në pjesën lindore të ultësirës perendimore Shqipëtare. Pjesa jugperendimore e bashkisë ka reliev fushor ndërsa zonat në verilindje dhe në lindje janë zona me reliev kodrinor-malor. Bashkia Kuçovë përfshin 4 njësi administative: NjA Kuçovë, NjA Perondi, NjA Kozare dhe NjA Lumas. Kjo bashki kufizohet me bashkitë e Lushnjes, Belshit, Cërrikut, Gramshit, Beratit dhe Urës Vajgurore.

Bashkia Kuçovë ka një identitet të fuqishëm industrial, të trashëguar që në shek. XVIII dhe të fuqizuar në periudhën e themelimit si "Qyteti i Naftës". Pavarësisht statusit aktual në stanjacion të kësaj industrie, ky potencial duhet ripërdorur në mënyrë të re dhe efikase për ekonominë lokale.

Kemi dy spikatje të rëndësishme kulturore (dhe potenciale për turizmin) janë Kisha bizantine e Shën Nolli në Perondi, dhe Kisha Ungjillizimit e Salcë-Kozares.

Zhvillimi hapësinor në Kuçovë ka pësuar rritje të madhe territoriale në periudhën 1990-2007, më pas ka qëndruar pothuajse i njëjtë.

Metabolizmi

Energjia gjeotermale në territorin e Kuçovës mund të përftohet nga uji i shtresave kolektore që gjendet në puset e naftës, për ngrohjen e serave. Numri i ditëve me diell dhe sasia e rrezatimit diellor në territorin e Kuçovës janë mjaft të favorshme për t'u përdorur si burim energjie. Një nga mënyrat e përdorimit të kësaj energjie do ishte nëpërmjet paneleve fotovoltaike, për ngrohjen e banesave etj

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm duhet të shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë. Ky sistem furnizimi duhet të jetë kryesisht konvencional (rrjet tubacionesh) në zonat ku është e nevojshme, ndërsa në zonat ku uji mund të nxirret nëpërmjet puseve mund të përdoret kjo metodë. Thuajse i gjithë territori shtrihet në formacion ujëmbajtës (akuifer me porozitet çarje-karst dhe përcjellshmëri shumë të lartë të lartë uji), ndaj është më i ndjeshëm ndaj ndotjes që mund t'iu shkaktohet ujërave nëntokësore dhe tokës.

Fluksi i ushqimit tregon që kulturat bujqësore që kanë prodhim më të lartë në Bashkinë Kuçovë janë perimet, drithërat, drufrutorët si: pemët frutore, ullinjtë dhe vreshtat. Pra Kuçova nuk është e specializuar në një kulturë specifike, por ka një sasi prodhimi të përafërt të kulturave të sipërpërmendura.

Duhet që mbetjet të diferencohen patjetër që në burim, në mënyrë që të ketë një nivel më të lartë riciklimi. Vend-depozitimi që ndodhet në Tapi, pranë shtratit të Lumit Devoll duhet të mbyllet dhe sipas standardeve përkatëse dhe të transferohet si landfill sanitar-inxhinierik në një territor gjeologjikisht dhe teknikisht të përshtatshëm, larg akuifereve dhe me përshkueshmëri të ulët.

Mjedisi dhe ekosistemet

Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Devollit, Osumit e Semanit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e këtyre lumenjve përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e lumenjve të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje.

Për të shmangur degradimin e tokave dhe rrezikimin e shëndetit të njeriut nëpërmjet konsumit të produkteve të rritura në toka të ndotura nga nafta, është e nevojshme që bashkia të përcaktojë qartë kufirin e ndarjes ndërmjet tokave bujqësore dhe atyre industriale.

Përveç mbrojtjes së burimeve ujore, bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së degradimit të tokës nga praktikat bujqësore të paqëndrueshme. Për këtë arsye, është e nevojshme që bashkia të krijojë kushte që shmangin problemet që vijnë me bujqësia intensive duke futur shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore pa cenuar qëndrueshmërinë e saj.

Duke qenë zonë me burime të shumta nafte me shfrytëzim intensiv, është e rëndësishme që të kryhen studime që përcaktojnë gjendjen e nëntokës për të shmangur rreziqet që mund të kanosen nga shembje të ndryshme të saj, sidomos në një kohë kur teknologjia e shfrytëzimit të naftës së përdorur është shumë e përparuar dhe e re, dhe kur ndikimi i së cilës në mjedis ende debatohet.

Në territorin e bashkisë ndodhen edhe disa vatra të nxehta mjedisore. Duke pasur parasysh rreziqet që vatrat e nxehta mjedisore paraqesin për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, nevojitet që të merren masa për pastrimin dhe rehabilitimin e tyre sa më të shpejtë.

Bashkia ndeshet edhe me sfidat e ndotjes së ajrit nga industria e naftës dhe burime të tjera. Dy nga ndotësit më të përhapur në qytetin e Kuçovës dhe në zonën përreth janë LNP-ja, e cila e ka origjinën nga automjetet që lëvizin në zonë, dhe H2S e cila e ka origjinën nga industria nxjerrëse e naftës që operon në zonë. Ndërkohë, falë industrisë nxjerrëse të naftës, lëndë të tjera ndotëse në ajër të cilat nuk janë mbi normat e lejuara janë edhe oksidet e squfurit, si trajta SO2 dhe benzeni C6H6. Ndërkohë një burim tjetër ndotje në zonën e qytetit të Kuçovës është edhe fabrika e prodhimit të tullave dhe impianti i prodhimit të asfalto- betonit. Prania e kësaj industrie në zonë ka sjellë praninë e grimcave ndotëse të ajrit si PM10, PM2.5, C, S të cilat në të shumtën e rasteve janë mbi normat e lejuara, duke u bërë burim i shumë sëmundje të mushkërive dhe ndotjes së mjedisit. Në këto kushte, Bashkia Kuçovë duhet të marrë masa për shtimin e hapësirave të gjelbra pranë industrive ndotëse, si dhe të bashkëpunojë me inspektoratet shtetërore dhe vendore të mjedisit për kontrollin e vazhdueshëm të zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore të këtyre bizneseve.

Për të parandaluar efektet e mundshme negative të ndryshimeve klimaterike, duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.

Zhvillimi ekonomik

Treguesit makroekonomikë në nivel qarku vlerësojnë se Qarku Berat është ndër 5 qarqet që kontribuojnë më pak në PBB e vendit, dhe ka tendenca uljeje të vlerave të PBB ndër vite.

VSHB më e madhe në nivel qarku i takon bujqësisë, ndjekur nga industria. Gjithsesi produktiviteti më i lartë është i sektorit të shërbimeve, gjë që tregon se ky është sektor që vlen për të investuar.

Sektori bujqësor përfaqësohet nga një numër prej 5,318 fermash bujqësore, blegtorale e mikse, si dhe 37 subjekte agro-përpunuese. Numri i fermave është mjaft përfaqësues në Qarkun Berat, dhe veçanërisht prodhimi i perimeve të serës, foragjereve, bostanoreve, dhe rendimenti i lartë prodhues i qumështit të lopës, të dhisë, mishit të gjedhit dhe të të imëtave. Gjithsesi në Kuçovë nuk ka pikë grumbullimi bujqësore, por më e afërta ndodhet në Kutalli të Lushnjes.

Sektori industrial përfaqësohet nga disa subjekte agro-përpunuese të industrisë së lehtë, si dhe industria e nxjerrjes së naftës, e përpunimit të saj. Numri i puseve në bashkinë Kuçovë është më i larti në gjithë zonat naftëmbajtëse në Shqipëri, ndërkohë që punësimi në këtë sektor zë vetëm 17% të të punësuarve në nivel bashkie.

Ekonomia e Bashkisë Kuçovë është e orientuar drejt ekonomisë agrare, por sektori bujqësor nuk është aq mbizotërues sa në bashki të tjera fqinje. Potencialisht, sektori i shërbimeve vlen për t'u zhvilluar, duke qenë se aktualisht zë 30% të të punësuarve.

Demografia

Bashkia Kuçovë në 1 janar 2015 regjistroi një numër të popullsisë rezidente prej 31 mijë banorë (sipas INSTAT), me një koefiçent të raportit gjinor të vlerësuar në 101 (101meshkuj për çdo 100 femra). Sipas strukturës moshore rreth 68% e kësaj popullsie i përket grup-moshës (15-64) vjeç dhe 19% në grupmoshën (0-14) vjeç, tregues këta që demonstrojnë potencial të lartë të popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e së cilës në tregun e punës do të rrisë performancën ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregon së akoma kemi një popullsi të re.

Sipas projeksioneve të popullsisë-skenari i rritjes së mesme- popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.

Përsa i përket numrit të popullsië nga Gjendja Civile na rrezlton se në Bashkinë Kuçovë kemi një popullsi prej 56083 banorësh. Në krahasim me numrin e popullsisë nga INSTAT ka ndryshime të mëdha. Gjithsesi në PPV janë analizuar të dhënat nga dy burimet e informacionit.

Zhvillimi Social

Sa i takon infrastrukturës arsimore, bashkia Kuçovë ka mbulim të mirë me të tre nivelet e arsimit (parashkollor, 9-vjeçar dhe të mesëm). Disa fshatra me distancë të largët nga institucionet arsimore më të afërta janë: Frashëri, Luzaj dhe Katundas në lidhje me kopshtet, Lumasi e Katundasi në lidhje me shkollat 9-vjeçare dhe, përveç tyre, edhe Driza, Koritëza e Sheqëzi në lidhje me shkollat e mesme.

Raporti mësues-nxënës, si tregues i kapacitetit të mësimdhënies, rezulton të jetë relativisht favorizues në krahasim me standardet e BE, si dhe mesataren kombëtare, sidomos për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.

Në bashkinë Kuçovë gjenden 20 institucione shëndetësore, nga të cilat 1 spital (në qytetin e Kuçovës), 6 qendra shëndetësore, 7 ambulanca konsultore, 3 shërbime dentare dhe 3 farmaci. Kërkohet të shtohet një qendër shëndetësore në njësinë Perondi dhe 2-3 qendra shëndetësore, ose ambulanca konsultore në njësinë Kuçovë, për të përmbushur standardet e kërkuara të sigurimit të shërbimit parësor.

Strehimi Social

Përsa i përkët gjendjes së strehimit, nga analiza e strehimit social vërehet se rreth 28 familje kanë marrë miratimin nga Këshilli Bashkiak për ndërtimin e banesave sociale për to si dhe 43 familje të cilat do te zhvendosen nga zona e tyre e banimit që është zona industriale e ish-UPN dhe rreth 15 familje të tjera në kuader të planit do të zhvendosen, sepse banesat e tyre aktuale vlerësohen të jenë në një distancë mjaft të afërt me puset e naftës. Në total kemi rreth 86 familje të cilat do zhvendosen në një zonë e cila do të shfrytezohet për strehim social. Duhet thënë se numri i aplikantëve për strehim social në Bashkinë Kuçovë është 440 familje që është një numër mjaft i lartë.

Infrastrukturat

Sistemi Rrugorë dhe Transporti: Bashkia e Kuçovës lëvizshmërinë më të lartë përsa i përket transportit ndërqytetas e ka me qytetin e Tiranës dhe Beratin.

Sipas draftit të Planit Kombëtar 2015-2030 në Kuçovë do të kalojë boshti qëndror jugor i cili vjen nga Papëri dhe përfundon në Memeliaj në të cilë bashkohet me korridorin e kaltër. Ky është një nga investimet më të rëndësishme të infrastrukturës rrugore që pritet të ndërtohet në vendin tonë.

Nga analiza e infrastrukturës rrugore, një nga problemet kryesore që është evidentuar nga grupi i punës janë hyrje daljet (intersect-et) e rrugëve lokale me rrugët interurbane kryesore. Kjo analizë është bërë në GIS dhe janë evidentuar 157 pika konfliktuale të cilat janë burim aksidenti për këtë bashki.

Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura: Kanalizimi i ujërave të ndotura është i pjesshëm, edhe në vetë zonë urbane në Kuçovë (ofrohet vetëm në qytetin e Kuçovës 70%).

Shërbimi i orfuar është në nivele të pakënaqshme, pasi sistemi i kanalizimeve të ujrave të ndotura është në pjesën më të madhë i bllokuar, i dëmtuar, ose është shtrirë në mënyrë të pakontrolluar dhe jashtë standardeve higjieno-sanitare.

Zonat Rurale nuk kanë rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura (largimi i ujrave bëhet nëpërmjet gropave septike, jashtë standardeve higjeno-sanitare, ose nëpërmjet kanaleve të hapura kulluese që kalojnë fare pranë zonave të banuara).

Impianti i trajtimit të ujrave të ndotura urbane duhet parashikuar të ndërtohet paralelisht me reahbilitimin apo ndërtimin e sistemit të ri të grumbullimit të ujrave të ndotur. Një studim përcjellës nevojitet për të përcaktuar karakteristikat dhe elementet kryesore ndotës të ujrave në Kuçovë në mënyrë që të përzgjidhet metodologjia dhe teknika më e përshtatshme trajtuese në impiant.

Duke vlerësuar së Kuçova gjeneron ujra të ndotura industriale, sidomos ato të cilat futen në proçeset e përpunimit të naftës, bartin elementë si metale të rënda, squfur etj. të cilat jo vetëm janë shpesh në nivele toksike por kanë impakt të drejtpërdrejt në biotën ujore me të

cilën vihen në kontakt. Si rrjedhoj do të propozohet që këto ujra të kenë një sistem të dedikuar grumbullimi – trajtimi – monitorimi e shkarkimi.

Ndriçimi i mjediseve publike: Në Bashkinë Kuçovë shërbimi i ndriçimit publik ofrohet në Qytetinin e Kuçovës , në NJA Kozare, dhe në NJA Perondi ndërsa në NJA Lumas ky shërbim nuk ofrohet.

Ofrimi ë ishërbimit të ndricmit publik në Qytetin e Kuçovës është mjaft i kënaqshëm. Rreth 94 % rrjetit rrugor të qytetit është e ndriçuar ndërsa të pa ndriçuara janë disa akse terciare të qytetit. Investimet kryesore në këtë fushe janë bërë pas viteve 90 megjithate në qytet kemi disa zona në të cilat rrjeti i ndriçimit publik nuk funksionon kemi rreth 80 koka ndriçimi në një gjatësi prej 1600 m. Arsyeja e mosfunksionimit është mungesa e kabllit lidhës.

Sherbimi i ndriçimit publik në NJA Kozare është i shtrirë në rreth 4 akse rrugore, në një gjatësi prej 3746 m me një numer prej 120 ndriçusash. Nga 120 rreth 54 janë jashtë funksioni. Arsyeja kryesore mosfunksionimit është dëmtimi i kokave të ndriçuesve

Në NJA Perondi kemi rreth 2326 m rrjet rrugor të ndriçuar me një numer prej 59 ndriçusash ku 10 ndriçusa

Mbetjet e Ngurta: Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për qytetin e Kuçovës, si dhe për njësitë Perondi e Kozare, në një shkallë të mirë mbulimi, një herë në ditë.

Vend-depozitimi i mbetjeve të ngurta në meandrin e Lumit Devoll, në afërsi të fshatit Rreth Tapi, është një ndër vartat e nxehta më të rëndësishme të bashkisë, pasi toka në këtë zonë është shumë aluvionale dhe mbetjet e lëngshme, duke shkaktuar jo vetëm shtresat nëntokësore, por edhe ujërat nëntokësorë dhe vetë ujërat e lumit

Sistemi i kullimit dhe ujitjes: Argjinaturat e Lumit Devoll në terrtiorin e Bashkisë Kuçovë janë në një gjendje të mirë, ndërsa argjinaturat e Lumit Seman dhe Osum në afersi te kësaj bashkie kanë nevojë për rehabilitime të pjesshme.

Rezervuarët me gjendjen më problematike janë Rezervuarët e Belesovës dhe Fier-Mimarit të cilët ujisin një pjesë të madhe të tokave në Bashkinë e Kuçovës.

Rrjeti i infrastrukturës bujqësore në një masë prej 78.3% është i bllokuar tërësisht ose në mënyrë të pjesshme.

Sistemet territoriale dhe përdorimi i tokës

Përdorimi bujqësor është dominues dhe burimi kryesor në nivel bashkie. Pjesa më e madhe e tokës bujqësore është tokë arë e kultivuar.

Konfliktet kryesore në përdorimet e papërputhshme lidhen me vendndodhjen e puseve të naftës në afërsi të zonave të banuara dhe në mes të tokës bujqësore të kultivuar, si dhe shumë pranë brigjeve lumore. Duhen marrë masa për uljen e efektit negativ të tyre në mjedis, apo rrezikun e kontaminimit të tokës dhe ujërave.

Zonat e përpunimit të naftës ndodhen shumë pranë qendrës së banuar dhe nuk janë të izoluara në mënyrë të mirë, pavarësisht përdorimit të filtrave për emetimet në ajër.

Tipologjitë Ndërtimore

Nga pikmapja e zhvillimit ndërtimor, tipologjitë më të përhapura janë vilat me densitet shumë të ulët që përbëjnë rreth 40% të territorit të ndërtuar. Kjo është një karakteristikë që dëshmon për karkaterin mjaft rural dhe periferial që ka bashkia si dhe pjesa më e madhe e vendbanimeve janë të shpërhapura në territor. Tipologji mjaft të përhapura rezultojnë dhe tipologjitë e vilave me densitet të ulët të cilat janë banesat individuale 1-3 katëshe. Në në këto tipologji klasifikohen dhe sipërfaqet e serave si tipologji në bujqësi të cilat përbëjnë rreth 13 % të sipërfaqes së ndërtuar. Tipologjitë ndërtimore industriale zënë rreth 9% të hapësirave të ndërtuara. Më pas vijnë tipologjitë ndërtimore siç janë: vilat me dendësi të lartë , vilat me dendësi të mesme , ndërtesat gjatsore me dendësi të lartë, ndërtesat gjatosre mikse me kulla sidhe ndërtesat gjatsore miks me vila. Këto tipologji kryesisht ndodhen në qytetin e Kuçovës të cilat kanë përqindje të ulëta në krahasim me tipologjitë e tjera ndërtimore.

2. Plani i Zhvillimit të Territorit

2.1 Plani i propozimeve territoriale

2.1.1 Thellimi i vizionit territorial të zhvillimit

Në këtë seksion të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kuçovë përfshihen propozimet që zhvillohen në kuadër të këtij plani. Ky plan ndërmerr propozime në fusha të ndryshme, të madhësive të ndryshme dhe të natyrave të ndryshme.

Plani bazohet në skemën e vizionit të përgjithshëm territorial të Bashkisë, ndaj ajo risillet në vijim të seksionit. Po ashtu, risillen objektivat stategjikë, programet e zhvillimit, si dhe projektet për çdo program, duke veçuar kësaj here transformimet madhore që propozon plani. Transformimet madhore janë projekte strategjike të një natyre katalitike e gjeneratore. Kanë efekt zinxhir në zhvillim, sepse realizimi i tyre indukton projekte të tjera më të vogla, si edhe aktivizon kapitalin privat në proceset e zhvillimit të territorit.


Një pikë mjaft e rëndësishme është edhe paqyrimi e përputhshmëria e PPV-së së Kuçovës me dokumentet kombëtare të planifikimit, siç është dokumenti i Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

Gjithashtu, do të evidentohen propozimet territoriale të cilat janë të ndara në fasha funksionale, qendërsi dhe zona. Propozimet kryesore territoriale janë: fashat natyrore lumore (fasha Osum-Seman, fasha Devoll dhe fasha Lapardhicë); fashat dhe mikrofashat e banimit (fasha e banimit Tapi-Rreth Tapi-Kuçove, mikrofasha e banimit Gegë dhe mikrofasha e banimit Drizë); fasha ekonomike (zona përgjatë aksit rrugor Ura Vajgurore-Kuçovë); qendërsia Kuçovë (kjo qendërsi do të trajtohet në dy zona: zona mikse dhe zona banimi); qendërsia e parkut rajonal të Kozarës; qendërsia e fshatit Kozarë; qendërsia e fshatit Lumas; si dhe mikroqendërsitë ku përfshihen të gjitha zonat e banuara të vogla, të cilat do të kenë zhvillime minimale. Propozimet infrastrukturore kryesisht kanë të bëjnë me rehabilitimin e akseve kryesore, si dhe ndërtimin e rrugëve të reja të cilat kanë rëndësi stategjike për bashkinë. Ndërsa evidentimi i karakterit të zonave të banuara ka të bëjë me vlerësimin e sektorëve kryesorë dhe potencialet kryesore për çdo zonë të banuar. Gjithashtu, do të shpjegohen ndërhyrjet strategjike të cilat i ndërmerr plani, si dhe platforma e ndërhyrjeve në territor.

- **Vizioni i përgjithshëm dhe projektet që ndërmerren në kuadër të PPV-së, Kuçovë**

Në bazë të analizave të thelluara, në bazë të konsultave me qytetarët, në bazë të dokumentit të Strategjisë Territoriale të bashkisë së Kuçovës, si dhe në bazë të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, *për 15 vitet e ardhshme Kuçova do të jetë një bashki e cila do të mbështetet në zhvillimin e qëndrueshëm duke shfrytëzuar me efiçencë burimet natyrore, e bazuar në një ekonomi të diversifikuar mbi potencialet që ofron, duke përmirësuar aksesin dhe lidhjet me qendrat e banuara përrreth dhe brenda saj, si dhe duke përmirësuar shërbimet sociale me qëllim rritjen e standardeve të jetesës.*

Figura 174. Vizioni i përgjithshëm i Bashkisë Kuçovë



- **Objektivat strategjike, programet strategjike dhe projektet**

<u>Objektivi strategjik 1</u>: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomiko-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Kuçovë në sektorin industrial, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.

<u>O1P1:</u> Zhvillimi i politikave nxitëse dhe mbështetja infrastrukturore për rikualifikimin dhe rritjen e performancës së zonave industriale të bashkisë.

Pr.1: Hartimi i PDV-së për rizhvillimin industrial të zonës së ish-UMN-së.

Pr.2: Sigurimi i infrastrukturës bazë për strukturat industriale dhe magazinuese në hyrje të qytetit (ndërtimi i infrastrukturave të nevojshme ndihmëse në afërsi të stacioneve të dekantimit të naftës).

O1P2: Rritja e performancës së sektorëve ekonomikë në bashkinë Kuçovë, zhvillimi i sektorit të shërbimeve, si dhe zhvillimi i sektorëve bujqësorë e blegtoralë në zonat me karakter rural, duke përmirësuar rrjetin e shkëmbimeve dhe tregtisë së produkteve bujqësore.

Pr.3: Krijimi i një pike grumbullimi të produkteve bujqësore në Kozarë.

Pr.4: Rritja e kapaciteteve të tregut aktual në Kuçovë dhe rigjenerimi i zonës.

Pr.5: Krijimi i një qendre agro-industriale për përpunimin, përgatitjen e prodhimeve në shkallë rrethi, si: produkte bujqësore dhe blegtorale në afërsi të tregut aktual.

Pr.6: Krijimi i zonës ekonomike me njësi tregtare dhe shërbimesh përgjatë aksit rrugor Kuçovë-Ura Vajgurore.

Pr.7: Programi për mbjelljen e fidanëve të rinj të drurëve frutorë në zonën e kodrave të qytetit të Kuçovës për të rritur prodhimin bujqësor.

Pr.8: Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Kuçovë.

O1P3: Nxitja e procesit të zgjerimit dhe densifikimit për të gjithë qendrat e njësive administrative, si dhe për disa fshatra me potencial urbanizimi.

Pr.9: Krijimi i PDV-së për polet e reja urbane në qytet që do t'i nënshtrohen rizhvillimit dhe rehabilitimit, duke siguruar parametra zhvillimi efikas.

Pr.10: Hartimi i PDV-së për zonat e zgjerimit në fshatrat Kozarë Qendër, Lumas, Perondi, Vodëz, si dhe fshatra të tjerë që do presin zhvillim.

O1P4: Përmirësimi i klimës së biznesit të vogël nëpërmjet politikave nxitëse dhe sigurimit të infrastrukturës së përshtatshme mbështetëse të tyre

Pr.11: Mbështetja e zhvillimit të NVM-ve dhe bizneseve të vogla artizanale në zonat ekonomike me karakter tregtar (qendra e zona ekonomike Kuçovë-UraVajgurore), nëpërmjet instrumenteve stimuluese në PDV.

Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.

O2P1: Konsolidimi i lidhjeve të bashkisë së Kuçovës në nivel rajonal, duke siguruar integrimin me rrjetet shtetërore rrugore.

Pr.1: Ndërtimi i Boshtit Qendror Jugor.

Pr.2: Rehabilitimi dhe ndërtimi i pjesshëm i unazës përrreth qytetit (rruga Kuçovë-Perondi- Magjatë- Dumollë- Goraj- Drizë- Gegë- Kuçovë).

Pr.3: Ndërtimi i rrugës tangjente që lidh aksin Kuçovë-Ura Vajgurore nga Kthesa e Fermës deri tek ura e lumit Devoll nëpërmjet ish-zonave industriale.

Pr.4: Rehabilitimi i rrugës së Belshit, si rrugë që luan rolin e Boshtit Kombëtar Qendror, në një periudhë afatmesme, si dhe rehabilitimi e ndërtimi i pjesshëm i rrugës Kuçovë- Arrëz.

Pr.5 Ndërtimi i dy urave, njëra mbi lumin Osum dhe tjetra mbi lumin Devoll.

O2P2: Integrimi i bashkisë së Kuçovës në tërësinë e itinerareve të gjelbra rajonale nëpërmjet infrastrukturës së lehtë e turistike

Pr.6: Krijimi i një rrjeti shtigjesh, të pajisur me sinjalistikën respektive dhe shërbimet ndihmëse, me destinacion Kozarë-Kuçovë-Gramsh e më gjerë.

O2P3: Përmirësimi i lidhjeve ndërqytetëse mes qendrave të njësive rurale me njëra-tjetrën dhe me Kuçovën.

Pr.7: Ndërtimi i rrugëve që lidhin Lumasin me qytetin e Kuçovës (Kuçovë- Magjatë- Sheqëz-Vodhëz-Lumas, Kuçovë-Goraj-Pashtraj- Bardhaj- Lumas, Kuçovë- Velagosht - Lumas).

Pr.8: Rehabilitimi i rugës Kuçovë- Perondi- Lapardha- Vodhëz- Lumas- Pëllumbas- Belesovë- Meandrake.

Pr.9: Rikonstruksioni dhe ndërtimi i urave që lidhin akset rrugore në dy anët e përroit të Lapardhicës (rehabilitimi i urës në afërsi të fshatit Vodhëz, rehabilitimi i urës në afërsi të fshatit Bardhaj, ndërtimi i urës së këmbësorëve në afërsi të fshatit Goriçan, ndërtimi i urës në afërsi të fshatit Lumas).

Pr.10: Rehabilitimi i aksit rrugor Perondi- Qoshk- Sheqëz- Bardhaj- Goriçan- Lumas- Langozaj.

Pr.11: Përmirësimi i gjendjes së ndriçimit dhe sinjalistikës horizontale dhe vertikale në të gjithë bashkinë dhe ndërtimi e pajisja me infrastrukturë KUZ e "Rrugës së Drizës" në lagjen "11 Janari", Kuçovë.

Pr.12: Rehabilitimi i akseve rrugore që lidhin fshatrat turistike në NjA Perondi dhe Lumas.

O2P4: Sistemimi i rrjeteve rrugore lokale për të rritur nivelin e jetueshmërisë në qytet dhe zona rurale

Pr.13: Rikonstruksioni i pjesshëm i akseve rrugore "Toli Shuka", "Koli Hoxholli", "Kongresi i Lushnjes", "Koço Koleci", "Ismail Qemali" dhe "Isa Boletini"; shtrimi i segmenteve rrugore nga sheshi "11 Janari" deri të tunelet e UMN-së, si dhe nga Policia deri të Spitali; mbikqyrja e punimeve të rrugës "K. Laçka- Q.Stafa" (në proces).

Pr.14: Ristrukturimi i rrugëve lokale të fshatit Magjatë e Bardhaj, i rrugëve në Kozarë, si dhe i rrugëve dytësore në Lumas.

Pr.15: Ndërtimi i korsive të biçikletave në qytetin e Kuçovës.

O2P5: Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, duke siguruar shërbim cilësor për të gjithë territorin e bashkisë

Pr.16: Ndërtimi i rrjetit të KUZ-it në fshatrat Drizë, Gegë, Kozarë.

Pr.17: Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit kullues në zonën pranë UPN-së, në seksionin Porta e Përpunimit-Hipotekë.

Pr.18: Rikonstruksioni i infrastrukturës së ujësjellësit në segmentin Çiflik-Kuçovë.

Pr.19: Hartimi i një plani afatgjatë për sigurimin e shërbimit të ujësjellësit në fshatrat Demollarë, Luzaj, Belesovë, Mendrakë, Sheqëz, Krekëz, Koritëz dhe Katundas, Lumas dhe Pëllumbas.

Pr.20: Rehabilitimi i sistemit të gropave septike në fshatrat që nuk kanë akses në rrjetin e kanalizimeve.

Pr.21: Përmirësimi tërësor i sistemit të kanalizimeve duke ndarë ujërat e bardha nga ato të zeza në qytet, si dhe duke siguruar mbulim me rrjet për të gjithë bashkinë.

Pr.22: Ndërtimi i një impianti të trajtimit të ujërave të zeza dhe ndërtimi i tubacionit kryesor paralel me kanalin e Dikatrës.

O2P6:Përmirësimi i situatës së lëvizshmërisë dhe transportit publik në nivel bashkie

Pr.23: Zhvillimi i një sistemi transporti publik brenda bashkisë për të siguruar aksesin e fshatrave Drizë, Perondi e Lumas drejt Kuçovës.

Pr.24: Sistemimi dhe zgjerimi i terminalit të autobusëve në qytetin e Kuçovës.

Pr.25: Mbulimi me transport publik efikas i gjithë territorit të bashkisë.

Objektivi strategjik 3: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integrimit me potencialet rajonale turistike.

O3P1: Rehabilitimi mjedisor dhe rigjenerimi i ish-zonave industriale në territorin e bashkisë me synim kthimin e tyre në zona banimi dhe rekreacion.i

Pr.1: Rehabilitimi mjedisor dhe rizhvillimi i zonës së TEC-it si pol kulturor e rekreativ.

Pr.2: Rehabilitimi mjedisor dhe ristrukturimi i ish-zonës industriale të Uzinës së Përpunimit të Naftës për të siguruar cilësi të mirë jetese, si dhe kthimi në hapësirë të gjelbër dhe rekreative.

O3P2: Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane duke përfshirë strategjitë për mbledhjen e diferencuar dhe reduktimin e mbetjeve, zhvendosjen dhe rregullimin e vendit të depozitimit ekzistues për t'u përshtatur me kushte më sanitare, si dhe mundësitë e kryerjes së kompostimit të mbetjeve organike.

Pr.3: Hartimi i një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel bashkie me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane, si dhe blerja e automjeteve për transportimin e mbetjeve urbane.

Pr.4: Ndërtimi i një landfill-i sanitar për depozitimin e mbetjeve urbane.

Pr.5: Hartimi i një strategjie dhe sigurimi i kushteve fizike për kompostimin e mbetjeve organike.

Pr.6: Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe kthimi në hapësirë të gjelbër me pemë të larta.

O3P3: Sistemimi në trajtë parku i zonës së kodrave të Kozarës duke shfrytëzuar elementet ekzistuese të peizazhit, me funksion "rekreacion" dhe reduktim të pasojave shqetësuese të zonës naftëmbajtëse.

Pr.7: Krijimi i një parku rajonal në zonën nga Rezervuari i Murrizit deri në fshatin Vlashuk.

Pr.8: Krijimi i një rrjeti bujtinash në fshatrat përreth parkut rajonal që të krijohen kapacitetet e duhura të hotelerisë në zonë.

O3P5: Rehabilitimi mjedisor i zonave ripariane të lumenjve dhe përrenjve

Pr.9: Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative të zonave ripariane të lumit Devoll dhe Osum-Seman.

Pr.10: Rehabilitimi mjedisor dhe marrja e masave për minimizimin e erozionit të tokave bujqësore përgjatë përroit të Lapardhicës.

Pr.11: Realizimi i masave infrastrukturore dhe vegjetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga lumenjtë Devoll dhe Osum.

O3P6: Hartimi i një plani për studimin e ndotjes reale të tokës dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën naftëmbajtëse të Kozarës

Pr.12: Kryerja e një studimi të integruar për vlerësimin e ndotjes nga nafta në tokë, ajër, ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Pr.13: Marrja e masave për rikuperimin e efekteve të dëmtimit dhe ndotjes nga nafta, përmirësimi i kushteve fizike të puseve.

O3P7: Reduktimi i efekteve negative të emetimeve të zonës industriale ekzistuese dhe zgjerimit të propozuar të saj

Pr.14: Hartimi i planit të reduktimit të emetimeve të zonës së UMN-së dhe industrisë tjetër në hyrje të qytetit, si dhe marrja e masave taksative për zbatimin e tij.

O3P8: Përmirësimi i imazhit të qytetit si "qytet i naftës", duke valorizuar identitetin në shërbim të turizmit nëpërmjet krijimit të Muzeut të Naftës dhe rehabilitimit të lagjes historike si pjesë të "qytetit-muze"

Pr.15: Ndërtimi i një objekti muzeal të naftës.

Pr.16: Ndërtimi i një muzeu të aeronautikës në zonën e fushës së aviacionit.

Pr.17: Hartimi i një strategjie për kthimin e një pjese të blloqeve '1 Maji' dhe 'Llukan Prifti' në lagje-muze për qëllime identifikimi dhe turistike.

Pr.18: Zgjatimi dhe kthimi në rrugë për këmbësorë i bulevardit kryesor të qytetit.

Pr.19: Kthimi i puseve të naftës në objekte tërheqëse (lyerja, vendosja e ndriçuesve) për t'i dhënë një pamje tjetër qytetit.

Objektivi strategjik 4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesi në aspektin social-kulturor.

O4P1: Rikonstruksioni i objekteve arsimore shëndetësore dhe me funksione publike me probleme fizike, si dhe përshtatja e mjediseve për të plotësuar kërkesat, kapacitetet dhe standardet.

Pr.1: Rikonstruksioni i shkollave 9-vjeçare në Rreth Tapi, Vodëz, Perondi, Bardhaj, Lumas, "18 Tetori" Kuçovë, si dhe i shkollës së mesme në Perondi, i oborrit të shkollave-kopshteve dhe ambienteve ndihmëse të tyre (një ndër këto institucione 9- vjeçare "Gaqi Karakashi").

Pr.2: Përmirësimi i kushteve laboratorike dhe sportive të objekteve arsimore 9-vjeçare dhe të mesme në bashki.

Pr.3: Ndërtimi i kopshteve në fshatrat Frashër, Luzaj, Katundas dhe Belesovë, si dhe rikonstruksioni i kopshtit në fshatin Lumas.

Pr.4: Ndërtimi i një shkolle të mesme në fshtin Gegë dhe i një qendre shëndetësore në fshatin Goraj.

Pr.5: Rikonstruksion zyrash dhe mbikqyrje punimesh për to; kolaudim punimesh ndërtim ambulance Lumas; kolaudim, mbikqyrje rikonstruksion shkolle Lumas; kolaudim punimesh Sheqëz-Vodhëz-Koritëz- Lumas.

Pr.6: Kolaudim, mbikqyrje punimesh i rikonstruksionit të banesave rome, Lumas.

O4P2: Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i shesheve kryesore në qytet dhe në qendrat e njësive rurale.

Pr.7: Rikonstruksioni i sheshit të pazarit në Kuçovë.

Pr.8: Rikonstruksioni i shesheve të brendshme të blloqeve 5-katëshe të banimit në lagjen "1 Maji" dhe i shesheve të qendrave të njësive administrative të Lumasit, Perondisë dhe Kozarës.

O4P3: Krijimi i mundësive të strehimit të përballueshëm për popullsinë aktuale dhe strehimit social për popullsinë e regjistruar si të pastrehë, duke ndjekur politika koherente strehimi, stimuj tatimorë dhe qira të lehtësuar.

Pr.9: Ndërtimi i një objekti të strehimit social për popullsinë e pastrehë ose në nevojë strehimi

Pr.10: Hartimi i një plani për regjistrimin e të gjithë familjeve të pastreha në bashki.

Pr.11: Integrimi i politikave të strehimit në instrumentet e planifikimit si bonus intensiteti apo kushtëzime të tjera për zhvilluesit e PDV-së.

O4P4: Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i popullsisë duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit.

Pr.12: Ndërtimi i një Qendre Artistike e Kulturore për shërbime ndaj të rinjve.

Pr.13: Rikonstruksioni i stadiumit të Kuçovës dhe krijimi i një poli të rëndësishëm sportiv e rekreativ në zonën e stadiumit.

O4P5: Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Kuçovë, gjelbërimit dhe hapësirave me karakter të veçantë për t'i shërbyer funksionit mjedisor dhe estetik për qytetin.

Pr.14: Rikonstruksioni i pikës turistike të qendrës Kuçovë.

Pr.15: Zgjerimi i zonës së varrezave të qytetit Kuçovë.

Pr.16: Krijimi i parqeve të vogla urbane në zona natyrore periferike të qytetit (krijimi i parkut në meandrimin e lumit Devoll, në afërsi te venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta të qytetit).

Pr.17: Ndërtimi i një itinerari për biçikleta dhe këmbësorë, me hapësira te gjelbra përgjatë kanalit vaditës që kalon në qytet.

Pr.18: Programi për mbjelljen e pemëve dekorative në rrugët kryesore të qytetit të Kuçovës.

O4P6: Hartimi i një strategjie të përfshirjes në arsim profesional të popullsisë vendase, në ndihmë të punësimit në sektorë të industrisë së lehtë, artizanatit etj.

Pr.19: Ngritja e një shkolle profesionale rajonale për naftën.

Pr20: Kryerja e marrëveshjeve me operatorë artizanalë dhe shërbimesh për zhvillimin e trajnimeve në sektorë specifikë, ndihmës për ekonominë lokale.

O4P7: Programi për marrjen e masave të plotësimit me bazë materiale në institucionet që ofrojnë shërbimet sociale.


Pr.21: Pajisja me soba për ngrohje me dru në institucionet e arsimit (shkolla, kopshte, çerdhe).

Pr.22: Blerje librash për qendrën rinore dhe bibliotekën.

- **Fashat, qendërsitë, zonat**

Për të kaluar nga vizioni territorial drejt përdorimit të tokës e, më pas, drejt njësive strukturore, territori është lexuar më thellësisht e, më pas, strukturuar në fasha e qendërsi. Fillimisht lexohen fashat e qendërsitë si zona përkatësie të elementeve të forta territoriale, qofshin këto natyrore apo artificiale. Më pas, bazuar në vizionin dhe në politikën e Bashkisë për zhvillimin e territorit, vendoset nëse këto fasha e qendërsi do të theksohen më tej, pra do të fuqizohen, dhe nëse do të krijohen të reja aty ku vihet re se ekziston potenciali apo nevoja. Fashat e qendërsitë e propozuara nuk janë thjesht zona përkatësie, por tashmë janë matrica funksionale territoriale të propozuara, mbi bazën e të cilave territori ndahet më tej në njësi strukturore dhe në përdorime toke. Fashat e qendërsitë paraqiten në figurën më poshtë dhe në tekstin në vijim.

Figura 175. Fashat, qendërsitë dhe zonat e bashkisë Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

Fashat natyrore lumore: Fashat natyrore lumore janë fashat të cilat kryesisht propozojnë masat mbrojtëse dhe rehabilituese të mjedisit përgjatë lumenjve dhe përrenjve kryesorë të bashkisë së Kuçovës. Fashat janë: *fasha funksionale Osum- Seman, fasha funksionale Devoll dhe fasha funksionale Lapardhicë.*

Fashat natyrore lumore Osum-Seman dhe Devoll përfshijnë shtretërit e lumenjve, brigjet, zonat ripariane ekzistuese të lumenjve, si dhe tokat bujqësore që janë në afërsi të lumit dhe përgjithësisht propozohen të kthehen në zona ripariane. Zonat ripariane do të kenë rehabilitime të tyre me shtime të bimësisë së lartë dhe të ulët në mënyrë që të bëhet një mbrojtje e mire e tokave bujqësore nga lumi dhe përmbytjet e mundshme. Gjithashtu, këto fasha do të përfshijnë edhe disa zona naftëmbajtëse që ndodhen në afërsi të lumenjve Osum dhe Devoll. Këto zona naftëmbajtëse trajtohen si zona ekskluzive nafte ku nuk do të lejohet asnjë aktivitet tjetër dhe asnjë zhvillim ndërtimor. Gjithashtu, do të merren masa për përmirësimin fizik të sigurisë së puseve dhe minimizimin e ndotjes së tokës përreth tyre, të ajrit, si dhe të akuifereve ujore dhe ujërave të lumenjve. Këto masa nuk kanë për qëllim fuqizimin e industrisë së naftës, pasi kjo është një politikë tashmë e vendosur në territor dhe që shkon përtej mundësisë së Bashkisë për ta influencuar me anë të planit. Qëllimi është që këto zona të përkufizohen qartë dhe të ndahen nga territoret e tjera në mënyrë që të mos ndikojnë negativisht në to.

Fasha natyrore e Lapardhicës përfshin përroin e Lapardhicës, si dhe dy degët e tij, përroin e Sinecit dhe të Belesovës. Kjo fashë përfshin zonat ripariane të përrenjve të mësipërm, si dhe tokat bujqësore në afërsi të këtyre përrenjve. Në këtë fashë vërehet që ka erozion të lartë të tokave bujqësore nga përroi, një problem ky i cili dëmton ekonominë lokale, që kryesisht si sektor zhvillimi ka bujqësinë. Duke patur këtë problem, zonat ripariane të lumit do të trajtohen me pyllëzime dhe mbjelljen e bimësisë së lartë dhe tokat bujqësore në afërsi të lumit do të mbillen me kultura bujqësore, të cilat minimizojnë erozionin e tokave nga lumi. Në raste të ndryshme mund të ndërmerren edhe ndërtime të argjinaturave mbrojtëse.

Fasha ekonomike përfshin dy anët e aksit kryesor rrugor që lidh Urën Vajgurore me Kuçovën. Në këtë fashë do të ketë zhvillime të shërbimeve tregtare, të bizneseve me karakter bujqësor, si dhe të zonave të banimit. Ky lloj zhvillimi do të ndikojë në shtimin ndërlidhjes ndërmjet Kuçovës dhe Urës Vajgurore. Për momentin, në këto zona ka mjaft njësi tregtare dhe biznesi, të cilat operojnë, por ndikimi i tyre nuk është i mjaftueshëm për të krijuar një zonë të mirëfilltë ekonomike. Me anë të zhvillimit që do tëi jepet kësaj zone do të forcohet karakteri ekonomik.

Qendërsia e qytetit të Kuçovës: I gjithë qyteti i Kuçovës është i shtrirë në dy zona, të cilat janë: zona fushore në afërsi të lumit Devoll, si dhe zona kodrinore. Qyteti merr formën e një "amfiteatri", i ndarë qartësisht në këto dy zona: në zonën fushore, ku kemi të gjitha shërbimet kryesore të qytetit, që mund të quhet zona mikse, si dhe në zonën e kodrave, që i dedikohet kryesisht funksionit të banimit. Zona mikse është zona me problematikën më të madhe dhe ndërhyrjet më të mëdha të zhvillimit në shkallë qyteti do të përqendrohen në këtë zonë, kjo edhe si pasojë e interesit të sektorit publik dhe privat për ta zhvilluar atë. Kjo hapësirë përfshin ish-zonat industriale të Kuçovës (ish- UPN-ja dhe zona e TEC-it), zonat industriale në funksion (zona e përpunimit të naftës), zona të ndryshme me karakter ekonomik (zona e tregut), si dhe zonat të cilat kanë patur zhvillime të vonshme të banimit (zona të reja të banimit dhe zona informale). Duke kuptuar edhe problematikat që ka zona, siç janë degradimi i zonave industriale dhe ndotja mjedisore, si dhe mungesa e shërbimeve

publike, kjo zonë do t'i nënshtrohet rigjenerimit urban, rehabilitimit mjedisor, si dhe ristrukturimit infrastrukturor në shumë pjesë të saj. Zona e dytë ose zona kodrinore, e cila ka karakter banimi, do të synohet të konsolidohet më tej duke ruajtur të njëjtin karakter, por me parametra të tjerë zhvillimi.

Qendërsia e parkut rajonal të Kozarës: Zona e kodrave të Kozarës në anën veriperëndimore të bashkisë së Kuçovës do të ketë statusin e një parku rajonal të bashkisë, i cili do të shërbejë si një zonë e gjelbër dhe vend turistik për të gjithë bashkinë. Në këtë zonë do të ketë trajtime peizazhistike të ndryshme, si dhe do të bëhen investime të ndryshme në infrastrukturën e zonës, në mënyrë që zona të tërheqë sa më shumë vizitorë.

Fashat e banimit:

Fasha Tapi-Rreth Tapi-Kuçovë: Kjo fashë përfshin fshatrat Tapi, Rreth Tapi dhe përfundon në skajin jugor të qytetit të Kuçovës. Këto zona lidhen nga një aks rrugor që lidh direkt fshatin Rreth Tapi me aksin ekonomik Kuçovë-Urë Vajgurore e, më pas, vetë qytetin e Kuçovës. Zhvillimi do të orientohet drejt konsolidimit të zonave të banimit, duke forcuar karakterin dhe tipologjitë e fashës.

Fashat Gegë dhe Drizë janë dy fasha të cilat përfshijnë përkatësisht zonat e banuara që aksesohen nga akset rrugore Kuçovë-Gegë dhe Kuçovë-Drizë. Këto fasha do të kenë karakter banimi me dendësi të ulët, por nuk do të kenë parametra të lartë zhvillimi në krahasim me parametrat e zhvillimit ekzistues.

Fasha e Perondisë: Kjo fashë përfshin zonat e banuara që lidh rruga Kuçovë-Perondi nga pjesa jugore e qytetit deri në fshatin Goraj. Kjo fashë do të zhvillojë zonat të cilat ndodhen ndërmjet qytetit të Kuçovës dhe fshatit Perondi, që tashmë shihet si një lagje e qytetit, si dhe zonat nga fshati Perondi drejt fshatit Goraj. Fasha kryesisht ka karakter rezidencial, por edhe zhvillimin e shërbimeve mbështetëse, të cilat janë të domosdoshme. Kjo fashë do të forcojë karakterin e zonës, por nuk do të ketë parametra të lartë zhvillimi.

Qendërsitë Kozarë dhe Lumas: Dy qendrat e banuara të njësive administrative Lumas dhe Kozarë do të zhvillohen si qendërsi në të cilat do të realizohet përmirësimi i shërbimeve utilitare, si dhe përmirësimi infrastrukturës.

Mikroqendërsitë: Mikroqendërsitë janë zonat e banuara të të gjitha fshatrave të bashkisë Kuçovë, të cilat do të kenë parametra minimalë zhvillimi në krahasim me parametrat ekzistuese. Zhvillimet kryesore do të jenë plotësimi i këtyre qendrave me shërbime utilitare dhe infrastrukturën e nevojshme.

Qendërsia aeroport: Kjo qendërsi përfshin të gjithë zonën e aeroportit, e cila, edhe pse nuk është në kompetencën e bashkisë, përbën një potencial të madh për zonën. Kjo zonë do të jetë zonë konservimi, sepse është zonë e rëndësisë kombëtare. Bashkia do të lobojë tek autoritetet qendrore për përdorimin e këtij aeroporti gjatë verës edhe për civilë/turistë.

Zonat bujqësore: Këto zona kryesisht shtrihen në pjesën jugperëndimore të bashkisë, aty ku ndodhen edhe zonat fushore, si dhe përgjatë dy luginave të territorit të bashkisë së Kuçovës, të cilat formësojnë territorin e bashkisë. Në këto zona do të ketë konsolidim, konservim mbrojtës të tokës bujqësore, si edhe ristrukturim të infrastrukturës bujqësore për të rritur prodhimin bujqësor.

Zonat natyrore: Këto zona ndodhen në pjesën qendrore dhe lindore të bashkisë dhe kanë një sipërfaqe të madhe në raport me sipërfaqen e përgjithshme të bashkisë. Këto zona do të jenë zona konservimi dhe rehabilitimi mjedisor në të cilat nuk do të lejohen veprimtari që dëmtojnë natyralitetin e zonave.

- **Propozimet e infrastrukturave**

Zhvillimi i infrastrukturave rrugore është një tjetër aspekt i cili parashikohet nga Plani i Përgjithshëm Vendor. Siç parashikohet edhe nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar, aksi më i rëndësishëm kombëtar që kalon në bashkinë e Kuçovës është Boshti Qendror i Jugut, i cili kalon nga lugina e Devollit dhe lidhet me rrugën nacionale Lushnje-Berat. Në raport me këtë aks bashkia e Kuçovës ka një pozicion të favorshëm strategjik, gjë që është mjaft pozitive për zhvillimin dhe aksesin e saj.


Një rrugë e cila është mjaft e rëndësishme është rruga Kuçovë-Arrëz, e cila bën lidhjen dytësore të qytetit të Kuçovës me aksin nacional Lushnje-Berat. Lidhja ndërmjet Kuçovës dhe këtij aksi kryesor bëhet me ndërtimin e një ure në afërsi të fshatit Arrëz, mbi lumin Osum. Ndërtimi i një ure tjetër mbi lumin Devoll bën lidhjen e këtij aksi me njësinë administrative Kozarë.

Një rëndësi të madhe për bashkinë e Kuçovës kanë akset rajonale, të cilat bëjnë lidhjen ndërmjet qytetit të Kuçovës dhe njësive të tjera administrative të bashkisë. Me rëndësi do të jetë rehabilitimi i aksit rrugor Kuçovë-Perondi-Magjatë-Dumollë- Drizë-Gerë- Kuçovë. Rehabilitimi i këtij aksi do të përmirësonte aksesibilitetin e lëvizjes ndërmjet qytetit të Kuçovës dhe fshatrave përreth tij, si dhe do të shërbente si një rrjet unazor për këto zona. Aksi tjetër i rëndësishëm është aksi rrugor Kuçovë-Perondi-Lapardha–Vodhëz-Lumas-Pëllumbas –Belesovë- Meandrakë. Gjithashtu, dy akse rrugore të cilat lidhen me aksin e sapopërmendur janë Lumas-Sinec dhe Lumas-Luzaj. Këto akse bëjnë lidhjen e qytetit të Kuçovës me fshatrat e njësisë administrative të Lumasit, që është edhe njësia administrative më problematike përsa i përket aksesibilitetit. Gjithashtu ndërhyrje me mjaft rëndësi janë rehabilitimet dhe ndërtimet e tri akseve tërthore që aksesojnë fshatra të tjera të cilat kanë akses të dobët. Këto akse janë: aksi Kuçovë-Magjatë-Sheqëz-Vodhëz, aksi Kuçovë-Pashtaj-Bardhaj dhe aksi Kuçovë-Drizë-Velagosht-Langozaj-Lumas. Me ndërtimin dhe rehabilitimin e këtyre akseve të gjitha zonat e banuara të bashkisë Kuçovë do të kenë akses të mirë në lidhje me qendrën e njësisë administrative dhe qytetin e Kuçovës.

Për sa i përket propozimeve infrastrukturore në shkallë qyteti vlen të përmendet edhe ndërtimi i rrugës, e cila fillon nga kryqëzimi i hyrjes në qytetin e Kuçovës, kalon përgjatë zonës industriale të përpunimit të naftës, kalon përgjatë ish-UPN-së dhe lidhet me kryqëzimin në afërsi të urës mbi lumin Devoll, e cila të çon në Kozarë. Kjo rrugë do të përmirësojë ndjeshëm aksesin e këtyre zonave dhe do të shërbejë si by-pass i përkohshëm për trafikun që vjen nga Elbasani në Belsh, në Kuçovë, në Urën Vajgurore dhe lidhet me aksin nacional Berat-Lushnje.

- **Evidentimi i potencialeve të zhvillimit**

Figura 176. Karakteri i vendbanimeve



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

Për sa i përket karakterit të zonave të banuara do të evidentohen fushat me potencial zhvillimi për zonat kryesore të banuara. Qendra kryesore e banuar në bashkinë e Kuçovës është qyteti i Kuçovës, i cili si sektor prioritar ka sektorin industrial, bujqësor dhe turistik. Sektori industrial ka të bëjë me përpunimin dhe nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror. Sektori tjetër i rëndësishëm është sektori bujqësor, duke qenë se Kuçova ka terrene fushore dhe toka të përshtatshme për mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore. Në Kuçovë synohet për ndërtimin e një magazine bujqësore e cila do të bëjë mbledhjen dhe shpërndarjen e produkteve, gjë që do të ketë një ndikim pozitiv në ekonominë lokale. Gjithashtu, sektor i rëndësishëm është edhe turizmi, i cili mund të ndihmohet përmes krijimit të itinerareve turistike, si dhe krijimit të paketave turistike për të vizituar vendet kulturore dhe zonat natyrore. Të tilla janë, për shembull, Kisha e Ungjillizimit në Kozarë dhe Kisha e Shën Kollit në Perondi, si dhe parku rajonal i kodrave të Kozarës. Gjithashtu, qyteti i Kuçovës do të ketë shërbimet tregtare si sektor kryesor, si dhe do të jetë qendër administrative për të gjithë bashkinë.

Perondia, si qendër e njësisë administrative, do të ketë si sektor primar bujqësinë, si dhe turizmin kulturor. Fshatrat Magjatë e Tapi do të kenë sektor primar bujqësinë, ndërsa fshatrat Gegë dhe Drizë do të kenë si sektor primar bujqësinë dhe turizmin natyror.

Kozarja, si qendër e njësisë administrative, sektor primar do të ketë bujqësinë dhe turizimin natyror, duke qenë se në afërsi të këtij fshati ka toka pjellore dhe ndodhen kodrat e Kozarës, të cilat do të kthehen në park rajonal, dhe kështu do të ketë mundësi për zhvillimin e turizmit. Një sektor mjaft i rëndësishëm për Kozarën është edhe sektori industrial, sepse në afërsi të këtij fshati ndodhen edhe zonat naftëmbajtëse të Kuçovës. Gjithashtu, fshatrat Vlashuk, Salcë Kozarë dhe Fier-Mimar, si pjesë të njësisë administrative Kozarë, prioritet kryesor do të kenë zhvillimin e sektorit bujqësor.

Lumasi, si qendër e njësisë administrative, si sektor primar do të ketë turizmin dhe sektorin bujqësor dhe blegtoral. Lumasi karakterizohet nga relieve kodrinoro- malore, si dhe ka mjaft zona natyrore të cilat janë një potencial mjaft i mirë për zhvillimin e turizmit. Tradita e gatimit dhe cilësia e produkteve ushqimore të zonës ndikon, gjithashtu, në zhvillimin e turizmit. Bujqësia dhe blegtoria janë, po ashtu, mjaft të rëndësishme për Lumasin, i cili prodhon produkte blegtorale dhe bujqësore të një cilësie të lartë. Në këtë sektor ka nevojë që të ketë një marketim dhe reklamim të mirë të këtyre produkteve, si dhe investime për zhvillimin e këtyre fushave. Fshatrat kryesore të njësisë administrative Lumas, siç janë Pëllumbasi, Belesova, Meandraka dhe Luzaj, kryesisht prioritet do të kenë përsëri fushat e turizmit natyror dhe të bujqësisë.


- **Ndërhyrjet madhore dhe platforma e ndërhyrjeve në territor**

Në vazhdim të këtij seksioni do të paraqiten ndërhyrjet madhore ose ndërhyrjet strategjike, si dhe ndërhyjet e tjera të territorit që parashikon Plani i Përgjithshëm Vendor i Kuçovës.

Këto ndërhyrje do të ndërmerren në bazë të strategjisë së zhvillimit që është hartuar, në bazë të analizave të thelluara që janë ndërmarrë në kuadër të planit, si dhe në mbështetje të nevojave dhe problematikave kryesore që paraqet bashkia e Kuçovës. Gjithashtu, këto ndërhyrje janë vazhdimësi e thellimit të vizionit territorial që ndërmerr ky plan për bashkinë Kuçovë.


Ndërhyrjet madhore strategjike që ndërmerr plani do të kenë një efekt të madh në përmirësimin e shumë aspekteve dhe stimulojnë në mënyrë direkte zhvillimin e territorit, si dhe zgjidhjen e disa problematikave madhore që ka bashkia e Kuçovës.

Figura 177. Ndërhyrjet strategjike të Bashkisë Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co- PLAN; 2016

Figura 178. Ndërhyrjet strategjike të Bashkisë Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co- PLAN; 2016

1. <u>Rehabilitimi i aksit rrugor Belsh-Kuçovë</u>: Rehabilitimi i këtij aksi është mjaft i rëndësishëm për bashkinë e Kuçovës, sepse përmirëson aksesin dhe forcon ndërlidhjen e saj me zonat e Belshit dhe të Elbasanit. Ky aks, në mënyrë provizore, do të luajë rolin e Boshtit Qendror Jugor, i cili pritet të ketë ndikim të madh në zhvillimin e bashkisë, kjo si pasojë e pozicionit në të cilin ndodhet bashkia në raport me këtë aks të rëndësishëm kombëtar.

2. <u>Ndërtimi i autostradës së Boshtit të Jugut</u>. Ky projekt infrastrukturor është projekti më i rëndësishëm për vetë rëndësinë që ka dhe në nivel kombëtar. Është një korridor i shpejtësisë së lartë, i cili lidh Tiranën e Elbasanin me Beratin e, më pas, shkon deri në Tepelenë e Sarandë dhe kalon në Kuçovë. Siç e përmendëm, në një periudhë afatmesme, Rruga e Belshit do të luajë rolin e Boshtit Qendror Jugor për pjesën që kalon në bashkinë e Kuçovës. Në një periudhë afatgjatë synohet të ndërtohet një trase e re që vjen përgjatë luginës së Devollit, kryqëzohet me aksin rrugor Kuçovë –Ura Vajgurore, kalon në anën lindore të aeroportit të Kuçovës dhe lidhet me aksin kombëtar Lushnje-Berat në afërsi të fshatit Moravë, që është pjesë e bashkisë së Urës Vajgurore.


3. Ndërtimi i aksit tangentcial të qytetit. Ky aks lidh Rrugën Naftëtari pranë rrethrrotullimit të hyrjes në qytetin e Kuçovës me Rrugën e Fabrikës që ndodhet në afërsi të Urës së Devollit, e cila të dërgon në fshatin Kozarë. Ky aks kalon përmes zonave ish-industriale në periferi të qytetit në anën perëndimore të tij. Ndërtimi i këtij aksi rrugor është mjaft i rëndësishëm për qytetin e Kuçovës, sepse luan rolin e by-pass-it të qytetit, si dhe përmirëson ndjeshëm aksesin në pjesën perëndimore të qytetit. Në nivel rajonal, ky aks shmang kalimin në qendër të qytetit të trafikut ndërqytetës që vjen nga Elbasani e Belshi dhe kalon për në Urën Vajgurore e, më pas, në Berat.

4. Rigjenerimi i qendrës së njësive administrative Lumas, Kozarë dhePerondi. Këto ndërhyrje përfshijnë rivitalizimin e zonave qendrore të fshatrave Lumas, Kozarë dhe Perondi. Gjithashtu, ato përfshijnë përmirësimin e hapësirave publike, shtimin e zonave të shërbimeve, përmirësimin e infrastrukturave në zonë, si dhe përmirësimin e shërbimeve sociale.

5. Rikonceptimi i zonës qendrore të qytetit të Kuçovës. Ky projekt përfshin ndërhyrjet në zonën qendrore të qytetit që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe shtimin e hapësirave publike, përmirësimin e aksesit, shtimin e shërbimeve, si dhe restaurimin e objekteve në këtë zonë. Ky projekt e kthen zonën qendrore të Kuçovës në një zonë multifunksionare, gjë që do të ketë efekt të menjëhershëm në rritjen e lëvizshmërisë në këtë zonë, si dhe në zhvillimin e njësive tregtare dhe të biznesit.

6. Rehabilitimi i zonave të lumenjve Devoll dhe Osum-Seman, si dhe i përroit të Lapardhicës. Kjo ndërhyrje përfshin rehabilitimin, si dhe trajtimin peizazhistik të brigjeve lumore në bashkinë e Kuçovës. Ky program do të ketë dy efekte kryesore: do të minimizojë dukurinë e erozionit dhe gërryerjes së tokave bujqësore nga lumi, si dhe do të krijojë zona natyrore dhe rekreative përgjatë lumit, të cilat do të jenë të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në natyrë.


Figura 179. Rehabilitimi i zonave ripariane



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

7. Rehabilitimi i rrugës së Sinecit. Burimi ujor i Sinecit është një ndër atraksionet më të mëdha turistike në bashkinë e Kuçovës, por aksesi në këtë zonë është mjaft i vështirë dhe problematik. Rehabilitimi i rrugës së Sinecit do të rriste numrin e turistëve në zonë dhe do të kishte ndikim pozitiv në ekonominë lokale të zonës.

Figura 180. Përmirësimi i aksesit në zonën e burimit të Sinecit



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

8. Rehabilitimi i rrugëve rurale me vlera peizazhistike. Ky program zhvillimi përfshin të gjitha akset infrastrukturore të cilat lidhin zonat kodrinore dhe malore në pjesën lindore të bashkisë Kuçovë. Qëllimi i këtij programi zhvillimi është përmirësimi i aksesit në këto zona për zhvillimin e sektorit të turizmit, i cili do të luajë rol kyç në përmirësimin e ekonomisë lokale të bashkisë.

9. Rivënia në funksion e aeroportit, si dhe ndërtimi i një muzeu lufte në afërsi të aeroportit. Ky projekt përfshin riaktivizimin e aeroportit për qëllime turistike. Riaktivizimi i aeroportit do të ketë impakt të madh në bashkinë e Kuçovës dhe do të kontribuojë në zhvillimin e sektorit të shërbimeve, hotelerisë, si dhe zhvillimin e sektorit turistik, i cili është mjaft i rëndësishëm për bashkinë e Kuçovës. Gjithashtu, ndërtimi i një muzeu lufte në këtë zonë do të ishte një vlerë e shtuar si për aeroportin, ashtu edhe për qytetin. Kjo vepër do të sillte rritjen e numrit të turistëve në Kuçovë.

10. Rehabilitimi i zonës së ish-UPN-së. Zona e ish-UPN-së është një zonë ish-industriale, e cila ka problematika të mëdha mjedisore, si pasojë e aktivitetit industrial të përpunimit të naftës që është kryer në këtë zonë. Në këtë zonë është hartuar një projekt për rehabilitimin mjedisor dhe kthimin e kësaj hapësire në një zonë rekreative, çlodhëse dhe argëtuese.

11. Rehabilitimi i venddepozitimit të mbetjeve të ngurta në Kuçovë. Venddepozitimi i mbetjeve të ngurta aktualisht ndodhet në bregun lindor të lumit Devoll, në afërsi të fshatit Kozarë. Depozitimi i mbetjeve në ambient të hapur dhe djegia e tyre shkaktojnë probleme të konsiderueshme mjedisore për zonën. Me anë të zhvillimit të projektit

synohet që të rehabilitohet zona dhe të kthehet në park me pemë të larta. Kjo zonë do të shërbejë si pjesë e zonës ripariane të lumit, si dhe si hapësirë e gjelbër e qytetit.

12. Krijimi i parkut rajonal periferik në kodrat e fshatit Kozarë. Zona kodrinore në veri të fshatit Kozarë është një zonë mjaft e bukur, e cila, me disa ndërhyrje, mund të kthehet në atraksion turistik për Kuçovën. Synohet kthimi i kësaj zone në park rajonal, si dhe ndërtimi i rrugëve të biçikletave dhe i itinerareve natyrore që do të tërheqin turistë të shumtë në zonë. Gjithashtu, krijimi i një rrjeti bujtinash në fshatrat në afërsi të këtij parku do të zhvillojë turizmin dhe do të krijojë kapacitetet e duhura për turistët që do të vizitojnë zonën. E gjithë kjo do të ketë impakt në zhvillimin e ekonomisë lokale të zonës.

Figura 181. Krijimi i parkut rajonal të kodrave të Kozares



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

13. Rehabilitimi i zonës së rezervuarit të Belesovës. Ky projekt përfshin rehabilitimin e digës së rezervuarit të Belesovës dhe kthimin e saj në rrugë këmbësorësh dhe biçikletash. Gjithashtu, ky projekt përfshin edhe krijimin e zonave për piknik dhe të rrugë-kalimeve në afërsi të zonës së rezervuarit, si dhe rehabilitimin mjedisor dhe trajtimin peizazhistik të kodrave përreth rezervuarit të Belesovës. Ky rezervuar ka nevojë edhe për ndërhyrje për pastrim, si dhe investime të ndryshme që të jetë plotësisht funksional përsa i përket dhe vaditjes së zonave përreth. Kjo zonë do të kthehet në një rezervat të menaxhuar mjedisor, gjë që do të rrisë shkallën e konservimit të zonës dhe natyralitetit të saj.

Figura 182. Rehabilitimi i zonës së rezervuarit të Belesovës



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

14. Krijimi i itinerareve natyrore turistike. Ky projekt synon krijimin e infrastrukturës bazë për lëvizjen në natyrë të turistëve. Një itinerar fillon në Perondi, ngjitet në kurrizoren e kodrave, vazhdon në Velagosht dhe përfundon në fshatin Frashër. Itinerari i dytë fillon nga fshati Krekëz, vazhdon në zonën arkeologjike të Balibadhës që është në kufi me bashkinë e Beratit dhe përfundon në fshatin Meandrakë. Përgjatë këtyre itinerareve do të ketë zona të përshtatshme për kamping, zona pushimi, zona për piknik, si edhe sinjalistikën bazë ndihmëse për këto itinerare turistike.

15. Kthimi i zonës së Sinecit në rezervat të menaxhuar mjedisor. Zona e Sinecit, si një atraksion turistik, synohet të kthehet në rezervat të menaxhuar mjedisor. Zona do ta fitojë këtë status që të ketë një mbrojtje dhe konservim më të mirë të vlerave natyrore që ka si zonë.

16. Ndërtimi i zgjatimit të bulevardit kryesor të qytetit të Kuçovës. Si pjesë e rehabilitimit të qendrës së qytetit do të jetë edhe ndërtimi i zgjatimit të bulevardit deri në afërsi të kanalit vaditës të Dikatrës, që depërton në qytet. Bulevardi i ri do të kthehet në një hapësirë për lëvizjen e këmbësorëve, si dhe për lëvizjen me biçikleta. Kjo hapësirë do të jetë hapësira kryesore publike e qytetit, e cila do të ketë dy efekte: do të zhvillojë zonën nga pikëpamja ekonomike si pasojë e shtimit të njësive tregtare dhe bizneseve, si dhe do të kthehet në një hapësirë publike të mirëfilltë në qendrën e qytetit të Kuçovës.

Figura 183. Rehabilitimi dhe ndërtimi i zgjatimit të bulevardit ekzistues në Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

17. Krijimi i zonës ekonomike në aksin rrugor Kuçovë-Ura Vajgurore. Ky projekt do të ketë një impakt të fortë ekonomik për bashkinë e Kuçovës dhe më gjerë, sepse synohet që me anë të këtij projekti aksi Ura Vajgurore- Kuçovë të kthehet në një zonë ekonomike dhe shërbimesh me njësi tregtare dhe biznese, por edhe me ambiente argëtimi dhe çlodhjeje. Ky aks rrugor do të zgjerohet dhe do të jetë i pajisur në anë të tij me kalime për këmbësorë dhe biçikleta, si dhe me hapësira të gjelbra. Kjo zonë synon të kthehet në një zonë ekonomike, sepse ka një akses të mirë si nga Ura Vajgurore, edhe nga qyteti i Kuçovës dhe nga fshatrat Rreth Tapi, Tapi, Kozarë, Perondi, Magjatë dhe Arrëz. Me zhvillimin e këtij projekti ekonomia lokale do të njohë rritje në sektorët e shërbimeve të biznesit dhe tregtisë.

Figura 184. Krijimi i zones ekonomike në aksin rrugor Kuçovë- Ura Vjagurore



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

18. Rehabilitimi i puseve të naftës dhe kthimi i tyre në atraksion për qytetin. Duke qenë se qyteti i Kuçovës ka një karakter të fortë industrial si pasojë e industrisë së nxjerrjes së naftës, puset e naftës janë një element mjaft i rëndësishëm i kësaj industrie. Puset e naftës përbëjnë një problem nga pikëpamja vizive për zonat e banuara në afërsi të puseve. Ky problem synohet të zgjidhet me rehabilitimin fizik të puseve, si dhe kthimin e tyre në një mjet i cili brandon qytetin. Projekti konsiston në lyerjen dhe vendosjen e ndriçuesve në këto puse. Kjo ndërhyrje do ta zgjidhte këtë problem viziv, si dhe do t'i shndërronte puset e naftës në objekte të brandimit të qytetit, si pjesë të tij.

19. Rehabilitimi dhe rigjenerimi i zonës së ish-TEC-it dhe ndërtimi i Muzeut të Naftës. Ky projekt përfshin rehabilitimin e zonës së ish-TEC-it si një zonë ish-industriale, si dhe kthimin e saj në një hapësirë publike dhe rekreative për qytetarët. Ndërtimi i Muzeut të Naftës në këtë hapësirë do të sjellë një pjesë të formimit të qytetit si pasojë e pranisë së rezervave të naftës, si dhe historikun e nxjerrjes së naftës në Shqipëri. Ndërtimi i

muzeut, si dhe rigjenerimi i hapësirave publike do të rrisin numrin e turistëve dhe vizitorëve në qytet. Duke qenë se, siç e theksuam, Kuçova ka një karakter të fortë industrial, me anë të këtij projekti synohet që, përveç përfitimit ekonomik nga industria, ajo të ketë edhe zhvillim turistik nga kjo pikëpamje.

20. Ndërtimi i terminalit të autobusëve. Ky projekt përfshin ndërtimin e terminalit të autobusëve përgjatë rrugës "Llambi Shella" e cila lidhet me rrugën "Kosova". Kjo rrugë ndodhet paralel me bulevardin "Slanisllav Zuber" në anën e majtë të tij. Vendqëndrimet e autobusëve ndodhen në anë të rrugës "5 Qershori", gjë që përbën problem për trafikun e zonës. Ndërtimi i terminalit të autobusëve i jep një zgjidhje përfundimtare vendqëndrimit të autobusëve në qytetin e Kuçovës. Projekti gjithashtu përfshin edhe pajisjen me ambiente të tjera ndihmëse për udhëtarët, si dhe për personelin e terminalit.

21. Programi për mbjelljen e fidanëve të ullinjve në kodrat e Kuçovës. Zona lindore-kodrinore në periferi të qytetit të Kuçovës përbën një mushkëri të gjelbër për qytetin, e cila është mjaft e rëndësishme të mirëmbahet dhe të zhvillohet më tej si zonë ullishtesh, por edhe si zonë rekreative dhe çlodhëse. Në këto zona do të aplikohet një program për mbjelljen e fidanëve të rinj në mënyrë që kjo zonë të dendësohet më shumë me pemë dhe të shtohet prodhimi i produkteve bujqësore.

22. Zhvillimi i zonës së tregut të lirë të Kuçovës. Ky projekt përfshin rindërtimin e tregut në një kapacitet më të madh njësish tregtare me të gjitha facilitetet mbështetëse që ka tregu, me zonat e parkimit, si dhe ambientet e shërbimit për tregun. Gjithashtu, kjo ndërhyrje përfshin edhe ndërtimin e pikës së grumbullimit të produkteve bujqësore. Ky projekt do të ketë një impakt të madh në ekonominë lokale të zonës dhe do të zhvillojë sektorin e shërbimeve dhe të tregtisë, si dhe do të shtojë sasinë e produkteve bujqësore që tregtohen.

Figura 185. Rehabilitimi i zonës së tregut në Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

23. Rehabilitimi i zonës së stadiumit të qytetit. Ky projekt përfshin rehabilitimin e të gjithë zonës përreth stadiumit, si dhe krijimin e hapësirave publike dhe të shërbimeve mbështetëse.

24. Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza. Për bashkinë e Kuçovës një rëndësi të veçantë do të ketë rehabilitimi i infrastrukturave bazë mbitokësore dhe nëntokësore.

Si pjesë e këtyre infrastrukturave është edhe infrastruktura e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza. Një ndër problemet kryesore është derdhja e ujërave të zeza në kanalin vaditës të Dikatrës në periferi të qytetit të Kuçovës e, më pas, derdhja e tyre në lumin Osum, në afërsi të bashkimit me lumin Devoll. Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, si dhe i tubacionit kryesor që çon ujërat e zeza në impiant do të zgjidhte problemin e ndotjes mjedisore nga ujërat e zeza të qytetit. Kjo ndërhyrje do të minimizonte problemet mjedisore, si dhe do të përmirësonte në mënyrë të ndjeshme infrastrukturën e kanalizimeve të ujërave të zeza. Sipas propozimit të bashkisë ky impiant do të ndërtohet pranë pikës së derdhjes së ujërave të zeza, në afërsi të lumit Osum. Sipas masterplanit kombëtar ky impjant është i përshtatshëm të ndërtohet në afërsi të fshatit Moravë në bashkinë e Urës Vajgurore. Në bazë vizitave në terren zona e projektit në Urën Vajgurore është shum afër zonave të banuara. Plani merr në konsideratë të dy opsionet por vendndodhja do te percaktohet me hartimin studimit te fizibilitetit.

25. Ndërtimi i landfillit të qytetit në afërsi të zonave të naftës në Arrëz. Depozitimi i mbetjeve urbane është një problem tjetër i cili duhet të marrë zgjidhje nga plani. Aktualisht, venddepozitimi i mbetjeve bëhet në fushë të hapur dhe djegia e tyre shkakton probleme të shumta mjedisore. Zona aktuale do t'i nënshtrohet rehabilitimit mjedisor dhe do të ketë mbjellje me pemë të larta. Zona e landfillit do të ndërtohet në afërsi të zonave të naftës, si dhe në afërsi të impiantit të propozuar për trajtimin e ujërave të zeza. Ndërtimi i ladfillit do të bëhet në rast se marrëveshja për ndërtimin e landfillit rajonal të Urës Vagurore nuk realizohet.

Përpos ndërhyrjeve madhore të cilat kanë efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e bashkisë, kemi edhe ndërhyrjet në njësitë strukturore të cilat janë zonat e banimit, zonat natyrore, si dhe zonat bujqësore të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të ndryshme sipas llojit të zhvillimit, intensitetit të ndërtimit, sipas përmirësimit të akseve rrugore, sipas përmirësimit të hapësirave publike, si dhe sipas tipologjisë së propozuar të ndërtimit.

Metodologjia që do të ndiqet në këto zona do të jetë krijimi i disa makrozonave të cilat do të jenë shumatore të njësive strukturore sipas ngjashmërive në format e ndërhyrjeve.

- Zona qendrore për intensifikim. Kjo zonë përfshin të gjithë qendrën e qytetit, e cila si përdorim bazë ka "banim" dhe do të zhvillohet me intensifikim. Pra, do të rritet intensiteti, si dhe shfrytëzimi i territorit për ndërtim, por sigurisht do të ketë edhe përmirësim dhe rritje të sipërfaqeve të gjelbra, si dhe përmirësim të kapaciteteve infrastrukturore.
- Zona qendrore për rigjenerim dhe rehabilitim. Është zona në të cilën ndodhen kryesisht zonat ish-industriale, si dhe zonat të cilat kanë probleme të mëdha mjedisore. Këto zona do të kenë ripërtëritje dhe rigjenerim, si dhe rehabilitime mjedisore. Këto zona do të kenë kryesisht përdorim "shërbime", "zona rekreative e çlodhëse", si dhe "zona banimi". Në rastet e ndërtimit për banim do të kemi rritje të intensitetit, si dhe rritje të shfrytëzimit të territorit për ndërtim.
- Zonat për dendësim me mbushje urbane. Këto zona janë zonat përreth qendrës së qytetit të cilat do të zhvillohen me anë të dendësimit me mbushje. Në këto zona do të kemi rritje të intensitetit, si dhe rritje jo të madhe të shfrytëzimit të territorit për

ndërtim. Në disa raste kemi të bëjmë me ristrukturime infrastrukturore për shkak të problemeve infrastrukturore.

- Zona periferike lindore e qytetit. Kjo zonë ndodhet në kufi të zonës urbane të qytetit të Kuçovës dhe në pjesën lindore të saj kufizohet me zonën kodrinore të ullishteve të qytetit. Në këtë zonë do të kemi konsolidim dhe forcim të karakterit urban, kurse tipologjia e ndërtimit do të jetë ajo ekzistuese. Në disa raste do të kemi edhe ristrukturim infrastrukturor si pasojë e mangësive të zonës në lidhje me infrastrukturat.
- Zona ekonomike e zhvillimit. Kjo zonë, e cila ndodhet përgjatë aksit Kuçovë-Ura Vajgurore, karakterizohet nga zhvillime ndërtimore të shumta, të cilat do të ndryshojnë karakterin e zonës, si dhe përdorimin aktual të tokës. Do të kemi rritje të intensitetit të shfrytëzimit të territorit për ndërtim, si dhe shtim të infrastrukturave dhe hapësirave publike.
- Fashat urbane për konsolidim. Në këtë grup përfshihen: fasha Rreth Tapi-Kuçovë, fasha Gegë, fasha Drizë dhe fasha Perondi. Këto zona, si ndërhyrje, do të kenë konsolidim të tyre, një rritje të vogël të intensitetit dhe të shfrytëzimit të territorit, si dhe rritje të hapësirave për infrastrukturë dhe hapësira publike. Një faktor i përbashkët është forcimi i karkterit linear të tyre, që është mjaft i rëndësishëm, si dhe ruajtja dhe konservimi i tokave bujqësore/ natyrore në afërsi të tyre.
- Qendrat e njësive administrative Kozarë, Perondi dhe Lumas. Në këtë grup përfshihen qendrat e njësive administrative, të cilat do të kenë dendësime, rikonceptime dhe shtime të hapësirave publike, shtime të shërbimeve utilitare, si dhe shtime të infrastrukturës. Këto zona karakterizohen nga një rritje mesatare e intensitetit dhe Ksht-së[354] dhe do të jenë zona me dendësi të mesme.
- Zonat ekskluzive të naftës. Këto zona janë kryesisht zona ku ndodhen puset e naftës. Në këto zona propozohet ngrirja e tyre, kurse në rastet kur ka zona të banuara në brendësi të tyre propozohet zhvendosja e tyre në zonat e banuara në afërsi të qytetit të Kuçovës.
- Zonat e fshatrave për konsolidim. Në këtë grup përfshihen të gjitha zonat e fshatrave të cilat do të kenë parametra pak më të lartë të zhvillimit se sa parametrat aktualë të tyre. Gjithashtu, do të ketë shtim të hapësirave publike, si dhe shtim të infrastrukturës. Në disa raste do të ketë edhe ristrukturime infrastrukturore për shkak të problematikës së mungesës së infrastrukturës jo të mirë të zonave.
- Zonat bujqësore. Nga pikëpamja ndërtimore, këto zona do të jenë kryesisht zona konservimi ose ngrirjeje, ku kemi konsolidim të tokës bujqësore. Në disa raste, në këto zona, lejohet ndërtimi i serrave dhe magazinave të produkteve bujqësore, sipas legjislacionit në fuqi për ndërtime bujqësore në tokë bujqësore. Ndërtimet ekzistuese të banimit në këto zona do të kenë të drejtë për shtimin e një kati ndërtimi në parcelat truall të tyre, por nuk do të kenë të drejtë të zgjerojnë gjurmën përtej parcelës truall që kanë në pronësi. Gjithashtu, nuk do të lejohen ndërtime të reja, përveç atyre pak rasteve kur do të lejohet mbushja urbane me intensitet të ulët dhe zonat do të kthehen në urbane.

- Zonat natyrore. Këto zona do të kenë konservim dhe, në disa raste, edhe trajtim peizazhistik dhe rehabilitim mjedisor. Gjithashtu, në këto zona nuk do të lejohen ndërtime të reja.

Përputhshmëria e PPV-së së Kuçovës në raport me PPK-në

Një etapë mjaft e rëndësishme e planit është përfshirja e propozimeve madhore të PPK-së si propozime në PPV-në e Kuçovës. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen propozimet e PPK-së që janë përfshirë në propozimet e PPV-së së Kuçovës.

Tabela 82. Përfshirja e propozimeve të PPK-së në PPV-në e Kuçovës

Propozimi i Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK) ose PINS Bregdeti	Pasqyrimi në PPV	Sqarime për mënyrën e reflektimit në PPV
Kuçova si një qendër dytësore në rajon ku si qendra parësore janë Vlora, Fieri dhe Berati	I plotë	Nga aspekti i zhvillimit rajonal, Kuçova klasifikohet si një nga qendrat dytësore të rajonit, e cila si potencial kryesor ka zhvillimin industrial, zhvillimin e sektorit bujqësor dhe atij turistik. Gjithashtu, me rëndësi është forcimi i lidhjeve të Kuçovës, si qendër dytësore, me Beratin, Elbasanin e Lushjen me anë të akseve kryesore nacionale për të kontribuar në zhvillimin e rajonit.
PPK-ja si synim për zhvillimin e bashkisë Kuçovë ka konsolidimin e zhvillimit të qytetit me qëllim frenimin e shpërhapjes urbane në dëm të tokës bujqësore.	I plotë	Në kuadër të Planit të Përgjithëm Vendor të Bashkisë Kuçovë, qyteti i Kuçovës propozohet të intensifikohet në qendër të tij, si dhe të rritet në shtrirje në ekstremitetet e tij. Gjithashtu, një ndër parimet bazë në të cilat bazohet plani është mbrojtja dhe konsolidimi i tokës bujqësore duke ndaluar ndërtimin e objekteve për funksion "banim" në tokat bujqësore.
Krijimi i korridoreve natyrore përgjatë dy lumenjve Osum dhe Devoll.	I plotë	Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kuçovë parashikon krijimin e dy fashave lumore. Fasha Osum-Seman dhe fasha Devoll, si fasha mjedisore që si qëllim do të kenë rehabilitimin mjedisor të zonave ripariane dhe brigjeve të lumenjve, si dhe kthimin e tyre në zona rekreative.
Propozohet ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për të minimizuar ndotjen e lumenjve	I plotë	Impianti i trajtimit të ujërave të zeza propozohet të ndërtohet në afërsi të fshatit Tapi, në vendin ku aktualisht derdhen ujërat e zeza.
PPK-ja mbështet rritjen e prodhimeve të produkteve bujqësore kryesore në Kuçovë, si dhe ndërtimin e tregjeve rajonale bujqësore.	I plotë	Në kuadër të PPV-së Kuçovë, në NjA Kozarë, e cila si sektor kryesor ekonomik ka zhvillimin e bujqësisë, propozohet ndërtimi i një pike grumbullimi të produkteve bujqësore, ndërsa në qytetin e Kuçovës propozohet një zonë e agro-industrisë për përpunimin e produkteve bujqësore.
PPK-ja propozon ndërtimin e boshtit të jugut në itinerarin Elbasan- Cërrik – Kuçovë – Berat – Memaliaj.	I plotë	Në bazë të PPV-së Kuçovë, ky aks vjen nga Elbasani dhe Cërriku nga pjesa veriore e bashkisë, kalon në luginën e lumit Devoll e, më pas, lidhet me aksin nacional Lushnje-Berat.
PPK-ja propozon krijimin e itinerareve me biçikleta që lidhin Beratin, Lushnjen dhe Lagunën e Karavastasë.	I plotë	Në bazë të PPV-së Kuçovë, propozohet krijimi i itinerareve të biçikletave që lidhin zonën e kodrave të Kozarës me Kuçovën, kalojnë në Perondi, më pas në kodra, në drejtim të fshatit Meandrakë, e më pas në bashkitë e Gramshit dhe Beratit.

2.1.2 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës

Në këtë seksion do të paraqiten ndryshimet që pëson territori për sa i përket përdorimit të tokës, si dhe sistemeve territoriale, në bazë të propozimeve që ndërmerr Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kuçovë. (Harta e sistemeve territorial me kod P: 01/6)

- **Sistemet e territorit**

Tabela 83. Sistemet ekzistuese territoriale

Sistemi urban	5.41%
Sistemi bujqësor	52.12%
Sistemi infrastrukturor	3.07%
Sistemi natyror	36.50%
Sistemi ujor	2.90%

Tabela 84. Sistemet e propozuara të territorit

Sistemi urban	5.90%
Sistemi bujqësor	51.40%
Sistemi infrastrukturor	3.55%
Sistemi natyror	36.25%
Sistemi ujor	2.90%

Figura 186. Sistemet e propozuara të territorit



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

Siç dallohet në bazë të ndërhyrjeve territoriale që ndërmerr plani, sistemi urban është rritur nga 5.41% në 5.9% si pasojë e shtimit të sipërfaqeve truall nëpërmjet njësive strukturore të cilat kanë përdorim bazë banimin dhe kanë konvertime të tokës nga sisteme të tjera në sistemin urban. Si pasojë e rritjes së sistemit urban kemi një zvoglim të sistemeve natyror dhe bujqësor. Duhet thënë që me anë të sistemeve territoriale të propozuara përcaktohen dhe zonat të cilat do të përfshihen në procesin e konvertimit të tokave nga njëri sistem në tjetrin. Kemi dy lloj konvertimesh: konvertime të matshme, të cilat parashokohen në plan dhe konvertime gjatë kohës së zbatimit të planit. Këto konvertime të tokave që ndodhin gjatë zbatimit në vite të planit, kryhen sipas ligjit të posaçëm në fuqi dhe që janë të pamatshme. Sistemi ujor është një sistem që nuk ndryshon në bazë të propozimeve që ndërmerr plani. Në bazë të ndërtimit, rehabilitimit, si dhe zgjerimit të disa akseve rrugore

sistemi infrastrukturor rritet nga 3.07% në 3.55%, duke ndikuar në një ndryshim të vogël për sistemin bujqësor e natyror. Sistemet natyrore dhe bujqësore do të kenë reduktim përkatësisht nga 36.5 % në 36.25% dhe nga 52.12% në 51.4%. Kjo si pasojë e arsyeve që shpjeguam më lart për rritjen e sistemit urban dhe atij infrastrukturor. Më tej paraqitet tabela e treguesve të sistemeve, si edhe një tabelë që specifikon detajet e ndryshimit të sistemit territorial.

Tabela 85. Sistemet e territorit dhe treguesit përkatës

Sistemet	Treguesit	Vlera
Sistemi urban	1. Sipërfaqja e përgjithshme (ha ose km²)	9.25 km²
	2. Gjatësia e sistemit rrugor m/banor	9.57
	3. Popullsia ekzistuese dhe kapaciteti mbajtës	55,015 banore (pop. ekz. sipas Gjendjes Civile) 91,317 banore (kapaciteti mbajtës)
	4. Njësi banimi të parashikuara.	2,282,925 m² ndërtim
	5. Njësi banimi të mundshme për strehim social	467
	6. Njësi shëndetësore (ekzistuese dhe të propozuara)	23
	7. Njësi të arsimit 9-vjeçar (ekzistuese dhe të propozuara)	27
	8. Njësi të arsimit të mesëm (ekzistuese dhe të propozuara)	8
	9. Nr. i linjave të transportit publik urban dhe ndërurban	6
	10. Nr. i njësive strukturore	378
	11. Sipërfaqe e gjelbër m²/banor	33.57
	12. Sipërfaqe trashëgimi kulturore (ha)	2.32 ha
	13. Tregues ekonomikë	66.5 ha zonë ekonomike (biznes, industri)
	14. Sipërfaqe pronash publike (ha) dhe % ndaj sipërfaqes së përgjithshme	3,602 ha dhe 2.25%
	15. Shërbime administrative (nr. objektesh dhe Sn m²)	41 objekte me sn 13,803 m²
	16. Detyrime fetare (nr. objektesh dhe Sn m²)	5 objekte me sn 2,697 m²
	17. Intensiteti për ha (m²/ha)	4,013m²\ha
	18. Sipërfaqe që konvertohet në bujqësore (m² ose ha)	PA
	19. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m² ose ha)	PA
	20. Sipërfaqe që konvertohet në ujore (m² ose ha)	PA
	21. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m² ose ha)	2.7 ha
Sistemi bujqësor	1. Sipërfaqe e përgjithshmë (ha)	82.35 km²
	2. Sipërfaqe kryesore (Boniteti I-IV) në ha	PA
	3. Sipërfaqe dytësore (Boniteti V-X) në ha	PA
	4. Sipërfaqe ose gjatësi e sistemit të ujitjes dhe vaditjes sipas 3 kategorive	55 km kanale të I 49.3 km kanale të II 12.6 km kanale të III
	5. Sipërfaqe tokë pa fryt (ha)	236.39 ha
	6. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m² ose ha)	8.38 ha
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m² ose ha)	57.92ha
	8. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m² ose ha)	38.63 ha
Sistemi ujor	1. Sipërfaqe ujore (km²)	4.64km²

	2. Gjatësia e lumenjve kryesorë (km)	26.5
	3. Sipërfaqe akuiferesh sipas llojeve	22.4 km² çarje/karst 12.8 km² ndërkokrrizor 9.6 km² poro/çarje 1.6 çarje
	4. Sipërfaqe që konvertohen, nëse është rasti	PA
Sistemi infrastrukturor	1. Sipërfaqe ose gjatësi rrugësh sipas kategorive të kodit rrugor	5.68km²
	2. Gjatësia e hekurudhës (km)	PA
	3. Nr. i aeroporteve	1(airoport ushtarak)
	4. Njësi energjitike (nr. ose sipërfaqe ose gjatësi)	PA
	5. Landfill/ Incinerator/ Zonë për kompostim (nr. ose ha)	1
	6. Impiant për trajtimin e ujërave të ndotura (nr. ose ha)	PA
	7. Sipërfaqe ose gjatësi që konvertohet në një sistem tjetër (specifiko, nëse rasti)	PA
Sistemi natyror	1. Sipërfaqe e përgjithshme (ha ose km²)	58.08km²
	2. Sipërfaqe pyjore (ha)	4,367 ha
	3. Sipërfaqe kullota (ha)	423.6 ha
	4. Sipërfaqe të matricës natyrore sipas llojeve (ha)	4,367 ha pyll 423.6 ha kullota 278.5 ha toke bosh
	5. Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm (nr. dhe ha)	3 zona 925.8 ha
	6. Sipërfaqe që konvertohet në bujqësore (m² ose ha)	PA
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m² ose ha)	12.8714 ha
	8. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m² ose ha)	35.5678 ha


Tabela 86. Ndryshimi i sistemeve të territorit

Sistemi territorial në gjendjen ekzistuese	Sipërfaqja që ndryshon	Qëllimi i ndryshimit të kategorisë
Bujqësor	8.382 ha konvertohet nga sistemi bujqësor në sistem natyror. Ky konvertim ndodh kryesisht në afërsi të zonave riapriane ekzistuese.	Ky konvertim bëhet si qëllim i zgjerimit dhe të menaxhimit të zonave ripariane në dy anët e lumenjve Osum dhe Devoll sidhe të përroit të Lapardhicës
Bujqësor	38.6351 ha konvertohet nga sistemi bujqësor në sistem infrastrukturor. Ky konvertim ndodh kryesisht në zonat ku kalojnë akse të reja rrugore ose propozohet zgjerim ose rehabilitim i atyre ekzistuese.	Ky konvertim bëhet si qëllim i përmiresimit te aksesit në zonat rurale të bashkisë si dhe i përmirësimit të aksesit në raport me bashkitë fqinje e rajonin.
Bujqësor	68.3476 ha konvertohet nga sistemi bujqësorë në atë urban. Pjesa më e madhe e këtij konvertimi i takon njësive strukturore të cilat ndodhen përgjatë rrugës Kuçovë- Ura Vajgurore si dhe në zona të tjera të bashkisë.	Ky konvertim ka si qellim rritjen e zonave të reja të banimit, të sherbimeve, të zonave ekonomike rekreative e socilale.

Natyror	12.8714 ha konvertohet nga sistemi natyror në atë urban. Kryesisht zonat e konvertimit janë pjesë e njësive strukturore të fshatrave në zona kodrinore e malore që janë të shumtë në pjesën lindore të bashkisë.	Ky konvertim ka si qellim rritjen e zonave të reja të banimit, të sherbimeve, të zonave ekonomike rekreative e socilale.
Natyror	35.5678 ha konvertohet nga sistemi natyror në atë infrastrukturor. Ky konvertim ndodh kryesisht në zonat ku kalojnë akse të reja rrugore ose propozohet zgjerim ose rehabilitim i atyre ekzistuese.	Ky konvertim bëhet si qëllim i përmiresimit te aksesit në zonat rurale të bashkisë si dhe i përmirësimit të aksesit në raport me bashkitë fqinje e rajonin.
Urban	2.7069 ha konvertohet nga sistemi urban në atë infrastrukturor. Ky konvertim ndodh në zonat urbane ku kemi parashikohen ndërhyrje në indrasturë.	Ky konvertim bëhet si qëllim i përmiresimit te aksesit në zonat rurale të bashkisë si dhe i përmirësimit të aksesit në raport me bashkitë fqinje e rajonit.

- **Përdorimi i tokës**

Figura 187. Përdorimi i propozuar i tokës





Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Përsa i përket përdorimit të tokës, siç e theksuam më sipër, ndryshimi më i madh është kthimi i zonave të naftës që, përpos sipërfaqes së puseve, aktualisht kanë përdorim toke të kategorisë bazë bujqësi. Në këto zona me përdorim të propozuar bazë "industri" nuk lejohet aktiviteti bujqësor në *buffer* 50 m rreth puseve dhe, për shkak të dendësisë së puseve, kjo reflektohet në të gjithë zonën. Ndryshime të përdorimit të tokës ndodhin kryesisht në fashën ekonomike përgjatë aksit rrugor që lidh Kuçovën me Urën Vajgurore. Këtu kemi konvertime të tokës nga tokë bujqësore në tokë truall për ndërtim që do të ketë përdorim toke me kategori bazë "shërbimet". Gjithashtu, në fashat e banimit, siç janë fasha Drizë, fasha Gegë, si dhe fasha Rreth Tapi-Kuçovë, kemi konvertime të tokës bujqësore në tokë truall, por që janë shumë më të pakta se në zonën e fashës ekonomike. Për përdorimin e propozuar të tokës është punuar në bazë të parimit për zgjidhjen e problemeve të përdorimeve të papërputhshme midis njëra-tjetrës, që do të thotë se përdorimi i propozuar i tokës shmang zonat të cilat kanë përdorime të papërputhshme. Një ndër këto përdorime është rasti që sapo përmendëm më sipër: konflikti i tokës bujqësore me naftën. Këto zona, siç e theksuam, janë kthyer në zona nafte në një distancë 50m nga puset e naftës, siç parashikon VKM-ja nr. 671 për distancat nga objektet industriale. Gjithashtu, në zonat ku kemi raste të konfliktit të industrisë me banimin, zonat e banimit janë evidentuar si zona për ngrirje urbane dhe, në 2 raste, si zona në të cilat aplikohet zhvendosja urbane. Gjithashtu, në rastin e konfliktit të bujqësisë me banimin kemi konservim të tokës bujqësore, si dhe ndalim të ndërtimit. Këto raste do të shpjegohen në dokumentin e rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor.

Në vijim paraqitet tabela e bilancit të përdorimit të propozuar të tokës. Kjo tabelë ndërtohet për kategoritë bazë që kombinohen në çdo njësi strukturore, përfshirë zonat ripariane, rrugët dhe ujërat. Harta përkatëse është ajo me kodin P: 01/2.

Tabela 87. Bilanci i përdorimit të tokës


Nr	Llojet e miksimeve të përdorimeve	Sip e miksimit të përdorimit në Ha	% kat 1	% kat 2	% kat 3
1	01. Banim, ,	383.46	100.00%	0.00%	0.00%
2	01. Banim, 03. Bujqesi,	201.48	66.08%	33.92%	0.00%
3	01. Banim, 03. Bujqesi, 04. Sherbime	17.43	72.08%	20.32%	7.60%
4	01. Banim, 03. Bujqesi, 06. Ujera	5.51	75.00%	20.00%	5.00%
5	01. Banim, 03. Bujqesi, 08. Trashegimi dhe monumente kulture dhe historike	12.44	50.00%	40.00%	10.00%
6	01. Banim, 03. Bujqesi, 12. Arsim	31.11	73.04%	21.96%	5.00%
7	01. Banim, 03. Bujqesi, 13. Shendetesi	22.41	55.00%	40.00%	5.00%
8	01. Banim, 04. Sherbime,	80.65	85.13%	14.87%	0.00%

9	01. Banim, 04. Sherbime, 03. Bujqesi	2.23	60.00%	20.00%	20.00%
10	01. Banim, 04. Sherbime, 10. Institucione	11.32	81.57%	12.29%	6.14%
11	01. Banim, 04. Sherbime, 12. Arsim	19.23	85.00%	10.00%	8.07%
12	01. Banim, 04. Sherbime, 14. Infrastrukture	3.29	65.00%	25.00%	10.00%
13	01. Banim, 05. Perdorime te Vecanta,	4.50	90.00%	10.00%	0.00%
14	01. Banim, 10. Institucione,	6.83	90.00%	10.00%	0.00%
15	01. Banim, 11. Aktivitete sociale dhe rekreative,	4.48	90.00%	10.00%	0.00%
16	01. Banim, 11. Aktivitete sociale dhe rekreative, 10. Institucione	3.23	75.00%	15.00%	10.00%
17	01. Banim, 11. Aktivitete sociale dhe rekreative, 12. Arsim	5.25	70.00%	20.00%	10.00%
18	01. Banim, 11. Aktivitete sociale dhe rekreative, 13. Shendetesi	6.21	85.00%	10.00%	5.00%
19	01. Banim, 12. Arsim,	75.14	88.30%	11.70%	0.00%
20	01. Banim, 12. Arsim, 03. Bujqesi	3.48	75.00%	10.00%	15.00%
21	01. Banim, 12. Arsim, 04. Sherbime	17.70	83.96%	10.00%	6.04%
22	01. Banim, 12. Arsim, 05. Perdorime te Vecanta	4.36	80.00%	10.00%	10.00%
23	01. Banim, 12. Arsim, 10. Institucione	19.00	75.35%	15.58%	9.08%
24	01. Banim, 12. Arsim, 13. Shendetesi	14.23	80.00%	10.00%	10.00%
25	01. Banim, 13. Shendetesi,	16.03	90.70%	9.30%	0.00%
26	01. Banim, 13. Shendetesi, 08. Trashegimi dhe monumente kulture dhe historike	11.57	85.00%	5.00%	10.00%
27	02. Industri dhe Ekonomi, ,	250.63	100.00%	0.00%	0.00%
28	02. Industri dhe Ekonomi, 01. Banim,	241.32	91.63%	8.37%	0.00%
29	03. Bujqesi, ,	258.03	100.00%	0.00%	0.00%
30	03. Bujqesi, 01. Banim,	2702.45	97.37%	2.63%	0.00%
31	03. Bujqesi, 01. Banim, 05. Perdorime te Vecanta	444.93	97.56%	1.44%	1.00%
32	03. Bujqesi, 02. Industri dhe Ekonomi, 05. Perdorime te Vecanta	6.69	60.00%	30.00%	10.00%
33	03. Bujqesi, 05. Perdorime te Vecanta, 01. Banim	169.44	98.00%	1.00%	1.00%
34	03. Bujqesi, 07. Natyrore, 01. Banim	547.28	83.81%	15.19%	1.00%
35	03. Bujqesi, 11. Aktivitete sociale dhe rekreative,	36.98	95.00%	5.00%	0.00%
36	03. Bujqesi, 11. Aktivitete sociale dhe rekreative, 01. Banim	260.04	93.47%	5.00%	1.53%
37	04. Sherbime, ,	1.41	100.00%	0.00%	0.00%
38	04. Sherbime, 01. Banim,	55.28	78.90%	21.10%	0.00%
39	04. Sherbime, 02. Industri dhe Ekonomi,	30.57	60.00%	40.00%	0.00%
40	05. Perdorime te Vecanta, ,	5.06	100.00%	0.00%	0.00%
41	06. Ujera, ,	71.55	100.00%	0.00%	0.00%
42	06. Ujera, 07. Natyrore, 03. Bujqesi	639.20	60.00%	30.00%	10.00%
43	07. Natyrore, ,	249.55	100.00%	0.00%	0.00%
44	07. Natyrore, 03. Bujqesi,	1179.90	84.94%	15.06%	0.00%
45	07. Natyrore, 03. Bujqesi, 01. Banim	6188.00	72.46%	26.54%	1.00%
46	07. Natyrore, 03. Bujqesi, 05. Perdorime te Vecanta	295.66	75.00%	24.00%	1.00%
47	07. Natyrore, 03. Bujqesi, 06. Ujera	483.11	90.00%	8.00%	2.00%

48	07. Natyrore, 03. Bujqesi, 11. Aktivitete sociale dhe rekreative	627.06	45.00%	40.00%	15.00%
49	09. Zone Ushtarake, ,	3.68	100.00%	0.00%	0.00%
50	11. Aktivitete sociale dhe rekreative, ,	37.18	100.00%	0.00%	0.00%
51	11. Aktivitete sociale dhe rekreative, 01. Banim, 10. Institucione	3.59	70.00%	20.00%	10.00%
52	11. Aktivitete sociale dhe rekreative, 04. Sherbime,	7.25	80.00%	20.00%	0.00%
53	14. Infrastrukture, ,	233.89	100.00%	0.00%	0.00%
54	14. Infrastrukture, 02. Industri dhe Ekonomi, 04. Sherbime	4.69	30.00%	40.00%	30.00%

- **Zonat e bashkisë së Kuçovës**

Figura 188. Zonat e bashkisë së Kuçovës



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co- PLAN; 2016

Tabela 88. Zonat e bashkisë së Kuçovës

Zona (emër dhe nr)	Kuçovë nr.1	Kozare nr.2	Lumas nr.3	Perondi nr.4
Sipërfaqe (ha)	388	4,704.9	7,195.7	3,778.3
Sipërfaqe banimi (ha)	97.6	32.9	20.3	77.4
Zona ekonomike (ha)	10.8	0	0	55.7
Kapaciteti mbajtës (popullsi)	39,041	13,173	8,143	30 960
Dendësi sipas kapacitetit mbajtës (banorë/ha)	100.62	2.8	1.13	8.2
Gjelbërim i zonës urbane (m^2/banor)	33.57	33.57	33.57	33.57
Parkimi maksimal i mundur (m^2)	234,246	79,038	48,858	185,760
Nr.i njësive strukturore	56	104	106	112
Njësi banimi	9,760	3,294	2,035	7,740
Dendësia njësi banimi/ha	38.79	25.4	15	25

Hapësira publike	22.4 ha	4.2 ha	3.2 ha	6.8 ha
Nr.i njësive për PDV	6	0	0	6
Nr.i njësive TDZH	Po 1 dhënëse 2 marrëse	Jo	Jo	Po 4 dhënëse
Njësi për INK	2	-	-	-
Sistemi urban (ha)	251.6	129.4	133	309.5
Sistemi bujqësor (ha)	0	2,753	2,478	2,353
Sistemi natyror (ha)	0	1,008	4,281	456
Sistemi ujor (ha)	0	220.6	130.8	33.6
Sistemi infrastrukturor (ha dhe km)	31	113.3	87.7	351.7

Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

Në bazë të VKM-së nr. 671, në këtë seksion të planit tabela e mësipërme paraqet zonat si shumatore të njësive strukturore, si dhe të dhënat në bazë të propozimeve që përshin plani.

2.1.3 Nyjet kryesore të infrastrukturave dhe hapësirave publike

Nyjet kryesore infrastrukturore dhe hapësirat publike: Nyjet kryesore infrastrukturore të parashikuara në bashkinë e Kuçovës janë 4. Këto nyje të propozuara ndodhen të gjitha përgjatë autostradës së Boshtit të Jugut, si dhe të gjitha janë nyje infrastrukturore me disnivel. Nyja e parë infrastrukturore është nyja në afërsi të hyrjes së qytetit, e cila krijohet nga autostrada dhe rruga Kuçovë-Ura Vajgurore. Nyja e dytë është nyja që krijohet nga rruga Kuçovë –Kozarë me autostradën në afërsi të urës mbi lumin Devoll. Këto dy nyje do të jenë nyje infrastrukturore me disnivel, me hyrje dhe dalje në autostradë. Dy nyjet e tjera krijohen nga autostrada dhe rruga dytësore që lidh aksin Kuçovë- Ura Vajgurore me skajin jugor të qytetit të Kuçovës, si dhe nga rruga dytësore e aeroportit që lidh pistën e avionëve me vendqëndrimin e tyre. Këto dy nyje do të jenë nyje me disnivel dhe autostrada do të kalojë me nënkalim.

Gjelbërimi në qendrat e banuara të bashkisë Kuçovë: Parametrat dhe standardet e gjelbërimit për qendrat e banuara përcaktohen në VKM-në nr. 671, në nenin 83:

Gjelbërimi publik në territoret urbane:

1. Përcaktimet e këtij neni nuk përdoren për territoret që kanë përdorim homogjen B-bujqësi, N-toka natyrore dhe U-ujëra.

2. Zonat e gjelbra në nivel territori urban përbëhen nga: a) gjelbërimi i përgjithshëm publik; b) gjelbërimi publik i kufizuar; c) gjelbërimi i veçantë.

3. Standardet minimale për gjelbërimin e përgjithshëm publik, sipas llojeve përbërëse, janë:

a) 2.5m2/banor për gjelbërim në nivel njësie, përjashtuar gërmat b) dhe c) të kësaj pike dhe përfshirë këndе lojërash për fëmijë, pavarësisht numrit të popullsisë së njësisë;

b) $1m^2$/banor në qendra deri në 10,000 banorë dhe $4m^2$/banor në qendra me mbi 10,000 banorë për gjelbërim masiv në parqe dhe lulishte brenda aglomeratit.

c) $1.5m^2$/banor në qendra deri në 10,000 banorë dhe $2.5m^2$/banor në qendra me mbi 10,000 banorë për gjelbërim në rrugë, shëtitore, sheshe dhe brigje ujore, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

ç) gjithsej për gërmat a), b) dhe c) të kësaj pike, $5m^2$/banor në qendra deri në 10,000 banorë dhe $9m^2$/banor në qendra me mbi 10,000 banorë;

d) 8m²/banor në qendra deri në 10,000 banorë dhe 17m²/banor në qendra me mbi 10,000 banorë për gjelbërim të zonës së pushimit park periferik. Kjo zonë mund të përmbajë edhe struktura të shërbimit publik për aktivitete argëtuese, kulturore, sportive, sheshe të ndryshme lojërash për fëmijë e të rritur, rrugë këmbësore, shkallare etj. Sipërfaqja e asfaltuar dhe/ose e zënë me struktura përbën jo më shumë se 5% të sipërfaqes së përgjithshme të parkut.

dh) gjithsej për gërmat ç) dhe d) të kësaj pike, 13m²/banor në qendra deri në 10,000 banorë dhe 26m²/banor në qendra me mbi 10,000 banorë.

4. Çdo strukturë banimi duhet të ketë në një rreze prej 400 metrash, të paktën një hapësirë të gjelbër të llojit të përcaktuar në germën b) të pikës 3 të këtij neni.

5. Gjelbërimi shoqëror i kufizuar përfshin sipërfaqet e gjelbra me përdorim publik, si edhe gjelbërimin vetjak të banesave individuale tip vilë, pavarësisht nëse banesat janë të bashkëngjitura apo të shkëputura. Standardi minimal është 1 deri në 2 m²/banor dhe varet nga tipologjia e ndërtimeve, madhësia e parcelës minimale dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit. Këto zona përdoren vetëm nga përdoruesit e ndërtimit, si: pacientët që përdorin hapësirën e gjelbër në një spital, klientët e një institucioni, vizitorët apo banorët e banesës individuale.

6. Gjelbërimi i veçantë përfshin struktura dhe zona me funksione, të tilla si: kopsht botanik dhe/ose zoologjik, fidanishte dhe breza sanitarë mbrojtës. Standardet për kopshtin botanik dhe zoologjik vlerësohen sipas manualeve të projektimit, numrit të përdoruesve dhe aktiviteteve që parashikohet të kryhen në një zonë të tillë.

7. Standardet për parqet dhe lulishtet në pronësi private nuk janë objekt i kësaj rregulloreje.

Tabela 89. Standardet dhe parametrat aktualë dhe të propozuar të gjelbërimit në qytetin e Kuçovës

Zona e gjelbër	Standardi	Vlera ekzistuese		Vlera e propozuar	
	m²/banor	ha	m²/banor	ha	m²/banor
a) Gjelbërim në nivel njësie strukturore	2.5 m²/banor	0	0	Kshp-të për njësitë strukturore variojnë nga 5% deri ne 20%	
b) Gjelbërim masiv parqe e lulishte	4 m²/banor	7.9	2.8	28.4	8.8
c) Gjelbërim rrugor, sheshe, brigje ujore në zonë urbane	2.5 m²/banor	5.1	1.8	7.3	2.27
ç) a&b&c	9 m²/banor	13	4.6	45.4	14.07
d) Park periferik	17 m²/banor	16.7	5.94	63.2	19.5
dh) ç&d: Gjelbërim i përgjithshëm publik	26 m²/banor	29.7	10.54	108.6	33.57
e) Fidanishte	PA	230.6	-	922.1	-
ë) Zonë ripariane	PA	165.2	-	388.9	-
f) Kopsht zoologjik	PA	PA	PA	PA	PA
g) Kopsht botanik	PA	PA	PA	PA	PA
gj) Breza sanitarë, zona buferike, breza mbrojtës	PA	0	-	838.1	-
h) Pyje (pyllëzim)	PA	0	-	0	-
i) Zona të mbrojtura natyrore	PA	0	-	959.2	-
e-i) Gjelbërim i veçantë	PA	385.8	-	3,108.3	-

Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

Tabela e mësipërme paraqet standardet e gjelbërimit sipas zërave të caktuar aktualë dhe të propozuar, në bazë të nenit 83 të VKM-së nr. 671. Për sa i përket gjelbërimit të përgjithshëm publik, sipas standardit, ai duhet të jetë 26m²/ banor. Me sipërfaqet aktuale të gjelbërimit ky standard nuk përmbushet, sepse është 10.54 m²/banor, ndërsa me sipërfaqet e propozuara shkon në 33.57m²/banor. Gjelbërimi i përgjithshëm publik ndahet në disa zëra: gjelbërimi në nivel njësie strukturore; gjelbërimi masiv i parqeve dhe lulishteve; gjelbërimi rrugor, i shesheve dhe i brigjeve ujore në zona urbane; gjelbërimi i parqeve periferike. Vërehet se sipërfaqet aktuale të gjelbërimit nuk e plotësojnë standardin në asnjë nga këto zëra, ndërsa sipas sipërfaqeve të propozuara të gjelbërimit vetëm njëri nga këto zëra nuk e plotëson standardin, por që kompensohet me zërat e tjerë dhe, në total, standardi i përgjithshëm plotësohet.

Për sa i përket sipërfaqeve të tjera të parashikuara në VKM, fidanishtet aktualisht janë 23.6 ha dhe propozohet të rriten në 922.1 ha. Sipërfaqet e zonave ripariane aktualisht janë 165.2 ha dhe propozohet të rriten në 388.9 ha. Brezat sanitarë aktualisht nuk aplikohen në bashkinë e Kuçovës dhe, sipas distancave të përcaktuara me ligj, si breza sanitarë propozohet një sipërfaqe prej 838.1 ha, ndërsa për zonat e mbrojtura propozohet krijimi i parkut rajonal të kodrave të Kozarës, si dhe krijimi i rezervateve të menaxhuara natyrore të Belesovës dhe të Sinecit.

Zonat e hapësirave publike: Në qytetin e Kuçovës ka disa hapësira të reja publike që propozohen si të tilla, përveç hapësirave publike ekzistuese. Këto hapësira janë: zona e ish-UPN-së, zona e ish-TEC-it, zona përgjatë kanalit kullues që kalon në qytet. Zona e ish-UPN-së dhe ish-TEC-i janë njësi strukturore të veçanta. Këto zona kanë probleme të mëdha mjedisore, sepse kanë statusin e ish-zonave industriale. Për to do të ketë rehabilitim mjedisor më pas dhe rikonceptim, në mënyrë që të kthehen në hapësira publike. Këto hapësira publike do të kenë funksion rekreativ dhe çlodhës për qytetin. Hapësirë publike e propozuar është edhe itinerari i këmbësorëve dhe i biçikletave përgjatë kanalit kullues, i cili ndiqet nga kryqëzimi hyrës ekzistues i qytetit deri në zonën e varrezave të qytetit. Kjo hapësirë mund të shërbejë edhe si zonë për aktivitete sportive si vrap në natyrë dhe ecje me biçikleta. Kjo hapësirë do të ketë edhe zona të gjelbra, të cilat janë të domosdoshme sepse do të shërbejnë edhe si brez mbrojtës i zonave industriale në afërsi.

Itineraret e biçikletave dhe të këmbësorëve përfshihen në këto hapësira publike, nga të cilat mund të përmendim itinerarin e kodrave të Kuçovës, i cili fillon në zonën e Kishës së Shën Kollit në Perondi, kalon në zonat e kodrave të Kuçovës dhe përfundon në afërsi të urës mbi lumin Devoll, i cili lidh Kuçovën me Kozarën. Bulevardi kryesor i qytetit synon të kthehet në një hapësirë për këmbësorë, si dhe propozohet të zgjatet në pjesën perëndimore deri në afërsi të kanalit kullues që ndodhet në qytet, si dhe të lidhet me zonën rekreative të ish-UPN-së. Gjithashtu, si hapësira publike të gjelbra Bashkia përfshin edhe zonën e kodrave, të cilat janë të përshtatshme si zona çlodhjeje dhe argëtimi. Një zonë tjetër që do të ketë ndërhyrje që të kthehet në hapësirë të gjelbër është edhe zona e meandrimit të lumit Devoll në afërsi të venddepozitimit ekzistues të mbetjeve, e cila do të trajtohet si zonë rekreative me pemë të larta.

Hapësirat publike në njësitë administrative: Hapësirat publike që janë menduar të propozohen janë rikonceptimet e shesheve qendrore të qendrave të njësive administrative

që ndodhen në Lumas, Perondi dhe Kozarë. Si pjesë e ndërhyrjes së njësive strukturore ku përfshihen këto sheshe do të jetë edhe rikonceptimi që ka të bëjë me zhvillimin e projekteve të dizajnit të këtyre hapësirave publike. Gjithashtu, si hapësirë publike mund të quhet edhe zona e parkut rajonal të Kozarës, e cila është një zonë e gjelbër që pret të ketë investime në infrastrukturën rrugore për t'u aksesuar më mirë. Kjo zonë është një zonë e përshtatshme për aktivitete në natyrë si piknikët.

2.1.4 Njësitë strukturore të territorit

- **Njësitë strukturore të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë së Kuçovës**

Një nga etapat më të rëndësishme të Planit të Përgjithshëm Vendor është edhe përcaktimi i njësive strukturore të planit. Në këtë seksion do të shpjegohen kriteret bazë të ndarjes së njësive strukturore të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë së Kuçovës, mënyrat e ndërhyrjes së njësive strukturore, si dhe njësitë strukturore që shkojnë për PDV-në. VKM-ja nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", në seksionin 7, në nenin 75, shpjegon ç'është një njësi strukturore, si dhe kriteret bazë që duhet të ketë një njësi strukturore.

Njësia është ndarja më e vogël e territorit për qëllime zhvillimi, e cila përcaktohet gjatë procesit të planifikimit. Autoriteti i planifikimit përcakton kufijtë e njësive në Planin e Përgjithshëm Vendor në mënyrë të tillë që një njësi:

- të mos ketë përdorime të papërputhshme dhe me ndikime negative mes tyre, veç rasteve kur parashikohen kushte shtesë për realizimin e një zhvillimi;
- të jetë kompakte dhe e njëtrajtshme sa i përket tipologjisë hapësinore të parashikuar nga plani;
- të ketë tregues dhe kushte të njëtrajtshme të zhvillimit sipas rregullores së zhvillimit;
- të kufizohet nga rrjeti rrugor, pavarësisht nga kategoritë e rrugëve dhe, sipas rastit, nga linja hekurudhore, breza mbrojtës dhe sanitarë, brigje ujore, përrenj, lumenj apo elemente të tjera lineare dhe të dukshme në territor;

Veç këtyre kritereve janë marrë në konsideratë edhe kritere të tjera, si më poshtë:

- Vijat e dukshme në hartë/fotografi ajrore të pronësisë apo të ndarjes së qartë të përdorimeve;
- Distancat nga trupat ujorë, distancat nga zonat industriale, distancat dhe mënyrat e zhvillimeve përgjatë objekteve infrastrukturore të rëndësisë kombëtare;
- Qëllimi i synuar në të ardhmen për zhvillimin në zonë;
- Ndërhyrjet përmirësuese/plotësuese infrastrukturore;
- Raporti sipërfaqe – nr. pronësish/parcelash të dukshme;
- Mënyra e ndërhyrjes në territor, e analizuar së bashku me funksionin e propozuar apo përdorimin e ardhshëm të tokës;
- Qëllimi i synuar për mbrojtjen apo konservimin e territoreve dhe elementeve territoriale të caktuara;
- Kushtëzime ligjore sektoriale;
- Konsultat me pronarë të tokave dhe grupe të interesit në lidhje me zhvillimin e zonave të caktuara.


Ndërkohë, ndër këto njësi strukturore disa janë përzgjedhur për të qenë subjekt i PDV-së. Kriteret për përzgjedhjen e zonave për PDV-në janë përcaktuar në rregulloren e planifikimit të miratuar me VKM-në nr. 671 në vitin 2015. Këto kritere janë:

a) Zhvillimi dhe/ose rizhvillimi, sipas parashikimeve të PPV-së;
b) Ndryshimi i përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit, sipas parashikimeve të PPV-së dhe drejtimeve të kësaj rregulloreje;
c) Investimet publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit, sipas parashikimeve të PPV-së;
ç) Programet e transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte, sipas parashikimeve të PPV-së dhe drejtimeve të neneve 30 dhe 31 të ligjit.

Veç këtyre kritereve, sipas rastit janë marrë në konsideratë edhe kriteret e mëposhtme:

- Mënyra e ndërhyrjes në territor, e analizuar së bashku me funksionin e propozuar apo përdorimin e ardhshëm të tokës;
- Raporti sipërfaqe – nr. pronësish/parcelash të dukshme;
- Lehtësia e realizimit të zhvillimit në bazë parcele përkundrejt atij në bazë zone/njësie dhe mënyra e menaxhimit të procesit;
- Prioriteti kohor i bashkisë për ndryshime/zhvillim në zonë;
- Konsultat me pronarë të tokave dhe grupe të interesit në lidhje me zhvillimin e zonave të caktuara.

Figura 189. Njësitë strukturore sipas kodeve, Bashkia Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

Njësitë strukturore të lumenjve: Në këto njësi strukturore përfshihen pjesët e shtratit të lumenjve, zonat ripariane të lumenjve dhe, në rastet kur zonat ripariane janë më të vogla se 20 m, që është distanca minimale që përcakton ligji për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në brigje, janë përfshirë edhe toka bujqësore në brendësi të kësaj distance. Pra, në këto raste, kufiri i njësisë strukturore është distanca 20 m nga lumi. Këto njësi

strukturore do të kenë përdorim miks, sepse në këto njësi përfshihen tri lloje përdorimesh që janë: kategoria ujore (shtrati i lumit dhe lumi), kategoria natyrore (këtu përfshihen zonat ripariane) dhe kategoria bujqësore (sipas rastit, këtu përfshihen tokat bujqësore në distancë më të vogël se 20 m nga lumi). Këto njësi strukturore do të kenë disa mënyra ndërhyrjeje të kombinuara. Pjesët e lumit dhe të shtratit të lumit do të jenë zona konservimi, zonat ripariane do të jenë zona rehabilitimi mjedisor dhe trajtimi perizazhistik, ndërsa zonat bujqësore që janë pjesë e këtyre njësive strukturore, do të jenë zona konservimi, të cilat do të kenë si kriter mbjelljen e kulturave bujqësore, kryesisht pemëtore, me qëllim ruajtjen e territorit nga erozioni dhe veprimtaria e lumit.

Njësitë strukturore të zonave naftëmbajtëse: Në këto njësi përfshihet sipërfaqja e tokës e cila është në një distancë më të vogël se 50m nga puset e naftës. Kriteri i dytë i përcaktimit të këtyre njësive strukturore është kufiri i pronësisë. Përgjithësisht, tentohet që, në rastet kur prona do të ndahet, të kemi ndarje të pronës në formë të atillë që pjesa e pronës e cila është jashtë zonës naftëmbajtëse të jetë e shfrytëzueshme për qëllime të pronarit të saj. Këto zona do të jenë zona ekskluzive për veprimtarinë industriale të nxjerrjes së naftës në të cilat nuk do të lejohet një veprimtari tjetër. Mënyra e ndërhyrjes do të jetë ngrirje dhe zhvendosje urbane. Zhvendosja urbane do të aplikohet si mënyrë ndërhyrjeje në një njësi strukturore që cilësohet si zonë industriale e nxjerrjes së naftës. Kjo ndodh sepse zonat e banuara ndodhen në një distancë mjaft të vogël me puset. Në këto njësi strukturore nuk do të lejohet të prodhohen as prodhime bujqësore të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut i cili i konsumon. Këto njësi strukturore do të kenë masa për sigurimin e puseve dhe pastrimin mjedisor në zonat përrreth tyre, si dhe për mbjelljen e biməve që rrisin sasinë e oksigjenit në ajër.

Njësia strukturore e parkut rajonal ka patur relievin si kriter të përcaktimit të kufirit të saj, duke përfshirë në një njësi strukturore të gjithë zonën e kodrave, e cila ndodhet në zonën e Kozarës. Në këtë njësi përfshihen zona të cilat janë të mbjella me drurë frutorë, si dhe kultura të tjera bujqësore. Do të propozohet që të ketë programe mbjelljeje me pemë frutore në disa zona. Në zonat natyrore të kësaj njësie do të ketë trajtime të peizazhit, si dhe zona konservimi. Gjithashtu, do të ketë edhe ndërhyrje infrastrukturore për përmirësimin e aksesit të zonës. Në këtë njësi kemi ekzistencën e një zone e cila ka puse nafte e, si rrjedhojë, në këtë zonë nuk do të lejohet mbjellja e produkteve bujqësore në një distancë deri në 50 m nga puset. Kjo zonë do të ketë masa për sigurimin e puseve nga rrjedhjet dhe masa për uljen e emetimeve të tyre në ambient.

Njësia strukturore e aeroportit: Si kriter të përcaktimit të saj kjo njësi strukturore ka pronësinë dhe përdorimin e tokës. Mënyra e ndërhyrjes do të jetë ngrirja dhe konservimi, sepse ndërhyrja në këtë zonë është në kompetencën e isntitucioneve qendrore, sepse klasifikohet si zonë me rëndësi kombëtare.

Njësitë strukturore bujqësore: Si kriter bazë të përcaktimit të tyre njësitë bujqësore kanë funksionalitetin e tyre, rrjetin rrugor, si dhe pronësinë. Për këto njësi do të propozohet konservim. Në disa raste në këto njësi janë përfshirë edhe ndërtime të cilat janë në zona bujqësore. Për këto ndërtime propozohet ngrirja urbane.

Njësitë strukturore natyrore: Si kriter të përcaktimit të tyre njësitë strukturore natyrore kanë rrjetin rrugor dhe format e relievit të cilat strukturojnë territorin. Në këto njësi propozohet konservim dhe rehabilitim mjedisor.

Njësitë strukturore të autostradës: Ky grupim i këtyre njësive ka të përbashkët vetëm kalimin e autostradës nëpër këto njësi. Në këto njësi do të respektohen distancat nga akset rrugore, që janë 25 m brez.

Njësitë strukturore të ndërtueshme:

Njësitë strukturore të fashës ekonomike: Këto njësi strukturore përfshijnë zonën përgjatë aksit kryesor Ura Vajgurore- Kuçovë. Ato kanë si kriter kryesor kufirin e pronësisë. Kështu, në këto njësi do të përfshihen të gjitha pronat që janë në vijën e parë në afërsi të rrugës, kurse në rastet kur vlerësohet që prona është shumë e madhe për t'u përfshirë e gjitha, bëhet një ndarje e pronës në mënyrë të atillë që të jetë e shfrytëzueshme në të dyja njësitë strukturore. Gjithashtu, kriter për përcaktimin e njësive strukturore janë edhe akset pingule të aksit kryesor Ura Vajgurore- Kuçovë. Mënyra e ndërhyrjes do të jetë ndërhyrje me zhvillim, sepse këto njësi pritet të krijojnë një zonë të mirëfilltë të bizneseve dhe shërbimeve, si dhe do të kenë parametra zhvillimi dukshëm me të lartë se parametrat ekzistues që ka zona. Gjithashtu, në shumë pjesë të këtyre njësive do të kemi konvertime nga toka bujqësore në tokë truall. Kjo sjell edhe ndryshimin e përdorimit ekzistues të tokës. Tipologjitë ndërtimore mund të jenë ndërtime 3-4 kate kolektive ose individuale të përshtatshme për biznes, por edhe për funksion rezidencial. Këto njësi, nga karakteristikat që kanë për zhvillim, bazuar në VKM-në nr. 671, shkojnë të gjitha për PDV-në.

Njësitë strukturore të qytetit të Kuçovës: Qyteti i Kuçovës qartësisht ndahet në dy zona të mëdha. Ky dallim i këtyre zonave sjell edhe ndryshimin e kritereve të përcaktimit të kufijve të njësive strukturore. Këto njësi strukturore qartësisht do të ndryshojnë nga mënyra e ndërhyrjes, tipologjia e ndërtimit, si dhe përdorimet që do të kenë. Zona fushore e qytetit të Kuçovës do të ketë përdorim toke miks, sepse është zona ku do të vendosen zonat e shërbimeve, zonat e argëtimit, zonat industriale, si dhe zonat e banimit me dendësi të ndryshme. Zona kodrinore e qytetit të Kuçovës do të ketë përdorimin tokë bazë "banim" kryesisht me dendësi të mesme të ulët, të plotësuar me shërbime mbështetëse. Së pari, do të shpjegojmë kriteret, mënyrat e ndërhyrjes, si dhe tipologjitë e propozuara të zonës fushore dhe, së dyti, do të shpjegojmë kriteret, mënyrat e ndërhyrjes dhe tipologjitë e propozuara të zonës kodrinore.

Njësitë strukturore të zonës fushore me përdorim miks:

Njësitë strukturore të industrisë dhe të shërbimeve: Këto njësi strukturore ndodhen në zonën mikse, përkatësisht përgjatë rrugës "Naftëtari", që është rruga kryesore hyrëse për në qytetin e Kuçovës, si dhe përgjatë rrugës "Llambi Shella". Si kriter të përcaktimit të tyre këto njësi kanë tipologjinë ekzistuese të ndërtimit që janë ndërtesa të përshtatshme për magazinim. Gjithashtu, kriter tjetër është rrjeti rrugor dhe kufiri i pronësisë. Këto njësi strukturore kanë qenë dhe më parë zona industriale dhe kanë probleme mjedisore dhe të degradimit të strukturave. Mënyra e ndërhyrjes në këto zona do të jetë rigjenerimi i tyre me përdorim miks "shërbime" dhe "industri" me tipologji të njëjtë ndërtimore. Bazuar në këto karakteristika, si dhe bazuar në VKM-në nr. 671, këto njësi do të kenë PDV.

Njësitë strukturore industriale të veprimtarisë së naftës në qytetin e Kuçovës: Në qytetin e Kuçovës do të propozohen 4 njësi strukturore të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e përpunimit dhe nxjerrjes së naftës. Si kriter të përcaktimit të kufijve të tyre këto njësi kanë përdorimin e tokës, rrjetin rrugor, mënyrën e ndërhyrjes që do të kenë këto njësi strukturore, si dhe distancën e zonës mbrojtëse sanitare, që është 50 m nga këto objekte. Mënyrat e

ndërhyrjes që propozohen janë ngrirje, zhvendosje, si dhe rehabilitim mjedisor. Në këto njësi vërehet qartë që ka ndërtime me funksion "banim". Për këtë përdorim toke do të ketë ngrirje dhe zhvendosje të këtyre banorëve. Në këto njësi do të lejohen vetëm aktivitetet industriale të përpunimit të naftës. Në këto zona do të ndërmerren masa për forcimin e sigurisë dhe zvogëlimin e pasojave në mjedis të këtyre veprimtarive.

Njësia strukturore e zhvillimit të banesave sociale: Kjo njësi ndodhet në zonën fushore dhe bën pjesë në njësitë e banimit në pjesën veriperëndimore të qytetit. Në këtë njësi do të ndiqet programi i strehimit social. Kriteret e përcaktimit të kësaj njësie janë rrjeti rrugor dhe pronësia. Mënyra e ndërhyrjes në këtë zonë është zhvillimi dhe dendësimi, sepse do të kemi ndryshim të përdorimit të tokës, të tipologjisë së ndërtimit, si dhe të parametrave të zhvillimit. Kjo njësi, në bazë të kompleksitetit të zhvillimit që ka, do të zhvillohet me PDV. Tipologjia e ndërtimit që do të propozohet do të jetë banesa kolektive me lartësi deri në 3-4 kate.

Njësitë strukturore të zonave të aktiviteteve sociale dhe rekreative: Këto njësi strukturore janë 3: njësia strukturore e ish-UPN-së, njësia strukturore e zonës e ish-TEC-it, si dhe njësia strukturore e stadiumit të qytetit. Si kriter bazë të përcaktimit të këtyre njësive është sistemi rrugor, përdorimi i tokës, si dhe mënyrat e ndërhyrjes. Në dy njësitë e para mënyra e ndërhyrjes do të jetë rehabilitimi mjedisor dhe rikonceptimi i tyre, duke qenë se janë zona ish-industriale dhe paraqesin problematikë mjedisore dhe degradim. Që të kthehen në zona rekreative të qytetit, përpos rehabilitimit mjedisor, ato kanë të domosdoshme edhe projekte rikonceptimi të tyre. Njësitë e ish-UPN-së dhe ish-TEC-it do të zhvillohen me PDV, në bazë të VKM-së nr. 671. Njësia strukturore e stadiumit do të ketë rigjenerim dhe rikonceptim.

Njësia strukturore e tregut të lirë të qytetit të Kuçovës: Si kriter bazë të përcaktimit të saj kjo njësi ka përdorimin dhe rrjetin rrugor. Si njësi strukturore nuk do të ketë ndryshim përdorimi, por do të zhvillohet me parametra të tjerë. Në këtë situatë, mënyra e ndërhyrjes do të jetë rizhvillimi. Përveç zonës së tregut të lirë të qytetit propozohet të ndërtohet edhe pika e grumbullimit të produkteve bujqësore, si dhe plotësimi me shërbime mbështetëse.

Njësitë strukturore të banimit: Njësitë strukturore të banimit në zonën mikse ndahen në tri grupime: grupimi i njësive strukturore të banimit në hyrje dhe në dalje të qytetit të Kuçovës që ndodhen përgjatë akseve rrugore kryesore, grupimi i njësive strukturore të banimit në afërsi të zonave industriale të naftës, si dhe njësitë strukturore qendrore të banimit.

Grupimi i parë janë njësitë e banimit të ndodhura në hyrje dhe në dalje të qytetit të Kuçovës të cilat si kriter të përcaktimit të tyre kanë rrjetin rrugor, tipologjinë ndërtimore, përdorimin e tokës, si dhe problematikat. Këto njësi, aktualisht, janë njësi me dendësi të ulët, ndaj propozohet dendësim me mbushje urbane, si dhe ristrukturim infrastrukturor. Tipologjia e ndërtimit do të vazhdojë të jetë e njëjta, me ndërtime individuale me lartësi dy deri në tri kate. Në këto njësi vërehet se ka puse nafte, ndaj në një distancë prej 50 m nga puset nuk lejohet të ndërtohet dhe duhet të propozohen masa mbrojtëse për zvogëlimin e pasojave që kanë në mjedis.

Njësitë strukturore të banimit në afërsi të zonave industriale të naftës: Grupimi i dytë janë tri njësi strukturore në periferi të qytetit të Kuçovës të cilat kanë një problematikë të njëjtë sepse ndodhen në mes dy njësive strukturore të industrisë së përpunimit të naftës. Si kriter të përcaktimit të tyre këto njësi kanë mënyrat e ndërhyrjes dhe rrjetin rrugor. Mënyra e

ndërhyrjes është ngrirja e cila nuk lejon zhvillime të reja në zonë, sepse klasifikohet si një zonë me problematikë të madhe mjedisore. Në një fazë të mëvonshme këto njësi mund të propozohen për zhvendosje.

Njësitë strukturore qendrore të banimit: Grupimi i fundit i njësive strukturore të zonës mikse janë njësitë strukturore qendrore të banimit. Ky grupim përbëhet nga 3 njësi strukturore të cilat kanë interes më të madh për zhvillim. Nga grupet e interesit dy njësitë e para ndodhen në zonën qendrore të qytetit përgjatë rrugës "Stanisllav Zuber", që është aksi kryesor i qytetit. Kriteret kryesore të përcaktimit të tyre janë: rrjeti rrugor, mënyra e ndërhyrjes, tipologjia dhe pronësia. Këto njësi strukturore do të kenë zhvillime dukshëm me parametra me të lartë se sa ata ekzistues. Tipologjia e ndërtimit do të jetë banesa kolektive me përdorim miks "banim" dhe "shërbime". Njësia e tretë e këtij grupimi do të ketë zhvillime ndërtimore vetëm në anën lindore të saj, ndërsa për në anën perëndimore do të propozohen breza mbrojtës me pemë të larta për të mbrojtur zonën e banimit nga zonat industriale. Gjithashtu, do të respektohet distanca 50 m nga zona industriale për ndërtimet. Në bazë të këtyre karakteristikave, si dhe në bazë të VKM-së nr. 671, këto njësi zhvillohen me PDV.

Njësitë strukturore të zonës kodrinore me përdorim bazë "banim": Njësitë strukturore të kësaj zone ndahen në tri grupime: njësitë strukturore ndërmjet akseve rrugore "Stanislav Zuber" dhe "Rrugës së Re", grupimi i njësive strukturore të banimit kodrinore, si dhe grupimi i njësive strukturore të banimit periferike.

Grupimi i njësive strukturore ndërmjet dy akseve kryesore përfshin dy njësi të cilat janë të ndërtuara me ndërtesa kolektive në periudhën e realizmit socialist. Si kriter bazë i përcaktimit të këtyre njësive është tipologjia ndërtimore dhe rrjeti rrugor. Përdorimi i këtyre njësive si përdorim bazë ka "banimin", por është i kombinuar me "shërbime" dhe "institucione", duke qenë se po flasim për një zonë qendrore të qytetit. Në njërën njësi propozohet konservim, sepse është një njësi që ka parametra të lartë të zhvillimit ekzistues. Një veçori tjetër është që synohet të ruhet ky bllok ndërtimesh si pjesë e arkitekturës së realizmit socialist. Në njësinë tjetër propozohet dendësim me intensifikim, sepse në këtë njësi kemi tipologji ndërtimi mikse dhe ka hapësira për zhvillime të reja.

Grupimi i njësive strukturore rezidenciale kodrinore përfshin të gjitha njësitë e anës lindore të qytetit të cilat janë përreth qendrës së qytetit. Si kriter kryesor të përcaktimit të tyre këto njësi kanë rrjetin rrugor dhe tipologjinë e ndërtimit. Ndërhyrja që propozohet në këto njësi strukturore është dendësimi me intensifikim.

Grupimi i njësive strukturore periferike përfshin të gjitha njësitë strukturore në anën lindore të qytetit të cilat janë në kufijtë e zonës urbane. Si kritere bazë të përcaktimit të tyre këto njësi kanë rrjetin rrugor, pronësinë, si dhe kufirin ekzistues të zonës urbane. Pra, do të ndiqet me rigorozitet kufiri ekzistues i zonës urbane dhe nuk do të ketë zhvillime të reja në drejtim të kodrave. Mënyra e ndërhyrjes së këtyre njësive strukturore do të jetë dendësimi me mbushje urbane dhe konsolidimi. Këto mënyra ndërhyrjeje nuk lejojnë zhvillime intensive të këtyre zonave. Tipologjia ndërtimore propozohet të jetë e njëjtë dhe karakteri i këtyre zonave të forcohet. Me këto mënyra ndërhyrjeje synohet mbrojtja e kodrave nga zhvillimet ndërtimore.

Njësitë strukturore të fashës së banimit Rreth Tapi – Kuçovë: Këto njësi strukturore përfshijnë zonat të cilat janë përgjatë aksit rrugor që lidh fshatin Rreth Tapi me aksin rrugor

Ura Vajgurore-Kuçovë dhe përfundon në skajin jugor të qytetit të Kuçovës. Këto njësi strukturore kriter të përcaktimit të tyre kanë pronësinë, tipologjinë e propozuar dhe mënyrën e ndërhyrjes. Mënyrat e ndërhyrjes do të jenë konsolidimi dhe, në disa raste, dendësimi me mbushje urbane. Përdorimi bazë i tokës do të jetë "banimi" dhe tipologjia do të jetë ndërtime individuale me lartësi maksimale 2-3 kate. Këto njësi nuk do të kenë parametra të lartë zhvillimi në krahasim me parametrat ekzistues të tyre.

Njësitë strukturore të fashave të banimit Gegë dhe Drizë: Këto njësi strukturore janë dy grupe njësish të cilat kanë karakteristika të njëjta. Kriteret e përcaktimit të tyre janë pronësia, mënyrat e ndërhyrjes dhe përdorimi i tokës. Këto njësi janë njësi me përdorim bazë "banimin" dhe mënyra e ndërhyrjes do të jetë konsolidimi urban, sepse do të synohet të ruhet karakteri aktual i tyre. Kjo do të thotë që këto zona do të kenë zhvillime me parametra pak më të lartë sesa parametrat ekzistues të zhvillimit. Këto njësi, me zhvillimin që do t'u jepet, do të krijojnë zona urbane përgjatë akseve rrugore duke ruajtur karakterin e tyre.

Njësitë strukturore të fashës Perondi: Njësitë strukturore të fashës funksionale të Perondisë do të ndahen në dy grupime, të cilat dallohen nga mënyrat e ndërhyrjes, ndërsa kriteret e tjera të përcaktimit të tyre janë të njëjta. Si kritere bazë këto njësi do të kenë pronësinë si dhe rrjetin rrugor. Këto njësi përfshijnë të gjitha zonat nga fshati Perondi deri në fshatin Goraj. Njësia qendrore e fshatit Perondi do të ketë mënyrë ndërhyrjeje me dendësim dhe përdorimi i saj do të jetë përdorim miks, ku si bazë do të ketë "banimin", por do të propozohen edhe përdorime "shërbimesh" plotësuese. Do të ketë ndërtime me intensitet të mesëm-të ulët. Në njësitë e tjera ndërhyrja do të jetë konsolidimi urban, në mënyrë që të ruhet karakteri i zonave, intensiteti i ndërtimit do të jetë i ulët dhe përdorimi kryesor do të jetë "banim".

Njësitë strukturore të Kozarës: Si kriter të përcaktimit të tyre njësitë strukturore të fshatit Kozarë do të kenë rrjetin rrugor dhe pronësinë. Për nga mënyra e ndërhyrjes dhe e përdorimit do të kemi dy lloje njësish. Njësia qendrore e fshatit do të ketë përdorim miks, ndërhyrja do të jetë dendësimi me mbushje urbane dhe rikonceptimi i intensitetit të ndërtimit do të jetë i mesëm- i ulët. Në njësitë e tjera strukturore të fshatit ndërhyrja do të jetë konsolidimi urban, dhe përdorimi bazë do të jetë "banimi" dhe intensiteti i ndërtimit do të jetë i ulët në mënyrë që të ruhet karakteri i zonave.

Njësia strukturore e Lumasit: Si kriter bazë të përcaktimit të saj njësia strukturore e Lumasit ka përdorimin dhe pronësinë e tokës. Metoda e ndërhyrjes do të jetë dendësimi dhe rikonceptimi, ndërsa intensiteti i ndërtimit do të jetë i ulët, në mënyrë që zona të ruajë karakterin që ka.

Njësitë strukturore të fshatrave: Si kriter bazë këto njësi kanë rrjetin rrugor, përdorimin e tokës dhe pronësinë. Mënyra e ndërhyrjes që propozohet në këto njësi është konsolidimi urban, kurse parametrat e zhvillimit do të jenë minimalë. Ajo që synohet është ruajtja e karakterit të këtyre zonave.

2.1.5 Parashikimi demografik dhe strehimi

Në këtë seksion, në bazë të parashikimit të popullsisë që është bërë në analizën demografike sipas dy burimeve që janë Gjendja Civile dhe INSTAT-i, do të bëhet një parashikim mbi kapacitetin mbajtës të popullatës që do të ketë bashkia Kuçovë, në bazë të

propozimeve që ndërmerr plani. Gjithashtu, do të merret parasysh edhe faktori i strehimit social, si dhe familjet të cilat do të zhvendosen si pasojë e problemeve me përdorimet e papërputhshme të tokës.

Tabela 90. Parashikimi për popullsinë e Bashkisë Kuçovë, 2011-2031

Popullsia, qarku, bashkia, komunat, 2011-2031	Bashkia Kuçovë	Kuçovë	Perondi	Kozarë	Lumas
2011	32,964	13,343	9,495	5,928	4,198
2015	31,424	12,720	9,052	5,651	4,002
2016	30,531	12,358	8,794	5,491	3,888
2021	28,489	11,532	8,206	5,123	3,628
2026	26,653	10,788	7,677	4,793	3,394
2031	24,969	10,107	7,192	4,490	3,180

Burimi: INSTAT; Llogaritje të autorëve; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2015

Tabela 91. Parashikimi i popullsisë sipas regjistrit të gjendjes civile 2021, 2026, 2031

Emërtimi	2015	2016	2021	2026	2031	Dif 2031-2015
NjA Kuçovë	29558	29473	29053	28638	28230	-1328
NjA Perondi	10494	10470	10349	10229	10020	-474
NjA Kozarë	7949	7938	7864	7794	7727	-222
NjA Lumas	7014	7011	6997	6983	6969	-45
Total	55015	54892	54263	53644	52946	-2069

Burimi: Gjendja Civile; Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN; 2016

Në tabelat e mësipërme vërehet që kemi diferenca të mëdha të dhënash ndërmjet dy burimeve. Sipas INSTAT-it, numri i popullsisë aktuale në bashkinë e Kuçovës është 32,964 banorë dhe parashikohet që në vitin 2031 të ulet deri në 24,969 banorë. Sipas Gjendjes Civile, popullsia aktuale e bashkisë Kuçovë është 55,015 dhe në vitin 2031 parashikohet të ketë rënie me 2069 banorë dhe popullsia të jetë 52,946 banorë. Ndërkohë që kapaciteti mbajtës i bashkisë Kuçovë me zhvillimiet që parashikohen në total shkon në 91,317 banorë. do të merret mundësia për të plotësuar territorin me shërbime dhe plani afatgjatë i Bashkisë për të rritur popullsinë. Nga zhvillimet që do të ketë bashkia Kuçovë në kuadër të planit synohet që popullsia të ketë një rritje reale me 3000 banorë, pra në bazë të propozimeve që parashikon ky plan pas 15 vitesh do të jetë 58,015 banorë, bazuar në të dhënat e regjistrit të gjendjes civile.

Si pasojë e mënyrave të ndërhyrjes në territor, në bashki rritet kapaciteti mbajtës përtej parashikimeve të popullsisë sipas INSTAT e Gjendjes Civile. Kjo rritje e kapaciteti mbajtës vjen sepse ndërtimet për banim mund të rriten pasi kemi 18 njësi strukturore për mbushje urbane, 19 njësi strukturore për dendësim, 2 njësi strukturore për rigjenerim, 7 njësi strukturore për intesifikim dhe 104 njësi strukturore për konsolidim. Njësitë për konsolidim janë kryesisht njësitë strukturore me përdorim bazë banimi të fshatrave që parametrat e propozuar të zhvillimit janë pak më të lartë se sa ato ekzistues.

Përsa i përket gjendjes së strehimit, nga analiza e strehimit social vërehet se rreth 24 familje kanë marrë miratimin nga Këshilli Bashkiak për ndërtimin e banesave sociale, rreth 43 familje do të zhvendosen nga zona e tyre e banimit që është zona industriale e ish-UPN-së dhe rreth 15 familje të tjera do të zhvendosen në kuadër të planit, sepse banesat e tyre

aktuale vlerësohen të jenë në një distancë mjaft të afërt me puset e naftës. Në total kemi rreth 86 familje të cilat do të zhvendosen në një zonë e cila do të shfrytëzohet për strehim social. Duhet thënë se numri i aplikantëve për strehim social në bashkinë Kuçovë është 440 familje, që është një numër mjaft i lartë.

Bashkia me ndihmën e Ministrisë së Zhvillimit Urban ka ndërmarrë hartimin e një projekti për ndërtimin e një objekti ku do të strehohen 24 familje. Ky investim pritet të kryhet në një periudhë afatmesme nga MZHU. Në këtë objekt do të ndërtohet dhe qendra e strehimit të përkohshëm e cila parashikohet si detyrim ligjor.

Lidhur zonën ku janë parashikuar ndërtimet e banesave sociale është njësia me kod 1/45 që ndodhet përbri rrugës kryesore që lidh zonën e Kthesës së Fermës me urën mbi Lumin Devoll. Përveç projektit të objektit që është miratuar nga Këshilli Bashkiak në këtë zonë ka hapësira për ndërtimin e disa objekteve të tilla në mënyrë që të plotësohen kërkesat për banesa sociale për të gjithë Bashkinë Kuçovën

Gjithashtu për zonat të cilat kanë zhvillim intesiv me përdorim bazë banim është parashikuar instrumenti i intesistetit me kusht në menyrë që katet e fundit të ndërtimeve të përdoren si banesa sociale.

Në lidhje me subvensionimin e qerave nga Bashkia për vitin 2016 përherë të parë është parshikuar një fond prej 600 000 lekë për bonus strehimi por që nuk u bë i mundur përdorimi i tij për pengesa ligjore. Ligji i ri parashikon dhe kategoritë që përfitojnë nga bonusi i strehimit. Do të mendohet që vitet në vijim të parashikohet një fond më të lartë 1 200 000 lekë i cili është fillisht modest pasi Bashkia nuk gjeneron të ardhura nga përdorimi i banesave sociale që mund të përdoren për arsye strehimi në formën e subvesionimeve. Me ndërtimin e banesava sociale ky fond do të rritet pasi do shtohen të ardhurat nga përdorimi i banesave sociale.

2.1.6 Instrumentet e drejtimit të zhvillimit

Përsa i përket instrumenteve të drejtimit të zhvillimit në Bashkinë Kuçovë janë përdorur tre lloje instrumentash: BID, TDZH dhe INK:

BID- instrument që përdoret në zonat e zhvillimit të bizneseve; TDZH- Transferimi i të drejtës së zhvillimit; INK- Instrumenti i intensitetit të ndërtimit me kusht.

BID në thelb është një partneriritet publik privat me anë të të cilit pronarët e bizneseve zgjedhin të kontribuojnë financiarisht për zhvillimin mirëmbajtjen dhe promovimin e zonës. Ky instrument ndikon në mënyrë direkte në zonë si dhe rrit prerformancën ekonomike të bizneseve dhe zones në përgjithësi.

TDZH, është një teknikë e menaxhimit të përdorimit të tokës që transferon zhvillimin nga një zonë ku bashkia dëshiron të ketë më pak zhvillim tek zonat ku njësia vendore synon të ketë më shumë zhvillim, në përputhje me planin e përgjithshëm vendor të territorit (PPV)

INK është një instrument që i jep mundësi zhvilluesit të ndërtojë me një intesitet ndërtimi më të lartë në zona të caktuara të bashkisë me kusht që zhvilluesi të ofrojë investime publike.

Njësitë strukturore ku është caktuar që të përdoret instrumenti i BID janë njësitë e fashës ekonomike që lidhin Kuçovën me Urën Vajgurore. BID nuk është i detyrueshëm por i lejueshëm dhe i preferueshëm për këtë zonë.

Njësitë strukturore ku është caktuar që të përdoret TDZH janë dy lloje sipas VKM-së: njësi strukturore marrëse dhe njësi strukturore dhënëse. Njësitë dhënëse janë tre. Këto zona janë përkatësisht zonat me kod1/18, 4/77, 4/27 dhe 4/26 të cilat ndodhen në periferi të qytetit të Kuçovës, kanë kërkesë për ndërtim dhe janë njësi që ndodhen në afërsi me zonat e naftës. Njësitë strukturore të TDZH marrëse janë njësitë me kodifikim 1/4 dhe 1/53, të cilat janë zona qendrore ku interesi për zhvillim është i madh.

Njësitë strukturore në të cilat është vendosur të aplikohet intensiteti i ndërtimit me kusht (INK) janë njësitë me kod 1/4 dhe 1/11. Në njësinë 1/4 intesiteti i propozuar pa kushte për banimin është 1.8 dhe për shërbimet është 1.9, ndërsa intesiteti shtesë me kusht është 0.6 si për banimin dhe për shërbimet. Intensiteti total i propozuar është 2.4 për banimin dhe 2.5 për shërbimet, lartësia maksimale pa kushte është 5 kate dhe 17 m ndërsa lartësia maksimale pas zbatimit të I me kushte është sipas projektit.

Në njësinë 1/11 Intesiteti i propozuar pa kushte është 1.4 për banimin dhe 1.6 për shërbimet. Intensiteti shtesë me kushte është 0.5 si për banimin dhe për shërbimet si dhe intesiteti total i propozuar me kushte është 1.9 për banimin dhe 2 pë shërbimet. Lartësia maksimale pa kushte është 14 m dhe 4 kate ndërsa me kushte do të jetë sipas projektit. Ky intensistet me kusht në këto raste mund të jëpët për investime publike të ndryshme të cilat i merr përsipër zhvillusi. Sugjerohet që investimi publik të jëtë ndërtimi i banesave sociale.

2.2 Shërbimet dhe infrastrukturat publike

2.2.1 Efektet e infrastrukturave kombëtare e rajonale

Projektet e infrastrukturës kombëtare dhe rajonale do të kenë impakt të madh në bashkinë e Kuçovës. Projekti më i rëndësishëm që ka Shqipëria, sipas SETTO-s (South-East Transport Observatory, institucion i rëndësishëm që orienton strategjitë e transportit në Ballkan dhe unifikon prioritetet e infrastrukturës së vendeve që janë pjesë e saj në bazë të strategjive kombëtare), është Boshti Qendror Jugor.


Një ndër dokumentat kryesor ku duhet të mbështetet zhvillimi infrastrukturor bashkisë Kuçovë është Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) 2015-2030, miratuar në muajin maj të vitit 2016. Ky dokument jep direktiva të rëndësishme mbi zhvillimet në vend të cilat duhet të zbatohen dhe nga planet zhvillimit që ndërmerren në nivele më të ulëta të qeverisjes siç është dhe Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kuçovë. Ndër elementet kryesorë të Planit Kombëtar është infrastruktura dhe transporti në nivel kombëtar dhe rajonal, të cilat do të kenë ndikim edhe në territorin e Bashkisë e Kuçovë. Projekti i vetëm infrastrukturor që propozon PPK dhe ndikon drejt për drejt në territorin e bashkisë Kuçovë, është Boshti Qendror Jugor [Tiranë–Elbasan - Berat - Gjirokastër] i cili përforcon lidhjen Veri – Jug të vendit si dhe integron Shqipërinë me korridoret europiane qendrore. Gjithashtu përmirëson lidhjet e qendrave urbane në brendësi të territorit.

Kjo infrastrukturë do të sjellë një lidhje më optimale ndërmjet Shqipërisë Qendrore dhe Jugore. Boshti Qendror Jugor është i gjatë 180 km dhe do të lidhë Tiranën me pjesën jugore të vendit, ku 10 % e kësaj rruge është ekzistuese, 15 % është duke u planifikuar, si dhe

ngelet për t'u planifikuar edhe 75 %. Ky projekt është planifikuar që në periudhën janar-dhjetor 2007. [355]

Boshti qendror jugor do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në bashkinë e Kuçovës. Sipas informacioneve të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ky projekt është në fazën e studimit të fizibilitetit, kështu që nuk ka një gjurmë të saktë se ku do të kalojë kjo autostradë, por ky itinerar pritet të ndërtohet në pjesën perëndimore të qytetit të Kuçovës, përgjatë luginës së lumit Devoll. Duke parë që nuk ka një gjurmë ekzistuese, në propozimet për infrastukturën rrugore jepet varianti se ku pritet të ndërtohet kjo infrastrukturë rrugore i cili paraqitet në figurën e mëposhtme.

Figura 190. Impakti i projekteve rajonale dhe kombëtare, Bashkia Kuçovë



Burimi:Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

2.2.2 Lëvizja në territor

Në këtë seksion do të njihemi me propozimet e rrjetit rrugor sipas funksionalitetit, sipas kodit rrugor, si dhe sipas mënyrave të ndërhyrjes në akset rrugore. Së pari do të shpjegohet rrjeti rrugor i propozuar sipas funksionaltitet, së dyti do të shpjegohet rrjeti rrugor i propozuar sipas kodit rrugor dhe së treti do të shpjegohet rrjeti rrugor i propozuar sipas mënyrës së ndërhyrjes.

Rrjeti rrugor i propozuar sipas funksionalitetit do të shpjegohet në dy shkallë. Si fillim do të shpjegohet rrjeti rrugor i propozuar në shkallë bashkie dhe, më pas, do të shpjegohet rrjeti rrugor i propozuar në shkallë qyteti.

Rrjeti i propozuar rrugor sipas funksionalitetit të rrugëve ndahet në këto kategori: Kategoria e parë është autostrada Elbasan-Cërrik-Kuçovë–Berat, që ndryshe quhet Boshti i Jugut, i cili, në kuadër të PPK-së, kalon në luginën e lumit Devoll dhe lidhet me aksin kombëtar Lushje-Berat. Sipas propozimeve të funksionalitetit, ky aks rrugor do të jetë më vete. Kategoria e dytë e akseve të propozuara sipas funksionalitetit janë akset radiale të

bashkisë, të cilat mund të quhen rrugët hyrëse-dalëse të qytetit të Kuçovës. Këto akse rrugore janë: Kuçovë- Ura Vajgurore- Berat, Kuçovë-Belsh-Elbasan, Kuçovë-Cërrik-Elbasan, Kuçovë-Kozarë-Lushnje, Kuçovë Arrëz (në këtë aks do të ndërtohet një urë në afërsi të bashkimit të lumenjve Osum dhe Devoll, si dhe një urë tjetër mbi lumin Devoll që bën lidhjen e këtij aksi me fshatin Kozarë), si dhe Kuçovë-Lapardha-Berat. Kategoria tjetër e rrjetit rrugor janë rrugët lidhëse rurale, të cilat kanë një rëndësi të madhe përsa i përket lidhjes që qyteti i Kuçovës ka me qendrat kryesore të banuara të bashkisë Kuçovë. Gjithashtu, ato kanë edhe rëndësi ekonomike për këto zona. Këto rrugë rrisin aksesin e këtyre qendrave të banuara në drejtim të qytetit të Kuçovës. Në këtë kategori bëjnë pjesë këto akse: Kuçovë- Perondi- Goraj- Drizë- Gegë- Kuçovë (ky aks unazor rrit aksesin në zonat përreth qytetit të Kuçovës), Kuçovë- Lapardha-Vodhëz- Lumas- Belesovë-Mandrakë, si dhe Kuçovë- Tapi- Rreth Tapi. Në këtë kategori përfshihen edhe akset tërthore që bëjnë lidhjen e qytetit të Kuçovës me aksin rrugor të Lumasit. Këto akse rrugore janë: Kuçovë- Drizë- Velagosht- Lumas, Kuçovë- Pashtraj- Bardhaj- Lumas dhe Kuçovë-Magjatë- Sheqëz- Lumas. Kategoria tjetër e rrugëve janë rrugët rurale të cilat shtrihen në zona kodrinore dhe fushore dhe lidhin fshatra të vegjël me njëri-tjetrin. Këto akse rrugore mund të ndahen në rrugë turistike dhe rrugë bujqësore. Gjithashtu, kemi edhe shtigjet, të cilat janë rrugë ekzistuese kryesisht ndër zonat kodrinore-malore të bashkisë së Kuçovës. Këto shtigje do të krijojnë itineraret turistike për zhvillimin e turizmit natyror. Kategoria e fundit janë rrugët e fshatrave ku përfshihen të gjitha rrugët në brendësi të zonave të banuara të fshatrave.

Përsa i përket rrjetit të propozuar sipas funksionalitetit në shkallë qyteti kemi këto kategori: rrugët primare të qytetit, rrugët sekondare të qytetit, si dhe rrugët kodrinore të qytetit. Akset primare të qytetit janë akset të cilat lidhin në mënyrë gjatësore dhe tërthore zonën kodrinore me zonën fushore të qytetit. Rrugët sekondare janë kryesisht rrugët të cilat kanë një rëndësi dytësore në lidhjen e qytetit dhe ndodhen në zonën fushore të tij. Rrugët kodrinore janë akset rrugore të cilat lidhin lagjet kodrinore të qytetit dhe ndihmojnë në shpërndarjen e trafikut që vjen nga rrugët kryesore në këto pjesë të qytetit.

Duke u mbështetur në propozimet e akseve rrugore sipas funksionalitetit do të shpjegojmë edhe rrjetin rrugor të propozuar sipas kodit rrugor. Sipas ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, rrugët klasifikohen në:

- Autostradë
- Rrugë interurbane kryesore
- Rrugë interurbane dytësore
- Rrugë urbane kryesore
- Rrugë urbane dytësore
- Rrugë lokale

Sipas këtij ligji, kriteri kryesor i përcaktimit të rrugëve janë gjerësitë e seksioneve të rrugëve, numri i korsive, si dhe lloji i këtyre korsive. I vetmi aks që do të konsiderohet autostradë, sipas kodit rrugor, do të jetë Boshti i Jugut. Ky aks do të ketë një gjerësi prej 22 m, me karrexhata të pavarura, me 2 korsi për secilën karrexhatë, pra 4 në total, i pajisur me bankina dhe rrugë shërbimi, si dhe kryqëzime me disnivel. Aksi Lushje- Berat, i cili kalon në afërsi të bashkisë Kuçovë, klasifikohet si rrugë interurbane kryesore. Akset radiale (hyrëse-dalëse për në qytet) dhe rrugët rurale lidhëse klasifikohen si rrugë interurbane dytësore, të cilat kanë gjerësi nga 10 deri në 8 m dhe numri i korsive është 2. Rrugët rurale

kryesisht klasifikohen si rrugë lokale me 2 korsi dhe me gjerësi 6 m. Rrugët e fshatrave kryesisht klasifikohen si rrugë lokale me 2 korsi dhe me gjerësi 6 m. Akset kryesore të qytetit kalsifikohen si rrugë urbane kryesore me gjerësi nga 16 deri në 14 m, me dy karrexhata me nga 2 korsi (njëra korsi është korsi parkimi), e pajisur me trotuar dhe, në disa raste, me korsi biçikletash. Rrugët dytësore dhe rrugët dytësore kodrinore janë, sipas rastit, ose rrugë urbane dytësore, të cilat variojnë me gjerësi nga 10 deri në 8 m, me dy korsi dhe trotuar, ose klasifikohen si rrugë lokale me gjerësi 6 m, me dy korsi lëvizjeje.

Përsa i përket mënyrave të ndërhyrjes në akset rrugore kemi përcaktuar 5 kategori: akse rrugore për zgjerim, akse rrugore për rehabilitim, akse rrugore për zgjerim dhe rehabilitim, akse rrugore të reja, si dhe akse rrugore të pandryshuara. 9% e akseve rrugore nuk do të kenë ndryshime, dhe në këtë mënyrë propozohen për mirëmbajtje, 13% e këtyre akseve do të propozohen si akse të ndërtuara nga e para, 22% e akseve rrugore propozohen për rehabilitim, 29% e akseve rrugore propozohen për zgjerim, si dhe 27% e këtyre akseve propozohen për zgjerim dhe rehabilitim. Sistemi rrugor, sipas Kodit Rrugor dhe kodeve të prerjeve, funksionalitetit, mënyrave të ndërhyrjeve në të dhe prerjet paraqiten përkatsisht në hartat me kode (P:02/2, P;02/3, P:02, P:02/1, P:02/5, P:02/6 dhe P:02/4).

Transporti publik ndërqytetës (propozimi i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës): Transporti publik ndërqytetës luan një rol të rëndësishëm në mënyrën e lëvizjes (bashkëveprimit) të bashkive me njëra-tjetrën. Ky lloj transporti është kompetencë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Në kuadër të reformës administrative të vitit 2014, lindi nevoja për një konceptim të ri të transportit publik ndërqytetës në nivel bashkie dhe jo vetëm në nivel qarku që ishte më parë.

Duke u bazuar në këtë reformë, rrjeti i ri i linjave është përcaktuar pasi ka kaluar procedurat e modelimit dhe të konsultimit me përfaqësuesit e bashkive përkatëse dhe shoqëritë që shërbejnë sot në transportin ndërqytetës. Po ashtu, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, në zbatim të ligjit të mësipërm, ka hartuar udhëzimin "Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve me autobus brenda vendit". Me udhëzimin e ri është përcaktuar që gjithsej në të gjithë vendin do të operojnë 326 linja ndërqytetëse, nga 588 që ishin më parë.[356]

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, në zbatim të ligjit nr. 10/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar", publikon rrjetin e linjave ndërqytetëse, stacionet e qëndrimit dhe oraret për secilën linjë që do të fillojë të zbatohet më 1 janar 2017. Kërkesë e rëndësishme është që bashkitë të përcaktojnë vendndodhjen e terminaleve të autobusëve, në zbatim të nenit 21/1 të ligjit nr.10, 2016. E domosdoshme është, gjithashtu, që shoqëritë që do të licensohen të rinovojnë 20% të flotës së tyre të autobusëve gjatë vitit të parë të licencës.

Në muajin maj të këtij viti u prezantuan linjat e reja të transportit ndërqytetës në nivel qarku, si dhe në nivel bashkie. Sipas propozimeve të bëra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, bashkia e Kuçovës pritet të ketë lidhje të rëndësishme kryesisht me bashkitë e Beratit dhe Tiranës. Metodologjia e kësaj analize është bërë me anë të numrit të orareve në të cilat lëviz çdo linjë në ditë. Duke u bazuar në këtë kriter, në muajin janar pritet që në linjën Kuçove-Berat të ketë 9 orare nisjeje në ditë. Kjo tregon rëndësinë që

kanë këto dy bashki për njëra-tjetrën, për sa i përket lëvizshmërisë. Duhet theksuar që një tjetër linjë e rëndësishme pritet të jetë linja Kuçovë- Tiranë, e cila do të ketë 5 orare.

Figura 191. Linjat e propozuara të transportit publik ndërqytetës



Burimi: Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës; Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

- **Transporti publik i propozuar**

Transporti publik është një nga shërbimet më të rëndësishme që ofrojnë bashkitë për të patur akses më të mirë midis vendbanimeve, sidomos me shërbimet që ndodhen në qytet, të cilat duhet të aksesohen nga të gjithë banorët e bashkisë në një kohë të shkurtër. Ky lloj shërbimi është i rregulluar në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar. Transporti publik rrethqytetës dhe urban është kompetencë e bashkive dhe linjat e transportit publik miratohen nga Këshilli Bashkiak me propozim të kryetarit të Bashkisë.

Me ndarjen e re administrative, duke parë zgjerimin e territorit dhe sistemit rrugor, bashkia e Kuçovës ka propozuar disa linja të reja dhe shtimin e autobusëve (mikrobusëve) për të patur akses më të mirë me ish-njësitë administrative që janë pjesë e bashkisë. Sipas të dhënave të bashkisë, transporti publik ndërqytetës mbulon 40.8 km lineare, ku në vitin 2016 janë shtuar linjat Kuçovë- Drizë, Perondi- Kuçovë dhe Kuçovë-Lumas. Stacionet e furgonave janë të përcaktuara nga vetë drejtuesit e furgonave dhe udhëtarët, pasi kur jepen licencat e tyre nuk vendosen orare dhe stacione, sepse furgonat janë "autovetura taksi" dhe nuk i parashikon formati i licencave të tyre. Kështu, për shembull, linja Kuçovë-Salcë

Kozarë ka 4 stacione që janë: Kuçovë-Sheshi i lagjes "11 Janari"-Dikater (kryqëzimi te karburanti "Benja")-Havaleas (qendër Kozarë)-Salcë Kozarë.

Nisur nga analiza e gjendjes ekzistuese, si dhe bazuar në ligjin nr. 8308 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, propozohet hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse bazuar mbi disa kritere, si: të dhënat demografike e gjeografike, gjendja social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjeti rrugor dhe gjendja e infrastrukturës rrugore. Në procesin e hartimit të rrjetit të linjave rrethqytetëse merren parasysh lidhjet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe qendrave të njësive administrative përbërëse, qendrave të njësive administrative përbërëse dhe fshatrave, si dhe ndërmjet vetë fshatrave. Ky rrjet linjash transporti miratohet çdo tri vjet dhe nuk duhet të cënojë rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse[357].

Në propozimet e transportit publik është bërë edhe një analizë e numrit të banorëve që përdorin transportin publik, bazuar tek të dhënat e INSTAT-it dhe projeksionet deri në 2031. Përqindja që përdorin transportin publik është e ulët, duke parë që 6.4% e përdorin këtë lloj shërbimi në nivel bashkie, por që varion për çdo ish-njësi administrative dhe në vitet e ardhshme pritet që numri i banorëve që e përdorin këtë shërbim të rritet. Në qytetin e Kuçovës pritet që transporti publik të përdoret nga mbi 40% e banorëve të qytetit, kurse në ish-njësitë administrative të variojë nga 2- 10% e popullsisë. Duke u bazuar ne linjat e transportit të propozuar supozohet që personat që do të përdorin transportin publik të rritet me 50%.

Tabela 92. Numri i banorëvë që priten të kenë akses në transportin publik 2011-2031

	Projeksioni popullsisë 2011-2031			Përdorimi në % sipas vitit 2011	% e propozuar për transportin publik	Nr i banorëve që do të përdorin transportin publik		
	2011	2021	2031			2011	2021	2031
Bashkia Kuçovë	32,964	28,489	24,969			0	0	0
Kuçovë	13,343	11,532	10,107	14%	41%	1,847	4,728	4,144
Përondi	9,495	8,206	7,192	5%	8%	475	656	575
Kozare	5,928	5,123	4,490	1%	2%	36	102	90
Lumas	4,198	3,628	3,180	3%	5%	126	181	159

Burimi: Instat 2011; Përgatiti: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Përveç bazës ligjore, një tjetër analizë e rëndësishme është hedhja e një rrezeje në çdo linjë ekzistuese të transportit publik me distancë 500 m (distanca që mund të përshkojë në këmbë një person për në stacionin më të afërt), në mënyrë që të shihet se cilat janë zonat/vendbanimet që nuk aksesohen nga ky lloj shërbimi.


Nga analizat e kryera, si dhe në propozimet që janë bërë për transportin rrethqytetës shihet që pjesa veriore dhe verilindore e bashkise nuk ka akses të mirë me këtë shërbim. Duke u bazuar në kriteret e mësipërme, propozohet krijimi i 2 unazave, një prej të cilave do të lidhë Kuçovën me Lumasin, e cila është një nga ish-njësitë administrative më të rëndësishme që i është bashkuar bashkisë së Kuçovës. Unazat në pjesën lindore do të mbulojnë një gjatësi prej 40 km lineare.

Në pjesën veriore të bashkisë ekzistojnë 2 linja: linja Kuçovë-Gegë dhe linja Kuçovë- Drizë. Në këtë pjesë të bashkisë propozohet një linjë unazore e cila do të unifikojë këto 2 linja

radiale për të bërë të mundur një akses më të mirë të pjesëve që nuk aksesohen nga transporti publik.

Pjesa jugperëndimore e bashkisë nuk ka akses të mirë me qendrën e qytetit, kështu që propozohet lidhja unazore Kuçovë-Ura Vajgurore-Tapi-Rreth Tapi-Kuçovë. Kjo linjë do të përshkojë një gjatësi 7.8 km.


Figura 192. Skema e propozuar e transportit publik në Kuçovë



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Transporti publik qytetas: Përsa i përket linjave të transportit qytetas propozohet që të kalojë në akset kryesore të infrastrukturës rrugore së propozuara duke u bazuar edhe në linjat e transportit rrethqytetas sepse këto linja kalojnë në qendër të qytetit. Një nga kriteret që është marrë parasysh gjatë hartimit të linjave qytetase është distanca 500 m që duhet të përshkruaj në këmbë një banor i qytetit për në stacionin më të afërt. Propozohet krijimi i një linje unazore sepse pjesa tjetër e qytetit është e aksesuar nga linjat e transportit publik rrethqytetas.Transporti qytetas është i rëndësishëm në funksionimin normal të lëvizshmerisë (mobilitetit) në qytet.

Figura 193. Skema e propozuar e transportit publik në qytetin e Kuçovës



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Kategoritë e kushtet teknike të sistemit rrugor sipas funksionalitetit: Seksionet e prerjeve janë bërë sipas kategorisë së funksionit të rrugës dhe jo sipas kodit rrugor. Çdo funksion i rrugë i është dhënë një kod specifik që të kuptohen nga njëri tjetri p.sh rrugët fshatit kanë kodin Fsh për tu identifikuar me seksionin e prerjeve ne cad. Ne autocad profilet janë bërë sipas rendit alfabetik p.sh Fsh-A ku Fsh është funksioni i rrugës dhe A është prerja e cila në cad gjendet me emërtimin A-A' për të treguar segmentin ku është bërë prerja. Duke parë që rendi albabetik ka nje limit shkronjash është vazhduar me dublikimin e gërmave pra Fsh-AA ku është po e njëjta llogjike si me lart (Fsh është funksioni dhe AA tregon prerjen në cad me emertimin AA-AA'). Pra seksionet e prerjeve Fsh-A, Fsh-AA dhe Fsh-AAA janë të ndryshme me njëra tjetrën, gjë e cila pasqyrohet në cad. Po më të njejtën llogjike janë bërë e profilet e segmenteve të tjera.

- **Konkluzione**

Transporti ndërqytetës, i miratuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, do të zbatohet në janar 2017. Kështu, bashkia e Kuçovës do të krijojë lidhje të rëndësishme me bashkitë e Beratit dhe Tiranës, duke parë numrin e orareve që pritet të nisen nga Kuçova drejt këtyre bashkive.

Transporti publik në bashkinë e Kuçovës funksionon në linja lineare (radiale) dhe mbulon një distancë prej 40.8 km lineare. Propozohet që ky lloj transporti të mbulojë një gjatësi prej 77.8 km lineare dhe linjat të jenë unazore.

Propozohet, gjithashtu, krijimi i unazave që do të sjellin akses më të mirë ndërmjet vendbanimeve me njëri-tjetrin dhe me shërbimet në qytet, si dhe mënyrë me efiçente për të rregulluar linjat e autobusëve (furgonave) që do të kalojnë në këto unaza.

2.2.3 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura

Në këtë seksion do të trajtohen rekomandime të përgjithshme në lidhje me nevojat për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës e cila siguron shërbimin e furnizimit me ujë për konsum publik dhe kanalizimet e ujrave të ndotura urbane.

- **Infrastruktura e furnizimit me ujë**

Problemet kryesore të sektorit lidhen me mirëmenaxhimin e sistemit të furnizimit, ku zgjidhja e propozuar konsiston në instalimin e matësve individualë për çdo lidhje konsumatore. Faktor tjetër në përmirësimin e sektorit është eleminimi i të gjitha lidhjeve të paligjshme dhe të paregjistruara, kombinuar kjo me një politikë të fortë dhe ndërgjegjësim të popullatës mbi detyrimet financiare karshi ofrimit të këtij shërbimi.

Ngritja e një sistemi monitorimi, ku matës gjeneralë instalohen nga tubacioni magjistral, në dalje të rezervuarëve dhe në nënzonat e shërbimit, do t'i ofroj ndërmarjes së Ujësjellës Kanalizime Kuçovë mundësinë për të kuptuar dhe gjurmuar zonat ku uji humbet apo shpërdorohet.

Theksojmë se kryesore në masat që duhet të ndërmarrë Bashkia Kuçovë, duhet të jetë sigurimi i linjës magjistrale, e cila sjell ujin nga burimi i Bogovës. Në mënyrë kategorike në këtë segment nuk duhet të ketë asnjë lidhje shërbimi për klientë e konsumatorë të vegjël. Të gjitha ndërhyrjet dhe degëzimet duhen relatuar dhe shoqëruar me projektin

Nga vrojtimi në terren dhe analizat teknike të të dhënave, në tabelën e mëposhtme konstatohet se NjA Kozarë dhe Lumas kanë burime të pamjaftueshme të ujit për konsum publik. Kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së infrastrukturës, e kombinuar edhe me disponueshmërinë ndaj burimeve ekzistuese.

Tabela 93. Kapaciteti i burimeve të furnizmit me ujë krahasuar me kërkesën e parashikuar

Zona e furnizimi t me ujë	Pop. 2015	Pop. 2030	Kapaciteti mesatar vjetor aktual i burimit te furnizimit me ujë		Kërkesa aktuale dhe e projektuar (m^3/ditë)		Kërkesa duke pranuar humbjet 25% (m^3/ditë)	Kërkesa ose jo për burime të reja të furnizimit me ujë (m^3/ditë)	
			l/s	m^3/ditë	2015	2030		Mjafton (+)	Mungesë (-)
Kuçovë	34,707	33,146	603	52,056	5,206	4,972	6,613	45,443	
Perondi	5,345	5,104	15	1,296	802	766	1,018	278	
Kozare	7,949	7,727	6	545	1,192	1,159	1,542		-997
Lumas	7,014	6,969	6	480	1,052	1,045	1,390		-910
Total	**55,015**	**52,946**	629	**54,377**	**8,252**	**7,942**	**10,563**	**45,721**	**-1,907**

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016

Rezervuarët e ujit për konsum publik parashtrojnë një problem të përbashkët, i cili është mbrojtja higjeno-sanitare e tyre. Konkretisht, të gjithë rezervuarët, krahas shpëlarjes së rregullt 2 herë në muaj duhet t'i nënshtrohen edhe mbrojtjes higjeno santitare të udhëhequr nga Inspektoriati Shëndetit Publik, sëbashku me Ndërmarrjen UK Kuçovë.

Në mënyrë të ngjashme me analizën e mësipërmeme për burimet e ujit të pijshëm, rezulton se volumet e stokimit të ujit për Kuçovën dhe Perondinë janë mëse të mjaftueshme, ndërkohë që problematike shfaqet situata sërish në Kozarë dhe Lumas.


Tabela 94. Kërkesa për rezervuarë shtesë sipas zonave të furnizimit me ujë

Zona e furnizimit me ujë	Vëllimi aktual në zonën e furnizimit me ujë (m^3)	Kërkesa ditore e projektuar për popullsinë ne 2030 (m^3)	2030 Kërkesa mesatare ditore me humbje 25% (m^3)	Rregullimi "8-orësh" i vëllimit te ujit ne rezervuar (m^3)	Nevoja për rezervuare te rinj (m^3)	
					Mjafton (+)	Mungesë (-)
Kuçovë	7,750	4,972	6,613	2,204	5,546	
Perondi	700	766	1,018	339	361	
Kozare	330	1,159	1,542	514		-184
Lumas	300	1,045	1,390	463		-163
Total	**9,080**	**7,942**	**10,563**	**3,521**	**5,906**	**-347**

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

Sipas "Master planit kombëtar të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur", që u miratua nga Këshilli Kombëtar i Ujit në dhjetor te vitit 2015, u bë e mundur të identifikohen projekte të veçanta që do t'u duhet të përmbushin nevojat e 12 zonave të kërkesës për furnizim me ujë në zonën e planifikimit të Bashkisë së (zgjeruar të) Kuçovës.

Figura 194. Harta e sistemit aktual të furnizimit me ujë dhe propozimeve të reja, Bashkia Kuçovë



Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD, Punoi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Respektivisht NjA Kozarë dhe Lumas kërkojnë prioritet edhe në ndërhyrjet që do të planifikohen për këtë sektor, sepse niveli shërbimit në këto dy zona është minimal, sikurse edhe vëmendja e kushtuar nga Matserplani është minimale.

Tabela 95. Përmbledhje e investimeve të nevojshme për Bashkinë Kuçovë (2021-2040)

Sistemi i furnizimit me ujë	Ndërhyrja	Elementet përbërës te ndërhyrjeve me investime	Shuma	Investimi (euro)

Devoll (Perondi, Kozarë)	Rehabilitim	Kaptazh burim uji	42,400	1,317,900
		Rezervuar	102,910	
		Stacion pompimi	682,960	
		Linje transmetimi	153,000	
		Rrjet shpërndarës	281,500	
		Lidhje	55,130	
Gege (Kozarë)	Rehabilitim	Kaptazh burim uji	8,800	207,860
		Rezervuar	8,110	
		Linje transmetimi	73,000	
		Rrjet shpërndarës	107,600	
		Lidhje	10,350	
Vlashuk (Kozarë)	Rehabilitim	Kaptazh burim uji	16,940	179,000
		Rezervuar	12,610	
		Linje transmetimi	76,570	
		Rrjet shpërndarës	63,760	
		Lidhje	6,120	
Frashër (Kozarë)	Rehabilitim	Kaptazh burim uji	18,580	285,360
		Rezervuar	2,250	
		Linje transmetimi	27,470	
		Rrjet shpërndarës	43,840	
		Lidhje	1,980	
Magjatë Fushë (Perondi)	Rehabilitim	Kaptazh burim uji	5,250	355,330
		Rezervuar	8,110	
		Linje transmetimi	102,570	
		Rrjet shpërndarës	229,140	
		Lidhje	10,260	
Vlashuk (Kozarë)	Zgjerim i zonës së shërbimit	Rrjet shpërndarës	12,750	13,290
		Lidhje	0,540	
Frashër (Kozarë)	Zgjerim i zonës së shërbimit	Rrjet shpërndarës	17,420	18,500
		Lidhje	1,080	
Magjatë Fushë (Perondi)	Zgjerim i zonës së shërbimit	Rrjet shpërndarës	44,270	49,130
		Lidhje	4,860	
Total				2,426,370

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016

- **Infrastruktura e kanalizimeve të ujrave të ndotura urbane**

Kuçova dhe fshatrat përreth si Perondi e Tapi kanë një sistem kanalizimi ekzistues. Fillimisht ky sistem ishte projektuar si një sistem i ndarë (grumbullimi i ujërave të ndotura të ishte i veçantë nga grumbullimi i ujërave te shiut). Sidoqoftë, në këtë rrjet kanalizimesh me vonë u bënë shumë lidhje, duke e transformuar kështu në një sistem të kombinuar.

Sistemi i kanalizimeve mbulon afërsisht 70% të popullsisë dhe ka 2 grykëderdhje kryesore, të cilat bëjnë të mundur shkarkimin e ujërave të ndotura në një gji të ngushtë (kanali kryesor prej 4 km) nga ku më pas këto ujëra të ndotura derdhen të pa trajtuara në lumin Osum.

Prurja e ujërave të ndotura të kanalizimeve parashikohet sipas kërkesës për ujë për vitin 2030. Sasia e ujit të furnizuar dhe të përdorur në tualete, dushe, gatim, biznese, industri, godina publike dhe procese të tjera, përcillet tek sistemi i kanalizimeve.

Pa bërë një inspektim CCTV[358], vlerësimi i gjendjes aktuale të rrjetit ekzistues të kanalizimeve, është i vështirë të konstatohet. Duke krahasuar kushtet e sistemit ekzistues të kanalizimit të qytetit, mund të themi se ky sistem është shumë i amortizuar. Mendohet që afërsisht 50 % e këtij sistemi duhet të rehabilitohet. Si rezultat i shpateve të pjerrëta që ka ky qytet në pjesën lindore, problem i bllokimit nga ndotjet e ngurta është i pranishëm vetëm ne zonat e grykëderdhjeve ekzistuese.

Një nga rezultatet e masave të propozuara është ulja e ndjeshme e numrit të gropave septike. Për rrjedhojë, kjo masë do të sjellë përmirësimin e tokës, rritjen e cilësisë se ujërave nëntokësore dhe uljen e sëmundjeve të shkaktuara si rezultat i mungesës së higjienës. Për më tepër, sistemi i ri i kanalizimeve do të parandalojë përmbytjet në zonat urbane dhe do të përmirësojë cilësinë e jetës.

Bashkia Kuçovë do të ketë një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, që i shërben pjesës më të madhe të popullsisë në qendrën urbane të Bashkisë dhe zonave të shërbyre në NjA Kozarë, Perondi e Lumas. Nënvizojmë se Master Plani për investimeve kombëtare për UK nuk ka parashikuar investime për impiant trajtimi të ujit të ndotur për ish-komunën Lumas, por propozimi ynë është që Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotura Urbane për Bashkinë Kuçovë të projektohet për të mbuluar edhe NjA Lumas. Pozicioni gjeografik i këtij impianti mendohet të jetë në Bashkinë Ura Vajgurore, midis fshatit Moravë dhe Urës Vajgurore. Duke qënë se pozicionimi gjeografik bie ndesh me dy elementë thelbësor (distanca nga zona e banuar dhe distanca nga trupi ujor natyror) nevojitet që mbi këtë propozim të hartohet një plan i detajuar i veprimit ku të merren në konsideratë masa specifike për mbrojtjen nga shkarkimet aksidentale mbi trupin ujor, trajtimin e llumit aktiv si edhe për zbutjen e ndotjes aromatike në ajër duke pozicionuar impjantin në varësi të trëndafilit të erës si edhe uljen e efektit të ndotjes vizuale nëpërmjet krijimit të zonës buferike mbrojtëse e të veshur me vegjetacion të dëndur e të lartë. Duhet theksuar se propozimi i impjantit të trajtimit të ujrave të ndotura në Urën Vajgurore vjen si propozim nga Master plani kombëtarë ndërsa bashkia propozon që ky impjant i trajtimit të ujërave të ndotura të ndërtohet në afersi të fshatit Arrëz në zonat e naftës. Plani merr në konsideratë të dy opsionet për ndërtimin e këtij impjanti. Vendndodhja përfundimtare mbetet të përcatktohet me hartimin e studimit të fizibilitetit.

Impiantet e trajtimit i klasifikojmë kryesisht sipas nivelit të trajtimit që ofron teknologjia e instaluar.

Impianti i Trajtimi Primar: Ndryshe i quajtur si trajtim mekanik, realizon diferencimin dhe largimin e mbetjeve të ngurta të cilat pluskojnë dhe ato të cilat kanë dekantuar në fund të pondit. Kjo teknologji largon edhe llumin e formuar nga dekantimi. Megjithëse është një teknologji e cila bazohet në trajtimin mekanik, shpesh për të përshpejtuar proçesin e sedimentimit përdoren edhe kimikate.

Impiantet Mekanike reduktojnë nivelin e NBO[359] në ujrat e e ndotura në masën 20-30% dhe diferencojnë 50-60% të mbetjeve të ngurta në këto ujra. Kjo teknike trajtimi në përgjithësi përdoret si fazë fillestare e trajtimit të ujrave ku më pas mund të investohet për rritjen e efikasitet të trajtimit të ujrave me anë të metodave më të specializuara.

Impianti Trajtimi Dytësor: Këto tipe impiantesh ofrojnë trajtim bilogjik të ujrave të ndotura urbane. Konkretisht ato arrijnë që nëpërmjet mikroorganizmave të konsumojinë të të gjithë lëndën organike ndotëse të tretur në këto ujra. Ky proçes biologjik i shoqëruar edhe me

pondet e dekantimit realizon largimin e më tepër se 85% të mbetjeve inorganike ndërkohë që reduktimi i NBO do të realizohen nëpërmjet proçeseve me llum aktiv, sistemet ligatinore, filtra me pikim apo teknikave më bashkëkohore të cilat realizojnë shpërbërjen e lëndës ndotëse organike.

Impianti Trajtimit Terciar: Në këto impiante krahas përfshirjes së dy sistemeve të mësipërme kemi integrimin e proçeseve kimike të specializuara dhe të mbyllura në të cilën realizohet pastrimi i ujrave të ndotura urbane duke larguar më tepër se 99% të masës ndotëse. Teknologjia e përdorur në këto impiante është mjaft e shtrenjtë qoftë për fazën e instalimit si edhe të mirmbajtjes së tyre, sidomos impiantet të cilat trajtojnë fosforin dhe azotin e tretur.


Vlen të theksohet se për dy tipet e fundit të impianteve, kostot e ndërtimit si edhe ato operimit janë relativisht të larta. Ndikimi në zbutjen konkrete të kostove mund të adresohet tek kostot operacionale ku në rast se sasia e përgjithshme e ujrave të ndotura që do të hyj në trajtim do të reduktohet rrjedhimisht ndikimi do të shfaqet edhe në koston e përgjithshme të trajtimit.

Për këto arsye propozojmë që sistemi i grumbullimit të ujrave të ndotura urbane medoemos të diferencohet nga grumbullimi i ujrave të larta në mënyrë që sasia totale që do të dërgohet në impiant të reduktohet për tu reflektuar kështu edhe në kostot finale.

Gjithashtu ky propozim ofron edhe përfitime të tjera duke konsideruar se ujrat e larta (të shiut) mund të depozitohen dhe të përdoren për qëllime dytësore të Bashkisë Kuçovë (larje, vaditje, zjarrfikse etj.)

Propozimi konkret për Bashkinë Kuçovë do të ishte që të synohet ndërtimi i një Impianti Trajtimi Dytësor, pra një teknologji trajtimi me llum aktiv.

Figura 195. Harta e sistemit aktual të shërbimit me kanlaizime dhe propozimeve të reja, Bashkia Kuçovë



Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD, Punoi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Investimet e rekomanduara në sistemin e kanalizimeve janë përmbledhur ne mënyrë të tille për të dhënë një tabllo të plotë të nën-programimeve të investimeve dhe afatet përkatëse të propozuara.

Tabela 96. Projekte të sitemit të kanalizimeve. Investime Kapitale (2021-2040)

Sistemi i kanalizimeve	Ndërhyrja	Elementet përbërës te ndërhyrjeve me investime	Shuma	Investimi (EUR)
Kozare, Kuçovë, Perondi	Zgjerimi i zonës së shërbimit	Faza I impiant i trajtimit të ujërave të ndotura	4,741,860	4,741,860
Kozare, Kuçovë, Perondi	Zgjerimi i zonës së shërbimit	Rrjeti i kanalizimeve	7,105,780	7,925,640
		Lidhja	260,080	
		Rrjeti i ujërave të shiut	559,780	
Kozare, Kuçovë, Perondi	Zgjerimi i zonës së shërbimit	Rrjeti i kanalizimeve	8,069,820	9,561,600
		Lidhja	1,491,780	
Perondi	Sistem i ri	Rrjeti i kanalizimeve	459,080	660,170
		Lidhja	21,350	
		Faza I impiant i trajtimit të ujërave të ndotura	133,830	
		Rrjeti i ujërave të shiut	45,900	
Kozare	Sistem i ri	Rrjeti i kanalizimeve	546,860	713,710
		Lidhja	14,700	
		Faza I e impiant i trajtimit të ujërave të ndotura	97,470	
		Rrjeti i ujërave të shiut	54,690	
Totali				23,602,980

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

2.2.4 Ndriçimi i mjediseve publike

Në këtë seksion do të jepen propozime mbi zhvillimin e infrastrukturës së ndriçimit publik, të bazuara këto në analizën e ofrimit të këtij shërbimi që është hartuar në kapitullin e analizës. Në rastin e qytetit të Kuçovës ndriçimi publik ofrohet në 94% të rrjetit rrugor të qytetit, çka është një tregues mjaft i lartë, ndërsa në njësitë administrative Perondi dhe Kozarë ky shërbim ofrohet vetëm në disa akse dhe paraqet probleme të mëdha në këto zona, pasi një pjesë e këtij rrjeti nuk funksionon si duhet. Në njësinë administrative Lumas ky shërbim nuk ofrohet.

Si synim primar i bashkisë është përdorimi i teknologjive të reja, si dhe zëvendësimi i kokave të ndriçuesve me ndriçues të përshtatshëm për teknologjinë LED. Në kuadër të këtij synimi, po punohet për hartimin e një projekti me një kompani italiane të ndriçimit LED. Ky projekt synon që si burim kryesor financimi të ketë fonde nga BE-ja. Gjithashtu, synohet objektivi afatshkurtër që i gjithë rrjeti rrugor i qytetit të Kuçovës të jetë i pajisur me ndriçim publik në 100% të tij.

Si objektiv afatmesëm synohet shtrirja dhe ofrimi i shërbimit funksional të ndriçimit në njësitë administrative të cilat kanë probleme të konsiderueshme në këtë drejtim. Ky shërbim synohet të ofrohet fillimisht në fshatin Lumas, i cili aktualisht nuk e ofron këtë shërbim, si dhe synohet të përmirësohet në fshatrat Perondi dhe Kozarë. Si objektiv afatgjatë synohet edhe ofrimi i këtij shërbimi në disa fshatra kryesore që janë: Pëllumbas, Sheqëz, Vlashuk, Belesovë dhe Tapi.

2.2.5 Mbetjet e ngurta

- **Masa & propozime mbi menaxhimin e mbetjeve**

Në mbështetje të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", si edhe ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), ngarkohen Bashkitë për të hartuar e, më pas, për të zbatuar "Planin lokal të menaxhimit të mbetjeve".

Referuar Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, miratuar me VKM-në nr. 175, datë 19.1.2011, Bashkitë e Beratit, Kuçovës dhe Urës-Vajgurore trajtohen si Zona 9 e mbetjeve. Në Planin Kombëtar Berati është përcaktuar si zonë strategjike e mbetjeve[360], prej nga rrjedh edhe përgjegjësia e detyrimi i arritjes së objektivave madhorë të Planit Kombëtar, si edhe i lind e drejta të hartojë planin rajonal të menaxhimit të mbetjeve[361]. Shërbimi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Kuçovë duhet të shtrijë infrastrukturën e tij në të gjithë territorin dhe të nisë me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve që në pikat e grumbullimit. Propozohet që të hartohet një përditësim i planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për bashkinë e Kuçovës, plan i cili do të konsistojë në:

- Vlerësimin e sasisë totale dhe mercologjisë së mbetjeve,
- zbatimin e skemave të reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit të mbetjeve,
- vlerësimin e potencialit të riciklimit me synim riciklimin e 50% të mbetjeve të riciklueshme,
- organizimin e shërbimeve dhe operacioneve të menaxhimit të mbetjeve për mbulimin e të gjithë NjA-ve të bashkisë Kuçovë për një periudhë 15-20 vjeçare,
- rehabilitimin dhe ristrukturimin e venddepozitimeve ekzistuese,
- ndërtimin e një landfill-i rajonal, si edhe mundësinë e ndërtimit të një incineratori për asgjësimin e plotë të mbetjeve. Të gjitha këto të shoqëruara me projektin teknik dhe vlerësimin përkatës mjedisor. Të përfshihen gjithnjë 2 ose më tepër alternativa ku përzgjedhja të bëhet nisur nga parimi "Opsioni më i mirë i zbatueshëm mjedisor" OZM,
- ofrimin e shërbimit të riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve,
- sistemet e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve,
- trajtimin e mbetjeve,
- organizimin e *landfill*-it,
- trajtimin e mbetjeve inerte & të rrezikshme,
- mirëmbajtjen.

Parashikohet që afati maksimal për ndërtimin e *landfill*-eve rajonale dhe venddepozitimeve për mbetjet inerte dhe ato të rrezikshme (jo-urbane) të jetë fundi i vitit 2020, i cili përkon edhe me afatin e vendosur për mbylljen dhe rehabilitimin e të gjithë venddepozitimeve jashtë kushteve teknike dhe çdo kriteri higjieno-sanitar.

Ndërhyrje e menjëhershme nevojitet të parashikohet për rehabilitimin e venddepozitimit të mbetjeve në zonën e ish-NB "Partizan" në Rreth Tapi. Një plan & projekt i detajuar inxhinierik duhet hartuar fillimisht për parandalimin e shkarkimeve të shllameve, emetimeve të gazta dhe të vetë mbetjeve të ngurta mbi trupin ujor gjatë rehabilitimit të venddepozitimit.
Masat konkrete:

I. Rehabilitimi *in-situ* duke izoluar tabanin dhe të gjithë perimetrin e venddepozitimit.

II. Zhvendosja e të gjitha mbetjeve të grumbulluara ndër vite për në venddepozitimin e ri në Urën Vajgurore ose në një pikë transferimi[362] të përkohshme e, më pas, rehabilitimi i zonës që sot përdoret si venddepozitim.

Duke vlerësuar distancat e largëta që kanë NjA-të Lumas & Kozarë me Urën Vajgurore ku mendohet të ndërtohet *landfilli*-i rajonal, propozojmë që të ndërtohen dy stacione transferimi të mbetjeve urbane. Pra, duhet të studiohet mundësia për të përcaktuar një zonë specifike për secilën NjA, e cila do të ketë funksionin e venddepozitimit tranzitor të mbetjeve për këto NjA. Në përzgjedhje duhet pasur parasysh që zona të ketë impaktin më të vogël në mjedis për sa i përket karakteristikave gjeologjiko-hidrologjike dhe mjedisit biotik të asaj zone. Zonat potenciale që janë marrë si alternativa për ndërtimin e *landfill*-it janë:

I. Zona kadastrale 2075 në bashkinë e Urës Vajgurore (pranë qafës së Shpiragut & fshatit Mbreshtan), me një sipërfaqe afërsisht 3.5ha dhe rreth 100mmnd[363]

Koordinatat referuese të kësaj zone paraqiten si më poshtë:

Tabela 97. Koordinatat referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e landfill-it rajonal

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 50' 58.3418"	40° 44' 18.3829"
UTM Zone 34N	402862.04	4510358.54
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4402953.88	4512294.11
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	487291.06	4511537.55

Burimi: ASIG Geoportal

Figura 196. Vendndodhja e landfill-it rajonal të propozuar për ndërtim në bashkinë Ura Vajgurore & pellgu ujëmbledhës i ujërave të larta



Burimi: Bashkia Kuçovë & Co-PLAN

Kjo zonë e përcaktuar nuk ndodhet mbi akuiferin e Beratit, por, duke vlerësuar paraprakisht topografinë e zonës, nevojitet që të projektohet një sistem drenimi për ujërat e larta, i cili duhet të shmangë shkarkimet e mundshme në këtë *landfill*.

II. Zona kadastrale 1801 në bashkinë e Kuçovës, me një sipërfaqe afërsisht 5,1ha dhe rreth 75mmnd

Koordinatat referuese të kësaj zone paraqiten si më poshtë:

Tabela 98. Koordinatat referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e landfill-it rajonal

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 56' 3.6148"	40° 47' 47.2192"
UTM Zone 34N	410100.22	4516707.74
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4410195.02	4518645.90
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	494458.51	4517970.72

Burimi: ASIG Geoportal

Figura 197. Vendndodhja e landfill-it rajonal të propozuar për ndërtim në bashkinë Kuçovë & pellgu ujëmbledhës i ujërave të larta



Burimi: Bashkia Kuçov & Co-PLAN

Pozicioni i kësaj fushe nuk ndodhet mbi akuiferin e lumit Osum, por paraqet problem për sa i përket distancës me zonën më të afërt të banuar. Gjithashtu, duke u pozicionuar në rrëzë të kodrave prapa repartit ushtarak, nevojitet një sistem drenimi i cili do të largojë ujërat e larta nga *landfill*-i propozuar.

I. Zona e ish-UPN-së, Kuçovë, me një sipërfaqe rreth 8500m^2 dhe rreth 33mmnd

Koordinatat referuese të kësaj zone paraqiten si më poshtë:

Tabela 99. Koordinatat referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e inçerneratorit

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 54' 36.6726"	40° 47' 54.8689"
UTM Zone 34N	408065.76	4516968.66
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4408159.73	4518906.93
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	492420.59	4518208.50

Burimi: ASIG Geoportal

Figura 198. Ish- zona e UPN-së & projekti i rehabilitimit



Burimi: Kooperimi për Zhvillim nga R.Çeke, Raporti i Fizibilitetit

Kooperimi për Zhvillim nga Republika Çeke ka hartuar një projekt të detajuar mbi mundësinë e rivitalizimit të kësaj zone të ndotur duke inkorporuar trajtimin e të gjithë ndotësve të identifikuar në këtë zonë.

Gjithashtu, është menduar që në një seksion të kësaj hapësire e cila do t'i nënshtrohet rehabilitimit të ndërtohet një inçernerator për mbetjet e ngurta të bashkisë së Kuçovës dhe jo vetëm.

Kjo është një iniciativë e cila bie disi ndesh me pozicionimin e zonës në raport me qytetin dhe me ndërtimet, pasi zonat e banuara, në këtë rast, janë shumë pranë këtij inçerneratori, ndaj edhe çdo hap i mëtejshëm për planifikimin dhe projektimin e tij duhet të parashikojë alternativa të tjera lidhur me pozicionin, si edhe mbi proceset teknologjike të djegies së mbetjeve dhe emetimit të gazrave kanceroze (dioksin & furane).

Paralelisht me masat e lartpërmendura, Bashkia Kuçovë, në bashkëpunim me organet e qeverisë qendrore që veprojnë në Berat, duhet të përcaktojë një zonë specifikisht të dedikuar për mbetjet e rrezikshme industriale dhe mbetjet inerte. Ndër kriteret themeltare të cilat duhen respektuar rreptësisht në momentin që merret një vendim për shfrytëzimin e


një hapësire territoriale në funksion të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme janë: distanca me zonën më të afërt të banuar, prezenca e ujërave sipërfaqësore, prezenca e akuifereve, trëndafili i erës etj.

Ndërsa për kriteret e përcaktimit të vendgrumbullimit të mbetjeve inerte duhet patur parasysh kombinimi i tipologjisë së relievit dhe faktorëve atmosferik, si: shpejtësia dhe intensiteti i erërave, prezenca e rrjedhave ujore sipërfaqësore, distanca nga zonat e banuara & qendrat turistike etj.

Propozohet që njësoj si me iniciativën e *landfill*-it rajonal të operohet edhe me vendgrumbullimin e mbetjeve inerte e të rrezikshme, pra bashkitë Kuçovë, Urë Vajgurore dhe Berat të ndërtojnë së bashku infrastrukturën e nevojshme që do të presë këto lloj mbetjesh. Një mundësi mbetet edhe përdorimi i hapësirave të ish-Kombinatit të Industrisë së Tekstilit ose truallit pas serave diellore si stacion për grumbullimin e këtyre mbetjeve dhe trajtimin e tyre deri në asimilim. Një alternativë tjetër lidhur me trajtimin e mbetjeve të thata të rrezikshme mbetet dërgimi i tyre në bashkinë e Kuçovës, nëse do të ndërtohet incineratori i mbetjeve.

Nevojitet që të gjitha pikat e paligjshme të depozitimit të mbetjeve urbane (*dhe jo vetëm*) t'u nënshtrohen një fushate për mbylljen dhe rehabilitimin e zonave që ato kanë zënë. Me asimilimin e pikave të paligjshme të depozitimit të mbetjeve një masë shoqëruese duhet të vijojë, e cila do të konsistojë në hartimin e një plani veprimi për pastrimin e të gjithë bashkisë së Kuçovës, për të cilin nevojitet gjithëpërfshirja e shoqërisë civile, biznesit dhe administratës publike qendrore e lokale në mënyrë që nëpërmjet një programi 2 deri 3 mujor i gjithë territori i bashkisë Kuçovë të jetë inspektuar dhe pastruar nga mbetjet urbane dhe inerte. Krijimi i pikave të paligjshme të depozitimit të mbetjeve mund të shërbejë si tregues i nevojës për shtrirje më efiçente të pikave të grumbullimit të mbetjeve apo nevojës për pikë transferimi.

Figura 199. Gjendja ekzistuese dhe propozimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Kuçovë




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Duke qenë se mbetjet mund të kthehen në burim fitimi, propozojmë që skemat me cikël të mbyllur të menaxhimit të mbetjeve të inkorporohen si më poshtë:

- Çdo zonë bujqësore (NjA në bashkëpunim me banorët dhe bashkinë) të përcaktojë hapësirën e grumbullimit dhe kompostimit të mbetjeve organike, si edhe të përpunimit të plehut organik, si produkt i këtij procesi.
- Fillimisht në qytet e më pas në të gjithë bashkinë të vendosen kontenierë të dedikuar për mbetjet organike, plastike, qelq – metal. Kjo infrastrukturë i shërben ndarjes në burim dhe funksionimi varet nga informimi i publikut mbi mënyrën e realizimit të ndarjes dhe vlerës së saj. Pra, bashkia duhet të ndërmarrë një fushatë informimi dhe edukimi qytetar mbi ndarjen e mbeturinave, riciklimin dhe ripërdorimin.
- Në *landfill*-in e ri të parashikohet njësia e dedikuar mbi kontrollin - ndarjen dhe para-riciklimin e mbetjeve, në mënyrë që sasia e dedikuar për depozitimin final të jetë e identifikuar dhe sa më e reduktuar në volum.

Propozohet që në projektimin e *landfill*-it të ri të imponohet përfshirja e skemës së kapjes dhe përpunimit të gazit metan me qëllim prodhimin e LPG-së për përfitim ekonomik.

Figura 200. Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve në bashkinë e Kuçovës dhe niveli i trajtimit të tyre sipas objektivave të planit të menaxhimit për periudhën 2012 - 2015



Burimi: Plani bashkiak IMU, Kuçovë

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme: Bashkia Kuçovë nuk ka një plan për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Si rrjedhojë, menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme shtepiake që është kompetencë e bashkisë mbetet ende një sfidë. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia Kuçovë:

- Për mbetjet e rrezikshme shtepiake: të hartojë një Plan Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Shtëpiake, si dhe mënyra e trajtimit të tyre dhe përcaktimi i vendit të depozitimit përfundimtar të tyre.
- Mbetje të rrezikshme: të insistoj pranë institucioneve të linjës për gjidhjen e menaxhimit të rrymave të ndryshme të mbetjeve të rrezikshme, të cilat ndodhen apo prodhohen brenda territorit të bashkisë.
- Mbetje të rrezikshme spitalore: të harojë një plan për përcaktimin dhe miratimin e vend depozitimit të mbetjeve spitalore jo të rrezikshme dhe të monitorojë administrimin e mbetjeve sipas kopetencave të saj.

- Mbetje të rrezikshme industriale: të bashkëpunojë më institucionet qëndrore për zgjidhjen e problemit të trajtimit të mbetjeve industriale të depozituara dhe që prodhohen në teritorin e bashkisë.
- Të shtohet përqindja e mbetjeve të ricikluara: Planet dhe projektet që do të hartohen / zhvillohen në funksion të menaxhimit të mbetjeve industriale, të marrin në konsideratë dhe mundësinë e reduktimit të tyre që në burim dhe uljen e mundësisë së deportimit të ndotjes nga industria në tokë, ujë, ajër.


2.2.6 Infrastrukturat sociale

Në këtë seksion do të evidentohen edhe një herë problematikat e mbulimit të zonave të banuara nga rrezet e shërbimit të infrastrukturës arsimore në tri nivelet e saj (niveli parashkollor, niveli 9-vjeçar dhe niveli i mesëm), si dhe të mbulimit të zonave të banuara me shërbimin e infrastrukturës shëndetësore. Propozimet për sa i përket këtij seksioni do të ndërmerren në bazë të analizës së përfshirjes sociale në kapitullin I, në bazë të nenit 83 të VKM-së 671, i cili tregon standardet minimale të planifikimit për institucionet arsimore të 3 niveleve dhe të institucioneve shëndetësore, si dhe numrit të banorëve të cilëve i shërbejnë këto institucione.

Analiza e përfshirjes sociale jep konkluzione në lidhje me mbulimin e zonave të banuara me rrezet e shërbimit të institucioneve arsimore në 3 nivele (parashkollor, 9- vjeçar dhe të mesëm), si dhe për institucionet shëndetësore dhe gjendjen e tyre fizike.

Nga analiza e përfshirjes sociale del si konkluzion se fshatrat Frashër, Luzaj, Katundas Belesovë, Meandrake dhe Langozaj nuk kanë çerdhe dhe kopshte gjithashtu dhe zonat e fshatrave Goraj, Drizë dhe zona e banuar në afërsi Kthesës së Fermës (hyrja e qytetit të Kuçovës) nuk janë të mbuluara me shërbim nga kopshtet dhe çerdhet. Rekomandohet që në fillim këto struktura të ndërtohen në fshatrat Frashër, Luzaj, Belesovë, Langozaj Drizë, Goraj dhe në zones e Kthesës së Fermës. Më pas mund të ndërtohen edhe në fshatrat Meandrakë dhe Katundas. Këto institucione do të ndërtohen në afërsi të qendrave të këtyre fshatrave.


Figura 201. Mbulimi me shërbimin e kopshteve dhe çerdheve në bashkinë Kuçovë (Propozim)



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Për sa i përket situatës së shkollave të ciklit 9-vjeçar, situata paraqitet problematike në zonat e fshatit Langozaj. Ky fshat ndodhet në afërsi të fshatit Lumas dhe nxënësit e fshatit Langozaj do të akomodohen në shkollën 9-vjeçare të fshatit Lumas. Në këtë situatë shkolla e fshatit Lumas do t'i nënshtrohet një rikonstruksioni për rritjen e kapaciteteve të saj.

Figura 202. Mbulimi me shërbimin e shkollave 9-vjeçare në bashkinë Kuçovë (Propozim)




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Situata më problematike për sa i përket mbulimit me shkolla të mesme paraqitet në fshatrat Drizë dhe Gegë, si dhe Sheqëz, Vodhëz, Koritëz dhe Krekëz.

Në rastin e fshatrave Drizë dhe Gegë, të cilat janë fshatra të mëdha, nevojitet ndërtimi i kësaj shkolle të mesme. Ndërtimi i kësaj shkolle mendohet të jetë në afërsi të qendrës së fshatit Gegë. Në rastin e grupit të fshatrave Sheqëz, Vodhëz, Krekëz dhe Koritëz, të cilat ndodhen në njësinë administrative Lumas, ato mbulohen shumë mirë nga shkolla e mesme e zonës së Lapardhasë, e cila ndodhet në bashkinë e Beratit. Me anë të një marrëveshjeje ndërbashkiake mund të mundësohet që nxënësit e këtyre fshatrave të studiojnë në këtë shkollë të mesme. Në të kundërt, nevojitet ndërtimi i një shkolle të mesme, e cila mund të vendoset në fshatin Vodhëz dhe të mbulojë me shërbim gjithë këtë zonë dhe më gjerë.

Figura 203. Mbulimi me shërbimin e shkollave të mesme në bashkinë Kuçovë (Propozim)




Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Për sa i përket gjendjes fizike të këtyre insitucioneve, në gjendje kritike janë: Shkolla 9-vjeçare në Bardhaj, Lumas, si dhe kopshti "Shefqet Shuaipi" në Lumas. Këto godina duhet të kenë ndërhyrje për rikonstruksionin e tyre të plotë në mënyrë emergjente. Ndër shkollat e mesme kemi një gjendje mesatare të tyre, duke patur parasysh që mungojnë ambientet sportive dhe laboratorët shkencorë. Në këtë situatë duhet të ndërhyhet për rikonstruksionin e tyre, duke shtuar këto ambiente ndihmëse që janë mjaft të domosdoshme për nxënësit.

Situata e institucioneve të shërbimit të sistemit shëndetësor duket e kënaqshme, pasi vetëm në NjA Perondi nevojitet ndërtimi i një qendre shëndetësore, si pasojë e raportit të popullsisë me numrin e qendrave shëndetësore. Duke analizuar vendndodhjen e qendrave shëndetësore në NjA Perondi, kjo qendër e re shëndetësore propozohet të ndërtohet në fshatin Goraj, në afërsi të sheshit të fshatit. Për sa i përket standardeve të sipërfaqes së qendrave shëndetësore të përcaktuara në VKM-në 671, janë 6 qendra shëndetësore që nuk i plotësojnë këto standarde (2 në NjA Kozarë, 3 në NjA Perondi dhe 1 në NjA Lumas). Në këto qendra shëndetësore do të ketë ndërhyrje dhe rikonstruksion.

Figura 204. Mbulimi me shërbimin e qendrave shëndetsore në bashkinë Kuçovë (Propozim)



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

2.2.7 Infrastruktura të tjera Publike

Në këtë seksion do të përfshihet zhvillimi dhe analizimi i disa infrstrukturave të cilat kanë të bëjnë me Mbrojten Civile, mbrojtjen nga zjarri, infrastrukturat e energjisw elektrike, infrastrukturat e komunikimit elektornik si dhe disa masa që ndërmerren me administrimin e burmeve natyrore dhe kulturore.

<u>Masat për administrimin e burimeve natyrore dhe kulturore</u>

- Shtimi i gjelbërimit në brigjet lumore për zbutjen erozionit dhe gërryerjes së tokave nga lumi si dhe krijimi infrastrukturave të nevojshme sidomos në meandrimet e lumit për shmangien e permbytjeve.

- Krijimi i ishujve vegjetarian në zonat bujqësore të cilët bëjnë përthithjen e lëndëve të ndryshme kimike që i hidhen tokës bujqësore.
- Mirëmbajtja e kanaleve vaditëse dhe kulluese si dhe të hapësirës përgjatë tyre si rruge-kalim.
- Mirembajtjen e digave te rrezervuarëve sidhe te brigjeve te liqeneve si dhe kthimin e tyre nne zona rekreative.
- Shtim i zonave te mbrojtura sipas seksionit 2.3.2 te ketij dokumenti.
- Hartimi i një studimi per zonat e trashigimise kulturore ku percaktohen kushtet e mbrojtjes per secilin monument kulturore ne Bashkinë e Kuçovës.

Më tepër detaje në lidhje me administrimin e burimeve natyrore e kulturore, gjenden në seksionin 6.2, 6.3, 6.5 dhe 6.6 të planit mjedisor dhe në masat e VSM-së, në kapitullin 6 të saj.

Mbrojtja nga zjarri

Në Bashkinë Kuçovë ndodhet 1 stacion zjarrfikësish me një sipërfaqe parcele 3195m² dhe sipërfaqe ndërtimi 667 m². Ky stacion zjarrfikësish ka rreth 13 punonjës dhe dy automjete ku një prej tyre është jashtë funksionit. Stacioni i zjarrfikësve ndodhet në aksin kryesor të qytetit në pjesën veriore të qytetit.

Mbrojtja nga zjarri është një shërbim që kalon tërësisht në varësi të bashkisë, pra përfshirë mjetet e asetet dhe stacionet e MZSH-së, sipas ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Sipas këtij ligji, bashkitë duhet të plotësojnë infrastrukturën dhe ekipet përkatëse deri në vitin 2018.

Për bashkinë e Kuçovës, nisur nga stadardet minimale që vendos ligji për këtë infrastrukturë, duhet që të ketë të paktën 1 zjarrfikës profesionist për 1,500-2,000 banorë dhe jo më pak se 14 profesionistë zjarrfikës për një stacion MZSH. Për pasojë, bazuar në rritjen e popullsisë sipas Gjendjes Civile (24,969 banorë), në bashki, duhet të jenë të paktën 17 – 12 zjarrfikës profesionistë dhe të paktën 2-1 stacione MZSH. Sigurisht, kjo vlerë përllogaritet me popullsinë sipas Gjendjes Civile për vitin 2031, ndërkohë që bashkia duhet të përgatitë një plan pune për të shtuar gradualisht numrin e zjarrfikësve dhe stacioneve MZSH, të cilin mund ta rishikojë çdo tre vjet, në varësi të ndryshimeve që ndodhin në popullsi. Për shkak se shërbimi është dinamik dhe numri i punonjësve ndryshon sipas popullsisë, vendndodhja e stacioneve nuk mund të përcaktohet në këtë moment kohor, por është subjekt i zbatimit të Planit në kohë. Në çdo rast, nevojitet që të paktën 1 stacion të ndodhet në qytetin e Kuçovës, dhe një i dytë në pjesën lindore të bashkisë.

Mbrojtja civile

Numri i objekteve dhe sipërfaqja e zonave aktuale me përdorim ushtarak, sipas inventarit të pronave publike është 11 ku kemi zonën e airoportit ushtarak i cili ka një siperfaqe prej 2.38 km² dhe 10 zona ushtarake të klasifikuara si vend-strehime me një sipërfaqe prej 4319.9 m². Numri i objekteve të policisë së shtetit është 1 dhe ka një siperfaqe prej 6225 m². Aktualisht bashkia i ka evidentuar këto zona, por për shkak se ato përbëjnë informacion të klasifikuar shtetëror, bashkia nuk mund të ndërhyjë në këtë lloj infrastrukture me propozime në nivel vendor. Për momentin, në dijeni të bashkisë nuk ka zhvillime të reja për zona të tilla.

Emergjencat Civile

Për sa i përket emergjencave civile, merren një sërë masash që lidhen me përmbytjet, rrëshqitjet dhe erozionin, ujërat e larta etj. Në mënyrë të detajuar këto masa infrastrukturore paraqiten në seksionin e planit mjedisor, si psh. në tabelat 100, 102, 106, etj të kapitullit 2.3 të këtij dokumenti.

Energjia Elektrike

Përsa i përket infrastrukturës energjitike, për të përmirësuar cilësinë e ofrimit të këtij shërbimi në Bashkinë Kuçovë, Drejtoria Rajonale e OSHEE Berat do të ndërmarrë disa ndërhyrje në sistemin shpërndarës energjitik

Në Qytetin e Kuçovës planifikohet të ndërhyhet në tre fidra që dalin nga N/Stacioni Kuçovë gjithashtu dhe në fidrin që furnizon me energji elektrike Fshatrat Perondi dhe Magjatë. Ky investim parashikon kthimin me tension 20 kV të kabinave që funizojnë këta fidra të cilët janë: Fidri nr.3 (10kV) në lagjen Tafil Skendo dhe 11 Shkurti, Fidri Nr. 10 (10 kV) në lagjen Llukan Prifti dhe 1 Maji, Fidri Nr.5 (kV) në lagjen 11 Janari si dhe Fidri Nr.8 (10 kV) në Fshatrat Perondi, Matranas dhe Magjatë. Rrjeti shpërndarës i Tensionit të Mesëm (TM) do të jetë i gjithi kabllorë nëntokësor dhe kabinat që aktualisht janë shtyllore do të kthehen në kontenier betoni ndërsa në kabinat periferike të lagjeve 1 Maji dhe 11 Janari si dhe në Fshatrat Magjatë dhe Perondi , rrjeti i shpërndarjes së Tensionit të Ulët (TU) do të kthehet nga rrjet me përcjellësa ajror në kabllor ABC me vetëmbajtje.

Një tjetër investim është investimi në fidrin Nr.7 (10 kV). Ky investim parashikon rikonstruksionin e kabinave të vjetra si dhe rikonstruksionin e rrjetit shpqrnadrës TU të kabinave të këtij fidri që prekin Fshatrat Havaleas, Vlashuk, Zdravë Demollar dhe Goraj.

Infrastukturat e komunikimit elektronik

Përsa i përket infrastrukturës së komunikimit elektronik, si pasojë e mungesës së informacionit nga institucionet përkatëse nuk kemi të dhëna për të patur një analizim dhe propozim të këtyre infrastrukturave.

2.3 Plani për mbrojtjen e mjedisit

Në bazë të analizës së ndikimit në mjedis, ka rezultuar se projektet do të kenë kryesisht ndikim të ulët në mjedis, me disa përjashtime për projekte specifike. Ndikimi, edhe pse në shkallë të ndryshme, do të jetë kryesisht në tokë, burime ujore, pyje, ajër, biodiversitet, etj. Ndikimi parashikohet të jetë specifik për çdo projekt më vete.

Marrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti, dhe në rastin tonë të projekteve të PPV-së së bashkisë është kompetencë e një numri të caktuar institutesh publike dhe e zhvilluesit të projektit. Institutet publike sigurohen që për çdo projekt, zhvilluesit e projekteve parashikojnë dëmtimet e mundshme të mjedisit gjatë fazës së zbatimit dhe, përpara fillimit të zbatimiti të projektit, marrin masat teknike të nevojshme për parandalimin dhe zbutjen e tyre. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet zbatimit të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i cili përcakton kushtet e zbatimit të një projekti në rrespekt me mjedisin.

Sipas Ligjit nr. 10440, projektet, përpara zbatimit do t'i nënshtrohen "procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis" ose "procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në

mjedis" sipas Ligjit nr. 10440, datë 7.7. 2011,. Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre. Sipas nenit 4 të të njëjtit ligji, vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit. *Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin vlerësimin e ndikimit të projektit gjatë fazës së zbatimit dhe gjithashtu edhe dekontaminimin /pastrimin apo rikthimin* e zonës në gjendjen e mëparshme, funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, edhe propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Autoriteti vendimmarrës për hartimin e VSM-së është Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila vendos nëse një projekt i nënshtrohet VNM-së paraprake ose duhet t'i nënshtrohet edhe procedurës së thelluar të VNM-së. Hartimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM-së) të një projekti mbetet detyrë e zhvilluesit të projektit (neni 11 i Ligjit nr. 10440). Hartimi i VSM-së është proces që përfshin institucionet shtetërore (Ministrinë e Mjedisit dhe AKM-në), zhvilluesisn e projektit, pushtetin lokal ku zhvillohet projekti dhe palët e tjera të interesuara si publiku dhe organizatat jofitimprurëse, etj. Zhvilluesi, për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet me publikun e interesuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij (Neni 14 i Ligjit nr. 10440).

Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti luan edhe autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për licencimin e veprimtarive (zbatimin e projekteve). Ligji nr. 10440 i kërkon autoriteteve në fjalë që, përpara vendimit për dhënien e lejes së zhvillimit apo licencës përkatëse për një projekt të propozuar, të sigurohet që projekti t'i jetë nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me vendim apo deklaratë. Vendimi apo deklarata për projektin e propozuar është i vlefshëm për aq kohë sa është e vlefshme dhe leja e zhvillimit/licenca përkatëse për projektin (Neni 20 i Ligjit nr. 10440).

Mbas marrjes së lejes për zbatimin e projektit, zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë (Neni 20 i Ligjit nr. 10440).

Një vëmendje të veçantë si objekt mbrojtjeje i kushtohet zonave të mbrojtura, ose zonave veçanarisht të mbrojtura (neni 21 i Ligjit nr. 10440). Në këtë rast, dispozitat e ligjit nr. 10440 zbatohen edhe në rastet kur veprimtaria e propozuar nuk ka të bëjë drejtpërdrejt apo nuk është e nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojë efekte të rëndësishme mbi atë zonë.

Kur AKM-ja apo ministria, në përfundim të procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti, shprehet se veprimtaria e propozuar, veçmas apo në bashkëveprim me veprimtari ose plane dhe projekte të tjera, të realizuara apo të propozuara, mund të ketë

ndikim negativ të rëndësishëm mbi integritetin e një zone veçanërisht të mbrojtur, atëherë autoriteti përgjegjës që mbulon fushën e projektit, nuk lejon zhvillimin e tij, Bëjnë përjashtim vetë rastet kur i) nuk ka zgjidhje tjetër alternative; ii) veprimtaria e propozuar duhet të zbatohet për arsye urgjente të interesave madhorë të publikut, përfshirë edhe ata me natyrë shoqërore apo ekonomike (arsye urgjente të interesave madhorë të publikut që merren në konsideratë, kur zona veçanërisht e mbrojtur përmban lloje habitatesh natyrore prioritare dhe/ose specie prioritare, janë vetëm ato që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut apo sigurinë e publikut, ose që sjellin ndikime të rëndësishme pozitive për mjedisin); iii) duhen marrë të gjitha masat kompensuese për të siguruar zbatimin e kërkesave të "Natyra 2000".

Si përfundim, mund të thuhet se masat për mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së përcaktohen në VNM-të përkatëse të çdo projeti. Rolin kryesor të mbrojtjes së mjedisit në këtë rast e luajnë Ministria e Mjedisit me institucionet vartëse që miratojnë VNM-të e projekteve, autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për licencimin e veprimtarive të cilat kërkojnë që projekti të jetë pajisur me vendim apo deklaratë mjedisore, zhvilluesit e projekteve të cilët përcaktojnë masat që merren gjatë fazës së zbatimit dhe autoritetet inspektuese gjatë fazës së zbatimit. Një rol tejet të veçantë dhe të rëndësishëm pritet që të luhet nga publiku në fazën e hartimit të VSM-ve dhe për ndërgjegjësimin e qeverisë lokale (bashkisë) për rëndësinë e respektimit të ligjit nr. 10440 gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së dhe në të ardhmen.

2.3.1 Mbrojtja e tokës

- **Masat për mbrojtjen e tokës/territorit**

Në shumë ish-komuna të Bashkisë së Kuçovës, territori ka përdorim bujqësor dhe industrial. Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike që ka sjellë për vendin, ka ndikuar negativisht në ndotjen e tokës, për shkak të mbetjeve të dherave industriale të depozituara në vende të papërshtatshme dhe për shkak të puseve të industrisë së naftës të përdorur gjatë aktivitetit naftë-nxjerrës ndër vite.

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së tokës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Kuçovë ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Masat për uljen e ndotësve dhe shkallës së degradimit të tokës përfshijnë rihabilitimin e sistemit ujitës-kullues, luftën kundër erozionit dhe pastrimi i tokës nga ndotja.

Me qëllim mbrojtjen e tokës fenomene të rrezikut gjeologjik (erozion, përmbytje, etj.) dhe nga ndërhyrjet e njeriut, rekomandehen masat e mëposhtme për Bashkinë.

- **Hartimi dhe zbatimi i Planit për Shtimin e Sipërfaqeve Pyjore** për përmirësimin e sipërfaqeve të tokave të gërryera, të braktisura, të zhveshura dhe të shpyllëzuara. Bashkisë së Kuçovës i del si detyrë hartimi dhe zbatimi i këtij plani në zbatim të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar" Neni 7, nëpërmjet të cilit synohet shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve në zonat e braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera.
- Parandalimin ose kufizimin deri në maksimum të kalimit të tokës pyjore në tokë bujqësore ose urbane,

- **Përcaktimin e venddepozitimit rajonal** të mbetjeve urbane për shmangien e përmbytjes së tokave bujqësore nga Devolli. Duke ju referuar Ligjit nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e Kërkesave për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte" Nenit 19, Bashkisë i del për detyrë që të bashkëpunojë me bashkitë e tjera për të përcaktuar vendin e venddepozitimit rajonal dhe për mënyrën e funksionimit të tij. Në këtë formë Bashkia e Kuçovës eleminon përmbytjen e tokave nga lumi Devoll si pasojë e hedhjes së mbetjeve të ngurta në shtratin e lumit Devoll.

Rrëshitjt/rrëzim i gurëve: Në Bashkinë Kuçovë, problemet me rrëshitjet/rrëzimin e gurëve evidentohen më tepër në zonat kodrinore për pasojë të shpyllëzimit, mosmenaxhimit të tokave e pyjeve dhe ndërhyrjeve të ndryshme. Me qëllim përmirësimin e gjendjes së territorit në zona ku ndodhin këto fenomene (shih hartën në analizën e thelluar të territorit) rekomandohet të merren masa mbrojtëse për të parandaluar këtë fenomen, kryesisht *në zonën midis lumenjëve Devoll dhe Lapardha, në jug të NjA-së Lumas, në veri të NjA-së Perondi dhe në kufirinin midis Kuçovës dhe NjA Perondi*së. Ndër masat kryesore përmendim:

- Hartimin e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve: Për fenomenin e rrëshqitjes si pasojë e shpyllëzimeve pa kriter në këtë Bashki rekomandohet të merren masa në mënyrë emergjente nëpërmjet hartimit të Planit të Mbarështrimit të Pyjeve. Bashkia mund të marrë masa paraprake duke mbjellë pemë dhe bimë të ndryshme në zonën e NjA Lumas, Perondi dhe Kozare. Struktura pranë Bashkisë ndjek dhe mbikqyr punën për përmirësimin e zonave tek të cilat ka ndodhur proçesi i rrëshqitjes, detyrim ligjor i cili i vjen nga ligji për pyjet dhe shërbimin pyjor.
- Kufizimi i sipërfaqeve që kalojnë nga tokë pyjore në tokë bujqësore: Një faktor tjetër, që duhet përmendur përsa i përket rrëshqitjeve është dhe shndërrimi i tokave pyjore në bujqësore duke tjetërsuar kështu morfologjinë e tokës në të cilën ndodh. Rekomandohet që Bashkia të mos miratojë kërkesa për kalimin e tokës pyjore në tokë bujqësore në zonat ku shihet dukshëm krijimi i fenomenit të rreshqitjeve, kryesisht ne zonaen e NJA Lumas dhe Perondi.

Erozioni në zonat pyjore: Sa i përket erozionit në zonat pyjore, gjëndja paraqitet problematike si pasojë e shpyllëzimit, shfrytëzimit pa kriter dhe dëmtimit të bimësisë së ulët, në veçanti në zonën e Lumasit. Rekomandohet që Bashkia.

- Të hartojë Planet e Mbarështrimit të Zonave Pyjore: Zonat më problemtike ndaj këtij fenomeni shfaqen: brigjet e lumenjëve Devoll, Osum dhe Seman, brigjet e lumit Laparadha (Bardhaj, Sheqës, Vodës, Pëllumbas) si një lumë me karakter të rrëmbyeshëm malor, si dhe në NjA Lumas për shkak të prishjes së digave ujëmbajtëse para digës së Belesovës.
- Të marrë masa për sistemimin e shtratit të lumit të Lapardhasë, ndërtimit të veprave inxhinierike me karakter shuarës energjie përgjatë shtratit të lumit të Lapardhasë (sidomos dy digat përpara arritjes së lumit në Rezervuarin e Belesovës) dhe krijimin e zonave ripariane përgjatë lumenjëve që përshkojnë Bashkinë dhe krijojnë probleme me përmbytjet e tokave përreth.
- Të ndërhyhet urgjentisht për rehabilitimin e përrenjve, kryesisht në përrenjtë e pjesës veriore dhe lindore të NJA Lumas.

Erozioni në zonat fushore: Zonat fushore të Bashkisë Kuçovë përshkohen nga një rrjet i dendur sistemi ujor, që nga kanalet vaditëse dhe kulluese deri tek përrenjtë dhe lumenjtë e

Devollit dhe Lapardhasë duke shkaktuar përmbytje të herëpashershme të tokave përreth në rast shirash. Si një problematikë e rëndësishme rekomandohet që:

- të merren masa për përmirësimin e sistemit ujitës dhe kullues duke i pastruar dhe duke i përmirësuar si dhe duke i rehabilituar ato kryesisht në NJA Perondi dhe Kozare.
- të merren masa për përmirësimi e zonave riparane në mënyrë, që të minimizohet rreziku i përmbytjes së këtyre tokave me qëllim parandalimin e përmbytjes së tokave përreth lumenjëve Devoll, Seman, Lapardha.

Përmbytjet: Rreziku i përmbytjes me rikthim 100-vjeçar në Bashkinë e Kuçovës parashikohet të shkaktohet nga lumi i Devollit ndaj dhe rekomandohet që:

- *të përditësohet Plani I Menaxhimit të Përmbytjeve* me rikthim 50-vjeçar. Planet e sotme janë të vitit 2003 dhe nuk marrin parasysh ndryshimet e regjimit të reshjeve dhe fenomeneve të tjera klimatike në dhjetëvjeçarin e fundit.
- të hartohet një plan menaxhimi në rast përmbytjesh me rikthim 100-vjeçar. Fillimisht rekomandohet të bëhen studime për të përditësuar përmbytjet në Bashki.
- Të hartoje dhe zbatojë Plane Veprimi për kontrollin teknik të digave dhe pastrimin e tyre nga materialet e depozituara në liqene me qëllim shmangien e përmbytjeve dhe shtimin e kapacitetit ujëmbajtës të tyre. Më problematike paraqitet situate në digën e Belesovës e ndjekur nga diga në Goraj, Fier-Mimar dhe së fundi në Gegë.

- **Masa për mbrojtjen e tokës bujqësore**

Duke parë rëndësinë e veçantë që ka sektori i bujqësisë në ekonominë e Bashkisë, është e rëndësishme që Bashkia të investojë në mbrojtjen e tokën bujqësore në përgjithësi dhe tokës bujqësore në veçanti. Në këtë rast, krahas masave të propozuara në PPV-në e Bashkisë Kuçovë, bashkia rekomandohet të marrë një sërë masash të tjera të cilat janë renditur më poshtë:

- **Mbrojtja dhe erozioni në toka bujqësore:** është një fenomen që prek territorin e Bashkisë Kuçovë për pasojë të një sërë shkaktarësh, si lloji i përdorimi i tokës dhe shpyllëzimet. Përgjithësisht, në territorin fushor të Bashkisë (pjesa perëndimore) vihet re keqmenaxhimi i tokës duke ndjekur praktika jo të mira për përdorimin e saj. Përdorimi i tokës nga bujqësia ka shkaktuar probleme me erozionin. Ndaj rekomandohet që Bashkia:
- **Ruajtja ose mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet:** Bashkia e Kuçovës është përgjegjëse për nxjerrjen e vendimeve të detyrueshme në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore. Veprimtari të tilla si ndërtimi mbi tokë bujqësore ndalohen me ligj (Nenet 10 dhe 14 i Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore").
- **Ndalimin e çdo zënie ose përdorim të paligjshëm të tokës** në territorin e bashkisë në zbatim të Ligjit nr. 7501 "Për Tokën" i ndryshuar, Neni 21. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia e Kuçovës të marrë masa për kontrollin e vazhdueshëm për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme në tokat bujqësore.
- **Hartimin e një Plani Veprimi për Informimin e Bujqërve për praktikat e mira bujqësore** që synojnë uljen e erozionit dhe rritjen e prodhueshmërisë së tokave. Praktika të tilla përfshijnë punimin e tokës duke e trazuar atë sa më pak, ruajtjen e masës bimore të të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit etj.

- **Mbikqyrja e punës për përmirësimn e zonave të gërryera në tokat bujqësore:** Për problemet me erozionin në toka bujqësore, rekomandohet që Bashkia të drejtojë dhe të mbikqyrë punën për përmirësimn e zonave të gërryera në tokat bujqësore, në zbatim të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar" Neni 7.
- **Investime në bujqësi me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore sipas standardeve të BE-së** (ku synohet mbrojtja e tokave të brishta /të pjerrëta *ndaj erozionit, gërryerjes, etj.*). në shumë fshatra ose zona kodrinore, popullsia është e detyruar të kultivojë tokat në pronësi të saj për arsye ekonomike. Kultivimi kryhet edhe në rastet kur tokat janë të ndjeshme ndaj erozionit e gërryerjes (për shkak të shiut e erës). Me qëllim shmangien e degradimit të këtyre tokave nga kultivimi, rekomandohet që Bashkia të investojë në bujqësi, dhe në veçanti, të nxitë pronarët e tokave të ndjeshme që të mos i punojnë ato në këmbim të kompensimit të tyre.

Tabela 100. Projektet e planifikuara në PPV për mbrojtjen e tokës

Qëllimi	Masa	Projektet
Masa kundër degradimit të tokës	Rihabilitimi i sistemit ujitës-kullues	- Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë Bashkinë Kuçovë - Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit kullues në zonën pranë UPN, në seksionin Porta e Përpunimit-Hipotekë - Rehabiltimi mjedisor dhe marrja e masave për minimizimin e erozionit të tokave bujqësore përgjatë Përroit të Lapardhicës. - Marrja e masave për rekuperimin e efekteve të dëmtimit dhe ndotjes nga nafta, permiresimi i kushteve fizike të puseve.
	Lufta kundër erozionit	
	Pastrimi i tokave të ndotura	

Burnimi: Co-PLAN, 2016

2.3.2 Mbrojtja e peizazhit, biodiversitetit, pyjeve, kullotave dhe zonave të mbrojtura

- **Masa për mbrojtjen e peizazhit**

Peisazhi në teritorin e Bashkisë Kuçovë paraqitet i ndryshëm, në varësi të teritorit dhe zonave ku dominon aktiviteti njerëzor (Shih seksionin e peisazhit). Problematikat kryesore që has peisazhi në teritorin e bashkisë kanë të bëjnë kryesisht me fragmentimin/copëtimin e peisazhit natyror, dhe mos futjen e elementëve të peisazhit natyror në zonat urbane dhe në zonat me aktivitet industrial. Krahas problemeve në shkallë të madhe, vlen për tu theksuar problemet me peisazhin urban e atë industrial, të cilët deri më tani nuk kanë gjetur një rrugë të përbashkët ndërthurjeje me atë natyror. Në qytet mbetet problem krijimi i një peisazhi të mirëfilltë urban, duke përfshirë të gjithë elementët e gjelbërimit, arkitektonikës, kopshteve, monumenteve kulturor dhe historik, të cilët sëbashku do të krijoni një peisazh të ndërthurur dhe të pëlqyeshëm për qytetarët. Shpesh praktikat e mira të peisazhit nuk ndiqe, apo përcaktohen si dytesore, keto praktika janë spontane, ku zonat urbane dhe industriale kanë përdorur elementë të peisazhit në mënyrë rastësore, apo duke patur një orientim të lehtë mbi çështjen e dizajnit të peisazhit. Kryesisht, rrugët dhe sheshet kanë qënë pjesë e futjes së dizajnit të pejsazhit, me mbjellje pemësh formë lineare, duke ndjekur linja strikte, në rastet dominuese duke ndjekur konturet e infrastrukturës, kjo është një mënyrë, sigurisht jo universale në rregullimin dhe krijimin e peisazhit, apo përdorimit elementëve të tijë në funksion të dekorit urban e më gjerë. Studimi i peisazhit në tërësi dhe

elementëve të tij kërkon studime të thelluara duke analizuar të gjithë komponentët që e formojnë atë (planifikimi, arkitektuonika, historia, kultura, kultura bujqësore, natyra, bimet lokale, e deri tek komponentet më elementar si ndryshimi i ngjyrës së peméve përgjatë sitinëve të vitit) dhe gjetjen e rrugëve të përbashkëta për ndërthurjen e pikave që mund të kombinohen me njeri tjetrin për të krijuar një peisazh të pëlyeshëm dhe funksional.

Masa të parashikuara në PPV

Me qëllim mbrojtjen e përbërësve të mjedisit dhe peisazhit, në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) i cili është në fazë miratimi, Bashkia Kuçovë ka parashikuar marrjen e disa masave të cilat përqendrohen në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytetin e Kucovës dhe në zonat industriale, krijimin e zonave ripariane përgjat lumenjëvë (Devoll, Osum, Lapardha, dhe degët e tyre) dhe krijimin e parqeve urbane. Konkretisht për përmirësimin e peisazhit, në PPV, Bashkia ka propozuar rehabilitimin mjedisor dhe ristrukturimin e ish-zonës industriale të Uzinës së Përpunimit të Naftës, për të siguruar cilësi të mirë jetese si dhe kthimin në hapësire të gjelbër dhe argëtuese, krijimin e një parku rajonal në zonën nga Rezervuari i Murrizit deri në fshatin Vlashuk, kthimin e puseve të nafës në objekte tërheqëse (lyerja e tyre dhe vendosja e ndriçuesve), mbjelljen e peméve në zonat urbane, etj. Projektet e propozuara nga Bashkia në PPV që synojnë përmirëzimin e peisazhit në territorin e Bashkisë paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela 101. Projektet e planifikuara në PPV që synojnë përmirësimin e peisazhit

Qëllimi	Masa	Projekti
Përmirësimi i peizazhit në territorin e Bashkisë Kuçovë Nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të gjelbra	Shndërrimi në sipërfaqe të gjelbra i zonave industriale	- Rehabilitimi mjedisor dhe ristrukturimi i ish-zonës industriale të Uzinës së Përpunimit të Naftës, për të siguruar cilësi të mirë jetese sidhe kthimi ne hapësire gjelbër dhe rekreative. - Krijimi i një parku rajonal në zonën nga Rezervuari i Murrizit deri në fshatin Vlashuk - Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative te zonave ripariane të Lumit Devoll dhe Osum-Seman. - Zgjatimi dhe kthimi në rrugë për këmbësorë i bulevardit kryesor të qytetit. - Kthimi i puseve të nafëts në objekte atraktive (lyerja vendosja e ndriçuesave) për ti dhënë një pamje tjetër qytetit. - Rehabilitimi mjedisor dhe rizhvillimi i zonës së TEC-it si pol kulturor e rekreativ - Rikonstruktimi i sheshit të pazarit në Kuçovë - Rikonstruktimi i shesheve të brendshme të blloqeve 5-katëshe të banimit në lagjen 1 Maji dhe i shesheve
	Shndërrimi i objekteve industriale në objekte zbukurimi për qytetin	
	Krijimi i zonave ripariane përgjatë lumenjve	
	Krijimi i parqeve urbane/rajonale	

		të qendrave të njësive administrative të Lumasit, Perondisë dhe Kozares - Programi për mbjelljen e pemëve dekorative në rrugët kryesore të qytetit të Kuçovës.

Burimi: Co-PLAN, 2016

Masa të tjera shtesë

Hartimi i PPV-së ka synuar Planifikimin e Zhvillimit të Territorit në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen e mjedisit, në rastin konkret mbrojtjen e peizazhit në territorin e bashkisë. Në funksion të përmirësimit të peizazhit, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Kuçove rekomandohet:

- **Peisazhi Urban: Futja dhe ndërthurja e përbërësve të peisazhit natyror në brendësi të zonave urbane** (sipërfaqe të gjelbërta, pemë, shkurre, sipërfaqe ujore). Kjo kërkon studime të hollësishme për zona specifike, apo dhe në shkallë qyteti (Qyteti i Kuçovës), në mënyrë që peizazhi uban të ndëthuret me atë natyror dhe ky i fundit të mund të shërbejë, krahas të mirave mjedisore, si dekor urban. Masa specifike për përmirësimin e peisazhit urban në teritorin e bashkisë janë:
  - Ruajtja e struktures së pemëve përgjatë rrugëve. Pra, nëse aksi rrugor karakterizohet nga pemë kumbulle të kuqe që ka rezistuar në kohë dhe i është përshtatur klimës dhe tokës, rekomandohet që të ruhet kjo lloj bimësie, si dhe mundësisht të së njejtës madhësi dhe distancë nga njëra-tjetra, deri në fund të aksit për të ruajtur "*formalitetin*" që karakterizon këtë peizazh. Zgavrat e bordurat ku pema qëndron duhet të jenë të së njejtës madhësi, ngjyrë dhe materiali mbulese. Kjo e fundit duhet të ketë çarje të mjaftueshme për të lejuar depërtimin e ujit në rrënjë, por të mos pengojë ecjen mbi to. Gjithashtu duhet të jetë e lëvizshme për qëllime mirëmbajtjeje. Rekomandohet që mbulesat dhe zgavrat të mos lihen të çara e me bordurë sepse, veçanërisht në rrugët me trotuare të ngushta (1-2 m) pemët kthehen në pengesë serioze për ecjen e kalimtarëve.
  - Përzgjedhja e bimëve përgjat akseve rrugore urbane duhet të jetë me bimësi të të njëjtit lloj, ose me një kombinim 2-4 llojesh por sipas një tendence të përsëritur që krijon elementin estetik dhe të rregullsisë në dizajnin e peizazhit rrugor. Si parim, larmia në ngjyrë, formë dhe lloj mund të arrihet në akset e tjera, por brenda të njëjtit aks bimët, forma, distanca dhe lloji i tyre rekomandohet të qendrojnë të pandryshuara, ose në formacione të projektuara paraprakisht.
  - Në zona park e hapsira të tjera publike ku do të mbillen pemë, karakteri formal i ketij peizazhi mund të thyhet nga pemë të të njëjtit lloj të mbjella rresht, në pemë të së njejtës familje (gjethore, halore, shkurre), por të mbjella në grupime. Pra grupe me nga 3 apo 5 pemë në varësi të hapësirës. Gjithsesi, në zonat park, projektuesit e peizazhit kanë liri në përzgjedhjen e formacioneve, për sa kohë që: zgjedhin bimë vendase apo të përshtatura për një kohë shumë të gjatë në territorin e qytetit/bashkisë së Kuçovës; i vendosin në mënyrë të tillë që të garantojnë hije në verë dhe depërtim të dritës së diellit në dimër; bëjnë të mundur krijimin e zonave me bar dhe jo vetëm lule ose tokë nën hije ku nuk

mund të rriten bimët; krijojnë mikroklima të ndryshme brenda parkut; sjellin shumëllojshmëri bimësh që ofron informacion shkencor bazik edhe për përdoruesit e parkut; garantojnë që bimësia e përzgjedhur përmirëson cilësinë e tokës dhe rrit aftësinë filtruese e infiltruese të saj.

- Ti kushtohet vëmendje "*Xhepave Urban*", ose thënë ndryshe hapësirave boshe, të patrajtuara mes pallateve apo ndërtesave të ndryshme të qytetit të cilat fshehin një potencial të madh në trajtimin e peizazhit urban. Këto hapësira vërtetojnë se peizazhi nuk ka përmasë standard dhe se është vetë elementi i përdorur në të i cili nëpërmjet funksionit që ofron edhe në një hapësirë relativisht të vogël, sërisht ofron një shumëllojshmëri aktivitetesh e mjedisesh. Po si hapësirat e tjera park, edhe këto xhepa ofrojnë tipologji të ndryshme sipas vendodhjes. Pra, këto xhepa mund të trajtohen sipas neovojaës së komunitetit.
- Bimët e rekomanduara për përdorim në teritorin e Bashkisë Kuçovë (jo të vetmet) janë: Lofata *(Cercis siliquastrum)*, Lagestromia *(Lagerstroemia indica)*, Kumbulla e Kuqe (*Prunus cerasifera*), Ulliri i egër (*Olea europaea*), Rrapi (Platanus occidentalis), Pisha e Butë (*Pinus Pinea*), Dafina *(Laurus Nobilis) dhe* Ginko *(Ginkgo Biloba)* të cilat janë bimë (pemë) me tipare terheqëse, rezistente ndaj ndotjes, të përshtatshme me zonën dhe sjellin të mira mjedisore (filtrojnë ajrin, neutralizojnë temperaturën, etj.)

- **Peisazhi industrial: Të merren masa në drejtim të uljes së ndikimit negativ visual të zonave industriale**. Kjo kërkon studime specifike në mënyrë që futja e elementëve të gjelbërimit me pemë dhe shkurre të shërbejë si përmirësues i peisazhit dhe fshehjen e zonave/objekteve të cilat nuk janë të përshtatshëm nga pikëpamja vizuale. Gjatë hartimit të këtyre projekteve dhe zbatimit të tyre duhet pasur parasysh që funksionet industriale dhe gjelbërimi, apo përbërësit e peisazhit të balancohen dhe të plotësojnë njeri-tjetrin duke krijuar një dizajnë të pëlqyeshëm dhe njëkohësisht duke garantuar ruajtjen e funksionalitetit. Masa specifike për përmirësimin e peisazhit industrial janë:
  - Të shtohen sipërfaqet e pyllëzuara në zonat industriale, kryesisht zona e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës e cila është pranë qytetit të Kuçovës. Pyllëzimi i këtyre zonave do të përmirësonte pamjen vizuale të zonës industriale dhe do të silltë një sërë përfitimesh mjedisore, si mbrojtja e tokës, shtimi i oksigjenit në ajër dhe zbutja e klimës, etj.
  - Të mbillen pemë të cilat, karahas rregullimit të peisazhit, përshtaten me tokën dhe që mund të zhvillohen në mjedise relativisht të ndotura. Për mbjelljen e pemëve në zonat industriale rekomandohen bimët si: Pisha e Butë (*Pinus Pinea*), Rrapi *(Platanus orientalis)*, Plepi *(Populus alba)*, Shelgu *(Salix species)*, Eukalipti *(Eucalyptus)* etj.
- **Peizazhi natyror: Të synohet mbrojtja dhe përmirësimi i peisazhit natyror** nëpërmjet shtimit të zonave të pyllëzuara dhe uljes së fragmentimit të zonave natyrore. Masa specifike për përmirësimin dhe mbrojtjen e peisazhit natyror mund të jenë:
  - Të ruhen, ndërtohen aty ku mungojnë, zonat ripariane të lumenjëve, të cilat janë një përbërës i rëndësishëm i plotësimit të peizazhit të territorit të Bashkisë. Ruajtja dhe përmirësimi i zonave ripariane luajnë rol të shumëfishtë, kanë

funksion mbrojtës të tokës nga erozioni, njëkohësisht luajnë rolin e brezit buferik (zbutës) të ndalimit të ndotjes nga sipërfaqet bujqësore në drejtim të lumit, kanë një rol të rëndësishëm si korridor lidhës për habitatet dhe për strehimin dhe levizjen e specieve të ndryshme, gjithashtu dhe ndikimet positive në përmirësimin e cilësisë së ajrit, zbutjen e klimës, etj.

- Ripyllëzimi i zonave të shpyllëzuara dhe të degraduara nga shkaqe të ndryshme do të sillte një ndikim pozitiv në ruajtjen e njetrajtshmërisë dhe të bashkimit të pjesëve të copëtuara të pyjeve, duke krijuar një peizazh pyjor të vazhdueshëm. Gjatë kësaj ndërhyrje duhet treguar kujdes i veçantë që pemët e përzgjedhura të të njëjtit lloj që kanë qënë më parë, ose të përshtaten pemë të tjera, gjithmonë duke përdorur pemë të cilat janë karakteristike për zonë dhe që e kanë habitatin e tyre këtë territor.
- Të mbillen pëmë të cilat, karahas rregullimit të peisazhit, përshtaten me tokën dhe që mund të shërbejnë si mbrojtëse të tokës nga erozioni dhe që nuk përbëjnë rezik për të prishur balancat me bimët e tjera (nuk janë invazive), ndër të tjera rekomandohen: Shelgu *(Salix species)*, Plepi (*Populus alba)*, Akacia *(Acacia)*, Eukualipti *(Eucalyptus), etj.*

- **Peizazhi rural: Mbrojtja e peizazhit rural dhe përmirësimi i cilësisë së tij,** duke e konsideruar si pjesë të pandashme të peizazhit natyror. Kjo do të arrihet nëpërmjet marrjes së masave specifike për rregullimin e elementëve të caktuara, disa prej këtyra masave mund të jenë:
  - Gjatë hartimeve të planeve të zhvillimit të bujqësisë të kihen parasysh elementët e peizazhit, në mënyrë që, aty ku është e mundur, dhe sektori i bujqësisë të përshtatet me përbërësit e tjerë të peizazhit, apo të krijojë një peizazh i cili nuk fragmenton në vijushmërinë pamore (edhe fizike aty ku është e mundur) të peizazhit.
  - Ruajtja, mirëmbajtja e kanaleve vaditëse/kullues dhe mbjellja e brigjeve të tyre me gjelbërim, duke krijuar "damarë" të gjelbërt përgjatë parcelave bujqësore (kryesisht bimësi e ulët, barishtore dhe shkurre te vogla).
  - Të krijohen breza buferike (zbutës) me pemë të larta dhe të ulta në pjesët fundore të tokave bujqësore, me qëllim krijimin e një zone të gjelbërt dhe parandalimin e shpërdarjes së ndotësve në sipërfaqe të gjera (në qoftë se në pjesën fundore të parcelave bujqësore ndodhet një lum, ky brez i gjelbërt të ulte ndjeshëm depërtimin e ndotësve si pasojë e shpelarjes së tokës bujësore nga vaditja).
  - Të mbillen pëmë/bimë të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund krijojnë konflikt me zhvillimin bujqësor. Për mbjelljen e pemëve në zonat industriale rekomandohen bimët si: Pisha e Butë (*Pinus Pinea*), Rrapi *(Platanus orientalis)*, Plepi *(Populus alba),* Shelgu *(Salix species)*, Eukalipti *(Eucalyptus)* etj.

Masa të tjera, të përgjithshme, për mbrojtjen e peisazhit dhe ndërthurjen e tij me të gjithë përbërësit e peisazhit në harmoni të plotë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ndjeshmërisë emocionale të qytetarëve mund të jenë:

- **Të ruhet dhe konservohet peisazhi natyror dhe ai artificial**: Kjo merr një rëndësi të veçantë për banorët që jetojnë, apo që kthehen në vendin e orgjinës, nga

pikëpamja emocionale dhe e qetësisë që i ofron identiteti i vendlindjes/banimit të tyre.

- **Përfitime të tjera nga ruajtja e peizazhit**: Ruajtja dhe konservimi i peisazhit natyror gjithashtu ka një sërë përfitimesh mjedisore, kryesisht në mbrojtjen e tokës, uljen e ndotjes, habitatit për specie e deri tek përfitimet ekonomikte të drejtpërdrejta. Bashkia Kuçovë në PPV-në e hartuar në 2016, ka hartuar një sërë projektesh të ndryshëm infrastrukturorë në territorin e bashkisë duke marrë në konsideratë të gjithë përbërësit e peizazhit dhe mbrojtjes dhe përmirësimit të tyre aty ku është e mundur. *Ndaj rekomandohet që gjatë zbatimit të projekteve nga PPV-së të merren në konsideratë të gjithë masat që janë dhënë në të për ruajtjen e peizazhit dhe përmirësimit të tij.*

- **6.3.2 Masa për mbrojtjen e biodiversitetit**

Territori i Bashkisë Kuçovë ka një biodiversitet relativisht të pasur dhe të larmishëm (shih seksionin e biodiversitetit), si nga pikëpamja faunistike ashtu edhe floristike. Megjithatë, qëndrueshmëria e biodiversitetit has në një sërë vërshtirësish, të cilat lidhen kryesisht më problemet e shkaktuara nga aktiviteti njërëzor në territor. Zhvillimi bujqësor, industrial, urban dhe ai infrastrukturor janë problemet të cilët kanë pasur ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e biodiversitetit. Hapja e tokave bujqësore (vitet e shkuara) ka çuar në tkurrje dhe fragmentim të habitateve natyrore, industria e naftës kryesisht ka patur ndikim negativ në prishjen e cilësisë së tokës dhe të ujrave duke dëmtuar biodiversitetin, zhvillimi urban dhe ai infrastrukturor ka copëtuar gjithashtu habitatet, kryesisht ai infrastrukturor (rrugë) i cili ka copëtuar konsiderueshëm habitatet, duke vështirësuar, apo penguar plotësisht vijueshmërinë e tyre. Si pasojë, shumë specie mbeten të izoluara në habitate të vogla të copëzuara.

Në këtë situatë, hartimi i PPV-së ka synuar Planifikimin e Zhvillimit të Territorit në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen e biodiversitetit në territorin e Bashkisë. Në PPV, Bashkia ka marrë disa masa specifike (ka hartuar projekte specifike) për të përmirësuar situatën e për të krijuar mundësinë për një biodiversitet sa më të qëndrueshëm. Këto masa janë përkthyer në projekte specifike të cilat synojnë shtimin e sipërfaqeve të gjelbra natyrore që shërbejnë si habitat për florën e faunën dhe rehabilitimi i zonave ripariane të lumenjve.

Në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të mëtjeshëm të biodiversitetit, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Kuçove rekomandohet:

- **Hartimi i Planit të Menaxhimit/Veprimit të Biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij në brëndësi të territorit të bashkisë**, kryesisht për zonat të cilat shihen prioritare për ruajtjen e specieve të mbrojtura. Në këtë rast, Bashkisë i nevojitet bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe institucione të tjera lokale e qëndrore (AKM, ARM Berat, etj.). Ky rekomandim vjen edhe si detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 587, datë 20.7.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit".

- **Inventarizimi i specieve dhe përditësimi i tij për territorin e bashkisë** (në bashkëpunim me Ministrine e Mjedisit dhe institucionet të tjera vendore dhe qëndrore, AKM, ARM, AKZM, ADZM). Inventarizimi përbën bazën mbi të cilën të hartohet plani i menahimit të biodiversitetit, përcaktohen zonat që spikaten për larmishmëri flore dhe faune dhe zonat që strehojnë speciet e rrezikuara. Inventarizimi i shërben Bashkisë për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit nga

ndërhyrjet e njeriut dhe nga elementet natyrore, detyrim ky që rrjedh nga Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe VKM Nr. 84, datë 27.1.2009 "Për Caktimin e kritereve për ngriten e rrjetit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit".

- **Hartimi i Planit të Mbarështimit të Fondit Kullosor,** në mënyrë që të dihet kapaciteti i teritorit për kullotje dhe të ndërmerren masa për ndalimin e kullotjes aty ku vlersohet e nevojshme.
- **Hartimi i Planit të Mbarështimit të Bimeve mjekësore dhe Aromatike,** në mënyrë që të njihet kapaciteti i lejuar i shfrytëzimit të këtyre bimeve duke ruajtur balancat e tyre (në bashkëpunim me institucionet vendore dhe qëndrore, Ministria e Mjedisit, Ministritë e linjës, ARM, AKM, etj.).
- **Bashkëpunimi me fermerët e zonës për mbarështimin dhe ruajtjen e biodiversitetit e specieve bujqësore dhe blektorale lokale dhe vendase** të cilat janë cilësuar si të rrezikuara nga lista e specieve të rrezikuara në shkallë vendi (në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Mjedisit).
- **Kontrolli i zbatimit të moratoriumit të ndalimit të gjuetisë dhe prerjeve të pyjeve** (duhet theksuar që për zbatimin e moratoriumit të pyjeve Bashkia është e ngarkuar drejtpërsëdrejti për kontrodhin dhe zbatimin e tij, ndërsa për atë të gjuetisë Bashkisë i lind detyrim nga ligji për mbrojtjen e faunës dhe ligji për mbrojtjen e biodiversitetit. Kontrolli i zbatimit të moratoriumeve, gjuetisë dhe pyjeve, kërkon:
  - Bashkëpunim me institucionet lokale dhe qëndrore për të kordinuar punën dhe për të kryer veprimtari të përbashkëta të cilat cilësohen më efikase në bashkëpunim ndërinstitucional (institucionet që duhet të lidhen ura bashkëpunimi janë Bashkitë fqinje, Ministria e Mjedisit, ARM, AKM, Policinë e shtetit, etj.)
  - Ngritjen e sistemeve të informimit në terren, në mënyrë që të raportohen në kohë dëmet dhe të dalin para përgjegjësisë shkelësit (sistemi duhet të jetë formal, krahas punonjëve të lidhen mardhënie të mira me banorët e zonës dhe kryesisht me barinjtë).
  - Hartimin e planeve të kontrollit dhe inspektimeve në terren, në mënyrë që të gjitha kontrollet të jenë të kordinuara dhe të kenë efikasitet në veprimtarinë e tyre.
  - Organizimin e fushata të ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë që ka ndalimi i gjuetisë dhe prerjes së pyjeve për një afat të paracaktuar, përkatësisht 5 vjet për ndalimin e gjuetise dhe 10 vjet për ndalimin e shfrytëzimit të pyjeve.
- **Studimi i ndikimit të industrisë së naftës në ndotjen e ujërave dhe marrja e masave për zvogëlimin e ndikimeve negative dhe shpërndarjen e ndotjes:** kjo do të sigurojë përmirësimin e cilësisë të ujrave dhe të tokës e, si rrjedhojë, garantimin e kushteve optimale për zhvillimin e biodiversitetit përrth zonës industriale dhe më gjerë. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon:
  - Rehabilitimin e zonave të ndotura nga aktivitëti i industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të naftës (zona e UPN-së dhe kanali i Dikatrës dhe zona naftë-nxjerrëse)

- Mbjelljen e pemëve në zonat ku është e mundur, përreth zonës industriale dhe në brendësi të sajë.
- Kontrollin e shkarkimeve të ujërave të ndotura industriale, gjetja e mundësisë për trajtimin e tyre dhe ndalimi i shkarkimit të tyre në trupa ujorë (në bashkëpunim me organet qëndrore e vendore, Ministritë e Linjës, ARM Berat, AKM etj.)
- Studimin e zhvillimit të fushave të reja naftënxjerrëse (pus-shpimeve) dhe marrjen e masave paraprake, në mënyrë që ndikimi të jetë sa më i ulët, ose të ndalohet zhvillimi i këtyre pus-shpimeve kur vlerësohet e tillë (Në bashkëpunim me institucionet qëndrore, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë përgjegjëse për industrinë, etj.)

- **Marrja e masave paraprake për uljen e ndikimeve negative në habitate nga ndërtimi/zgjerimi i infrastrukturës rrugore** (kryesisht rruget lidhëse të fshatrave 6-8m gjerësi). Në pikat ku vlerësohet që ndarja e habitateve krijon probleme në biodiversitetin e zonës, të ndërtohen ura/nënkalime ekologjikë për të lidhur habitatet e copëzuara. Rrugët lidhese ekzistuese dhe të propozuara në NjA Lumas dhe në të gjitha zonat natyrore të Bashkisë duhet të kenë parasysh ndërtimin e urave ekologjike pasi këto rrugë kanë ndikim të konsiderueshmëm në habitate (copëzojnë habitatet).

Tabela 102. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e biodiversitetit

Qëllimi	Masa	Projekti
Zhvillimi i qëndrueshëm i biodiversitetit	Ruajtja e diversitetit të specieve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë	- Programi për mbjelljen e fidanëve të rinj të drurëve frutorë në zonën e kodrave të qytetit të Kuçovës - Krijimi i një parku rajonal në zonën nga Rezervuari i Murrizit deri në fshatin Vlashuk - Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative te zonave ripariane të Lumit Devoll dhe Osum-Seman.
	Krijimi i parqeve rajonale	
	Krijimi i koridoreve lidhës për habitatet	

Burimi: Co-PLAN, 2016

- **Masa për mbrojtjen e pyjeve e kullotave në Bashkinë Kuçovë**

Mirëadministrimi i pyjeve dhe kullotave nga Bashkia Kuçovë, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e gjendjes aktuale në sipërfaqen e fondit pyjor e kullosor.

Me qëllim mbarështimin dhe përmirësimin e zonave pyjore e kullosore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Kuçovë ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Masat për mbarështimin e

pyjeve në territorin e Bashkisë përfshijnë krijimin e parqeve rajonale e urbane dhe rihabilitimin e zonave ripariane përgjatë gjatësive të lumenjëve në teritorin e Bashkisë.

Në funksion të mbarështimit e qëndrueshmërisë së sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Kuçove rekomandohet:

- **Inventarizimi i fondit pyjor e kullosor** në mënyrë që të dihet sipërfaqja aktuale. Siç është theksuar më parë, të dhënat zyrtare rreth fondit pyjor e kullosor janë të vitit 1984-84 kur është kryer inventari i fundit i këtij fondi.
- **Hartimi i Planit të Mbarshtimit të Pyjeve e kullotave** i cilë është detyrim ligjor për Bashkinë, që buron nga ligji nr. 9385/2005"Për pyjet dhe shërbimin pyjor". Duke qënë se në territorin e Bashkisë Kuçovë nuk njihet mirë kapacitetet që kanë kullotat për t'u shfrytëzuar, lind nevoja edhe për hartimin e Planit të Mbarështimit të Kullotave, i cili do të mundësojë njohjen e kapaciteteve të kullotjes në territorin e bashkisë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.
- **Hartimi i Planit të monitorimit & kontrollit** të pyjeve dhe kullotave me qëllim zbatimin e ligjit dhe shmangjen e demtimeve në territor.
- **Përmirësimin e infrastrukturës rrugore** të pyjeve dhe kullotave (rrugë aksesi), të cilat janë jetike për ndërhyrje në rastet e rënies së zjarrit në pyje, kryesisht ne NJA-në Lumas.
- **Zgjidhje e konflikti Pyje –Bujqësi**. Ky konflikt është theksuar vitet e fundit për shkak se pemtaria është shndërruar në sector fitimprurës për banorët. Në këtë rast rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me popullsinë, të përcaktojë se deri në cilën shkallë lejohet zhvillimi i pemtarisë në dëm të sipërfaqeve pyjore.
- **Monitorimi dhe zbatimi i moratoriumit** të shfrytëzimit të pyjeve.
- **Masa të tjera:** në sipërfaqet e fondit pyjor është e nevojshme të ndërmerren disa hapa për përmirësimin e gjendjes së pyjeve dhe kullotave. Të tilla mund të jenë:
  - Kryerja e një studimi të hollësishëm me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë shkaktuar tharjen e llojeve të bimësisë në seksione të ndryshme në territor.
  - Studim i hollësishëm për përcaktimin e mundësisë së rehabilitimit të sipërfaqeve të djegura që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale.
  - Mbajtja nën kontroll e sëmundjeve (koncesionares) dhe dëmtuesve, ku shkalla e prekjes është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm.
  - Marrja e masave për parandalimin e zjareve si krijimi i një rrjeti për njoftimin e rënies së zjarreve (barinjtë mund të luajnë një rol tejet të rëndësishëm në këtë rast), ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien përpara përgjegjësisë të gjithë kundravajtësve që shkaktojnë zjaret, etj.

Tabela 103. Projektet e planifikuara në PPV për shtimin e zonave pyjore

Qëllimi	Masa	Projektet
Marshtimi i pyje	Krijimi i parqeve rajonal	- Krijimi i një parku rajonal në zonën nga Rezervuari i Murrizit deri në fshatin Vlashuk - Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative te zonave ripariane të Lumit Devoll dhe Osum-Seman.

	Rehabilitim i zonave ripariane	- Krijimi i parqeve të vogla urbane në zona natyrore periferike të qytetit (krijimi i parkut në meandrimin e Lumit Devoll në afërsi te venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta të qytetit). - Programi për mbjelljen e pemëve dekorative në rrugët kryesore të qytetit të Kuçovës. - Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe kthimi në hapësirë të gjelbër me pemë të larta.
	Krijimi i parqeve urbane	

Burnimi: Co-PLAN, 2016

- **Masa për menaxhimin e Zonave të Mbrojtura**

Në territorin e Bashkisë Kuçovë, kryesisht në NJA Lumas, ka zona tërheqëse, sipërfaqe pyjore e ujore dhe më vlera të larta të biodiversitetit (shih seksionin e Zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit). Në NJA Lumas ndodhet edhe Kanioni i Sinecit i shpallur si Monument Natyre, edhe pse nuk është e qartë përkatësia bashkiake e zonës në të cilën ndodhet kanioni. Ky monument ka një gjatësi prej 1.5km dhe shtrihet në kufi me Bashkinë e Gramshit. Deri më sot, kjo zonë është njohur si zonë e mbrojtur e Bashkisë Gramsh. Fatkeqësisht, në mungesë të një harte në të cilën të pasqyrohen kufinjtë e kësaj zone me ligj, është e vështirë të përcakthet nëse mbas ndarjes së re administrative, pjesë të këtij monumenti i përkasin gjeografikisht edhe Bashkisë së Kuçovës.

Duke patur parasysh se Kanioni i Sinecit ka vlera të rralla biologjike, gjeologjike e peizazhistike të cilat und ta shndërrojnë këtë kanion në një burim kryesor për zhvillimin e turizmit propozohet (pranë institucioneve përkatëse AKZM, AdZM):

- Krijimi i një parku natyror të përbashkët ndërmjet Bashkive Koçovë dhe Gramsh ku të përfshihen vendburimi i Sinecit së bashku me shpellën e Xhixhilesë dhe zona të tjera piktoreske. Një gjë e tillë mundëson ruajtjen e këtij burimi dhe kanioneve të tij si dhe shfrytëzimin e tij si një pasuri kombëtare dhe vendore për zhvillimin e turizmit. Në bazë të ligjit nr. 8906/2002 "Për zonat e mbrojtura", Bashkia ka të drejtë të propozojë dhënien e statusit të mbrojtjes për zona të caktuara natyrore dhe të jetë palë gjatë shpalljes dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura në territorin e saj.
- Hartimi i një Plan Menaxhimi për zonën e mbrojtur të propozuar në bashkëpunim me ADZM Berat dhe Elbasan.
- Promovimin e vendburimit e kanioneve të Sinecit si zonë turistike që ofron mundësi argëtimi dhe shplodhjeje.
- Hartimi i një programi për ndërgjegjësimin e popullsisë së zonës rreth mbrojtjes së Kanionit të Sinecit e pasyrive të tjëra natyrore.
- Zbatimi i shkallës së mbrojtjes për Kanionin e Sinecit. Për Sinecin, në cilësinë e monumentit të natyrës, shkalla e mbrojtjes e përcaktuar me ligj është shkalla e parë. Në dy tabelat e mëposhtme tregohen emertimet, karakteristikat, zonat buferike si dhe shkalla e mbrojtjes së kësaj zone natyrore.

Gjithashtu në NjA Lumas një tjetër zonë e rëndësishme natyrore është dhe zona e kodrave përrreth rezervuarit të Belesovës kjo zonë aktualisht nuk ka status mbrojtje si zonë natyrore. Në këtë zonë propozohet pranë institucioneve përkatëse AKZM, AdZM):

- Krijimi i parkut natyror të zonave përrreth rezervuarit të Belesovës ku përfshihen rrezervuari i belesoves dhe zonat kodrinore përrreth.

- Zbatimi i shkallës së për parkun natyror të zonave përrreth rezervuarit të Belesovës. Kjo zoë mjedisore mendohet të jetë zonë e mbrojtur e kategorisë IV (Rrezervat natyror menaxhuar). Në dy tabelat e mëposhtme tregohen emertimet, karakteristikat, zonat buferike si dhe shkalla e mbrojtjes së kësaj zone natyrore.

Në NjA Kozare ndodhet një tjetër zone e cila vlersohet për natyralitetin dhe shkallën e lartë të biodiversitetit. Ky territor ndodhet në veri të fshatit Kozare dhe përfshin pjesën deri ne afersi te rrezervuarit të Murrizit ose të Thanës siç quhet ndryshe. Kjo zonë aktualisht nuk ka status mbrojtje si zonë natyrore. Në këtë zonë propozohet pranë institucioneve përkatëse AKZM, AdZM):

- Krijimi i parkut natyror rajonal i kodrave të Kozares ku përfshihet territori nga Rezervuari i Murrizit në veri deri në afërsi të fshatit Kozare në jug.
- Zbatimi i shkallës së mbrojtjes për parkun natyror rajonal të kodrave të Kozares. Kjo zonë mjedisore mendohet të jetë zonë e mbrojtur e kategorisë së VI (Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara). Në dy tabelat e mëposhtme tregohen emertimet, karakteristikat, zonat buferike si dhe shkalla e mbrojtjes së kësaj zone natyrore.

Tabela 104. Kategoritë e zonave të mbrojtura të propozuara në Bashkië Kuçovë sipas karakteristikave

Kategoria	Emërtimi	Karakteristikat	Zuna buferike në metra	Shkalla e mbrojtjes
Kategoria III	Monument natyror	Monumenti Natyror përfaqëson një formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralesh ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror[364].	-	Shkalla e parë (i)
Kategoria IV	Rezervat natyror i manaxhuar/ Park Natyror	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i manaxhuar (zonë e manaxhimit të habitateve dhe llojeve).	50	Shkalla e tretë (iii)
Kategoria VI	Zonë e mbrojtur e burimeve të manaxhuara /zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht, të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të manaxhuara.	50	Shkalla e katërt (iv)

Burimi: Ligji Nr 8906/.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868/2008

Tabela 105. Shkalla e mbrojtjes dhe domethënia (veprimtaritë e ndaluara)

Kategoria	Shkalla e mbrojtjes	Veprimtaritë e ndaluara

Kategoria III	Shkalla e parë (i)	Aktivitetet që janë të ndaluara: a) prerja e drurëve dhe e shkurreve; b) përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike; c) ndërtime të çdo lloji; ç) nxjerrja e mineraleve dhe e torfave; gjuetia dhe peshkimi; dh) ndezja e zjarreve; . e) kullotja, kalimi i kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i objekteve për mbajtjen e tyre; ë) ngritja e objekteve çlodhëse, argëtuese dhe sportive; f) kalimi nëpër shtigje, me përjashtim të pronarit ose të përdoruesit të tokës; g) lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve; gj) vozitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi; h) riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut.
Kategoria IV	Shkalla e tretë (iii)	**Aktivitetet që ndalohen me ligj në këto zona:** a) ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura; b) depozitimi i kimikateve; c) lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim; ç) mbledhja e bimëve, mineraleve, gjetjeve poleontologjike dhe e gurëve; d) ngritja dhe funksionimi i objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje. dh) vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit; e) ngjitjet alpine, skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave të caktuara. **Veprimtaritë e lejuara me leje mjedisi** 3. Veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji dhe çdo veprimtari tjetër, që nuk ndalohet nga ky nen, mund të ushtrohen, pasi të pajisen me leje mjedisi.
Kategoria VI	Shkalla e katërt (iv)	**Aktivitetet që ndalohen me ligj në këto zona:** a) mbjellja e pyjeve monokulturë; b) neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara; c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase; ç) gjuetia me ushqime të helmuara; d) ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane; dh) lëvizja me mjete trasporti jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara. Ky rregull nuk zbatohet për automjetet dhe makineritë shtetërore, bujqësore e pyjore, të zjarrfikësve, autoambulancave, makinerive të shërbimeve veterinare dhe atyre të menaxhimit të ujërave; e) organizimi i garave me automjete, motoçikleta e biçikleta. **Veprimtaritë e lejuara me leje mjedisi** Veprimtaritë që ndryshojnë përdorimin e territorit, ndërtimet, përdorimi i kimikateve e pesticideve, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, për zona më të mëdha se 2 ha dhe veprimtaritë e tjera, që nuk ndalohen shprehimisht nga pika 2 e këtij neni, mund të ushtrohen vetëm pasi të jenë pajisur me leje mjedisi dhe të miratohen në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

Burimi: Ligjin nr.9868, datë 4.2.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura"

2.3.3 Mbrojtja e sistemit ujor

- **Masat mbrojtëse për burimet ujore sipërfaqësore**

Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore është detyrim ligjor për Bashkinë i cili rrjedh kryesisht nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për ruajtjen e mjedisit dhe ofrimin e një mjedisi cilësor për qytetarët në territorin e saj si dhe Ligji nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore". Krahas tyre, detyrimet rrjedhin edhe nga ligje të tjera që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo të përbërësve specifikë të tij.

Nga analiza e thelluar e territorit ka rezultuar se lumenjtë Osum, Devoll, Seman dhe Lapardha së bashku me degët e tyre kanë pësuar dëmtime të shumta brenda territorit të Bashkisë së re të Kuçovës, (shih seksionin e Ujërave Sipërfaqësore) në 20 vitet e fundit. Dëmtimat kanë të bëjnë me hidro-morfologjinë e lumenjve, dëmtime në florë e faunë dhe ndotje të ujërave të tyre. Burimet kryesore të ndotjes kanë rezultuar fusha e depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane në brigjet e lumit Devoll që ka shkarkuar ndotjen e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore nëpërmjet rrjedhjes së shllamit në ujërat e lumit Devoll dhe depërtimit të tij në shtresat e tokës deri në Akuiferin Kuaternar të Beratit; shkarkimi i ujërave të ndotura urbane dhe industriale (kryesisht ujrat e industrisë së naftës) drejtpërsëdrejti në lumin Devoll në mungesë të impianteve përkatëse të trajtimit të ujërave të ndotura.

Me qëllim mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore, në kuadër të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kuçovë ka hartuar disa projekte specifike të cilat përqendrohen në *përmirësimin e hidro-morfoligjisë së lumenve të Basenit të Semanit* (Devoll, Lapardha, dhe degët e tyre), *mbrojten e burimeve ujore nga ndotja e shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve* në të shkuarën si dhe *uljen e ndotjes nga industria e naftës*. Projektet janë kryesisht me fokus, i) rehabilitimin mjedisor dhe kthimin në zona për argëtim të zonave ripariane të Lumenjve Devoll e Lumbardhë, ii) hartimin e Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve sipas ligjit Nr. 10463, datë 229.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" Neni 12. Në plan përfshihen propozime për *ndërtimin e në venddepozitimi të mbetjeve urbane* (Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 23), ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërav të zeza, dhe krijimin e një sistemi për mbledhjen dhe ripërdorimin e ujërave të bardha, si dhe kryerjen e një studimi të thellë rreth ndikimit të industrisë së naftës në ujëra dhe tokë ndër vite. Krahas masave të propozuara në PPV, rekomandohet edhe marrja e masave që janë:

Monitorimi i menjëhershëm i Lumit Devoll, Osum dhe Seman: gjatë fazës së monitorimit të ujërave të lumit Devoll, ka rezultuar se ujërat janë të ndotur me metale të rënda si Pb, Cd, Ni, Mn, Fe, Cu, Cr. Duke patur parasysh se ujërat e lumenjve në përgjithësi përdoren për ujitje të kulturave bujqësore, dhe herë herë edhe për peshkim, dhe se metalet e pranishme në lumin Devoll si Pb e Cd janë kancerogjenë, është e rëndësishme që të merren masa për monitorimin e thellë të lumenjve për një kohë prej të paktën dy-vjeçare në mënyrë që të përcaktohet nëse:

- Ujërat e lumit Devoll mund të përdoren për ujitje pa cënuar shëndetin e banorëve dhe konsumatorëve,
- Banorët e zonave në afërsi të lumit mund të peshkojnë dhe të konsumojnë peshkun e zënë në ujërat e lumit Devoll pa cënuar shëndetin e tyre

Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të inerteve lumore në Osum e Devoll: Lumenjtë e Basenit të Semanit janë shfrytëzuar për inerteve në rrjedhën e mesme dhe të poshtme. Me

qëllim mbrojtjen e lumit, ruajtjen e cilësisë së ujërave të tij dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Këshillin e Basenit Ujor të Semanit:

- Të ndalojë urgjentisht shfrytëzimin e inerteve lumore, kryesisht në fillimin e hyrjes së lumenjëve Devoll e Osum në territorin e Bashkisë dhe në lumin e Lapardhasë përgjatë aksit në NJA-së Lumas, ku është vënë re shfrytëzim itensiv i inerteve lumore. (në bashkëpunim me ABU Seman, ARM Fier, dhe Ministrinë e Mjedisit). Bazuar në VKM Nr.1, datë 21.6.2006 "Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve", Bashkisë së Kuçovës i rekomandohet që *për shfrytëzimn e zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve të japë leje vetëm në rastet kur ka depozitime të mjaftueshme dhe vetëm në segmente të caktuara*. Pra, Marrja e inerteve, në rastet kur është e pashmangshme për arsye ekonomike, *të shoqërohet me studime specifike të posaçme për çdo rast* me qëllim shmangien e dëmtimit të trupit lumor. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka kryer studime të hollësishme rreth shfrytëzimit të inerteve të lumenjve dhe ndikimit të tyre në mjedis. Për këtë arsye, rekomandohet *bashkëpunimi me SHGJSH për shqyrtimin e çdo lejeje*,
- Të largojë menjëherë impiantet e prodhimit të inerteve nga siperfaqet e shtratit apo terracës së shtratit të Devollit dhe Osumit në segmentin e lumit që shërben si dritare hidrogjeologjike,
- Të rehabilitojë shtratin e lumit në zonat e dëmtuara përgjat lumit të Lapardhasë, në NJA-në Lumas dhe përgjatë lumit Devoll e Osum (Ndërtimin e pritave anësore e tërthore me qëllim shmangien e erozionit të brigjeve, mbrojtjen e urave, pastrimin e brigjeve të lumit të mbushura me inerte, krijimin e pyjeve artificiale në terracën e shtratit apo në terracën e parë me qëllim shmangien ose uljen e veprimtarisë gërryese të rrjedhës).[365]

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme: Bashkia Kuçovë nuk ka një plan për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Si rrjedhojë, menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme shtëpiake që është kompetencë e bashkisë mbetet ende një sfidë. Me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e ujërave të lumienjve në Bashkinë Kuçovë nga ndotja e shkaktuar nga mbetjet e rrezikshme, rekomandohet hartimi i një plani bashkiak për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Më konkretisht rekomandohet që:

- Për mbetjet e rrezikshme industriale (të krijuara nga operatorët e pajisur me leje mjedisi A dhe B): të bashkëpunojë me institucionet e linjës për menaxhimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve të rrezikshme, të cilat ndodhen apo krijohen brenda territorit të bashkisë.
- Për mbetjet e rrezikshme shtëpiake dhe atë të krijuara nga opëratorët e pajisur me leje mjedisi të tipit C: të hartojë një Plan Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Shtëpiake ku të përcaktojë mënyrat e mundshme të trajtimit të tyre dhe një venddepozitim përfundimtar.
- Për mbetjet e rrezikshme spitalore: të hartojë një plan për përcaktimin dhe miratimin e venddepozitimit të mbetjeve spitalore jo të rrezikshme dhe të monitorojë administrimin e mbetjeve sipas kopetencave të saj.
- Riciklimi i mbetjeve: Të hartojë një plan për riciklimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve të riciklueshme: Planet dhe projektet që do të hartohen / zhvillohen në funksion të menaxhimit të mbetjeve industriale, nevojitet që të marrin në

konsideratë edhe mundësinë e zvogëlimit të sasisë së krijuar të mbetjeve që në burim dhe uljen e mundësisë së ndotjes së mjedisit nga industria.

Kontrolli i shkarkimeve industriale në ujë: Në këtë konteks rekomandohet që Bashkia:

- të hartojë plane për kontrollin e zbatueshmërisë së Lejeve të Mjedisit (në bashkëpunim me ARM Berat, AKM) për subjekete që shkarkojnë mbetje të cilat dëmtojnë cilësinë e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor, kryesisht subjektet e industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve në territorin e saj. Zbatimi i këtyre masave rrjedh si detyrim ligjor për Bashkinë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligje të tjera për mbrojtjen e mjedisit dhe specifikisht për mbrojtjen dhe menaxhimin e ujrave.

Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikat e Mira Bujqësore: Problem në burimet ujore përbëjnë dhe infiltrimet e kimikateve dhe pesticideve që përdoren në bujqësi. Rekomandohet që bashkia të hartojë një Plan Veprimi për Praktikat bujqësore që duhet të ndiqen në mënyrë që të minimizohen përdorimet e këtyre kimikateve.

Hartimi dhe zbatimi i një plani vendor dhe një plani ndërbashkiak për menaxhimin e lumit Devoll: Devolli është lumë që përshkon territorin e bashkive të ndryshme. Si rrjedhojë, mbrojtja e tij kërkon bashkërendimin e përpjekjeve të të gjitha bashkive përkatëse dhe me Agjencinë e Basenit Ujor (ABU Seman) të Semanit. Bashkëpunimi mund të kryhet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve e planeve ndërbashkiake për hartimin e Planit të Menaxhimit të Devollit. Ky plan duhet të përcaktojë angazhimet përkatëse për çdo bashki në fushat e mëposhtme:

- përdorimin e qëndrueshëm të ujërave të lumit Devoll nga të gjitha bashkitë (bashkëpunim në dhënien e lejeve për shfrytëzimin e ujit për qëllime të ndryshme si për pije, bujqësi, industri, etj.) pa penalizuar bashkitë në rrjedhën e mesme e të poshtme të lumit,
- kordinim për ruajtjen e mirëmbajtjen e lumit (pastrimin e shtratit të lumenjve, krijimin e fashës së gjelbërt, ndalimin e shfrytëzimit të inerteve në lumë),
- parandalimin e ndotjes së lumenjve në çdo bashki (ndalimin e hedhjes së mbetjeve në lumë/burime ujore sipërfaqësore) në mënyrë që bashkitë në rrjedhën e poshtme të mos marrin të gjitha ujërat e ndotura të bashkive në rrjedhën e sipërme dhe të mesme;
- përcaktimin e pasojave që ndërtimi i HEC-eve në degët e Devollit mund të ketë në cilësinë e ujit të lumenjve, në prurje, biodiversitet dhe deri në plazhe.
- pyllëzimin e pellgut ujëmbledhës të lumit Devoll e degëve të tij me qëllim shmangien e përmbytjeve dhe erozionit;
- përcaktimin dhe mbrojtjen e segmenteve të Devollit (dritareve hidrogjeologjike) që ushqejnë me ujë akuiferët përgjatë tij në mënyrë që të shmanget ndotja e ujërave nëntokësore

Ndërgjegjësimi i qytetarëve rreth mbrojtjes së mjedisit ujor: rekomandohet që Bashkia të ndërtojë një program ndërgjegjësimi të popullsisë për rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore ku të vihet theksi tek mospërdorimi i lumenjve si vende të depozitimit të mbetjeve, etj.

Shtimi i numrit të stacioneve të monitorimit të lumenjve, i shpeshtësisë së monitorimit dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktiviteteve ekonomike (industriale, bujqësore,

etj.) të pranishme në territor. Devolli dhe Osumi përshkruajnë territore të gjera me aktivitetet të ndryshme bujqësore dhe industriale. Për fat të keq, këta lumenj monitorohen nga një numër i kufizuar stacionesh monitorimi[366]. Duke parë rëndësinë që kanë për bujqësinë dhe si burim ushqyes për Akuiferin e Beratit, rekomandohet:

- Monitorimin mujor ose mundësisht ditor të cilësisë së ujërave të lumenjve Devoll, Seman e Osum nga ARM Berat gjatë gjithë vitit. Monitorimi i lumenjve deri më tani kryhet nga AKM. Është e udhës që monitorimet të kryhen edhe nga ARM Berat. Duke qenë e pranishme në territor, ARM Berat arrin të monitorojë ujërat e lumenjve Devoll e Osum në kohën e duhur edhe në rastet kur ka derdhje të rastësishme abuzive të lëndëve të ndryshme në lumë. Për këtë asye, rekomandohet që të ngarkohet ARM Berat me përgjegjësinë e monitorimit të herëpashershëm të lumit sipas një Plani Monitorimi Vendor të tij duke e pajisur atë me një laborator teknik të akredituar për kryerjen e analizave të ujit.
- Shtimin e stacioneve të reja të monitorimit të lumenjve në zonat më problematike (në afërsi të zonave më të banuara, në zonën naftënxjerrëse, etj.). Për këtë nevojitet bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencinë Rajonale Berat.
- Shtimin e parametrave të monitoruara dhe përshtatjen e parametrave që monitorohen me aktivitetin industrial të pranishëm në territor . Në bashkitë si Kuçova ku industria e naftës është mjaft aktive, nevojitet monitorimi i ujërave nga kjo industri. Sot, përveç përcaktimit të ndotjes, është e rëndësishme që të përcaktohet edhe burimi i ndotjes. Vetëm në këtë mënyrë mundësohet zbatimi i arimit "ndotësi paguan"

Tabela 106. Projektet e propozuara në PPV për mbrojtjen e lumenjve

Qëllimi	Masa	Projekti
Përmirësime në hidro-morfoligjinë e lumit	Krijimi i zonave ripariane Mbrojtja e brigjeve të lumenjve nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturave të ndryshme Ndërtimi /pastrimi i digave për administrimin efiçent të ujit	- Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative i zonave ripariane të Lumit Devoll e Lapardha, - Pastrim digash për mbrojtjen nga përmbytjet dhe shtimin e vëllimit të rezervuarëve me qëllim grumbullimin e sasive më të mëdha të ujit gjatë shirave të rrëmbyeshëm, - Rikonstruktimi i digës së Rezervuarit të Belesovës, - Ndërtimi i digave në Rrerrak për parandalimin e përmbytjeve nga rezervuari i Belesovës, - Realizimi i masave infrastrukturore dhe vegjetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga Lumenjtë Devoll dhe Osum.
Mbrojten e burimeve ujore nga ndotja nga mbetjet e ngurta e të lëngta	Menaxhimi i integruar i mbetjeve	- Hartimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në nivel bashkie, me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane, - Hartimi i Strategjisë për Kompostim të Mbetjeve Organike. - Përmirësimi tërësor i sistemit të kanalizimeve, duke ndarë ujërat e bardha nga të zeza në qytet, e duke siguruar mbulim me rrjet për gjithë Bashkinë, - Rehabilitimi i sistemit të gropave septike në fshatrat që nuk kanë akses në rrjetin e kanalizimeve, - Ndërtimi i një impianti të trajtimit të ujërave të zeza dhe ndërtimi i tubacionit kryesor paralel me kanalin e Dikatrës,

		- Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe kthimi në hapësirë të gjelbër me pemë të larta - Ndërtimi i një landfilli sanitar për depozitimin e mbetjeve urbane.
Ulja e ndotjes nga nafta	Studime rreth ndikimit të sektorit të naftës në mjedis	- Kryerja e një studimi të integruar për vlerësimin e ndotjes nga nafta në tokë, ajër, ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore

Burnimi: Co-PLAN, 2016

- **Masa për mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore (akuiferët)**

Bashkia e Kuçovës është e pasur me ujëra nëntokësore ku dallojmë akuferët ndërkokrrizorë që përkojnë me luginën e Osumit dhe Devollit (Akuiferi Karstik i Beratit) dhe akuiferët me porozitet me çarje-karst (Masivi karstik i Luzajt në Kuçovë) me shtrirje të gjerë në territorin e Bashkisë. Duke u mbështetur në studimet e kryera nga SHGJSH rreth problematikave të ndryshme të akuiferëve në Qarkun e Beratit[367], lind nevoja të merren disa masa të rëndësishme për mbrojtjen e tyre. Disa nga këto masa renditen më poshtë

Mbrojtja e shëndetit të popullsisë

Ndalimi i menjëhershëm i furnizimit me ujë të popullsisë nga Akuiferi i Beratit: ky akuifer është përdorur për një kohë të gjatë nga industria e naftës. Në këtë akuifer kalojnë edhe një numër pusesh të cilët kanë edhe teknologji të vjetër gjë që në një farë mënyre tregon se puset nuk janë izoluar mirë (Në SHBA kur pus-shpimet e naftës bëhen në trupin e akuiferit nuk lejohet përdorimi i tij për ujë të pishëm). Si rrjedhojë, për aq kohë sa nuk ka studime të thella për ndikimin e industrisë së naftës në cilësinë e ujërave të këtij akuiferi, rekomandohet me forcë që ujërat e Akuiferit të Beratit të mos përdoren për furnizimin me ujë të popullsisë së Bashkisë së Kuçovë (e Beratit).

Sipas SHGJSH-s, ujërat e pijshmë që merren nga zonat *Çiflig-Arrëzës-Fier Shegan* janë të sigurta për vetitë fiziko-kimike të mira të ujit. Megjithatë, e ritheksojmë se ujërat e Akuiferit të Beratit (nga ku mund të marrin zonat *Çiflig-Arrëzës-Fier Shegan)* nuk duhen përdorur për furnizimin me ujë të popullsisë për aq kohë sa nuk janë kryer studimeve të thelluara që përcaktojnë cilësinë e ujërave të akuiferit.

Monitorimi në mënyrë urgjente i Akuiferit të Beratit për ndotje nga nafta (naftë bruto, gasoline, dhe aditivë të gasolinës). Monitorimi duhet të ketë si qëllim të përcaktojë llojin e përdorimit të ujërave të Akuiferit të Beratit (nëse ujërat e këtij Akuiferi mund të përdoren për furnizim me ujë të popullsive të Bashkive Kuçovë e Berat). Deri më sot, aktiviteti i naftës në zonën e Kuçovës ka ndotur ujërat sipërfaqësorë (ujërat e Devollit dhe ujërat e kanaleve të vogla), tokën dhe ajrin,[368] si dhe disa burime ujore nëntokësore si Burimin e Gazit dhe Burimin e Skurrajve në Kuçovë të cilët përdoreshin për ujë të pijshëm[369]. Duke patur parasysh se ujërat e lumit Devoll në hyrje të Kozarës furnizojnë me ujë Akuiferin e Beratit, dhe se në këtë zonë ndodhen puse nafte të cilët në të shkuarën kanë përdorur teknologji të vjetër, llogjikisht rrjedh se Akuiferi i Beratit është ndotur nga industria e naftës me hidrokarbure në çdo rast që puset e naftës nuk janë izoluar (veshjet anësore të puseve) në mënyrë të tillë që të mos lejojnë rrjedhjen e produkteve të naftës në tokë e ujë. Për këtë arsye, lind domosdoshmërisht nevoja e monitorimit të ujërave të Akuiferit poroz të Beratit për ndotje nga nafta dhe përcaktimi i përdorimit të ujit (si ujë për industrinë, për popullsinë, për bujqësinë, etj.). Nevoja është urgjente edhe për faktin se

ujërat e Akuiferit të Beratit përdoren për furnizimin me ujë të popullsisë së disa fshatrave në Kuçovë dhe të disa zonave të tjera në Bashkinë e Beratit.

Zbatimi dhe mbrojtja e zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve (legale/ilegale): Në Bashkinë e re të Kuçovës, pus-shpimet janë shërndarë përgjatë brigjeve të Devollit dhe të pellgjeve të tyre ujëmbledhëse përkatëse në zona me përdorim të ndryshëm toke (bujqësor dhe industrial). Nga studimet e kryera[370], mungesa e zbatimit të zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve është përcaktuar si një ndër shkaqet kryesore që çojnë në ndotjen e akuiferëve. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia e Kuçovës:

- Të krijojë një regjistër ku të regjistrohen pus-shpimet legale dhe ilegale në territor dhe vendodhja e tyre me qëllim përcaktimin e cilësisë së këtyre ujrave dhe gjetjen e mundësisë për shmangjen e konflikteve më veprimtaritë e tjera (nafta, bujqësia, urbanizimi) që shkaktojnë ndotje në to. Pus-shimet duhen klasifikuar sipas nivelit të rrezikshmërisë që ato paraqesin për ndotjen e ujërave nëntokësore. Kjo ndihmon për inspektimin e tyre të tyre të herë pas hershëm.
- Të krijojë dhe mbrojë zonat higjeno-sanitare përreth të gjitha pus-shpimeve në zbatim të Ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" dhe VKM nr.145, datë 26.2.1998 " Për miratimin e rregullores higjeniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm".
- Të ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura industriale në Devoll dhe Osum

Krijimi i zonave të mbrojtura me status të veçantë (Dritaret hidrogjeologjike): Në disa zona të bashkisë, ujërat sipërfaqësorë (ujërat e lumenjve Devoll dhe Osum) kanë lidhje të mira hidrologjike me ujërat nëntokësore. Në Akuiferin e Beratit, këto zona shtrihen në territorin e bashkive Kuçovë e Berat. Në Kuçovë shtrihet kryesisht në hyrje të lumit Devoll në Kozarë, ndërsa në Berat shtrihet kryesisht në luginën e lumit Osum nga Uznova deri në Moravë. Si rrjedhojë, lind nevoja që në ato zona ku ujërat sipërfaqësorë të lumenjve (Osum, Seman e Devoll) ushqejnë akuiferët, të krijohen zona të mbrojtura me status të veçantë (Dritare Hidrogjeologjike).[371] Të tilla zona janë të rëndësishme për mbrojtjen e akuiferëve nga ndotja dhe duhen konsideruar si Zona të Mbrojtura gjatë planifikimit të zhvillimit të territorit në Bashki. Në zonat me status Dritare Hidrogjeologjike rekomandohet që toka të përdoret për aktivitetet që nuk shkaktojnë ndotje në mjedis. Si hapa të parë në Bashkinë e Kuçovës, rekomandohet:

- dhënia e statusit "Zonë e Mbrojtur me Status të Veçantë" për zonat që shërbejnë si Dritare Hidrogjeologjike (ato zona të territorit që ushqejnë akuiferët). Përgjatë luginës së Osumit, një zonë e tillë është zona nga ***Uznova deri në Moravë***[372]. Pergjatë Devollit është zonë ***në hyrje të lumit Devoll në zonën e Kozarës***. Këto janë zonat ku ujërat e Osumit, Semanit e Devollit ushqejnë Akuiferin e Beratit. Në luginën e lumenjve të basenit të Semanit, për përcaktimin e dritareve hidrogjeologjike nevojitet bashkëpunimi me SHGJSH-në.
- Në zonat e quajtura dritare hidrogjeologjike, të ndalohet dhënia e lejeve për pus-shpime/aktivitete ndotëse[373] ose të ndërpritet leja e aktiviteteve aktuale që shkaktojnë ndotje në mjedis. Rekomandohet që të vendosen kushte të rrepta që garantojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore gjatë dhënies së lejeve për aktivitete të ndryshme në këto zona.

- Në zonat me status Dritare Hidrogjeologjike rekomandohet që toka të përdoret për aktivitetet që nuk shkaktojnë ndotje në mjedis

Ndalimi i dhënies së lejeve të shfrytëzimit për inertet lumore në zona të ndjeshme ndaj ndotjes: rekomandohet ndalimi i dhënies së lejeve të shfrytëzimit të inerteve lumore në zonat e ndjeshme, me qëllim ruajtjen e ekulibrave hidrodinamikë të akuiferëve, në bashkëpunim me Këshilllin dhe Agjensinë e Baseneve Ujor të Semanit (zonë e ndjeshme ndodhet në hyrje të lumit Devoll në NJA Kozarë). Ky rekomandim vjen edhe në zbatim të VKM Nr.1, datë 21.6.2006 "Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve",

Shtimi i pikave të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktivitetetve ekonomike në zonë: AKM në bashkëpunim me SHGJSH monitoron gjendjen e burimeve ujore nëntokësore rregullisht me bazë vjetore[374]. Megjithatë, vihet re se numri i pikave të monitorimit për përcaktimin e cilësisë së ujërave nëntokësore në çdo basen e akuifer është i ulët, ndërkohë që zonat me ndjeshmëri të lartë ndotjeje janë të larta, veçanërisht në akuiferët e Basenit të Semanit. Pikat më problematike që përkojnë me shtrirjen e lumit Osum brenda territorit të Bashkisë Berat janë Uznovë-Moravë ndërsa në territorin e Bashkisë Kuçovë, zona më e ndjeshme ndaj ndotjes përkon me lumin Devoll në hyrje të Kozarës. Me qëllim monitorimin e hollësishëm të cilësisë së ujërave të akuiferëve të Qarkut Berat, rekomandohet shtimi i pikave të monitorimit të akuiferëve dhe shtimi i parametrave të monitoruar. Në Bashkitë si Kuçova rekomandohet monitorimi i parametrave që tregojnë edhe ndotjen nga nafta.

Marrja e masave për mbrojtjen e akuiferëve nga Industria e naftës: Në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, nevojitet një direktivë ose një program specifik që trajton mbrojtjen e akuiferëve që shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë nga ndotja industriale, sidmomos nga industria e naftës, nxjerrja e mineraleve dhe prodhimi i energjisë gjotermale. Siç ndodh në vendet më të shvilluara si SHBA[375], direktiva/programi duhet:

- Të përcaktojë nëse lejohet shpimi i puseve të naftës në akuiferë që përdoren për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm. Të përcakton zona të ndjeshme ndaj ndotjes në të cilat duhen shmangur aktivitetet ekonomike që shkaktojnë ndotje (mundësisht aktivitete industriale që pajisen me leje mjedisore A dhe B). Është me rëndësi të përcaktohet edhe largësia nga akuiferi (një zonë mbrojtjeje) brenda së cilës nuk lejohet shpimi i puseve industriale.
- Të hartojë një program për mbrojtjen e akuiferëve nga veprimtaria industriale dhe e naftës. Ky program duhet:
    - Të përcaktojë akuiferët që duhen ruajtur (ku përjashtohet çfarëdolloj veprimtarie industriale) sepse me rëndësi jetike për furnizimin me ujë të popullsisë. Këto akuiferë nuk mund të preken nga pus-shpime të ndryshme industriale
    - Të përcaktojë akuiferët ujërat e të cilëve janë tashmë të ndotur dhe mund të përdoren vetëm për qëllime industriale
    - Të përcaktojë trupat ujorë nëntokësorë të cekët dhe të thellë ujërat e të cilave lejohet të shfrytëzohen nga industria në përgjithësi dhe industria e

naftës në veçanti si dhe të caktohet quota e lejuar për shfrytëzim me qëllim që të shmangen rënie të nivelit të sipërfaqes së tokës.

- Të përcaktohet nëse lejohet ri-injektimi (venddepozitimi) i ujërave të përdorura e të ndotura të industrisë së naftës
- Në qoftë se lejohet ri-injektimi, të përcaktohen zonat ku ri-injektimi lejohet me ligj dhe zonat në të cilat ërjashtohen. Gjithashtu, në këtë rast, nevojitet që të përcaktohen me ligj kushtet teknike nën të cilat mund të kryhet ri-injektimi.
- Të përcaktohen standardet që kompanitë e naftës duhet të zbatojnë për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e puseve të ri-injektimit
- Të përcaktohen me ligj institucionet përgjegjëse për rregullimin e veprimtarisë së ri-injektimit në vend.

Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikat e Mira Bujqësore: Problem në burimet ujore përbëjnë dhe infiltrimet e kimikateve dhe pesticideve që përdoren në bujqësi. Rekomandohet që bashkia të hartojë një Plan Veprimi për Praktikat bujqësore që duhet të ndiqen në mënyrë që të minimizohen përdorimet e këtyre kimikateve.

Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve ujore të akuiferëve

Pajisja me një pasqyrë të rezervave vjetore të ujërave nëntokësore në akuiferë. Pasqyra të kihet parasysh gjatë dhënies së lejeve për shfrytëzimin e ujërave të akuiferëve me qëllim shfrytëzimin e qëndrueshëm të akuiferëve.[376] Rritja e kërkesës për ujë për nevoja familjare dhe veprimtari të ndryshme ekonomike ka rritur trysninë mbi akuiferët, në veçanti mbi Akuiferin e Beratit, duke çuar në mbishfrytëzimin e tyre. Në periudhën me reshje të pakta në verë (qershor-shtator), kërkesa për ujë rritet edhe më tej nga sektori i turizmit e bujqësisë. Në këtë periudhë, akuiferët kanë nivelin më të ulët të ujit në krahasim me periudhat e tjera të vitit për shkak të mungesës së shirave. Rol kryesor në menaxhimin e akuiferëve kanë SHGJSH-ja, Agjencia e Menaxhimit të Basenit të Semanit (ABU Seman) së bashku me Bashkinë e Kuçovës dhe bashkitë e tjera përkatëse që shfrytëzojnë akuiferët. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujorë rrjedh si pasojë e zbatimit të ligjit nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"

Të analizohen akuiferët në thellësi mbi 200m: deri më sot, SHGJSH ka kryer studime përreth akuiferëve të cekët (nën 200m thellësi). Duke qenë se industria e naftës dhe industria në përgjithësi shfrytëzon edhe ujërat e akuiferëve në thellësi mbi 200m, lipset që këto akuiferë të pasqyrohen në inventarin e burimeve ujore në mënyrë që të përcaktohet ndikimi i industrisë në këto akuiferë dhe pasojat që mbishfrytëzimi i tyre mund të ketë në supërfaqe (ulje të nivelit të tokës).

Monitorimi i sasisë së ujit që shfrytëzohet nga akuiferët në Qarkun Berat e Bashkitë e tij: Sipas ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", Bashkisë së Kuçovës në bashkëpunim me AKM, ARM dhe Këshillin dhe Agjensinë e Basenit Ujor të Semanit i del për detyrë të mbikqyrin dhe të detyrojnë subjektet dhe individët të instalojnë pajisje për mbajtjen nën kontrroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private për të eleminuar lidhjet e paligjshme dhë shfrytëzimin e pakontrrolluar të akuferit ujëmbajtës. Kjo do të sillte një mirëmenaxhim të burimeve ujore dhe, përsa i përket Akuferit të Beratit, Bashkia do të kishte informacion më të saktë për përdorimin e tij.

2.3.4 Cilësia e ajrit

Mbrojtja e cilësisë së ajrit është detyrim ligjor për Bashkinë i cili rrjedh nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 26, pika 1. Ky ligj ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për të ofruar një mjedis cilësor për qytetarët në territorin e saj. Ligji 162/2014 "Për mbrojtjen e silësisë së ajrit në mjedis" është ligji kryesor që ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë specifike të përmirësimit të cilësisë së ajrit së bashku me ligje të tjera që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo përbërësve specifikë të tij.

Gjatë analizës së thelluar të gjendjes së mjedisit në territor, është vënë re se cilësia e ajrit në Bashkinë Kuçovë nuk është e mirë, kryesisht në zonat naftënxjerrëse. Burimet e ndotësve të cilësisë së ajrit në Bashkinë Kuçovë janë kryesisht industria e naftës, mjetet e transportit (në zonat urbane), cilësia jo e mirë e naftës së përdorur nga mjetet e transportit, si dhe sektorë të tjerë të ekonomisë si ndërtimet. Në analizë u vu re edhe mungesa e një monitorimi të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit gjatë gjithë vitit (monitorimi në një numër shumë të kufizuar ditësh gjatë vitit dhe mungesa e një rrjeti monitorimi me pajisje fikse në pika të caktuara në Bashki për monitorimin e përhershëm ose ditor të cilësisë së ajrit).

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Kuçovë ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor të cilat parashikojnë uljen e ndotjes nga mjetet e trasnportit. Këto projekte parashikojnë uljen e numrit të makinave në qarkullim nëpërmjet fuqizimit të transportit publik dhe nxitjes së transportit alternativë (siç është transporti me biçikleta), dhe uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytet, hartimin e planeve për uljen e shkarkimeve në ajër nga industria e rëndë, si dhe planifikimin efiçent të territorit.

Krahas masave të mësipërme të propozuara në PPV, rekomandohet marrja e disa masave të cilat synojnë uljen e ndotjes në burim. Duhet theksuar se lidhur me ndotjen nga sektori i naftës, rekomandohet që popullsia në të ardhmen të lëvizë në zonën kodrinore të qytetit ku shkarkimet në ajër nga kjo industri ndihen më pak. Megjithatë, për aq kohë sa popullsi vazhdon të bashkëjetojë me puset e naftës, rekomandohet:

Duke patur parasysh që në territorin e Bashkisë Kuçove vepron industria e naftës e cila shkarkon në ajër një numër të lartë ndotësish, lind nevoja që Bashkia të ndërmarrë disa masa konkrete të cilat janë renditur më poshtë:

- Hartimi i një plani për uljen e ndotjes së ajrit nga nafta. Nevojitet që pushteti qendror, pushteti loka (Bashki) dhe përfaqësues të industrisë së naftës të identifikojnë praktikat dhe teknikat më të mira të mundshme që mund të zbutin ndotjen e ajrit nga kjo industri.
- të shihohet bashkëfinancimi Bashki - Pushtet – Industri Nafte për zbatimin e planit për uljen e ndotjes së ajrit nga nafta. Në bazë të parimit "ndotësi paguan", është detyrë e kompanisë së naftës që të financojë futjen e teknikave më të mira të mundshmepër uljen e ndotjes së shkarkimeve në ajër në zonën e operimit. Megjithatë, me qëllim që mungesa e kapacitetit financiar të kompanisë së naftës që operon në Kuçovë për të financuar ndryshimin e teknologjisë të mos penalizojë popullsinë vendase, rekomandohet që të shokohet edhe mundësia e bashkëfinancimit shtet – kompani nafte. ndotja e naftës duhet parandluar që në

burim. Në të kundërt, asnjë masë tjetër nuk do të ketë efektin e duhur për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Bashkinë Kuçovë.

- Hartimin e Planit të Veprimit Afatshkurtër për PM_{10}, NO_2 dhe Benzenin, në zbatim të Ligjit 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit", neni 8 pika 4. Nga analiza e cilësinë së ajrit në territorin e Bashkisë Kuçovë, përmbajtja e PM_{10}, NO_2 dhe Benzenit në ajër është më e lartë së vlerat kufi të përcaktuara me ligj. Hartimi i planeve të tilla është kërkesë ligjore për Bashkinë duke qenë se përmbjantja e substancave të mësipërme në ajër i kalon kufinjtë e caktuar me ligj.
- Përfshirjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Planet Sektoriale të Bashkisë (planin e zhvillimit të transportit publik, transportit rrugor, zhvillimit urban, industrial, të pyjeve, etj.)
- Bashkëpunimin me Inspektoriatin e Mjedisit për zbatimin e normave të shkarkimeve në ajër nga sektori i industrisë (i naftës në veçanti), i ndërtimeve, etj.
- Ndërmarrja e nismave të herëpashershme për kontrollin e zbatueshmërisë së kushteve të lejeve mjedisore (të tipit A, B dhe C) dhe të ligjit në tërësi si dhe pjesëmarrja aktive në dhënien e Lejeve Mjedisore (në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse) të këtyre subjekteve.
- Hartimi i Planeve të Detajuara Vendore (PDV-ve) duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik dhe transport alternativ (këmbësor, bicikleta, etj.). Në PPV, është arashikuar ulja e numrit të makinave në qarkullim me qëllim uljen e ndotjes nga mjetet e transportit. për të njëtën arsye rekomandohet hartimi i PDV-ve duke ndjekur shembullin e PPV-së e cila ka hartur projekte që kanë si synim fuqizimin e transportit publik, favorizimin e këmbësorëve dhe nxitjen e përdorimit të mjeteve të transportit alternativ (biçikleta ose motorrë, të paktën në zonat urbane), zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra, kufizimin e numrit të makinave në qarkullim në qendra urbane, shtimin dhe zgjerimin e trotuarve në rrugët më të rrahura nga qytetarët, fuqizimin e mëtejshëm të transportit publik dhe shtimin e korsive të biçikletave përgjatë akseve të rrugëve në qendra dhe nëpërmjet rrugëve që lidhin NjA-të e afërta në largësi, zhvillimin territorial të qendrave të NjA-ve ose urbane në parimin e përdorimit të tokës/truallit në mënyrë efiçente dhe të përqendruar dhe jo të shpërhapur (përdorime mikse të zonave që nënkuptojnë biznese, banime, dhe shërbime në të njëjtën zonë), me qëllim uljen e kilometrave që qytetarët nevojitet të përshkojnë me makinë për plotësimin e nevojave të tyre (blerjet, udhëtime për në institute, shkolla, qendra spitalore) në jetën e përditshme.
- Menaxhimi i mbetjeve sipas parimeve të mbrojtjes së mjedisit (duke shmangur dhe parandaluar djegien e tyre si dhe duke parashikuar kapjen e gazrave që lëshojnë mbetjet gjatë shpërbërjes së tyre jashtë dhë brenda venddepozitimit të mbetjeve. Rekomandohet që venddepozitimet që parashikohet të ndërtohen në të ardhmen të pajisen me sistemin e kapjes së gazrave që çlirohen nga degradimi i mbetjeve në mënyrë që të mos shkarkohen të pakontrolluara në atmosferë.

Monitorimi i ajrit

- Krijimi i stacioneve të përhershme të monitorimit të ajrit me qëllim monitorimin ditor dhe mundësisht orar (24/7) të cilësisë së ajrit në zonat me aktivitet të lartë naftënxjerrës (në Qytetin e Kuçovës dhe në zonën naftënxjerrëse të Kozarës ku ka një përqëndrim të lartë pusesh). Monitorimi orar shërben përtë njoftuar qytetarët në përgjithësi dhe pjesën më të ndjeshme të popullsisë (fëmijët, të moshuarit, gratë

shtatzanë, etj.) që të ëndrojnë brenda sa herë që cilësia e ajrit nuk është e mirë. Në këtë mënyrë shmangen shumë rreziqe që i kanosen popullsisë së Bashkisë. Për këtë lipset bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse (AKM, ARM Berat dhe Instituti i Shëndetit Publik).

- Shtimi i parametrave të monitoruar. Duke qenë se Bashkia e Kuçovës është zonë me industri nafte tejet aktive në territorin e saj, lipset që monitorimi i cilësisë së ajrit të përfshijë një numër të madh parametrash që tregojnë ndotjen nga nafta. Është mjaft e rëndësishme që përveç benzenit dhe disa parametrave të tjerë që monitorohen nga AKM-ja, të përfshihen edhe Përbërësit Organikë të Avullueshëm (VOCs).
- Monitorimi i përditshëm i treguesve problematikë të ajrit (P_{M10}, NO_2 dhe Benzenin) në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse (AKM e ARM Berat) deri në uljen e përqëndrimit të tyre në ajër brenda parametrave të lejuar me ligj.

Tabela 107. Projektet e propozuara në PPV që synojnë përmirësimin e cilësisë së ajrit

Qëllimi	Masat	Projekti specific i parashikuar në PPV
Ulja e numrit të makinave në qarkullim	Fuqizimi i transportit publik	-Mbulimi me transport publik efikas i gjithë territorit të Bashkisë. -Zhvillimi i një sistemi transporti publik brenda bashkisë, për të siguruar aksesin e fshatrave Drizë, Perondi e Lumas drejt Kuçovës.
	Nxitja e transporteve alternativë	-Ndërtimi i korsive të Biçikletave në Qytëtin e Kuçovës. -Ndërtimi i një itinerari për biçikleta dhe kembësorë me hapësira te gjelbra përgjate kanalit vaditës që kalon në qytet.
	Planifikimi efiçent i territorit	Projekte të ndryshme ku përcaktohet intensiteti i ndërtimeve (ngritje në lartësi dhe jo shpërhapje në territor, zonat për ndërtim, etj. në mënyrë që të kufizohet lëvizja me makina (shihni projektet specifike në tekstin e PPV-së)
	Kufizimi i makinave në qendra urbane	Zgjatimi dhe kthimi në rrugë për këmbësorë i bulevardit kryesor të qytetit.
Përmirësimi i cilësisë së ajrit	Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në qytet	-Krijimi i parqeve të vogla urbane në zona natyrore periferike të qytetit (krijimi i parkut në meandrimin e Lumit Devoll në afërsi te venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta të qytetit). -Programi për mbjelljen e pemëve dekorative në rrugët kryesore të qytetit të Kuçovës.

Ulja e ndotjes industriale	Hartimi i planeve për uljen e shkarkimeve nga industriale	Hartimi i planit të uljes së shkarkimeve të zonës së UMN-së, dhe industrisë në hyrje të qytetit, si dhe marrja e masave taksative për zbatimin e tij.

Burimi: PPV, 2016

2.3.5 Rekomandime mbi zonat e nxehta mjedisore

Bashkia Kuçovë nuk ka zona të nxehta mjedisore të shpallura ligjërisht. Megjithatë, mendohet se në territorin e Kuçovës ndodhen disa zona të nxehta mjedisore (shih seksionin e vatrave të nxehta mjedisore) që kanë nevojë për rehabilitim sa më të shpejtë me qëllim shmangien e ndotjes së mjedisit dhe rreziqeve që i kanosen shëndetit të banorëve që jetojnë ngjitur ose përreth këtyre zonave. Zonat kryesore të nxehta mendohet se janë venddepozimi i mbetjeve urbane, Kanali i "Dikatrës, ish-Uzina e Përpunimit të Naftës (UPN-ja) dhe zona naftënxjerrëse.

Me qëllim përmirësimin e vatrave të nxehta mjedisore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Kuçovë ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Këto masa përfshijnë rehabilitimin e kanaleve vaditëse, ndërtimin e kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura industriale, pastrimin dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis të zonave naftë nxjerrëse, rehabilitimin e fushës së mbetjeve dhe ndërtimin e landillit.

Në funksion të uljes së ndikimit negativ mjedisor të vatrave të nxehta mjedisore dhe rehabilitimin e tyre, krahas masave të propozuara në PPV rekomandohen edhe masa të tjera si:

- Rihabilitimi i venddepozitimit të vjetër me qëllim shmangien e ndotjes së tokës e ujërave nëntokësorë nëpërmjet shllamit që krijohet nga shpërbërja e mbetjeve
- Hartimi i një plani për venddepozitimin / trajtimin e mbetjeve të rrezikshme që planifikohet të grumbullohen nga rihabilitimi i vatrave të nxehta (zona e ish-UPN-së, kanali i Dikatrës dhe zona naftë-nxjerrëse). Mbetjet e depozituara në këto vatra të nxehta mjedisore janë kryesisht të krijuara nga hidrokarburët. Rrjedhimisht, marrja e masave paraprake për trajtimin dhe depozitimin e tyre përfundimtar është e pashmangshme, në mënyrë që mos të krijohet një tjetër vatër e nxhehtë mjedisore (kjo nisëm realizohet në bashkëpunim me organet e pushtetit qendror, për arsye se mbetjet industriale nuk menaxhohen nga Bashkia).
- Ndërtimi i një stacioni trasferimi për mbetjet industriale, kryesisht mbetjet e krijuara nga industria e naftës, deri në një moment të dytë kur institucionet përkatëse të japin një zgjidhje përfundimtare për depozitimin e tyre përfundimtar.
- Marrja e masave për parandalimin e ndotjes së mjedisit gjatë rehabilitimit të zonave të mbrojtura. Më konkretisht, rekomandohet transportimi i dheut të hequr pa u depozituar fillimisht në zonat përreth duke shmangur kështu ndotjen e zonës, përdorimin e makinerive të përshtatshme, shmangien e icidenteve që mund të ndodhin nga grumbullimi i mundshëm i gazit në shtresat e poshtme të mbetjeve të depozituara, etj.

Tabela 108. Projektet e planifikuara në PPV për rehabilitimin e vatrave të nxehta mjedisore

Qëllimi	Masa	Projektet
Rehabilitimi i vatrave të nxehta mjedisore	Rehabilitimi i kanaleve vaditës	- Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit kullues në zonën pranë UPN, në seksionin Porta e Përpunimit-Hipotekë - Ndërtimi i një impianti të trajtimit të ujërave të zeza dhe ndërtimi i tubacionit kryesor paralel me kanalin e Dikatrës - Rehabilitimi mjedisor dhe ristrukturimi i ish zonës industriale të Uzinës së Përpunimit të Naftës, për të siguruar cilësi të mirë jetese sidhe kthimi ne hapësire gjelbër dhe rekreative. - Kryerja e një studimi të integruar për vlerësimin e ndotjes nga nafta në tokë, ajër, ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore - Marrja e masave për rekuperimin e efekteve të dëmtimit dhe ndotjes nga nafta, permiresimi i kushteve fizike të puseve. - Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe kthimi në hapësirë të gjelbër me pemë të larta. - Ndërtimi i një landfilli sanitar për depozitimin e mbetjeve urbane
	Ndërtimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave të ndotur industrial	
	Pastrimi dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis i zonave naftë nxjerrëse	
	Rehabilitimi i fushes së mbetjeve dhe ndërtimi i landillit	

Burnimi: Co-PLAN, 2016

2.3.6 Rekomandime mbi zonat historike dhe monumentet e kulturës

Bashkia Kuçovë ofton aktualisht dy kisha të cilat për nga potenciali që kanë mund të shërbejnë si pika me interes për zgjerimin e potencialit kulturor e vizitueshmërisë në rritje që po konstatohet në qytetin e Beratit (prej vitit 2008) pasuri botërore e njerëzimit UNESCO.

Sikurse është përmendur Kisha e Perondisë dhe Kisha e Kozarës janë dy monumente kulti që aktualisht u mungon zona e mbrojtur. Studimi dhe më pas miratimi i tyre nga Ministria e Kulturës do të ndihmonte në mbrojtjen e tyre afatgjatë dhe krijonte kushtet për zhvillimin e harmonizuar të zonës përreth. Veçanërisht mbetet për trajtim të veçantë në bashkëpunim me njësinë vendore përdorimi i varrezës në afërsi të kishës së Kozarës.

2.4 Plani i veprimeve për zbatimin e PPV-së

2.4.1 Fazat e zbatimit të planit


Material i hartëzuar me ngjyra që tregojnë periudha kohore + tekst shpjegues. Teksti duhet të shpjegojë se çfarë nevojitet si parakusht për të realizuar zbatimin e fazave.

Një seksion mjaft i rëndësishëm i planit është fazimi dhe zbatueshmëria e tij në bazë të projekteve prioritare që do të ndërmarrë Plani i Përgjithshëm Vendor. Në këtë seksion do të trajtohet fazimi i zhvillimit të njësive strukturore, fazimi i rrjetit rrugor të propozuar, si dhe fazimi i projekteve madhore. Metodologjia e ndjekur ka tri fazime kohore: fazën afatshkurtër, që është një periudhë 3 vjeçare nga miratimi i planit; fazën afatmesme, që

është periudha 5 vjeçare nga miratimi i planit; fazën afatgjatë, që zgjat nga periudha e miratimit të planit deri në vitin 2031, kur parashikohet të ketë fazën përfundimtare të tij.

- **Fazimi i njësive strukturore**

Figura 205. Fazimi i njësive strukturore



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Për sa i përket fazimit të njësive strukturore, prioritet kryesor do të ketë zhvillimi i njësive strukturore të qendrës së qytetit që përbëhet nga njësitë ku do të aplikohet intensifikimi, zhvillimi dhe rigjenerimi për sa i përket banimit dhe zhvillimit të shërbimeve, dhe ku vlerësohet se interesi për zhvillime ndërtimore është më i lartë se në zonat e tjera. Prioritet, gjithashtu, do të ketë zhvillimi i njësive të rekreacionit që janë njësitë e ish-UPN-së dhe ish-TEC-it. Prioritet do të ketë edhe krijimi i njësive ekskluzive të puseve të naftës, si dhe i zonave industriale. Këto njësi kanë prioritet sepse në këto zona do të aplikohet ngrirja urbane dhe konservimi në mënyrë që të mos ketë zhvillime ndërtimore të reja në këto zona. Prioritet të zhvillimit të njësive në një periudhë afatshkurtër do të kenë edhe njësitë qendrore të qendrave administrative dhe të disa fshatrave që kanë ndërhyrje kryesore, siç është ndërtimi i shkollave apo dhe i qendrave shëndetësore. Gjithashtu, prioritet për periudhën afatshkurtër do të kenë edhe disa njësi të fashës ekonomike të cilat janë në afërsi të qytetit të Kuçovës dhe në afërsi të qytetit të Urës Vajgurore.

Për sa i përket zhvillimit të njësive në periudhën afatmesme në këtë grupim hyjnë njësitë të cilat ndodhen përreth qendrës së qytetit të Kuçovës, si dhe disa njësi të fshatrave kryesore të bashkisë së Kuçovës. Këto njësi kryesisht do t'i dedikohen banimit dhe zhvillimit të shërbimeve. Interesi për zhvillim në këto njësi vlerësohet të jetë mesatar. Njësitë strukturore që do të zhvillohen do të jenë në këto fshatra: Vlshuk, Kozarë Fshat, Salcë Kozarë dhe Perondi në zonën e fashës së banimit; Tapi- Reth Tapi në zonën e fashës së banimit; si dhe Fshatrat Drizë, Gegë, Pëllumbas, Sheqëz, Vodhës, Langozaj, Goraj dhe Velagosht.


Gjithashtu, si zhvillime afatmesme do të klasifikohen edhe njësitë natyrore të zonave ripariane, të parkut rajonal të Kozarës, të rezervateve të menaxhuara të Belesovës dhe Sinecit, si dhe të rezervuarëve ujorë të Gegës, Drizëz dhe Fier-Mimarit. Këto njësi si bazë

të ndërhyrjeve do të kenë rehabilitimin mjedisor, trajtimin peizazhistik, si dhe mbrojtjen nga erozioni.

Për sa i përket ndërhyrjeve në njësitë e tjera, ato mund të klasifikohen në grupimin e njësive për ndërhyrje afatgjata. Në këtë grupim futen të gjitha njësitë e banimit si në pjesën periferike të qytetit, ashtu edhe në zonat e banimit në fshatra të ndryshme ku ndërhyrjet nuk do të jenë të mëdha. Gjithashtu, në këtë grupim futen edhe njësitë bujqësore të cilat si ndërhyrje kanë konservimin dhe konsolidimin e tyre.

- **Fazimi i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor**

Figura 206. Fazimi i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor



Burimi: Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Për sa i përket rrjetit rrugor, në periudhën afatshkurtër parashikohet të ndërhyhet në akset kryesore që bëjnë lidhjen e bashkisë Kuçovë me akset nacionale kryesore. Këtu mund të përmendim akset: Kuçovë- Ura Vajgurore, Kuçovë- Belsh, Kuçovë- Cërrik, Kuçovë- Kozarë- Fier Mimar- Fier Shegan, si dhe Kuçovë- Lapardha. Akse të tjera të cilat parashikohet të ndërhyhet në një periudhë afatshkurtër janë rrugët e brendshme të qytetit të Kuçovës që do ti nënshtrohen rehabiltimit, zgjerimit dhe ndërtimit. Si më të rëndësishmet mund të përmendim ndërtimin e zgjatimit të bulevardit të Kuçovës dhe rrugën nga Kthesa e Fermës deri në urën e lumit Devoll në afërsi të Kozarës. Akset e tjera të rëndësishme parashikohen të zgjerohen dhe rehabilitohen. 2 rrugë të tjera të cilat do të kenë ndërhyrje në një periudhë afatshkurtër janë: aksi Tapi- Rreth Tapi- Kuçovë dhe aksi Kuçovë- Perondi-Lapardha- Vodhëz- Lumas- Pëllumbas- Belesovë- Meandrake.

Si akse të cilat do të kenë ndërhyrje në një periudhë afatmesme vlerësohen akset rrugore të cilat përmirësojnë aksesin e qytetit të Kuçovës me fshatrat kryesore të njësive administrative. Në këtë grupim futen akset: Kuçovë- Arrëz, Kuçovë- Magjatë- Sheqëz, Kuçovë- Velagosht, Lumas- Sinec, Kuçovë- Drizë, si dhe Kuçovë- Gegë. Gjithashtu, si rrugë në të cilat do të ketë ndërhyrje në një periudhë afatmesme vlerësohen akset turistike që lidhin qytetin e Kuçovës me parqet periferike, rrugët e brendshme dytësore të qytetit, si dhe rrugët e brendshme të fshatrave kryesore.

Si akse të cilat do të kenë ndërhyrje në një periudhë afatgjatë vlerësohen të gjitha akset e tjera rrugore. Në këtë grupim kryesisht futen rrugët të cilat përmirësojnë lidhjen e fshatrave me njëri-tjetrin, një pjesë e rrugëve të brendshme të fshatrave, si dhe autostrada e Boshtit Qendror Jugor, që vlerësohet si një projekt madhor, por që do të realizohet në një fazë afatgjatë.

- **Fazimi i projekteve në bashkinë e Kuçovës**

Tabela 109. Tabela e fazimit të projekteve

Objektivat strategjikë, programet dhe projektet e Bashkisë Kuçovë	Faza1 (0-3 vjet)	Faza2 (3-5 vjet)	Faza3 (5-15 vjet)
Objektivi strategjik 1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomiko-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë Kuçovë në sektorin industrial, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët			
O1P1: Zhvillimi i politikave nxitëse dhe mbështetja infrastrukturore për rikualifikimin dhe rritjen e performancës së zonave industriale të bashkisë			
Pr.1: Hartimi i PDV-së për rizhvillimin industrial të zonës së ish-UMN-së			
Pr.2: Sigurimi i infrastrukturës bazë për strukturat industriale dhe magazinuese në hyrje të qytetit (ndërtimi i infrastrukturave të nevojshme ndihmëse në afërsi të stacioneve të dekantimit të naftës)			
O1P2: Rritja e performancës së sektorëve ekonomikë në bashkinë Kuçovë, zhvillimi i sektorit të shërbimeve, si dhe zhvillimi i sektorëve bujqësorë e blegtoralë në zonat me karakter rural, duke përmirësuar rrjetin e shkëmbimeve dhe tregtisë së produkteve bujqësore			
Pr.3: Krijimi i një pike grumbullimi të produkteve bujqësore në Kozarë			
Pr.4: Rritja e kapaciteteve të tregut aktual në Kuçovë dhe rigjenerimi i zonës			
Pr.5: Krijimi i një qendre agro-industriale për përpunimin, përgatitjen e prodhimeve në shkallë rrethi, si: produkte bujqësore dhe blegtorale në afërsi të tregut aktual			
Pr.6: Krijimi i zonës ekonomike me njësi tregtare dhe shërbimesh përgjatë aksit rrugor Kuçovë-Ura Vajgurore			
Pr.7: Programi për mbjelljen e fidanëve të rinj të drurëve frutorë në zonën e kodrave të qytetit të Kuçovës për të rritur prodhimin bujqësor			
Pr.8: Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Kuçovë			
O1P3: Nxitja e procesit të zgjerimit dhe densifikimit për të gjithë qendrat e njësive administrative, si dhe për disa fshatra me potencial urbanizimi			
Pr.9: Krijimi i PDV-së për polet e reja urbane në qytet që do t'i nënshtrohen rizhvillimit dhe rehabilitimit, duke siguruar parametra zhvillimi efikas			

Pr.10: Hartimi i PDV-së për zonat e zgjerimit në fshatrat Kozarë Qendër, Lumas, Perondi, Vodëz, si dhe fshatra të tjerë që do presin zhvillim			
O1P4: Përmirësimi i klimës së biznesit të vogël nëpërmjet politikave nxitëse dhe sigurimit të infrastrukturës së përshtatshme mbështetëse të tyre			
Pr.11: Mbështetja e zhvillimit të NVM-ve dhe bizneseve të vogla artizanale në zonat ekonomike me karakter tregtar (qendra e zona ekonomike Kuçovë-UraVajgurore), nëpërmjet instrumenteve stimuluese në PDV.			
Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën			
O2P1: Konsolidimi i lidhjeve të bashkisë së Kuçovës në nivel rajonal, duke siguruar integrimin me rrjetet shtetërore rrugore			
Pr.1: Ndërtimi i Boshtit Qendror Jugor			
Pr.2: Rehabilitimi dhe ndërtimi i pjesshëm i unazës përrreth qytetit (rruga Kuçovë- Perondi- Magjatë- Dumollë- Goraj- Drizë- Gegë- Kuçovë)			
Pr.3: Ndërtimi i rrugës tangjente që lidh aksin Kuçovë-Ura Vajgurore nga Kthesa e Fermës deri tek ura e lumit Devoll nëpërmjet ish-zonave industriale.			
Pr.4: Rehabilitimi i rrugës së Belshit, si rrugë që luan rolin e Boshtit Kombëtar Qendror, në një periudhë afatmesme, si dhe rehabilitimi e ndërtimi i pjesshëm i rrugës Kuçovë- Arrëz			
Pr.5 Ndërtimi i dy urave, njëra mbi lumin Osum dhe tjetra mbi lumin Devoll			
O2P2: Integrimi i bashkisë së Kuçovës në tërësinë e itinerareve të gjelbra rajonale nëpërmjet infrastrukturës së lehtë e turistike			
Pr.6: Krijimi i një rrjeti shtigjesh, të pajisur me sinjalistikën respektive dhe shërbimet ndihmëse, me destinacion Kozarë-Kuçovë-Gramsh e më gjerë			
O2P3: Përmirësimi i lidhjeve ndërqytetëse mes qendrave të njësive rurale me njëra-tjetrën dhe me Kuçovën.			
Pr.7: Ndërtimi i rrugëve që lidhin Lumasin me qytetin e Kuçovës (Kuçovë-Magjatë-Sheqëz-Vodhëz-Lumas, Kuçovë-Goraj-Pashtraj- Bardhaj- Lumas, Kuçovë- Velagosht - Lumas)			
Pr.8: Rehabilitimi i rugës Kuçovë- Perondi- Lapardha- Vodhëz- Lumas-Pëllumbas- Belesovë- Meandrake			
Pr.9: Rikonstruksioni dhe ndërtimi i urave që lidhin akset rrugore në dy anët e përroit të Lapardhicës (rehabilitimi i urës në afërsi të fshatit Vodhëz, rehabilitimi i urës në afërsi të fshatit Bardhaj, ndërtimi i urës së këmbësorëve në afërsi të fshatit Goriçan, ndërtimi i urës në afërsi të fshatit Lumas)			
Pr.10: Rehabilitimi i aksit rrugor Perondi- Qoshk- Sheqëz- Bardhaj-Goriçan- Lumas- Langozaj			
Pr.11: Përmirësimi i gjendjes së ndriçimit dhe sinjalistikës horizontale dhe vertikale në të gjithë bashkinë dhe ndërtimi e pajisja me infrastrukturë KUZ e "Rrugës së Drizës" në lagjen "11 Janari", Kuçovë			
Pr.12: Rehabilitimi i akseve rrugore që lidhin fshatrat turistike në NjA Perondi dhe Lumas			
O2P4: Sistemimi i rrjeteve rrugore lokale për të rritur nivelin e jetueshmërisë në qytet dhe zona rurale			
Pr.13: Rikonstruksioni i pjesshëm i akseve rrugore "Toli Shuka", "Koli Hoxholli", "Kongresi i Lushnjes", "Koço Koleci", "Ismail Qemali" dhe "Isa Boletini"; shtrimi i segmenteve rrugore nga sheshi "11 Janari" deri të			

tunelet e UMN-së, si dhe nga Policia deri të Spitali; mbikqyrja e punimeve të rrugës "K. Laçka- Q.Stafa" (në proces)			
Pr.14: Ristrukturimi i rrugëve lokale të fshatit Magjatë e Bardhaj, i rrugëve në Kozarë, si dhe i rrugëve dytësore në Lumas			
Pr.15: Ndërtimi i korsive të biçikletave në qytetin e Kuçovës			
O2P5: Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, duke siguruar shërbim cilësor për të gjithë territorin e bashkisë			
Pr.16: Ndërtimi i rrjetit të KUZ-it në fshatrat Drizë, Gegë, Kozarë			
Pr.17: Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit kullues në zonën pranë UPN-së, në seksionin Porta e Përpunimit-Hipotekë			
Pr.18: Rikonstruksioni i infrastrukturës së ujësjellësit në segmentin Çiflik-Kuçovë			
Pr.19: Hartimi i një plani afatgjatë për sigurimin e shërbimit të ujësjellësit në fshatrat Demollarë, Luzaj, Belesovë, Mendrakë, Sheqëz, Krekëz, Koritëz dhe Katundas, Lumas dhe Pëllumbas.			
Pr.20: Rehabilitimi i sistemit të gropave septike në fshatrat që nuk kanë akses në rrjetin e kanalizimeve			
Pr.21: Përmirësimi tërësor i sistemit të kanalizimeve duke ndarë ujërat e bardha nga ato të zeza në qytet, si dhe duke siguruar mbulim me rrjet për të gjithë bashkinë			
Pr.22: Ndërtimi i një impianti të trajtimit të ujërave të zeza dhe ndërtimi i tubacionit kryesor paralel me kanalin e Dikatrës			
O2P6:Përmirësimi i situatës së lëvizshmërisë dhe transportit publik në nivel bashkie			
Pr.23: Zhvillimi i një sistemi transporti publik brenda bashkisë për të siguruar aksesin e fshatrave Drizë, Perondi e Lumas drejt Kuçovës			
Pr.24: Sistemimi dhe zgjerimi i terminalit të autobusëve në qytetin e Kuçovës			
Pr.25: Mbulimi me transport publik efikas i gjithë territorit të bashkisë			
Objektivi strategjik 3: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integrimit me potencialet rajonale turistike			
O3P1: Rehabilitimi mjedisor dhe rigjenerimi i ish-zonave industriale në territorin e bashkisë me synim kthimin e tyre në zona banimi dhe rekreacioni			
Pr.1: Rehabilitimi mjedisor dhe rizhvillimi i zonës së TEC-it si pol kulturor e rekreativ			
Pr.2: Rehabilitimi mjedisor dhe ristrukturimi i ish-zonës industriale të Uzinës së Përpunimit të Naftës për të siguruar cilësi të mirë jetese, si dhe kthimi në hapësirë të gjelbër dhe rekreative			
O3P2: Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane duke përfshirë strategjitë për mbledhjen e diferencuar dhe reduktimin e mbetjeve, zhvendosjen dhe rregullimin e vendit të depozitimit ekzistues për t'u përshtatur me kushte më sanitare, si dhe mundësitë e kryerjes së kompostimit të mbetjeve organike			
Pr.3: Hartimi i një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel bashkie me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane, si dhe blerja e automjeteve për transportimin e mbetjeve urbane			
Pr.4: Ndërtimi i një *landfill*-i sanitar për depozitimin e mbetjeve urbane			

Pr.5: Hartimi i një strategjie dhe sigurimi i kushteve fizike për kompostimin e mbetjeve organike			
Pr.6: Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe kthimi në hapësirë të gjelbër me pemë të larta			
O3P3: Sistemimi në trajtë parku i zonës së kodrave të Kozarës duke shfrytëzuar elementet ekzistuese të peizazhit, me funksion "rekreacion" dhe reduktim të pasojave shqetësuese të zonës naftëmbajtëse			
Pr.7: Krijimi i një parku rajonal në zonën nga Rezervuari i Murrizit deri në fshatin Vlashuk			
Pr.8: Krijimi i një rrjeti bujtinash në fshatrat përreth parkut rajonal që të krijohen kapacitetet e duhura të hotelerisë në zonë			
O3P5: Rehabilitimi mjedisor i zonave ripariane të lumenjve dhe përrenjve			
Pr.9: Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative të zonave ripariane të lumit Devoll dhe Osum-Seman			
Pr.10: Rehabilitimi mjedisor dhe marrja e masave për minimizimin e erozionit të tokave bujqësore përgjatë përroit të Lapardhicës			
Pr.11: Realizimi i masave infrastrukturore dhe vegjetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga lumenjtë Devoll dhe Osum			
O3P6: Hartimi i një plani për studimin e ndotjes reale të tokës dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën naftëmbajtëse të Kozarës			
Pr.12: Kryerja e një studimi të integruar për vlerësimin e ndotjes nga nafta në tokë, ajër, ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore			
Pr.13: Marrja e masave për rikuperimin e efekteve të dëmtimit dhe ndotjes nga nafta, përmirësimi i kushteve fizike të puseve			
O3P7: Reduktimi i efekteve negative të emetimeve të zonës industriale ekzistuese dhe zgjerimit të propozuar të saj			
Pr.14: Hartimi i planit të reduktimit të emetimeve të zonës së UMN-së dhe industrisë tjetër në hyrje të qytetit, si dhe marrja e masave taksative për zbatimin e tij			
O3P8: Përmirësimi i imazhit të qytetit si "qytet i naftës", duke valorizuar identitetin në shërbim të turizmit nëpërmjet krijimit të Muzeut të Naftës dhe rehabilitimit të lagjes historike si pjesë të "qytetit-muze"			
Pr.15: Ndërtimi i një objekti muzeal të naftës			
Pr.16: Ndërtimi i një muzeu të aeronautikës në zonën e fushës së aviacionit			
Pr.17: Hartimi i një strategjie për kthimin e një pjese të blloqeve '1 Maji' dhe 'Llukan Prifti' në lagje-muze për qëllime identifikimi dhe turistike			
Pr.18: Zgjatimi dhe kthimi në rrugë për këmbësorë i bulevardit kryesor të qytetit			
Pr.19: Kthimi i puseve të naftës në objekte tërheqëse (lyerja, vendosja e ndriçuesve) për t'i dhënë një pamje tjetër qytetit			
Objektivi strategjik 4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesi në aspektin social-kulturor			
O4P1: Rikonstruksioni i objekteve arsimore shëndetësore dhe me funksione publike me probleme fizike, si dhe përshtatja e mjediseve për të plotësuar kërkesat, kapacitetet dhe standardet			
Pr.1: Rikonstruksioni i shkollave 9-vjeçare në Rreth Tapi, Vodëz, Perondi, Bardhaj, Lumas, "18 Tetori" Kuçovë, si dhe i shkollës së mesme në Perondi,			

i oborrit të shkollave-kopshteve dhe ambienteve ndihmëse të tyre (një ndër këto institucione 9- vjeçare "Gaqi Karakashi")			
Pr.2: Përmirësimi i kushteve laboratorike dhe sportive të objekteve arsimore 9-vjeçare dhe të mesme në bashki			
Pr.3: Ndërtimi i kopshteve në fshatrat Frashër, Luzaj, Katundas dhe Belesovë, si dhe rikonstruksioni i kopshtit në fshatin Lumas.			
Pr.4: Ndërtimi i një shkolle të mesme në fshtin Gegë dhe i një qendre shëndetësore në fshatin Goraj			
Pr.5: Rikonstruksion zyrash dhe mbikqyrje punimesh për to; kolaudim punimesh ndërtim ambulance Lumas; kolaudim, mbikqyrje rikonstruksion shkolle Lumas; kolaudim punimesh Sheqëz-Vodhëz-Koritëz- Lumas			
Pr.6: Kolaudim, mbikqyrje punimesh i rikonstruksionit të banesave rome, Lumas			
O4P2: Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i shesheve kryesore në qytet dhe në qendrat e njësive rurale			
Pr.7: Rikonstruksioni i sheshit të pazarit në Kuçovë			
Pr.8: Rikonstruksioni i shesheve të brendshme të blloqeve 5-katëshe të banimit në lagjen "1 Maji" dhe i shesheve të qendrave të njësive administrative të Lumasit, Perondisë dhe Kozarës			
O4P3: Krijimi i mundësive të strehimit të përballueshëm për popullsinë aktuale dhe strehimit social për popullsinë e regjistruar si të pastrehë, duke ndjekur politika koherente strehimi, stimuj tatimorë dhe qira të lehtësuar			
Pr.9: Ndërtimi i një objekti të strehimit social për popullsinë e pastrehë ose në nevojë strehimi			
Pr.10: Hartimi i një plani për regjistrimin e të gjithë familjeve të pastreha në bashki			
Pr.11: Integrimi i politikave të strehimit në instrumentet e planifikimit si bonus intensiteti apo kushtëzime të tjera për zhvilluesit e PDV-së			
O4P4: Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i popullsisë duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit			
Pr.12: Ndërtimi i një Qendre Artistike e Kulturore për shërbime ndaj të rinjve			
Pr.13: Rikonstruksioni i stadiumit të Kuçovës dhe krijimi i një poli të rëndësishëm sportiv e rekreativ në zonën e stadiumit			
O4P5: Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Kuçovë, gjelbërimit dhe hapësirave me karakter të veçantë për t'i shërbyer funksionit mjedisor dhe estetik për qytetin			
Pr.14: Rikonstruksioni i pikës turistike të qendrës Kuçovë			
Pr.15: Zgjerimi i zonës së varrezave të qytetit Kuçovë			
Pr.16: Krijimi i parqeve të vogla urbane në zona natyrore periferike të qytetit (krijimi i parkut në meandrimin e lumit Devoll, në afërsi te venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta të qytetit)			
Pr.17: Ndërtimi i një itinerari për biçikleta dhe këmbësorë, me hapësira te gjelbra përgjatë kanalit vaditës që kalon në qytet			
Pr.18: Programi për mbjelljen e pemëve dekorative në rrugët kryesore të qytetit të Kuçovës			
O4P6: Hartimi i një strategjie të përfshirjes në arsim profesional të popullsisë vendase, në ndihmë të punësimit në sektorë të industrisë së lehtë, artizanatit etj.			

Pr.19: Ngritja e një shkolle profesionale rajonale për naftën			
Pr20: Kryerja e marrëveshjeve me operatorë artizanalë dhe shërbimesh për zhvillimin e trajnimeve në sektorë specifikë, ndihmës për ekonominë lokale			
O4P7: Programi për marrjen e masave të plotësimit me bazë materiale në institucionet që ofrojnë shërbimet sociale			
Pr.21: Pajisja me soba për ngrohje me dru në institucionet e arsimit (shkolla, kopshte, çerdhe)			
Pr.22: Blerje librash për qendrën rinore dhe bibliotekën			

2.4.2 Plani i investimeve kapitale

Për shkak të volumit, ky seksion i PPV-së së Bashkisë Kuçovë paraqitet si dokument më vete dhe pjesë përbërëse e PPV-së.

2.4.3 Monitorimi i zbatimit të planit dhe çështje institucionale-ligjore

Ky seksion i PPV-së së Bashkisë Kuçovë shpejgon mënyrën e monitorimit si dhe zbatimin e tij.

Në përgjithësi, propozimet e planit, përveç atyre që kanë të bëjnë specifikisht me masat mjedisore, nuk kërkojnë ndryshime në kuadrin ligjor e administrativ, së paku jo për periudhën afatshkurtër. Propozimet institucionale e ligjore për zbatimin e masave mjedisore janë trajtuar në mënyrë të zgjeruar në tekstin e VSM-së. Tabela përmbledhëse e këtyre propozimeve jepet më poshtë.

Tabela 110. Rekomandime për përmirësimin e monitorimit të mjedisit

Çështje ligjore, institucionale, procedurale për monitorimin e mjedisit	**Masa**	**Instrumenti**
Mospajisja me laboratorë e institucioneve të monitorimit të mjedisit	**Pajisja me laborator**	**Numër laboratori të çertifikuar në pronësi të institucioneve**
Mungesa e laboratoreve që kanë kapacitet të monitorojnë parametra si përbërjet klorure dhe PCB si dhe pesticidet dhe PAHs	Pajisja me laboratorë të specializuar	**Rritja e kapacitetit për matjen e përbërjeve klorure, PCB-ve, pesticideve dhe PAHs**
Monitorimi i mjedisit bazuar në numër të kufizuar treguesish mjedisorë (parametrat)	**Krijimi i bazës ligjore për shtimin e parametrave që nevojitet të maten për monitorimin e duhur të treguesve fizikë të mjedisit (ajrit, tokës, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, biodiversitetit, pyjeve)**	**Parametra /ndotës që shkarkohen nga industria e rëndë**
Numri i kufizuar i pikave të monitorimit	**Shtimi i pikave**	**Numri i pikave**
Shpeshtësia e monitorimit të ujërave e pamjaftueshme	**Shtimi i frekuencës**	**Numër i lartë matjesh/vit**
Vetë-monitorimi i aktiviteteve të pajisura me leje A dhe B joreal	**Kalimi i monitorimit të shkarkimeve të indsutrisë së pajisur me leje mjedisore (A dhe B) nën kompetencat e ARM-Berat**	**Monitorim mujor i parametrave**
Mungesa e kompetencave të ARM-së Berat për monitorimin e mjedisit	**Shtimi i kompetencave**	**Monitorimi parametrave**

Mungesa e bazës ligjore/procedurave e programeve për mbrojtjen e ujërave nëntokësore	Krijimi i programeve të posaçme për mbrojtjen e akuiferëve nga industria e rëndë dhe industria e naftës	Numri i programeve në mbrojtje të akuiferëve

Punoi: PLGP, Co-PLAN, 2016.

Përtej çështjeve mjedisore, sugjerimi kryesor është që PPV-ja të zbatohet për të paktën dy vite, periudhë gjatë të cilës Bashkia do të monitorojë jo vetëm zbatimin, por edhe vështirësitë e hasura. Këto do të raportohen në Raportin e Territorit. Kjo periudhë zbatimi do të ndihmojë që Bashkia të përpilojë propozime në lidhje me ndryshimet e nevojshme në bazën ligjore dhe/ose administrative për planifikimin, sektorë të tjerë, dhe sipas rastit edhe për strukturën administrative në nivel vendor. Sigurisht këto propozime mbeten sugjerime në rast të një procesi të mundshëm ndryshimi të bazës ligjore. Pra, në tërësi, për periudhën afatshkurtër nuk mendojmë se nevojiten ndryshime ligjore dhe/ose administrative në nivel kombëtar.

Megjithatë, eksperienca e hartimit të PPV-së, parashtron disa sugjerime paraprake si në vijim, një pjesë e të cilave janë të tilla që duhet të shqyrtohen nga institucionet e nivelit kombëtar (në rast rishikimi të bazës ligjore) dhe një pjesë që vetë Bashkia do të punojë për t`i realizuar gjatë zbatimit të PPV-së. Sa u përket propozimeve për nivelin vendor, ato janë brenda dhe në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar, por vijnë si procedura të mundshme që Bashkia ka të drejtë të hartojë e realizojë në kuadër të autonomisw vendore dhe pa rënë ndesh me legjislacionin në fuqi.

Sugjerime në nivel kombëtar, në rast ndryshimi të bazës ligjore:

- Gjatë zbatimit të PPV-së, mund të lindë nevoja për të ndryshuar intensitetin e ndërtimit dhe/ose koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim (Ksht). Këta koeficientë kanë natyrë shumë teknike dhe janë shumë të rëndësishëm për procesin e zhvillimit dhe veçanërisht pronarët dhe zhvilluesit. Bashkia, mund t`i shfrytëzojë këta koeficientë në zbatimin e Intensitetit me kushte, pra për të përfituar infrastrukturë publike. Ky proces ndryshimi kërkon fleksibilitet për të qenë efiçient dhe fitimprurës.

Për sa kohë që ndryshimi i nevojshëm/kërkuar nuk bie ndesh me propozimet e planit, me legjislacionin e posaçëm (sektorial) dhe treguesit për Kshp dhe Kshr (koeficientë të interesit publik dhe që nuk duhet në asnjë mënyrë të zvogëlohen), sugjerohet që legjislacioni i planifikimit (në një ndryshim të mundshëm) të parashikojë ndryshim të I dhe Ksht vetëm me ndryshim të rregullores dhe miratim në Këshill Bashkiak, pa qenë i nevojshëm kalimi në KKT. Procesi duhet të jetë transparent dhe nevojitet një procedurë për ta realizuar. Këtë propozim nuk e përmban aktualisht ligji, por vjen si sugjerim për një ndryshim të mundshëm ligjor në të ardhmen.

- Po ashtu, nevojitet që legjislacioni i planifikimit dhe zhvillimit të territorit të rishikojë **dokumentacionin që dorëzohet për leje për objektet e vogla** (shiko tabelën e monitorimit në vijim) **në zona rurale**. Nevoja për të ndërtuar këto objekte mbetet shpesh peng i projektit, liçencave profesionale dhe kolaudimit e çertifikimit. Bashkia do të realizojë një procedurë të brendshme për ta lehtësuar procesin e lejes së ndërtimit për këto objekte duke zbatuar legjislacionin në fuqi, por do të ishte e udhës që ky rregullim të bëhej në VKM-në përkatëse.

- Një ndryshim ligjor që identifikohet si mjaft i nevojshëm dhe sugjerohet ka të bëjë **me ndryshimin e resursit të tokës bujqësore në urbane** (konvertimi i tokës), sipas legjislacionit aktual për bujqësinë/tokën bujqësore. Aktualisht, ky legjislacion përcakton se ndërtimet për interes bujqësor që lejohen të ndodhin në tokë bujqësore (llojet e ndërtimeve listohen në VKM nr 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar), dhe si pjesë e procedurës së lejes së ndërtimit është ndryshimi paraprak i resursit të tokës bujqësore në urbane. Një veprim i tillë do të rezultojë në ndërtime për interes bujqësor që do të fragmentojnë tokën bujqësore duke krijuar ishuj urbanë.

Pavarësisht se legjislacioni nuk lejon ndryshimin e përdorimit të objektit të ndërtuar, është më me vlerë që konvertimi i tokës të mos kryhet. Subjekti ndërtues/pronari i tokës mund të kërkojë të ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së ndërtuar pas për shembull 10 apo 15 viteve, dhe kjo mund të lejohet për sa kohë që ndryshimi i destinacionit ndodh brenda listës së objekteve për interes bujqësor. Për shembull, një pronar mund të kërkojë që parcelën e zhvilluar si serë ta kthejë në stallë, apo anasjelltas. Në këtë mënyrë sigurohet fleksibilitet për ndërtimet e lejuara në tokë bujqësore dhe në të njëjtën kohë parandalohet fragmentimi i saj dhe konvertimi gradual e me leje në tokë urbane.

- Është e nevojshme që koncepti **zonë ripariane** të bëhet i detyrueshëm me ligj, dhe pa ndryshuar pronësinë. Mbjellja e zonës ripariane duhet të kryhet nga autoritetet publike, edhe nëse pronësia e tokës është private. Në këtë zonë, pronarët kufizohen në të drejtat e tyre për ndërtim dhe bujqësi dhe bashkia dhe autoritetet qendrore duhet të parashikojnë instrumente dhe masa për të kompensuar këto të drejta, e veçanërisht të drejtën për bujqësi. Kjo do të garantonte edhe zbatimin e legjislacionit të ujërave në lidhje me brigjet dhe të drejtat për përdorimin e tyre. Parashikimet e PPV-së për këto zona përballen me tre vështirësi: kosto e lartë e mbjelljes; pronësia – për ato raste kur këto toka janë private; konvertimi i këtyre sipërfaqeve nga bujqësore në natyrore.

Për vështirësinë e parë, autoritetet vendore e qendrore duhet të parashikojnë fonde të përvitshme. Për vështirësinë e dytë, autoritetet duhet të garantojnë se pronësia është e paprekshme nëse kompensohet vetëm e drejta për bujqësi dhe/ose zhvillim dhe mund të tjetërsohet vetëm në rast të një kompensim të plotë të pronës. Për vështirësinë e tretë, theksojmë se në mjaft raste këto zona kanë qenë natyrore dhe janë kthyer në bujqësore për të rritur sipërfaqen e tokës bujqësore. Për rrjedhojë, burimi ujor ka shkaktuar përmbytje duke dëmtuar edhe më tej tokat e brigjeve. Pra nevojitet që këto sipërfaqe të rikthehen në gjendje natyrore e me bimësi të përshtatshme për ruajtjen e brigjeve ujore.

- Kodi rrugor ka bërë përcaktime që influencojnë vijën e kuqe. Vija e kuqe përcaktohet nga distanca e ndërtimeve nga trupi i rrugës. Kodi rrugor përmban shumë pak përcaktime në lidhje me këto distanca, duke mos konsideruar rastet e shumta të tipologjive urbane. Thelbi i neneve për distancat në Kodin Rrugor është distanca si një parametër teknik, por jo cilësia tërësore e hapësirës. Kjo e fundit realizohet në mënyra të ndryshme për tipologji të ndryshme dhe jo vetëm përmes distancës nga trupi i rrugës, por edhe përmes Kshp e Kshr (koefiçientët për hapësirë publike dhe rrugë). Në zona urbane ku shpejtësia e lëvizjes së automjeteve është e

ulët dhe nuk prek sigurinë e qytetarëve, distancat nga trupi i rrugës mund të jenë më të vogla se sa ato të parashikuara nga Kodri Rrugor (deri në 0m), për sa kohë që trotuari ka një gjerësi të mjaftueshme. Madje në raste të tjera, situata urbane është e tillë ku ndërtimet e reja duhet të respektojnë vijën ekzistuese të ndërtimit (p.sh. zonë e konsoliduar, qendrore, historike, etj.). Këto raste përjashtimore lejohet nga VKM nr. 671/2015 (për planifikimin e territorit) dhe është PPV-ja që duhet t`i detajojë, por duhet të lejohen edhe nga Kodi Rrugor.

Po ashtu, koncepti vijë e kuqe merr në konsideratë në mënyrë të njëjtë çdo object, ndërsa Kodi Rrugor përcakton distanca të ndryshme për ndërtimet, të ndryshme për pemet dhe të ndryshme për muret rrethuese. Nëse i referohemi Kodit, përfshirë këtu edhe rastet përjashtimore si në paragrafin më sipër, atëherë vija e kuqe për një rrugë mund të pozicionohet në mënyra të ndryshme, dhe kjo varet nga konteksti lokal. Për këtë qëllim, është mirë që vija e kuqe të përcaktohet vetëm përmes rregullores, prerjeve tip të rrugëve dhe jo përmes hartës plan.

Në nivel vendor:

- Në nivel vendor nëvojitet të: i) krijohen struktura të reja për monitorim mjedisor dhe të PPV-së, ose të përmirësohen ato ekzistuese duke u shtuar në organikën lokale, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore; ii) të rritet numri i inxhinierëve apo planifikuesve që mbulojnë njësitë administrative; iii) të shtohet stafi i drejtorisë së planifikimit për të zbatuar në kohë dhe më cilësi të gjitha projektet dhe proceset zhvillimore të parashikuara nga PPV-ja.
- Në vijim paraqiten të përmbledhura disa nga çështjet institucionale e ligjore që duhet të ndodhin në nivel vendor për zbatimin e planit të monitorimit të indikatorëve të PPV-së. Theksojmë se propozimet e tabelës së mëposhtme janë tërësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe synojnë të detajojnë procedura të brendshme, në përputhje me përcaktimet ligjore, përmes të cilave lehtësohet zbatimi i PPV-së dhe i ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur idnikatorët të cilët shërbejnë për procesin e monitorimit të këtij plani

Tabela 111. Indikatorët për monitorimin e PPV-së

Indikatori	Vlera	Periudha e monitorimit	Çështje institucionale e ligjore
Lejet e ndërtimit të dhëna në përputhje me PPV-në	E pacaktuar	Çdo fund muaji dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	Procedurat për lejet janë të përcaktuara ligjërisht dhe në rregulloren përkatëse të bashkisë. Me një rregullore të brendshme nevojitet të rregullohet procedura për rastet e objekteve me volum të vogël, kryesisht për bujqësi, si strehim për kafshët në bujqësi, depo për vegla bujqësore, etj. Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014.

Deklaratat paraprake për punime	E pacaktuar	Çdo fund muaji dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	
Ndërtime informale në territor	0	Çdo fund muaji dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	Bashkëpunim me ALUIZNI. Në rregulloren e brendshme nevojite të rregullohet procedura e monitorimit sipas strukturës përkatëse në bashki. Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014.
Projektet prioritare të zbatuara në përputhje me PPV dhe veçanërisht Planin e Investimeve Kapitale	Të paktën 50% e projekteve sipas fazimit të realizuar në PPV dhe në PIK	Çdo gjashtë muaj dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014.
Numri i rasteve/njësive strukturore në të cilat zbatohet INK	Të paktën një rast në vitin e parë pas miratimit të planit; 10% e rasteve të parashikuara, në 3 vitet e para pas miratimit të planit; mbi 20% e rasteve të parashikuara, në vitet në vijim.	Çdo fund viti.	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014. Përgatitje e rregullores së programit specifik ose e procedurës për rastin përkatës.
Numri i rasteve dhe pronave që marrin pjesë në program TDZH	Të paktën një rast në 3 vitet e para pas miratimit të planit; Të paktën kërkesa nga 40% e rasteve në vitet në vijim.	Çdo fund viti.	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014. Përgatitje e rregullores së programit specifik ose e procedurës për rastin përkatës. Indikatori rishikohet pas 3 viteve të para pas miratimit të planit, pas vlerësimit të suksesit dhe mundshmërisë së zbatimit të programit. Kjo mund të kërkojë edhe ndryshim të PPV për t'iu përshtatur kushteve të reja dhe realitetit.
Mundësia për ndryshim të PPV-së	Jo më shumë se 5% e sipërfaqes brenda 2 viteve të para; Jo më shumë se 1% e njësive strukturore në lidhje me intensitetin dhe/ose Ksht, brenda 2 viteve të para; 0% zvogëlim të sipërfaqes së propozuar rrugore dhe të hapësirës publike në çdo kohë.	Çdo fund viti.	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014. Dokumentim dhe publikim sipas ligjit i procedurave për ndryshim. Për dy vlerat e para (ndryshimi i sipërfaqes dhe i njësive strukturore në lidhje me Intensitetet dhe Ksht), pas dy viteve të para pas miratimit të planit duhet të propozohet një vlerë e re e indikatorit, por pa ndryshuar indikatorin.

			Vlera për hapësirën publike dhe sistemin rrugor nuk ndryshon gjatë jetëgjatësisë së planit, përveçse nëse rritet.

3. Shtojcat

3.1 Tabela përmbledhëse e PPV-së

1. Të dhëna të përgjithshme për bashkinë		
Emërtimi	**Vlera dhe Njësia**	**Specifikime**
Sipërfaqja e njësisë vendore	160.03 km^2	Sipërfaqe truall, tokë bujqësore etj.
Numri i popullsisë ekzistuese	31,424 banorë(INSTAT) 52,0150(Gjendja Civile)	Popullsia për çdo njësi të qeverisjes vendore
Zona të rëndësisë kombëtare dhe zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore	925.8 ha	Sipas legjislacionit të posaçëm dhe ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit
Sipërfaqe e miratuar zonash informale	20.5 ha	Zonat e miratuara nga ALUIZNI
Problematika mjedisore		Venddepozitimi i mbetjeve të ngurta dhe inerte, Zonat e nxehta mjedisore ish-UPN, vendburimet e naftës, kanali i Dikatrës, mostrajtimi i ujërave të ndotura dhe të shiut etj

2. Propozime të PPV-së		
Emërtimi	**Vlera dhe njësia**	**Specifikime**
Lloji i zhvillimit të pritshëm në 15 vitet e ardhshme		Intensifikimi i qendrave të urbanizuara, dhe mbushje urbane në zonat të cilat kanë nisur procesin e urbanizimit. Mbrojtja dhe Konservimi strikt i tokës bujqësore dhe burimeve të tjera natyrore, Intensifikimi i oznave ekonomike të cilat kanë kapacitetin për të akomoduar bizneset e reja. Shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe krijimi i korridoreve të gjelbërta vegjetative etj.
Përdorimet kryesore të propozuara të tokës		Banim, Bujqesi, Naturore, Industri e lehte përpunuese, Shërbime, Parku periferik i qytetit, Aktivitete Sociale dhe Rekreacion, Arsim dhe Shëndetësi
Numri i popullsisë së pritshme shtesë në 15 vitet e ardhshme	3000 banorë	Vlerësimi sipas parashikimeve demografike parashikon renine të

		populllsië por me zhvillimet që pritet të ketë bashkia në kuadër të planit parashikohet të ketë një rritje prej 3000 banorësh
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar për banim	90. 775 ha	Sipërfaqja që pritet të shtohet për banim në 15 vitet e ardhshme
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar jo për banim	23.275 ha	Specifikimi i funksioneve biznes, tregti, industri etj.
Sipërfaqe e përgjithshme e zonave në mbrojtje	925.8 ha	Zonat e mbrojtura, zona për konservim etj.
Sipërfaqe e përgjithshme e banesave për strehim social	12.2 ha	
Sipërfaqe të gjelbra shtesë	1832.2 ha	Parqe, pyje etj.
Numri i njësive strukturore	378	

3. Të dhëna financiare		
Emërtimi	**Vlera dhe Njësia**	**Specifikime**
Vlera e përgjithshme e planit e investimeve kapitale	9,992,466,173 lek	Duhet të jetë në përputhje me programin buxhetor afatmesëm
Fazat e zbatimit të zhvillimit	3 periudha përkatëse	0-3 vite – Afatshkurtër 3-5 vite Afatmesëm 5 deri në jetëgjatësinë e planit - Afatgjatë

4. Dokumenti i PPV-së për dorëzim				
Nr.	**Kapitulli/Dokumenti**	**Hartohet/Miratohet**	**Referenca ligjore**	**Check list**
1.	Strategjia territoriale	Hartohet dhe miratohet	Neni 51 pika 2 VKM. 671	+
2.	Analiza dhe vlerësimi i territorit	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Neni 53 VKM. 671	+
3.	Parashikimet e planit	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Neni 54 VKM. 671	+
4.	Vlerësimi strategjik mjedisor	Hartohet dhe miratohet	Neni 51 pika 5 VKM. 671	+
5.	Materiali hartografik	Hartohen dhe miratohen	Neni 57 VKM. 671	+
6.	Rregullorja e PPV-së	Hartohet dhe miratohet	Neni 56 VKM. 671	+
7	Plani i Investimeve Kapitale	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Neni 51 pika 3/dh VKM. 671	+

5. Hartat bashkëlidhur dokumentit të shkruar të PPV-së sipas rregullores së planifikimit

Nr.	Tematika e hartës	Lloji i hartës	Shkalla	Kodi i hartës	Check list
1.	Harta bazë	Harta bazë vektoriale e njësisë vendore dhe topografia	1:75,000	Brenda në tekst	+
2.	Vizioni strategjik i zhvillimit të territorit	Drejtimet kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit; objektivat; fazat kohore të zbatimit të programeve.	1:75,000 1:25,000 1:10,000	V:1,V:2 V;3,V;4 P;02/9, P;02/10 N;01/16 N;01/17	+
2.	Elementet ekzistuese të territorit	Topografik; gjeologo-inxhinierik; hidro-gjeologjik dhe hidrografik; e makrozonimit dhe, sipas rastit, mikrozonimit sizmik; boniteti i tokave; burimet natyrore, si mjedise pyjore, kullota, sipërfaqe ujore, rezervate, miniera dhe të tjera të kësaj natyre; zonat e mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë kulturore dhe historike.	1:75,000	Brenda në tekst	+
3.	Pozicionimi strategjik i në raport me rajonin	Kufijtë territorialë në rajon; Identiteti historik, urban, ekonomik	1:500,000	Brenda në tekst	+
4.	Vlerësimi ekonomik	Pozicionimi dhe përqendrimi i burimeve dhe poleve ekonomike lokale; elementet e konkurrueshmërisë; shpërndarja e sektorëve dhe e fuqisë punësorë;	1:75,000	Brenda në tekst	+
5.	Vlerësimi social	Shërbimet sociale; shkollat; shëndetësia	1:75,000	Brenda në tekst	+
	Vlerësim demografik	Përqendrimi i popullsisë në territor; lëvizjet e popullsisë në vite; shpërndarja e popullsisë në nivel banese dhe për tipologji banesash; sipërfaqen e banimit për person sipas tipologjive të banesave; numri i banesave në një strukturë banimi sipas tipologjive në territor.	1:75,000	Brenda në tekst	
6.	Analiza e planeve të mëparshme	Përdorimi i tokës; infrastrukturat; intensiteti i ndërtimit.	1:75,000 1:25,000 1:10,000	Brenda në tekst	+
7.	Pronat	Përdorimi i pronave publike; problemet në marrëdhëniet e pronësisë në territor; zonat informale sipas llojeve dhe ecurisë së integrimit	1:75,000	Brenda në tekst	+
8.	Rëndësia kombëtare	Zonat dhe strukturat	1:75,000	P;04	+
9.	Problemet mjedisore	Vendndodhja e elementeve ndotëse dhe me ndikim negativ;	1:150,000	M;02	+

		Shkalla e ndikimit negativ të burimeve ndotëse në territor			
10.	Përdorimi ekzistues i tokës	Kategori bazë; nënkategoritë; funksionet dhe aktivitetet;	1:75,000 1:25,000 1:10,000	Brenda në tekst	+
11.	Infrastrukturat	Furnizimi me ujë; ujërat e zeza; mbetjet urbane; rrugët; ndricimi; transporti; lidhja me infrastrukturat kombëtare	1:75,000 1:25,000 1:10,000	Brenda në tekst	+
12.	Cilësia fizike e strukturave	Nivelet e cilësisë; rekomandime për riparim, rigjenerim, rizhvillim.	1:75,000 1:25,000 1:10,000	Brenda në tekst	+
13.	Tipologjitë hapësinore	Zona sipas njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes në parcelë dhe në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike si dhe lartësisë së strukturave	1: 75,000	N;01/13 N;01/14	+
14.	Periferaliteti	Zona sipas: largësisë nga qendra e zonës së banuar; largësisë nga qendrat e punësimit; lidhjes me sistemin rrugor; furnizimin me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale; nivelit të përafërt të të ardhurave të shtresave shoqërore; plotësimit me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës; nivelit të kriminalitetit dhe sigurisë së jetës; problemeve të ndryshme sociale përfshirë përjashtimin social.	1:75,000	Brenda në tekst	+
15.	Elemente të veçanta territoriale	Objekte dhe struktura, natyrore apo artificiale, me ndikim në qytet dhe hapësirëformim	1:75,000	Brenda në tekst	+
16.	VSM	Hartat përshkruese, analizuese dhe vlerësuese	1:75,000	M;03 M;04 M;05 M;06	+
17.	Parashikimi i përdorimit të tokës	5 sistemet; kategoritë bazë dhe nënkategoritë; funksione dhe aktivitete; qendrat, polet, korridoret kryesore të zhvillimit ekonomik; tipologjitë e parashikuara hapësinore; zonat e rëndësisë kombëtare; njësitë strukturore; zonat me prioritet zhvillimi; zonat për PDV; shpërndarja e popullsisë; plani e strehimit;	1:75,000 1:25,000 1:10,000	P;01 P;01/1 P;01/2 P;01/3 P;01/4 P;01/5 P;01/6 N;01/1 N;01	+

		të tjera;			
18.	Shërbimet dhe infrastrukturat e propozuara	Rrjetet e infrastrukturave; Objektet e shërbimeve sociale dhe rrezet e mbulimit	1:75,000 1:25,000 1:10,000 (Q)	P;03/1 P;03/2 P;03/3	+
19.	Instrumentet e drejtimit të zhvillimit	Zonat për transferim të së drejtës për zhvillim Zona për intensitet me kushte Zona për zhvillim të detyrueshëm të tokës Zonat e preferimit; Zonat e pezullimit të zhvillimit; Zonat për servitut publik;	1:75,000	Brenda në tekst	+
20	Plani i veprimeve	Harta e fazimit të zhvillimit sipas njësive strukturore dhe sipas infrastrukturave; Tjetër sipas rastit	1:75000	Brenda në tekst	

3.2 Tabela sistemeve dhe zonave

Sistemet	Treguesit	Vlera	Zona (Emër dhe Nr.)	Kuçovë Nr. 1	Kozare Nr. 2	Lumas Nr. 3	Perondi Nr. 4
Sistemi Urban	1. Sipërfaqe përgjithshme (ha ose km²)	9.25km²	Sipërfaqe (ha)	388	4,704.9	7,195.7	3,778.3
	2. Gjatësia e sistemit rrugor m/banor	9.57	Sipërfaqe banimi (ha)	97.6	32.9	20.3	77.4
	3. Populsia ekzistuese dhe kapaciteti mbajtës	55,015 banore (pop. ekz. sipas Gjendjes Civile) 91,317 banore (kapaciteti mbajtës)	Zona ekonomike (ha)	10.8	0	0	55.7
	4. Njësi banimi të parashikuara sipas kapacitetit mbajtës	2,282,925 m²ndërtim	Kapaciteti mbajtës (popullsi)	39,041	13,173	8,143	30,960
	5. Njësi banimi të mundshme për strehim social	467	Dendësi sipas kapacitetit mbajtës (banorë/ha)	100.62	2.8	1.13	8.2
	6. Njësi shëndetësore (ekzistuese dhe të prpozuara)	23	Gjelbërim i zonës urbane (m²/banor)	33.57	33.57	33.57	33.57
	7. Njësi të arsimit 9-vjeçar (ekzistuese dhe të prpozuara)	27	Parkimi maksimal i mundur (m²)	234,246	79,038	48,858	185,760
	8. Njësi të arsimit të mesëm (ekzistuese dhe të prpozuara)	8	Nr. i njësive strukturore	56	104	106	112
	9. Nr. i linjave të transportit publik urban dhe ndërurban	6	Nr. njësive me PDV	6	0	0	6
	10. Nr. i njësive strukturore	378	Njësi për TDZH	Po 1 dhënëse 2 marrëse	Jo	Jo	Po 4 dhënëse
	11. Sipërfaqe e gjelbër m²/banor	33.57	Njësi për INK	2	-	-	-
	12. Sipërfaqe trashegimi kulturore (ha)	2.32 ha	Sistem urban (ha)	251.6	129.4	133	309.5
	13. Tregues ekonomikë	66.5 ha zonë ekonomike (biznes, industri)	Njësi banimi	9,760	3,294	2,035	7,740
	14. Sipërfaqe pronash publike (ha) dhe % ndaj sipërfaqes së përgjithshme	3,602 ha dhe 2.25%	Dendësia njësi banimi/ha	38.79	25.4	15	25
	15. Sipërfaqe që konvertohet në hujqësore (m² ose ha)	PA	Hapësira publike (m²)	22.4 ha	4.2 ha	3.2 ha	6.8 ha
	16. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m² ose ha)	PA					

	17. Sipërfaqe që konvertohet në ujore (m^2 ose ha)	PA					
	18. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	2.7 ha					
	19. Shërbime administrative (nr. objektesh dhe Sn m^2)	41 objekte me sn 13,803 m^2					
	20. Detyrime fetare (nr. objektesh dhe Sn m^2)	5 objekte me sn 2,697 m^2					
	21. Intensiteti për ha (m^2/ha)	4 013m^2/ha					
Sistemi Bujqësor	1. Sipërfaqe e përgjithshme (ha)	82.3 km^2	Sistem bujqësor (ha)	0	2,753	2,478	2,353
	2. Sipërfaqe kryesore (Boniteti I-IV) në ha	PA	Nënkategoritë	Bujqësore e Kultivuar	Bujqësore e Kultivuar, Sera, Magazinimi Bujqësore	Bujqësore e Kultivuar, Sera, Magazinimi Bujqësore	Bujqësore e Kultivuar, Sera, Magazinimi Bujqësore
	3. Sipërfaqe dytësore (Boniteti V-X) në ha	PA	Nr. i njësive strukturore	1	24	19	22
	4. Sipërfaqe ose gjatësi e sistemit të ujitjes dhe vaditjes sipas 3 kategorive	55 km kanale të I 49.3 km kanale të II 12.6 km kanale të III					
	5. Sipërfaqe tokë pa fryt (ha)	236.39 ha					
	6. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m^2 ose ha)	8.3 ha					
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m^2 ose ha)	57.9 ha					
	8. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	38.6 ha					
Sistemi Ujor	1. Sipërfaqe ujore (km^2)	4.64km^2	Sistem ujor lumë (ha)	0	220.6	130.8	33.6
	2. Gjatësia e lumenjve kryesorë (km)	26.5	Sistem ujor liqene (ha)	0	19.4 ha	40.8 ha	13.9 ha
	3. Sipërfaqe akuiferesh sipas llojeve	22.4 km^2çarje/karst 12.8 km^2 ndërkokrrizor 9.6 km^2 poro/çarje 1.6 çarje					
	4. Sipërfaqe që konvertohen, nëse është rasti	PA					
Sistemi Infrastrukturor	1. Sipërfaqe ose gjatësi rrugësh sipas kategorive të kodit rrugor	5.68km^2	Sistem infrastrukturor (ha dhe km)	31	113.3	87.7	351.7
	2. Gjatësia e hekurudhës (km)	PA					
	3. Nr. aeroportesh	1(airoport ushtarak)					
	4. Njësi energjitike (nr. ose sipërfaqe ose gjatësi)	PA					
	5. Landfill/ Incinerator/ Zonë për kompostim (Nr. ose ha)	1					
	6. Impiant për trajtimin e ujërave të ndotura (Nr. ose ha)	PA					
	7. Sipërfaqe ose gjatësi që konvertohet në një sistem tjetër (specifiko, nëse rasti)	PA					
Sistemi Natyror	1. Sipërfaqe e përgjithshme (ha ose km^2)	58.08km^2	Sistem natyror (ha)	0	1,008	4,281	456
	2. Sipërfaqe pyjore (ha)	4,367ha	Nënkategoritë		Shkurre e Dendur, Shkurre e Përzier	Shkurre e Dendur, Shkurre e Përzier	Shkurre e Dendur, Shkurre e Përzier
	3. Sipërfaqe kullota (ha)	423.6ha	Nr. i njësive strukturore	0	3	24	6

	4. Sipërfaqe të mbrojtura sipas llojeve (ha)	4,367 ha pyll 423.6 ha kullota 278.5 ha toke bosh					
	5. Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm (nr dhe ha)	3 zona 925.8 ha					
	6. Sipërfaqe që konvertohet në bujqësore (m^2 ose ha)	PA					
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m^2 ose ha)	12.8ha					
	8. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	35.5ha					

3.3 Korrespondenca institucionale

Takimet e kryera në kuadër ta hartimit të PPV- Bashkia Kuçovë			
Personat/ Institucioni/	**Data e takimit**	**Vendi i takimit**	**Qëllimi i takimit**
Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile	10/02/2016	Tiranë	Marrje informacioni mbi zonat e përmbytjes, zonat e rrezikuara nga tërmetet, zjarret etj.
Emergjencat Civile Rajonale - Berat	26/02/2016	Bashkia Berat	Marrje informacioni mbi zonat e përmbytjes, zonat e rrezikuara nga tërmetet, zjarret etj.
Autoriteti Rrugor Shqipëtar (ARrSh)	26/10/2015	Tiranë	
AlbPetrol	07/03/2016	Kuçovë	Mbi vendburimin e gazrave dhe zonave të kontratës për Bashkinë Kuçovë
Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Administrimit të Tokës Bujqësore	19/02/2016	Tiranë	Marrje informacioni dhe harta për bonitetin e tokave, kanalet ujitëse dhe vaditëse
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)	06/2016	Fushë-Krujë	Marrje e hartave dhe informacionit mbi bonitetin e tokave
INSTAT	03/2016	Tiranë	Të dhënat mbi popullsinë
AlbPetrol	06/2016	Kuçovë	Marrje informacioni mbi problematikat e sektorit të industries së naftës në bashkinë Kuçovë
SHGJSH	12/2015	Tiranë	Grumbullim informacioni mbi urjërat nëntokësorë dhe gjeologjinë e bashkisë
ALUIZNI	11/04/2016	Tiranë	Marrje informacioni mbi zonat informale dhe zonat në process legalizimi
Forumi i Bashkërendimit të Planeve Vendore	12/02/2016	Bashkia Berat	Bashkërendimi i SZHT Kuçovë me bashkitë kufitare dhe AKPT
Forumi i Bashkërendimit të Planeve Vendore	15/09/2016	Bashkia Berat	Bashkërendimi i PPV Kuçovë me bashkitë kufitare dhe AKPT
Agjensia e Zonave të Mbrojtura Berat	12/07/2016	Agjensia e Zonave të Mbrojtura Berat	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi Zonat e Mbrojtura të Bashkisë Berat dhe porpozime mbi Bashkinë Kuçovë
ARM Berat	12/07/2016	Agjensia Rajonale e Mjedisit, Berat	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi VSM-në, Zonat Nxehta Mjedisore, Monitorimet, Problemet Mjedisore dhe projektet.

Bankers Petrolium	07/2016	Bankers Petrolium Fier	Grumbullim informacioni mbi teknologjinë e shpimeve të naftës në fushën naftëmbajtëse të Kuçovës

Korrespondenca Institucionale në kuadër ta hartimit të PPV- Bashkia Kuçovë			
Institucioni	**Qëllimi i shkresës**	**Data e dërgimit/ Nr protokolli**	**Kthimi i Përgjigjes**
Bordi i Kullimit	Kërkesë për të dhëna mbi investimet e vitit 2016 të cilat pritet të financohen nga Banka Botërore	11/09/2015 Nr.Prot. 5663	23/09/2015 Nr.Prot. 177/1
Agjencia e Shërbimit Arkeologjik	Të dhëna mbi vendodhjen e zonave me potencial arkeologjik	11/09/2015 Nr.Prot. 5670	02/10/2015 Nr.Prot. 601/1
Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Paurive Kulturore	Marrja e listës së plotë të monumenteve të kulturës	11/09/2015 Nr.Prot. 5675	02/11/2015 Nr.Prot. 264/1
Drejtoria Rajonale e Mjedisit	Marrja e informacionit mbi lejet mjedisore dhe subjektet operuese për Qarkun Berat	11/09/2015	
Drejtoria e Shërbimit Pyjor	Marrja e informacionit mbi sipërfaqet pyjore në pronësi të Bashkisë Kuçovë	11/09/2015 Nr.Prot. 5679	18/09/2015
Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARrSh)	Lista e objekteve ne ndertim (2013, 2014, 2015) + Harta e sistemit rrugor dhe hekurudhor të Shqipërisë.	11/09/205	22/12/2015
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	Mbi lejet minerare në Bashkinë Kuçovë	06/10/2015 Nr.Prot. 6355	26/10/2015 Nr.Prot. 8799/1
Qendra Kombëtare e Regjistrimit	Raporti Vjetor I Regjistrit Tregtar, 2015		29/03/2016 Nr.Prot. 3018
MBZHRAU	Të dhënat lidhur me aktivitetin e akuakulturës në lumenj, liqene, rezervuare	06/04/2016 Nr.Prot. 1679/6	19/04/2016 Nr.Prot. 2131/1

3.4 Procesverbalet dhe materiale nga dëgjesat publike, komente e përgjigje

Kuçovë, më 09 / 10 / 2015

PROCES – VERBAL

Sot më datë 09 / 10 / 2015 u realizua dëgjesa e parë publike mbi nismën e Planit të Përgjithshëm për Bashkinë Kuçovë. Kjo dëgjesë u realizua në prani të:

- Kryetarit të Bashkisë Kuçovë z. Selfo Kapllani.
- Specialistët e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit
- Administratorët e Njësive Administrative Perondi, Kozare, Lumas.
- Komisionit Qytetarë.
- Grupet e Interesit si: biznesi privat, OJF etj.

- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Dëgjesa u nis me fjalimin e Kryetarit të Bashkisë z.Selfo Kapllani, në të cilin falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim. Ndër të tjera, theksohet nga kryetari arsyet e ndërmarrjes së nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit Administrativ nga Bashkia Kuçovë. Ky proçess po asistohet nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes Projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) si një nga pesë (5) bashkitë model në Republikën e Shqipërisë. Për t`u njohur me këtë nismë dhe proçedurat e saj bëhet prezantimi nga specialistja e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit znj. Xhenisa Kostreni.

Në këtë prezantim u informua mbi:

- Qëllimin e PPV
- Territori i Bashkisë Kuçovë
- Dokumentet përfundimtare
- Grupet e punës
- Proceset dhe afatet kohore
- Takime këshilluese, teknike dhe organizative
- Forumi këshillimor vendor
- Buxheti
- Si dhe dëgjesa publike ku e I u zhvillua sot.

Në këtë dëgjesë të parë u fol mbi nismën e PPV-së.

Proçesi i miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Kuçovë do të bëhet me dy ndalesa:

Ndalesa e I: Do të jetë miratimi i Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Njësisë.

Ndalesa e II: Miratimi i Planit të Zhvillimit të Territorit.

Ndër Prioritetet e Planit të Përgjithshëm Vendor janë projektet si më poshtë:

- Ndërtimi i rrugës Kuçovë- Lumas.
- Zgjerimi i varrezave.
- Vend grumbullimi të mbetjeve urbane.
- Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare "18 Tetori".
- Rikonstruksioni i rrugës "Toli Shuka".
- Si dhe projekte të tjera të renditura në prezantim.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u dhanë sugjerimet si:

- Të bëhen investime në shkollën fillore të Njësisë Administrative Kozare.
- Projekt për lulishte pranë pallateve dhe konkretisht në lagjen nr.1, blloku "Tafil Skëndo".

- Rikonstruksioni i Gjimnazit të Përgjithshëm Kuçovë.
- Rikonstruksioni i Institucioneve aktuale të Kulturës ose ndërtimi i objekteve të reja në funksion të tyre.
- Ftesë për donatorët për të investuar në projekte të ndryshme të cilat do të ndikojnë në përmisimin e cilësisë së jetesës së komunitetit.
- Plani i Përgjithshëm Vendor i mëparshëm i Bashkisë Kuçovë me kufijt e vjetër, të jetë orientim dhe të shërbejë në përmisimin dhe hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor i cili është në proçes dhe përfshin territorin e Bashkisë së re Kuçovë.

Dëgjesa pasardhëse do të jetë në fund të nentorit, me tematikë: "VIZIONI".

Dëgjesa të tjera do të zhvillohen janar- korrik 2016 ku do të jetë informimi mbi Planin, Rregulloren dhe VSM dhe do të zhvillohen 2- 3 takime. Është parashikuar që finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor dhe VSM të jetë në mes të muaji mars 2016. Në ë gjitha këto takime, do të jenë të pranishëm edhe specialistët e Institutit të Zhvillimit të Habitait (Co-plan), të cilët do të marrin pjesë në diskutimet e hapura për auditorin.

Në këtë takim proçes-verbali u mbajt nga juristia e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit znj. Milena Bullari.

Për/ Drejtorinë e Urbanistikës dhe Strehimit

Ing. Olgert ZOGA

Ark. Eljan HAJDARI

Ing. Xhenisa KOSTRENI

Sp/Strehimi. Bledar DJAMANDI

Juriste. Milena BULLARI

Sp/Investimesh. Julian LEZO

Sp/kontrolli të territorit. Edmond MENAJ

Kuçovë, më 04/ 12 / 2015

PROÇES – VERBAL

Sot më datë 04 / 12 / 2015 u realizua dëgjesa e dytë publike mbi vizionin e Planit të Përgjithshëm për Bashkinë Kuçovë. Kjo dëgjesë u realizua në prani të:

- Kryetarit të Bashkisë Kuçovë z. Selfo Kapllani.
- Specialistët e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit.
- Specialistë të CoPLAN.
- Specialistë të Agjensiësë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (A. K. P. T)
- Administratorët e Njësive Administrative Perondi, Kozare, Lumas.
- Komisionit Qytetarë.

- Grupet e Interesit si: biznesi privat, OJF etj.
- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Dëgjesa u nis me fjalimin e Kryetarit të Bashkisë z.Selfo Kapllani, në të cilin falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim. Ndër të tjera, theksohet nga kryetari se në këtë takim do të jepet vizioni për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit Administrativ nga Bashkia Kuçovë dhe procesi i miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor i cili do të bëhet me dy ndalesa:

1- Fillimisht do të kalohet në proçesin e **miratimit të Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Njësisë,** dhe

2- më pas do të miratohet **Plani i Zhvillimit të Territorit** shoqëruar nga rregullorja në zbatim të tij.

Ky proçess po asistohet nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes Projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) si një nga pesë (5) bashkitë model në Republikën e Shqipërisë. Për t'u njohur mbi vizionin e Planit të Përgjithshëm Vendore bëhet prezantimi nga specialisti i CoPLAN, z. Zenel Bajrami.

Në këtë prezantim u informua mbi:

- Pikëpamja policentrike dhe shtrirja hapësinore e Bashkisë Kuçovë.
- Përdorimi i tokës dhe infrastruktura.
- Të dhënat dhe parashikimet demografike.
- Punësimi.
- Niveli i edukimit.
- Shëndetësia.
- Biznesi
- Bujqësia.
- Mjedisi, ekositemet dhe ndotja.

Në këtë dëgjesë të parë u fol mbi vizionin e PPV-së, mbi shtrirjen e Bashkisë Kuçovë që shtrihet në pjesën lindore të Ultësirës Perëndimore, e kufizuar në veri dhe veriperëndim nga zona e Sulovës dhe lumi Devoll, e në jug e jugperëndim nga rrjedha e poshtme e lumit Osum. Me një sipërfaqe prej 160.22 km^2, territori i Kuçovës së sotme e tejkalon atë të rrethit të Kuçovës, duke përfshirë nën juridiksionin e saj edhe njësinë administrative Lumas, krahas njësive Kuçovë (qendër), Perondi e Kozare. Duke iu referuar studimit të policentrizmit [377] në nivel kombëtar, Kuçova, së bashku me Beratin dhe njësitë administrative Perondi, Otllak e Ura Vajgurore, përbën një nga qendrat e aglomeratit bipolar Berat-Kuçovë. Kjo Zonë Funksionale Urbane (ZFU) nuk mbivendoset me ZFU të tjera fqinje, dhe ka një popullsi prej 116 653 banorësh, duke mbuluar kështu 78% të popullsisë së qarkut Berat.

Më shumë se gjysma e territorit të Bashkisë Kuçovë (rreth 52% e saj), mbulohet nga toka bujqësore, kryesisht tokë e kultivuar e tipit arë, e përqëndruar në gjithë pjesën perëndimore, si dhe përgjatë luginëssë lumit të Devollit e përrenjve që derdhen në të. Prodhimet kryesore

të kultivuara në të janë drithërat, perimet (në sera), bostanoret, foragjeret, ullinjtë, pemët frutore dhe vreshtat. Zonat natyrore shtrihen kryesisht në masivin kodrinoro-malorlindor, zënë rreth 35% të territorit, dhe përbëhen nga pyje të dendur të përzier dhe shkurre të dendura, veçanërisht pyje të shkozës së përzier.

Nga këndvështrimi strukturor demografik, në bashkinë Kuçovë banojnë rreth 22% e popullatës rezidente të qarkut Berat (31 424 banorë), duke përbërë kështu bashkinë e dytë më të populluar të tij, pas Bashkisë Berat. Kjo populsi, krahasuar me regjistrimin e fundit të vitit 2011, ka pësuar rënie me rreth 1500 banorë, ose me 5% më pak. Shkaqet për këtë lidhen me emigrimin, uljen e ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritme te larta të migrimit të brendshëm. Njësia më e populluar mbetet qendra Kuçovë, ku jetojnë 40 % e banorëve të bashkisë, e ndjekur nga Perondia, Kozare e më pas Lumasi. Pra raporti urban-rural vlerësohet si 40-60, në favor të popullsisë rurale.

Ekonomia e Bashkisë Kuçovë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë, e cila është sektori që gjeneron punësimin më të lartë, mbi 50% në nivel bashkie dhe mbi 75% në njësitë administrative me karakter rural.

Ndërkaq, sektori i shërbimeve gjeneron punësim për 16.41% të popullsisë dhe industria për 10.9% të popullsisë, ku 70% e tyre i përkasin popullsisë urbane. Gjithsesi, sa i takon numrit të aktiviteteve që operojnë në sektorë të ndryshëm, predominojnë aktivitetet tregtare (që përbëjnë 54.3% të tregut), ndjekur nga shërbimet (me 31.1%) dhe nga industria (10.9%). Shkalla e papunësisë për bashkinë është relativisht e ulët, në raport me rajonin: Kuçova ka një normë 20.5% të papunësisë.

Në bashkinë Kuçovë, mesatarja e viteve të shkollimit është 9.6 vite, relativisht më e ulët se mesatarja kombëtare (10.2) dhe e njëjtë me mesataren në nivel qarku. Përqindja e popullsisë me arsim të lartë universitar dhe pasuniversitar është 6.2%. Ky raport e pozicionon Kuçovën në mënyrë të favorshme në raport me bashkitë fqinje të Belshit, Cërrikut dhe Ura Vajgurore, por në disfavor në lidhje me vlerën në nivel qarku (11.7%). Njësia Kozare ka përqindjen më të lartë të popullsisë që ka përunduar vetëm arsimin fillor ose 8/9-vjeçar (75.17%), kurse qyteti i Kuçovës rezulton me nivelin më të lartë arsimor, ku 10% e popullsisë kanë përfunduar arsimin universitar

Sa i takon infrastrukturës arsimore, bashkia Kuçovë ka mbulim të mirë me të tre nivelet e arsimit (parashkollor, 9-vjeçar dhe të mesëm).

Në bashkinë Kuçovë gjenden 20 institucione shëndetësore, nga të cilat 1 spital (në qytetin e Kuçovës), 6 qendra shëndetësore, 7 ambulanca konsultore, 3 shërbime dentare dhe 3 farmaci. Duke qenë se standardi për qendra shëndetësore është 1 për 250-1500 banorë dhe për ambulanca 1 për 1500-2000 banorë, rezulton të nevojiten minimalisht 21 qendra shëndetësore dhe 16 ambulanca për të përmbushur nevojat bazë të popullsisë së Kuçovës, pra 15 qendra shëndetësore dhe 9 ambulanca shtesë.

Pjesa me e madhe e biznesit, 102 prej tyre janë bare, kafe, restorante, 92 ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregti dhe transport, 82 njësi i përkasin shërbimeve. Ndërkaq, Shuma e kontributeve që japin bizneset e vogla në formë takse, ka pësuar rritje në vitin 2012, për shkak të rritjes së numrit të bizneseve, por deri në 2014 ka rënë sërish në vlera më të ulëta se 2009.

Toka bujqësore në Bashkinë Kuçovë zë rreth 8,184ha dhe ndodhet në Perondi, Kozarë, Lumas. Toka kultivohet me drithëra, perime (perime në sera), bostanore, foragjere, ullinj, pemë frutore dhe vreshta. Në bashki ndodhet edhe një shoqatë fermerësh dhe 37 biznese agropërpunimi.

Kuçova karakterizohet nga një klimë mesdhetare fushore me dimër të butë e me lagështirë dhe me verë të nxehtë dhe të lagësht.Temperatura mesatare vjetore është rreth 16.7°C.Temperatura maksimale vjetore gjatë ditës është është rreth 29.2°C, ndërsa ajo minimale është 4.1°C. Zona e Kuçovë është një nga zonat më të nxehta të vendit, ku temepartura e ditëve të nxehta mund të arrijë edhe 42-45°C, ndërsa ajo e ditëve të ftohta të dimri mund të shkojë rreth -7°C.

Ndër Prioritetet e Planit të Përgjithshëm Vendor janë projektet si më poshtë:

- Ndërtimi i rrugës Kuçovë- Lumas.
- Zgjerimi i varrezave.
- Vend grumbullimi të mbetjeve urbane.
- Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare "18 Tetori".
- Rikonstruksioni i rrugës "Toli Shuka".
- Si dhe projekte të tjera të renditura në prezantim.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u dhanë sugjerimet si:

- Të merren masa për ndotjet që janë tek kanalet kryesore të qytetit.
- Ti jepet rëndësi infrastrukturës rrugore, sidomos segmentit Elbasan- Kuçovë.

Dëgjesa pasardhëse do të jetë më 13 janar 2016, në vazhdimësi të miratimit të Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Njësisë për Planin e Përgjithshëm Vendor.

Dëgjesa të tjera do të zhvillohen janar- korrik 2016 ku do të jetë informimi mbi Planin, Rregulloren dhe VSM dhe do të zhvillohen 2- 3 takime. Është parashikuar që finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor dhe VSM të jetë në mes të muaji mars 2016. Në të gjitha këto takime, do të jenë të pranishëm edhe specialistët e Institutit të Zhvillimit të Habitait (Co-plan), të cilët do të marrin pjesë në diskutimet e hapura për auditorin.

Në këtë takim, proçes-verbali u mbajt nga specialistja e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit znj. Xhenisa Kostreni.

Për/ Drejtorinë e Urbanistikës dhe Strehimit

Ing. Olgert ZOGA

Ark. Eljan HAJDARI

Ing. Xhenisa KOSTRENI

Sp/Strehimi. Bledar DJAMANDI

Juriste. Milena BULLARI

Sp/Investimesh. Julian LEZO

Sp/kontrolli të territorit. Edmond MENAJ

Drejtor i Urbanistikës dhe Strehimit: Ferdinand PUTRO

Kuçovë, më 13 /01/ 2016

PROÇES – VERBAL

Sot më datë 13 / 01 / 2016 u realizua dëgjesa e tretë publike mbi Strategjinë e Zhvillimit Territorial të Bashkisë Kuçovë. Kjo dëgjesë u realizua në prani të:

- Kryetarit të Bashkisë Kuçovë z. Selfo Kapllani.
- Nënkryetar z. Ilirjan Llangozi.
- Nënkryetar z. Shpëtim Nishani.
- Specialistët e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit.
- Ekspertë të mjedisit dhe planifikimit urban të CoPLAN.
- Specialistë të Agjensiësë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (A. K. P. T).
- Administratorët e Njësive Administrative Perondi, Kozare, Lumas.
- Komisionit Qytetarë.
- Grupet e Interesit si: biznesi privat, OJF etj.
- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Dëgjesa u nis me fjalimin e Kryetarit të Bashkisë z.Selfo Kapllani, në të cilin falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim. Ndër të tjera, theksohet nga kryetari se në këtë takim do të jepet tematika mbi Strategjinë e Zhvillimit Territorial të Bashkisë Kuçovë nga ku procesi i miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është zgjedhur të bëhet me dy ndalesa.

3- Fillimisht do të kalohet në procesin e **miratimit të Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Njësisë,** dhe

4- më pas do të miratohet **Plani i Zhvillimit të Territorit** shoqëruar nga rregullorja në zbatim të tij.

Ky proçess po asistohet nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes Projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) si një nga pesë (5) bashkitë model në Republikën e Shqipërisë. Për t`u njohur mbi Strategjinë e Zhvillimit Territorial bëhet prezantimi nga eksperti i CoPLAN, z. Zenel Bajrami.

Në këtë prezantim u informua mbi:

- Proçesi i deritanishëm mbi dëgjesat publike për planin e përgjithshëm vendor te Bashkisë Kuçovë.
- Analiza e pozicionit strategjik të Bashkisë.
- Metabolizmi i territorit.
- Analiza e arsimit.
- Analiza mbi mjedisin.
- Analiza për përdorimin e tokës.

- Analiza SËOT- Pika të forta, dobësi, mundësi dhe kërcënimes.
- Zhvillimi ekonomik dhe punësimi.
- Infrastruktura, lidhjet rajonale dhe transporti.
- Turizmi, trashëgimia historiko- kulturore dhe natyrore.
- 12 polet e zhvillimit.

Proçesi i deritanishëm mbi dëgjesat publike për planin e përgjithshëm vendor te Bashkisë Kuçovë. Për prezantimin e Planit të Përgjithshëm Vendor janë realizuar deri më tani 2 dëgjesa publikë me tematika: "Nisma" dhe "Vizioni". Kjo është degjesa e tretë ku përfshin fazën e parë të proçesit, atë të miratimit të Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Njësisë.

Analiza e pozicionit strategjikë të Bashkisë. Shtrirja territoriale, dendësia e banimit, komunikimi për punë e shërbime dhe vazhdimësia e zonës së banuar në dy dekadat e fundit, e kanë klasifikuar Kuçovën (para ndarjes territoriale) si qendër aglomerati dhe së bashku me Beratin (gjithashtu qendër) dhe 3 njësi rrethuese (Perondi, Otllak dhe Ura Vajgurore) si aglomeratin e Berat-Kuçovës (aglomerat bipolar). Nga këto 5 njësi, bashkia e Kuçovës përfshin vetëm 2 (Kuçovën dhe Perondinë), popullsia e të cilave përbën 69% të popullsisë së bashkisë pas reformës.

Ky lloj zhvillimi territorial, nëse shoqërohet edhe me disa parametra të tjerë morfologjikë e funksionalë (PBB, numri i udhëtarëve me transport publik, numri i studentëve, etj.) përcakton llojin e modelit policentrik ose jo të territorit përkatës. Një tjetër analizë e realizuar është ajo e policentrizmit potencial, e cila tregon mundësinë e një rajoni për të qenë qendër interesi për investime e zhvillim, duke ndryshuar kështu hartën e zhvillimit policentrik e rajonal. Analiza e policentrizmit (aktual dhe potencial) e paraqet bashkinë e Kuçovës si një zonë mjaft qendrore ndaj flukseve të lëvizjes, përqendrimit të popullsisë, distancave të shkurtra, e interesit për punësim (për shkak të afërsisë me rrjetin e lëvizjes dhe të mbivendosjes së izokroneve).

Territori. Bashkia e re Kuçovë, shtrihet në pjesën lindore të Ultësirës Perëndimore, ku përshkohet nga rrjedha e lumit Devoll, i cili bashkohet në daljen perëndimore të Bashkisë me rrjedhën e lumit Osum. ***Kuçova.*** Bashkia Kuçovë ka sipërfaqe prej 160.22 km^2, dhe popullsi 31,424 banorë për qytetin Kuçovë.

Metabolizmi i territorit. Analiza e Metabolizmit analizon flukset në territor/qytet urban. Analizmi i flukse bëhet nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve, për secilin fluks që merret në analizim. Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë. Në këtë rast flukset që do të merren në analizë janë: fluksi i energjisë, fluksi i ujit, fluksi i ushqmit dhe fluksi i mbetjeve.

Arsimi. Popullsia në Bashkinë e Kuçovës me arsim fillort 8 ose 9 vjeçar (llogaritur si raport i personave që kanë përfunduar arsimin 8 ose 9 vjeçar ndaj popullsisë 15 vjeç e lart) përbën pjesën më të madhe të popullsisë, 57.1% (INSTAT, Census 2011). Raport ky më i lartë se në Bashkinë Berat, shumë i përafërt me atë në Bashkitë Gramsh dhe Lushnje, por krahasimisht i ulët krahasuar me Bashkitë Cerrik, Belsh dhe Ura Vajgurore. Ndërsa sa i përket arsimit të mesëm Kuçova me 31.8% të popullsisë që ka kryer këtë nivel arsimor ka

një raport pothuajse të njëjtë me Beratin dhe Lushnjen dhe krahasimisht më të lartë se bashkitë e tjera fqinje. Kjo do të thotë që popullsia që përbën forcën e punës në këtë bashki është më e kualifikuar nga ajo që ofrohet nga bashiktë fqinje dhe për rrjedhojë lehtëson konkurencën në tregun e punësimit rajonal. Nga ana tjetër përqindja e popullsisë me arsim të lartë universitar dhe pasuniversitar është 6.2%. Ky raport e pozicionon Kuçovën para bashkive të Belshit, Cerrikut dhe Ura Vajgurore por pas atyre të Beratit, Lushnjes dhe Gramshit.

Aktualisht Bashkia Kuçovë ka 26 kopshte, 29 shkolla 9-vjeçare dhe 6 shkolla të mesme, Në Kuçove nga 29 shkolla 9 Vjeçare 12 e kanë këtë raport më të ulët se ai i BE, ndërsa pjesa tjetër e tejkalon atë. Ndërkohë mesatarja është e barabartë me atë të BE. Mund të themi që sa i përket këtij indikatori Bashkia Kuçovë është shumë e avantazhuar.

Mjedisi. *Burimet Ujore Sipërfaqësore,* Bashkia e Kuçovës ka një rrjet të pasur ujor. Në veri-perëndim, Bashkia përshkohet nga rrjedha e mesme e lumit Devoll i cili bashkohet me Lumin Osum në Arrëz të Urës Vajgurore. Territori i bashkisë përshkohet edhe nga rrjedha e mesme e lumit Osum e cila ndan kufirin administrativ të Bashkisë së Kuçovës me Bashkinë e Urës Vajgurore, duke filluar nga Guri i Bardhë në Urë Vajgurore e deri në perëndim në Arrëz, pika ku Devolli dhe Osumi bashkohen për të formuar Seanin. Nga Arrëz deri në kufi me Lushnjën në Veri-perëndim, bashkia përshkohet nga Semani. Osumi dhe Semani shërbejnë edhe si kufinj administrativë ndërmjet bashkisë së Kuçovës dhe Urës Vajgurore. Pjesa perëndimore e bashkisë përshkohet nga Lumi i Lapardhasë i cili furnizohet me ujë nga një numër i madh përrenjsh në zonën e Lumasit. Në Kuçovë ndodhen edhe një numër rezervuarësh ndër të cilët mund të përmendim ujëmbledhësin e Gorajt në pjesën qendrore të bashkisë, ujëmbledhësin e Belesovës në pjesën perëndimore, Ujëmbledhësin ndërmjet fshatrave Gegë dhe Drizë dhe ujëmbledhësin në Salcë-Kozarë. *Burimet Ujore Nëntokësore.,* Qarku i Beratit (i përbërë nga bashkitë e Kuçovës, Urës Vajgurore, Poliçanit, Beratit e Skraparit) ka një rrjet të pasur pellgjesh ujore nëntokësore. Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike.

Përdorimi i tokës. Sipas klasifikimit të Census 2011, Bashkia e Kuçovës ka Kuçovën si qendër rajonale, Perondinë si qendër suburbane dhe Kozarën dhe Lumasin si njësi vendore bujqësore fushore të cilat mbajnë peshën kryesore të zhvillimit të bujqësisë në zonën e bashkisë. Toka bujqësore zë rreth 8,184ha dhe ndodhet në Perondi, Kozarë, Lumas. Kuçova së bashku me bashki të tjera si Fieri, Berati, Ura Vajgurore dhe Lushnja, bën pjesë në ultësirën perëndimore të vendit me toka pjellore që kultivohen pothuajse gjatë gjithë vitit. Kuçova ka terren fushor e malor. Terreni fushor shtrihet kryesisht gjate rrjedhjeve te lumenjve te Devollit ne veri dhe të perrenjve te veçante qe rrjedhin nga kodrat drejt lumenjve. Toka kultivohet me drithëra, perime (perime në sera), bostanore, foragjere, ullinj, pemë frutore dhe vreshta. Në bashki ndodhet edhe një shoqatë fermerësh (në Perondi me emrin HIP) dhe 37 biznese agropërpunimi. Foragjeret zënë sipërfaqen më të madhe të kultivuar në Kuçovë, me 2,587ha të ndjekur nga drithërat me 1,592ha dhe perimet me 360ha. Kuçova dallohet edhe për rritjen e bagëtisë. Për shkak të llojit të tokës (me teksturë të imët) dhe relievit (mungesës së pjerrësisë e cila bën të pamundur kullimin e ujit në rast reshjesh), këto lloj tokash nevojitin mirëmbajtje të vazhdueshme lidhur me kullimin e ujit dhe ujitjen gjë që garanton prodhimtari të lartë bujqësore. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo buqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më

të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshmë që respektojnë mjedisin, siç përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së.

Zhvillimi ekonomik dhe punësimi.

Ekonomia. Në përgjithësi vlen të theksohet që bashkia ka kaluar nga një territor vetëm urban në një territor më kompleks urbano-rural. Përsa i përket njësive ekonomike në Bashkinë Kuçovë, operojnë rreth 823 *biznese* ku rreth 92% janë biznes i vogël dhe 8 % janë biznes i madh. Sektori me numrin më të madh të bizneseve janë sherbimet me 42.65%, sektori i dytë është tregtia me 33.54%, sektori i tretë është industria me 11.9% dhe më pas vijnë sektorët e bujqësisë me 5.08% dhe ndërtimi 1.58%. Duhet theksuar se këto raporte mund të ndryshojnë sepse rreth 6% e bizneseve e kanë të pa indetifikuar llojin e aktivitetit. *Sektori bujqësor* është një sektor mjaft i rëndësishëm në Bashkinë Kuçovë. Kjo bashki ka rreth 22% të numrit të fermave të Qarkut Berat. Në bashki operojnë 37 ndërmarrje agropërpunuese ku 14 prej tyre janë furra buke dhe 9 prej tyre janë baxho. Duhet theksuar se zonat që kanë më shumë potenciale për zhvillimin bujqësor janë zonat jug- perëndimore të bashkisë në veçanti njësitë administrative të Kozarës dhe Perondisë. Njësia administrative e Lumasit megjithëse me një profil bujqësor ka më pak përparësi si pasojë e relievit kodrinor-malor. Prodhimet e *produkteve blegtorale* që vlersohen si të kënaqshme janë, prodhimi qumështit të lopes, prodhimi i mishit të derrit, sidhe prodhimi i mishit të shpendëve. Prodhimet e tjera të produkteve blegtotrale vlersohen si mesatare ose të ulëta. *Industria* është një tjeter sektor me peshë në ekonominë e Kuçovës. Kuçova është një ndër zonat naftëmbajtëse në Shqipëri dhe sektori industrial ka të bëjë kryesisht me industrinë e nxjerrjes së naftës. Në Bashkinë Kuçovë ndodhen rreth 1090 puse nafte dhe për një periudhe 6 mujore prodhohet rreth 1133 ton naftë.

Punësimi. Punësimi sipas degëve të ekonomisë ku: Zonat rurale kanë numrin më të konsiderueshëm në sektorin e bujqesisë, ndërsa zona urbane në qytetin e Kuçovës pjesën më të madhe të të punësuarve e ka në sektorin e shërbimeve. Gjithashtu nje pjesë e madhe e popullsisë së qytetit Kuçovë është e punësuar në Industri dhe Tregti respektivisht 33.5% dhe 17.3%, e para si rezultat i Industrise në hidrokarbure që kjo bashki ka. Për më tepër niveli arsimor i përfunduar për të punësuarit e kësaj bashkie ka një ndryshim të madh mes zonave urbane dhe atyre rurale. Një tjetër indikator i rëndësishëm që ndikon në mirëqënien dhe konkurrueshmërinë e kësaj bashkie është edhe papunësia. Papunësia më e madhe është në njësinë Kuçovë, dhe më e vogël në njësinë Kozarë, respektivisht 38.5% dhe 4.8%.

Infrastruktura, lidhjet rajonale dhe transporti.Nga analiza e infrastrukturës rrugore dalim në konkluzionin që në Bashkinë Kucovë ka 314 km rrugë lineare. Bashkia e Kucovës ndodhet ndërmjet Lushnjës dhe Beratit. Lushnja dhe Berati lidhen ndërmjet tyre në rrugën shtetërore SH 72 ku në degëzimi tek Ura vajgurore, për të shkuar në Kucovë merret rruga Shtetërore SH 91 e cila fillon në degëzimin e Urës Vajgurore. Nga analiza e infrastrukturës rrugore dhe transportit së Bashkisë Kucovë të ndara sipas kodit rrugor kemi: rrugë interurbane kryesore (23); rrugë interurbane dytësore (37); rrugë urbane kryesore (4); rrugë urbane dytësore (56); rrugë lokale (194), ku në total gjatësitë e tyre shkojnë në 314 km. Një nga analizat që është bërë për Bashkinë Kucove është dhe gjëndja e sipërfaqes së rrugës, ku e kemi ndarë në të shtruar ose të pashtruar. Rrugët e shtruara shtrihen kryesisht në rrugët Interurbane kryesore, përgjithësisht në rrugët interurbane dytësore, rrugët urbane kryesore që ndodhen në qytetin e Kucovës si dhe rrugët urbane dytësore që shtrihen po ashtu brenda

qytetit si dhe në periferi të Kucovës, sidomos në ish- komunat e Bashkisë Kucove, kryesisht në qendrat e fshatrave.

Turizmi, trashëgimia historiko- kulturore dhe natyrore. Në bashkinë e Kuçovës ndodhen 2 monumente kulture të kategorisë së parë, kisha e Ungjillezimit në fshatin Kozarë dhe kisha e Shën Kollit në fshatin Perondi. Sipas nenit 32 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore" specifikohet që për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse përreth, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që ka shpallur monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve te Kulturës.

12 polet e zhvillimit. Polet e zhvillimit paraqesin dhe supozimet e projekteve të reja për zhvillimin e Bashkisë Kuçovë, të cilat bazohen në përzgjedhjen e një nga tre hapa: zhvillim; rigjenerim; rivitalizim.

Poli 1- Perspetiva e qendrës administrative, qendrës komerciale, kulturore apo të banimit intensiv.

Poli 2- Perspetiva e qendrës komerciale, kulturore.

Poli 3, 4, 5- Perspektiva e qendrës së industrisë përpunuese dhe ekonomike, qendrës së magazinimit dhe logjistikës.

Poli 6- Perspetiva e qendrës magazinimit dhe tregut.

Poli 7- Perspetiva të tjera drejt qendrës komerciale, kulturore dhe të banimit intensiv.

Poli 8- Perspektiva drejt qendrave rekreativo- sportive, qendrave të shërbimeve, infrastrukturës dhe institucioneve kërkimore.

Poli 9, 10- Perspetiva e qendrës rekreativo- sportive.

Poli 11- Perspetiva e qendrës së magazinimit dhe tregut, si dhe qendrave komerciale.

Poli 12- Perspektiva të tjera te qendrës së shërbimeve dhe infrastrukturës.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u bënë pyetje në lidhje me materialin si dhe u dhanë sugjerimet si:

- Supozime për ndërtimin e një terminali në hyrje të qytetit.
- Mundësitë e reja për shfrytëzimin e energjisë elektrike.
- Metodika dhe mundësi për futjen e biznesit në investime për shfrytëzimin e resureve të ndryshme që përmban Bashkia Kuçovë.
- Ti jepet rëndësi infrastrukturës rrugore, lidhja midis njësisë administrative Lumas dhe qytetit Kuçovë, si dhe segmentit Elbasan- Kuçovë.

Dëgjesa pasardhëse do të jenë në muajin mars 2016, në vazhdimësi të miratimit të Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Njësisë për Planin e Përgjithshëm Vendor. Është parashikuar që finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor dhe VSM të jetë në mes të muaji mars 2016. Në të gjitha këto takime, do të jenë të pranishëm edhe specialistët e Institutit të Zhvillimit të Habitait (Co-plan), të cilët do të marrin pjesë në diskutimet e hapura për auditorin.

Në këtë takim, proçes-verbali u mbajt nga specialistja e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit znj. Xhenisa Kostreni.

Për/ Drejtorinë e Urbanistikës dhe Strehimit

Ing. Olgert ZOGA

Ark. Eljan HAJDARI

Ing. Xhenisa KOSTRENI

Sp/Strehimi. Bledar DJAMANDI

Juriste. Milena BULLARI

Sp/Investimesh. Julian LEZO

Sp/kontrolli të territorit. Edmond MENAJ

Drejtor i Urbanistikës dhe Strehimit: Ferdinand PUTRO

Kuçovë, më 28 / 04 / 2016

PROÇES – VERBAL

Sot më datë 28 / 04 / 2016 u realizua dëgjesa e katërt publike mbi "Vlerësimit Strategjik Mjedisor" të Bashkisë Kuçovë. Kjo dëgjesë u realizua në prani të:

- Kryetarit të Bashkisë Kuçovë z. Selfo Kapllani.
- Nënkryetar z. Shpëtim Nishani.
- Specialistët e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit.
- Ekspertë të mjedisit dhe planifikimit urban të CoPLAN.
- Specialistë të Agjensiësë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (A. K. P. T).
- Administratorët e Njësive Administrative Perondi, Kozare, Lumas.
- Komisioni Qytetarë.
- Grupet e Interesit si: biznesi privat, OJF etj.
- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Dëgjesa u nis me fjalimin e Kryetarit të Bashkisë z.Selfo Kapllani, në të cilin falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim. Fjalën e mban eksperti i planifikimit urban te CoPLAN, z. Zenel Barjami, ku thekson se deri më tani për Bashkinë Kuçovë janë bërë tre dëgjesa dhe kjo është dëgjesa e katërt me tematikë mbi "Vlerësimit Strategjik Mjedisor", mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis. Aktualisht, ka përfunduar miratimi i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit. Konkretisht per tematikën e sotme, do të merren parasysh dhe do t`u kushtohet shumë rëndësi të gjitha propozimet që do të jepen për kete teme si dhe per planin e përgjithshëm vendor. Deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Kuçovë, do të kemi dhe dëgjesa të tjera publike.

Prezantimi i sotëm mbahet nga ekspertja e mjedisit, znj. Arta Alla, duke cilësuar se, në planin e përgjithshëm vendor, rëndësi të madhe ka dhe mjedisi, ndikimi i mjedisit dhe promovimi i turizmit. Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) është i bazuar në kuadrin ligjor të posaçëm si: ligji nr 91, datë 28.02.2013 "Për vlerësimin Strategjik Mjedisor"; VKM nr. 507, datë 10.6.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor"; VKM nr. 219, datë 11.3.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"; Draft-Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (2015-2020); VKM nr. 671, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit". Proçesi i miratimin të VSM- së kalon në disa faza , faza e pare përmban shqyrtimin e VSM-së, në fazën e dytë është bërë analiza e gjendjes së mjedisit, ku shikohet gjithë informacionet e mbledhura për të bërë analizën e mjedisit. Dhe faza e tretë do të jetë hartimi i raportit paraprakë i VSM- së. Dëgjesa pasardhëse do të jetë për ndikimin në mjedis nga planet e paraqitura nga bashkia, dhe tematika e sotme do të përmbajë problemet e mjedisit.

Në këtë prezantim u informua mbi:

- Gjendja e mjedisit, pozicioni gjeorgrafik i bashkisë, si dhe territori i saj me një reliev kodrinoro- fushorë.
- Sistemet territoriale.
- Përdorimi i tokës bujqësore duke përfshirë kultura si: foragjerë, drithëra, perime në sera, bostanore, vreshtari e pemë frutore, ullinj etj.
- Gjeorreziqet: erozioni, rrëshqitjet, tërmetet, rreziqet gjeologjike në shtretërit e lumenjve, rreziqe të shkaktuara nga dora e njeriut.
- Ndotja nga nafta: Zona naftënxjerrëse është vatër mjedisore e ndotur rëndë me hidrokarbure; Rreth 1/3 e sipërfaqes së vendburimeve të naftës rezulton të jetë e ndotur nga nafta bruto; Kuçova dhe sidomos Kozara kanë ndotje të tokës nga puset e naftës në sipërfaqen naftë-nxjerrëse.
- Në bashkinë Kuçovë gjenden 3 vendburime nafte, dhe 1090 puse nafte., dhe në territorin e bashkisë gjenden gjithsesi, 311 puse naftë dhe nga këto 210 janë në funksion, dhe 101 puse janë pa funksion.
- Problemet e tokave bujqësore ku një ndër to është gërryerja e tokës (humbje) në brigjet e lumenjve, përmbytja e tokave bujqësore.
- Problematikë ose përdorime konfliktuale të tokës bujqësore.
- Problematikë për shndërimin e tokave bujqësore në zona urbane.
- Nëntoka, ku cilësohen dy probleme kryesore: puse pa përdorim dhe futje e teknologjisë së re të shpimit horizontal me plasje (*hydraulic fracturing*).
- Ujërat sipërfaqësorë: lumenjtë, rezervuarët dhe karakteristikat dhe problematikat e tyre.
- Ujërat nëntokësorë, llojet dhe problematikat e akuiferëve (pellgjet ujore).

- Mbetjet urbane, inerte, spitalore, industriale etj, si dhe menaxhimi dhe riciklimi i tyre.
- Cilësitë ajrit, ndotësit e ajrit.
- Fondi pyjor dhe kullosor si dhe problematikat.
- Biodiversiteti , flora dhe fauna si dhe problematikat dhe mbrojtja e tyre.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u bënë pyetje apo u dhanë sugjerimet në lidhje me materialin si:

- Teknologjia e përdorur mbi prodhimin e naftës, e cila është një ndër burimet kryesore në zhvillimin ekonomik, duhet të jetë një teknologji dhe të përdoren metoda, që mos të japin efekte të tjera anësore, negative. Nga pikëpamja gjeologjike, baseni i Kuçovës është ndërtuar nga basene të shkëputura dhe metodat e përdorura deri më sot, nuk sjellin efekte negative.
- Sa i përket ndërhyrjes në ujërat sipërfaqësore, konkretisht për lumenjtë, bashkia do të ndërhyjë me mbjelljen e pemëve duke arritur në rezultatin e zvogëlimit të erozionit.
- Sa i përket ndotjes në mjedis që vjen nga nafta, bashkia ka bërë disa iniciativa me donatorë, për të bërë ndërhyrjet e para për "Rehabilitimin e gjithë zonës".
- Për njësinë administrative Lumas, cilësohet se ka materiale të mjaftueshme mbi pyjet, dhe ka hapësira për tu riparuar, dhe theksohet se shumica e shkurreve janë shkatërruar. Këto 2- 3 vitet e fundit, në lumin Lapardhica ka pasur një erozion të lartë të lumit. Në aspektin turistik, në Lumas egzitojnë kanionet/ burimi i Sinecit, shpella afër këtij burimi, që mund të jenë pika të rëndësishme turistike. Këto zona duhet të hidhen në plan, dhe të shikohet mundësia për tu shpallur dhe si zona të mbrojtura dhe të jetë e mundur ndërtimi i një infrastukture të mirë për të shkuar deri në këto zona, të cilat do të tërheqin një numër të madh turistësh.
- Nëse është një inventar i plotë mbi pyjet, kullotat dhe resurseve të tjera, ato mund të shfrytëzohen si vende turistike, si në rastin e: pylli i Vlashukut etj.
- Diskutime ishin mbi zonën e TEC dhe zona e Ndërtim Montimi, ku përgatitja e një projekt ideje që e kthen këtë zonë në një zonë të shëndetshme dhe argëtuese për qytetarët e bashkisë Kuçovë.

Dëgjesa pasardhëse do të jenë në muajin maj 2016, në vazhdimësi të rjetit rrugor, mënyra e funksionimit të bashkisë, si dhe ndërhyrjet kryesorë në infrastrukturë. Në të gjitha këto takime, do të jenë të pranishëm edhe specialistët e Institutit të Zhvillimit të Habitatit (Co-plan), të cilët do të marrin pjesë në diskutimet e hapura për auditorin.

Në këtë takim, proçes-verbali u mbajt nga specialistja e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit znj. Xhenisa Kostreni.

Për/ Drejtorinë e Urbanistikës dhe Strehimit

Ing. Olgert ZOGA

Ark. Eljan HAJDARI

Ing. Xhenisa KOSTRENI

Sp/Strehimi. Bledar DJAMANDI

Juriste. Milena BULLARI

Sp/Investimesh. Julian LEZO

Sp/kontrolli të territorit. Edmond MENAJ

Sp/ projektesh. Arminda BARDHI

Drejtor i Urbanistikës dhe Strehimit: Ferdinand PUTRO

Kuçovë, më 23 / 05 / 2016

PROÇES – VERBAL

Sot, më datë 23 / 04 / 2016 u realizua dëgjesa e pestë publike mbi "Për infrastrukturën rrugore, përdorimi i tokës si dhe infrastrukturën nëntokësore të bashkisë Kuçovë". Kjo dëgjesë u realizua në prani të:

- Kryetarit të Bashkisë Kuçovë z. Selfo Kapllani.
- Nënkryetar z. Ilirjan Llangozi.
- Specialistët e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit.
- Ekspertë të mjedisit dhe planifikimit urban të CoPLAN.
- Specialistë të Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (A. K. P. T).
- Administratorët e Njësive Administrative Perondi, Kozare, Lumas.
- Komisioni Qytetarë.
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak Kuçovë.
- Grupet e Interesit si: biznesi privat, OJF etj.
- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Dëgjesa u nis me fjalimin e Kryetarit të Bashkisë z.Selfo Kapllani, në të cilin falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim si dhe punën e mirë të bërë nga grupi punës të CoPLAN-it. Kryetari i bashkisë, ndër të tjera thekson se, kjo është dëgjesa e pestë publike në radhë, dhe deri më tani, është diskutuar dhe është punuar pjesa më e madhe dhe e rëndësishme e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për bashkinë e re Kuçovë. Pjesëmarrja dhe sugjerimet në çdo dëgjesë ka qënë e lartë dhe e kënaqshme. Brenda muajit korrik duhet të përfundojë dhe të paraqitet varianti final i PPV-së duke patur parasysh sugjerimet e dhënë në çdo dëgjesë publike. Fjalën e vazhdon eksperti i planifikimit urban te CoPLAN, z. Zenel Barjami, ku thekson se deri më tani për Bashkinë Kuçovë janë bërë 4 dëgjesa dhe kjo është dëgjesa e pestë me tematikë mbi "Për infrastrukturën rrugore, përdorimi i tokës si dhe infrastrukturën nëntokësore të bashkisë Kuçovë". Konkretisht per tematikën e sotme, do të merren parasysh dhe do t`u kushtohet shumë rëndësi të gjitha propozimet që do të jepen për kete teme si dhe per planin e përgjithshëm vendor. Prezantimi vazhdon duke përmendur rëndësinë që ka bashkia e re Kuçovë në koridorin kryesor të boshtit jugor.

Në këtë prezantim u informua mbi:

- Ofrimin e shërbimeve publike bazike në periferi të bashkisë së re Kuçovë janë më problematike.
- Pozicioni gjeorgrafik i bashkisë, si dhe territori i saj me një reliev kodrinoro-fushorë si dhe sistemet territoriale.
- Vizioni i bashkisë Kuçlovë: Kuçova, një qytet i mundësive të barabarta me synimin e një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë lokale, të shoqërisë dhe mjedisit që e rrethon. Ky zhvillim do të arrihet duke mbrojtur burimet natyrore, resurset kombëtare, hapësirat publike dhe kulturën e traditën vendore të kësaj zone, me qëllimin kryesor për një të ardhme sa më të qëndrueshme edhe për brezat e ardhshëm. Bashkia e Kuçovës e ndërton të ardhmen e banorëve të saj, mbi një ekonomi të shëndoshë dhe të larmishme, por me fokus në shfrytëzimin e pasurive nëntokësore, turizmin historiko-kulturor e natyror dhe bujqësinë.
- Objektivat dhe programet strategjike përfshijnë: 1) zhvillimi ekonomik dhe punësimi 2) infrastruktura, lidhjet rajonale dhe transporti 3) turizmi – trashëgimia historiko-kulturore dhe natyra 4) mjedisi – rrjeti lumor dhe kurora e gjelbër.
- U paraqit infratruktura ekzistuese, dhe u paraqitën propozimet nga grupi i punës për ndërtimin e akseve të reja rrugore, rrjet rrugor që bën lidhjen e qendrës urbane Kuçovë me 3 njësitë administrative: Perondi, Lumas dhe Kozare. U dha propozimi për kalimin e një autostrade, që do të shtrihet në zona ku nuk paraqiten shumë objekte të ndërtuara. U paraqit zona e aviacionit, dhe për këtë zonë do të përfliet në një nga dëgjesat e ardhshme publike.
- U paraqit shpërndarja e puseve të naftës, puse që janë funksionale dhe ato që nuk janë funksionale, dhe deri më tani nuk është paraqitur një inventar ku të klasifikojë puset në ato funksionale dhe ato jo funksionale.
- Industria e naftës nxjerrëse: Zona naftënxjerrëse është vatër mjedisore e ndotur rëndë me hidrokarbure; Rreth 1/3 e sipërfaqes së vendburimeve të naftës rezulton të jetë e ndotur nga nafta bruto; Kuçova dhe sidomos Kozara kanë ndotje të tokës nga puset e naftës në sipërfaqen naftë-nxjerrëse. Problemet e tokave bujqësore ku një ndër to është gërryerja e tokës (humbje) në brigjet e lumenjve, përmbytja e tokave bujqësore apo dhe ndotja e tyre nga prodhimi ndër vite të naftës.
- U dha paraqitja e shpërndarjes së zonave pyjore, u dhanë propozime për zona, të cilat në të ardhme mund të kthehen në zona të mbrojtura, zona të cilat mund të jenë vende të rëndësishme turistike si:Kodrat në Fier-Mimar, Sinec në Lumas etj.
- Problematikë për shndërimin e tokave bujqësore në zona urbane. Ujërat nëntokësorë, llojet dhe problematikat e akuiferëve (pellgjet ujore).
- Paraqitja e infrastrukturës rrugore, përfshiu klasifikim të rrjetit rrugor si: rrugë radiale, rrugë lidhëse rurale, rrugë rurale, rrugë fshati, autostradë si dhe shtigje të ndryshme.
- Përmes prezantimit në harta përkatëse, u tregua shprëndarja e rrugëve me karakter: turistik, bujqësor.

- Për transportin publik u dhanë propozimet për stacionet përkatëse të autobusave/ fugonave/ taksi, ku shtrihen linjat e transportit publik rrethqytetas ato që janë ekzistuese dhe propozimet nga grupi i punës.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u bënë pyetje apo u dhanë sugjerimet në lidhje me materialin si:

- Sugjerim për rikonstruksionin e rrugës "Kongresi i Lushnjes" pranë bulevardit kryesor të qytetit.
- Sugjerime për rikonstruksionet për rrugët e lagjes nr 1, blloku "11 Janari" apo segmente

  rrugore që lidhin qendrën urbane me Njësinë Administrative Lumas.
- Problematikë e madhe për bashkinë e re, dhe me ndarjen e re territoriale, janë kanalet kulluese në njësitë administrative. Për këto është miratuar fond nga njësia e qeverisjes qendrore, dhe zbatimi kalon në dy faza, ku konkretisht jemi në fazën e parë, atë për kanalet ujitëse.
- Diskutime ishin mbi zonën e TEC dhe zona e Ndërtim Montimi, ku përgatitja e një projekt ideje që e kthen këtë zonë në një zonë të shëndetshme dhe argëtuese për qytetarët e bashkisë Kuçovë.

Dëgjesa pasardhëse do të jenë në muajin qershor 2016, dhe të jepet një përmbledhje për gjithë fazën e hartimit dhe miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Të gjitha propozimet/ sugjerimet apo problemet e paraqitura në çdo dëgjesë publike të bërë për bashkinë Kuçovë, janë marrë dhe do të merren parasysh deri në miratimin e PPV.

Në të gjitha takimet e ardhshme, do të jenë të pranishëm edhe specialistët e Institutit të Zhvillimit të Habitatit (Co-plan), të cilët do të marrin pjesë në diskutimet e hapura për auditorin.

Në këtë takim, proçes-verbali u mbajt nga specialistja e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit znj. Xhenisa Kostreni.

Për/ Drejtorinë e Urbanistikës dhe Strehimit

Ing. Olgert ZOGA

Ark. Eljan HAJDARI

Ing. Xhenisa KOSTRENI

Sp/Strehimi. Bledar DJAMANDI

Juriste. Milena BULLARI

Sp/Investimesh. Julian LEZO

Sp/kontrolli të territorit. Edmond MENAJ

Sp/ projektesh. Arminda BARDHI

Drejtor i Urbanistikës dhe Strehimit: Ferdinand PUTRO

Kuçovë, më 06/ 07 / 2016

PROÇES – VERBAL

Sot, më datë 06 / 07 / 2016 u realizua dëgjesa e gjashtë publike mbi "Mbi planin e Zhvillimit dhe Rregullorja Vendore e Planifikimit të bashkisë Kuçovë". Kjo dëgjesë u realizua në prani të:

- Kryetarit të Bashkisë Kuçovë z. Selfo Kapllani.
- Nënkryetarët e bashkisë Kuçovë.
- Specialistët e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit.
- Ekspertë të mjedisit dhe planifikimit urban të CoPLAN.
- Specialistë të Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (A. K. P. T).
- Administratorët e Njësive Administrative Perondi, Kozare, Lumas.
- Komisioni Qytetarë.
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak Kuçovë.
- Grupet e Interesit si: biznesi privat, OJF etj.
- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Dëgjesa u nis me fjalimin e Kryetarit të Bashkisë z.Selfo Kapllani, në të cilin falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim si dhe punën e mirë të bërë nga grupi punës të CoPLAN-it. Kryetari i bashkisë, ndër të tjera thekson se, kjo është dëgjesa e parafundit publike në radhë, dhe deri më tani, është diskutuar dhe është punuar pjesa më e madhe dhe e rëndësishme e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për bashkinë e re Kuçovë. Pjesëmarrja dhe sugjerimet në çdo dëgjesë ka qënë e lartë dhe e kënaqshme. Brenda muajit korrik duhet të përfundojë dhe të paraqitet varianti final i PPV-së duke patur parasysh sugjerimet e dhënë në çdo dëgjesë publike. Pas kësaj dëgjese do të punohet mbi rregulloren e PPV. Në shtator do të zhvillohet dëgjesa e fundit e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Fjalën e vazhdon eksperti i planifikimit urban te CoPLAN, z. Zenel Barjami, ku thekson se deri më tani për Bashkinë Kuçovë janë bërë 5 dëgjesa dhe kjo është dëgjesa e gjashtë me tematikë mbi "*Planin dhe Rregulloren e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit së Bashkisë Kuçovë*". Deri më tani janë zhvilluar dëgjesa publike me tematika të ndryshme dhe brenda shtatorit do të kemi të gjithë dokumentat për hartimin e PPV, dhe gjatë kësaj kohe do të bëhet vlerësimi i gjithë propozimeve.

Konkretisht per tematikën e sotme, do të merren parasysh dhe do t'u kushtohet shumë rëndësi të gjitha propozimet që do të jepen për kete teme si dhe per planin e përgjithshëm vendor. Prezantimi vazhdon duke përmendur rëndësinë që ka bashkia e re Kuçovë në koridorin kryesor të boshtit jugor.

Në këtë prezantim u informua mbi:

- Vizioni i bashkisë Kuçovë: Kuçova, një qytet i mundësive të barabarta me synimin e një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë lokale, të shoqërisë dhe mjedisit që e rrethon. Ky zhvillim do të arrihet duke mbrojtur burimet natyrore, resurset kombëtare, hapësirat publike dhe kulturën e traditën vendore të kësaj zone, me qëllimin kryesor për një të ardhme sa më të qëndrueshme edhe për brezat e

ardhshëm. Bashkia e Kuçovës e ndërton të ardhmen e banorëve të saj, mbi një ekonomi të shëndoshë dhe të larmishme, por me fokus në shfrytëzimin e pasurive nëntokësore, turizmin historiko-kulturor e natyror dhe bujqësinë.

- Pozicioni gjeografik i bashkisë, si dhe territori i saj me një reliev kodrinoro- fushorë si dhe sistemet territoriale.
- Karakteri i vendbanimeve karakterizohet sipas zonave që është i ndarë territori i gjithë Bashkisë Kuçovë, si zona aeroport, zonë industriale me 50m bufer, zonë nxjerrje/ përpunim nafte me 50m bufer, zonë bujqësore, zonë kodrinore malore, zonë kodrinore fushore si dhe qendra multifunksionale.
- U trajtuan kufizimet që do të jenë përgjatë brigjeve të sistemit të ujërave sipërfaqësore të lumenjve, për brezin sanistar të puseve të naftës, apo për brezi mbrojtës të autostradës.
- U paraqit infratruktura ekzistuese, dhe u paraqitën propozimet nga grupi i punës për ndërtimin e akseve të reja rrugore, rrjet rrugor që bën lidhjen e qendrës urbane Kuçovë me 3 njësitë administrative: Perondi, Lumas dhe Kozare. Klasifikimi i rrjetit rrugor është sipas: autostradë, rrugëve radiale, rrugë urbane kryesore, rruge lidhëse rurale, rrugë rurale, rrugë urbane dytësore, rrugë kodrinore, rrugë fshati, shtigje për bashkinë Kuçovë.
- U paraqit shpërndarja e korsive të biçikletave, në qendrën urbane të Kuçovës si dhe në njësitë adminitrative si dhe skema e parkimeve të mjeteve.
- Përsa i përket sistemit rrugor u paraqit skema e ndërhyrjes për rrugët, duke bërë zgjerime për to, konservim të tyre, ndërtimin e rrugëve të reja, rehabilitim e tyre.
- U paraqit ndarja e fashave (fasha ekonomke, Devoll, Drizë, Gegë, Perondi, Seman-Osum, Tapi - Kuçovë), qendërsitë (Mikroqendërsitë, Airoport, Kozare, Lumas, Parkut Rajonal) dhe zonat e bashkisë (Z e Kodrave, Zona me përdorim bazë banim, si dhe zona me përdorim miks).
- Përmes prezantimit në harta përkatëse, u tregua shpërndarja egzistuese e përdorimit të tokës si dhe ajo e propozuar, për qytetin.
- U paraqitën sistemet territoriale aktuale si dhe ato të propozuara.
- Paraqitja e menyrave të ndërhyrjes si: zhvillim, rikrijim, pastrim, zbutje, reklamim, konsolidim, ngrirje, dendësim, dendësia mbushje urbane, dendësim intensifikim, konservim, zhvendosje, trajtim peizazhistik, rizhvillim, rikonceptim, ristrukturim, riparim, rindërtim, riparim, rigjenerim, rehabilitime, restaurimi, miks etj.
- Për bashkinë Kuçovë, ka 380 njësi strukturore, ku vetë qendra urbane e Kuçovës, ka 80 njësi strukturore.
- U shpjeguan parametrat e zhvillimit si koefiçenti i shfrytëzimit të tokës, intensiteti koeficenti egzistues dhe ai i propozuar i shfrytëzimit të territorit etj.
- Së fundmi u treguan rastet e zhvillimit të njësive strukturore, si rastet: blloku qendror i banimit në Kuçovë, njësia strukturore qendrore, zonës së Sinecit, në fshatin Katundas të njësisë administrative Lumas, zona e tregut, zona e ish tecit, zona e ish UPN, zona e Stadiumit.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u bënë pyetje apo u dhanë sugjerimet në lidhje me materialin si:

- Diskutime ishin mbi zonën e TEC dhe zona e Ndërtim Montimi, ku përgatitja e një projekt ideje që e kthen këtë zonë në një zonë të shëndetshme dhe argëtuese për qytetarët e bashkisë Kuçovë.
- Propozimet për kalimin e rrugës që lidh qendrën urbane Kuçovë me Njësinë Administrative Lumas.

Dëgjesa pasardhëse do të jenë në muajin shtator 2016, dhe do të prezanothet e gjitha puna e hartimit dhe përgatitjes të Planit të Përgjithshëm Vendor. Të gjitha propozimet/ sugjerimet apo problemet e paraqitura në çdo dëgjesë publike të bërë për bashkinë Kuçovë, janë marrë dhe do të merren parasysh deri në miratimin e PPV.

Në këtë takim, proçes-verbali u mbajt nga specialistja e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit znj. Xhenisa Kostreni.

Për/ Drejtorinë e Urbanistikës dhe Strehimit

Ing. Olgert ZOGA

Ark. Eljan HAJDARI

Ing. Xhenisa KOSTRENI

Sp/Strehimi. Bledar DJAMANDI

Drejtor i Urbanistikës dhe Strehimit: Ferdinand PUTRO

Kuçovë, më 01/ 09 / 2016

PROÇES – VERBAL

Sot, më datë 01 / 09 / 2016 u realizua dëgjesa e shtatë dhe e fundit publike mbi "*Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit së Bashkisë Kuçovë*"

Kjo dëgjesë u realizua në prani të:

- Kryetarit të Bashkisë Kuçovë z. Selfo Kapllani.
- Nënkryetarit te bashkisë Kuçovë, z. Ilirjan Llangozi.
- Specialistët e Drejtorive të Bashkisë Kuçovë.
- Ekspertë të mjedisit dhe planifikimit urban të CoPLAN.
- Specialistë të Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (A. K. P. T).
- Përfaqësues të Agjensisë Rajonale të Mjedisit Berat dhe të Agjensisë Kombëtare të Mjedisit.
- Administratorët e Njësive Administrative Perondi, Kozare, Lumas.
- Komisioni Qytetarë.
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak Kuçovë.
- Grupet e Interesit si: biznesi privat, OJF etj.

- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Fjalimin e ka Kryetari i Bashkisë z.Selfo Kapllani, në të cilën falenderon të gjithë pjesëmarrësit e pranishëm, dhe thekson se bashkia Kuçovë ka ndërmarrë nismën për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit Administrativ, dhe në këtë proçes bashkia po asistohet nga USAID, përmes Projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe Institutit për Zhvillimin e Habitatit (Co-PLAN), si një nga 5 bashkitë model në Republikën e Shqipërisë në kuadër të planifikimit të territorit. Fjalimi vazhdon me një përmbledhje për çdo dëgjesë që është prezantuar deri më sot nga bashkia Kuçovë.

Fjalimin e mbajnë ekspertët e mjedisit të CoPLAN, që prezantojnë një përmbledhje të dëgjesës së tretë publike mbi VSM, dhe ndërkohë pikat kryesore që janë për t`u shqyrtuar sot janë mbi:

-Vlerësimi Strategjik Mjedisor duke folur mbi kuadrin ligjor dhe proçesin
-Gjendja e mjedisit (një përmbledhje e dëgjesës së III, mbi VSM)
-Vlerësimi i ndikimit të projekteve të PPV-së në mjedis
-Masat mjedisore të propozuara në PPV dhe VSM
- dhe në fund një hapësirë për diskutime në lidhje me temën e dëgjesës.

Proçesi apo Metodologjia e hartimit të VSM në kuadër të PPV-së kalon në 3 faza, ku faza e parë është shqyrtimi nëse nevojitet VSM për PPV. Faza e dytë përfshin analizën dhe gjendjen e mjedisit ku mblidhen informacione për çështjet mjedisore që do të shqyrtohen për VSM. Dhe në fazën e fundit, është hartimi i Raportit Paraprak, ku do jepet vlerësimi i ndikimit në mjedis e shëndet të propozimeve të Planit, si dhe Masat parandaluese e zbutëse të ndikimeve negative në mjedis. U bë një përmbledhje për dëgjesën e tretë publike, dhe ndërkohë pikat kryesore për temën e sotme, janë projektet e propozuara në PPV, si dhe metodologjia e përdorur në vlerësimin e projekteve të PPV-së. Për projektet e PPV duhet të bazohet në zhvillimin e qendrueshëm social- ekonomik, në zhvillimin infrastrukturor lokal dhe aksesi, në mbrojtjen dhe zhvillimin e qendërueshëm mjedisor si dhe në mbështetjen e komuniteteve për zhvillimin social. Për çdo projekt, duhet bërë vlerësimi lidhur me 10 Objektiva Mjedisore, që duhet të ketë përputhshmëri me secilin projekt dhe me objektivat mjedisore. Mbi bazën e qëllimit të VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë Planit, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Vlerësimi mjedisor që do të bëhet për çdo projekt, realizohet për secilën nga OM (Objetkivat Mjedisore) që janë: ajri, uji, toka, biodiversiteti, pyjet, peizazhi, klima, kultura, shëndeti si dhe ai social- ekonomik. Kriteret e përdorura në vlerësimin mjedisor të projekteve janë referuar sipas ligjit nr 91/2013, konkretisht në: cilësinë e përbërësve të mjedisit (toka, uji, ajri etj), ndikimet në mjedis nga zbatimi i planit(projekteve), ndikimet e projekteve mbi zonat e mbrojtura si dhe në shkallën e përputhjes së planit më Objektivat Kombëtare Mjedisore. Kriteret e lartpërmendura janë përdorur me pesha në vlerësim. Vlerësimi për çdo kriter bëhet me *0 (keq), 10 (i mirë)* dhe një vlerësim *të ndërmjetëm* i cili merr pikë nga *0.1 deri në 9.9.* Kur pikët shumëzohen me peshën përkatëse, ato japin vlerën numerike të vlerësimit të ndikimit të projektit në përbërësin përkatës mjedisor, që përkon edhe me Objektivin Mjedisor të VSM-së. Pra, në parim, sa më tepër pikë merren në vlerësim, aq më i vogël është ndikimi negativ në mjedis. Kjo vlen si në nivel kriteri, ashtu edhe në nivel vlerësimi total për një projekt të planit. Kjo do të thotë *se* vlerësimi total i ndikimit në mjedis sipas një tabeleje (tabelë që është në dispozicion të bashkisë), për një propozim të caktuar të PPV-së, lëviz nga 0 (shumë negativ ose me ndikim të shumë të lartë

negativ) në 10 pikë (shumë pozitiv ose pa ndikim negativ). Sipas" Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis rezulton të ketë përputhshmëri mesatare me Objektivat Kombëtar Mjedisor":

Ndikimi në mjedis i projekteve të planifikuara mund të mbahet nën kontroll dhe të zbutet duke ndjekur dhe rrepektuar Masat Mjedisore.

Më tej, takimi vazhdon me masat kryesore për Mbrojtjen e Mjedisit Propozuar në PPV, ku përmenden masa mbi parandalimin e zbutjen e ndikimit të projekteve specifike të PPV-së gjatë zbatimit.Këto masa janë bazuar në vizionin Strategjik për Mjedisin. Ndër elementët kryesore që u përmendën në dëgjesën e sotme, ku u dhanë dhe masat për problemet që ato shkaktojnë në mjedis janë si: mbrojtja e tokës nga ndotja përmes rehabilitimit të puseve të naftë, apo të tokave të ndotura me hidrokarbure, masat mbrotjëse në tokat bujqësore përmes ndalimit të ndërtimeve të paligjshme si dhe zgjidhje të konfliktit bujqësi- industri naftebanim nëpërmjet zonimit të përcaktimit të zonave mbrojtëse, masat mbrojtëse për sistemin ujor, sipërfaqësorë si rehabilitimi i shtretërve apo zonavë ripariane të lumenjve, masat mbrojtëse për ujërat nëntokësore përmes krijimit të zonave higjeno- sanitare përreth puseve, masat mbrojtëse për ajrin përmes përdorimit efiçens të tokës, fuqizimit të transporitit alternativ dhe atij të transportit publik, shtimit të hapërsirave të gjëlbërta dhe ato për këmbësorët, masat mbrojtëse për pyjet dhe kullotat,krijimi i zonave argëtuese të gjelbërta apo shpallje zonë të mbrojtur zonave që kanë vlera natyrore, kulturore e turistike, teknologjitë e përdorura për puset e naftës, etj.

etj. Masat të tjerë të propozuara për PPV janë ato të rehabilitimit të ish UPN-së, ish TEC-it, venddepozitimit të mbetjeve urbane etj.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u bënë pyetje apo u dhanë sugjerimet në lidhje me materialin si: Zbatimi i projekteve per rehabilitimin e zonave të naftës, që sjellin ndotje në mjedis, krijimi i stacioneve të monitorimit.

Të gjitha propozimet/ sugjerimet apo problemet e paraqitura në dëgjesë për bashkinë Kuçovë, janë marrë dhe do të merren parasysh deri në miratimin e PPV.

Në këtë takim, proçes-verbali u mbajt nga specialistja e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit znj. Xhenisa Kostreni.

Për/ Drejtorinë e Urbanistikës dhe Strehimit

Ing. Olgert ZOGA

Ark. Eljan HAJDARI

Ing. Xhenisa KOSTRENI

Sp/Strehimi. Bledar DJAMANDI

Sp/Projektesh Julian LEZO

Ing. Arminda BARDHI

Drejtor i Urbanistikës dhe Strehimit: Ferdinand PUTRO

Shënime dhe Referenca

[1] Klasifikimi i klimës sipas Köppen-it është një klasifikim klime nga më të përdorurit në sistemet e klasifikimit të klimës. U publikua për herë të parë në 1884 nga klimatologu ruso-gjerman Vladimir Köppen. Më vonë, klimatologu gjerman Rudolf Geiger bashkëpunoi me Köppen-in për ndryshimin e sistemit të klasifikimit dhe tashmë sistemi njihet me emrin Köppen–Geiger. Ky klasifikim lidhet me tipat e vegjetacionit dhe si reagojnë ata ndaj klimës.

[2] Klasifikimi Csa - Klima e grupit C - Klima mesatare që ndodhin zakonisht në anën perëndimore të kontinenteve ndërmjet gjerësive 30° dhe 50°. Csa - është klima me verë të thatë ose, ndryshe, klima mesdhetare.

[3] Bashkësia e strukturave gjeologjike brenda territorit të Shqipërisë

[4] SHGJSH, Harta e pasurive minerale, Qarku Berat, Shkalla 1:100,000, 2014

[5] "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Berat, fq. 31-32, 2014

[6] "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Berat, fq. 32, 2014

[7] "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Berat, fq. 32-33, 2014

[8] "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Berat, fq. 33, 2014

[9] SHGJSH, Harta hidrogjeologjike, Qarku Berat, Shkalla 1:100,000, 2014

[10] "Akuiferi ose ujëmbajtësi është një formacion nëntokësor shkëmbi të përshkueshëm apo materiali të copëzuar i cili mund të prodhojë sasi të përdorshme uji dhe të merret qoftë nga burimet (natyrale), qoftë nga puset (artificiale)" cit: Vezir Muharremaj, "Shkenca e Tokës II", 2014

[11] "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Berat, fq. 58, 2014

[12] "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Berat, 2014

[13] Vezir Muharremaj, "Shkenca e Tokës II", fq. 161, 2014

[14] "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Berat, fq.66, 2014

[15] SHGJSH, "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Berat, fq. 91, 2014

[16] "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Berat, fq. 77, 2014

[17] https://sq.wikipedia.org/wiki/Perondia, hyrë në mars 2015, dhe https://sq.wikipedia.org/wiki/Ku%C3%A7ova, hyrë në mars, 2015

[18] Analiza merr parasysh vitet përkatëse të plansheteve të hartave topografike të Shqipërisë (nga 1956 në 1983)

[19] Bazuar në hartat topografike të Shqipërisë, ortofoto 2007, hartë bazë ESRI 2013, si dhe llogaritjet e autorëve

[20] Bashkia Kuçovë, "Analiza e gjendjes ekzistuese për planin e përgjithshëm të planifikimit të territorit"

[21] Sipas Seksionit 1.4.1, referuar INSTAT-it, 2011

[22] Llogaritje të autorëve

[23] Republika e Shqipërisë, Forcat e Armatosura, Baza Ajrore, Historiku i Regjimentit "23 Peza"

[24] Përzgjedhja e kësaj zone si rajon është bërë vetë për arsye studimi. Në këtë territor gjenden burime të shumta ujore, janë përqendruar një pjesë e madhe e HEC-eve dhe parqet nga zona fushore e bregdetare deri tek ajo malore. Pra, nga ana e analizës së metabolizmit i përmban të gjitha elementet e nevojshme për analizim

[25] Burimi i informacionit është Harta e rrezatimit mesatar vjetor, AKBN, përpunuar tek Harta e energjisë në rajon (Co-PLAN)
[26] Albanian Geotermal Atlas
[27] Energji të rinovueshme, energjia diellore
[28] "Strategjia kombëtare e energjisë", 2013
[29] INSTAT, Censusi 2011 (Grid)
[30] Njësi ekonomike familjare
[31] INSTAT, Censusi 2011
[32] Imbotilim është uji i pijshëm i paketuar në shishe
[33] Harta hidrologjike, SHGJSH
[34] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku i Beratit, Tiranë 2014
[35] Të dhënat për ujësjellës-kanalizime janë përpunuar nga Valu ADD
[36] Referuar "Hartës së përdorimit të tokës dhe mbulesës së tokës sipas CORINE"
[37] Në çdo rast, për njësinë administrative Kuçovë prodhimtaria bujqësore e blegtorale është 0.
[38] Ministria e Mjedisit, Agjencia Rajonale Mjedisore Berat, "Raporti rajonal mjedisor- Berat", Berat 2014
[39] INSTAT (2013), i disponueshëm në: http://www.instat.gov.al/al/themes/mjedisi.aspx?tab=tabs-5
[40] "Raporti rajonal mjedisor – Berat", 2014
[41] Vendim i KM nr.175, datë 19.1.2011, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve".
[42] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë*, Qarku Berat, Ministria e Energjisë dhe Industrisë.
[43] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë*, Qarku Berat, Ministria e Energjisë dhe Industrisë.
[44] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.
[45] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.
[46] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.
[47] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Beart, 2014.
[48] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Beart, 2014.
[49] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Beart, 2014.
[50] Nyle C. Brady, Ray R. Weil, Elements of the nature and properties of the soils, Third edition, 2010.
[51] SHGJSH 2014.
[52] SHGJSH, Harta Hidrologjike e Qarkut të Beratit.
[53] Nyle C. Brady, Ray R. Weil, Elements of the nature and properties of the soils, Third edition, 2010,
[54] Agjencia Kombëtare e Mjedisit, *Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit*, 2013.
[55] Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, *Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania*, Agric. Econ. – Czech, 60, 2014 (6): 287–293.
[56] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.
[57] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.
[58] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.

[59] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.

[60] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.

[61] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.

[62] Miriam Bogdani Ndini, *Analysis of Surface and Ground Water Exchange in Two Different Watersheds*, Institute of Energy, Water and Environment, University of Polytechnics, Albania, 2012.

[63] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë Qarku Berat*, 2014.

[64] SHGJSH, Drejtoria e Hidrogjeologjisë, Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, *Monitorimi i Dinamikë së Shtratit në Lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjendjes*, Shkurt, 2016.

[65] Kriteret mund të ndryshojnë nga vendi në vend.

[66] Ligji Nr. 111/2012 "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore".

[67] Instituti kompetent për studimin dhe monitorimin e gjendjes së shtretërve të lumenjve është SHGJSH-ja, siç përcaktuar me Ligjin Nr. 111/2015 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar".

[68] SHGJSH, Drejtoria e Hidrogjeologjisë, Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, *Monitorimi i Dinamikës së Shtratit në Lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjendjes*, Shkurt, 2016.

[69] Sipas Krutaj, F., Gruda, Gj., Kabo, M., Meçaj, N., Qirjazi, P., Sala, S., Ziu, T., Kristo, V. dhe Trojani, V. 1991, "Gjeografia fizike e Shqipërisë", Vëllimi II, Tiranë.

[70] Ky monitorim i cilësisë së ujërave sipërfaqësore u krye për lumenjtë: Seman (Osum, Devoll, Seman, dhe Gjanicë), Shkumbin, dhe Vjosë. Monitorimi u krye në periudhën qershor-korrik 2015, nga Co-PLAN-i, në kuadër të zbatimit të projektit të USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore. Në pellgun e lumit Seman, marrja e mostrave të ujit për analizë u bë në 11 pika, 6 nga të cilat në Osum. Në të gjitha pikat u analizuan në laborator 13 parametra fiziko dhe bio-kimikë (pH, Light Transparency, Electric Conductivity, Total Suspended Solids (TSS), Total Dissolved Solids (TDS), Dissolved Oxygen (DO), Temperature, Biochemical Oxygen Demand (BOD), N-NH_4, N-NO_3, N-NO_2, sulfidet dhe Total Coliform). Ndërkohë, 7 nga mostrat e mbledhura u analizuan edhe për praninë e metaleve të rënda (Pb, Cd, Mn, Ni, Zn, Cu, Co, Cr, Hg, As, Ba, Br).

[71] *Biological Oxygen Demand* – Nevoja Biologjike për Oksigjen.

[72] Normat janë marrë nga *Council Directive CEE/CEEA/CE 78/659* (Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659) për cilësinë e ujërave të ëmbla për rritjen e peshqve.

[73] *Total Suspended Solids.*

[74] *Total Dissolved Solids.*

[75] Standardi mjedisor është marrë nga *Directive 2006/113/EC of The European Parlament and of The Council of 12 December 2006 on the quality required of shellfish waters.*

[76] Metalet e rënda janë monitoruar në Seman 1 dhe 2, Gjanicë 1 dhe 2, Devoll 2, Osum 5 dhe 6, si she Vjosë 1 dhe 3.

[77] Ligji 11/2016 "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore".

[78] SHGJSH, 2014.

[79] Bashkia Kuçovë.

[80] AKBN (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore).

[81] SHGJSH.

[82] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë*, Qarku Berat, Ministria e Energjisë dhe Industrisë

[83] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2014.

[84] Studimet e mëparshme të bëra rreth burimeve ujore nëntokësore bazoheshin në sipërfaqen e Qarkut të Beratit sipas ndarjes administrative të territorit përpara Reformës së Re Administrative. Ende nuk ka një studim që përcakton sipërfaqen e akuiferëve në nivel bashkie të re.

[85] SHGJSH 2014.

[86] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Berat*, 2014.

[87] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Berat*, 2014.

[88] USAID, 2014, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Kuçovë pas Ndarjes Administrative Territoriale.*

[89] USAID 2014.

[90] USAID 2014.

[91] USAID 2014.

[92] USAID 2014.

[93] USAID 2014.

[94] SHGJSH: Deri më sot ende nuk janë kryer studime që përcaktojnë sasinë e ujit të shfrytëzuar nga puse të tilla.

[95] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Berat*, 2014.

[96] Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2015.

[97] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Berat*, 2014.

[98] Biseda me punonjës të Bashkisë Kuçovë.

[99] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Kuçovw pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.*

[100] AKM, Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2015.

[101] USAID, Projekti "*Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Kuçovë pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.*

[102] USAID, Projekti "*Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Berat pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.*

[103] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Berat*, 2014.

[104] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014.

[105] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014.

[106] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014.

[107] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014.

[108] Matthew Heberger and Kristina Donnelly , *Oil, Food, and Water: Challenges and Opportunities for California Agriculture*, Pacific Institute, December 2015.

[109] Bashkia Kuçovë.

[110] Agjencia Amerikane e Mjedisit (US EPA).

[111] Ligji Nr. 11/2016 "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore".

[112] US EPA, //www.epa.gov/uic/aquifer-exemptions-underground-injection-control-program.

[113] http://www.epa.gov/uic/aquifer-exemptions-underground-injection-control-program.

[114] *Hydraulic fracturing.*

[115] *horizontal drilling.*

[116] Futet sërish në pusin e shpuar.

[117] http://www.bankerspetroleum.com/albania/bankers-albania (March 30, 2016).

[118] http://www.bankerspetroleum.com/operations/three-part-operational-strategy.

[119] EPA, http://www2.epa.gov/hfstudy/executive-summary-hydraulic-fracturing-study-draft-assessment-2015.

[120] Deri më tani, ujërat nëntokësore mbulohen nga Ligji 111/2012[120] për manaxhimin e integruar të ujërave ndërsa mungon legjislacioni për mbrojtjen e nëntokës.

[121] Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA (Environmental Protection Agency in USA). http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells

[122] Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA (Environmental Protection Agency in USA). http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells

[123] Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA (Environmental Protection Agency in USA). http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells

[124] Ri-injektimi kryhet *kryesisht për ri-injektimin e CO2, mbetjeve, përmirësimin e prodhimit të naftës, minierat, si dhe për parandalimin e depërtimit të ujit të kripur.*[124] *Një praktikë e tillë është parë si një mënyrë e sigurt dhe e pak shpenzime për depozitimin e mbetjeve të padëshiruara dhe kryesisht të mbetjeve të rrezikshme industrial dhe nënprodukteve të tyre.* http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells

[125] "Ndikimet mbi mjedis të industrisë nxjerrëse të naftës, vlerësimi i mjedisit në vendburimin e visokës dhe rrugët që duhet të ndiqen për rehabilitimin e tij", Nevton Kodhelaj, Nevina Koja, Fatjona Levani.

[126] Në SHBA, kongresi ka kaluar ligjin për Mbrojtjen e burime ujore (*the Safe Drinking Water Act -SDWA*) në vitin 1974 I cili parashikon mbrojtjen e burimeve ujore që furnizojnë popullsinë me ujë të pijshëm. Në kuadër të këtij ligji, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka hartuar programin e Kontrollit të Lëndëve të ri-injektuara Nëntokë (*Underground Injection Program Control*) i cili përcakton kushtet kur ri-injektimi lejohet me ligj.

[127]ARM Berat.

[128] David J. Nowak, USDA Forest Service, Syracuse, NY, *The Effects of Urban Trees on Air Quality*, 2002

[129] US EPA, https://www.epa.gov/greenvehicles/greenhouse-gas-emissions-typical-passenger-vehicle-0.

[130] US EPA (United States Environmental Protection Agency), Average Annual Emissions and Fuel Consumption for Gasoline-Fueled Passenger Cars and Light Trucks, 2008.

[131] INSTAT, 2010.

[132] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, *Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.*

[133] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, *Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.*

[134] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, *Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.*

[135] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, *Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.*

[136] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, *Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March.*

[137] Bëhet fjalë për naftën që përdoret për makina.

[138] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.

[139] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.

[140] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.

[141] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.

[142] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.

[143] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.

[144] Environmental Center for Administration and Technology, Tirana 2008.

[145] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, *Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.*

[146] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, *Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.*

147 Sipas studimit të ECAT në vitin 2008. Nga fushata pilot mbi shkarkimet e gazrave nga mamitat e makinave zhvilluar në qytetin e Tiranës në vitin 2008, është studiuar sasia e shkarkimeve në ajër nga makinat me moshë të ndryshme. Studimi ka testuar 1,036 automjete me vite prodhimi të ndryshme. 880 makina përdornin si lëndë djegëse naftën dhe 156 benzinën.

[148] ECAT, Kontrolli - mirëmbajtja dhe siguria e automjeteve, Tiranë 2008.

[149] ECAT, Kontrolli - mirëmbajtja dhe siguria e automjeteve, Tiranë 2008.

[150] United States Environmental Protection Agency, *Oil and Natural Gas Sector: Standards of Performance for Crude Oil and Natural Gas Production, Transmission, and Distribution*", https://ëëë.epa.gov/airquality/oilandgas/tech.html

[151] VNM - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.

[152]US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6

[153] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6

[154] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6

[155] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6

[156] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6

[157] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6

[158] Agjencia Kombëtare e Mjedisit, *Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit*, 2013.

[159] AKM, 2013.

[160] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Beart*, 2014.

[161] Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, *Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania*, Agric. Econ. – Czech, 60, 2014 (6): 287–293.

[162] ARM, Berat 2014.

[163] Raporti i Gjendjes së Mjedisit Berat, 2014.

[164] Strategjia e Zhvillimit Për Territorin e Bashkisë Kuçovë, USAID, 2016.

[165] Co-PLAN 2015, Harta e Përdorimit të Tokës Kuçovë – Draft.

[166] ARM Berat, 2014.

[167] EU Commission, *Overview of CAP Reform 2014-2020*, Agricultural Policy Perspectives Brief, N°5* / December 2013.

[168] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[169] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[170] The World Bank, *Looking Beyond the Horizon.*

[171] ECN 2008.

[172] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[173] The World Bank, *Looking Beyond the Horizon.*

[174] SZHT, Bashkia Kuçovë, 2016.

[175]Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[176]Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[177]Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[178]Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[179] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[180] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[181] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[182] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[183] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[184] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016.

[185] The World Bank, *Reducing the Vulnerability of Albania's Agricultural Systems to Climate Change.*

[186]The World Bank, *Reducing the Vulnerability of Albania's Agricultural Systems to Climate Change*

[187]SZHT, Bashkia Kuçovë, 2016.

[188] SHGJSH, 2014.

[189]Shpetim Nishani, N/Kryetar i Bashkise Kuçovë, *Historiku i Uzinës së Përpunimit të Naftës, Kuçovë*, 11.05.2012 (prezantim).

[190] Projekti Çek, Bashkia Kuçovë.

[191]United Nations Economic Commission for Europe, *Albania: Environmental Performance Reviews, Second Review*, United Nations, New York and Geneva, 2012, Raporti *South-Eastern European mining related risks: Identification and verification of environmental hot spots.*

[192] ARM Berat, *Raporti i Gjendjes së Mjedisit*, 2014.

[193] ARM Berat, *Raporti i Gjendjes së Mjedisit*, 2014.

[194] Albpetrol, sh.a. 2016.

[195] Ligji nr. 9117, 2004 "Per percaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të sh.a ARMO".

[196] Në momentin e shkrimit të këtij artikulli, Bankers është në proces negocimi për shitjen e kompanisë.

[197] http://www.albpetrol.al/kush-jemi/ (30 mars 2016)

[198] Këto ditë flitet se International Petroleum Ltd. ka shitur aktivitetin e saj. Mbetet ende e panjohur kompania që do të shfrytëzojë këtë zonë në vend të kompanisë Sherëood Petroleum Ltd. Sipas Bankers Petroleum Ltd. Kuçova ka 12 milion naftë fuçi rezervë (rreth 7.1% të rezervave kombëtare)[198].

[199] Vendim Nr.686, date 19.10.2007 *Per Miratimin E Marrëveshjes Hidrokarbure, Ndërmjet Albpetrol Sha-Së Dhe Sherwood International Petroleum Ltd per zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në vendburimin e Kuçovës për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në zonën e kontratës.*

[200] Aneksi A, Vendim Nr.686, date 19.10.2007.

[201] Të dhënat janë marrë nga punonjës të Bashkisë Kuçovë

[202] Bashkia Kuçovë, 2016

[203] Të dhënat janë marrë nga Bashkia Kuçovë

[204] Dr. Shannon L. Ferrell, Dr. Tiffany Dowell Lashmet, Dr. Rusty Rumley, *Petroleum Production on Agricultural Lands in Oklahoma: Managing Risks and Opportunities*, USDA National Institute of Food and Agriculture.

[205] Dr. Shannon L. Ferrell, Dr. Tiffany Dowell Lashmet, Dr. Rusty Rumley, *Petroleum Production on Agricultural Lands in Oklahoma: Managing Risks and Opportunities*, USDA National Institute of Food and Agriculture.

[206] http://www2.epa.gov/hydraulicfracturing

[207] Futet sërish në pusin e shpuar.

[208] Dr. Shannon L. Ferrell, Dr. Tiffany Dowell Lashmet, Dr. Rusty Rumley, *Petroleum Production on Agricultural Lands in Oklahoma: Managing Risks and Opportunities*, USDA National Institute of Food and Agriculture.

[209] Matthew Heberger and Kristina Donnelly , *Oil, Food, and Water: Challenges and Opportunities for California Agriculture*, Pacific Institute, December 2015.

[210] Agjencia Amerikane e Mjedisit (US EPA), Chapter 5 Oil/Water Separators, 2013.

[211] ARM Berat, *Raporti i Gjendjes së Mjedisit*, 2014.

[212] ARM Berat.

[213] ARM Berat, *Raporti i Gjendjes së Mjedisit*, 2014.

[214] *Enhanced Oil Recovery* ose teknika për shfrytëzimin efiçent të naftës.

[215] Gazeta New York Times,
http://www.nytimes.com/2013/10/12/business/international/france-upholds-fracking-ban.html?_r=0

[216] American Petrolium Institute

[217] S. Taku Ide (Dept. of Petroleum Engineering, Stanford University), S. Julio Friedmann (Lawrence Livermore National Laboratory, 7000 East Ave, Livermore, CA 94550), and Howard J. Herzog (Labratory for Energy and the Environment, MIT Cambridge MA 02139), CO2 leakage through existing wells: current technology and regulations.
https://sequestration.mit.edu/pdf/GHGT8_Ide.pdf

[218] Dr. Shannon L. Ferrell, Dr. Tiffany Dowell Lashmet, Dr. Rusty Rumley, *Petroleum Production on Agricultural Lands in Oklahoma: Managing Risks and Opportunities*, USDA National Institute of Food and Agriculture.

[219] Sipas burimeve të Bankers, kompania ka vetëm një leje shfrytëzimi.

[220] Sipas Ligjit Nr. 111/2015 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqipëtar", për kryerjen e shpimeve për ujëra nëntokësore me thellësi mbi 15m nga sipërfaqja e tokës merret miratim nga SHGJSH përpar se të dorëzohet projekti hidrogjeologjik tek Këshilli i Basenit.

[221] Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit, ky plan është në proces hartimi.

[222] US GS (Shërbimi Gjeologjik Amerikan), 2016. http://water.usgs.gov/ogw/subsidence.html

[223] US GS (Shërbimi Gjeologjik Amerikan), 2016. http://water.usgs.gov/ogw/subsidence.html

[224] US GS (Shërbimi Gjeologjik Amerikan), 2016. http://water.usgs.gov/ogw/subsidence.html

[225] Të dhënat janë marrë nga biseda me përfaqësues të Kompanisë Bankers.

[226] US EPA, *Protecting Underground Sources of Drinking Water from Underground Injection (UIC).*

[227] USGS, 18 korrik, 2016, http://earthquake.usgs.gov/research/induced/myths.php

[228] USGS, 18 korrik, 2016, http://earthquake.usgs.gov/research/induced/myths.php

[229] Drejtoria rajonale e shërbimit pyjor Berat.

[230] Ish-Komuna Kozare, Lista e Inventarit miratuar me VKM nr. 180 datë 31.03.2005.

[231] Nenin 2, Pika 5 (Përkufizime dhe fushat e veprimit) të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor".

[232] Në nenin 9, Pika 4 (Rezervat Natyror i Manaxhuar/Park Natyror) të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura"

[233] Nenin 2, Pika 20(Përkufizime dhe fushat e veprimit) të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "PËR PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR"

[234] Cit. Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar).

[235] Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar).

[236] AKZM 2016.

[237] Ligji Nr 8906, datë 06.06.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008.
[238] VKM Nr.31, datë 20.01.2016 për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[239] Strategjia për Zhvillimin e Territorit, Bashkia Kuçovë.
[240] Plani Strategjik i Zhvillimit, Komuna Lumas.
[241] Vendim Nr. 676, Date 20.12.2002 "Për Shpalljen Zonë e Mbrojtur të Monumenteve të Natyrës Shqiptare".
[242] AKZM, http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Elbasan/EL_Mon/EL25.htm.
[243] Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë, SHGJSH 2014.
[244] AKZM, http://www.akzm.gov.al/apps/akzm_cd/Elbasan/EL_Mon/EL25.htm
[245] Ligji Nr 9587, datë 20.7.2006 'Për Mbrojtjen e Biodiversitet'.
[246] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
[247] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
[248] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
[249] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
[250] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
[251] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
[252] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
[253] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
[254] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit"
[255] Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
[256] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[257] VKM nr. 31, dt. 20. 01. 2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
[258] EU Commission, *Overview of CAP Reform 2014-2020*, Agricultural Policy Perspectives Brief, N°5* / December 2013.
[259] Llogaritjet e autorit, duke ruajtur peshat specifike të ndarjes së popullsisë në bashki e komuna me të dhënat e censusit të popullsisë, 2011.
[260] Shënim metodik: *INSTAT-i, mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, si dhe në "trendin" që kanë pësuar treguesit demografikë të lindshmërisë, vdekshmërisë, emigracioni dhe migracioni, ka ndërtuar skenarët e parashikimeve të popullsisë. Sipas këtyre përllogaritjeve, janë ndërtuar 3 skenarë të numrit të popullsisë shqiptare deri në vitin 2031, përkatësisht skenari i rritjes së ulët (lindshmëri e ulët, vdekshmëri e lartë, migracion i lartë), skenari i rritjes së mesme (lindshmëri, vdekshmëri dhe migracion me rritje të mesme) dhe skenari i rritjes së lartë (lindshmëri e lartë, vdekshmëri e ulët dhe migracion i ulët). Për efekt planifikimi (demografik, financiar-buxhetor) rekomandohet përdorimi i të dhënave që rezultojnë nga skenari i rritjes së mesme të popullsisë. Gjithashtu, vlen të theksohet se parashikimet e popullsisë për rastin e qarqeve janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme në periudha 5-vjeçare dhe vetëm në nivel qarku, pra nuk ka llogaritje në nivel bashkie ose ish- komune. Mbështetur në të dhënat e popullsisë për ish-komunat, bashkitë dhe peshën e tyre përkatëse ndaj qarkut për vitin 2011, janë përgatitur "projeksionet e popullsisë në nivel bashkie dhe komunash për periudhën 2016-2031.*

[261] Llogaritur si raport i personave që kanë përfunduar arsimin 8 ose 9-vjeçar ndaj popullsisë 15 vjeç e lart
[262] Ky vlerësim është kryer nga Ministria e Arsimit për të gjithë objektet arsimore (parashkollore deri në shkollë të mesme) në territorin e Shqipërisë në vitin 2012. Treguesit e matur janë: kushtet e mureve të jashtme, kushtet e mureve të brendshme, gjendja e çatisë, gjendja e tavaneve të brendshme, gjendja e themeleve, cilësia e dyerve dhe cilësia e dritareve
[263] Bashkia Kuçovë, 2015
[264] Me qendra shëndetësore, në këtë rast, nënkuptohen si qendra shëndetësore, sipas përkufizimit në VKM-në nr. 857, datë 20.12.2006, "Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor", ashtu edhe ambulancat konsultore.
[265] Sipas VKM-së nr. 671, datë 29.7.2015, kërkohet një qendër shëndetësore për 250-1500 banorë
[266] Referuar "Analizës demografike", seksioni 1.4.1
[267] Drejtoria e Shëndetit Publik
[268] Ministria e Shëndetësisë, 2009: "Situata shëndetësore dhe kujdesi shëndetësor, arritjet dhe drejtimet për të ardhmen"
[269] Drejtoria e Shëndetit Publik, 2010, referuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe UNICEF, 2013: "Varfëria e fëmijëve në Shqipëri"
[270] Referuar http://www.civitas.al/al/vendi/kucove-banoret-proteste-kunder-firmes-se-naftes-po-rrezikojme-shendetin
[271] Living Standard Measurement Study: "Studimi për matjen e standardit të jetesës"
[272] Shifër që i përket vitit 2010, referuar "Analizës së treguesve socialë sipas qarqeve", 2014
[273] Shërbime që adresojnë problemet e familjeve dhe fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian
[274] PBB (produkti i brendshëm bruto) tregon se çfarë vlere kanë të mirat materiale dhe shërbimet që janë prodhuar në vend gjatë një viti, duke iu referuar çmimit të tregut.
[275] Referuar të dhënave të publikuara nga INSTAT-i, në "Llogaritë rajonale në Shqipëri, 2012" dhe "Vjetarin statistikor rajonal, 2015"
[276] VSHB llogaritet si: Vlera e prodhimit - Vlera e konsumit të ndërmjetëm. (Vlera e prodhimit = Vlera e shitjeve totale të mallrave dhe shërbimeve + Vlera e ndryshimeve në inventar; Konsumi i ndërmjetëm (KN) = kostoja e materialeve, furnizimeve dhe shërbimeve të përdorura për të prodhuar mallrat ose shërbimet përfundimtare)
[277] Produktiviteti llogaritet si raport i VSHB-së së sektorit me numrin e të punësuarve në atë sektor
[278] Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve, 2012. Burimi: Vjetari statistikor 2012
[279] Organizata për Bujqësi dhe Ushqim (FAO), 2014
[280] Referuar "Mbulesës së tokës sipas Corine"
[281] INSTAT, 2015
[282] INSTAT, 2011
[283] "Strategjia ndërsektoriale e bujqësisë dhe zhvillimit rural 2014-2020"
[284] INSTAT 2012 dhe Bashkia Kuçovë, 2015
[285] "Strategjia ndërsektoriale e bujqësisë dhe zhvillimit Rural 2014-2020"
[286] Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Nëntor 2014, "*Analiza e skemave mbështetëse. Politikat dhe strategjitë e ndërhyrjeve në bujqësi*"
[287] Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Nëntor 2014, "*Analiza e skemave mbështetëse. Politikat dhe strategjitë e ndërhyrjeve në bujqësi*"
[288] Co-PLAN 2016, Harta e përdorimit të tokës, Kuçovë
[289] Të dhëna të Bashkisë Kuçovë, 2015
[290] "Nxitja e zhvillimit rajonal nëpërmjet objektivave të mjëvjeçarit për qarkun e Beratit", UNDP 2013
[291] "Nxitja e zhvillimit rajonal nëpërmjet objektivave të mjëvjeçarit për qarkun e Beratit", UNDP, 2013
[292] Të dhëna të Bashkisë Kuçovë, 2015
[293] INSTAT, 2015
[294] "Nxitja e zhvillimit rajonal nëpërmjet objektivave të mjëvjeçarit për qarkun e Beratit", UNDP, 2013

[295] "Raporti i gjendjes së mjedisit- Berat", 2014

[296] "Raporti i Gjendjes së Mjedisit- Berat", 2014

[297] Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, *Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania*, Agric. Econ. – Czech, 60, 2014 (6): 287–293

[298] ARM, Berat 2014

[299] "Raporti i gjendjes së mjedisit- Berat", 2014

[300] Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës.

[301] Llogaritja është bërë duke marrë parasysh vetëm të dhënat për pronat publike që vijnë nga Inventari i Pronave Publike. Pra, të gjitha këto prona konsiderohen si 100%, por kjo është bërë për efekte llogaritjeje. Nga kjo listë e të dhënave nuk janë të përfshira zonat pyjore.

[302] Ligj nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës.

[303] http://shqiptarja.com/sociale/2750/lame-29-5--e-nd-rtimeve-n--shqip-ri-jan--zona-informale-310114.html#sthash.T2OE7DÊa.dpuf

[304] http://shqiptarja.com/sociale/2750/lame-29-5--e-nd-rtimeve-n--shqip-ri-jan--zona-informale-310114.html#sthash.T2OE7DÊa.dpuf

[305] Vendim i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 1/7, datë 26.10.2007 për Miratimin e Vijave Kufizuese të Zonave/ Vendbanimeve Informale në Qarkun e Beratit.

[306] https://sq.wikipedia.org/wiki/Lista_e_rrug%C3%ABve_komb%C3%ABtare_dhe_autostradave_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri

[307] *Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar*

[308] *Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar*

[309] *Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", neni 9, fq. 5*

[310] Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", faqe 3

[311] Ligji nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.10 488, datë 5.12.2011, faqe 7

[312] Përgatitur nga informacionet e marra nga ndriçimi urban, FSHZH, vëzhgimet në terren, si dhe evidentimi nga ortofoto e vitit 2007 dhe 2015, ASIG

[313] *Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar*

[314] *Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar*

[315] *Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar*

[316] Burimi ValuAdd & KfW Design Report - Kuçovë

[317] Projekt i përpiluar prej KfW

[318] PLGP/USAID/ValuAdd dhe KfW Design Report - Kuçovë

[319] SCADA - Supervisory Control and Data Acquisition

[320] Bashkia Kuçovë

[321] PLGP/USAID/VALU ADD, 2015

[322] Ligji 10463 – 2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

[323] "Reforma territoriale"

[324] "Raporti i gjendjes në mjedis – Berat-Kuçovë", 2015, *Kapitulli 1.4*

[325] Bashkia Kuçovë

[326] "Raporti i gjendjes në mjedis – Berat – Kuçovë", 2015, fq. 40

[327] SHGJSH, 2014

[328] Ligji nr. 111, datë 2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"

[329] Vendim nr. 452, datë 11.7.2012, "Për *landfill*-et e mbetjeve"

[330] Aneksi 1, i përcaktuar në VKM-në nr. 452, datë 11.07.2012

[331] ARM Berat, *Raporti i Gjendjes në Mjedis*, Berat, 2015.

[332] ARM Berat, 2016
[333] ARM Berat, 2016
[334] ARM Berat, 2016
[335] NGO – "Për Mirëqënien sociale e mjedisore", Qarku Berat
[336] "Ndikimet mbi mjedis të industrisë nxjerrëse të naftës, vlerësimi i mjedisit në vendburimin e Visokës dhe rrugët që duhet të ndiqen për rehabilitimin e tij" – Fakulteti i Gjeologji Minierave - Nevton Kodhelaj
[337] EU, "Management Plan for Berat Region", 2010, The European Union's IPA 2010 programme for Albania
[338] "Studimi i fizibilitetit – Ndarja në burim e mbetjeve urbane në bashkinë Kuçovë" (Assist Impact – USAID)
[339] Shënim i rëndësishëm: Informacioni i paragrafit, si dhe i tabelës së mësipërme është informacion i bazuar në materialet e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Ky informacion nuk është i plotë përsa i përrket kanaleve të treta.
[340] "Plani i menaxhimit të integruar të mbetjeve", Bashkia Kuçovë – Qershor 2013 (EDEN)
[341] "Raporti i gjendjes në mjedis – Berat-Kuçovë", 2015
[342] Vendimi nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"
[343] VKM nr. 671, neni 73
[344] VKM 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"
[345] "Analiza e policentrizmit", "Strategjia e zhvillimit për territorin", Bashkia Kuçovë, 2016
[346] "Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020", miratuar me vendim të KM, nr.691, data e Aktit: 29.07.2015
[347] Co-PLAN 2015, Harta e përdorimit të tokës, Kuçovë - Draft
[348] Albpetrol Sh.a. 2015, Companies, http://www.albpetrol.al/en/companies/ aksesuar datë 22.11.2015
[349] Bankers Petroleum Ltd. 2015, Reserves, http://www.bankerspetroleum.com/operations/reserves aksesuar datë 22.11.2015
[350] CIA 2015, World Factbook, https://www.cia.gov/library/publications/resources/the-world-factbook/geos/al.html aksesuar datë 22.11.2015
[351] Ligj nr 9073, "Per privatizimin e shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" shpk, Kuçove" datë 29.05.2003
[352] Burimi: "Rregullorja e planifikimit"- VKM nr. 671
[353] Burimi: "Rregullorja e planifikimit"- VKM nr. 671
[354] Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për ndërtim
[355] http://www.seetoint.org/wp-content/uploads/downloads/2014/12/MAP-2015-FINAL-web.pdf , page 40

[356] ttp://www.transporti.gov.al/al/newsroom/njoftime/njoftim-per-linjat-e-reja-te-transportit-nderqytetas&page=1
[357] *Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar*

[358] *Closed Circuit Tele-Vision* - Video inspektim i seksionti të tubacionit për dëmtime apo ndërhyrje të paligjshme.

[359] Nevoja Biokimike për Oksigjen - NBO.
[360] "Plani kombëtar i menaxhimit të mbetjeve" - 2010 – 2025, fq. 35
[361] "Plani kombëtar i menaxhimit të mbetjeve" - 2010 – 2025, fq. 41
[362] "Pikë transferimi mbetjesh urbane" quhet një stacion tranzitor i përcaktuar për grumbullimin e përkohshëm të të gjithë mbetjeve urbane të një bashkie/qyteti apo kumuniteti të vogël të cilat kanë si destinacion final *landfill*-in.
[363] mmnd – metra mbi nivel deti

[364] VKM Nr.31, datë 20.01.2016 për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

[365] SHGJSH, 2016

[366] ARM 2014

[367] SHGJSH

[368] ARM Berat

[369] ARM Berat

[370] SHGJSH

[371] SHGJSH

[372] SHGJSH

[373] SHGJSH

[374] Rezultatet e monitorinit publikohen në Raportin e Monitorimit të Mjedisit të vitit përkatës.

[375] http://www.epa.gov/uic/class-ii-oil-and-gas-related-injection-wells#dw_protect

[376] SHGJSH

BASHKIA KUÇOVË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT
TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË TERRITORIT TË BASHKISË KUÇOVË

MIRATOHET

KRYETARI I KKT

Z. EDI RAMA

MINISTRJA E ZHVILLIMIT URBAN

ZNJ. EGLANTINA GJERMENI

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Z. GJERGJI MIHALI

KRYETARI I BASHKISË

Z. SELFO KAPLLANI

Miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Kuçovë Nr.76 Datë24/11/2016

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.2 Datë 29/12/2016

Hartuar nga	Bashkia Kuçovë
Mbështetur nga	Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtime....3
Lista e Figurave....4
Lista e Tabelave....4
Hyrje....5
1. Politika e hartimit të Planit të Investimeve Kapitale....7
2. Nevoja për investimeve kapitale dhe identifikimi i projekteve....11
3. Kapaciteti financiar i Bashkisë Kuçovë....14
3.1 Analiza financiare 2010-2015....14
3.1.1 Të ardhurat....14
3.1.2 Shpenzimet....18
3.1.3 Teprica operative dhe buxheti kapital....19
4. Përzgjedhja e projekteve kapitale prioritare....22
5. Mundësitë e financimit dhe mobilizimi i të ardhurave....23
5.1 Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve....23
5.2 Parashikimi i tepricës operative dhe buxhetit kapital....25
6. Fishat e projekteve kapitale....27
7. Shtojca....47
8. Shënime dhe referenca....55

Shkurtime

MF	Ministria e Financave
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
PIK	Plani i Investimeve Kapitale
PBA	Programi i Buxhetit Afatmesëm
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PPP	Partneritet Publik Privat
QQ	Qeveria Qendrore
TO	Teprica Operative
TON	Teprica Operative Neto
SZHT	Strategjia e Zhvillimit për Territorin
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Lista e Figurave

Figura 1. Hapat në hartimin e PIK 6
Figura 2. Financimi i investimeve kapitale 8
Figura 3. Planifikimi financiar – të krijosh hapësirë për projekte të reja 8
Figura 4. Ecuria e të ardhurave totale dhe ndryshimet vjetore 14
Figura 5. Kontributi i kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave totale 15
Figura 6. Të ardhurat vendore dhe ndryshimi vjetor i tyre 15
Figura 7. Kontributi sipas kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave vendore 16
Figura 8. Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare dhe ndryshimi vjetor i tyre 17
Figura 9. Shpenzimet sipas qëllimit të përdorimit dhe ndryshimi vjetor i tyre 18
Figura 10. Kontribute sipas kategorive në ndryshimin vjetor të shpenzimeve totale 19
Figura 11. Teprica operative neto 20
Figura 12. Të ardhura dhe shpenzime kapitale 21
Figura 13. Shpenzimet kapitale sipas programeve buxhetore 21
Figura 14. Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve 25
Figura 15. Parashikimi i tepricës operative neto 26
Figura 16. Parashikime për buxhetin kapital, 2016 – 2030 26

Lista e Tabelave

Tabela 1. Inventari i infrastrukturës dhe shërbimeve publike në Bashkinë e Kuçovës 13
Tabela 2: Mbulimi i popullsisë së njësive administrative të Bashkisë së Kuçovës me shërbime vendore 13
Tabela 3: Supozime bazë për parashikimin e të ardhurave 23
Tabela 4: Supozime bazë për parashikimin e shpenzimeve 24

Hyrje

Plani i Investimeve Kapitale (PIK) hartohet si një dokument strategjik financiar dhe adreson investimet dhe përmirësimet kapitale që rezultojnë të nevojshme për zbatimin e vendimeve të planeve të përgjithshme vendore (PPV). PIK përcakton kohën e realizimit, koston, burimet e financimit si dhe informacione të tjera të detajuara, të cilat kanë të bëjnë përgjithësisht me infrastrukturat publike. Në rregulloren e planifikimit të territorit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) numër 671, datë 29.07.2015, neni 54, pika 5/b, përcaktohet se plani për zhvillimin e territorit shoqërohet edhe me planin e veprimeve për zbatimin e PPV-së, i cili mes të tjerave përmban *"koston e përgjithshme për zbatimin dhe aktivitetet kryesore të financuara të shoqëruara me planin e investimeve kapitale"*. Kjo përcakton edhe bazën ligjore kryesore, të cilës i referohet dhe respekton hartimi i PIK.


PIK është një plan shumëvjeçar i projekteve kapitale të listuara sipas prioritetit, i prezantuar në faza, që identifikon pasurinë/asetin që do të rehabilitohet, vitin kur do të fillojë të zbatohet dhe kohëzgjatjen e investimit, koston që do të kërkojë realizimi, si dhe mënyrën e propozuar të financimit të investimit. PIK prezantohet si një pasqyrë përmbledhëse që përfshin shpenzimet për investimet kapitale për çdo vit, të detajuara sipas objektivave strategjikë dhe programeve që përmbushin, si dhe mënyrës së financimit të tyre.

Qëllmi kryesor i dokumentit është të mundësojë:

- garantimin e mekanizmave të nevojshëm përmes të cilëve objektivat strategjikë të identifikuara në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit për Territorin e bashkisë të integrohen sa më mirë në procesin e planifikimit;
- krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta midis projekteve kapitale prioritare dhe prioriteteve në kryerjen e shpenzimeve nëpërmjet shpërndarjes efektive të burimeve në dispozicion;
- parashikim më të mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë disa vjeçare për të gjitha programet e shpenzimeve;
- përdorimin e parimit të vlerës së parasë nëpërmjet efektivitetit dhe efiçencës ekonomike në kryerjen e shpenzimeve publike;
- forcimin e disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal, në linjë me programin buxhetor afatmesëm (PBA).

Hapi i parë për përgatitjen e PIK është hartimi i politikave të PIK, të cilat reflektojnë vizionin strategjik të zhvillimit të bashkisë si dhe strategjinë financiare dhe fiskale që do të ndiqet për të mundësuar realizimin e objektivave strategjike që zbërthejnë këtë vizion. Hartimi i politikës së PIK pasohet prej vlerësimit dhe identifikimit të nevojave kapitale (Figura 1. Hapat në hartimin e PIK). Hapi i tretë mundëson analizimin e kapaciteteve financiare të bashkisë, dhe prezanton një pamje të plotë të situatës dhe mundësive financiare të njësisë vendore, duke u ndalur veçanërisht në kapacitetin huamarrës të njësisë si dhe mundësinë për të reduktuar shpenzimet operative, e prezantuar instrumente të reja financiare në funksion të përmirësimit të infrastrukturave publike. Kjo analizë pasohet prej listës së projekteve kapitale të prioritarizuara, mbi bazën e një metodologjie vlerësimi të ndarë e dakordësuar me aktorët. Mobilizimi i të ardhurave dhe fazimi i investimeve sipas nevojave dhe mundësive janë hapat që përmbyllin hartimin e dokumentit, i cili i nënshtrohet seancave të diskutimit me publikun njëlloj si PPV.

Figura 1. Hapat në hartimin e PIK



Burimi: Manuali për hartimin e planit të investimeve kapitale, Co-PLAN 2008

Dokumenti i PIK për Bashkinë Kuçovë, është i organizuar në kapituj që reflektojnë hapat e ndërmarra gjatë hartimit të PIK, dhe përmbyllet me pasqyrën përmbledhëse të shpenzimeve për investimet kapitale sipas fazave të përcaktuara edhe në PPV. Për të gjithë periudhën e konsideruar në PIK, 2016 – 2030, shpenzimet parashikohen dhe prezantohen në tabelë të detajuara për çdo vit. Pjesë e dokumentit të PIK janë edhe fishat e projekteve kapitale, të cilat sjellin një informacion të përmbledhur në lidhje me investimin e parashikuar, vlerën e tij, kohëzgjatjen, mënyrën e financimit, etj.

1. Politika e hartimit të Planit të Investimeve Kapitale

Politika e hartimit të PIK adreson qasjet e ndjekura në lidhje me një sërë çështjesh, si p.sh.: (i) lloji i projekteve kapitale të përfshira; (ii) periudhën kohore që PIK mbulon; (iii) mënyrën e financimit të projekteve kapitale, apo mundësinë për të mobilizuar të ardhura; (iv) strategjinë financiare dhe atë fiskale që do të ndjekë bashkia për të mundësuar realizimin e investimeve të parashikuara; (v) procesin e përfshirjes dhe konsultimit të publikut gjatë hartimit të PIK, etj.

Në këtë dokument PIK prezantohet si një prej instrumenteve që mundësojnë zbatimin e PPV-së. Ky fakt kushtëzon dhe orienton njëkohësisht hartimin e tij. Kështu, identifikimi dhe përcaktimi i nevojave për investime kapitale në bashki, bëhet drejtpërdrejtë gjatë dhe nëpërmjet procesit të hartimit të PPV-së. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për procesin e prioritarizimit të investimeve kapitale, si dhe fazimin e tyre. PIK mbulon periudhën kohore 2016 – 2030 dhe investimet kapitale organizohen sipas tre fazave, të cilat reflektojnë edhe planin e veprimit të hartuar në SZHT të Bashkisë së Kuçovës. Për fazën e parë të PIK (2016 – 2020) jepen të detajuara në analizë të gjitha të dhënat financiare dhe fiskale si dhe mundësitë e financimit të PIK, ndërsa për fazën e dytë (2020 – 2025) dhe të tretë (2026 – 2030) parashikimet prezantohen për zërat kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke reflektuar strategjinë financiare të parashikuar për financimin e investimeve kapitale.

Si pjesë e politikës së PIK, procesi është kryer në mënyrë të tillë që të ofrojë informacionin e nevojshëm edhe për vendodhjen gjeografike të investimit, duke i specifikuar investimet (sa herë është e mundur) sipas njësive administrative që përbëjnë Bashkinë e Kuçovës.

Më poshtë do të ndalemi kryesisht në detajimin e strategjisë financiare të propozuar prej Bashkisë Kuçovë për të mundësuar realizimin e investimeve/përmirësimeve të listuara.

Burimi kyesor i vetë Bashkisë së Kuçovë për financimin e PIK është teprica operative neto (TON). TON do të përcaktohet si diferenca midis të ardhurave korente dhe shpenzimeve korente (Figura 2., Financimi i investimeve kapitale). Konvencionalisht, të ardhurat korente do të identifikohen si diferencë e të ardhurave totale me të ardhurat kapitale (të ardhura nga shitja e aseteve dhe të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë). Shpenzimet korente do të quhen të kategoritë e shpenzimeve për personel dhe për shpenzime operative. Diferenca midis këtyre dy kategorive do të japë atë që quhet tepricë operative (TO).


Figura 2. Financimi i investimeve kapitale



Burimi: Manuali për hartimin e planit të investimeve kapitale, Co-PLAN 2008

Nga ky përkufizim bëhet e qartë se niveli i TON është funksion i performancës fiskale të bashkisë nga njëra anë – pra rritjes së të ardhurave prej taksave, tarifave dhe si dhe e mundësive të tjera alternative të financimit, dhe nga ana tjeter, përmirësimit të menaxhimit financiar, nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve operative dhe eficientimit të stafit vendor (Fig. 3, Krijimi i hapësirës për projekte të reja).

Figura 3. Planifikimi financiar – të krijosh hapësirë për projekte të reja



Burimi: Plani Strategjik i Zhvillimit dhe Buxhetimi Afatmesëm me Bazë Performancën, dldp 2012

Pikërisht në këto dy drejtime kryesore fokusohet edhe strategjia financiare e Bashkisë së Kuçovës për 15 vitet e ardhshme: (i) nga njëra anë përmirësimit të performancës nga

ana e të ardhurave nëpërmjet mirë-menaxhimit financiar dhe eksplorimit të burimeve alternative të financimit; dhe (ii) nga ana tjetër reduktimit të shpenzimeve operative nëpërmjet eficientimit të stafit vendor.

Përmirësimi i performancës në kahun të ardhurave vendore do të mundësohet si rezultat i disa faktorëve dhe masave të parashikuara, si më poshtë:

- mirë-administrimi dhe menaxhimi i taksave vendore, dhe veçanërisht i taksës mbi pasurinë e paluajtshme (taksës mbi ndërtesën, tokën bujqësore dhe truallin);
- prezantimi i instrumenteve të rinj financiarë (si tarifat e përmirësimit të infrastrukturës vendore, bonusit të intensitetit, programet e transferimit të të drejtës së zhvillimit apo programet e financimit nëpërmjet rritjes së taksave specifike, etj.), të cilat jo vetëm do të mundësojnë mirë-menaxhimin e territorit të Bashkisë së Kuçovës, por do të ofrojnë një instrument të qenësishëm financiar për mbulimin e kostove të infrastrukturave të përmirësuara, apo zonave urbane të rivitalizuara;
- vënia në shfrytëzim e objekteve dhe pronave të Bashkisë duke mundësuar eficientimin e përdorimit të tyre nëpërmjet skemave të partneritetit publik – privat;
- eksplorimi i mëtejshëm skemave të partneriteteve me sektorin privat në ofrimin e shërbimeve publike, si transporti publik, sportet dhe qendrat rekreative, menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, pikat e grumbullimit për produktet bujqësore, etj..

Përsa i përket rritjes së TON, nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve operative, Bashkia e Kuçovës parashikon marrjen e një sërë masash si më poshtë:

- përmirësimin e praktikave në ofrimin e shërbimeve vendore dhe eficientimin e kostove të tyre nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit;
- riorganizimit të disa shërbimeve vendore nëpërmjet eksplorimit të mëtejshëm të skemave të partneritetit me sektorin privat;
- reduktimit të kostove administrative nëpërmjet përmirësimit/rikonstruksionit të objekteve vendore duke mundësuar eficiencën energjitike.

Së fundmi, në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiare si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe pasi të jenë qartësuar asetet në pronësi të bashkisë përdorur në kolateralizimin e kredive); fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH, etj.) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës; fondet nga donatorët e huaj (Banka Botërore, USAID, KfW, WBIF, etj.) apo edhe format e partneritetit publik-privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit.

Kjo strategji financiare është prezantuar dhe diskutuar me publikun përgjatë takimeve të zgjeruara të organizuara në kuadër të hartimit të PPV-së dhe ka marrë aprovimin e tij, në funksion të realizimit të vizionit të Bashkisë së Kuçovës:

"Kuçova udhëhiqet nga synimi madhor për një zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, ekonomik dhe mjedisor të territorit të saj, përmes mbështetjes së ekonomisë lokale, rimëkëmbjes së aktiviteteve urbane dhe ndërveprimit shoqëror për të mirën e përbashkët. Ky zhvillim do të arrihet duke mbrojtur burimet natyrore, si ato me rëndësi kombëtare dhe ato me rëndësi lokale, përfshirë hapësirat publike dhe kulturën e traditën vendore të zonës, me qëllimin kryesor për një të ardhme sa më të qëndrueshme edhe për brezat e ardhshëm.

Bashkia e Kuçovës e ndërton të ardhmen e banorëve të saj, mbi një ekonomi të shëndoshë dhe të larmishme, por me fokus në shfrytëzimin e pasurive nëntokësore, turizmin historiko-kulturor e natyror dhe bujqësinë. Besojmë se diversifikimi i ekonomisë vendore do të sjellë mirëqenie për të gjithë shoqërinë dhe do të rrisë cilësinë e standardet e jetesës në territorin e bashkisë tonë. Cilësia e jetesës në këto territore do të përcaktohet edhe nga menaxhimi i integruar e i drejtë i territorit me një qeverisje transparente në ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturave përkatëse të nevojshme për çdo banor të Kuçovës.

Bashkia Kuçovë, përtej qëllimit të rritjes ekonomike, synon të krijojë një mjedis të shëndetshëm shoqëror dhe natyror, në funksion të së mirës së komunitetit dhe në harmoni me interesat individuale të çdo banori dhe të sektorit privat. Kohezioni social dhe garancia për një mjedis natyror vetëripërtëritës janë themeli i mirëqenies social-ekonomike dhe i zhvillimit të qëndrueshëm për komunitetin e Kuçovës."

Për hartimin e PIK është marrë në konsideratë edhe kuadri ligjor përkatës për financat vendore dhe konkretisht:

- Ligji 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore";*
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë";* ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012
- Ligj nr. 57/2016 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar;
- Ligji nr. 147/2015 *"Për Buxhetin e vitit 2016";*
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 *"Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore";*
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e Taksave Vendore";*
- Ligji nr. 9764, datë 09.07.2007 *"Për disa ndryshime në ligjin 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore";*
- Ligji nr. 142/2015 *"Për ndryshime dhe amendime në ligjin nr. 9632";*
- Ligji nr. 10117, dt. 23.04.2009; ligji 10146, dt. 28.09.2009; ligji nr. 10073, 09.02.2009 *"Per disa ndryshime në ligjin nr. 9632, dt. 30.10.2006 mbi sistemin e taksave vendre.";*
- Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 *"Për proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë";*
- Ligji 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare"*, i amenduar;
- Ligj nr.10 296, datë 8.7.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";*
- Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) numër 671, datë 29.07.2015 *"Për miratimin e Rregullores për Planifikimin e Territorit";*
- Udhëzim nr.4, datë 29.02.2016 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019".*

- Udhëzim nr. 2, datë 06.02.2012 *"Për procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit"*
- Udhëzim nr. 1, datë 04.06.2014 *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari"*
- Udhëzim nr. 34, datë 28.12.2015 *"Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016"*
- Udhëzim nr. 7/1, datë 28.02.2014 *"Për përgatitjen e buxhetit vendor"*
- Udhëzim nr. 3, datë 16.01.2015 *"Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit""*
- Udhëzim nr. 7, datë 11.02.2015 *"Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limitit të angazhimeve"*
- Udhëzim nr. 8, datë 29.03.2012, *"Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm"*

2. Nevoja për investimeve kapitale dhe identifikimi i projekteve

Identifikimi dhe vlerësimi i nevojës së Bashkisë së Kuçovës për investime kapitale është bërë nëpërmjet ndjekjes së hapave si më poshtë:

- Vlerësimi i kushteve ekzistuese të infrastrukturës në qytet dhe nevojës së ardhshme për shërbime (shiko Tabela 1.). Është vlerësuar gjendja e infrastrukturave dhe shërbimeve të ndryshme publike dhe është grumbulluar informacion në lidhje me moshën, gjendjen, historinë e mirëmbajtjes dhe koston e zëvendësimit të infrastrukturave/shërbimeve publike.
- Vlerësimi i nevojave të tjera për investime kapitale për përmbushjen e objektivave strategjikë të parashikuara në SZHT-në e Bashkisë: si p.sh. projektet urbane apo zhvilluese: krijimi i zonave të gjelbra, strehimi social, krijimi i zonave të reja të parkimit, etj.
- Rishikimi i projekteve të aprovuara më parë, për të mundësuar përditësimin e PIK, lidhjen e tij me dokumentet e tjera financiare (PBA dhe buxheti vjetor), dhe krijimin e një panorame sa më të plotë në lidhje me investimet kapitale në Bashki.

Tabela 1. dhe Tabela 2., sjellin një panoramë të situatës në lidhje me nevojën për infrastrukturë dhe shërbimeve publike në bashki, referuar aksesit që banorët kanë në to, për çdo njësi administrative.

Tabela 1. Inventari i infrastrukturës dhe shërbimeve publike në Bashkinë e Kuçovës

	Njesitë Administrative të Bashkisë Kuçovë			
Inventari	**Kozarë**	**Kuçovë**	**Lumas**	**Perondi**
Populisia	5,622.0	12,654.0	3,981.0	9,005.0
Toka e banueshme (ha)	152.9	168.6	124.5	265.9
Aksesi në infrastrukturë				
Rrugë (% e popullsisë)	98.0	99.5	93.6	97.8
Ujë (% e popullsisë)	98.3	-	58.8	100.0
Aksesi në objekte të superstrukturës				
Kopësht (425m) (% sipërfaqe banimi e mbuluar)	42.3	72.85	30.29	26.41
Shkollë 9-Vjeçare (900m) (% sipërfaqe banimi e mbuluar)	77.68	100	67.46	54
Shkollë e mesme (2750m) (% sipërfaqe banimi e mbuluar)	70.34	100	49.84	88.91
Qendra shëndetësore (1 qendër shëndetësore/ 10,000 banorë) (% e popullsisë)	100	100	100	80

Burimi: Co-PLAN dhe Bashkia Kuçovë, 2016

Kësaj panorame i shtohet plani i veprimit i hartuar në kuadër të SZHT-së, në të cilin janë identifikuar projektet dhe ndërhyrjet kryesore kapitale për realizimin e objektivave strategjike, si dhe lista e investimeve kapitale prioritare të miratuar së bashku me buxhetin e vitit 2016. Mbi këtë bazë është ndërtuar tabela e projekteve kapitale e cila përmbledh informacionin në lidhje me: (i) titullin e projektit, (ii) programin dhe objektivin strategjik në të cilin kontribuon realizimi i projektit; (iii) vendndodhjen gjeografike dhe administrative; (iv) vlerën e projektit; (v) kohën e zbatimit të tij; si dhe (vi) burimin e financimit.

Tabela 2: Mbulimi i popullsisë së njësive administrative të Bashkisë së Kuçovës me shërbime vendore

	Njesitë Administrative të Bashkisë Kuçovë			
	Kozarë	**Kuçovë**	**Lumas**	**Perondi**
Populisia me shërbime të mbuluara	5,514	12,603	3,729	8,815
Populisia pa shërbime të mbuluara	108	51	252	190
Gjithsej populisia	*5,622*	*12,654*	*3,981*	*9,005*
Densiteti (banorë/km2)	*131.1*	*4,017.1*	*52.1*	*238.2*

Burimi: Co-PLAN dhe Bashkia Kuçovë, 2016

3. Kapaciteti financiar i Bashkisë Kuçovë


3.1 Analiza financiare 2010-2015

Analiza e aktivitetit financiar për Bashkinë Kuçovë u realizua me përdorimin e të dhënave nga Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit), pranë Ministrisë së Financave. Përdorimi i këtij burimi justifikohet me faktin se arrihet të sigurohen seri kohore për periudhën 2010 – 2015 për të gjitha njësitë administrative përbërëse të Bashkisë së re Kuçovë. Të dhënat financiare janë të disponueshme në nivel njësie administrative në monedhë vendase dhe për efekte analize u konsoliduan në nivel bashkie.

3.1.1 Të ardhurat

Të ardhurat totale të Bashkisë Kuçovë vlerësohet të kenë ndjekur një prirje përmirësuese përgjatë periudhës 2010 – 2015. Norma mesatare vjetore e rritjes së të ardhurave gjatë kësaj periudhe rezultoi të jetë rreth 14.6%. Bashkia Kuçovë vlerëoshet të ketë patur një buxhet relativisht të ulët përgjatë kësaj periudhe, si rezultat i numrit të ulët të popullsisë dhe të bizneseve në territorin e saj. Në total, të ardhurat në dispozicion të Bashkisë Kuçovë janë luhatur në intervalin 0.4 – 0.8 miliard lekë. Në vitin 2015, burimet financiare në dispozicion të Bashkisë Kuçovë shënuan vlerën 849.8 milionë lekë, në rritje me rreth 55.0% në terma vjetorë.

Figura 4. Ecuria e të ardhurave totale dhe ndryshimet vjetore




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Në linja të përgjithshme, përcaktues i kahut të zhvillimeve në të ardhurat totale për Bashkinë Kuçovë rezulton të jenë të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare [1], përjashtuar vitin 2015. Përgjatë periudhës në analizë, të ardhurat totale u përbënë mesatarisht për rreth 74.8% nga të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare përkundrejt 25.2% nga të ardhurat vendore. Pesha e lartë e transfertave ndërqeveritare ndaj totalit të të ardhurave bën që, ndryshime të vogla në nivel qendror në lidhje me këtë kategori të ardhurash të kenë efekt të rëndësishëm në sjelljen e të ardhurave totale të Bashkisë Kuçovë, për pasojë lirshmërisë së saj në ndërmarrjen e projekteve të investimeve.

Analiza në terma kontributesh konfirmon varësine e Bashkisë Kuçovë nga transfertat ndërqeveritare (evidente deri në vitin 2014). Gjithashtu, kjo varësi reflektohet edhe në luhatshmërinë e lartë të ndjekur nga të ardhurat nga viti në vit.

Figura 5. Kontributi i kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave totale



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Viti 2015 paraqet një panoramë disi të ndryshme krahasuar me pesë vitet e mëparshme. Përgjatë këtij viti, kahu i zhvillimeve në të ardhurat totale është përcaktuar nga ecuria e të ardhurave vendore. Ky ndryshim i detyrohet më së shumti nivelit të lartë të të ardhurave të trashëguara nga viti i mëparshëm (zë ky që përfshin edhe të ardhurat nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve). Rritja e të ardhurave vendore kudërbilancoi efektin negativ të ngushtimit të transfertave ndërqeveritare gjatë vitit 2015, duke u pasqyruar në një rritje pozitive të të ardhurave totale.

Figura 6. Të ardhurat vendore dhe ndryshimi vjetor i tyre




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Pavarësia financiare e Bashkisë Kuçovë, matur nga raporti i të ardhurave vendore ndaj totalit të të ardhurave vlerësohet relativisht e ulët përgjatë periudhës 2010 – 2014. Viti 2015, ashtu si dhe u përmend më lart, rezulton të ketë patur zhvillime specifike për Bashkinë Kuçovë. Autonomia financiare regjistroi nivelin maksimal në vitin 2015 me rreth 54.4% dhe nivelin më të ulët në vitin 2013 me rreth 14.7%. Në vitin 2015, niveli i autonimisë financiare të Bashkisë Kuçovë i matur si raporti i të ardhurave vendore ndaj totalit të të ardhurave shënoi nivelin 55.4%, në rritje me rreth 34.4 pikë përqindjeje krahasuar me nivelin e treguesit një vit më parë. Duke përjashtuar të ardhurat nga fondet e trashëguara[2] si pjesë përbërëse e të ardhurave vendore, niveli i autonomisë financiare për vitin 2015 rezultoi të jetë më i larti historik (rreth 29.5%).

Të ardhurat vendore (përjashtuar të ardhurat nga fondet e trashëguara) të Bashkisë Kuçovë paraqiten të luhatshme në terma nominalë dhe me një prirje rritëse gjatë periudhës 2010-2015. Në nivel kategorish përbërëse, niveli i të të ardhurave vendore përcaktohet na masën më të madhe nga performanca e *taksave dhe tatimeve vendore*. Mesatarisht, të ardhurat nga taksat dhe tatimet vendore kanë përfaqësuar rreth 52.0% të të ardhurave totale gjatë viteve 2010 – 2015. Kategoria e dytë me peshën më të lartë në përbërjen e të ardhurave vendore përfaqësohet nga të ardhurat nga *tarifat vendore* të cilat përfaqësojnë mesatarisht 28.3% të tyre dhe të ardhurat nga asetet me mesatarisht 9.0%. Të *ardhurat e tjera* (të cilat përfshijnë të ardhura si donacione, dhurata, dividendë etj) përfaqësuan mesatarisht 10.7% të të ardhurave vendore për të gjithë periudhën e konsideruar. Rrijta e peshës së kësaj kategorie ndaj totalit të të ardhurave vendore i detyrohet nivelit të lartë të donacioneve në vitin 2015. Nëse do të përjashtonim këtë zë, të ardhurat e tjera do të përfaqësonin vetëm 0.4% të të ardhurave vendore.

Figura 7. Kontributi sipas kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave vendore



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Niveli i të ardhurave nga taksat dhe tatimet, ndër vite, është përcaktuar gjerësisht nga të ardhurat e gjeneruara nga *taksat e pronës (tokë bujqësore dhe ndërtesa), taksa mbi biznesin e vogël (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël)* dhe *taksa (tarifa prej vitit 2016) për zënien e hapësirave publike.* Taksat e pronës (taksa mbi ndërtesat dhe ajo mbi tokën bujqësore si dhe taksa e truallit[3]) shihen i taksa me kontribut potencial të


lartë në rritjen e të ardhurave vendore si dhe përmirësimin e pavarësisë financare të Bashkisë Kuçovë.

Të ardhurat nga tarifat vendore kanë ndjekur një prirje rritëse ndër vite dhe performanca e tyre në total udhëhiqet nga ecuria e të ardhurave zërat *tarifa e pastrimit dhe higjenës, tarifa të tjera të miratuara nga njësia administrative.*

Të ardhurat e gjeneruara nga menaxhimi i aseteve në dispozicion të Bashkisë Kuçovë përbëjnë një element të rëndësishëm në strukturën e të ardhurave vendore. Për më tepër, implementimi i sistemeve për menaxhimin e aseteve mund t'i transformojë ato në një burim akoma më të rëndësishëm financiar për Bashkinë Kuçovë.

Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare të Bashkisë Kuçovë, rezultojnë të jenë një element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Gjatë periudhës 2010-2015, ato kanë qenë të luhatshme duke shënuar nivelin maksimal në vitin 2013. Pas këtij viti, totali i transfertave ndërqeveritare shënoi norma rënëse në dy vitet në vijim. Varësia në terma financiarë nga kjo kategori të ardhurash kushtëzon ndjeshëm planifikimin e shpenzimeve kapitale (investimeve) të Bashkisë Kuçovë. Në vitin 2015, të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare shënuan vlerën 387.9 milionë lekë, në rritje me rreth 11.7% krahasuar me një vit më parë. Sipas elemtëve përbërës, peshën më të madhe e zënë të ardhurat nga transferta e kushëzuar e cila në vitin 2015 përfaqësoi rreth 65.4% të të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare (mesatarja 2010 – 2015 është 66.8%). Pjesa më e madhe e transfertës së kushtëzuar përbëhet nga fonde të Minsitrisë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës për buxhetet familjare dhe individët në nevojë.

Figura 8. Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar përfaqësuan mesatarisht 30.6% të të ardhurave nga transferta ndërqeveritare. Teorikisht dhe në ndryshim nga transfertat e kushtëzuara, për këtë kategori të ardhurash pushteti vendor gëzon autonomi të plotë në përdorim (përjashtuar rastet kur qeveria qendrore udhëzon ndryshe). Në praktikë, ky burim të ardhurash rezulton të jetë shumë i rëndësishëm dhe i qenësishëm në tërësinë


e mjeteve financiare në dispozicion të Bashkisë Kuçovë. Mesatarisht, niveli i të ardhurave nga transferta e pakushtëzuar është i krahasueshëm me totalin e të ardhurave vendore (të ardhurat nga taksat, tarifat, asetet dhe të ardhurat e tjera). Me përjashtim të vitit 2015, në të gjithë periudhën në analizë totali i transfertës së pakushtëzuar ka qenë më i lartë se të ardhurat nga burimet vendore. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet e ndara rezultojnë në një kontribut më të ulët ndaj totalit të të ardhurave nga tranfertat ndërqeveritare dhe tregojnë për një pirje rënëse në kohë (si pasojë e ndryshimeve legjislative të ndodhura).

3.1.2 Shpenzimet

Në përputhje me nivelin e të ardhurave totale, Bashkia Kuçovë realizon shpenzime për të siguruar vijimësinë institucionale, ushtrimin dhe përmbushjen e funksioneve dhe kompencave të përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 *"Mbi vetëqeverisjen vendore"*, në territorin në adminsitrim përcaktuar nga ligji nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërsië"*.

Gjatë vitit 2015, shpenzimet totale të Bashkisë Kuçovë shënuan një vlerë prej 633.6 milionë lekë, në rënie me rreth 6.2% krahasuar me shpenzimet e kryera një vit më parë. Tkurrja e shpenzimeve u udhëhoq nga ulja e shpenzimeve operative dhe atyre kapitale. Shpenzimet për personelin shënuan rritje edhe pse me ritme më të moderuara krahasuar me dy vitet e mëparshme. Nisur nga fakti se viti 2015 u karakterizua nga ndryshime të mëdha, Bashkia Kuçovë u përball me një situatë në të cilën, territori nën administrim dhe popullsia për tu shërbyer u rritën ndjeshëm, të gjitha këto të përkthyeshme në terma financiarë. Në këtë kontekst, nevoja për mjete financiare rezulton të të jetë e lartë si për shpenzime administrative ashtu dhe për shpenzime kapitale, veçanërisht në njësitë administrative (ish-komunat) që iu bashkëngjitën Bashkisë së vjetër Kuçovë.

Figura 9. Shpenzimet sipas qëllimit të përdorimit dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016


Ndër vite, struktura e shpenzimeve të Bashkisë Kuçovë rezulton të jetë dominuar nga shpenzimet operative dhe ato të personelit (paga dhe sigurime). Shpenzimet operative të Bashkisë Kuçovë mesatarisht përfaqësuan rreth 55.3% të shpenzimevet totale të

kryera gjatë viteve 2010 - 2015. Në vitin 2015, shpenzimet operative shënuan një vlerë prej rreth 348.9 milionë lekë, në rënie me rreth 7.5% krahasuar me nivelin e tyre të një viti më parë. Shpenzimet për personelin përfaqësuan mesatarisht rreth 17.0% ndaj totalit të shpenzimeve përgjatë periudhës 2010 – 2015. Në vitin 2015, shpenzimet për personelin rezultojnë të jenë zgjeruar me rreth 2.1% në terma vjetorë, duke përfaqësuar rreth 17.4% të shpenzimeve totale të kryera në vitin 2015.

Në terma kumulativë, shpenzimet e personelit dhe ato operative, përfaqësuan mesatarisht rreth 72.3% të shpenzimeve totale të ndërmarra nga Bashkia Kuçovë për periudhën 2010 – 2015. Pas tre vitesh rritjeje, këto shpenzime shënuan rënie me rreth 5.4% në vitin 2015.

Kategoria e shpenzimeve kapitale renditet e dyta për nga pesha që përfaqëson në shpenzimet totale të kryera nga Bashkia Kuçovë. Mesatarisht, shpenzimet kapitale përfaqësuan 27.7% të shpenzimeve totale të Bashkikë Kuçovë përgjatë periudhës 2010-2015. Viti 2015 regjistroi rreth 174.6 milionë lekë shpenzime kapitale, në rënie me rreth 8.2% krahasuar me një vit më parë.

Figura 10. Kontribute sipas kategorive në ndryshimin vjetor të shpenzimeve totale



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016


Analiza në terma kontributesh e cila merr në konsideratë njëkohësisht efektet e ndryshimeve vjetore si de peshën relative të secilës prej kategorive të shpenzimeve, tregon për një dominim të shpenzimeve kapitale në performacën e shpenzimeve totale. Kjo e fundit, më shume se nga pesha e tyre ndaj totalit është përcaktuar nga normat rritëse shumë të luhatshme. Ky rezultat deri diku konfirmon sa lartpërmendur në lidhje me autonominë e ulët financiare të Bashkisë Kuçovë, shpenzimet kapitale paraqesin një ndjeshmëri të lartë nga transfertat ndërqeveritare dhe fondet për investime të kontrolluara prej saj.

3.1.3 Teprica operative dhe buxheti kapital

Niveli i tepricës operative për periudhën 2010-2015 paraqitet pozitiv, në nivele të luhatshme por me një pirje të përgjithshme në rritje. Në vitet 2010-2012, teprica

operative rezulton te kë shënuar nivele të ulëta. Ndërkohë, në trevjeçarin në vijim teprica operative rezulton të jetë ndjeshëm më lartë. Niveli maksimal u shënua në vitin 2015, ku teprica operative shënoi një vlerë prej 233.6 milionë lekësh, vlerë kjo rreth 3.8 herë më e lartë krahasuar me një vit më parë. Ky nivel i tepricës operative përfaqëson rreth 33.7% të të ardhurave operative të Bashkisë Kuçovë në vitin 2015 dhe sinjalizon për një orientim të qartë drejt ndërmarrjes së investimeve kapitale. Për sa kohë që aksesi në burimet financiare nga grantet konkurruese, burimet ndërkombëtare dhe forndet e donatorëve paraqesin një parashikueshmëri të ulët, teprica operative (dhe teprica operative neto) përbëjnë burimin kryesor mbi bazën e të cilit të ngrihen parashikimet për financimin e projekteve kapitale.

Figura 11. Teprica operative neto




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Buxheti kapital në dispozicion të Bashkisë Kuçovë do të përcaktohet si shuma e mjeteve financiare nga teprica operative, të ardhruat kapitale nga shitja e aseteve, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, të ardhura nga huaja, donacionet dhe të ardhura nga taksa të përmirësimit apo instrumentë të tjerë të posaçëm të zhvillimit. Të gjitha këto përbëjnë atë që gjerësisht konisderohet si buxhet kapital dhe që për Bashkinë Kuçovë rezulton të ketë shënuar vlera pozitive përgjatë periudhës 2010 – 2015.

Shpenzimet kapitale të ndërmarra nga Bashkia Kuçovë gjatë periudhës 2010 – 2014 kanë qenë në mënyrë konstante më të larta krahasuar me buxhetin kapital në dispozicion. Në vitin 2015 u verifikua situata e kundërt, ku të ardhurat kapitale rezultan më të larta se shpenzimet kapitale të kryera. Kështu, të ardhurat apo buxheti kapital për vitin 2015 rezultoi në rreth 390.8 milionë lekë përkundrejt një niveli shpenzimesh kapitale pres rreh 216.2 milionë lekësh.


Figura 12. Të ardhura dhe shpenzime kapitale



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Shpërndarja sipas programeve buxhetore e buxhetit kapital përgjatë periudhës 2010 - 2015 pasqyron dhe orientimin strategjik të bashkisë në kohë. Në vitet 2010 – 2015, investimet kapitale ishin të përqëndruara në programin buxhetor "çështjet ekonomike" (pavarësisht burimit të financimit) ku përfshihen edhe investimet e lidhura me infrastrukturën rrugore. Programet buxhetore *arsimi* dhe *strehim dhe komoditete të komunitetit* gjithashtu rezultojnë të kenë qenë destinacion i një pjese të shpenzimeve kapitale të ndërmarra nga Bashkia Kuçovë.

Figura 13. Shpenzimet kapitale sipas programeve buxhetore



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

4. Përzgjedhja e projekteve kapitale prioritare

Identifikimi dhe vlerësimi i projekteve kapitale është bërë në përputhje me objektivat strategjik të SZHT-së, të reflektuar gjithashtu edhe në propozimet e PPV-së. Referuar pamundësisë së financimit të të gjithë projekteve të identifikuara në tabelën përmbledhëse të nevojave për investime kapitale, është bërë procesi i prioritarizimit dhe përzgjedhjes së projekteve të investimeve mbi bazën e një sërë kriteresh të dakordësuara me aktorët. Kriteret marrin në konsideratë tre çështje kryesore: (i) koston e investimit; (ii) jetëgjatësinë dhe kohën e përdorshme të investimit; (iii) koston e mirëmbajtjes.

Mbi bazën e këtyre tre çështjeve lista e kritereve që investimet kapitale duhet të plotësojnë në procesin e prioritarizimit të tyre është si më poshtë:

- kontributi i projektit në prioritetet strategjike: sa dhe si kontribuon projekti në arritjen e objektivave strategjik;
- natyra e projektit: a ndikon projekti në parandalimin/eleminimin e një situate urgjente/të rrezikshme;
- statusi i projektit: a është projekt në vazhdim apo projekt i ri dhe si është identifikuar;
- vendndodhja gjeografike/administrative: cila është zona e mbuluar nga projekti dhe në cilën njësi administrative kontribuaon/shtrihet ai;
- kohëzgjatja e shlyerjes së kostos së projektit: a mundet projekti të gjenerojë të ardhura në buxhetin vendor? Kur dhe për sa kohë mund të ndodhë kjo?;
- mundësia e financimit të projektit: a financohet projekti prej buxhetit vendor kapital, apo prej programeve të qeverisë qendrore (QQ)/donatorëve/etj).

5. Mundësitë e financimit dhe mobilizimi i të ardhurave

Në funksion të përmbushjes së vizionit dhe të objektivave strategjikë të përshkruar në Strategjinë e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë, rezulton thelbësor përkthimi në terma sasiorë (monetar) i tyre. Për këtë qëllimin, projeket e investimeve sipas programeve kuantifikohen dhe shpërndahen ndër vite (fazohen në kohë). Materializimi i projekteve të investimeve në përmbushje të vizionit të Bashkisë Kuçovë varet shumë nga buxheti kapital apo mjetet financiare në dispozicion të bashkisë.

5.1 Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Parashikimi i të zërave të të ardhurave dhe të shpenzimeve për vitin 2016 është marrë nga projekt buxheti i Bashkisë Kuçovë për vitin 2016. Për periudhën 2017 – 2019, parashikimet u morrën nga Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2017 – 2019 dhe mbi bazën e supozimeve të PBA-së seritë kohore u zgjatën deri në vitin 2020. Për periudhën 2020 – 2030, parashikimet u kryen duke konsideruar trendin e përgjithshëm të ndjekur nga zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së mëparshme, normat rritëse të parashikuara në PBA 2017 – 2019, parashikimet e përgjithshme për treguesit makroekonomikë të publikuar nga Ministria e Financave.

Parashikimet për të ardhurat dhe shpenzimet vendosen në një kontekst makroekonomik të qendrueshëm i cili karakterizohet nga:

- normë inflacioni e qëndrueshme dhe pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë për 3%;
- kurs këmbimi me valutat kryesore (euro dhe dollar amerikan) i qendrushëm pa goditje permanente dhe të qenësishme;
- rritje e moderuar e popullsisë;
- rritje nominale dhe reale e ekonomisë pranë vlerës potenciale;
- rënie e ngadaltë por progresive e papunësisë;
- tregues fiskalë (defiçit buxhetor dhe borxh qeverie) pranë niveleve të përshkruara nga Traktati i Maastricht-it;
- qendrueshmëri e bilancit të pagesave (llogari korente dhe financiare).

Normat e rritjes së treguesve të ndryshëm për të ardhurat dhe për shërbimet do të aplikohen në mesataren rrëshqitëse të 5 viteve paraardhëse.

Tabela 3: Supozime bazë për parashikimin e të ardhurave

	2021-2025	2026-2030
Taksa dhe tatime	+5.0%	+10%
Tarifa vendore	+10.0%	+5.0%
Asete	+10.0%	+10.0%
Të tjera	+10.0%	+5.0%
Transferta e kushtëzuar	+7.0%	+10.0%
Transferta e pakushtëzuar	+10.0%	+10.0%
Transferta specifike	-	-
Taksa dhe tatime të ndara	+10.0%	+15.0%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Nisur nga norma mesatare e rritjes së të ardhurave nga taksat dhe tatimet, supozimet e aplikuara për periudhën 2016-2020 dhe niveli aktual i mbledhjes së tyre vlerësohet se

një normë rritjeje prej 5% në fazën e parë dhe 10.0% në fazën e dytë është e përshtatshme. Përsa i përket tarifave, në fazën e parë synohet rritje me rreth 10% dhe në të dytën 5%. Të ardhurat nga asetet vlerësohen me potencial të lartë për rritjen e të adhurave të Bashkisë Kuçovë dhe përmirësimi në menaxhimin e tyre do të mund të përkthehej në një rritje të të ardhurave me 10% në fazën e parë dhe të dytë. Në lidhje me transfertat ndërqeveritare, duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme legjislative (ligji për financat vendore) vlerësohet që transferta e pakushtëzuar të rritet me 10% në të dy fazat e konsideruara ndërsa transferta e kushtëzuar të rritet me 7% në vitet 2021-2025 dhe me rreth 10% në periudhën 2026-2030. Duke filluar prej vitit 2021, transferta specifike vlerësohet të mos jetë më si instrument nisur nga fakti se në harkun e pesë viteve pas marrjes së funksioneve të reja ato të jenë përbrendësuar nga Bashkia Kuçovë dhe fondet (për ti ushtruar në kohë) për to do të jenë të përfshira në totalin e transfertës së kushtëzuar. Përsa i përket të ardhurave nga taksat dhe tatimet e ndara vlerësohet një rritje me rreth 10% në fazën e parë dhe me rreth 15% në fazën e dytë. Parashikimi për një rritje të këtij niveli argumentohet me faktin se Kuçova është një ndër zonat naftëmbajtëse më të rëndësishme në Shqipëri, kontribuese e rëndësishme në të ardhurat e buxhetit të shtetit.


Tabela 4: Supozime bazë për parashikimin e shpenzimeve

	2021-2025	2026-2030
Personel	+1.5%	+2.0%
Operative	+2.0%	+1.0%
Kapitale	+10.0%	+10.0%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Shpenzimet për personelin vlerësohet të rriten me rreth 1.5% në fazën e parë dhe me rreth 2% në fazën e dytë. Rritja e efiecencës dhe efikasitetit në menaxhimin e Bashkisë si dhe nevojat për investime, vlerësohet një rritje e moderuar me 2 dhe 1% e shpenzimeve operative të Bashkisë Kuçovë, përkatësisht në të dyja periudhat e konsideruara. Nga ana tjetër, rritja me ritme të moderuara të shpenzimeve korente dhe atyre të personelit, do të pasqyrohet në rritje të nivelit të investimeve me 10% përgjatë të gjithë periudhës së parashikimeve.

Figura 14. Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016
*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Bazuar në supozimet e kryera, vlerësohet se Bashkia Kuçovë do të ketë një nivel të ardhurash më të ulët se shpenzimet e parashikuara deri në vitin 2025. Hendeku mes nevojës për shpenzimeve dhe burimeve të të ardhurave vjen duke u ngushtuar ndër vite. Megjithatë, Bashkia Kuçovë do të duhet të konsiderojë burime alternative të ardhurash për të mbyllyr hendekun negativ ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave. Ky skenar mund të konsiderohet si një variant neutral, ndjekës i prirjeve historike (deri diku të moderuar) të treguesve.

5.2 Parashikimi i tepricës operative dhe buxhetit kapital

Në vijim të parashikimeve për të ardhurat dhe për shpenzimet, llogarisim tepricën operative për të gjithë periudhën e konsideruar. Për periudhën 2016-2030, vlerësohet se teprica operative e Bashkisë Kuçovë do të jetë pozitive dhe në terma të konsiderueshëm. Kështu, për periudhën 2016-2020, teprica operative do të jetë pozitive duke u vlerësuar në mesatarisht rreth 4.6% e të ardhurave korente. Më tej, në periudhën 2021-2025 teprica operative vlerësohet të rritet në mesatarisht 12.7% e të ardhurave korente. Konsolidimi i Bashkisë Kuçovë si në terma insitucionalë ashtu dhe funksionalë do të materializohet në një aktivitet financiar të qëndrueshëm dhe tepricë operative pozitive, e vlerësuar në rreth 22.7% të të ardhurave korente të parashikuara për periudhën 2026-2030.


Figura 15. Parashikimi i tepricës operative neto



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016
*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Teprica operative së bashku me të ardhurat kapitale japin buxhetin kapital për periudhën e zgjedhur në dispozicion të Bashkisë Kuçovë për të ndërmarrë dhe realizuar investimet kapitale të synuara.

Figura 16. Parashikime për buxhetin kapital, 2016 – 2030



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016
*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Në vijim të ndarjes së re administrative-territoriale dhe ligjit të ri për vetë-qeverisjen vendore, bashkia e re e Kuçovë përballet me sfidën e menaxhimit burimeve financiare të kufizuara përkundrejt nevojave gjithmonë në rritje për shërbime dhe investime kapitale. Në këtë kontekst, planifikimi strategjik i investimeve në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, vlerësohet

thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performancës financiare në kahun e të ardhurave (veçanërisht rritja e bazës së taksueshme dhe tatim paguesve) si dhe racionalizimi në kahun e shpenzimeve (kryesisht ato operative).

Bazuar në të dhënat financiare historike, parashikimet e përfshira në dokumentin e PBA-së, supozimeve të ndërmarra për parashikimin e zërave kryesorë të të ardhurave dhe shpnezimeve rezulton një buxhet kapital pozitiv në dispozicion të Bashkisë Kuçovë. Në terma nominalë, buxheti kapital në dispozicion për financimin e projekteve të investimeve vlerësohet të ndjekë një prirje rritëse në kohë si pasojë e përmirësimit të menaxhimit fiskal dhe financiar të Bashkisë. Megjithatë, diferencat ekzistuese në nivelin e ofrimit të shërbimeve, zhvillimit ekonomik dhe pabarazitë sociale midis njësive adminsitrative përbërëse kërkojnë një fluks të lartë investimesh për të siguruar deri diku zbutjen e tyre. Ndaj, krahas buxhetit kapital në dispozicion të bashkisë, energji të mëtejshme do të duhet të orientohen në gjetjen e burimeve financiare alternative: huatë bankare nga sistemi bankar vendas (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi), fondet shtetërorë të ofruara në baza konkurrenciale (FZHR, FSHZH, AZHR etj.), fondet nga burime ndërkombëtare (IPA, BB) apo donatorë të ndryshëm (USAID, KfË etj).

6. Fishat e projekteve kapitale[4]

FISHË PROJEKTI 1 (O2P3_PR7)	
Qëllimi	Përmirësimi i cilësisë dhe aksesit të infrastrukturës në nivel bashkie
Titulli i Projektit	PR.7: Ndërtimi i rrugëve që lidhin Lumasin me qytetin e Kuçovës (Kuçovë-Magjatë-Sheqëz-Vodhëz-Lumas, Kuçovë-Goraj-Pashtraj- Bardhaj- Lumas, Kuçovë- Velagosht - Lumas
Preventivi	Kuçovë – Lumas: 700,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Aksesueshmëria e njësisë Lumas aktualisht realizohet vetëm nëpërmjet aksit Lapardha-Lumas, që nis nga rruga interurbane kryesore SH72, jashtë territorit administrativ të Bashkisë Kuçovë. Është e nevojshme të krijohet një lidhje e drejtpërdrejtë e qendrës Kuçovë me Lumasin dhe fshatrat më tej, për të nxitur ndërveprimin ekonomik dhe lehtësuar ofrimin e shërbimeve.
Përshkrimi i Projektit	Projekti do të zhvillohet në disa faza, duke nisur nga studimi i detajuar i gjurmës më të përshtatshme, dhe hartimi i projektit teknik, deri te tenderimi dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e rrugës. Projekti mendohet të ndërtohet brenda vitit 2017 dhe zgjatet për rreth 7-10 km, pjesërisht mbi gjurmën e shtigjeve ekzistuese e pjesërisht duke përshkuar luginat e përrenjve dhe kreshtat malore. Në projekt përfshihet rivitalizimi total i rrugës, shtrimi me asphalt, disiplinimi i ujërave që prekin gjurmën e rrugës, ndërtimi i veprave të artit që i shërbejnë rrugës, etj.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Justifikimi i Projektit	• Ky projekt shkurton kohën e lëvizjes nga qendra Kuçovë në njësinë Lumas nga 40 minuta në 20-30 minuta; • Projekti mundëson akses në njësinë Lumas dhe fshatrat përkatëse nga brenda njësisë administrative të bashkisë Kuçovë.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P3: *"Përmirësimi i lidhjeve ndërqytetëse mes qendrave të njësive rurale me njëra tjetrën dhe me Kuçovën"*; të Objektivit O2: *"Zhvillimi i infrastrukturës lokale e aksesi rajonal"*.
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimit të detajuar teknik mbi shtrirjen e rrugës; • Gjetja e financimit dhe tenderimi i projektit brenda gjysmës së parë të vitit 2016; • Zbatimi i projektit dhe ndërtimi i rrugës, plotësuar me sinjalistikën përkatëse, deri në përfundim të vitit 2017.
Rezultate të pritura	• Përmirësimi i lëvizshmërisë së banorëve të njësisë Lumas drejt qendrës; • Nxitja e tregtisë së produkteve bujqësore/blegtorale të njësisë Lumas në Kuçovë; • Akses më i mirë në shërbime arsimore, shëndetësore dhe qendra punësimi për banorët e njësisë Lumas; • Rritje e numrit të vizitave në fshatrat e Lumasit për arsye turistike e rekreative; • Rritje e vlerës së tokës në fshatrat që ndikohen drejtpërdrejt nga shtrimi i rrugës.
Risqet	• Pamundësia financiare për të përballuar koston e lartë të projektit; • Pengesat fizike e gjeoinxhinierike të terrenit në fazën e zbatimit të projektit; • Dëmtim i biodiversitetit në zonën malore të Lumasit për shkak të hapjes së trasesë së rrugës.
Statusi aktual i projektit	Në fazë prokurimi
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _ 2016 Tenderimi dhe Zbatimi _2016-2017
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 2	
Qëllimi	Përmirësimi i cilësisë dhe aksesit të infrastrukturës në nivel bashkie

Titulli i Projektit	*PR13: Rikonstruksioni i pjesshëm i akseve rrugore "Toli Shuka", "Koli Hoxholli", "Kongresi i Lushnjes", "Koco Koleci", "Ismail Qemali", "Isa Boletini"; shtrim i segmenteve rrugore nga sheshi 11 Janari deri të tunelet e UMN e nga Policia deri të Spitali; supervizion rruga "K. Laçka- Q.Stafa" (në proces).*
Preventivi	Kongresi Lushnjes 12,078,816.00 Lekë Toli Shuka – Isa Boletini 102,510,816.00 Lekë Supervizion rruga " K. Laçka- Q.Stafa" 228,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Ky projekt synon lidhjen më të mirë të pikave të rëndësishme urbane me njëra tjetrën, si psh. zona spitalore e qytetit, pazari, blloqet urbane të konsoliduara, tunelet e Uzinës Mekanike të Naftës, si dhe të rrugëve rurale në brendësi të fshatrave Magjatë e Bardhaj. Këto akse rrugore deri tani kanë qenë jo-funksionale, ose të cilësisë së dobët infrastrukturore.
Përshkrimi i Projektit	Projekti përbëhet nga faza paraprake, që është studimi dhe projekti i zbatimit të rikonstruksionit të segmenteve të përcaktuara; faza e dytë, tenderimi për zbatim; dhe faza e tretë, kryerja e punimeve të rikonstruktimit. Procesi është i njëkohshëm për të gjithë segmented në fjalë, për shkak të gjatësisë së shkurtër të tyre.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, MZHU
Justifikimi i Projektit	• Ky projekt lehtëson lëvizshmërinë në disa blloqe urbane të qytetit dhe rrit treguesin kshr në nivel zone; • Projekti mundëson lidhje më të mirë të qendrave të fshatrave Magjatë (Perondi) e Bardhaj (Lumas) me rrugët kryesore interurbane dhe interrurale.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P4: "*Sistemimi i rrjeteve rrugore lokale, për të rritur nivelin e jetueshmërisë në qytet dhe zona rurale*"; të Objektivit të Objektivit O2: "*Zhvillimi i infrastrukturës lokale e aksesi rajonal*".
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimit të detajuar teknik mbi shtrirjen e rrugës, piketimi dhe përcaktimi i llojit të ndërhyrjes/shtrimit; • Gjetja e financimit dhe tenderimi i projektit brenda gjysmës së parë të vitit 2016; • Zbatimi i projektit dhe ndërtimi i rrugës, plotësuar me sinjalistikën përkatëse, deri në fund të vitit 2017;
Rezultate të pritura	• Përmirësimi i strukturës dhe aksesit të blloqeve të banimit të qytetit Kuçovë; • Përmirësimi i lëvizshmërisë brenda fshatrave Magjatë dhe Bardhaj; • Aksesi më i shpejtë drejt zonës spitalore të qytetit.
Risqet	• Pamundësia financiare për të përballuar koston e projektit; • Vështirësitë e punimeve në fshatrat Magjatë e Bardhaj në periudhë dimri.
Statusi aktual i projektit	Në proces
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _ 2015-2016 Tenderimi dhe Zbatimi _2016-2017
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 3	
Qëllimi	Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe kushteve fizike të shkollave

Titulli i Projektit	PR1: Rikonstruksioni i shkollave 9 vjeçare, i shkollës së mesme në Perondi dhe i oborrit të shkollave-kopshteve si dhe ambjenteve ndihmëse të tyre
Preventivi	"18 Tetori" 86,911,627.00 Lekë "Perondi" 41,700,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Ky projekt ka si synim përmirësimin e kushteve fizike dhe kapacitetit mbajtës të objekteve arsimore të tipit shkollë 9-vjeçare dhe e mesme në fshatrat Rreth Tapi, Vodëz, Perondi, e në qytetin e Kuçovës, të cilat aktualisht ndodhen në gjendje të degraduar, për shkak të problematikave në muret e jashtme, muret e brendshme, çati, tavanet e brendshme, dyer e dritare.
Përshkrimi i Projektit	Projekti konsiston në ndërhyrje rikonstruktive të pjesshme për shkollën 9 vjeçare dhe të mesme të Perondisë, shkollën 9-vjeçare të Vodëzës, si dhe rikonstruktim të plotë për shkollën "18Tetori" në Kuçovë, dhe shtesë kati për shkollën 9 vjeçare të Rreth Tapisë. Projekti propozon ndërhyrje rikonstruktuese edhe në oborrin e shkollës 9 vjeçare "Gaqi Karakashi" në Kuçovë
Partnerët	**Bashkia Kuçovë, MASH, IADSA**
Justifikimi i Projektit	• **Ky projekt përmirëson cilësitë fizike, të termoizolimit, dhe estetike të shkollave 9 vjeçare problematike në fshatrat Perondi, Rreth Tapi, Vodëz, si dhe në Kuçovë;** • **Projekti ndihmon në rritjen e kapacitetit mbajtës për klasa, nxënës e mjete laboratorike për shkollën 9 vjeçare në Rreth Tapi;** • **Projekti mundëson përmbushjen e standardeve të planifikimit për objekte arsimore në lidhje me sipërfaqen minimale të nevojshme për student.**
Objektivi	**Projekti kontribuon në Politikën P1: *"Rikonstruksioni i objekteve arsimore shëndetsore dhe me funksione publike"*; të Objektivit të Objektivit O4: *"Mbështetje e komuniteteve për zhvillim social"*.**
Veprimet Strategjike	• **Gjetja e donatorëve potencialë për financimin e rikonstruksionit të shkollave në fjalë, si dhe pajisjen e tyre me mjete shtesë logjistike dhe akademike sipas nevojës;** • **Rikonstruktimi i njëkohshëm i objekteve arsimore, duke vendosur prioritet në kohën e shkurtër të zbatimit, në mënyrë që të mos pengohet procesi akademik.**
Rezultate të pritura	• **Përmirësimi i strukturës fizike, performancës energjitike dhe cilësive estetike të shkollave të përfshira në projekt;** • **Rritje e numrit të studentëve që frekuentojnë shkollën 9-vjeçare të Rreth Tapisë si rezultat i rritjes së kapaciteteve mbajtëse të saj.**
Risqet	• **Pamundësia financiare për të përballuar koston e projektit** • **Problemet e mbylljes së përkohshme të shkollës për arsye të punimeve**
Statusi aktual i projektit	Në proces
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _ 2015-2016 Tenderimi dhe Zbatimi _2016-2017
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 4 (O4P2_PR7/PR8 & O4P5_PR4)

Qëllimi	Rehabilitimi dhe rivitalizimi i hapësirave të gjelbra dhe publike në zonat urbane dhe rurale
Titulli i Projektit	PR7: Rikonstruktimi i sheshit të pazarit në Kuçovë; PR8: Rikonstruktimi i shesheve të brendshme të blloqeve 5-katëshe të banimit në lagjen I Maji dhe i shesheve të qendrave të njësive administrative të Lumasit, Perondisë dhe Kozarës; PR14: Rikonstruktimi i pikës turistike të qendrës Kuçovë.
Preventivi	Sheshi Pazarit 9,000,000.00 Lekë Sheshet e brendshme pallate 5-katëshe 36,000,000.00 Lekë Shkallët e pikës turistike në qendër 9,714,343.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Ky projekt hartohet në kuadër të përmirësimit të kushteve fizike, mjedisore, higjienike, funksionale dhe estetike të hapësirave publike brenda qytetit të Kuçovës, me synimin e rigjenerimit të blloqeve urbane, dhe rritjes së vlerës së truallit në zonat administrative me potencial zhvillimi.
Përshkrimi i Projektit	Projekti ka si synim pastrimin, ridizenjimin dhe mobilimin urban të shesheve të brendshme të blloqeve të banimit 5 katëshe, projektimin estetik e funksional të sheshit të pazarit, si një shesh qendror në qytet, dhe shtrimin e sistemimin e shkallëve të pikës turistike të Kuçovës
Partnerët	Bashkia Kuçovë, komuniteti lokal, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Justifikimi i Projektit	• Projekti i shërben rigjenerimit të zonave urbane të ndërtuara në stilin e realizmit socialist, të cilat do i nënshtrohen ndërhyrjeve vitalizuese • Projekti rivitalizon pikën turistike, si qendër të aktiviteteve turistike potenciale të bashkisë Kuçovë • Projekti mundëson akses më të mirë në zonën e pazarit
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P5: *"Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Kuçovë, gjelbërimit dhe hapësirave me karakter të veçantë, për t'i shërbyer funksionit mjedisor dhe estetik për qytetin"*, Projekti_PR14 dhe Politikën P2: *"Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i shesheve kryesore në qytet dhe në qendrat e njësive rurale"* të Objektivit të Objektivit O4: *"Mbështetje e komuniteteve për zhvillim social"*, Projekti_PR8
Veprimet Strategjike	• Kryerja e Studimit të detajuar, që përfshin detajet tekniko-inxhinerike, si dhe analizimin e strukturës aktuale të shesheve dhe metodave të shtrimit/punimit më të lidhura me kontekstin lokal • Gjetja e mënyrave të financimit/alokimi i buxhetit • Zbatimi i punimeve deri në fund të vitit 2016 për pikën c dhe deri në fund të 2017 për pikat a e b
Rezultate të pritura	• Akses më i mirë në zonën e pazarit • Përmirësim estetik i shesheve • Shtim i sipërfaqeve të gjelbërta në qytetin e Kuçovës
Risqet	• Pamundësia financiare për të përballuar koston e projektit në gjithë komponentët e tij • Moskryerja e punimeve në përputhje me pritshmëritë kohore
Statusi aktual i projektit	Shkallët e pikes turistike_në process Sheshi i pazarit dhe sheshet e brendshme të pallateve në fazë studimi.
Fazat e projektit	Sheshi Pazarit: Studimi dhe Projektimi _ 2015-2016 Tenderimi dhe Ndërtimi_2016-2017 Sheshet e brendshme pallate 5-katëshe: Studimi e Projektimi_2018-2019 Tenderimi e Ndërtimi_2019-2021 Shkallët e pikes turistike në qendër_2016-2017
Vlerësimi i prioriteteve	Sheshi i pazarit: Afatshkurtër-Afatmesëm Sheshet e brendshme pallate 5-katëshe: Afatmesëm-Afatgjatë Shkallët e pikës turistike në qendër: Afatshkurër

FISHË PROJEKTI 5 (O4P4_PR12)

Qëllimi	Rritja e cilësisë së jetës dhe mundësive për të rinjtë
Titulli i Projektit	PR12: Ndërtimi i një Qendre Artistike e Kulturore për Shërbime ndaj të Rinjve
Preventivi	10,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Ky projekt adreson mungesën e qendrave të aktiviteteve për të rinj, si dhe të një qendre të mirëfilltë artistike për Bashkinë Kuçovë. Nëpërmjet një qendre artistike për të rinjtë, integrohen nevoja që ka për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, trajnimin në kurse të ndryshme të lidhura me artin, me shërbimet e nevojshme për të rinjtë, aktivitetet rekreative e të orientuara drejt edukimit dhe sportit, etj.
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon ndërtimin e një qendre shërbimi ndaj të rinjve, të specializuar për aktivitete artistike e kulturore. Kjo qendër do ofrojë kurse artesh dhe trajnime specifike, këshillime karriere për të rinjtë, organizim aktivitetesh e eventesh kulturore, sportive, rekreative, për të rinjtë, organizim eventesh artistike / ekspozitash me impakt në bashki, etj.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, Komuniteti lokal, Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
Justifikimi i Projektit	Projekti ka impakt në dy shkallë: në nivel bashkie, dhe për të rinjtë që do e frekuentojnë qendrën. Në nivel bashkie, qendra do mundësojë organizim të aktiviteteve me pjesëmarrje të gjerë, me theks artistik, mbrojtjen e identitetit lokal, promovimin e turizmit, etj. Për të rinjtë qendra do mundësojë kultivimin e aftësive artistike, por edhe trajnime, këshillime karriere, e këshillime për çështje problematike, si dhe organizim aktivitetesh të përbashkëta sportive, rekreative, etj.
Objektivi	Projekti kontribuon në Programin 4: *"Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i popullsisë, duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese, dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit"* të Objektivit O4: *"Mbështetje e komuniteteve për zhvillim social."*
Veprimet Strategjike	• Gjetja e mundësive për financimin, duke adresuar fonde të qeverisë për kulturën dhe mirëqënien sociale; • Lidhja e marrëveshjeve me OJQ dhe organizata të tjera në rajon, të cilat operojnë në fusha të ngjashme, për të organizuar evente në bashkëpunim; • Krijim partneriteti me universitetet më të afërta dhe shkollat profesionale, për organizim trajnimesh e punëtorish të përbashkëta.
Rezultate të pritura	• Rritje e nivelit të përgjithshëm arsimor e kulturor të të rinjve në Kuçovë në 10 vjeçarin e ardhshëm; • Theksimi i potencialeve kulturore e historike të Bashkisë Kuçovë, në ndihmë të imazhit dhe fuqizimit të turizmit natyror e kulturor; • Rritja e angazhimit qytetar në çështje të përbashkëta komunitare, në kuadër të aktiviteteve të qendrës rinore.
Risqet	• Mundësitë e kufizuara të financimit mund të ngushtojnë sferën e veprimit të qendrës; • Vështirësi në gjendjen e vendndodhjes, pronësisë së truallit, etj.
Statusi aktual i projektit	Koncept ide
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _ 2017-2018 Tenderimi dhe Ndërtimi_2019-2020
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 6 (O4P3_PR9)

Qëllimi	Rritja e cilësisë së jetesës dhe strehimit në Bashkinë Kuçovë
Titulli i Projektit	*PR9: Ndërtimi i një objekti të strehimit social për popullsinë e pastrehë, ose në nevojë strehimi*
Preventivi	60,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Projekti fokusohet në nevojat për strehim që ka aktualisht popullsia në qytetin e Kuçovës, specifikisht personat e regjistruar si "të pastrehë", që arrijnë një numër të përafërt prej 870 familjesh (2500 persona). Ky projekt është vetëm një pjesë e strategjisë për sigurimin e strehimit për popullsinë e pastrehë, dhe për lehtësinë e strehimit për familjet e reja në gjithë territorin e bashkisë.
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon që banesa për strehim social do ketë një lartësi prej 6 katesh dhe do përmbushë një pjesë të nevojave aktuale për strehim për familjet e pastreha. Vendnodhja e projektit do përmbushë disa kushte, si: aksesi i mirë në infrastrukturë rrugore dhe në shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve; afërsia me qendrat e shërbimeve të qytetit, për të shmangur segregimin ekonomik; prania e kushteve të përshtatshme të gjelbërimit, diellëzimit, dhe hapësirave publike; plotësim i standardeve bazë për jetueshmërinë, si m^2/banor, sipas legjislacionit etj.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, komuniteti lokal, Ministria e Zhvillimit Urban, sektori i ndërtimit
Justifikimi i Projektit	Projekti vjen si nevojë emergjente e bashkisë, për të përmbushur nevojat bazike të popullsisë së pastrehë. Ky projekt është i pari në një vazhdimësi politikash e projektesh të fokusuara në sigurimin e strehimit të përballueshëm në gjithë Bashkinë Kuçovë.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P3: "Krijimi i mundësive të strehimit të përballueshëm për popullsinë aktuale, dhe strehimit social" të Objektivit O4: *"Mbështetje e komuniteteve për zhvillim social"*, Projekti_PR9
Veprimet Strategjike	• Gjetja e mundësive për financimin të projektit, duke përfituar nga fonde të strehimit social; • Identifikimi i familjeve që do gjejnë strehim në këtë banesë, sipas nevojës dhe statusit të emergjencës; • Realizim i PPP me sektorin e ndërtimit, për të mundësuar strehimin e pjesës tjetër të popullsisë së ardhur, në nevojë.
Rezultate të pritura	• Ulje e numrit të familjeve të pastreha në masë 50% deri në fund të vitit 2016 dhe plotësisht deri në 2030
Risqet	• Tkurrja e sektorit të ndërtimtarisë në rajon, duke mos mundësuar krijimin e partneriteteve për strehimin social; • Vështirësitë në gjetjen e mjeteve të financimit për ndërtimin e banesave sociale që të përmbushin nevojat për strehim të të gjithë bashkisë Kuçovë; • Vështirësi të mundshme në procesin e gjetjes, blerjes dhe shpronësimit të parcelës ku do ndërtohet objekti i ri; • Mundësi të segregimit për shkak të strukturës së objektit dhe pozicionit të tij në qytet.
Statusi aktual i projektit	Koncept Ide
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _ 2015-2016 Tenderimi dhe Ndërtimi_2017-2018
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 7 (O4P2_PR8)

Qëllimi	Rehabilitimi dhe rivitalizimi i hapësirave të gjelbra dhe publike në zonat urbane dhe rurale
Titulli i Projektit	**PR8: Rikonstruktimi i shesheve të brendshme të bllokeve 5-katëshe të banimit në lagjen 1 Maji dhe i shesheve të qendrave të njësive administrative të Lumasit, Perondisë dhe Kozares**
Preventivi	36,000,000.00 Lekë (vlera e preventivuar përfshin dhe rikonstruksionin shesheve të brendshme të bllokeve 5-katëshe të banimit në Lagjen 1 Maji, investim ky i përfshirë në Fishë Projekti 4)
Sfondi i Projektit	**Ky projekt hartohet në kuadër të përmirësimit të kushteve fizike, funksionale dhe mjedisore të qendrave të njësive administrative rurale të Bashkisë Kuçovë. Aktualisht qendrat e njësive Lumas dhe Perondi janë të pasistemuara dhe pjesërisht të pashtruara, ndërsa fshati Havaleas i njësisë Kozare ka qendër të rikonstruktuar, por jo në trajtë sheshi publik. Është e rëndësishme të krijojet një imazh më pozitiv i qendrave rurale, në funksion të potencialit turistik të zonës dhe ofrimit të shërbimeve më cilësore ndaj banorëve.**
Përshkrimi i Projektit	Projekti ka si synim pastrimin, ridizenjimin, shtrimin dhe mobilimin urban të shesheve qendrore të fshatrave Lumas, Perondi dhe Havaleas, për të përmirësuar cilësinë e jetesës dhe kushtet e ofrimit të shërbimeve në to.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, Komuniteti lokal, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Justifikimi i Projektit	• Projekti mundëson akses më të mirë në fshatrat kryesore të Bashkisë Kuçovë • Projekti ndihmon në përmirësimin e imazhit të njësive administrative, në funksion të zhvillimit të potencialeve të turizmit natyror • Projekti
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P2: *"Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i shesheve kryesore në qytet dhe në qendrat e njësive rurale"* të Objektivit të Objektivit O4: *"Mbështetje e komuniteteve për zhvillim social"*,
Veprimet Strategjike	• Kryerja e Studimit të detajuar, që përfshin detajet tekniko-inxhinerike, si dhe analizimin e strukturës aktuale të shesheve dhe metodave të shtrimit/punimit më të lidhura me kontekstin lokal; • Gjetja e mënyrave të financimit/alokimi i buxhetit; • Zbatimi i punimeve deri në fund të vitit 2017/2021.
Rezultate të pritura	• Rritja e cilësisë së jetës për banorët e zonave rurale të Bashkisë Kuçovë; • Përmirësim estetik i qendrës së fshatrave; • Shtimi i sipërfaqeve reale të përdorimit publik për banorët;
Risqet	• Pamundësia financiare për të përballuar koston e projektit në gjithë komponentët e tij; • Moskryerja e punimeve në përputhje me pritshmëritë kohore.
Statusi aktual i projektit	Koncept ide
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _ 2016-2017 Tenderimi dhe Ndërtimi_2018-2021
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm - Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 8 (O2P5_PR16)

Qëllimi	Rehabilitimi i infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve dhe sistemit të ujitjes e kullimit për zonat problematike të Bashkisë Kuçovë
Titulli i Projektit	PR16: Ndërtimi i rrjetit të KUZ në fshatrat Drizë, Gegë, Kozarë
Preventivi	Gegë 99,999,204.00 Lekë Drizë 67,671,690.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Projekti shërben për të siguruar shërbimin e përshtatshëm të KUZ në fshatrat Drizë, Gegë e Kozarë, në të cilat nuk ekziston ky rrjet.
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon ndërtimin e një rrjeti të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatrat Gegë, Drizë e Kozare, duke përfshirë studimin dhe piketimin e terrenit, dhe punimet e nevojshme.
Partnerët	DPUK, Bashkia Kuçovë
Justifikimi i Projektit	• Ky projekt siguron një ndër nevojat bazë sanitare dhe jetike të popullsisë së fshatrave përkatës; • Projekti mundëson kushte më të mira higjienike dhe mjedisore për vendbanimet e specifikuara.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P5 *"Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm, dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, duke siguruar shërbim cilësor për gjithë territorin e bashkisë"* të Objektivit O2: *"Zhvillimi i infrastrukturës lokale e aksesi rajonal"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projektit teknik; • Sigurimi i financimit nga fonde të posaçme shtetërore, ose donacione.
Rezultate të pritura	• Ofrimi i infrastrukturës së KUZ në pjesën më të madhe të territorit të fshatrave të projektit; • Mbyllja dhe rehabilitimi i gropave septike.
Risqet	• Pamundësia financiare për të përballuar koston e projektit; • Mungesa e një rrjeti të tillë ekzistues sjell vështirësi në ngritjen e rrjetit të ri nga e para, për t'iu përshtatur terrenit, dhe për të patur distancën e kërkuar nga vijat ujore të ujitjes e përrenjve.
Statusi aktual i projektit	Studim / Projektim_Aplikuar për financim
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _ 2015-2016 Tenderimi dhe Zbatimi _2016
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 9 (O2P5_PR17)

Qëllimi	Rehabilitimi i infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve dhe sistemit të ujitjes e kullimit për zonat problematike të Bashkisë Kuçovë.
Titulli i Projektit	PR17: Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit kullues në zonën pranë UPN, në seksionin Porta e Përpunimit-Hipotekë.
Preventivi	20,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Zona e projektit është nën përmbytje të vazhdueshme për shkak të rreshjeve të shiut, dhe amortizimit të kanalit ekzistues kullues.
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon pastrimin dhe rehabilitimin e kanalit ekzistues, si dhe rikonstruktimin e tij në zonat problematike.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, Komuniteti lokal
Justifikimi i Projektit	• Ky projekt do shmangë problemin e përmbytjes në zonën pranë UPN, që shkaktohet nga bllokimi i kanalit ekzistues.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P5 *"Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm, dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, duke siguruar shërbim cilësor për gjithë territorin e bashkisë"* të Objektivit O2: *"Zhvillimi i infrastrukturës lokale e aksesi rajonal"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projektit teknik; • Sigurimi i financimit nga fonde të posaçme shtetërore, dhe alokim i buxhetit respektiv bashkiak; • Marrje masash për pastrim të rregullt të kanaleve dhe kundër ndërtimeve të mundshme mbi kanal;
Rezultate të pritura	• Rritja e cilësisë së infrastrukturës në qytet; • Shmangia e problematikës së përmbytjes së zonës në UPN;
Risqet	• Pamundësia financiare për të përballuar koston e projektit
Statusi aktual i projektit	Koncept ide
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _2016-2017 Zbatimi _2018
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 10 (O2P5_PR18)

Qëllimi	Rehabilitimi i infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve dhe sistemit të ujitjes e kullimit për zonat problematike të Bashkisë Kuçovë
Titulli i Projektit	PR18: Rikonstruktim i infrastrukturës së ujësjellësit në segmentin Çiflik-Kuçovë
Preventivi	130,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Ky projekt zhvillohet për shkak të nevojave në rritje të popullsisë për ujë të pijshëm. Rezervuarët e Ciflikut janë një ndër burimet kryesore të furnizimit me ujë të qytetit të Kuçovës. Aktualisht rrjeti është i vjetëruar (20 vjeçar) dhe kërkon rikonstruktim të tubacioneve kryesore.
Përshkrimi i Projektit	Projekti konsiston në rikonstruktim të rrjetit të ujësjellësit nga rezervuaret në fshatin Ciflik, në qytetin e Kuçovës, në pikat ku tubacionet janë dëmtuar dhe ka humbje.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, Komuniteti lokal
Justifikimi i Projektit	• Ky projekt do sigurojë furnizim të vazhdueshëm me ujë në qytetin e Kuçovës, sidomos gjatë verës, ku niveli i ujit në rezervuare bie për arsye të thatësirës.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P5 *"Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm, dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, duke siguruar shërbim cilësor për gjithë territorin e bashkisë"* të Objektivit O2: *"Zhvillimi i infrastrukturës lokale e aksesi rajonal".*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projektit teknik që të sigurojë mosdëmtimin e tokës bujqësore dhe mospërzierjen e ujërave të rrjetit me ato nëntokësore; • Sigurimi i financimit nga fonde të posaçme shtetërore, dhe alokim i buxhetit respektiv bashkiak; • Rehabilitim i tokës së dëmtuar gjatë procesit të punimeve.
Rezultate të pritura	• Furnizimi vazhdueshëm me ujë të pijshëm i banorëve të Kuçovës; • Rritja e cilësisë së ujit, si pasojë e rehabilitimit të tubacionit të çelikut që e shpërndan atë nga rezervuari i Ciflikut.
Risqet	• Pamundësia financiare për të përballuar koston e projektit; • Dëmtimi i tokës bujqësore gjatë ndërhyrjeve në territor.
Statusi aktual i projektit	Koncept ide
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _ 2017-2018 Tenderimi dhe Zbatimi _2019-2020
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 11 (O3P1_PR2)

Qëllimi	Rritja e qëndrueshmërisë mjedisore, nëpërmjet masave parandaluese dhe rigjeneruese
Titulli i Projektit	PR2: Rehabilitimi mjedisor dhe rigjenerimi i ish zonave industriale të TEC-it dhe Uzinës së Përpunimit të Naftës.
Preventivi	Rehabilitim zona Uzina e Përpunimit të Naftës, Varianti 1 837,000,000.00 Lekë Rehabilitim zona Uzina e Përpunimit të Naftës, Varianti 2 4,464,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Ky projekt synon të zgjidhë në mënyrë përfundimtare problematikën e mbetjeve industriale në dy zonat më të rëndësishme ish-industriale të bashkisë. Këto zona janë të paintegruara funksionalisht me qytetin, ndonëse ndodhen në pika mjaft qëndrore të tij. Në to vërehet degradim strukturor dhe amortizim i objekteve, si dhe ndotje e tokës dhe e ujërave nëntokësore nga veprimtaria e dikurshme e tyre.
Përshkrimi i Projektit	Projekti ka si fokus rehabilitimin mjedisor të tokës dhe strukturave në zonat ish industriale të TEC-it dhe UPN-së. Pas aplikimit të strategjive të rehabilitimit mjedisor të ndërtesave, pastrimit të tokës, shtimit të gjelbërimit që i përgjigjet funksioneve rigjeneruese, projekti synon t'i kthejë zonat në qendra të integruara me qytetin, të fokusuara në rekreacion, evente artistike e kulturore, etj.
Partnerët	BE, Bashkia Kuçovë, Ministria e Mjedisit, OJQ, Komuniteti Lokal
Justifikimi i Projektit	• Ky projekt do sjellë një përmirësim mjedisor të ndjeshëm në qytetin e Kuçovës; • Projekti do risjellë në funksionim dy zona që përbënin barrë vizuale dhe mjedisore për qytetin.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P1: *"Rehabilitimi mjedisor dhe rigjenerimi i ish-zonave industriale në territorin e bashkisë, me synim kthimin e tyre në zona banimi dhe rekreacioni"* të Objektivit O3: "Mbrojtja e zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit".
Veprimet Strategjike	• **Faza 1: Hartimi i studimit për marrjen e masave mjedisore për rehabilitimin e zonës, pastrimin e tokës, zbutjen e amortizimit, etj;** • **Faza 2: Zbatimi i masave rikuperuese, plotësimi i zonave me infrastrukturën e gjelbër që i përshtatet funksionit;** • **Faza 3: Hartimi i strategjisë për ndryshimin funksional të zonave, në funksion të rekreacionit, shërbimeve publike, etj, duke përfshirë partneritete të mundshme me sektorin privat;** • **Faza 4: Dizenjimi funksional e estetik i zonave në përputhje me funksionin e ri.**
Rezultate të pritura	• Ulja e nivelit të ndotjes së tokës në zonat ish-industriale; • Përmirësimi i situates së gjelbërimit në qytet, e cila ndikon në rritjen e cilësisë së ajrit; • Krijimi i poleve të reja rekreative të qytetit, si mundësi atraksioni në rang rajonal.
Risqet	• Ndotja e tokës dhe e ujërave nëntokësore mund të jetë përhapur përtej zonës së projektit; • Kërkohet investim i lartë për të ndjekur të gjithë hapat e projektit, që nga pastrimi deri te ndryshimi i funksioneve dhe dizenjimi në trajtë parku rekreativ.
Statusi aktual i projektit	Aplikuar për fonde nga BE
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _2016 Zbatimi _2017-2020
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 12 (O4P4_PR13)

Qëllimi	Akses më i mire në shërbime rekreative e sociale të cilësisë së lartë
Titulli i Projektit	PR13_Rikonstruksioni i stadiumit të Kuçovës dhe krijimi i një poli të rëndësishëm rekreativ në zonën e stadiumit
Preventivi	120,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Stadiumi i Kuçovës ka një sipërfaqe prej 9560 m2 dhe është objekti më i rëndësishëm sportiv i qytetit, ku kryhen pjesa më e madhe e aktiviteteve të lidhura me sportin. Gjendja e tij aktuale është relativisht e lire, përveendja e tij aktuale është relativisht e mirë, përveç shkallëve të anës perëndimore, të cilat kanë nevojë për rikonstruksion.
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon rikonstruksionin e shkallares së stadiumit, në hyrjen në pjesën perëndimore të tij.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, Komuniteti lokal, Ministria e Arsimit dhe Sportit, FSHZH
Justifikimi i Projektit	• Projekti i shërben rikonstruksionit dhe funksionalitetit të objektit më të rëndësishëm sportive në rang bashkie; • Me kryerjen e rikonstruksionit, stadiumi mund të shtojë numrin e aktiviteteve dhe numrin e pjesëmarrësve në to.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P4: *"Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i populisë, duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese, dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit"* të Objektivit O4: *"Mbështetje e komuniteteve për zhvillim social"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimit të detajuar teknik të rikonstruktimit; • Gjetja e mundësive për financim nga fonde qeveritare, të palëve private, etj; • Realizimi i punimeve deri në vitin 2016.
Rezultate të pritura	• Rritja e numrit të aktiviteteve të organizuara në stadium; • Rritja e numrit të përdoruesve të stadiumit; • Përmirësim i imazhit të objekteve sportive në bashki.
Risqet	• Financimi i kërkuar ka vlerë të lartë, të papërballueshme vetëm nga buxheti bashkiak; • Shqetësime të përkohshme të aktiviteteve për shkak të punimeve.
Statusi aktual i projektit	Koncept ide
Fazat e projektit	Projektimi - Tenderimi – Zbatimi 2026-2030
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 13 (O2P3_PR9)

Qëllimi	Përmirësimi i infrastrukturës lokale në brendësi të zonave urbane e rurale
Titulli i Projektit	PR9: Rikonstruksioni dhe ndërtimi i urave që lidhin akset rrugore në dy anët e Përroit të Lapardhicës: Ura e varur në Lumas
Preventivi	50,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Ura aktuale në fshatin Lumas është e paqëndrueshme dhe përbën rrezik kalimi për automjetet, sidomos në periudhën e pranverës e vjeshtës, kur shtohet sasia e ujit në lumë. Eshtë e nevojshme të bëhet një ristrukturim i plotë i urës së varur, për të rritur sigurinë e kalimeve dhe aksesin e fshatit.
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon ristrukturimin e urës së varur në fshatin Lumas, duke përforcuar strukturën ekzistuese.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, komuniteti lokal
Justifikimi i Projektit	• Ky projekt adreson problemin e sigurisë në kalimin e urës ekzistuese • Sigurohet akses më i mirë i fshatit Lumas me pjesën tjetër të Bashkisë
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P3: *"Përmirësimi i lidhjeve ndërqytetëse mes qendrave të njësive rurale me njëra tjetrën dhe me Kuçovën"* të Objektivit O2: *"Zhvillimi i infrastrukturës lokale e aksesi rajonal"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimit të detajuar teknik të rikonstruktimit; • Gjetja e burimeve të financimit nga Ministria e Transportit, FSHZH, etj; • Hapja e procesit të tenderimit; • Kryerja e punimeve afateve; • Hartimi i masave për mirëmbajtje në vazhdim.
Rezultate të pritura	• Rritja e sigurisë gjatë kalimit të urës; • Përmirësimi i aksesueshmërisë në Lumas; • Rritja e bashkëpunimeve tregtare dhe lëvizjeve nga Lumas në pjesën tjetër të bashkisë.
Risqet	• Financimi i kërkuar ka vlerë të lartë, të papërballueshme vetëm nga buxheti bashkiak; • Probleme të mundshme gjatë punimeve si rezultat i sjelljes së ujërave, kushteve klimatike, etj; • Impakt i përkohshëm mjedisor gjatë punimeve, për shkak të pajisjeve të rënda, depozitimit të mbetjeve inerte, ndotjes akustike, etj.
Statusi aktual i projektit	Studim dhe Projektim
Fazat e projektit	Studimi dhe Projektimi _ 2024 Tenderimi dhe Ndërtimi _ 2025
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 14 (O4P5_PR15)

Qëllimi	Përmirësim i cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës në bashki
Titulli i Projektit	PR15: Zgjerimi i zonës së varrezave të qytetit Kuçovë
Preventivi	30,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Aktualisht, varrezat e qytetit të Kuçovës, të ndodhura në kufirin verior të tij, po shkojnë drejt plotësimit total të sipërfaqes së tyre.
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon zgjerimin e sipërfaqes së varrezave, duke konvertuar token e kultivuar përreth nga përdorimi bujqësi, në përdorim të veçantë. Gjithashtu propozohet një brez i gjelbërt rreth e qark parcelave të varrezave, për t'u distancuar nga zonat e banuara përreth.
Partnerët	Bashkia Kuçovë
Justifikimi i Projektit	• Sipërfaqja aktuale me funksion varrezë është në përfundim, dhe nuk plotëson nevojat e zonës urbane të Kuçovës
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P5: *"Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Kuçovë, gjelbërimit dhe hapësirave me karakter të veçantë, për t'i shërbyer funksionit njedisor dhe estetik për qytetin."* të Objektivit O4: *"Mbështetje e komuniteteve për zhvillim social"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projektit të zgjerimit dhe të dizenjimit peisazhistik me elemente të gjelbra; • Gjetja e mundësive për financim nga fonde të tjera; • Realizimi i punimeve deri në vitin 2017.
Rezultate të pritura	• Rritja e kapacitetit mbajtës të parcelave të varrezave; • Sigurimi i zonave buferike, ndarëse mes varrezave dhe vendbanimeve të afërta të tyre.
Risqet	• Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore të kultivuar; • Zgjerimi drejt pronave private mund të sjellë konflikte pronësie; • Vështirësi në gjetjen e burimeve të jashtme të financimit;
Statusi aktual i projektit	Koncept-Projekt
Fazat e projektit	Projektimi _ 2016 Zbatimi _2017
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 15 (O3P2_PR3)

Qëllimi	Përmirësim i cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës në bashki
Titulli i Projektit	PR3: Hartimi i një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel bashkie, me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane dhe blerja e automjeteve për transportimin e mbetjeve urbane.
Preventivi	Blerja e automjeteve për transportimin e mbetjeve urbane 4,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Gjendja aktuale e menaxhimit të mbetjeve në rang bashkie është jo e mirë, për shkak të mungesës së një vendi depozitimi sanitar të mbetjeve, pranisë së mbetjeve industriale, si pasojë e sektorit të përpunimit të naftës, etj. Gjithashtu nuk ka veprimtari riciklimi apo kompostimi të mbetjeve.
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon ndërtimin e një landfilli sanitar për depozitimin e mbetjeve urbane dhe hartimin e një strategjie të mbledhjes, grumbullimit e depozitimit të mbetjeve në nivel bashkie, të ndjekur nga strategji të detajuara për riciklimin e mbetjeve, kompostimin, menaxhimin e mbetjeve industriale e të naftës, etj.
Partnerët	Bashkia Kuçovë
Justifikimi i Projektit	• Madhësia e bashkisë së re e justifikon ndërtimin e një landfilli me kapacitet mesatar; • Gjendja aktuale e depozitimit të mbetjeve është alarmante, sidomos në lidhje me mbetjet industrial.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P2: *"Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane"* të Objektivit O3: *"Mbrojtja e zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit"*.
Veprimet Strategjike	• Hartimi i planit të menaxhimit të mbetjeve në nivel bashkie • Hartimi i një plani veprimi për riciklimin e mbetjeve familjare • Zhvillimi i një plani për kompostimin e mbetjeve ushqimore në njësitë administrative rurale • Hartimi i një strategjie për menaxhimin e mbetjeve industriale dhe të naftës • Studimi i parametrave të ndërtimit të landfillit të Bashkisë Kuçovë • Gjetja e mundësive të financimit të landfillit dhe projekteve të riciklimit dhe kompostimit, duke adresuar fonde të qeverisë • Krijim i partneriteteve me sektorin privat të interesuar në procesin e riciklimit dhe kompostimit • Marrja e masave për rritje kapacitetesh në menaxhimin e shërbimit publik të menaxhimit të mbetjeve në nivel bashkie
Rezultate të pritura	• Përmirësimi i kushteve mjedisore në zonat ekzistuese të vend-depozitimit të mbetjeve • Ulja e sasisë së mbetjeve të depozituara në terma afatgjatë, si rezultat i kompostimit • Ndërtimi i një landfilli sanitar rajonal, me potencial për gjenerim të ardhurash nga përdorimi i përbashkët me bashki fqinje • Fuqizimi i industrive rajonale me fokus riciklimin e letrës, qelqit dhe metaleve
Risqet	• Vështirësi në gjetjen e fondeve për ndërtimin e një landfilli sipas parametrave të kërkuar sanitarë • Probleme në gjetjen e subjekteve të interesuara për të kryer riciklim të mbetjeve familjare bashkiake • Probleme kulturore në mënyrën e menaxhimit të mbetjeve • Nivel i ulët i kthimit të investimit për landfillin në periudhën fillestare të funksionimit • Probleme të mundshme në pozicionimin e landfillit, në ruajtjen e balancave mes pronësisë dhe disponueshmërisë, aksesit të landfillit nga gjithë njësitë administrative, dhe vetive të përshtatshme gjeo-teknike të tokës.
Statusi aktual i projektit	Koncept-Projekt + Në process (blerja e automjeteve)
Fazat e projektit	Projektimi _ 2016 Zbatimi _2017
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër (blerja e automjeteve)

FISHË PROJEKTI 16 (O3P8_PR15)

Qëllimi	Zhvillimi social dhe kulturor i Bashkisë Kuçovë, si pikë me identitet të fortë në rajon
Titulli i Projektit	PR15: Ndërtimi i një objekti muzeal të naftës
Preventivi	87,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Bashkia e Kuçovës identifikohet me qytetin naftëmbajtës, ku uzina e përpunimit të naftës, së bashku me tërësinë e pus-shpimeve dhe industrive mbështetëse, janë elementët më të fortë qytetformues. Këta elementë duhet të shfaqen në trajtë muzeu.
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon ndërtimin e një muzeu të naftës, i cili do të ekspozojë gjithë veprimtarinë e Kuçovës si qytet naftëmbajtës, gjurmët e hershme të buimeve të naftës, aktivitetet industriale gjatë periudhës së ndërtimit dhe operimit të UPN, etj. Ky muze integrohet mirë me planin e rehabilitimit dhe rivitalizimit të zonës ish-industriale të UPN dhe TEC-it.
Partnerët	Bashkia Kuçovë, Ministria e Kulturës
Justifikimi i Projektit	• Në qytetin e Kuçovës ka dy zona ish-industriale, shumë pranë qendrës, të cilat kanë potencial për t'u shndërruar në hapësira rekreative për qytetin. Këto mund të jenë vendndodhje e muzeut të naftës; • Qyteti i Kuçovës përbën një rast të veçantë në Shqipëri, përsa i përket nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, si rrjedhojë, ndërtimi i një muzeu do kishte vlerë kulturore për të gjithë vendin; • Në Bashkinë Kuçovë mungojnë muzeumet e hapësirat e ngjashme kulturore.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P8: *"Përmirësimi i imazhit të qytetit si "qytet i naftës", duke valorizuar identitetin në shërbim të turizmit"* të Objektivit O3: *"Mbrojtja e zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit"*.
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projektit të muzeut, si përshtatje mes arkitekturës moderne dhe stilit industrial tipik të zones; • Gjetja e burimeve të financimit, nga qeveria ose palë të treta të interesuara; • Integrimi i hapësirave muzeale me hapësirën e rehabilituar të UPN-së.
Rezultate të pritura	• Zhvillimi i një poli të ri kulturor e rekreativ për qytetin; • Rritja e vizibilitetit të Kuçovës në këndvështrim rajonal; • Rritja e numrit të vizitorëve ditorë në Kuçovë; • Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nivelit kulturor për banorët e Kuçovës.
Risqet	• Vështirësi në gjetjen e financimit, me fonde nga qeveria ose palë të treta të interesuara; • Zonat ku paramendohet të vendoset muzeu do i nënshtrohen një procesi pastrimi dhe rehabilitimi mjedisor, i cili mund të zgjasë në kohë; • Mund të ketë vështirësi në gjetjen e një vendndodhjeje alternative.
Statusi aktual i projektit	Koncept-Projekt
Fazat e projektit	Projektimi _2017-2018 Tenderim - Zbatimi _2019-2020
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 17 (O2P1_PR1)

Qëllimi	Përmirësimi i cilësisë dhe aksesit të infrastrukturës në nivel bashkie
Titulli i Projektit	PR1: Ndërtimi i bypass-it të Kuçovës si pjesë e Boshtit Qendror Jugor
Preventivi	[Investim i qeverisë qendrore]
Sfondi i Projektit	Në kuadrin e planit strategjik kombëtar për ndërtimin e Boshtit Jugor, i cili përshkon territorin e Bashkisë Kuçovë, pritet që lëvizshmëria tranzit brenda qytetit të Kuçovës të rritet. Për të shmangur problemet e ndotjes së ajrit, ndotjes akustike, trafikut, etj brenda qytetit, rekomandohet të ndërtohet një bypass në pjesën perëndimore të Kuçovës
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon ndërtimin e një bypass-i për qytetin e Kuçovës, i cili është pjesë e Boshtit Qendror Jugor. Ky bypass kalon në pjesën perëndimore të qytetit të Kuçovës kryqëzohet me aksin rrugorë Kuçovë- Ura Vajgurore dhe më pas kalon në NjA Perondi, përbri airoportit dhe lidhet më aksin rrugorë Lushnje-Berat.
Partnerët	Qeveria Shqiptare
Justifikimi i Projektit	• Rritja e qarkullimit në qytetin e Kuçovës, si pasojë e densitetit të lartë të popullsisë dhe vendndodhjes së shërbimeve kryesore në nivel bashkie, kërkon që të çlirohet qendra dhe Rruga "Stanislav Zaber" nga trafiku tranzitor; • Projekti është pjesë e Boshtit të Jugut, një ndër akset kryesore strategjike kombëtare, i cili nis në Papër e përfundon në Memaliaj, ku lidhet me akset kombëtare.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P1: *"Konsolidimi i lidhjeve të Bashkisë Kuçovë në nivel rajonal, duke siguruar integrimin me rrjetet shtetërore rrugore"* të Objektivit O2: *"Zhvillimi i infrastrukturës lokale e aksesi rajonal"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimit të fizibilitetit për gjurmën më të përshtatshme të shtrirjes së bypass-it; • Hartimi i projektit të detajuar teknik te bypass-it; • Gjetja e mundësive për financim nga fonde të qeverisë, apo palëve të treta të interesit; • Zhvillimi i një strategjie për minimizimin e impaktit të rrugës në biodiversitet dhe marrjen e masave rehabilituese.
Rezultate të pritura	• Përmirësim i aksesit në gjithë territorin e Bashkisë Kuçovë; • Ulja e trafikut dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit në qytetin e Kuçovës; • Rritja e vlerës së pronës për fshatrat e Kozares ku kalon gjurma e rrugës.
Risqet	• Vështirësia e gjetjes së fondeve për financim të bypass-it; • Lehtësimi në qarkullimin tranzit bën që automjetet dhe përdoruesit e tyre të mos ndalojnë më në qytetin e Kuçovës; • Gjurma e rrugës shkakton disbalanca në biodiversitet; • Rritje e kostos dhe problematikës sociale për shkak të shpronësimit të zonës ku kalon gjurma dhe hapësira buferike e bypass-it.
Statusi aktual i projektit	-
Fazat e projektit	-
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë

FISHË PROJEKTI (O3P3_PR7)

Qëllimi	Zhvillimi i potencialeve të turizmit natyror në Bashkinë Kuçovë
Titulli i Projektit	PR7: Krijimi i një parku rajonal në zonën nga Rezervuari i Murrizit deri në fshatin Vlashuk
Preventivi	10,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Projekti synon të rivlerësojë peisazhin kodrinoro-fushor e lumor të njësisë Kozare, si potencial për t'u shndërruar në një park për Bashkinë Kuçovë, të integruar me itineraret e gjelbra rajonale: Fier Shegan-Gramsh dhe Belsh-Berat-Memaliaj
Përshkrimi i Projektit	Projekti parashikon hartimin e një studimi peisazhistik për zonën kodrinore të Kozarës, duke përfshirë mbjelljen me bimësi të lartë, në trajtë pylli të rrallë, vendosjen e elementeve rekreativë, krijimin e shtigjeve të shëtitjes, etj
Partnerët	Bashkia Kuçovë, Ministria e Mjedisit, FSHZH, Komuniteti lokal
Justifikimi i Projektit	• Ky projekt shërben për integrimin e Kuçovës në rrjetin e itinerareve natyrore rajonale, duke e kthyer qytetin në qendër potenciale turistike; • Projekti shërben për të ofruar një hapësirë të shëndetshme rekreative për bashkinë; • Sistemimet bimore në kodra mundësojnë përmirësim të cilësisë së ajrit të ndotur dhe përbëjnë barrierë për efektet e pakëndshme të puseve të naftës.
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P3: *"Sistemimi në trajtë parku i zonës së kodrave të Kozarës"* të Objektivit O3: *"Mbrojtja e zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit"*.
Veprimet Strategjike	• Hartimi i planit peisazhistik për vendosjen e bimësisë në mënyrë të tillë, që të valorizohet zona dhe të shmangen problemet e aromës së çliruar prej puseve të naftës; • Gjetja e investitorëve nëpërmjet inkuadrimit të projektit në strategjinë rajonale të zhvillimit të turizmit; • Zhvillimi i itinerareve natyrore rajonale, nëpërmjet caktimit të sinjalistikës, pikave çlodhëse, pikave të informacionit, etj.
Rezultate të pritura	• Rritja e cilësisë së jetës për komunitetin lokal, në aspekt të hapësirës rekreative dhe zbutjes së efekteve të pakëndshme të naftës në ajër; • Rritja e numrit të vizitorëve ditorë në park, si pjesë e itinerareve rajonale të shëtitjes.
Risqet	• Prania e puseve të naftës dhe aromës së çliruar prej tyre kërkon që bimësia në kodra të zgjidhet me kujdes, që t'i shërbejë funksionit primar rekreativ; • Vështirësi në gjetjen e investitorëve që marrin përsipër një pjesë të kostove të larta të projektit.
Statusi aktual i projektit	Koncept-Projekt
Fazat e projektit	Projektimi –Tenderimi - Zbatimi _2021-2025
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 19 (O2P3_PR11)

Qëllimi	Rehabilitimi i infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve dhe sistemit të ujitjes e kullimit për zonat problematike të Bashkisë Kuçovë
Titulli i Projektit	**PR11: Përmirësimi i ndriçimit e sinjalistikës në të gjithë bashkinë dhe ndërtimi e pajisja me infrastrukturë KUZ i "rrugës së Drizës" në lagjen "11 Janari", Kuçovë**
Preventivi	150,000,000.00 Lekë
Sfondi i Projektit	Ky projekt adreson problematikën aktuale në "Rrugën e Drizës", e cila është e pashtruar dhe e pashërbyer me rrjet të KUZ. Kjo rrugë lidh lagjen "11 Janari" me aksin kryesor urban "Stanisllav Zuber", dhe vazhdimi i saj në pjesën kodrinore, përfundon në fshatin Drizë. Pra ky segment rrugor përbën fillimin e një korridori të rëndësishëm inter-urban dhe një itinerari potencial natyror.
Përshkrimi i Projektit	**Projekti ka si synim rikonstruksionin e gjurmës ekzistuese të rrugës, duke pajisur me sinjalistikën respektive, hapësirën kombësore të nevojshme, si dhe ndriçimin dhe gjelbërimin rrugor të përshtatshëm. Gjithashtu projekti parashikon ndërtimin e rrjetit të KUZ për gjithë segmentin e rrugës në brendësi të qytetit Kuçovë.**
Partnerët	Bashkia Kuçovë, Komuniteti lokal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Justifikimi i Projektit	• Projekti i shërben përmirësimit të lidhjes ndërurbane mes Kuçovës dhe fshatit Drizë, si një itinerar alternativ ndaj rrugës "Ismail Qemali"; • Projekti ndikon në përmirësimin e ofrimit të shërbimit të KUZ për lagjen "11 Janari".
Objektivi	Projekti kontribuon në Politikën P3: ***"Përmirësimi i lidhjeve ndërqytetëse mes qendrave të njësive rurale me njëra tjetrën dhe me Kuçovën"*** të Objektivit O2: ***"Zhvillimi i infrastrukturës lokale e aksesi rajonal".***
Veprimet Strategjike	• Kryerja e studimit të detajuar, që përfshin detajet tekniko-inxhinerike për shtrimin e rrugës; • Gjetja e mënyrave të financimit/alokimi i buxhetit nga fondet e veta; • Zbatimi i punimeve deri në fund të vitit 2017; • Integrimi i aksit me itinerarin natyror të rajonit, nëpërmjet sinjalistikës, shërbimeve dhe vegjetacionit.
Rezultate të pritura	• **Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe ofrimit të shërbimeve për lagjen "11 Janari";** • **Rritja e aksesit ndaj fshatit Drizë, duke ofruar një mundësi alternative kalimi;** • **Përmirësimi i sigurisë dhe cilësisë mjedisore në segmentin e shtruar rrugor;** • **Përmirësimi i infrastrukturës turistike të itinerareve natyrore në rang bashkie.**
Risqet	• **Pamundësia financiare për të përballuar koston e projektit në gjithë komponentët e tij;** • **Moskryerja e punimeve në përputhje me pritshmëritë kohore;** • **Ndotja akustike dhe mjedisore, si dhe pengesat e përkohshme gjatë periudhës së kryerjes së punimeve.**
Statusi aktual i projektit	**Koncept ide**
Fazat e projektit	Projektimi _ 2016 Tenderim - Zbatimi 2017
Vlerësimi i prioriteteve	**Afatshkurtër**

7. Shtojca

Shtojca 1. Të ardhura Bashkia Kuçovë, 2010 – 2015

TË ARDHURAT (në 000/Lekë)		2010	2011	2012	2013	2014	2015
A	Taksa vendore	54,694	41,418	55,265	39,644	61,280	45,754
1	Taksa mbi pasurinë	18,244	13,973	16,595	13,109	29,540	25,451
1.1	*Taksa mbi ndërtesat*	6,735	6,450	7,337	6,651	20,247	17,743
1.2	*Taksa mbi tokën bujqësore*	11,509	7,524	9,259	6,458	9,293	7,708
2	Taksa mbi biznesin e vogël	20,173	12,706	25,843	14,824	19,072	16,065
3	Taksë tabele	296	306	137	119	155	134
4	Taksë reklame	206	81	24	10	42	5
5	Taksa e regjistrimit e biznesit	134	136	230	80	186	-
6	Taksë zënie hapësire publike	13,553	12,379	12,303	11,155	10,595	1,529
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	1,872	1,674	83	331	1,498	2,283
8	Taksa e kalimit të pronësisë	-	29	-	-	142	229
9	Taksë fjetje në hotel	-	-	-	-	-	58
10	Taska të tjera vendore	215	133	50	17	50	-
B	Tarifat vendore	20,948	18,736	21,333	33,794	39,172	41,656
1	Tarifë pastrimi	6,047	5,995	6,008	7,746	11,737	15,488
2	Tarifë gjelbërimi	-	-	-	-	-	3,800
3	Tarifë ndriçimi	-	-	-	-	-	5,573
4	Licenca, leje, autorizime	1,202	1,101	1,108	591	582	-
5	Tarifë therrje bagëtie	257	202	247	221	209	222
6	Tarifa të tjera të miratuara	12,085	9,905	12,545	22,818	24,825	-
7	Të ardhura nga parkimi	1,112	879	854	618	501	434
8	Të tjera (interesa, gjoba)	143	219	198	348	634	1,038
9	Të tjera	101	434	373	1,452	684	15,101
C	Të ardhura nga asetet	7,378	7,149	9,573	10,386	8,734	8,569
1	Të ardhura nga qeratë	1,853	1,556	4,684	5,107	4,579	3,337
2	Të ardhura nga shitja aseteve	-	-	-	-	-	-
3	Të ardhura nga kopshtet dhe çerdhet	5,349	5,444	4,824	5,217	4,070	5,232
4	Të tjera	175	148	65	62	86	
D	Të ardhura të tjera	840	630	-	200	50	154,852
1	Donacione	840	630	-	200	50	131,570
2	Dividendë, KSHP	-	-	-	-	-	23,282
3	Kredi	-	-	-	-	-	-
E	Të ardhura të trashëguara	-	-	-	-	-	211,107
F	Taksa e tatime të ndara	13,018	10,693	12,272	9,599	7,141	7,783
G	Transferta e pakushtëzuar	120,913	122,220	95,892	123,283	136,626	126,361
H	Transferta e kushtëzuar	270,715	199,183	235,613	354,036	295,337	253,701
1	Ekonomia	-	-	-	-	-	-
2	Bujqësia	-	-	-	-	-	-
3	Transporti dhe infrastruktura	58,464	5,574	37,529	93,345	22,787	21,303
4	Arsimi	28,336	8,964	16,451	30,524	28,186	949
5	Kultura	-	-	-	-	-	2,618
6	Shëndetësia	-	1,120	1,413	-	-	-
7	Mbrojtja	5,274	5,739	3,183	4,034	5,919	10,335
8	Përkujdesi social	178,640	175,509	177,036	223,794	238,444	206,942
9	Komisioni qendror i zgjedhjeve	-	2,276	-	2,339	-	-
10	Zhvillimi Urban	-	-	-	-	-	11,555
TOTALI		488,505	400,029	429,948	570,943	548,340	849,782

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Shtojca 2. Shpenzime Bashkia Kuçovë, 2010 – 2015

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Personel	104,004	93,881	92,561	100,469	107,830	110,049
Operative	336,754	282,971	309,894	333,124	377,174	348,987
Kapitale	78,738	163,552	109,272	336,195	190,224	174,556
Total	**519,496**	**540,404**	**511,727**	**769,787**	**675,228**	**633,592**

Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

	O3P3: Sistemimi në trajtë parku i zonës së kodrave të Kozares	PR7: Krijimi i një parku rajonal në zonën nga Rezervuari i Murrizit deri në fshatin Vlashuk
		PR8: Krijimi i një rrjeti bujtinash në fshatrat përreth rarkut rajonal qe te krijohen kapacitet e duhura te hotelerisë në zonë.
	O3P5: Rehabilitimi mjedisor i zonave ripariane të lumenjve dhe përrenjve.	PR9: Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative te zonave ripariane të Lumit Devoll dhe Osum-Seman.
		PR10: Rehabiltimi mjedisor dhe marrja e masave për minimizimin e erozionit të tokave bujqësore përgjatë Përroit të Lapardhicës.
		PR11: Realizimi i masave infrastrukturore dhe vegjetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga Lumenjtë Devoll dhe Osum
	O3P6: Hartimi i një plani për studimin e ndotjes reale të tokës dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën naftëmbajtëse të Kozares	PR12: Kryerja e një studimi të integruar për vlerësimin e ndotjes nga nafta në tokë, ajër, ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore
		PR13: Marrja e masave për rekuperimin e efekteve të dëmtimit dhe ndotjes nga nafta, permiresimi i kushteve fizike të puseve.
	O3P7: Reduktimi i efekteve negative të emetimeve të zonës industriale ekzistuese dhe zgjerimit të propozuar të saj.	PR14: Hartimi i planit të reduktimit të emetimeve të zonës së UMN, dhe industrisë tjetër në hyrje të qytetit, si dhe marrja e masave taksative për zbatimin e tij.
	O3P8: Përmirësimi i imazhit të qytetit si "qytet i naftës", duke valorizuar identitetin në shërbim të turizmit,	PR15: Ndërtimi i një objekti muzeal të naftës
		PR16: Ndërtimi i një muzeu të aeronautikës në zonën e fushës së aviacionit
		PR17: Hartimi i një strategjie për kthimin e një pjese të blloqeve '1 Maji' dhe 'Llukan Prifti' si lagje-muze, për qëllime identifikimi dhe turistike
		PR18: Zgjatimi dhe kthimi në rrugë për këmbësorë i bulevardit kryesor të qytetit.
		PR19: Kthimi i puseve të naftës në objekte atraktive (lyerja vendosja e ndriçuesave) për ti dhënë një pamje tjetër qytetit.
O4: Mbështetje e komuniteteve për zhvillim social	O4P1: Rikonstruksioni i objekteve arsimore shëndetsore dhe me funksione publike	PR1: Rikonstruksioni i shkollave 9 vjeçare, i shkollës së mesme në Perondi dhe i oborrit të shkollave-kopshteve si dhe ambjenteve ndihmëse të tyre
		PR2: Përmirësimi i kushteve laboratorike dhe sportive të objekteve arsimore 9-vjeçare dhe të mesme në bashki.
		PR3: Ndërtimi i kopshteve në Fshatrat Frashër, Luzaj, Katundas dhe Belesovë si dhe rikonstruksioni i kopshtit në Fshatin Lumas.
		PR4: Ndërtimi i një shkolle të mesme në fshtin Gegë dhe i një qendre shëndetsore në Fshatin Goraj
		PR5: Rikonstruksion zyrash dhe mbikqyrje punimesh për to; kolaudim punimesh ndërtim ambulance Lumas; kolaudim, mbikqyrje rikonstruksion shkolle Lumas; kolaudim punimesh Sheqëz-Vodhëz-Koritëz- Lumas
		PR6: Kolaudim, mbikqyrje punimesh i rikonstruksionit të banesave rome Lumas
	O4P2: Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i shesheve kryesore në qytet dhe në qendrat e njësive rurale	PR7: Rikonstruktimi i sheshit të pazarit në Kuçovë
		PR8: Rikonstruktimi i shesheve të brendshme të blloqeve 5-katëshe të banimit në lagjen 1 Maji dhe i shesheve të qendrave të njësive administrative të Lumasit, Perondisë dhe Kozares
	O4P3: Krijimi i mundësive të strehimit të përballueshëm për popullsinë aktuale, dhe strehimit social	PR9: Ndërtimi i një Objekti të strehimit social për popullsinë e pastrehë, ose në nevojë strehimi
		PR10: Hartimi i një plani të regjistrimit të gjithë familjeve të pastreha në bashki

		PR11: Integrimi i politikave të strehimit në instrumentet e planifikimit, si bonus intensiteti, apo kushtëzime të tjera për zhvilluesit e PDV
	O4P4: Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i popullsisë, duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese, dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit	PR12: Ndërtimi i një Qendre Artistike e Kulturore për Shërbime ndaj të Rinjve
		PR13: Rikonstruksioni i stadiumit të Kuçovës dhe krijimi i një poli të rëndësishëm sportiv e rekreativ në zonën e stadiumit.
	O4P5: Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Kuçovë, gjelbërimit dhe hapësirave me karakter të veçantë, për t'i shërbyer funksionit mjedisor dhe estetik për qytetin.	PR14: Rikonstruktimi i pikës turistike të qendrës Kuçovë
		PR15: Zgjerimi i zonës së varrezave të qytetit Kuçovë
		PR16: Krijimi i parqeve të vogla urbane në zona natyrore periferike të qytetit (krijimi i parkut në meandrimin e Lumit Devoll në afërsi te venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta të qytetit).
		PR17: Ndërtimi i një itinerari për biçikleta dhe kembësorë me hapësira te gjelbra përgjate kanalit vaditës që kalon në qytet.
		PR18: Programi për mbjelljen e pemëve dekorative në rrugët kryesore të qytetit të Kuçovës.
	O4P6: Hartimi i një strategjie të përfshirjes në arsim profesional të popullsisë vendase, në ndihmë të punësimit në sektorë të industrisë së lehtë, artizanit, etj.	PR19: Ngritja e një shkolle profesionale rajonale, për naftën.
		PR20: Kryerja e marrëveshjeve me operatorë artizanalë dhe shërbimesh, për zhvillimin e trajnimeve në sektorë specifikë, ndihmës për ekonominë lokale.
	O4P7: Programi për marrjen e masave të plotësimit me bazë materiale në institucionet që ofrojnë sherbimet sociale	PR21: Pajisja me soba për ngrohje me dru në institucionet arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe)
		PR22: Blerje librash për Qendrën Rinore dhe Bibliotekën

Burimi: Strategjia për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Kuçovë, 2016

Shtojca 4. Parashikimi i të ardhurave Bashkia Kuçovë, 2016 – 2030

TË ARDHURA (000/Lekë)		2016	2017	2018	2019	2020	2021-2025	2026-2030
A	**Taksa vendore**	**75,100**	**62,570**	**63,780**	**64,900**	**66,198**	**70,521**	**81,909**
1	Taksa mbi pasurinë	43,200	44,000	44,700	45,400	46,308		
1.1	*Taksa mbi ndërtesat*	22,000	22,500	23,000	23,500	23,970		
1.2	*Taksa mbi tokën bujqësore*	19,000	19,200	19,300	19,400	19,788		
1.3	*Taksa mbi truallin*	2,200	2,300	2,400	2,500	2,550		
2	Taksa mbi biznesin e vogël	1,200	1,300	1,400	1,500	1,530		
3	Taksë tabele	-	100	150	200	204		
4	Taksë reklame	100	120	130	150	153		
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	30,500	16,700	16,900	17,000	17,340		
6	Taksa e kalimit të pronësisë	-	200	300	400	408		
7	Taksë fjetje në hotel	100	150	200	250	255		
B	**Tarifat vendore**	**53,140**	**58,280**	**59,140**	**60,100**	**61,308**	**68,580**	**74,995**
1	Tarifë pastrimi	19,360	19,500	19,700	20,000	20,400		
2	Tarifë gjelbërimi	-	4,500	4,600	4,700	4,800		
3	Tarifë ndriçimi	7,100	7,300	7,400	7,500	7,650		
4	Tarifë therrje bagëtie	300	300	320	340	347		
5	Tarifë për zënien e hapësirave publike	3,500	3,600	3,700	3,800	3,876		
6	Të ardhura nga parkimi	620	640	670	700	714		
7	Të tjera	22,260	22,440	22,750	23,060	23,521		
C	**Të ardhura nga asetet**	**15,460**	**15,600**	**15,780**	**16,000**	**16,320**	**18,409**	**21,577**
1	Të ardhura nga qeratë	10,460	10,500	10,580	10,700	10,914		
2	Të ardhura nga shitja e aseteve	-	-	-	-	-		
3	Të ardhura nga kopshtet dhe çerdhet	5,000	5,100	5,200	5,300	5,406		
4	Të tjera							
D	**Të ardhura të tjera**	**44,477**	**6,742**	**5,679**	**6,700**	**6,834**	**11,225**	**11,601**
1	Donacione	-	-	-	-	-	-	-
2	Dividendë, KSHP	44,477	6,742	5,679	6,700	6,834	11,225	12,453
3	Kredi							
E	**Të ardhura të trashëguara**	**31,482**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
F	**Taksa e tatime të ndara**	**11,000**	**11,200**	**11,300**	**11,400**	**11,628**	**13,144**	**16,495**
G	**Transferta e pakushtëzuar**	**118,950**	**128,162**	**133,288**	**138,619**	**141,391**	**155,953**	**183,234**
H	**Transferta e kushtëzuar**	**120,125**	**121,742**	**121,742**	**121,742**	**124,177**	**135,426**	**157,993**
I	**Transferta specifike**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
	TOTALI	**469,734**	**404,296**	**410,709**	**419,461**	**427,856**	**473,257**	**547,803**

Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

Shtojca 5. Parashikimi shpenzimeve sipas kategorive Bashkia Kuçovë, 2016 – 2030

	2016	2017	2018	2019	2020	2021-2025	2026-2030
Personel	210,041	215,247	216,244	218,388	221,227	222,496	229,932
Operative	164,336	154,077	155,365	158,043	159,623	162,606	165,532
Kapitale	99,857	77,572	79,800	80,830	83,255	95,194	111,222
Total	**474,234**	**446,896**	**451,409**	**457,261**	**464,105**	**480,297**	**506,686**

Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Kuçovë dhe Co-PLAN, 2016

8. Shënime dhe referenca

Manuali për Hartimin e Planit të Investimeve Kapitale, Co-PLAN 2008

Plani Strategjik i Zhvillimit dhe Buxhetimi Afatmesëm me Bazë Performancën, dldp 2012

Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë, Bashkia Kuçovë 2016 përgatitur me asistencën e PLGP/USAID dhe Co-PLAN.

[1] Të ardhurat totale u ndanë në dy kategori: (i) kategoria e të ardhurave nga transferat ndërqeveritare ku u përfshinë të ardhurat nga transferta e kushtëzuar, transferta e pa kushtëzuar, transferta specifike (nga viti 2016) dhe të ardhurat nga taksa dhe tatime të ndara; (ii) kategoria e të ardhurave vendore ku u përfshinë të ardhurat nga taksat vendore, tarifat, të ardhurat nga asetet dhe të ardhura të tjera.

[2] Përfshirja e fondeve të trashëguara në totalin e të ardhurave vendore është një zgjedhje konvencionale për qëllime analize. Ky zë i të ardhurave përfshin të ardhura nga burime të ndryshme, përfshirë fondin e Zhvillimit të Rajoneve apo nga fonde të tjera. Në pamundësi ndarje në zëra të veçantë u vlerësua e përshtatshme përfshirja e tij në kategorinë e të ardhurave të tjera të të ardhurave vendore.

[3] Ligji Nr. 142/2015 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9632/2006 "Mbi sistemin e taksave vendore"

[4] Për të lehtësuar përdorimin e dokumentit të PIK, në këtë kapitull janë bashkangjitur disa prej Fishave të Projekteve Kapitale të përgatitura nga Bashkia Kuçovë, duke reflektuar në këtë mënyrë edhe projektet më strategjike të Bashkisë

	PARASHIKIMI I BUXHETIT KAPITAL (në 000 lekë)	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
I	**TË ARDHURAT KAPITALE**	**47,746**	**23,177**	**27,493**	**137,350**	**63,336**	**390,747**	**95,357**	**34,972**	**39,100**	**43,030**	**47,006**	**74,216**	**76,596**	**85,840**	**96,199**	**107,920**	**126,632**	**138,282**	**151,997**	**166,696**	**182,349**
1	Teprica operative neto	45,034	20,873	27,411	136,820	61,788	233,612	20,380	11,530	16,521	19,330	22,832	37,064	47,766	55,824	64,548	74,519	91,201	103,230	115,576	128,865	143,159
2	Të ardhura nga shitja e pronave	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Hua	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Dhurata, donacione	840	630	-	200	50	131,570	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Dividendë, KSHP	-	-	-	-	-	23,282	44,477	6,742	5,679	6,700	6,834	15,495	9,119	9,642	10,514	11,353	12,347	11,654	12,212	12,778	13,276
6	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë	1,872	1,674	83	331	1,498	2,283	30,500	16,700	16,900	17,000	17,340	21,657	19,711	20,374	21,138	22,048	23,084	23,398	24,209	25,053	25,915
7	Të ardhura nga taksa te përmirësimit/instrumenta të tjerë të posaçëm të zhvillimit																					
II	**SHPENZIMET KAPITALE**	**78,738**	**163,552**	**109,272**	**336,195**	**190,224**	**174,556**	**99,857**	**77,572**	**79,800**	**80,830**	**83,255**	**92,689**	**91,112**	**94,091**	**97,235**	**100,844**	**104,714**	**107,359**	**110,933**	**114,639**	**118,467**
1	Shërbimet e përgjithshme publike	*3,032*	*2,901*	*2,870*	*7,402*	*1,848*	110															
2	Rendi dhe siguria publike - Shërbimet policore																					
3	Çështjet ekonomike	*23,985*	*145,697*	*57,819*	*199,548*	*134,422*	135,574															
4	Mbrojtja e mjedisit																					
5	Strehimi, komoditetet e komunitetit	*21,042*	*4,294*	*30,000*	*98,465*	*24,835*	37,740															
6	Shëndetësia	-	*1,120*	*1,413*	-	-																
7	Argëtimi, kultura, çështjet fetare	*1,886*	*110*	*108*	*45*	*50*	148															
8	Arsimi	*28,793*	*9,430*	*17,062*	*30,734*	*29,069*	985															
9	Mbrojtja sociale																					
	TOTALI	(30,991)	(140,375)	(81,778)	(198,844)	(126,888)	216,190	(4,500)	(42,600)	(40,700)	(37,800)	(36,249)	(18,473)	(14,516)	(8,251)	(1,036)	7,076	21,919	30,923	41,064	52,057	63,882

PLANIFIKIMI BUXHETIT OPERATIV 000 Lekë		2010 *Fakt*	2011 *Fakt*	2012 *Fakt*	2013 *Fakt*	2014 *Fakt*	2015 *Fakt*	2016 *Plan*	2017 *Plan*	2018 *Plan*	2019 *Plan*	2020 *Plan*	2021 *Plan*	2022 *Plan*	2023 *Plan*	2024 *Plan*	2025 *Plan*	2026 *Plan*	2027 *Plan*	2028 *Plan*	2029 *Plan*	2030 *Plan*
I	TE ARDHURA Korente	485,793	397,724	429,866	570,412	546,792	692,647	394,787	380,854	388,130	395,761	403,682	417,992	430,020	440,710	452,136	464,377	482,380	496,494	511,079	526,527	542,871
I.I	**Të ardhura të pa kushtëzuara**	***215,078***	***198,541***	***194,253***	***216,376***	***251,455***	***438,946***	***274,632***	***259,112***	***266,388***	***274,019***	***279,505***	***287,553***	***297,374***	***305,730***	***314,323***	***323,126***	***333,412***	***343,449***	***353,546***	***364,033***	***374,947***
A	Të trashëguara nga viti i mëparshëm	-	-	-	-	-	211,107	31,482	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
B	Taksa dhe tatime vendore	52,821	39,744	55,183	39,313	59,782	43,471	44,600	45,870	46,880	47,900	48,858	48,178	49,018	49,649	50,196	50,637	54,489	55,878	57,387	59,089	61,045
C	Tarifa vendore	20,948	18,736	21,333	33,794	39,172	41,656	53,140	58,280	59,140	60,100	61,308	64,233	66,673	68,520	70,584	72,890	72,009	73,642	75,105	76,488	77,728
D	Të ardhura nga asetet	7,378	7,149	9,573	10,386	8,734	8,569	15,460	15,600	15,780	16,000	16,320	17,415	17,845	18,339	18,902	19,541	20,249	20,873	21,539	22,243	22,978
E	Taksa të ndara	13,018	10,693	12,272	9,599	7,141	7,783	11,000	11,200	11,300	11,400	11,628	12,436	12,752	13,094	13,488	13,948	15,115	15,731	16,416	17,181	18,030
F	Transferta e Pakushtëzuar	120,913	122,220	95,892	123,283	136,626	126,361	118,950	128,162	**133,288**	138,619	141,391	145,290	151,085	156,128	161,153	166,111	171,549	177,326	183,099	189,032	195,165
I.II	**Të ardhura të kushtëzuara**	***270,715***	***199,183***	***235,613***	***354,036***	***295,337***	***253,701***	***120,125***	***121,742***	***121,742***	***121,742***	***124,177***	***130,439***	***132,646***	***134,980***	***137,812***	***141,252***	***148,968***	***153,045***	***157,532***	***162,494***	***167,924***
G	Transferta e Kushtëzuar	270,715	199,183	235,613	354,036	295,337	253,701	120,125	121,742	**121,742**	121,742	124,177	130,439	132,646	134,980	137,812	141,252	148,968	153,045	157,532	162,494	167,924
H	Transferta Specifike	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
II	SHPENZIMET TOTALE	519,496	540,404	511,727	769,787	675,228	633,592	474,234	446,896	451,409	457,261	464,105	473,616	473,366	478,977	484,823	490,703	495,892	500,624	506,436	512,301	518,179
II.1	**SHPENZIMET KORENTE**	**440,759**	**376,851**	**402,455**	**433,592**	**485,004**	**459,035**	**374,377**	**369,324**	**371,609**	**376,431**	**380,850**	**380,927**	**382,254**	**384,896**	**387,588**	**389,859**	**391,179**	**393,265**	**395,503**	**397,662**	**399,712**
A	Paga	104,004	93,881	92,561	100,469	107,830	110,049	210,041	215,247	216,244	218,388	221,227	219,473	221,388	222,634	223,931	225,057	226,946	228,471	229,916	231,401	232,925
B	Operative	336,754	282,971	309,894	333,124	377,174	348,987	164,336	154,077	**155,365**	158,043	159,623	161,455	160,867	162,252	163,657	164,802	164,233	164,794	165,587	166,261	166,786
C	Kapitale	78,738	163,552	109,272	336,195	190,224	174,556	99,857	**77,572**	**79,800**	80,830	83,255	92,689	91,112	94,091	97,235	**100,844**	104,714	107,359	110,933	114,639	118,467
III	TEPRICA OPERATIVE NETO	45,034	20,873	27,411	136,820	61,788	233,612	20,380	11,530	16,521	19,330	22,832	37,064	47,766	55,824	64,548	74,519	91,201	103,230	115,576	128,865	143,159
IV	% (mbetjes operat. të ardhura operat)	9.3	5.2	6.4	24.0	11.3	33.7	5.2	3.0	4.3	4.9	5.7	8.9	11.1	12.7	14.3	16.0	18.9	20.8	22.6	24.5	26.4

TE ARDHURAT VENDORE (në 000/Lekë)		2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
A	**Taksa vendore**	**54.694**	**41.418**	**55.265**	**39.644**	**61.280**	**45.754**	**75.100**	**62.570**	**63.780**	**64.900**	**66.198**	**69.835**	**68.729**	**70.023**	**71.334**	**72.685**	**77.573**	**79.276**	**81.596**	**84.142**	**86.960**
1	Taksa mbi pasurinë	18,244	13,973	16,595	13,109	29,540	25,451	43,200	44,000	44,700	45,400	46,308										
1.1	*Taksa mbi ndërtesat*	6,735	6,450	7,337	6,651	20,247	17,743	22,000	22,500	23,000	23,500	23,970										
1.2	***Taksa mbi tokën bujqësore***	11,509	7,524	9,259	6,458	9,293	7,708	19,000	19,200	19,300	19,400	19,788										
1.3	*Taksa mbi truallin*							2,200	2,300	2,400	2,500	2,550										
2	Taksa mbi biznesin e vogël	20,173	12,706	25,843	14,824	19,072	16,065	1,200	1,300	1,400	1,500	1,530										
3	Taksë tabele	296	306	137	119	155	134	-	100	150	200	204										
4	Taksë reklame	206	81	24	10	42	5	100	120	130	150	153										
5	Taksa e regjistrimit e biznesit	134	136	230	80	186	-															
6	Taksë zënie hapësire publike	13,553	12,379	12,303	11,155	10,595	1,529															
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	1,872	1,674	83	331	1,498	2,283	30,500	16,700	16,900	17,000	17,340	21,657	19,711	20,374	21,138	22,048	23,084	23,398	24,209	25,053	25,915
8	Taksa e kalimit të pronësisë	-	29	-	-	142	229	-	200	300	400	408										
9	Taksë fjetje në hotel	-	-	-	-	-	58	100	150	200	250	255										
10	Taska të tjera vendore	215	133	50	17	50	-															
B	**Tarifa vendore**	**20,948**	**18,736**	**21,333**	**33,794**	**39,172**	**41,656**	**53,140**	**58,280**	**59,140**	**60,100**	**61,308**	**64,233**	**66,673**	**68,520**	**70,584**	**72,890**	**72,009**	**73,642**	**75,105**	**76,488**	**77,728**
1	Tarifë pastrimi	6,047	5,995	6,008	7,746	11,737	15,488	19,360	19,500	19,700	20,000	20,400										
2	Tarifë gjelbërimi	-	-	-	-	-	3,800		4,500	4,600	4,700	4,800	4,896									
3	Tarifë ndriçimi	-	-	-	-	-	5,573	7,100	7,300	7,400	7,500	7,650										
4	Licenca, leje, autorizime (transport,etj)	1,202	1,101	1,108	591	582	-															
5	Tarifë therrje bagëtie	257	202	247	221	209	222	300	300	320	340	347										
6	Tarifë për zënien e hapësirave publike							3,500	3,600	3,700	3,800	3,876										
7	Tarifa te tjera te miratuara nga NjA	12,085	9,905	12,545	22,818	24,825	-															
8	Tarifë gjuetie dhe peshkimi amator																					
9	Të ardhura nga parkimi	1,112	879	854	618	501	434	620	640	670	700	714										
10	Të tjera (interesa, gjoba)	143	219	198	348	634	1,038															
11	Te tjera	101	434	373	1,452	684	15,101	22,260	22,440	22,750	23,060	23,521										
C	**Të ardhura nga asetet**	**7,378**	**7,149**	**9,573**	**10,386**	**8,734**	**8,569**	**15,460**	**15,600**	**15,780**	**16,000**	**16,320**	**17,415**	**17,845**	**18,339**	**18,902**	**19,541**	**20,249**	**20,873**	**21,539**	**22,243**	**22,978**
1	Të ardhura nga qeratë	1,853	1,556	4,684	5,107	4,579	3,337	10,460	10,500	10,580	10,700	10,914										
2	Të ardhura nga shitja e aseteve												-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Të ardhura nga kopshtet dhe çerdhet	5,349	5,444	4,824	5,217	4,070	5,232	5,000	5,100	5,200	5,300	5,406										
4	**Të tjera**	175	148	65	62	86																
D	**Të ardhura të tjera**	**840**	**630**	**-**	**200**	**50**	**154,852**	**44,477**	**6,742**	**5,679**	**6,700**	**6,834**	**15,495**	**9,119**	**9,642**	**10,514**	**11,353**	**11,786**	**11,007**	**11,403**	**11,773**	**12,038**
1	Dhurata/Sponsorizime																					
2	Donacione	840	630	-	200	50	131,570						-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Dividendë, KSHP	-	-	-	-	-	23,282	44,477	6,742	5,679	6,700	6,834	15,495	9,119	9,642	10,514	11,353	12,347	11,654	12,212	12,778	13,276

4	Kredi																					
E	**Të ardhura të transhëguara dhe grante**	-	-	-	-	-	**211.107**	**31.482**					-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
F	**Taksa e tatime të ndara**	**13.018**	**10.693**	**12.272**	**9.599**	**7.141**	**7.783**	**11.000**	**11.200**	**11.300**	**11.400**	**11.628**	**12.436**	**12.752**	**13.094**	**13.488**	**13.948**	**15.115**	**15.731**	**16.416**	**17.181**	**18.030**
G	**Transferta e pakushtëzuar**	**120.913**	**122.220**	**95.892**	**123.283**	**136.626**	**126.361**	**118.950**	**128.162**	**133.288**	**138.619**	**141.391**	**145.290**	**151.085**	**156.128**	**161.153**	**166.111**	**171.549**	**177.326**	**183.099**	**189.032**	**195.165**
H	**Transferta e kushtëzuar**	**270.715**	**199.183**	**235.613**	**354.036**	**295.337**	**253.701**	**120.125**	**121.742**	**121.742**	**121.742**	**124.177**	**130.439**	**132.646**	**134.980**	**137.812**	**141.252**	**148.968**	**153.045**	**157.532**	**162.494**	**167.924**
1	Ekonomia	-	-	-	-	-																
2	Bujqësia	-	-	-	-	-																
3	Transporti dhe infrastruktura	58.464	5.574	37.529	93.345	22.787	21.303															
4	Arsimi	28.336	8.964	16.451	30.524	28.186	949															
5	Kultura	-	-	-	-	-	2.618															
6	Shendetesia	-	1.120	1.413	-	-																
7	Mbrojtja	5.274	5.739	3.183	4.034	5.919	10.335															
8	Përkujdesi social	178.640	175.509	177.036	223.794	238.444	206.942															
9	Mjedisi	-	-	-	-	-																
10	Komisioni qendror i zgjedhjeve	-	2.276	-	2.339	-																
11	Integrimi Evropian	-	-	-	-	-																
12	Zhvillimi Urban	-	-	-	-	-	11.555															
I	**Transferta specifike**												-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	TOTALI	488.505	400.029	429.948	570.943	548.340	849.782	469.734	404.296	410.709	419.461	427.856	455.144	458.851	470.726	483.787	497.778	517.250	530.899	546.691	563.353	580.823

OBJEKTIVI	PROGRAMI	PROJEKTET INVESTIMI T I NO (në lekë)	FISHI X	Njësia administrative	Vlera e Investimit (lekë)	Programuar të realizohet në vitin ...														
						2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
						20,380,114	11,529,852	16,520,600	19,330,287	22,832,035	37,064,356	47,765,937	55,823,880	64,547,563	74,518,661	91,200,962	103,229,622	115,575,756	128,865,082	143,159,206
O1: Zhvillim i qëndrueshëm social-ekonomik	O1P1: Zhvillimi i politikave nxitëse dhe mbështetja infrastrukturore për rikualifikimin dhe rritjen e performancës së zonave industriale të bashkisë	PR1: Hartimi i PDV për rizhvillimin industrial të zonës së ish UMN			100,000						100,000									
		PR2: Sigurimi i infrastrukturës bazë për strukturat industriale dhe magazinuese në hyrje të qytetit			500,000					500,000										
		PR3: Krijimi i një pike grumbullimi të produkteve bujqësore në Kozarë		Kozarë	80,000,000		40,000,000	40,000,000												
		PR4: Rritja e kapaciteteve të tregut aktual në Kuçovë sidhe rigjenerimi i zonës			100,000,000				100,000,000											
		PR5: Krijimi i një qendre agro-industriale për përpunimin, përgatitjen e prodhimeve në shkalle rrethi		Kozarë	150,000,000					150,000,000										
	O1P2: Rritja e performancës së sektorëve ekonomikë në Bashkinë Kuçovë (shërbime, bujqësi e tregti e produkteve bujqësore)	PR6: Krijimi i zonës ekonomike me njësi tregtare dhe shërbimesh përgjatë aksit rrugorë Kuçovë-Ura Vajgurore.			100,000,000				50,000,000	50,000,000										
		PR7: Programi për mbjelljen e fidaneve të rinj të drurëve frutorë në zonën e kodrave të qytetit të Kuçovës			10,000,000			3,333,333	3,333,333	3,333,333										
		PR8: Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë Bashkinë Kuçovë			220,000,000	71,212,520	74,393,740	74,393,740												

	O1P3: Nxitja e procesit të zgjerimit dhe densifikimit për të gjithë qendrat e njësive administrative, si dhe për disa fshatra me potencial urbanizimi	PR9: Krijimi i PDV për polet e reja urbane në qytet, që do pësojnë rizhvillim e rehabilitim, duke siguruar parametra zhvillimi efikas			300,000		300,000													
		PR10: Hartimi i PDV për zonat e zgjerimit në fshatrat Kozare Qendër, Lumas, Perondi, Vodëz, dhe fshatra të tjerë që do presin zhvillim.			500,000				500,000											
	O1P4: Përmirësimi i klimës së biznesit të vogël, nëpërmjet politikave nxitëse dhe sigurimit të infrastrukturës së përshtatshme mbështetëse të tyre.	PR11: Mbështetje e zhvillimit të NVM-ve dhe bizneseve të vogla artizanale në zonat ekonomike me karakter tregtar (qendra e zona ekonomike Kuçovë-UraVajgurore), nëpërmjet instrumenteve stimuluese në PDV.			200,000			100,000	100,000											
O2: Zhvillimi i infrastrukturës lokale e aksesi rajonal	O2P1: Konsolidimi i lidhjeve të Bashkisë Kuçovë në nivel rajonal, duke siguruar integrimin me rrjetet shtetërore rrugore	PR1: Ndërtimi i Boshtit Qendror Jugor	Fisha 17																	
		PR2: Rehabilitimi dhe ndërtimi i pjesshëm i unazës përreth qytetit (Rruga Kuçovë-Perondi-Magjatë-Dumollë-Goraj- Drizë-Gegë-Kuçovë).			200,000,000									200,000,000						
		PR3: Ndërtimi i rrugës tangeciale që lidh aksin Kuçovë- Ura Vajgurore nga kthesa e fermës deri tek ura e Lumit Devoll nëpërmjet ish zonave industriale.			300,000,000							150,000,000	150,000,000							

	PR4: Rehabilitimi i rrugës së Belshit si rrugë që luan rolin e boshtit kombëtar qendror në një periudhë afatmesme dhe rehabilitimi dhe ndërtimi i pjesshëm i rrugës Kuçovë-Arrëz			100,000,000																100,000,000
	PR:5 Ndërtimi i dy urave njëra mbi Lumin Osum dhe tjetra mbi Lumin Devoll			300,000,000																300,000,000
O2P2: Integrimi i Bashkisë Kuçovë në tërësinë e itinerareve të gjelbra rajonale, nëpërmjet infrastrukturës së lehtë, turistike	PR1: Ndërtimi i Boshtit Qendror Jugor D16:S16			25,000,000					25,000,000											
O2P3: Përmirësimi i lidhjeve ndërqytetëse mes qendrave të njësive rurale me njëra tjetrën dhe me Kuçovën	PR7: Ndërtimi i rrugëve që lidhin Lumasin me qytetin e Kuçovës (Kuçovë-Magjatë-Sheqëz-Vodhëz-Lumas, Kuçovë-Goraj-Pashtraj-Bardhaj-Lumas, Kuçovë-Velagosht - Lumas)	**Fisha I**		700,000,000		700,000,000														
	PR8: Rehabilitimi i rugës Kuçovë-Perondi-Lapardha-Vodhëz-Lumas-Pellumbas-Belesovë-Meandrake			200,000,000			200,000,000													
	PR9: Rikonstruksioni dhe ndërtimi i urave që lidhin aksel rrugore në dy anët e Përroit të Lapardhicës	**Fisha 13**		50,000,000											50,000,000					

		PR10. Rehabilitimi i aksit rrugor Perondi-Qoshk-Sheqëz-Bardhaj-Goriçan-Lumas-Langozaj.			150,000,000						150,000,000									
		PR11: Përmirësimi i ndriçimit e sinjalistikës në të gjithë bashkinë dhe ndërtimi e pajisja me infrastrukturë KUZ i "rrugës së Drizës" në lagjen "11 Janari", Kuçovë	Fisha 19		150,000,000		150,000,000													
		PR12: Rehabilitimi i akseve rrugore që lidhin fshatrat turistik në NJA Perondi dhe Lumas.			150,000,000					150,000,000										
	O2P4: Sistemimi i rrjeteve rrugore lokale, për të rritur nivelin e jetueshmërisë në qytet dhe zona rurale	PR13: Rikonstruksioni i pjesshëm i akseve rrugore "Toli Shuka", "Koli Hoxholli", "Kongresi i Lushnjes", "Koco Koleci", "Ismail Qemali", "Isa Boletini"; shtrim i segmenteve rrugore nga sheshi 11 Janari deri të tunelet e UMN e nga Policia deri të Spitali; supervizion rruga " K. Laçka-Q.Stafa" (në proces).	Fisha 2		114,817,632	114,817,632														
		PR14: Ristrukturimi i rrugëve lokale të fshatit Magjatë e Bardhaj, i rrugëve në Kozare, rrugëve dytësore në Lumas			12,554,296	12,554,296														
		PR15: Ndërtimi i korsive të Biçikletave në			100,000,000								100,000,000							

	Qytetin e Kuçovës																			
	PR16: Ndërtimi i rjetit të KUZ në fshatrat Drizë, Gegë, Kozarë	Fisha 8		167,670,894	167,670,894															
	PR17: Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit kullues në zonën prane UPN, në seksionin Porta e Përpunimit-Hipotekë	Fisha 9		20,000,000			20,000,000													
	PR18: Rikonstruktim i infrastrukturës së ujësjellësit në segmentin Çiflik-Kuçove	Fisha 10		130,000,000				65,000,000	65,000,000											
O2P5: Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm, dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, duke siguruar shërbim cilësor për gjithë territorin e bashkisë"	PR19: Hartimi i një plani afatgjatë për sigurimin e shërbimit të ujësjellësit në fshatrat Demollarë, Luzaj, Belesovë, Mendrakë, Sheqëz, Krekëz, Koritëz dhe Katundas, Lumas dhe Pellumbas.			99,980,000		99,980,000														
	PR20: Rehabilitimi i sistemit të gropave septike në fshatrat që nuk kanë akses në rrjetin e kanalizimeve			200,000,000			100,000,000	100,000,000												
	PR21: Përmirësimi tërësor i sistemit të kanalizimeve, duke ndarë ujërat e bardha nga të zeza në qytet, e duke siguruar mbulim me rrjet për gjithë bashkinë			100,000,000			50,000,000	50,000,000												
	PR22: Ndërtimi i një impianti të trajtimit të ujërave të zeza dhe ndërtimi i tubacionit kryesor paralel me kanalin e Dikatrës			250,000,000				125,000,000	125,000,000											

	O2P6:Përmirësimi i situatës së lëvizshmërisë dhe transportit publik në nivel bashkie.	PR23: Zhvillimi i një sistemi transporti publik brenda bashkisë, për të siguruar aksesin e fshatrave Drize, Perondi e Lumas drejt Kuçovës			1,000,000		1,000,000													
		PR24: Sistemimi dhe zgjerimi i terminalit të autobusëve në qytetin e Kuçovës			20,000,000		20,000,000													
		PR25: Mbulimi me transport publik efikas i gjithë territorit të bashkisë																		
	O3P1: Rehabilitimi mjedisor dhe rigjenerimi i ish-zonave industriale në territorin e bashkisë, me synim krijimin e tyre në zona banimi dhe rekreacioni	PR1: Rehabilitimi mjedisor dhe rizhvillimi i zonës së TEC-it si pol kulturor e rekreativ																		
		PR2: Rehabilitimi mjedisor dhe ristrukturimi i ish zonës industriale të Uzinës së Përpunimit të Naftës, për të siguruar cilësi të mirë jetese sidhe krijimi ne hapësire gjelbër dhe rekreative.	Fisha 11		4,464,000,000	4,464,000,000														
O3: Mbrojtja e zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit	O3P2: Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane	PR3:Hartimi i një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel bashkie, me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane dhe blerja e automjeteve për transportimin e mbetjeve urbane.	Fisha 15		4,000,000	4,000,000														
		PR4: Ndërtimi i një landfilli sanitar për depozitimin e mbetjeve urbane			200,000,000				200,000,000											
		PR5: Hartimi i një strategjie dhe sigurimi i kushteve			1,000,000				500,000	500,000										

	fizike për kompostim të mbetjeve organike.																			
	PR6: Rehabilitimi mjedisor i venddepozitim it ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe kthimi në hapësirë të gjelbër me pemë të larta.			10,000,000				5,000,000	5,000,000											
O3P3: Sistemimi në trajtë parku i zonës së kodrave të Kozares	PR7: Krijimi i një parku rajonal në zonën nga Rezervuari i Murrizit deri në fshatin Vlashuk	Fisha 18		10,000,000									10,000,000							
	PR8: Krijimi i një rrjeti bujtinash në fshatrat përreth rarkut rajonal qe te krijohen kapacitet e duhura te hotelerisë në zonë.			15,000,000									15,000,000							
O3P5: Rehabilitimi mjedisor i zonave ripariane të lumenjve dhe përrenjve.	PR9: Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative te zonave ripariane të Lumit Devoll dhe Osum-Seman.			50,000,000									50,000,000							
	PR10: Rehabiltimi mjedisor dhe marrja e masave për minimizimin e erozionit të tokave bujqësore përgjatë Përroit të Lapardhicës.			15,000,000			7,500,000	7,500,000												
	PR11: Realizimi i masave infrastrukturor e dhe vegjetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga Lumenjtë Devoll dhe Osum			16,723,720	16,723,720															
O3P6: Hartimi i një plani për studimin e ndotjes reale të tokës dhe të ujërave sipërfaqësore	PR12: Kryerja e një studimi të integruar për vlerësimin e ndotjes nga nafta në tokë, ajër, ujëra			2,000,000		1,000,000	1,000,000													

dhe nëntokësore në zonën naftëmbajtëse të Kozares	sipërfaqësore dhe nëntokësore																			
	PR13: Marrja e masave për rekuperimin e efekteve të dëmtimit dhe ndotjes nga nafta, permirësimi i kushteve fizike të puseve.			4,000,000			2,000,000	2,000,000												
O3P7: Reduktimi i efekteve negative të emetimeve të zonës industriale ekzistuese dhe zgjerimit të propozuar të saj.	PR14: Hartimi i planit të reduktimit të emetimeve të zonës së UMN, dhe industrisë tjetër në hyrje të qytetit, si dhe marrja e masave taksative për zbatimin e tij.			1,000,000						500,000	500,000									
	PR15: Ndërtimi i një objekti muzeal të naftës	Fisha 16		87,000,000				43,500,000	43,500,000											
	PR16: Ndërtimi i një muzeu të aeronautikës në zonën e fushës së aviacionit			90,000,000				45,000,000	45,000,000											
	PR17: Hartimi i një strategjie për kthimin e një pjese të blloqeve 'I Maji' dhe 'Llukan Prifti' si lagje-muze, për qëllime identifikimi dhe turistike			2,000,000																2,000,000
	O3P8: Përmirësimi i imazhit të qytetit si "qytet i naftës", duke valorizuar identitetin në shërbim të turizmit,	PR18: Zgjatimi dhe kthimi në rrugë për këmbësorë i bulevardit kryesor të qytetit.			200,000,000					50,000,000	50,000,000	50,000,000	50,000,000								
		PR19: Kthimi i puseve të naftës në objekte atraktive (lyerja vendosja e ndriçuesave) për ti dhënë një pamje tjetër qytetit.			3,000,000				3,000,000											
O4: Mbështetje e komuniteteve për zhvillim social	O4P1: Rikonstruksioni i objekteve arsimore shëndetsore dhe me	PR1: Rikonstruksioni i shkollave 9 vjeçare, i shkollës së mesme në	Fisha 3		128,611,627	128,611,627														

funksione publike	Perondi dhe i oborrit të shkollave-kopshteve si dhe ambjenteve ndihmëse të tyre																			
	PR2: Përmirësimi i kushteve laboratorike dhe sportive të objekteve arsimore 9-vjeçare dhe të mesme në bashki.			50,000,000																50,000,000
	PR3: Ndërtimi i kopshteve në Fshatrat Frashër, Luzaj, Katundas dhe Belesovë si dhe rikonstruksion i i kopshtit në Fshatin Lumas.			50,000,000			16,666,667	16,666,667	16,666,667											
	PR4: Ndërtimi i një shkolle të mesme në fshtin Gegë dhe i një qendre shëndetsore në Fshatin Goraj			30,000,000						30,000,000										
	PR5: Rikonstruksio n zyrash dhe mbikqyrje punimesh për to; kolaudim punimesh ndërtim ambulance Lumas; kolaudim, mbikqyrje rikonstruksion shkolle Lumas; kolaudim punimesh Sheqëz-Vodhëz-Koritëz-Lumas			2,646,770			661,693	661,693	661,693	661,693										
	PR6: Kolaudim, mbikqyrje punimesh i rikonstruksion it të banesave rome Lumas		Lumas	46,800	46,800															
O4P2: Rikonstruksio ni dhe rehabilitimi i shesheve	PR7: Rikonstruktim i i sheshit të pazarit në Kuçovë	Fisha 4	Kuçovë	9,000,000				9,000,000												

kryesore në qytet dhe në qendrat e njësive rurale	PR8: Rikonstruktim i i shesheve të brendshme të bllokeve 5-katëshe të banimit në lagjen 1 Maji dhe i shesheve të qendrave të njësive administrative të Lumasit, Perondisë dhe Kozares	Fisha 4 & Fisha 7	Kuçovë	36,000,000			9,000,000	9,000,000	9,000,000	9,000,000											
O4P3: Krijimi i mundësive të strehimit të përballueshëm për popullsinë aktuale, dhe strehimit social	PR9: Ndërtimi i një Objekti të strehimit social për popullsinë e pastrehë, ose në nevojë strehimi	Fisha 6	Kuçovë	60,000,000		30,000,000	30,000,000														
	PR10: Hartimi i një plani të regjistrimit të gjithë familjeve të pastreha në bashki																				
	PR11: Integrimi i politikave të strehimit në instrumentet e planifikimit, si bonus intensiteti, apo kushtëzime të tjera për zhvilluesit e PDV			1,000,000			1,000,000														
O4P4: Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i popullsisë, duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese, dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit	PR12: Ndërtimi i një Qendre Artistike e Kulturore për Shërbime ndaj të Rinjve	Fisha 5		10,000,000				5,000,000	5,000,000												
	PR13: Rikonstruksioni i stadiumit të Kuçovës dhe krijimi i një poli të rëndësishëm sportiv e rekreativ në zonën e stadiumit.	Fisha 12		120,000,000																	120,000,000
O4P5: Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Kuçovë, gjelbërimit dhe hapësirave me karakter të veçantë, për	PR14: Rikonstruktim i i pikës turistike të qendrës Kuçovë	Fisha 4	Kuçovë	9,714,434	9,714,434																
	PR15: Zgjerimi i zonës së varrezave të qytetit Kuçovë	Fisha 14	Kuçovë	30,000,000		30,000,000															

t'i shërbyer funksionit mjedisor dhe estetik për qytetin.	PR16: Krijimi i parqeve të vogla urbane në zona natyrore periferike të qytetit (krijimi i parkut në meandrimin e Lumit Devoll në afërsi te venddepozitim it ekzistues të mbetjeve të ngurta të qytetit).			50,000,000			10,000,000	10,000,000	10,000,000	10,000,000	10,000,000									
	PR17: Ndërtimi i një itinerari për biçikleta dhe këmbësorë me hapësira te gjelbra përgjate kanalit vaditës që kalon në qytet.			20,000,000						6,666,667	6,666,667	6,666,667								
	PR18: Programi për mbjelljen e pemëve dekorative në rrugët kryesore të qytetit të Kuçovës.			5,000,000	5,000,000															
	O4P6: Hartimi i një strategjie të përfshirjes në arsim profesional të popullsisë vendase, në ndihmë të punësimit në sektorë të industrisë së lehtë, artizanit, etj.	PR19: Ngritja e një shkolle profesionale rajonale, për naftën.			Realizuar nga qeveria qendrore																
		PR20: Kryerja e marrëveshjeve me operatorë artizanalë dhe shërbimesh, për zhvillimin e trajnimeve në sektorë specifikë, ndihmës për ekonominë lokale.			1,000,000				200,000	200,000	200,000	200,000	200,000								
	O4P7: Programi për marrjen e masave të plotësimit me bazë materiale në institucionet që ofrojnë shërbimet sociale	PR21: Pajisja me soba për ngrohje me dru në institucionet arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe)			1,800,000		600,000	600,000	600,000												
		PR22: Blerje librash për Qendrën Rinore dhe Bibliotekën			300,000	300,000															
					9,992,466,173	4,994,651,923	1,147,273,740	566,255,433	851,561,693	754,361,693	257,128,359	217,366,667	206,866,667	375,000,000	50,000,000	-	-				
					71,888,245.85																